

DISERTACION

**POZITA JURIDIKO NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS
1974 – 2011**

Doktoranti: BASHKIM RRAHMANI

**DORËZUAR:
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
SHKOLLËS DOKTORALE**

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(SHKENCA JURIDIKE), me profil (E DREJTË NDËRKOMBËTARE), për
marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Dr. Sc. FERIT DUKA

Nr i fjalëve: 92,618

Tiranë, 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Studimi është punë origjinale dhe është kryer duke u respektuar standardet e njohura dhe të pranura për studime dhe hulumtime.

Autori i studimit është i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm për detyrimet që ka pasur në kuptim të përdorimit të literaturës, referimeve, referencave, citimeve, etj., gjatë kryerjes së studimit doktorat.

A u t o r i

Abstrakti

Qëllimi i studimit është që përmes një qasjeje objektive të bëhet një përshkrim dhe interpretim i fakteve dhe i shkaqeve, të cilat kanë çuar te shpallja e Pavarësisë së Kosovës, nga këndvështrimi i brendshëm dhe nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare publike. Studimi synon të shpjegojë mundësitë e Kosovës për të ndikuar në politikën e jashtme gjatë kohës sa ka qenë pjesë përbërëse e federatës jugosllave. Në studim paraqitet edhe një pasqyrë e raporteve ndërkombëtare dhe e normave të së drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë pasuruar të drejtën

ndërkombëtare lidhur me të drejtën e vetëvendosjes dhe njohjes ndërkombëtare të shteteve të reja.

Metodologjia e këtij studimi është paraqitja e teorisë së vetëvendosjes dhe njohjes ndërkombëtare të shteteve duke derivuar doktrinën e vetëvendosjes dhe njohjes ndërkombëtare të shteteve duke u bazuar në praktikën ndërkombëtare dhe për të aplikuar doktrinën në rastin e përzgjedhur. Janë diskutuar edhe çështjet e integritetit territorial, bisedimeve dhe konferencave ndërkombëtare sikundër edhe roli i diplomacisë së SHBA dhe BE në procesin e pavarësimit dhe njohjes së shtetit të Kosovës.

Është paraqitur gjithashtu se e drejta ndërkombëtare publike sikundër edhe bashkësia ndërkombëtare nuk janë kategori statike dhe se ato janë pasuruar me norma dhe parime të reja në kuptim të krijimit të shteteve të reja dhe njohjes së tyre.

Abstract

The purpose of this study is to present through an objective approach a description and interpretation of facts and causes which led towards the declaration of Kosova Independence from the internal viewpoint and from the international public law viewpoint. Study aims to explain possibilities of Kosova to impact foreign policy during the time it was part of Yugoslav federation. On overview of international relations and the norms of the international law is presented which have enriched the international law regarding the right to self determination and the recognition of new states.

Methodology of this study is presentation of the theory of self determination and international recognition of states by deriving doctrine of self determination and recognition of states based on the international practice and to apply the doctrine in the selected case. The issues of territorial integrity, negotiations and conferences are discussed as well as the role of US and EU diplomacy in the process of Kosova independence and the recognition of the state of Kosova.

It is presented that the international public law and the international community are not static categories and that they are enriched with the new norms and principles in sense of creation of new states and their recognition.

MIRËNJOHJE

Së pari, dua të shpreh mirënjohje dhe ta falënderoj udhëheqësin, Prof.Dr. Ferit Duka, i cili me përkushtim dhe me përgjegjësi intelektuale më ka ndjekur gjatë gjithë kohës së studimeve në shkollën doktrale. Udhëzimet e profesor Feritit për hulumtim, për gjetje të burimeve dhe për përdorimin e tyre kanë qenë vendimtare për të nxjerrë produktin që kemi në duar. Profesor Feriti ka qenë shtytje dhe inkurajim për punë hulumtuuese në njërin anë, dhe në anën tjetër ka krijuar mjedisin ku jam ndjerë plotësisht i barabartë në komunikimin intelektual.

Mirënjohjet dhe falënderimet i adresohen Komisionit, që na ka udhëzuar dhe ndjekur gjatë ditëve doktrale, në veçanti profesorëve Romeo Gurakuqit dhe Arjan Vasjari, të cilët duke kritikuar dhe njëkohësisht duke qenë kërkues kanë shtuar vullnetin tim për punë dhe për ngritje të përgjegjësisë gjatë kohës sime si doktorant.

Falënderoj gjithashtu Prof.Dr.Ksenofon Krisafin i cili ka qenë çdo herë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të miya për orientim me literaturë, për interpretim të normave të së drejtës ndërkombëtare dhe për gatishmërinë e tij për të më udhëzuar sidomos në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe në çështje metodologjike.

I gjithë personeli i shkollës doktrale meriton respekt dhe falënderim për asistencën e dhënë, kolegjalitetin dhe lehtësimet gjatë komunikimit.

Falënderoj familjen time që më ka mbështetur dhe duruar gjatë gjithë kohës dhe që ka pasur mirëkuptim në kohën kur unë, për arsye të studimit nuk kam arritur të përmbush në kohën e duhur detyrat si familjar, si prind dhe bashkëshort.

PËRMBAJTJA

| | |
|---|------|
| DEKLARATA E AUTORËSISË | iii |
| Abstrakti..... | iv |
| Abstract | v |
| MIRËNJOHJE | vi |
| SHKURTESAT..... | vi |
| PARATHËNIE | viii |
| Pyetje dhe hipoteza..... | xii |
| Metodologjia e studimit | xii |
| Metodat e studimit..... | xii |
| Burimet e studimit..... | xiii |
| Grupi i parë: | xiii |
| Grupi i dytë: | xiii |
| Grupi i tretë: | xiii |
| | |
| Hyrje | 1 |
| Vështrim i shkurtër historik mbi gjendjen politiko-juridike të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1974 | 1 |
| Kosova brenda Federatës Jugosllave sipas Kushtetutës së vitit 1946..... | 6 |
| Ligji Kushtetues i vitit 1953..... | 8 |
| Kushtetuta e vitit 1963 | 11 |
| Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e vitit 1963 | 14 |
| | |
| KREU I: Zhvillimet politiko- juridike në Kosovë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974 deri në vitin 1981 | 18 |
| 1.1. Vështrim në Kushtetutën e KSAK-së..... | 18 |

| | | |
|--|---|-----|
| 1.1.1. | Pavarësia territoriale e Kosovës..... | 24 |
| 1.1.2. | Autonomiteti i Kosovës | 25 |
| 1.1.3. | Autonomiteti në fushën e vetorganizimit..... | 25 |
| 1.1.4. | Autonomiteti në fushën legjislative | 27 |
| 1.1.5. | Autonomiteti në fushën ekzekutive | 27 |
| 1.1.6. | Autonomiteti në fushën gjyqësore | 28 |
| 1.1.7. | Autonomiteti në fushën e financave | 28 |
| 1.1.8. | Autonomiteti në fushën e marrëdhënieve me botën e jashtme | 29 |
| 1.1.9. | Autonomiteti në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë..... | 30 |
| 1.1.10. | Autonomiteti në fushën e mbrojtjes popullore dhe të sigurimit shtetëror | 31 |
| 1.1.11. | Autonomiteti në fushën jashtëqeveritare | 31 |
| 1.2. | Ndryshimet në jetën administrative – juridike të Kosovës në periudhën 1974 – 1981. | 32 |
| 1.3. | Domosdoshmëria e avancimit të pozitës juridiko-kushtetuese të popullit të Kosovës .. | 40 |
| | | |
| KREU II: Autonomia e Kosovës drejt rrënimit: masat represive të qarqeve serbo-jugosllave kundër të drejtave të shqiptarëve | | |
| | | 51 |
| 2.1. | Memorandumi i ASH të Serbisë dhe pozita e Kosovës | 51 |
| 2.2. | Strategjia e Millosheviçit për të asgjësuar pozitën kushtetuese të shqiptarëve të Kosovës | 59 |
| | 2.2.1 <i>Kush ishte Millosheviçi?</i> | 59 |
| 2.3. | Ndryshimet e dhunshme të Kushtetutës së Kosovës..... | 69 |
| 3.1. | Deklarata e Pavarësisë së Kosovës dhe efektet e saj politiko- juridike | 78 |
| 3.2. | Shpallja e Kushtetutës së viti 1990 | 85 |
| 3.3. | Emancipimi politik i faktorit shqiptar në Kosovë: ngritja dhe ndërtimi i institucioneve të mëvetësishme | 89 |
| | | |
| KREU IV: Institucionet e Kosovës dhe Faktori Ndërkombëtar | | |
| | | 98 |
| 4.1. | Daytoni dhe Kosova | 98 |
| 4.2. | Ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës | 106 |
| 4.3. | Ridimensionimi i faktorit politik dhe ushtarak në Kosovë | 115 |
| 4.4. | Marrëveshja e Rambujesë dhe efektet politiko - juridike për Kosovën | 125 |

| | |
|---|-----|
| 4.4.1. <i>Fillimi i Konferencës</i> | 131 |
| KREU V: Çlirimi i Kosovës | 139 |
| 5.1. Kosova e lirë nën protektoratin e OKB-së | 139 |
| 5.1.1 <i>Baza legale dhe strukturat</i> | 142 |
| 5.1.2 <i>A ishte UNMIK-u i suksesshëm?</i> | 148 |
| 5.2. Evolucionimi i shtetësisë së Kosovës: Plani i Ahtisaarit..... | 152 |
| 5.2.1 <i>Standardet para statusit</i> | 153 |
| 5.2.2 <i>Parimet e Grupit të Kontaktit</i> | 157 |
| 5.3. Shpallja e pavarësisë | 158 |
| 5.3.1 <i>Kronologjia e takimeve</i> | 159 |
| 5.3.2 <i>Faktorët, formati dhe mënyra e zhvillimit të bisedimeve</i> | 164 |
| 5.4. Kushtetuta e re e Kosovës | 168 |
| <i>Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës – Plani i Ahtisaarit dhe ndikimi në Kushtetutën e Kosovës</i> | 168 |
| 5.4.1 <i>Anekset në Propozimin gjithëpërfshirës të zgjidhjes së statusit final të Kosovës</i> | 170 |
| 5.4.2 <i>Kushtetuta e Kosovës dhe raporti me Propozimin Gjithëpërfshirës</i> | 175 |
| KREU VI: Sfidat e reja të Kosovës së Pavarur..... | 180 |
| 6.1. Njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës..... | 180 |
| 6.2. Roli i diplomacisë amerikane | 195 |
| 6.3. Roli i Republikës së Shqipërisë dhe zhvillimet në Kosovë..... | 214 |
| 6.4. Zbehja e UNMIK-ut dhe vendosja e EULEX-it..... | 222 |
| 6.5. Shteti i Kosovës dhe integrimi European..... | 229 |
| EPILOG: | 246 |
| Gjetjet dhe përfundimet | 249 |

| | |
|---------------------------------------|-----|
| BURIMET DHE LITERATURA KRYESORE | 254 |
| Burime parësore | 254 |
| Burime dytësore | 257 |
| Gazeta: | 265 |
| Web faqe: | 265 |

SHKURTESAT

AACL – American Albanian Civic League
APJ – Armata Popullore e Jugosllavisë
ASSHA – Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve
AVNOJ – Antifasisticko Vece Narodno Oslobodilacke Jugoslavije
BE – Bashkimi European
BNK - Bashkëpunim Ndërkufitar
BRSS - Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
CEB – Këshilli i Bankës Evropiane për Zhvillim
CFA – Central Fiscal Authority
CFSP – Comon Foreign and Security Policy
CIA – Cetral Intelligence Agency
DPSA - Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit
EBRD – Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim
EIB – Banka Evropiane për Investime
ENP – European Neighborhood Policy
ESDP – European Security and Defence Policy
EULEX – Misioni European për Mbisundim të Ligjit në Kosovë
EUPT - Ekipi Planifikues i BE-së
FARK – Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës
IAC – Interim Administrative Council
IPA – Instrument for Pre-Accession Assistance
JIAS - Joint Interim Administrative Structures
JNA –Jugoslovenska Narodna Armija
KAÇKJ – Këshilli Antifashist Kombëtar Çlirimtar i Jugosllavisë
KAKM – Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë
KE - Këshilli i Evropës
KFOR – Kosovo Force
KSA – Krahina Socialiste Autonome

KSBE - Këshilli për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës
LKÇK – Lëvizja Kosovare për Çlirim Kombëtar
LKS – Lidhja Komuniste e Serbisë
LPK – Lëvizja Popullore e Kosovës
MMK - Monitorim – Mentorim – Këshillim
MPSA - Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asocimit
MSA - Marrëveshje për Stabilizim Asociim
NAAC – National Albanian American Council
NATO – North Atlantic Treaty Organization
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
OMLK - Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSCE – Organization for Security and Cooperation in Europa
OZNA – Organizata e Zbulimit në Ushtrinë Jugoslave
PKJ - Partia Komuniste e Jugosllavisë
PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PVPE - Plani i Veprimit i Partneritetit European
RFPJ – Republika Federative Popullore e Jugosllavisë
RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
RSS – Republika Socialiste e Serbisë
SANU - Srpska Akademija Nauka i Kulture
SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UDB – Unutrasnja Drzavna Bezbednot
UNHCR – United Nations High Commissioner for Refugees
UNMIK - UN Mission in Kosovo
UNOSEK – United Nations Office of the Special Envoy for Kosovo
UP – Universiteti i Prishtinës
USHT – Universiteti Shtetëror i Tiranës

PARATHËNIE

Në mes të argumenteve historike dhe çështjeve faktike, Kosova edhe sot aty - këtu vazhdon të jetë një çështje e debatueshme. Debatohet në qarqe akademike dhe joakademike, në qarqe politiko-diplomatike dhe mediatike, të brendshme, regjionale ose globale dhe pothuajse i tërë debati më shumë përqendrohet rreth një pyetjeje: a kishte Kosova të drejtë të shpallte pavarësinë? Ata që kundërshtojnë Pavarësinë e Kosovës, Deklaratën e Pavarësisë e konsiderojnë si shpallje të njëanshme. Kjo pyetje më tej tërheq edhe shumë pyetje të tjera, që rrjedhin varësisht nga ajo se a do të përdorim argumentet historike apo argumentet e dala nga gjendja faktike. Gjithsesi këto argumente pastaj përdoren varësisht nga këndvështrimi dhe varësisht nga pozita që dikush ka pro ose kundër Pavarësisë së Kosovës. Debati duket se është më i nxehtë kur zhvillohet nga qarqet serbe dhe shqiptare, ndërsa në nivele të mirëfillta akademike, ku mbisundon dija dhe forca e argumentit, zbërthehet pa emocione. Debati brenda shoqërisë kosovare dhe brenda shoqërisë serbe dhe debati në mes serbëve dhe shqiptarëve (për aq sa zhvillohet) ka ngarkesa emocionale dhe emocionet më shumë vërehen në anën serbe. Pra, në të tilla situata, një studiues nuk e ka të lehtë të interpretojë fakte dhe argumente që përdoren nga të dyja palët me qëndrime krejtësisht të kundërta, sidomos për një çështje të ndjeshme historike, politike, kulturore, etj.

Është akoma më vështirë të interpretohen argumente e fakte që jo rrallë nxirren nga të vërteta ose mite të imponuara që realisht në momente të caktuara kanë rezultuar me pasoja të rënda. Gjithnjë janë bërë përpjekje që këto të vërteta ose mite të bazohen në histori, në të drejta për territore, në kulturë, në origjinë, etj.

Qëllimi i studimit është që përmes një qasjeje objektive të bëhet një përshkrim dhe interpretim i fakteve dhe i shkaqeve, të cilat kanë çuar te shpallja e Pavarësisë së Kosovës, nga këndvështrimi i brendshëm dhe nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare publike. Analiza

do të japë raportet ekzistuese brenda federatës dhe raportet e federatës me bashkësinë ndërkombëtare.

Studimi synon të shpjegojë mundësitë e Kosovës për të ndikuar në politikën e jashtme gjatë kohës sa ka qenë pjesë përbërëse e federatës jugosllave.

Së fundi, ky studim synon të na japë një pasqyrë të raporteve ndërkombëtare dhe të normave drejtës ndërkombëtare, brenda të cilave Kosova ka shpallur pavarësinë e vet duke u fokusuar në parimet dhe normat e reja të cilat kanë pasuruar të drejtën ndërkombëtare, lidhur me të drejtën e vetëvendosjes dhe njohjes ndërkombëtare të shteteve të reja.

Qëllimi i studimit nuk është që të vërë në pah legjenda e mite apo që të merret me përshkrimin e fakteve historike, të cilat kanë bërë që Kosova të mbetet për një kohë të gjatë pjesë e sistemit jugosllav, dikur pjesë e mbretërisë jugosllave dhe më vonë e ish - Jugosllavisë Federative . Në të kundërt, shqyrtimi dhe analiza e problematikës që ngërthen ky punim, janë bërë në interes të argumentimit të pajtueshmërisë me të drejtën ndërkombëtare të aspiratave dhe përpjekjeve të shqiptarëve të Kosovës për shtetin e tyre të pavarur.

Përshkrimi i shkurtër, të fakteve dhe argumenteve historike, nuk i është ikur tërësisht, por edhe kur është bërë një përshkrim i tillë i fakteve, kjo është bërë në favor dhe në interes të argumenteve sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtën e Kosovës për pavarësi dhe shtetshmëri. Është bërë përpjekje që edhe përshkrimi, por njëkohësisht edhe interpretimi i fakteve të bëhet në një mënyrë burimore dhe jo të ndikuar. Për shumë çështje që rrok ky studim është shkruar jo vetën nga autorë shqiptarë, por dhe të huaj dhe disa gjëra lexuesit mund t'i duken si të përsëritura, të lexuara apo të dëgjuara. Por, thëniet që duken të dëgjuara dhe të përsëritura, ato përsëri duhet të shihen në kontekst të të gjithë punimit si edhe në kontekst të gjuhës së përdorur, por dhe stilit të të shprehurit. Në anën tjetër, për disa periudha të caktuara kohore dhe për disa ngjarje e fakte megjithatë është shkruar pak. Kjo sepse edhe distanca kohore është e shkurtër. Sado që secila pjesë e punimit mund të jetë edhe temë në vete dhe mund të jetë çështje studimesh edhe më të thella, megjithatë tërësia e ka veçantinë e vet sepse ngërthen në vetvete kohë dhe ngjarje të një lidhshmërie logjike, faktike dhe historike. Punimi kap shumë fusha, ku kryesoret janë çështjet juridiko-historike, juridiko-ndërkombëtare, juridiko-politike, politiko-diplomatike dhe ushtarake.

Është grumbulluar për vite literaturë juridike vendore dhe ndërkombëtare e fushës dhe është bërë një seleksionim i kujdesshëm i literaturës për t’iu referuar. Përzgjedhja për referime është bërë nga përpjekja për të qenë në radhë të parë neutral për gjithë objektin e studimit. Janë përzgjedhur edhe autorë jashtë atyre që kanë shkruar vazhdimisht për çështjen e Kosovës, për të gjetur edhe ndonjë mendim ndryshe nga mendimi që do ta quaja tradicional. Është synuar veçanërisht mbledhja dhe interpretimi i fakteve dhe veprimeve konkrete që kanë ndodhur sidomos gjatë kohëve të fundit. Kërkimi në internet ka ndihmuar si mjet shtesë, sikundër intervistat semistrukturore prej të cilave janë nxjerrë fakte dhe interpretime nga aktorë të veprimeve të caktuara. Përzgjedhja e të intervistuarve është bërë në bazë të kriterit akademik, politik, diplomatik, por janë intervistuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile, ku me të gjithë është arritur mirëkuptimi se intervistat do të përdoren vetëm për nevoja të studimit dhe se do të mbeten anonime.

Grumbullimi i literaturës ka përfshirë: punime të autorëve të spikatur të së drejtës ndërkombëtare tradicionale dhe aktuale. Në veçanti janë nxjerrë pikëpamjet dhe qëndrimet lidhur me të drejtën e vetëvendosjes dhe të drejtës së shkëputjes. Sipas tyre rezulton se si rregull shtetet krijohen sipas parimeve të sovranitetit të ndërtuar në sistemin Wesphalian të krijimit të shteteve, kurse e drejta e vetëvendosjes bazohet kryesisht në idetë e Mill-it dhe të tjerëve. Më vonë kjo e drejtë njihet vetëm për shtetet që dalin me procesin e shkolonizimit. Këtë pikëpamje e përkrahin thuajse të gjithë autorët serbë, të cilët, e bazojnë në të drejtat historike dhe e “fuqizojnë” duke përdorur kryesisht argumente politike. Por ka autorë të njohur të fushës, që mund të klasifikohen si të plejadës së re, si I.Brownlie, M.Shaw, M.Weller, që megjithatë kanë nisur të zhvillojnë ide të tjera lidhur me mundësitë e zgjerimit të së drejtës së vetëvendosjes dhe atë të shkëputjes edhe për shtetet jashtë procesit të shkolonizimit. Kjo sepse e drejta ndërkombëtare nuk mund të merret si kategori statike e së drejtës. Edhe kjo e drejtë ka evoluuar dhe evoluon, sepse shoqëria njerëzore, në fund të fundit, nuk mund të kuptohet si kategori krejtësisht statike. Autorët shqiptarë gjithashtu përdorin argumente historike dhe politike për të bazuar të drejtën e Kosovës në vetëvendosje. Krahas argumenteve historike dhe juridike ndihmon edhe praktika e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila pasuron normat e së drejtës ndërkombëtare me parime dhe kritere të reja, të cilat shtetet që aspirojnë dhe realizojnë pavarësinë duhet t’i plotësojnë që të pranohen në bashkësinë e shteteve të globit. Autorët shqiptarë kanë dhënë material dhe argumente të bollshme lidhur me argumentet historiko -

politike dhe për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe shkëputje. Këto të gjitha së bashku e argumentojnë bollshëm këtë të drejtë. E drejta ndërkombëtare është pasuruar me disa norma dhe kritere të reja, të cilat pavarësisht faktit se nuk kanë pasur të bëjnë në mënyrë eksplicite me Kosovën, flasin mjaftueshëm për të drejtën e vetëvendosjes në rastin e Kosovës, çka do t'i shërbente edhe diplomacisë kosovare aktualisht në procesin e lobimit për njohje të reja.

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbledhur material nga arkivat serbe. Edhe pse qasja atje ka qenë e mundur, marrja e materialeve ka qenë shumë e kufizuar. Përkundër premtimeve të vazhdueshme, sa herë që i jemi qasur drejtpërdrejt arkivave në Beograd, rezultatet kanë mbetur më shumë kurtoazi komunikimi dhe kinse gatishmërie për të mundësuar qasje në dokumente, sesa dhënie reale e mundësive për studim. Madje edhe kur lejonin qasje, atëherë ofroheshin dokumente që konsiderohen se i takojnë asaj që e njohim si dijeni e përgjithshme. Ofroheshin tekste kushtetutash, ligjesh dhe dokumentesh, të cilat mund të gjenden në biblioteka universitetesh, librari ose biblioteka publike universitare.

Është bërë një grumbullim i legjislacionit vendor, ndërkombëtar, i legjislacionit të ish-Jugosllavisë, të Kosovës, të Serbisë dhe dokumenteve nga mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë që kanë të bëjnë me objektin e studimit. Më pas është bërë analiza e gjithë këtyre dokumenteve duke përdorur metodën krahasuese në masë të duhur. Është bërë përpjekje që të mblidhen informacione shtesë përmes burimesh të ndryshme të informacionit.

Studimi është parë të jetë shumë i nevojshëm nga arsye të shumta. Argumentet historike për mbrojtjen e të drejtës së Kosovës për vetëvendosje gjinden më lehtë. Por këto argumente nuk janë të mjaftueshme për t'u përdorur të vetme, sidomos kur akoma vazhdohet që e drejta e vetëvendosjes të trajtohet nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare tradicionale. Prandaj është operuar sidomos me konceptet dhe këndvështrimet moderne të autorëve të dëgjuartë ditëve tona, të përmendur sipër (Shaw, Brownlie, etj).

Kështu qëllimi i këtij studimi shpresohet të jetë arritur në masë të madhe dhe si punim besohet se do të jetë ndihmesë modeste për, për studiues, për diplomatë vendorë dhe ndërkombëtar sikundër për historian të jashtëm e të brendshëm dhe për studentë.

Pyetje dhe hipoteza

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat janë dhënë si më poshtë:

- A ishte Kosova shtet brenda ish- Federatës Jugosllave e barabartë me njësitë e tjera të federatës? Nëse po, pse? Nëse kishte dallime, cilat ishin?
- Ç'është sot Kosova parë nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare publike? Shtet i pavarur? Pavarësi e mbikëqyrur? Protektorat? Shtet në krijim e sipër? Apo krijesë e re eksperimentale?

Ndryshimi i rrethanave gjeopolitike, rënia e komunizmit bashkë me ndryshimet në të drejtën ndërkombëtare publike lidhur me të drejtën e popujve për vetëvendosje, krahas procesit të shpërbërjes së dy federatave të mëdha (BRSS dhe RSFJ), ka të ngjarë të kanë ndikuar më shumë në procesin e pavarësimit të Kosovës si një rast sui generis, se sa aktivitetet dhe përpjekjet për liri dhe pavarësi brenda Kosovës.

Metodologjia e studimit

Punimi është zhvilluar duke përdorur *metodologjinë e kombinuar*.

Ajo ka synuar:

- Të përshkruajë zhvillimin historik të proceseve që çuan në Pavarësinë e Kosovës;
- Të paraqesë të drejtën e vetëvendosjes së Kosovës bazuar në parimet themelore dhe normat e së drejtës ndërkombëtare;
- Të derivojë doktrinën nga teoria e vetëvendosjes;
- Të aplikojë doktrinën në rastin konkret.

Metodat e studimit

Autori ka përdorur metoda të ndryshme si më poshtë:

Metodën e analizës historike e cila është përdorur *inter alia* për të përshkruar zhvillimin historik të Federatës Jugosllave dhe pozitën e Kosovës brenda federatës;

Metodën e analizës sistemike që është përdorur për të analizuar shumëllojshmërinë e burimeve juridike dhe historike (jurisprudenca, praktika institucionale, statute, konventa, botime dhe artikuj shkencor, etj.) dhe për të nxjerrë përfundime, për t'i përgjithësuar apo për t'i përmbledhur;

Metodën e analizës logjike e cila është përdorur për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në rregullat e logjikës si, p.sh., leximi dhe argumentimi i të kundërtës (*argumentum a contrario*), kontradiksioni, etj;

Metodën e analizës teleologjike e cila është përdorur për të interpretuar normat juridike dhe burimet duke synuar zbatimin e qëllimit të tyre;

Metodën e analizës komparative e cila është përdorur për të krahasuar qëndrimet e autorëve, opinionet dhe qëndrimet e shteteve dhe të shembujve nga praktika;

Metodën e analizës linguistike e cila është përdorur për të interpretuar termat juridikë si, p.sh., pakicë, popull, etj;

Metodën e analizës filozofike e cila është përdorur për të interpretuar burimet juridike në frymën e filozofisë të së drejtës;

Metodën e analizës teorike e cila është përdorur për të interpretuar burimet juridike si, p.sh., për të sqaruar përmbajtjen e vetëvendosjes zhdëmtuese, etj.

Burimet e studimit

Burimet e studimit mund t'i klasifikojmë në tri grupe:

Grupi i parë: aktet juridiko-normative: kushtetutat, konventat ndërkombëtare, Rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, raportet nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore si dhe raportet e emisarëve lidhur me gjendjen në Kosovë dhe rreth Kosovës; vendime të institucioneve dhe gjykatave dhe dokumente tjera relevante si dhe burime arkivore (të kufizuara në numër në funksion të problematikës së punimit);

Grupi i dytë: literaturë e veçantë si: artikuj shkencorë, botime, monografi të shkruar nga autorë vendas dhe të huaj;

Grupi i tretë: intervista gjysmë të strukturuar, revista, gazeta, web faqe, etj.

Hyrje

Vështrim i shkurtër historik mbi gjendjen politiko-juridike të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1974

Kosova edhe një herë, pa u pyetur dhe pa u respektuar vullneti i popullit të saj, “vullnetarisht” iu bashkua Serbisë Federale në kuadër të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Deklarimi “vullnetar” i Kuvendit të Prizrenit ra në kundërshtim të drejtpërdrejt me projektin e Partisë Komuniste të Kosovës dhe Metohisë. Ra sigurisht në kundërshtim edhe me premtimet e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, sepse pas çlirimit nga fashizmi, të gjithë do të përcaktoheshin vetë për të ardhmen e tyre. Kjo ishte në kundërshtim edhe me orientimet e shtetit shqiptar. Dhe në fund, edhe në kundërshtim me qëndrimet e Bashkësisë Ndërkombëtare karshi lëvizjeve dhe shpresave të popullit të Kosovës. Por, “pasi Tito konsolidoi pushtetin e vet dhe rolin e Partisë Komuniste në gjithë Jugosllavinë, ai favorizoi Kosovën brenda Serbisë për shkaqe politike, sepse atij i duhej mbështetja serbe dhe kështu do t’i fitojë ata në drejtim të komunizmit”.¹ Kurse, siç thotë Akademiku, Esat Stavileci, “në bazë të një marrëveshjeje të komiteteve qendrore partiake të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, Kosova nuk u përfshi fare në vendimet e AVNOJ-it (1943), me qëllim që të vetëpërcaktohej, ndërsa Konferenca e Bujanit (31.12.1943 – 1 e 2. 1. 1944), e miratoi një dokument me të cilin popullit shqiptar i njihej e drejta për vetëvendosje”.²

Rezoluta e Bujanit, që kishte treguar qartë vullnetin dhe aspiratat e popullit të Kosovës, jo vetëm nuk u mor për bazë, por kjo rezolutë në momente të caktuara të zhvillimeve do të përdoret si bazë për stigmatizim dhe si bazë për shqiptimin e masave represive, që ndërmerren organet e pushtetit kundër atyre që thirreshin dhe që e përmendnin këtë rezolutë. Konferenca e Bujanit³

¹ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.5 (qasur me 29.12.2013).

² Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.45.

³ Konferenca e Bujanit është mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe me 1 - 2 janar 1944, me pjesëmarrje të 49 delegatëve (nga të cilët 42 ishin shqiptarë) nga 61 sa ishin ftuar. Konferenca ka aprovuar një dokument shumë të rëndësishëm, që njihet si Rezoluta e Bujanit, që me përmbajtjen e vet tregon qartë vullnetin e popullit të Kosovës për vetëvendosje

ishite organizuar dhe mbajtur në rrethana të vështira luftime dhe kjo formalizonte juridikisht qëndrimet e lëvizjes antifashiste në Kosovë. Rezoluta e miratuar në këtë konferencë vuri themelin e ngrehinës kushtetuese të Kosovës për të siguruar të drejtën e vetëvendosjes. Ishte një dokument i karakterit konstitutiv, të cilin Jugosllavia nuk donte ta pranonte sepse kjo prishte projeksionin për Jugosllavinë Federative të vendosur në Konferencën e Këshillit Antifashist Çlirimtar Kombëtar të Jugosllavisë, në të cilin përfaqësuesit e Kosovës nuk kishin marrë pjesë. Në një fragment të Rezolutës thuhet:

*”Kosova e Metohia është një rajon me shumicën e popullatës shqiptare, e cila tashti, si edhe gjithmonë në të kaluarën, dëshiron të bashkohet me Shqipërinë...Mënyra e vetme për bashkimin e shqiptarëve të Kosovës e Metohisë me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorëve dhe shërbëtorëve të tyre. Sepse, e vetmja mënyrë me të cilën mund të arrihet liria, është në qoftë se të gjithë popujt, duke përfshirë edhe shqiptarët, kanë mundësinë për të vendosur për fatin e tyre, me të drejtën për vetëvendosje, deri në ndarje”.*⁴

Nga fragmenti i cituar mund të nxjerrim fakte të pamohueshme, të cilat atëherë edhe sot argumentojnë të drejtën për vetëpërcaktim të Kosovës dhe atë nga si vijon:

E para, Kosova ka qenë me shumicë shqiptare,

E dyta, sepse ka pasur territor të përcaktuar qartë,

E treta, se ka pasur edhe organet e veta të formuara përfaqësuese, dhe

E katërta, se organet e veta kanë ushtruar një pushtet në këtë territor për aq sa rrethanat e okupimit fashist kanë mundësuar dhe se ka qenë drejtpërdrejt e angazhuar në luftën antifashiste.

dhe respektivisht për t’iu bashkëngjitur Shqipërisë. Populli i Kosovës i ishte bashkëngjitur luftës antifashiste krahas popujve tjerë dhe përfaqësuesit e popullit të Kosovës në Konferencë nxorën një dokument shumë të rëndësishëm për projektimin e së ardhmes së Kosovës. Dhe pikërisht nga ky shkak strukturat e Partisë Komuniste të Jugosllavisë menjëherë me emisarët e vet filluan veprimtarinë e skualifikimit të Rezolutës, të cilën në fakt edhe e bënë duke pamundësuar zbatimin e saj. Por rëndësia e këtij dokumenti nuk ka mundur të zbehet në projeksionet kosovare dhe pavarësisht pengesave praktike dokumenti shpreh qartë aspiratat e popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe u shndërrua në një fakt historik që nuk mund të kontestohet.

⁴ Malcolm Noel, *Kosova një histori e shkurtër* (botimi shqip), fq.320-321.

Këshilli Antifashist për Çlirimin Kombëtar të Jugosllavisë (KAÇKJ/AVNOJ) kishte vendosur në nëntor të vitit 1943 që Kosovës do t'i njihej statusi autonom kur të përfundonte lufta.⁵ Kjo ishte Mbledhja e Dytë e KAÇKJ-së, e mbajtur në Jajce ku, pa përfaqësuesit e Kosovës, u vendosën themelet e federalizmit jugosllav. Shkaqet kryesore të mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të Kosovës në këtë Konferencë ishin kryesisht politike dhe jo si kanë argumentuar zakonisht teoricienë jugosllavë për shkaqe të rrethanave të vështira të luftës, kushteve të vështira gjeografike, mungesës së komunikimit, etj. Por pavarësisht nga mospjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në konferencë, KAÇKJ megjithatë, nuk ka arritur që ta bëjë të heshtë specificitetin e Kosovës, të popullatës dhe të vetë territorit të saj, prandaj ishte përmendur statusi autonom si diçka që do t'i njihej Kosovës pas përfundimit të luftës. Por konstituimi i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar në Konferencën e Bujanit dhe Rezoluta krijuan një bazë tjetër karshi qëndrimeve federaliste jugosllave, e cila në fakt dëshironte të shprehte pozicionimin dhe aspiratat e përcaktimit të së ardhmes sipas vullnetit të shumicës së popullit të Kosovës. Në Konferencë kishte përfaqësim gjithëpërfshirës dhe nga preambula e Rezolutës shohim se aty kishte shqiptarë, serbë, malazezë, nacionalistë, komunistë, rini antifashiste, rini komuniste, gra antifashiste, përfaqësues të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, etj.,⁶ dhe të gjithë këta po dakordoheshin për përcaktimin e së ardhmes së Kosovës. Kjo, megjithatë menjëherë pas aprovimit, u kundërshtua nga Partia Komuniste e Jugosllavisë në mënyra dhe forma të ndryshme manifestimi. Madje kundërshtimet filluan menjëherë dhe vazhduan deri në shpërbërjen e Jugosllavisë. Pavle Joviçević dhe Zekeria Rexha u dërguan që të dy te Tito, për t'ia shpjeguar Konferencën e Bujanit. Tito s'pati asnjë reagim negativ (...) përgjigjja zyrtare erdhi më 28 mars të 1944-ës përmes një letre të firmosur nga Milovan Gjlasi. Ai e quante Konferencën edhe vendimet e saj të gabuara, i hidhte ato poshtë dhe madje shkruante:

“Sot nuk duhet të flitet për bashkimin me Shqipërinë, sepse në këto momente nuk është fjala për caktimin e kufijve në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, pasi që të dyja shtetet janë të pushtuara nga Gjermania.”⁷

⁵ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.78.

⁶ Për më tepër shih tekstin e preambulës së Rezolutës së Konferencës së Bujanit.

⁷ Blendi Fevziu, *100 vjet – një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912 – 2012*, Klan&UET/Press, Tiranë, 2012, fq.172.

Kështu, më pas në Kosovë filloi krijimi i një terreni ku Rezoluta do të shihej si dokument i pavlerë, si dokument regresiv, si pengesë e së ardhmes, etj. Dhe si e tillë nuk duhej të merrej për bazë. Kështu filluan veprimet konkrete për aneksimin e Kosovës duke u krijuar një klimë e vështirë politike dhe veprimet kundër kësaj Rezolute fillojnë të jenë të dukshme, sidomos në gjysmën e dytë të vitit 1944. Gjatë vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 u zhvilluan bisedime ndërmjet disa krerëve komunistë se cilës njësi federale duhet t'i bashkohej Kosova. Mali i Zi, ashtu edhe Maqedonia, paraqitën kërkesat e tyre, por ideja mbisunduese ishte gjithmonë që Kosova të bashkohej me Serbinë.⁸ Në këtë situatë, në rrethana shumë të vështira politike, ekonomike, sociale, ushtarake, organizimit shumë të dobët të pushtetit në Kosovë, rrethanave ndërkombëtare jo të favorshme për aspiratat e Kosovës, premtimeve se në të ardhmen Kosova do të ketë të drejtën që të përcaktojë të ardhmen e vet, pa përkrahje të dukshme për aspiratat e popullit të Kosovës nga shteti amë, etj., mundësitë e jetësimit të qëllimeve të përcaktuara në Rezolutë ishin shumë të vogla. Ndërkohë që në anën tjetër forca politike, ushtarake, etj., dhe PKJ, që po udhëhiqte me luftën dhe që po ndërtonte tashmë federatën jugosllave, ishte shumë e madhe. Kjo nxjerr në sipërfaqe forcën dhe kundërshtimin me çdo kusht të Rezolutës dhe të orientimeve të popullatës shumicë të Kosovës në drejtim të vetëpërcaktimit dhe bashkimit kombëtar. Jugosllavia ishte e vendosur që ta pengonte zbatimin në praktikë të Rezolutës së Bujanit dhe realizimin e së drejtës së popullit të Kosovës për vetëvendosje. Kjo federatë në fakt, po ndërmernte veprime që çonin drejt aneksimin të Kosovës, ku përpos të tjerash Kosova u vu nën një shtetrrëhim dhe pushtet ushtarak gjatë një periudhe disamujorëshe. Me pretekstin se në Kosovë po zhvillohej një kundërrivolucion, sidomos në zonën e Drenicës, në periudhën prej 8 shkurt e deri në gjysmën e majit 1945 në Kosovë, me urdhrin e Komandantit Suprem, Tito⁹, u vendos pushteti ushtarak. Aplikimi i gjendjes ushtarake në Kosovë nga autoritetet jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore, i bëri “via facti” të pavlefshme premtimet mbi respektimin e së drejtës së vetëvendosjes për popullatën e Kosovës, për fatin politik të saj.¹⁰ Pushteti ushtarak i vendosur në Kosovë dhe masat represive që u ndërmorën, krahas qetësimit të dhunshëm të popullit të Kosovës, përgatiti terrenin e organizimit të Kuvendit të përfaqësuesve të popullit, ku Kosova “vullnetarisht” u deklarua për të ardhmen e vet brenda Serbisë Federale. Kuvendi u mbajt në

⁸ Malcolm Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, botimi shqip, Koha, Prishtinë, 2001, fq.328.

⁹ Shih Stipe Mesiç, *Si u shkatërrua Jugosllavia*, Prishtinë, 2011.

¹⁰ Gazmend Zajmi, *Rrjedhat kryesore të konfliktësishë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë*, Marrë nga: Esat Stavileci, Vepra V, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Prishtinë, 2013, fq.225.

Prizren me datë 10 korrik 1945. Në këtë Kuvend, që njihej si mbledhje e Këshillit Krahinor Popullor të Kosovës, morën pjesë anëtarë që nuk ishin të zgjedhur dhe nga 142 anëtarë të Këshillit vetëm 33 ishin shqiptarë. Kuvendi Krahinor i Kosovës dhe Metohisë, ka vendosur në formë të “Rezolutës për aneksimin e Kosovës dhe Metohisë me Serbinë Federale”, me të cilën njëkohësisht është vendosur edhe për konstituimin e kësaj treve si krahinë në kuadrin e Jugosllavisë Demokratike Federative.¹¹ Këtu, bazuar në rrethanat e përmendura, sikundër në vetë përbërjen me përfaqësues të pazgjedhur (në vend të shumicës pjesëmarrëse, shqiptarët ishin pakicë) të cilët votuan “lirshëm” dhe duke “përfaqësuar vullnetin e popullit” kishim imponim të qartë të vullnetit të të fortit dhe këtu fillon vendosja e Kosovës në ngrehinën e Federatës Jugosllave, për të cilën nuk po pyetej aspak. Asambleja krahinore popullore e Kosovës e Metohisë “shpreh dëshirën e mbarë popullsisë së krahinës që kjo t’i bashkohet Serbisë Federale si pjesë përbërëse të saj”¹². Për deklaram vullnetar gjithsesi nuk mund të flitet. Gjendja e menjëhershme e pasluftës megjithatë ishte një periudhë e represionit dhe pasi Tito shkëputet nga Moska, në vitin 1948, shqiptarët e Kosovës i nënshtrohen masave të ashpra represive, të cilët fajësoheshin po të shprehnin simpati për Udhëheqësin shqiptar dhe lojalist të Stalinit, Enver Hoxhën.¹³

Me të përfunduar Kuvendi i Prizrenit filloi “integrimi vullnetar” i Kosovës në strukturat kushtetuese të Serbisë Federale dhe Kosova caktohej si “oblast” autonom me emërtimin Kosova dhe Metohija. Me 7 gusht të vitit 1945 KAÇKJ në mbledhjen e tretë aprovon Rezolutën e Kuvendit të Kosovës dhe Metohisë për bashkim me Serbinë federale. Bazuar në këtë, Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë me 2 shtator 1945 nxori Ligjin (vendimin) për themelimin dhe organizimin e KAKM-së.¹⁴ I gjithë procesi i aneksimit apo integritit të Kosovës në Federatën Jugosllave sanksionohet përfundimisht me Kushtetutën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të nxjerrë me 31 janar 1946.

¹¹ Kurtesh Saliu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Prishtinë 1984 fq.31.

¹² ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës, viti 1945, kutia 23/A, dokumenti nr.2352.f.1-2. Rezolucion i Asamblesë krahinore të Kosovës e Metohisë (sipas Sabit Syla, Disertacioni doktorale-*Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti: Histori-Filologji, Departamenti i Historisë, Tiranë 2011, fq.87

¹³ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.11, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

¹⁴ Kurtesh Saliu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Prishtinë 1984, fq.31.

Rezoluta e Bujanit dhe Rezoluta e Kuvendit të Prizrenit, si dy dokumente krejtësisht të ndryshme, të nxjerra në kushte dhe në rrethana të ndryshme dhe me qëllime krejtësisht të kundërta me njëra - tjetrën, janë dokumente që megjithatë kanë diçka të përbashkët:

- Si njëra ashtu edhe tjetra shprehen pro së drejtës për vetëvendosje;
- Si njëra ashtu edhe tjetra dolën nga organe që po krijoheshin për të qenë përfaqësuese të popullit të Kosovës;
- Si njëra ashtu edhe tjetra u nxorën në rrethana të jashtëzakonshme (njëra në gjendjen e Luftës Antifashiste e tjetra në rrethana të një presioni dhe dhune politike kundër shqiptarëve);
- Si njëra ashtu edhe tjetra shkaktuan pasoja për shumicën e popullsisë në Kosovë: e para, nga shkak se të gjithë ata që u thirrën në të dhe që synuan jetësimin e saj e pësuan dhe iu nënshtruan masave të dhunës nga aparati shtetëror jugosllav dhe, e dyta, nuk paraqiti realisht kërkesat e shumicës së popullit të Kosovës dhe jetësimi i saj në praktikë shkaktoi pasoja të rënda për gjenerata dhe dekada të tëra;
- Por si njëra ashtu edhe tjetra janë dokumente që në vetvete kanë argumente të mjaftueshme juridiko- kushtetuese e jo vetëm të karakterit historik.

Rezoluta e Kuvendit të Prizrenit shënon fillimin e integritit të Kosovës në sistemin kushtetues të Federatës Jugosllave dhe të Serbisë, kurse Rezoluta e Bujanit mbetet e pajetësuar për një periudhë shumë të gjatë kohore. Krahas kësaj që u tha, Kosovës nuk iu njoh statusi i republikës pjesërisht ngaqë Serbia e kundërshtonte këtë gjë, po kryesisht ngaqë shqiptarët e Kosovës kurrë nuk kishin dashur të bëheshin pjesë e Jugosllavisë.¹⁵

Kosova brenda Federatës Jugosllave sipas Kushtetutës së vitit 1946

Kushtetuta e RFPJ, e datës 31 janar 1946, pasi ka numëruar republikat popullore si përbërëse të Federatës, ka përcaktuar edhe pozitat e dy krahinave: Krahinën Autonome të Vojvodinës dhe Krahinën Autonome të Kosovës e Metohisë”.¹⁶ Kështu të dyja krahinat përcaktohen të jenë në kuadër të Republikës Popullore të Serbisë, por krahinat mbeten edhe si

¹⁵ John V.A.Fine, *Rasti i jashtëzakonshëm i Josip Broz Titos*, AHS, Tiranë, 2010, fq.37.

¹⁶ Shih nenin 2, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të vitit 1946 (teksti i plotë i Kushtetutës është nxjerrë nga: http://www.arhivju.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_navigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije/ustav_fnrj.html

elemente konstitutive të federalizmit jugosllav dhe për më tepër, Kushtetuta parasheh garanci për realizimin e të drejtave të krahinës. Kosova kishte subjektivitet të vetin politik. Ajo përfaqësohej drejtpërdrejt me 15 deputetë në Kuvendin Popullor të RFPJ -së, në Dhomën e Kombeve.¹⁷

Kushtetuta e Republikës Popullore të Serbisë e nxjerrë në janar të vitit 1947 përsëriste dispozitat e Kushtetutës federative lidhur me autonominë, por edhe përcaktonte hollësitë, të drejtat dhe detyrat si dhe organizimin e krahinës. Neni 106 i Kushtetutës përcakton kompetencat e KAKM-së duke filluar nga kompetencat në zhvillim ekonomik e kulturor, planin dhe buxhetin e krahinës, zbatimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave kombëtare, sigurimin e arsimit fillor dhe të mesëm sipas planeve të RP të Serbisë, mbrojtjen sociale, shëndetin popullor, por edhe detyra e kompetenca që janë të përcaktuara në Kushtetutën federative.

Krahina si akt më të lartë juridik ka Statutin e vet që duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën e RFPJ-së dhe me Kushtetutën e RPS-së dhe duhet të vërtetohet nga Kuvendi Popullor i Republikës.¹⁸ Bazuar në këtë rregullativë juridike Kosova nxjerr Statutin e vet në maj të vitit 1948 që në një mënyrë më shumë ka qenë përsëritje e dispozitave të Kushtetutës së Republikës Popullore të Serbisë.

Organi më i lartë i pushtetit në Kosovë, në këtë kontekst rregullativash kushtetuese e ligjore ishte Këshilli Popullor Krahinor që zgjidhej nga qytetarët me mandat trevjeçar. Këshilli kishte kompetencë të nxirrte Statutin dhe akte tjera më të ulëta. Organi ekzekutiv ishte Këshilli Ekzekutiv Krahinor. Aktet që mund t'i nxirrte Këshilli Ekzekutiv Krahinor ishin: urdhëresat, udhëzimet dhe aktvendimet. Organet e administratës ishin të organizuara në formë të drejtorateve. Kosova në këtë kohë nuk kishte autonomi gjyqësore. Ekzistonin gjykatat e rretheve dhe katër gjykata të qarkut si gjykata të shkallës së dytë.¹⁹ Pavarësisht nga fakti se pozita e Kosovës ishte e sanksionuar edhe me Kushtetutën e RFPJ-së, megjithatë me Kushtetutën e Republikës Popullore të Serbisë çështjet në kontekst të të drejtave dhe detyrave të Kosovës

¹⁷ Shih nenin 54 të Kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të vitit 1946 (teksti i plotë i Kushtetutës është nxjerrë nga: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_navigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije/ustav_fnrj.html

¹⁸ Shih nenin 104 të Kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të vitit 1946 (teksti i plotë i Kushtetutës është nxjerrë nga: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_navigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije/ustav_fnrj.html

¹⁹ Kurtesh Salju, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.41

zbërtheheshin më shumë, kurse simbolikisht edhe me Statutin e Kosovës. Në bazë të Kushtetutës së RPS-së, Kuvendi i Republikës ka pasur të drejtë të shpërndajë Këshillin Popullor Krahinor dhe të shpallë zgjedhjet për Këshillin e Ri, por edhe të shkarkojë Këshillin Ekzekutiv Krahinor.²⁰

Ligji Kushtetues i vitit 1953

Ky lloj pozicioni i Kosovës në nivel të Federatës dhe në nivel të Republikës Popullore të Serbisë, edhe pse larg aspiratave të popullit shumicë, po dilte se ishte i papranueshëm për qarqet shoviniste serbe. Kosova e kësaj kohe ishte rajoni më i pazhvilluar ekonomikisht, me një popullatë ku shkalla e analfabetizimit ishte shumë e lartë. Në Kosovë çdo shqiptar shihej me dyshim nga pushteti serbo - jugosllav, nën pretekstin e tendencave për bashkim me Shqipërinë. Në vitet pesëdhjetë fillon një dhunë e llojit të vet kundër popullatës shqiptare, dhunë që manifestohej në forma duke filluar nga kolektivizimi, ndjekjet dhe persekutimet e deri te shpërngulja e dhunshme e popullatës kryesisht për në Turqi. Sigurimi shtetëror, që njihej si UDB²¹, kishte degjeneruar tepër shumë. Në vitet pesëdhjetë ishte shtuar obsesioni për kërkimin e armëve nga shqiptarët e Kosovës; fshatra të tëra rrethoheshin nga kordonë policësh, banorët merreshin në pyetje dhe rriheshin në polici. Aq i rëndë ishte trajtimi i atyre që nuk ishin në gjendje të dorëzonin ndonjë armë, sa që shumë shqiptarë e shihnin më të arsyeshme të blinin një armë, në mënyrë që të kishin diçka për të dorëzuar. Në pretekstin e kërkimit të armëve, 1.100 njerëz janë vrarë apo kanë vdekur nga pasojat e torturave, ndërsa 100.000 të tjerë janë torturuar.²² Oficerët e UDB-së në Kosovë, sipas statistikave të vitit 1956, ishin 58% serbë, 28% malazezë dhe vetëm 13% shqiptarë, kështu që operacionet e UDB-së vetëm shtonin pakënaqësinë gjithnjë e më të madhe dhe ndjenjën e polarizimit etnik në Krahinë²³. Nga dhuna, nga persekutimet, nga gjykimet e fabrikuara, etj, ishte krijuar një situatë e paperspektivë dhe e

²⁰ Po aty.

²¹ Unutrasnja Drzavna Bezbednost (Sigurimi i brendshëm shtetëror) ishte shërbimi famëkeq jugosllav nga i cili e kanë pësuar shumë shqiptarë të Kosovës. Ishte shërbim i ngjashëm me ato të vendeve të tjera të botës ish -komuniste si Securitatea e Rumanisë, Sigurimi shtetëror i Shqipërisë, etj. Nëpër duar të UDB-së kanë kaluar shumë shqiptarë dhe shumë nga ata janë likuiduar me masa mjaft brutale duke filluar me rrahje, burgosje, shantazhime e deri te vrasjet më makabre. Janë vrarë njerëz të lidhur e gjysmë të zhveshur nëpër mullarë të sanës, duke u mbytur në puse uji e deri te vdekja në duar të oficerëve gjatë kohës që ushtrohej rrahja dhe tortura. Edhe sot gjenden dëshmitarë të gjallë që tregojnë për këto masa të UDB-së të cilat kanë qenë të pranishme kudo në Kosovë, por në formë shumë më të hapur në zonën kufitare.

²² Jakup Krasniqi, *Kosova në kontekst historik*, Buzuku, Prishtinë, 2010, fq.33.

²³ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë&shtëpia e librit Tiranë 2001, fq.334.

pashpresë ku shqiptarët, apo një pjesë shumë e madhe e tyre nisën të mendojnë emigrimin. Dhe pikërisht kjo do t'i shkojë për shtat ideve të vjetra dhe ideve të reja për shpërnguljen e shqiptarëve jashtë trojeve etnike. Idetë e Vaso Çubrilloviçit dhe të tjerëve për shpërnguljen e shqiptarëve po aktualizoheshin sërish dhe faktikisht të zbatoheshin sërish. Vlerësohet se nga ish-Jugosllavia për në Turqi, gjatë periudhës 1945 – 1966, janë shpërngulur 246.000 veta.²⁴ Përsëri u zbatua një program për emigrimin e “Turqve” mbi bazën e traktatit të vitit 1953 midis Beogradit dhe Ankarasë. Kurse programi i nacionalistit serb, Vaso Çubrilloviç, i vitit 1944, dedikuar “Jugosllavisë së Re” të pasluftës së Dytë Botërore shkruante se “Kosova duhet ndryshuar etnikisht nga themeli” dhe se “shpërngulja e shqiptarëve duhej kryer shpejt në mënyrë që Europa të vihet para aktit të kryer”.²⁵ Në kontekst të ndjekjes së shqiptarëve shohim, se kemi futjen në jetë dhe zbatim praktik të programeve të reja e të vjetra. Shumë shqiptarë etnikë, që praktikonin fenë islame, vetëshpallëshin turq – kështu që numri i turqve në Kosovë u rrit nga 1.300 në regjistrimin e popullsisë të vitit 1948 në 34500 me atë të vitit 1953.²⁶ Nëse merret për bazë një shifër e supozuar prej 100.000 shqiptarësh të shpërngulur nga Kosova, atëherë krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullatës së asaj kohe, del se ky numër i të shpërngulurve ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe kjo shpërngulje sipas së drejtës ndërkombëtare mund të klasifikohet e ngjashme me gjenocidin.

Në rrethanat e paperspektivës, dhunës, presioneve që po ushtroheshin ndaj popullatës shqiptare në Jugosllavi filluan të zhvillohen disa procese që quheshin proceset e decentralizimit dhe të deetatizimit, me të cilat nisnin të ndërrojnë marrëdhëniet në mes të organeve federative dhe republikane, por që këto procese fillojnë t'i marrin kompetenca krahinave autonome në favor të republikave. Kështu, në vitin 1953 nxirret Ligji Kushtetues i RFPJ-së që, edhe pse nuk suprimoi nenin 2 të Kushtetutës, që përcaktonte tërësinë e Jugosllavisë dhe të subjekteve të saj përbërëse, megjithatë shënon një zhveshje të mëvetësisë se krahinave në favor të republikave. Me Ligjin Kushtetues federata nuk i përcakton as në mënyrë të përgjithshme kompetencat autonome të krahinave, por e autorizon republikën që këtë ta bëjë me Ligjin kushtetues të vetin. Kështu, Ligji Kushtetues i Republikës Popullore të Serbisë përcakton pozitën e krahinave në mënyrë më të detajuar, krahasuar me Kushtetutën Republikane të vitit 1947. Pra Ligji Kushtetues i vitit 1953

²⁴ Po aty, fq.336.

²⁵ Esat Stavileci, *Vepra V, Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtinë, fq.277-278.

²⁶ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010, fq.303.

“redukon autonominë e Kosovës edhe me më shumë represion ndaj shqiptarëve”.²⁷ Rregullimi i të drejtave dhe i detyrave autonome si dhe rregullimi i bazave të organizimit dhe kompetencës së organeve të njësive autonome “lidhej me Kushtetutën e Republikës”.²⁸ Ligji Kushtetues i Republikës i njeh këto të drejta autonome për krahinat: çështje me interes të përgjithshëm për krahinën në fushën e ekonomisë, në fushën e arsimit, në fushën e shëndetit popullor, në fushën e kulturës, në kujdesin social, etj. Pra, këto të drejta tashmë nuk janë të origjinës, por janë kompetenca, të cilat Republika ia ka lënë krahinës për t’i zbatuar. Krahina nxjerr Statutin e vet, që është në pajtim të plotë me Kushtetutën Republikane dhe tashmë nuk kërkohet që statuti të jetë në pajtim me Kushtetutën federative, por në pajtim me Kushtetutën republikane. Organi më i lartë i pushtetit në krahinë është Këshilli Popullor, i përbërë prej Dhomës Krahinore dhe Dhomës së Prodhuesve. Statuti duke u bazuar në Ligjin Kushtetues të Republikës cakton kompetencat e Këshillit Popullor.²⁹ Këshilli Popullor ka organet e veta si këshillat dhe komisionet, kurse aktet e Këshillit Popullor janë vendimet, rezolutat dhe udhëzimet. Organi ekzekutiv i krahinës është Këshilli Ekzekutiv, i cili përfaqëson krahinën, bën kujdes për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrë zbatimin e ligjeve, mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së këshillave popullore, etj.³⁰ Organet e administratës për nga emërtimi janë të ngjashme me ato republikane dhe këto janë: sekretariatet dhe pleqësitë.

Me Ligjin Kushtetues Këshilli Ekzekutiv Republikan ushtron mbikëqyrje të ligjshmërisë së punës së organit përfaqësues të Kosovës dhe rrjedhimisht kishte të drejtën e abrogimit të akteve që republika mund t’i konsideronte joligjore. Si përfundim Ligji Kushtetues i RFPJ-së ngushton kompetencat e krahinave dhe ato i lë më shumë në mëshirë të republikave, të cilave u janë dhënë më shumë kompetenca. Kështu nuk ka më të drejta të origjinës për krahinën sepse të drejtat e krahinës kalohen vetëm nga republikat. Epërsia e organeve republikane ndaj atyre krahinore është e dukshme dhe e shtuar. E gjithë kjo zbehu mëvetësinë e Kosovës, që njihej me emrin Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Zhvillimet e mëtejme kishin tendenca edhe më regresive në kontekst të pozitës juridike të Kosovës brenda Federatës Jugosllave.

²⁷ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.5 (parë më: 29.12.2013).

²⁸ Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish -Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.61.

²⁹ Neni 10 i Statutit të Krahinës së Kosovës.

³⁰ Neni 53 i Statutit të Krahinës së Kosovës.

Kushtetuta e vitit 1963

Pas Ligjit Kushtetues të vitit 1953 e deri te viti 1963, kur del Kushtetuta e Dytë Federative u zhvilluan debate të shumta lidhur me raportet në Federatë dhe lidhur me pozitat e njësisve federative. Në Serbi, Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë ishte më i zëshëm dhe kishte përgatitur materiale konkrete, me të cilat kërkohet që krahinat autonome të viheshin në nivele rrethi. Dhe ato (krahinat) janë kategori e republikave socialiste dhe se të drejtat dhe detyrat autonome dhe parimet themelore mbi organizimin e njësisve autonome përcaktohen me Kushtetutën e Republikës.³¹ Kërkohej gjithashtu që çështja e autonomisë/ve të mbetej çështje me të cilën do të merrej vetëm republika dhe jo federata. Dhe kjo faktikisht u sanksionua me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1963. Jugosllavia miratoi një kushtetutë të re që i jepte Kosovës statusin e pokrajina-s sikurse Vojvodinës, në vend të oblast.³² Kushtetuta e vitit 1963, ajo pak që kishte mbetur nga autonomia, do të reduktohet edhe më tutje, duke e vendosur atë më shumë nën Serbi sesa nën autoritetin federativ.³³ Kushtetuta federative i zhvesh krahinat nga karakteri federal duke i lënë ato nën ekskluzivitetin e Republikës së Serbisë. Me Kushtetutën federative konstatohet se “në RS-së të Serbisë ekzistojnë Krahina Autonome e Vojvodinës dhe ajo e Kosovës e Metohisë, të cilat janë formuar më 1945-ën me vendimin e Kuvendit Popullor të RP të Serbisë, në bazë të vullnetit të shprehur të popullsisë së këtyre trevave”.³⁴ Ky formulim e vë në pikëpyetje edhe vendimin e Kuvendit të Prizrenit sipas të cilit Kosova i bashkohej Serbisë federale duke qenë njëkohësisht pjesë përbërëse e Federatës. Kjo Kushtetutë kishte vetëm një garanci në kuptim të ruajtjes nga zhveshja totale e autonomisë së Kosovës, me nenin 111 të saj ku thuhet se “Kushtetuta parashikon se formimi ose suprimimi i krahinës autonome hyn në fuqi kur vërtetohet me Kushtetutën e Jugosllavisë”. Në paragrafin tre të nenit 111 konstatohet se “në Republikën Socialiste të Serbisë ekzistojnë krahinat autonome të Vojvodinës dhe Kosovës e Metohisë të cilat në vitin 1945 janë themeluar nga Kuvendi Popullor i Serbisë duke u bazuar në vullnetin e shprehur të banorëve të këtyre zonave”. Por, sa mund të ishte kjo garanci e mundshme për t’u realizuar, tani është vështirë të thuhet. Kjo ngase praktika ka treguar, se në çështjet që kishin të bënin me Kosovën, vullneti serb në të shumtën e rasteve pranohej lehtë apo

³¹ Esat Stavilevi, Vepra I, *Kosova në ish Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.62.

³² Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010, fq.303.

³³ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.5 (qasur më 29.12.2013).

³⁴ Kurtesh Saliu, Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e Autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.48

thjesht imponohej me lehtësi në Federatë. Tendencat e ndryshimeve të raporteve në Federatë kishin si qëllim decentralizimin dhe bartjen e pushtetit nëpër republika, por kjo nuk do të bëhej edhe për krahinat. Në këtë kohë organet e sigurimit ende vazhdonin me aktivitetet e tyre diskriminuese dhe shtypëse dhe tashmë shqiptarët e Kosovës vazhdonin të jetonin në pjesën më të shtypur politikisht. Vitet pesëdhjetë dhe fillimvitet gjashtëdhjetë për shqiptarët e Kosovës ishin më të vështirat e kohës së sundimit të Titos. Vazhdoi një pabarazi e madhe etnike: serbët dhe malazezët, të cilët përbënin 27% të popullatës së Kosovës sipas regjistrimit të vitit 1953, përbënin 50% të anëtarësisë së partisë dhe 68% të administratës dhe të posteve udhëheqëse.³⁵ Kosova gjatë kësaj periudhe ishte edhe rajoni më i pazhvilluar ekonomikisht i Jugosllavisë. Nga viti 1958 në tërë Kosovën kishte 49 ndërmarrje industriale me 16.000 veta të punësuar; Sllovenia, po në atë kohë, për hir të krahasimit, kishte 465 ndërmarrje të tilla.³⁶ Nuk do të ishte korrekte të thuhet nga konteksti i sotëm kohor, se Kosova dhe populli i Kosovës në atë kohë ka mundur të bënte më shumë, në mënyrë që të mbrohej subjektiviteti i Kosovës brenda Federatës dhe të pengohej futja e saj pothuaj e tërësishme vetëm në sistemin kushtetues të Republikës Socialiste të Serbisë. Rrethanat e përshkruara, përmendja e citimi i vetëm i disa fakteve shkojnë më shumë në favor të pamundësisë për të mbrojtur subjektivitetin e Kosovës.

Sidoqoftë, Republika Socialiste e Serbisë e nxori Kushtetutën e vet në vitin 1963, Kushtetutë kjo e cila tashmë i përcaktonte të drejtat dhe detyrat e krahinave. Sipas kësaj Kushtetute krahina rregullonte çështjet me interes të përgjithshëm për krahinën në fushën e ekonomisë, arsimit, kulturës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, marrëdhënieve komunale dhe atyre të banesave. Krahina nxjerr planin shoqëror dhe buxhetin, mund të themelojë organizata punuese e organizata të tjera vetëqeverisëse për ushtrimin e punëve në kuadrin e të drejtave dhe detyrave të veta, kujdeset për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë si edhe ushtron dhe punë të tjera të caktuara me ligjin republikan.³⁷

Sipas Kushtetutës të vitit 1963 dhe Statutit të Kosovës (i treti në radhë) krahina si organ më të lartë të pushtetit ka Kuvendin Krahinor. Kurse në Kushtetutën federative nuk figuron më

³⁵ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, & shtëpia e librit Tiranë, 2001, fq.336-337.

³⁶ Po aty.

³⁷ Shih nenin 129 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë të vitit 1963.

emri i Kosovës (autonome) si pjesë përbërëse e Federatës.³⁸ Ky Kuvend ushtron të drejtat e veta në bazë të Kushtetutës së RSS-së, ligjeve republikane dhe Statutit të Krahinës. Kuvendi përbëhet prej pesë dhomave: Dhomës Krahinore, Dhomës Ekonomike, Dhomës Kulturore-arsimore, Dhomës Sociale-shëndetësore dhe Dhomës Organizative politike. Deputetët zgjidhen në mënyrë të tërthortë dhe jodrejtëpërdrejt nga qytetarët. Si organ ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës është Këshilli Ekzekutiv. Kuvendi Krahinor themelon organet e administratës, që do të kryejnë punë administrative. Krahina e Kosovës në këtë periudhë ka zgjedhur pesë deputetë për dhomën e kombeve – në dhomën federative, por ky delegacion nuk ka qenë i pavarur. Ka qenë delegacion në kuadër të atij të Republikës së Serbisë.

Si përfundim, me këtë Kushtetutë krahinat e humbasin krejtësisht karakterin e tyre si element konstitutiv të federalizmit jugosllav duke u shndërruar në kategori republikane. Krahinat tash, më shumë i përngjajnë formave të vetëqeverisjes lokale sesa atyre të organizuara si autonomi politiko - territoriale. Ato mund të suprimohen sikurse bashkësitë shoqërore politike lokale dhe kjo tregon më së miri se në çfarë niveli kishte arritur pozita juridike e Kosovës, por edhe e Vojvodinës, me Kushtetutën Federative dhe Republikane të vitit 1963.

Por kjo Kushtetutë apo këto kushtetuta nuk do të kanë jetë të gjatë, sepse raportet shoqërore më pas do të ndryshojnë pak vite dhe sidomos pas Mbledhjes së famshme të njohur si “Plenumi i Brionëve” që në fakt ishte Mbledhja e Katërt e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, që u mbajt në Brionë³⁹ në vitin 1966. Në këtë plenum u shkarkua Aleksandër Rankoviç, që atëherë ishte në funksionin e nënkryetarit të Jugosllavisë dhe në të njëjtën kohë ai u shkarkua nga të gjitha funksionet e tjera politike e shtetërore.⁴⁰ Plenumi i Brionëve dhe ndryshimet në kreun shtetëror dhe politik jugosllav krijuan rrethana të reja që çojnë

³⁸ Shih nenin 2 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1963, ku në paragrafin e dytë thuhet se territori i RSFJ-së është i pandashëm dhe atë e përbëjnë territoret e republikave socialiste.

³⁹ Ishull në Kroaci që thuhet se ka qenë njëra nga rezidencat e Titos.

⁴⁰ Aleksandar Rankoviç ishte përfaqësues kryesor i forcave unitariste dogmatike dhe centraliste, të cilin shumëkush e konsideronte pasardhës të Titos. Ishte udhëheqës i rangut të lartë i Partisë Komuniste, me një të kaluar “impozante”. Ishte themelues i UDB-së dhe OZNA-s (shërbimit të fshehtë të ushtrisë) dhe për shumë vite shef i këtij shërbimi sikundër që ishte figurë dominante në policinë e fshehtë. Largimi i Aleksandër Rankoviçit nga kreu partiak jugosllav dhe nga skena politike, nuk ka ndodhur për shkak të Kosovës, por gjithsesi largimi i tij nga skena ka krijuar atmosferë të një fryme demokratike në një shoqëri socialiste çfarë ishte Jugosllavia. Ky nacionalist serb dhe antishqiptar i përjetuar u largua nga skena si pasojë e skandaleve të përgjimeve që kishte bërë sigurimi shtetëror ndaj funksionarëve të lartë partiakë dhe shtetërorë dhe edhe të vetë Titos. Për më tepër lidhur me Plenumin e Brionëve shih: *Ocjene i prikazi, Fontes Izvori za Hrvatsku Povijest*, No.3 (Zagreb) 3, fq.333-371. Ndërkaq te shqiptarët e Kosovës mbahet mend si një kriminel që ka ushtruar dhunë dhe terror, që si pasojë ka shkaktuar vrasje, burgosje, maltretime, tortura dhe shpërngulje të shqiptarëve nga trojet e tyre, sidomos largimin e tyre për në Turqi.

kah një demokratizim të raporteve në Federatën Jugosllave dhe filluan procesin e ri të decentralizimit të pushtetit, tashmë duke përfshirë edhe krahinat.

Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e vitit 1963

Nëpër nivele të ndryshme partiake e shtetërore u zhvilluan diskutime për nevojat e ndryshimeve kushtetuese dhe në vitin 1967 u krijuan komisione për ndryshimin dhe plotësimin e akteve më të larta juridike dhe politike në të gjitha nivelet: federative, republikane dhe krahinore. Këto diskutime zhvillohen në një kohë kur forcat dogmatike - centraliste apo burokratiko - etatiste në Serbi humbasin forcën dhe ndikimin. Ndryshimet u iniciuan jo vetëm si rezultat i Plenumit të Brionëve. Këto u iniciuan edhe në një klimë të favorshme të krijuar brenda Jugosllavisë, por edhe jashtë saj. Dhe ndryshimeve kushtetuese iu dhanë shtytje ngjarjet e zhvilluara në Kosovë, sidomos demonstratat e shqiptarëve në Kosovë të vitit 1968. Gjatë këtyre demonstratave të 27 nëntorit 1968, u parashtruan kërkesa për hapjen e universitetit të Kosovës, u protestua kundër politikës që demonstruesit e konsideronin politikë kolonialiste, apo shprehur ndryshe me këto demonstrata shprehej revoltë gjithëpopullore kundër politikës diskriminuese dhe shtypëse që po bëhej prej kohësh ndaj popullit shqiptar në Kosovë, por edhe në Jugosllavi përgjithësisht. Kështu një ndryshim në Kushtetutën e 1968-ës forcoi lidhjet me Federatën, pas së cilës shqiptarët demonstruan për një republikë të tyre, ndërkohë që disa madje kërkonin bashkim me Shqipërinë.⁴¹ Ndryshimet kushtetuese, përkatësisht amendamentet i përkrahte edhe Tito, i cili thoshte: këto amendamente kanë qenë një hap përpara në drejtim të kapërcimit të disharmonive të paraqitura dhe kanë krijuar mundësi të gjera për zhvillimin e vetëqeverisjes dhe për realizimin më të plotë të barazisë së kombeve e të kombësive të Jugosllavisë.⁴² Ndryshimet do të avanconin pozitën e Kosovës në Federatë duke u forcuar lidhjet me Federatën, por nuk do t'i jepnin Kosovës statusin e republikës. Këtë po e bënte të ditur edhe Legata e Beogradit kur iu drejtua Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut, ku shkruhej:

”në takimin që ka pasur Bujar Hoxha me disa anëtarë të komisionit, për ndryshimin e statusit të Kosovës ka mësuar se, Kosova nuk do të shpallet republikë, por autonomia e saj do të forcohet dhe për shumicën e problemeve ajo do të ketë lidhje me Federatën dhe jo me Republikën e Serbisë. Udhëheqja e Kosovës nuk ka propozuar vetë për krijimin e

⁴¹ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010, fq.306.

⁴² Izbor materiala za javnu debate o ustavnim amandmanima, Tanjug, Beograd, 1971, fq.6.

*republikës së Kosovës, mbasi një propozim i tillë, sipas mendimit të tyre, nuk ishte oportun për situatën e tanishme”.*⁴³

Por në kushte kur kërkesa për republikë, e shpallur dhe e mirëpritur në popull, u braktis nga politikanët e Kosovës, pjesëmarrësit e lëvizjes ilegale e çmuan atë si detyrë dhe objektiv të ri për të cilin ia vliente të luftohej e të sakrifikohej. Studentët, si pjesa më e ndjeshme dhe më shërbyese e popullit, u bënë bartësit kryesorë dhe u vunë në radhët e para të përpjekjeve dhe të luftës për republikë. Në fund të vitit 1968 ata dolën në demonstrata...⁴⁴

Dhe pa dyshim kontributi i demonstratave të 1968-ës në avancimin e pozitës së Kosovës është më i rëndësishmi, nëse jo kryesori.

Amendamentet kapnin sfera dhe fusha të cilat tash do të ndryshonin Kushtetutën esencialisht. Kështu, me amendamentin VII tashmë sanksionohej pozita kushtetuese e krahinave duke u bërë që ato t'i takonin dy sistemeve kushtetuese atij jugosllav dhe atij të Republikës së Serbisë. Me këtë amendament ndryshohen dispozitat e nenit 2, të Kushtetutës së Jugosllavisë.⁴⁵ Gjithashtu tashmë Krahina e Kosovës nuk do të quhej më Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, por do të quhej vetëm si Kosovë. Amendament shumë i fuqishëm është amendamenti XVIII i Kushtetutës federative, sipas të cilit krahinat përcaktoheshin si

*“bashkësi socialiste demokratike shoqërore e politike me përbërje të veçantë kombëtare dhe me veçori të tjera”*⁴⁶,

për më tepër statusi i krahinave tashmë pothuajse barazohet tërësisht me atë të republikave. Krahinat autonome ushtrojnë të gjitha funksionet, që ushtrojnë republikat, po përjashtim bëjnë ato funksione që paraqesin interes të përbashkët për kombet dhe kombësitë e Serbisë, e që përcaktohen me Kushtetutën e Republikës. Krahina me ndryshimet e bëra siguron të drejtën për të mbrojtur tërësinë e vetë territoriale. Krahina nxjerr Ligjin e vet Kushtetues, që është akti më i lartë me të cilin caktohen të drejtat, detyrat dhe organizimi i krahinës. Organi më i lartë

⁴³ AMPJ, viti 1968, dos.360, f.51. Relacion nga Legata e Beogradit drejtuar Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut, maj 1968, cituar nga: Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2012, fq.177.

⁴⁴ Ana Lalaj, *Kosova, rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*, Mësonjëtorja e parë, Tiranë, 2000, cituar nga Esat Stavileci, *Vepra I, Kosova në ish- Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.69.

⁴⁵ Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.55, 1968.

⁴⁶ Amendamenti XVIII, pika 2 në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

përfaqësues i krahinës nxjerr ligje në vend të vendimeve që nxirrte deri në këtë fazë. Në Kosovë me këto ndryshime themelohet Gjykata Supreme e Kosovës, e cila burimisht ushtron funksionin e vetë gjyqësor në territorin e saj. Brenda Gjykatës Supreme të Kosovës krijohet Dega Kushtetuese - Gjyqësore për çështje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Si subjekte të barabarta, krahinat përfaqësohen drejtpërdrejt në Federatë. Kështu në Dhomën e Kombeve të Kuvendit Federativ republikat delegojnë nga 20 deputetë, kurse krahinat përfaqësohen me 10 deputetë. Deputetët zgjidhen po në atë mënyrë sikurse në republika.⁴⁷

Ndryshimet kushtetuese vazhdojnë të bëhen edhe në vitin 1971, kur janë aprovuar amendamentet XX-XLII kushtetuese në Kushtetutën e RSFJ-së dhe këto ndryshime, në kontekst kohe dhe në kontekst të rendit juridik dhe sistemit politik kanë shënuar hapa të rëndësishëm në zhvillimin e asaj që ishte karakteristikë e sistemit jugosllav, sistemit të vetëqeverisjes socialiste si dhe me sigurimin e pozitës zotëruese të klasës punëtore. Ndryshimet kushtetuese kanë bërë një delegim të një numri të caktuar kompetencash nga federata në republika dhe në krahina. Krahinat në mënyrë të barabartë janë pjesë e përcaktimit të politikës së jashtme të Jugosllavisë. Këtë e bëjnë duke marrë pjesë në mekanizmat e dhënies së pëlqimit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare.⁴⁸

Ndryshimet përmes amendamenteve kushtetuese në aspektin formal-juridik sanksionojnë marrëdhëniet shoqërore të krijuara, të cilat nuk është se u pranuan lehtë në Serbi. Megjithatë, dhe pavarësisht pëlqimit ose kundërshtimit të Serbisë, marrëdhëniet shoqërore të një forme të demokracisë socialiste vetëqeverisëse jugosllave, kanë hapur rrugën për ndryshime edhe më të thella shoqërore dhe për demokratizim të raporteve në Federatë. Kjo ka çuar te nxjerrja e Kushtetutës Federative të vitit 1974 dhe rrjedhimisht edhe të kushtetutave të republikave dhe të krahinave në të njëjtin vit. Zgjidhjet në Kushtetutën e vitit 1974, synonin sipas Gazmend Zajmit, balancimin ndërmjet tendencave konfliktore, që manifestoheshin në sferën interetnike të Jugosllavisë ndërmjet konceptit të Federatës së centralizuar dhe tendencave konfederaliste, të eksponuara “pa u përmendur termi konfederatë në atë botë”.⁴⁹ Kjo Kushtetutë shënon, në një anë kulmin e zhvillimit të demokracisë socialiste të Federatës Jugosllave, kurse në anën tjetër do

⁴⁷ Amendamenti VIII në Kushtetutën e Jugosllavisë.

⁴⁸ Shih nenin 271 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁴⁹ Gazmend Zajmi, *Rrjedhat kryesore të konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë*, marrë nga Esat Stavileci, Vepra V, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtinë 2013, fq.230.

të shënojë edhe fillimin e fundit të kësaj Federate, e cila fatkeqësisht do të shkatërrohet përmes një procesi jokonsensual, proces që do shoqërohet me luftë të tmerrshme, përmasat e së cilës nuk janë parë në Europë qysh nga Lufta e Dytë Botërore.

KREU I: Zhvillimet politiko- juridike në Kosovë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974 deri në vitin 1981

1.1. Vështrim në Kushtetutën e KSAK-së

Amendamentet kushtetuese të vitit 1968 dhe të vitit 1971 paraqesin bazën për sanksionimin e pozitës së re kushtetuese brenda Federatës Jugosllave. Kjo pozitë fuqizohet duke u sanksionuar me Kushtetutën e vitit 1974. Kosova përcaktohet si njësi autonome, politike dhe territoriale në njërenë anë dhe si element konstitutiv i federalizmit jugosllav, në anën tjetër. Në kontekstin kohor dhe sipas Kushtetutës Kosova njihet si:

- *Bashkësi e gjerë shoqërore -politike autonome vetëqeverisëse;*
- *Bashkësi e kombeve dhe e kombësive;*
- *Element konstitutiv i federalizmit jugosllav;*
- *Me pozitën e saj në kuadrin e RS-së të Serbisë.⁵⁰*

Dallimi në emërtim në mes të republikave dhe krahinave autonome nuk ishte i madh përmbajtësisht. Edhe pse jo ende republikë, autoriteti i saj (Kosovës –vërejtje B.Rr) brenda Federatës ishte tashti i barabartë me atë të Serbisë.⁵¹ Kurse shkaqet e ndryshimit të Kushtetutës së vitit 1963 me amendamentet e përmendura më lart janë të ndryshme dhe mund të kategorizohen në amendamente politike, ekonomike, sociale, etj., por nga të gjitha mund të veçohen ato politike. Dhe nga amendamentet politike do të veçoja dy: ato që i takonin kontekstit gjithëjugosllav dhe ato që i takonin popullit shqiptar të Kosovës. Mund të gjendet edhe ndonjë lidhje me lëvizjet e Europës së viteve shtatëdhjetë, edhe pse përmbajtësisht ato s’kishin diçka të përbashkët me lëvizjet në Jugosllavi. Por gjithsesi ishte një frymë proteste edhe në Europë.

Rënia e Rankoviçit dhe Plenumi i Brionëve dinamizuan procesin e demokratizimit të raporteve shoqërore në Jugosllavi dhe nxitën një proces decentralizimi, përmes të cilit pushteti

⁵⁰ Kurtesh Saliu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.63.

⁵¹ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.5 (parë më: 29.12.2013).

federativ po delegonte autoritet nëpër njësitë federative. Marrëdhëniet e reja shoqërore duhej të sanksionoheshin me mekanizma formalo-juridikë dhe ky proces nuk duhej se mund të kryhej vetëm me amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963. Duhej nxjerrë një kushtetutë krejtësisht e re. Mjedisi politik ndryshoi dukshëm pas Plenumit të Brionëve, por kjo nuk do të thotë se në Serbi gjërat po pranoheshin lehtë. Në anën tjetër, gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1968 në Kosovë shpërthyen demonstrata gjatë të cilave u shprehën kërkesa ekonomike dhe politike, që synonin barazimin e pozitës së popullit shqiptar me atë të popujve tjerë të ish -Jugosllavisë. Demonstratat e Kosovës do të ndiqeshin nga demonstratat e shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Ulqinit dhe në vitet e ardhshme do të përkujtoheshin po në të njëjtën mënyrë me manifestime të hapura qytetare.⁵² Në demonstrata kërkohej lirim i përdorimit të flamurit, hapja e universitetit, si dhe statusi i republikës. Atmosfera e krijuar në Jugosllavi, sado që duhej më e favorshme dhe më demokratike, nuk ishte diçka e lehtë për Serbinë që t'i pranonte këto ndryshime dhe aq më shumë e sidomos qarqet nacionaliste serbe.

Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë, që në fakt është Kushtetuta e fundit e Federatës (që do shkatërrohet) është aprovuar më 21.02.1974. Kjo Kushtetutë njihet si një ndër kushtetutat më voluminoze apo më të gjata në botë. Përbëhet prej 406 neneve. Kushtetuta përbëhet prej 10 parimeve themelore dhe ndahej në gjashtë pjesë. Më në fund, Kushtetuta federative e vitit 1974 përcaktoi natyrën e dyfishtë të dy krahinave (pokrajina) si njësi federative dhe si pjesë të Serbisë....⁵³ Menjëherë pas nxjerrjes së kësaj Kushtetute u nxorën edhe Kushtetuta e Kosovës me datë 27.02.1974 dhe dy ditë përpara ishte nxjerrë edhe Kushtetuta e Republikës së Serbisë.

Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974, bashkë me Kushtetutën e KSA Kosovës, sanksionuan raportet shoqërore në Federatën Jugosllave, me çka Kosova duke u sanksionuar si njësi e mëvetësishme politike dhe territoriale, gjithashtu shndërrohej në një element konstitutiv federativ, i barabartë me të gjitha njësitë e tjera të Federatës. Krahina autonome me Kushtetutën federative caktohet si bashkësi autonome socialiste shoqërore-politike vetëqeverisëse

⁵² Sabit Sylaj, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 – 1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2012, fq.173.

⁵³ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010, fq.306.

demokratike, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve.⁵⁴

Sistemi jugosllav

*bënte një dallim në mes të kombeve dhe kombësive dhe në këtë kontekst, shqiptarët në Jugosllavi konsideroheshin kombësi. Ky dallim sqarohet me faktin se shqiptarët, sikundër hungarezët në Vojvodinë, konsiderohen si narodnost (kombësi) në vend të popull (narod). Dallimi supozohet të bëhet nga shkaku se ekzistonte shteti shqiptar dhe shteti hungarez. Kështu kombet kanë të drejtë për republikën e tyre, kurse kombësitë jo.*⁵⁵

Në anën tjetër sipas Kushtetutës federative

*kombet dhe kombësitë në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë janë të barabarta.*⁵⁶

Pavarësisht këtij dallimi në emër, me Kushtetutën federative përcaktohej se

*”punonjësit dhe kombet e kombësitë i realizojnë të drejtat e tyre sovraane në republikat socialiste dhe në krahinat socialiste autonome, kurse në RSFJ kur kjo ishte në interesin e përbashkët për të gjithë.*⁵⁷

Interpretimi i këtij formulimi, i çfarëdo lloji qoftë, nuk mund të mohojë faktin se Kosova si njësi federative nuk ishte përcaktuar kështu pikërisht për shkak të përbërjes e saj etnike. Pra, për shqiptarët që për një mori shkaqesh njiheshin si kombësi. Shkaqet pse shqiptarët njihen si kombësi, janë sqaruar më lart shkurtimisht.

Lidhur me qenësinë e Kosovës si element konstitutiv të federalizmit jugosllav, mund të numërojmë disa nga komponentët e kësaj qenësie, pa i përmendur këtu edhe argumentet historike. Kjo në mënyrë të qartë vërehet së pari nga formulimi që mund të nxirret nga Kushtetuta federative, sipas së cilës, kombet dhe kombësitë në Federatë vendosin mbi parimet e

⁵⁴ Shih nenin 4 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁵⁵ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.12, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

⁵⁶ Shih nenin 245 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁵⁷ Shih Parimet Themelore, Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë e vitit 1974.

marrëveshjes midis republikave dhe krahinave autonome, të solidaritetit e të reciprocitetit, të pjesëmarrjes së barabartë të republikave dhe krahinave autonome në organet e Federatës, si dhe mbi parimin e përgjegjësisë së republikave dhe të krahinave autonome për zhvillimin e tyre dhe për zhvillimin e bashkësisë socialiste si tërësi.⁵⁸

Krahina (në rastin tonë Kosova) ishte e barabartë në Federatë pos të tjerash edhe nga pjesëmarrja në:

- *të caktuarit e kompetencave të Federatës dhe të kompetencave të veta;*
- *në përfaqësimin e saj në Federatë në lëmenjtë që janë rezervuar për Federatën si funksione të saj;*
- *në përfaqësimin e saj në organet e Federatës;*
- *në zbatimin e vendimeve që merren në Federatë dhe përgjegjësinë që mban për to.⁵⁹*

Me ndërrimet që solli Kushtetuta, federata dhe kompetencat e saj përcaktoheshin nga përbërësit e saj, që tashmë janë tetë njësi të barabarta federative, edhe pse dy dallonin për nga emërtimi, më shumë sesa nga fuqia dhe nga përmbajtja. Ndarja e funksioneve të federatës bëhej nga organet federative, por me pjesëmarrje të barabartë të republikave dhe krahinave si përbërëse të federatës. Kushtetuta federative i ka caktuar të drejtat dhe detyrat e federatës në interes të realizimit të interesave të përbashkëta. Këto të drejta dhe detyrime federata i ka realizuar përmes organeve të veta, përmes organeve të republikave dhe përmes organeve të krahinave dhe gjithashtu edhe përmes vendosjes së drejtpërdrejtë. Sesa të fuqishme kanë qenë njësitë federative tregon fakti se Kushtetuta federative vendosej për t'u ndryshuar në dhomën federative të Kuvendit Federativ me pëlqimin e kuvendeve të të gjitha republikave dhe krahinave autonome. Dhe nëse Kosova nuk jepte pëlqimin, Kushtetuta federative nuk mund të ndryshohej. Por gjithsesi pavarësisht barazisë formale që u sanksionua, megjithatë gjendja ndryshonte bazuar në raportin e forcave në momente të caktuara kohore, sidomos në kuptimin politik. Problemi ka qenë në disharmoni midis reales dhe normative. Me fjalë të tjera, krahas jetës formalo-juridike Kosova si pjesë konstituive e Federatës Jugosllave, jeta reale në atë krahinë ka qenë e tillë që

⁵⁸ Shih Parimet themelore I, paragrafi 3, Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë e vitit 1974.

⁵⁹ Kurtesh Salju, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.68.

shpesh u ngjante pamjeve nga “Rrethi i nëntë i ferrit”.⁶⁰ Hegjemonia dhe shovinizmi kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë kohës kur ka ekzistuar Jugosllavia dhe këta janë manifestuar sidomos kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Por vrotimi për pozitën e Kosovës duhet vështruar në kontekst të angazhimeve për avancim të pozitës në federate dhe këto përpjekje sigurisht kanë kaluar nëpër rrrathë të ferrit sepse dhuna dhe politika antishqiptare nuk kanë mundur të fshihen dhe as të amnistohen me këtë Kushtetutë. Përvoja dhe ngjarjet vërtetojnë brishtësinë e Kushtetutës që në të vërtetë është rezultat dhe pasojë e brishtësisë së vetë federatës.

Pavarësisht nga kjo Kosova është e përfaqësuar në të gjitha organet federative. Fakti se ajo përfaqësohej me numër më të vogël, krahasuar me republikat e tjera, nuk e zbeh dhe nuk e zvogëlon në asnjë mënyrë barazinë me republikat. Kjo ngase vendosja në Dhomën e Republikave dhe të Krahinave Autonome bazohej më shumë në paraqitjen e delegacionit dhe jo në bazë të delegatëve veç e veç. Një mekanizëm i veçantë i vendosjes është quajtur të vendosurit paraprak, apo siç njihet si dhënie e pëlqimit nga njësitë federative veç e veç. Ky mekanizëm përdoret në Dhomën e Republikave dhe Krahinave Autonome kur vendoset për çështjet e politikës ekonomike dhe për planifikimin në nivel federativ, për përcaktimin e vëllimit të tërësishëm të buxhetit të Federatës, për marrjen e obligimeve nga Federata, ratifikimin e traktateve ndërkombëtare të cilat implikojnë nxjerrje të ligjeve bazuar në këto traktate apo për ndryshim të ligjeve bazuar në traktatet që po ratifikohen.⁶¹ Në ndonjë rast, kur mund të mos arrihej pëlqimi i republikave dhe i krahinave, Kushtetuta federative kishte një zgjidhje të përkohshme për raste të domosdoshme. Në këso rastesh Qeveria Federative, që njihej me emërtimin Këshilli Ekzekutiv Federativ, mund t’i propozonte Kryesisë së RSFJ-së nxjerrjen e Ligjit për Masa të Përkohshme⁶², por ky ligj nuk mund të shërbente si zgjidhje e përhershme. Ishte vetëm si zgjidhje e përkohshme, derisa të mos arrihej marrëveshje sipas procedurës së rregullt në Dhomën e Republikave dhe të Krahinave. Koha për sa do të vepronte ky ligj ishte maksimumi një vit. Kjo tregon qartë se edhe në aspekt të marrëveshjes në Federatë Kosova ishte krejtësisht e barabartë me njësitë e tjera federative.

⁶⁰ Ekrem Avdic & Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë, lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.178.

⁶¹ Shih nenin 286 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁶² Shih nenin 301 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

Në nivel të Federatës ekzistonte dhe funksiononte Fondi për zhvillimin e Republikave dhe të Krahinave jo mjaft të zhvilluara dhe këtu gjithashtu Kosova kishte pozitë të barabartë me të gjitha republikat e tjera të Federatës. Bashkëpunimin me republikat e tjera dhe me Krahinën e Vojvodinës Kosova e bënte në mënyrë të pavarur.

Me ndryshimet e reja kushtetuese dhe me nxjerrjen e kushtetutave federative, republikane dhe krahinore, siç është nënvizuar, njësitë federative barazohen për nga pozita në Federatë. Por megjithatë, për pozitën e krahinave autonome do të mbesin disa nene të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, të cilat krahinat i parashohin si pjesë përbërëse edhe të sistemit kushtetues serb. Shkakët pse kishin mbetur këta mekanizma formalë juridikë kanë qenë kryesisht politike, ngase është tentuar që forcat nacionaliste serbe dhe ato burokratike etatiste të ndaleshin në një mënyrë nga kundërshtimet kategorike të ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974. Pavarësisht nga kjo, këto forca shumë shpejt do të dalin me kërkesë për ndryshime të Kushtetutës apo të dispozitave që kanë të bëjnë me pozitën e krahinave autonome. Kështu pa u bërë ende një vit i plotë, më 16.01.1975 Kryesia e Republikës së Serbisë kërkon revizion të Kushtetutës. Revizioni kishte për qëllim që “të kthente pushtetin e vet mbi krahinat” për të “realizuar të drejtën e krijimit të shtetit serb” brenda Federatës Jugosllave. Për më tepër këto çështje, që parashtroheshin nga politika serbe, për raportet republikë - krahinë u përmblohdën në një elaborat që quhej “Libri i Kaltër”.⁶³ Këto qëndrime dhe ky elaborat në kohën e paraqitjes nuk gjetën përkrahjen nga elitat politike jugosllave dhe as nga Presidenti i atëhershëm jugosllav, Tito. Sidoqoftë, dispozitat e neneve 300, 301 dhe 305 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë do të jenë dispozita, të cilat do të paraqesin vështirësi dhe kokëçarje për shqiptarët e Kosovës. Do të jenë këto nene, të cilat Serbia do t’i përdorë për të iniciuar ndryshimet kushtetuese të mëvonshme, që për Kosovën do të jenë të përgjakshme dhe në anën tjetër do të jenë argumente, të cilat Serbia do të provojë t’i përdorë si argumente që tregojnë se Kosova ka qenë pjesë e sistemit kushtetues të Serbisë, në kohën e kundërshtimit të ndërtimit të shtetit të Kosovës.

⁶³ Libri i Kaltër ka bërë një analizë të pozitës kushtetuese të Serbisë dhe të pozitës së krahinave autonome. Shumë shpejt doli në shesh se nuk ishte pozita e krahinave qëllimi themelor i ndryshimeve në Kushtetutën e vitit 1974, por më shumë ishte mjet për të destabilizuar raportet në Jugosllavi. Në krye të Serbisë, menjëherë pas vdekjes së Titos, erdhi gjenerali, Nikola Lubicic, i cili nga një ushtarak shndërrohet në një burrë shteti. Para se të vinte dhe të merrte këtë pozitë, kishte shërbyer 13 vite në krye të Armatës Federative. Qëndrimi i tij se “Jugosllavinë do ta mbrojnë serbët dhe APJ” tregon përmbajtjen se Jugosllavia konsiderohej shtet serb, të cilin do ta mbrojnë APJ me ushtarët e vet. Për më tepër shih: Sonja Biserko, *Kovanje antijugoslavenske zavere*, Libri 1, Svedocanstvo, Beograd, 2006, fq.23.

Formulimi i nenit 300 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë linte hapësirë interpretimesh të ndryshme, varësisht nga raporti i forcave dhe varësisht nga momenti dhe rrethanat politike. Me këtë nen rregulloheshin disa çështje që e tregonin Republikën si bashkësi shtetërore në fushat siç janë: organizimi dhe zgjedhja e organeve republikane, shtetësinë republikane, festat, etj. Konstitucionalistët jo rrallë kanë bërë interpretime të ndryshme lidhur me dispozitat e neneve të përmendura të Kushtetutës së RS të Serbisë, por asnjë interpretim nuk do mund të shkojë në disfavor të qenësisë së Kosovës si njësi e barabartë e federalizmit jugosllav. Vënia e sistemit jugosllav në bazat kushtetuese të vitit 1974 është bërë nga kërkesat e shqiptarëve për status të barabartë me popujt e tjerë duke kërkuar status të republikës, në njërën anë, dhe në anën tjetër të tendencave serbe për refuzim të avancimit të pozitës juridiko - kushtetuese të shqiptarëve dhe të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Kështu kërkesat maksimaliste, në kontekst kohor, të Kosovës për nga emërtimi nuk u realizuan, kurse Serbia duhej qetësuar me ndonjë formulim, siç ishin nenet 300, 301 dhe 305 të Kushtetutës së RS të Serbisë. Kosova me Kushtetutën e vet ka rregulluar çdo çështje me interes për qytetarët e saj, ndërkohë që ka pasur edhe një mundësi, që përmes një mekanizmi kushtetues të pengojë ndryshimet e Kushtetutës serbe, e cila nuk ka mundur të ndryshohej pa pëlqimin e Kosovës, kurse Kushtetuta e Kosovës mund të ndryshohej vetëm sipas procedurës kushtetuese të paraparë me kushtetutën e vet. Kështu Kosova ka qenë e mëvetësishme në çdo aspekt dhe para se të paraqesim karakteristikat e mëvetësisë së Kosovës, do të përmendim edhe një fakt shumë të rëndësishëm: Kosova ka pasur pavarësi totale territoriale.

1.1.1. Pavarësia territoriale e Kosovës

Karakteristikë e federalizmit jugosllav ishte edhe pavarësia territoriale e njërive federative. Kosova sipas Kushtetutës ka të drejtë të vendosë për pavarësinë e saj territoriale. Nuk mund të bëhej kurrfarë ndryshimi i territorit të Kosovës, pa pëlqimin e dhënë, sikundër që edhe kufijtë e jashtëm të ish-Jugosllavisë nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin edhe të Kuvendit të Kosovës.⁶⁴ Këtë të drejtë të Kosovës e ka rregulluar Kushtetuta federative⁶⁵ dhe rrjedhimisht kjo çështje është rregulluar edhe me Kushtetutën e Kosovës. Kështu,

⁶⁴ Gazmend Zajmi, *Dimensionet e çështjes së Kosovës në Ballkan* (në dorëshkrim, vërejtje e ES-së), marrë nga Esat Stavileci, Vepra V, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.17.

⁶⁵ Neni 5 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

*territori i KSA Kosovës përbëhet nga territori i komunave që kanë qenë me rastin e nxjerrjes së Kushtetutës dhe ai nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës.*⁶⁶

1.1.2. Autonomiteti i Kosovës⁶⁷

Autonomiteti e Kosovës dhe e drejta e saj për të ndjekur rrugën e vet të ndërtimit, në proceset që do të pasojnë pas Kushtetutës së fundit të Federatës Jugosllave, do të kuptohet më lehtë nëse paraqesim fushat në të cilat manifestohej mëvetësia. Disa nga këto fusha janë, si vijon:

- *autonomiteti në fushën e vetorganizimit;*
- *autonomiteti në fushën legjislative;*
- *autonomiteti në fushën e ekzekutivit;*
- *autonomiteti në fushën gjyqësore;*
- *autonomiteti në fushën e financave;*
- *autonomiteti në fushën e marrëdhënieve me botën e jashtme;*
- *autonomiteti në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë;*
- *autonomiteti në fushën e mbrojtjes popullore dhe të sigurimit shtetëror;*
- *autonomiteti në fushën jashtëqeveritare.*

1.1.3. Autonomiteti në fushën e vetorganizimit

Faktori qenësor në të drejtën e vetorganizimit është akti më i lartë juridik i vendit dhe këtë Kosova e kishte. Me Kushtetutën e Kosovës rregullohej organizimi i Kosovës në mënyrë të

⁶⁶ Neni 3 i Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974.

⁶⁷ Profesor Arsim Bajrami, duke shpjeguar fushat ku Kosova konsiderohej se ishte e barabartë me republikat e tjera të Federatës Jugosllave, përdor termin mëvetësi. Profesor Kurtsh Saliu për këtë çështje përdor termin autonomitet. Të dy këtyre autorëve u referohem në masë të madhe në kreun 1 të punimit dhe vetëm për shkaqe gjuhësore, po arsyetoj pse unë do ta përdor termin autonomitet dhe këtë e bëj duke u bazuar në Fjalorin e Shqipes së Sotme, Botimi i dytë i ripunuar, Tiranë 2002, i cili për fjalën **autonomi** thotë: 1. E drejta e një vendi (e një krahinë a e një republike) për t'u qeverisur sipas ligjeve të veta, brenda sistemit të administrimit të një shteti më të madh; vetëqeverisje. Autonomi krahinore. Fitoi autonominë. 2. Mundësia për të punuar a për të vepruar në mënyrë të pavarur; gjendje pavarësie. Mëvetësi: të qenët i mëvetësishëm; pavarësi. Mëvetësia e Shqipërisë. Në asnjë mënyrë nuk e konsideroj se vihem në favor të njërit të këtyre njohësve të shquar të së drejtës, në veçanti të së drejtës kushtetuese, të cilëve u jam mirënjohës për dijen që më kanë dhënë që nga ditët kur kam qenë student i tyre në Fakultetin Juridik të Prishtinës e deri më sot.

mëvetësishme. Kosova sipas Kushtetutës mund të ndryshojë strukturën e vet dhe proceduara për ndryshimin e Kushtetutës është paraparë me Kushtetutën e vet. Fakti se me Kushtetutën federative është thënë se kushtetutat e njësisve federale nuk mund të janë në kundërshtim me Kushtetutën federative, nuk e humb dhe nuk e vë në diskutim origjinalitetin e Kushtetutës së Kosovës. Kjo është karakteristikë e sistemeve federale, ku kushtetuta e njësisë federative duhet të jetë në pajtim me kushtetutën federative.

Kosova me Kushtetutën e vet cakton funksionet dhe kështu, sipas Kushtetutës qytetarët, punonjësit, i realizojnë të drejtat sovrane, barazinë, lirinë kombëtare, sigurojnë zhvillimin shoqëror dhe shumë të drejta që në përshkrimin kushtetues të kohës kanë ngjyrë juridiko-socialiste.

Kosova ka organet e veta të qeverisjes, që përcaktohen dhe që rregullohen me Kushtetutën e vet. Këto organe janë: *Kuvendi i KSA Kosovës* si organ më i lartë i pushtetit. Kuvendi përbëhet prej tri dhomave: Dhoma e Punës së Bashkuar, që ka 90 delegatë, Dhoma Shoqërore - Politike dhe Dhoma e Komunave që kanë nga pesëdhjetë delegatë. Kuvendi krijon organe ndihmëse si komisione, këshilla ose forume që mund të jenë të përhershme apo të përkohshme. Kuvendi i Kosovës ratifikon marrëveshje të cilat krahina i lidh me organe dhe me organizata të shteteve të tjera dhe me organe dhe organizata ndërkombëtare.⁶⁸ Kryesia e KSA së Kosovës si organ i ri e përfaqëson Kosovën, shqyrton çështje me rëndësi për jetën politike, ekonomike, kulturore, realizimin e barazisë së kombeve dhe të kombësive, shqyrton çështjet e bashkëpunimit në mes të republikave dhe krahinave, bën falje në pajtim me ligjin, realizon punë të veçanta në fushën e mbrojtjes popullore, në kohë paqeje dhe në gjendje lufte si edhe në gjendje rreziku nga lufta. Në këso situata kryesia udhëheq me rezistencën në territorin e Kosovës.

Kryesia e KSA të Kosovës ka kryetarin dhe tetë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, kurse Kryetari i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës bëhet anëtar i Kryesisë sipas funksionit.⁶⁹

⁶⁸ Neni 301 i Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr. 04,1974,

⁶⁹ Neni 147 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë parasheh formimin e Kryesisë në republika dhe në krahina.

Këshilli Ekzekutiv i KSA të Kosovës apo ndryshe qeveria e Kosovës zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës. Në kuadër të kompetencave të Kosovës krijohen edhe organet e administratës, të cilat zbatojnë politikën e Kuvendit të Kosovës, ligjeve dhe akteve të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Organet e administratës vendosin për çështje administrative, mbikëqyrin çështjet administrative, etj. Organe kryesore të administratës janë sekretariatet krahinore, komitetet, drejtoritë, inspektoriatet, organizatat që ushtrojnë punë me interes duke kryer punë të caktuara administrative.⁷⁰

Mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë e kryen Gjykata Kushtetuese e KSA të Kosovës.⁷¹ KSA e Kosovë si instancë më të lartë të gjyqësisë ka Gjykatën Supreme dhe po ashtu Prokurorin Publik të Kosovës si instancë më të lartë të sistemit prokurorial të Kosovës.

1.1.4. Autonomiteti në fushën legjislative

Kosova në këtë fushë është bartëse sovrane dhe burimore e rregullimit legjislativ. Funkcionet legjislative të Kosovës kanë qenë njëlloj të rregulluara sikurse për njësitë e tjera federale. Kosova kështu ka nxjerrë Kushtetutën e vet sikundër ka nxjerrë ligje nga kompetenca që i kanë takuar me Kushtetutë. Ky pushtet legjislativ nuk ka qenë i kufizuar, përveçse në rastet për të cilat kanë qenë kompetencë të mbulohen me ligje federative.

1.1.5. Autonomiteti në fushën ekzekutive

Parimisht funksionet ekzekutive kanë të bëjnë me zbatimin e politikës dhe të normave të organeve të Kosovës. Por krahas kësaj organet e KSA të Kosovës kanë zbatuar edhe dispozitat federative që kanë qenë të rezervuara për t'u zbatuar nga njësitë federative. Organet federative kanë mundur të zbatojnë politika dhe dispozita vetëm për rastet e caktuara me Kushtetutën federative. Funkcionet ekzekutive në kuadër të Kosovës i ka kryer Këshilli Ekzekutiv. Ky organ tashmë kryesisht ka më shumë attribute ekzekutive dhe jo siç kishte me zgjidhjet e mëhershme kushtetuese edhe attribute politike edhe pse i mbeten edhe më tutje karakteristika politike, sepse në fund të fundit sistemi politik i Federatës Jugosllave ishte i një demokracie socialiste dhe njëpartiake. Sipas Kushtetutës, Këshilli Ekzekutiv i përgjigjet Kuvendit: për gjendjen në të gjitha

⁷⁰ Më shumë lidhur me organet e administratës shih: Ligji mbi administratën, Gazeta Zyrtare e KSAK-së e Kosovës, nr.40/75.

⁷¹ Neni 223 i Kushtetutës së KSA-së të Kosovës, paragrafi 2.

fushat; për realizimin e politikës dhe për zbatimin e ligjeve e të dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme të kuvendit; për orientimin dhe harmonizimin e punës së organeve krahinore të administratës.⁷² Këshilli Ekzekutiv i propozon kuvendit ligje; propozon buxhetin; nxjerr dekretligje; mbikëqyrë punën e administratës dhe ushtron funksionet që janë karakteristike për çdo njësi federative. Për punën e vet Këshilli Ekzekutiv i përgjigjet Kuvendit qoftë si tërësi, qoftë secilës dhomë të kuvendit.

1.1.6. Autonomiteti në fushën gjyqësore

Në fushën e gjyqësisë, sikurse edhe në republikat e tjera, edhe në Kosovë funksionin e kryen gjykatat e rregullta dhe gjykatat vetëqeverisëse. Në sistemin e Kosovës njiheshin gjykatat e kompetencës së përgjithshme dhe gjykatat ekonomike. Gjykata të rregullta janë: gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut, kurse shkalla e më e lartë i takonte Gjykatës Supreme të Kosovës. Në Kosovë kishim edhe gjykatat ekonomike të qarkut që ishin të vendosura në Prishtinë dhe në Gjakovë. Sa i përket gjykatave vetëqeverisëse në Kosovë u krijuan Gjykatat e Punës së Bashkuar, dhe atë për nëntë komuna me seli në Gjakovë dhe për trembëdhjetë komuna me seli në Prishtinë. Si shkalla më e lartë e gjyqësisë në këtë fushë specifike, ishte Gjykata e Lartë e Punës së Bashkuar, me seli në Prishtinë.

Organe e tjera të jurisprudencës ishin prokuroritë publike, avokati publik dhe avokati shoqëror i vetëqeverisjes.

1.1.7. Autonomiteti në fushën e financave

Të hyrat dhe të dalat vetjake të Kosovës përcaktohen me buxhetin e Kosovës në mënyrë të pavarur. Banka Popullore e Kosovës ishte institucion i sistemit unik monetar, që zbatonte politikën e përbashkët të emisionit, të cilin e përcaktonte Kuvendi i Jugosllavisë.⁷³ Bazuar në faktin se Kosova mbetej sipas të gjitha statistikave rajoni më i pazhvilluar dhe më i varfër i Federatës, një pjesë të financave ajo i siguronte edhe nga një institucion që njihej si Fondi për zhvillimin e viseve jo mjaft të zhvilluara dhe nga ky fond Kosova ka siguruar mjete në periudhën prej vitit 1974 - 1981. Ekzistenca e këtij fondi nga qarqet nacionaliste serbe shumë herë është

⁷² Neni 356 i Kushtetutës së KSA të Kosovës 1974.

⁷³ Neni 260 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

politizuar dhe të dhënat e prezantuara lidhur me shumat e fondeve shumë herë janë fryrë, thënë ndryshe, për qëllime politike janë dhënë të pasakta. Se në ç' masë të dhënat për investime në Kosovë nga Federata dhe nga fondi i përmendur janë të sakta, është çështje e debatueshme dhe është e vështirë për t'u verifikuar nga ky këndvështrim kohor. Sidoqoftë ja se ç' thotë një shënim: “përveç mjeteve të fondit janë siguruar edhe mjete të tjera nga buxheti i Federatës për zhvillim të aktiviteteve shoqërore dhe shërbimeve në republikat jo mjaft të zhvilluara dhe Kosovës. Kështu mjetet nga buxheti i federatës për këto qëllime në periudhën 1966-1984 ka kapur sipas çmimeve të kohës 149,4 miliardë dinarë. Krahas këtyre mjeteve, me rregulla të veçanta në këtë periudhë janë ndarë edhe 13 miliardë dinarë, të destinuar për Malin e Zi dhe për Kosovën”.⁷⁴

1.1.8. Autonomiteti në fushën e marrëdhënieve me botën e jashtme

Edhe në fushën e marrëdhënieve me botën e jashtme, Kosova ishte e barabartë me të gjitha njësitë e tjera federale. Deri me amendamentet kushtetuese, të cilat u ndryshuan nga Kushtetuta e vitit 1963, fusha e marrëdhënieve me jashtë ishte shumë e centralizuar dhe me çështjet e saj merrej kryesisht Federata. Por nga viti 1971, siç u tha, falë amendamenteve kushtetuese kemi inkuadrim të njërive federative në përcaktimin e politikës së jashtme dhe në anën tjetër kemi zbatim të politikës së jashtme edhe nga njësitë federative. Më pas, me Kushtetutën e 1974-ës kemi parimet themelore të RSFJ-së lidhur me politikën e jashtme dhe me pjesëmarrjen e njërive federative në politikën e jashtme. Njësitë federative, janë ato që nëpërmjet organeve dhe formave të caktuara, marrin pjesë aktive në ushtrimin e këtij funksioni. Kështu ato mbajnë përgjegjësi si për përcaktimin, ashtu edhe për realizimin e politikës së jashtme dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare të Jugosllavisë.⁷⁵ Duke u bazuar në kushtetutën e KSA të Kosovës të vitit 1974, Kuvendi i Kosovës shqyrton çështjet nga lëmi i politikës së jashtme dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare, jep pëlqimin për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në rastet e parashikuara me Kushtetutën e RSFJ-së, ratifikon marrëveshjet që Kosova lidh me organet dhe me organizatat e shteteve të huaja dhe me organizata ndërkombëtare.⁷⁶ Kushtetuta federative në këtë kontekst rregullon: “republikat dhe krahinat autonome realizojnë bashkëpunimin me organe dhe organizata të shteteve tjera dhe me organizata ndërkombëtare brenda suazave të politikës së

⁷⁴ Lidhur me këtë shih më shumë në: http://www.znaci.net/00001/120_8.pdf.

⁷⁵ Neni 244 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁷⁶ Neni 301 i Kushtetutës së KSA-së të Kosovës të vitit 1974.

jashtme, të përcaktuar të RSFJ-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.⁷⁷ Fillimisht, për çështje të politikës së jashtme, në vitin 1972 në Kosovë u krijua Sekretariati për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, që funksiononte si shërbim profesional i Këshillit Ekzekutiv Krahinor dhe që më vonë shndërrohet në shërbim profesional të Këshillit Ekzekutiv në të njëjtën kohë edhe të Kuvendit të Kosovës. Më pas nga viti 1978 si Sekretariat, kurse nga viti 1982 si Komitet Krahinor. Në këtë kontekst duhet shtuar se pranë Kuvendit të Kosovës formohet Komisioni për Marrëdhënie me Botën e Jashtme dhe gjithashtu pranë Kryesisë së Kosovës formohet Këshilli për Marrëdhënie me Botën e Jashtme. Zgjidhjet e reja kushtetuese dhe zgjidhjet që i bënë Kushtetuta e re, ofrojnë një larmi organesh, që merren me aktivitete me botën e jashtme, dhe kjo larmi tregon se Kosova merr pjesë aktive në krijimin e politikës së jashtme jugosllave, por shpreh qartazi nevojat e Kosovës si njësi federative, sikundër që vepron në mënyrë të pavarur në suaza të përgjegjësive të veta si njësi federative për nevojat e Kosovës në këtë fushë. Me këto aktivitete është avancuar dhe afirmuar pozita e Kosovës në botën e jashtme dhe është intensifikuar bashkëpunimi, veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës, shkencës, teknologjisë, etj., dhe për një kohë të shkurtër, Kosova ka arritur të vendosë marrëdhënie të drejtpërdrejta ekonomike, kulturore dhe shkencore me organe dhe organizata të më shumë se 80 vendeve të botës. Në anën tjetër, nga Kosova për Federatën Jugosllave kanë shërbyer 6 ambasadorë⁷⁸, në shtete të ndryshme të botës.

Si krahinë e ish-Jugosllavisë, Kosova kishte të drejtë, sikundër edhe kapacitete të duhura, për të ushtruar marrëdhënie ndërkombëtare. Brenda kornizës së ish-Jugosllavisë, Kuvendi federativ përbënte qendrën e formulimit të interesave të përbashkëta në marrëdhëniet me jashtë. Vendimet merreshin përmes harmonizimit të detajuar të politikave ndërmjet “bashkësive shoqëro-politike, gjegjësisht republikave dhe krahinave autonome” (Hasani 1988: 243). Kosova gjithashtu mund të zhvillonte bisedime me subjekte ndërkombëtare.⁷⁹

1.1.9. Autonomiteti në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë

Gjykata Kushtetuese si institucion që do të veprojë vetëm në një instancë, për herë të parë u paraqit në Kosovë në vitin 1969, për t’u fuqizuar me Kushtetutën e vitit 1974. Ky institucion

⁷⁷ Neni 271 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁷⁸ Kurtesh Salju, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.128.

⁷⁹ KIPRED, *Analizë politike, nr.6, Kosova shtet i paprecedencë*, Prishtinë, 2007, fq.14.

është kryesori për t'u marrë me çështjet e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë dhe kundër vendimeve të këtij institucioni nuk ka pasur mjete ankimi, pra vendimi ka qenë përfundimtar. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë nxjerrë sipas shqyrtimit publik, por me Rregullore të Punës Gjykata Kushtetuese mund të nxirrte vendime edhe pa debat publik. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallen në Gazetën Zyrtare të KSA të Kosovës. Kosova përfaqësohej në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë me një gjyqtar⁸⁰, kurse në Gjykatën Federative përfaqësohej sipas parimeve të përcaktuara në organe federative të republikave dhe krahinave.⁸¹

1.1.10. Autonomiteti në fushën e mbrojtjes popullore dhe të sigurimit shtetëror

Funksionet e Kosovës në këtë fushë janë zbatuar sipas zgjidhjeve që ka ofruar Kushtetuta Federative dhe Kushtetuta e Kosovës. Funksionet nga kjo fushë janë ushtruar në mënyrë të barabartë me njësitë e tjera të Federatës. Sipas Kushtetutës së Kosovës përgjegjësitë më të mëdha në fushën e mbrojtjes popullore i kanë Kuvendi i Kosovës dhe pas Kuvendit i ka edhe Kryesia e Kosovës. Kryesia e Kosovës ka qenë përgjegjëse që të udhëheqë së bashku me rezistencën e armatosura në territorin e Kosovës. Më pas me përgjegjësi të kësaj fushe ngarkohet Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës. Ka qenë përgjegjësi e Kryesisë së Kosovës të formojë Këshillin e Mbrojtjes Popullore duke i dhënë kompetenca të caktuara. Në Kosovë gjithashtu ekziston Shtabi i Mbrojtjes Popullore sikundër edhe Shtabi i Kosovës për Mbrojtje Civile. Në fund, në kuadër të kësaj fushe, duhet përmendur se punët e administratës janë kryer nga Sekretariati i Mbrojtjes Popullore. Edhe për sa i përket sigurimit të shtetit, me përjashtim të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutën Federative si kompetenca të saj, përgjegjësitë e tjera janë ushtruar në mënyrë të barabartë me njësitë e tjera federative.

1.1.11. Autonomiteti në fushën jashtëqeveritare⁸²

Në sistemin e RSFJ-së paraqiten edhe disa forma të organizimit të quajtura organe të ndryshme shtetërore - shoqërore, organizata shoqërore -politike dhe organizata shoqërore e

⁸⁰ Neni 381 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁸¹ Neni 370 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁸² Më gjerësisht për autonomitetin/mëvetësinë e Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974 shih : Kurtesh Salju, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.76-157 dhe Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.47-52 dhe Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish -Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.84-89.

shoqata të qytetarëve. Vetë emërtimi i këtyre formave të organizimit tregon karakterin e tyre dhe rolin që kanë mundur të luajnë brenda sistemit jugosllav, që në kontekstin kohor gjithsesi ishte më demokratik dhe që dallonte shumë nga ish -blloku socialist i lindjes. Edhe në këtë fushë, Kosova ka qenë e barabartë në formimin e këtyre mekanizmave, sikurse njësitë e tjera federative.

Karakteristikat e mëvetësisë së Kosovës, të sanksionuara me Kushtetutë dhe të cilat zbatoheshin realisht dhe praktikisht, nuk janë çështje e ndonjë mëshire që ishte bërë në favor të Kosovës, por gjithsesi këto karakteristika ishin pjesë e aspiratave të qytetarëve të Kosovës për të realizuar synimet e veta në Federatën në të cilën kishin hyrë dhe kjo vështirë se mund të kontestohet. Është krejt tjetër fakti se Kosova me (pa) dëshirën e saj ishte gjetur në një formulim kushtetues me të cilin shprehej se ishte edhe pjesë e sistemit kushtetues të RS të Serbisë. Është gjithashtu krejt tjetër, se shtetësia e Kosovës dhe aspiratat e saj janë kundërshtuar vazhdimisht nga RS e Serbisë, për çka do të flasim në vijim.

1.2. Ndryshimet në jetën administrative – juridike të Kosovës në periudhën 1974 – 1981

Nuk ka dyshim se pozita juridike e Kosovës, sikundër edhe vetë jeta e qytetarëve të saj, ndryshoi dukshëm dhe për të mirë, pas aprovimit të Kushtetutës së vitit 1974. Siç mund të konkludohet nga pjesa e parë e këtij kreu,

Kosova i merr tiparet e një subjekti juridiko - shtetëror krejtësisht të ngjashme dhe të barabarta me ato që kishin njësitë e tjera që emërtoheshin republika federative.⁸³

Por kjo barazi, në të vërtetë ishte vendosur tërësisht në themel të dobët, e të paqëndrueshëm. Kjo sepse, pos të tjerash,

pozita kushtetuese-juridike e Kosovës shprehte jo vetëm një paradoks formal juridik, por edhe një paradoks politik kushtetues të një njësie federale me Kushtetutë të vetën dhe që ishte në kuadër të një njësie tjetër federale.⁸⁴

⁸³ Shih nenin 2 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁸⁴ Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish-Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.93.

Në anën tjetër, kjo barazi dhe ky status i Kosovës brenda Federatës ishin kundërshtuar qysh nga inicimi i procesit nga forcat unitariste, etatiste, centraliste dhe nacionaliste serbe, të cilat për një moment të caktuar ishin larguar nga pozitat e vendimmarrjes dhe është çështje, që besoj se kërkon kohë që të mund të eksplorohet, lidhur me atë pse Lidhja Komuniste e Serbisë i pranoi ndryshimet kushtetuese. I deshën ata ndryshimet në favor të pozitës së Kosovës dhe të shqiptarëve? I pranuan për shkak të klimës së krijuar në Jugosllavi? I pranuan vetëm përkohësisht deri në ndryshim të klimës në favor të tyre?

Ndaj secilës pyetje janë dhënë përgjigje, por është e besueshme se mund të nxirren ende më shumë përgjigje, në varësi të hulumtimeve që mund të thellohen, sidomos duke nxjerrë dokumente nga arkivat serbe. Sidoqoftë, forcat etatiste, centraliste dhe nacionaliste serbe u mënjanuan dhe/apo mbetën jashtë strukturave dhe vazhduan punën e tyre nga pozitat jashtë sistemit apo jashtë strukturave partiake, duke u vendosur në klube shkrimtarësh apo në Akademinë e Arteve dhe të Shkencave Serbe. Por një pjesë e tyre nuk u larguan fare prej aty, por qëndruan dhe u përmbajtën në heshtje dhe u fshehën deri në momentin kur do ta vlerësonin situatën për të dalë sërish publikisht. Aktiviteti i tyre do të vazhdojë, siç do ta shohim në pjesën vijuese, dhe nuk ka të bëjë vetëm me Kosovën dhe me raportet shqiptaro - serbe. Ka të bëjë me rikonfigurimin e kufijve dhe ngritjen e çështjes së kufijve mes njësive federative, që serbët pretendonin t'i konsideronin administrative. Sidomos të kufijve kroatë dhe boshnjak, ndërkohë që Maqedonia dhe maqedonasit konsideroheshin të ishin serbë. Por të shohim sesi ndërtohej jeta në Kosovë me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 1974 në kontekst të raporteve Serbi – Kosovë – Federatë dhe ku ishte baza juridike që krijonte paqartësi raportesh.⁸⁵

Me Kushtetutën e nxjerrë Kosovës i ndryshohet emërtimi që kishte me kushtetutat e kaluara. Nga Krahina Socialiste Autonome e Kosovës dhe Metohisë, Kosova tash merr emrin e vet të vërtetë: Kosovë/Kosova.

Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë e përbëjnë

Republika Socialiste e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika Socialiste e Maqedonisë, Republika Socialiste e Sllovenisë, Republika Socialist e Kroacisë,

⁸⁵ Më gjerësisht për raportet në Federatë shih pjesën e tretë të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974, neni 244.

*Republika Socialiste e Malit të Zi, Republika Socialiste e Serbisë dhe Krahinat Autonome të Kosovës dhe të Vojvodinës që janë në përbërje të Serbisë.*⁸⁶

Formulimi i përbërësve të Federatës me Kushtetutën federative është i qartë dhe sipas këtij formulimi Federata ka tetë njësi përbërëse - konstitutive, çka do të thotë se Kosova në këtë aspekt është e barabartë me të gjitha njësitë e tjera federative. Më tutje,

*Krahina Socialiste Autonome është bashkësi autonome vetëqeverisëse shoqërore – politike, e themeluar në pushtetin e klasës punëtore dhe të njerëzve punonjës, ku punëtorët dhe qytetarët, kombet dhe kombësitë i realizojnë të drejtat e tyre sovraane, e kur kjo është në interes të njerëzve punonjës dhe qytetarëve, të kombeve dhe të kombësive të republikës si tërësi edhe me Kushtetutën e Republikës.*⁸⁷

Ky lloj formulimi i përbërësve të Federatës, sa i përket Kosovës del si rezultat i një kompromisi të arritur në mes të forcave politike në Jugosllavi, të cilat Kosovën esencialisht e bëjnë republikë në aspekt të përmbajtjes. Disa nga karakteristikat e qenësisë së Kosovës si republikë janë dhënë më sipër. Në anën tjetër, serbët dhe Serbia në raportet kur po nxirrej Kushtetuta nuk do të pranonin formulimin me emërtim republikë për Kosovën. Këtu të gjitha këto raporte në kuptim të ripërcaktimit të pozitive kushtetuese të njësisve federative nuk po bëheshin sipas kërkesave reale që i kishin banorët e këtyre njësisve federative. Kurse vetë krijesa e quajtur Jugosllavi kishte shumë veçanti që mund të ishin bazë e shkatërrimit të saj në çdo kohë. Sidomos nga shkaqet e kompozicionit shumë etnik të saj, pabarazisë nacionale, zhvillimit asimetrik të ekonomisë dhe të nivelit të zhvilluar të demokracisë. Kushtetuta e vitit 1974 përpos të tjerave paraqet një pengesë për ambiciet serbe. Ndonëse ambiciet serbe për të dominuar Jugosllavinë dhe për ta parë këtë si një “Serbi të zgjeruar” ishin goditur paksa me sistemin kushtetues të 74-ës, periudha e pas Titos krijoi ca shanse restauruese. Neointegrimi hegjemonist duhej të ishte esenca e këtij procesi, kurse pozita kontradiktore dhe e papërcaktuar qartë e kombësive dhe e krahinave autonome do të ishte pikënisja e tij. Këtu ishte, sipas profesor Aganit,

⁸⁶ Neni 2 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁸⁷ Neni 4 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

*”burimi dhe shkakut i vërtetë i krizës që fillon me Kosovën që në vitin 1981”.*⁸⁸

Në të gjithë botën e civilizuar, thotë Branko Horvat,

*disponimi, të kuptuarit dhe dëshirat e popullatës përcaktohen sipas tri mënyrave: shqyrtimit dhe diskutimit politik, raportimit të gazetarëve dhe me hulumtim të opinionit publik. Ndërkaq këtu kemi të bëjmë me fraza stereotipe, kurse shqyrtimet dhe kundërshtimet zhvillohen prapa dyerve të mbyllura.*⁸⁹

I gjithë debati për ndryshimet politike dhe kushtetuese vërehet të ketë qenë siç u tha, në mes dhe brenda oligarkive politike komuniste të republikave dhe krahinave të Jugosllavisë. Nuk është e njohur të jenë zhvilluar diskutime publike gjithëpërfshirëse; nuk është e njohur të jenë bërë ndonjëherë hulumtime të opinionit për të vepruar në bazë të gjetjeve; oligarkitë komuniste nuk ishin përfaqësues të vërtetë të qytetarëve; ndryshimet më shumë inicionin nga lart dhe gjithë kjo është e natyrshme kur flasim për një sistem komunist, pavarësisht se ky sistem dallonte shumë krahasuar me sistemin komunist të lindjes apo me Bllokun e BRSS-së.⁹⁰

Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 është rezultat i shumë dridhjeve politike dhe lëvizjeve që ndodhën në Jugosllavi: rënies së Rankoviçit, demonstratave të studentëve, demonstratave në Kosovë, të Pranverës Kroate, etj. Pas këtyre ngjarjeve duket se forcohet rryma liberale brenda Partisë Komuniste të Jugosllavisë, që konsiderohet se i printe Eduard Kardel⁹¹, rrymë kjo që deklarohej për forcim të vetëqeverisjes, forcim të tregut dhe për zvogëlim të rolit të

⁸⁸ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Vepra 3, Dukagjini, Pejë, 2002, cituar nga Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish -Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë 2013, fq.94.

⁸⁹ Branko Horvat, *Kosovsko Pitanje*, Drugo dopunjeno izdanje, Globus, Zagreb, 1989, fq.138.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Eduard Kardeli është një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Titos dhe një ndër figurat kryesore politike dhe shtetërore të vendimmarrjes në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1979, kur ka vdekur. Në mbledhjen e Dytë të KAÇKJ-së, të mbajtur në Jajce ku është zgjedhur anëtar i Kryesisë dhe po ashtu është zgjedhur edhe nënkryetar i Komitetit Nacional për çlirimin e Jugosllavisë. Pas luftës ka kryer funksione të shumta shtetërore në Federatën Jugosllave përfshirë edhe funksionin e nënkryetarit të qeverisë si dhe ministrin e jashtëm jugosllav. Mbahet mend edhe si ideator dhe zhvillues i ideve të vetëqeverisjes socialiste të modelit jugosllav dhe për sistemin e delegimit që ishte aplikuar në Federatën Jugosllave. Ka qenë profesor i rregullt në Fakultetin Ekonomik të Lubjanës dhe ka shkruar e publikuar mjaft punime. Është konsideruar si njeriu numër dy në federatë dhe është konsideruar si trashëgimtar i Titos. Kardel megjithatë ka qenë përkrahës i mbetjes së krahinave brenda Serbisë dhe në kohën e ndryshimeve kushtetuese Tito ka marrë rolin e një lloj arbitri dhe janë nxjerrë formulimet, siç janë përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974.

shtetit qendror dhe për federalizim të mëtejshëm të shtetit. Ideatori dhe kreatori i Kushtetutës ishte Eduard Kardeli, i cili që nga viti 1970 ka udhëhequr Komisionin e të gjitha Dhomave të Kuvendit Federativ për çështje kushtetuese. Komisioni i tij ka punuar amendamentet e viti 1971 dhe më pastaj ka përgatitur edhe Kushtetutën e vitit 1974. Komisioni ka punuar, dhe siç u tha, gjeti një kompromis në formulime duke mos e lënë Kosovën të emërtohet si republikë dhe duke e lënë një lloj lidhëseje formalo- juridike që e linte Kosovën pjesë edhe të sistemit kushtetues të Serbisë. Kjo lidhëse do të jetë burim i përhershëm i paqartësive dhe problemeve, të cilat do të shkaktojnë pasoja të tmerrshme. Mbetet ende për t'u sqaruar nëse në kohën e formulimit të tillë ishte menduar për pasojat apo nëse kjo ishte lënë edhe me ndonjë prapavijë që do të shërbejë si pretekst për veprime të tjera kushtetuese e jokushtetuese, paqësore apo të dhunshme, etj. E përmenda këtë edhe pse mund të gjasojë me ndonjë teori konspiracioni, por ngjarjet që u zhvilluan fare pak vite më vonë, sikurse mund të vërtetojnë tezat se Kosova ka mundur të emërtohej republikë në atë kohë edhe për nga emri, pasi ajo me të hyrë në fuqi Kushtetuta e RSFJ-së, në fakt ishte e barabartë me republikat e tjera⁹², në përmbajtje dhe në ushtrim të përgjegjësive dhe të funksioneve në Federatë. Një qasje më e lirë në arkivat serbe dhe ish-jugosllave (që tash janë krejtësisht apo kryesisht në Serbi) mundet që së paku të sqarojë më shumë këtë tezë, nëse jo edhe ta vërtetojë krejtësisht. Sidoqoftë, të shohim se ku ishin burimet e paqartësive, lidhur me përgjegjësitë për të tërë territorin e republikës – për marrëdhëniet që i rregullon republika në mënyrë unike, në bazë të nenit 300 të Kushtetutës së RS të Serbisë.

Është e qartë dhe duhet përsëritur shkurtimisht se me zgjidhjet e reja kushtetuese republikat dhe krahinat barazohen dhe gëzojnë një pavarësi të madhe në sferën politike, ekonomike, kulturore, arsimore, shëndetësore, politike, sociale dhe kështu me radhë. Por megjithatë mbeten paqartësi edhe kushtetuese juridike, por edhe politike, së paku në çështje emërtimesh, të cilat shkaktojnë pasoja pak vite më vonë. Dhe dallimet politike nga kushtetuese e juridike nuk është se mund të ndahen lehtë në një sistem politik njëpartiak - komunist, ku partia vendos për gjithçka. Kështu, Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste të Kosovës dhe Konferenca Akcionale e Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Kosovës bëhen të barabarta, por nuk

⁹² Shih nenin 2 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974. Ky nen përshkruan përbërësit e Federatës, kurse neni 4 bën përshkrimin e krahinave si: Krahina Socialiste Autonome është bashkësi shoqëro- politike demokratike e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe njerëzve punues, ku njerëzit punues dhe qytetarët, kombet dhe kombësitë i realizojnë të drejtat e tyre sovraane dhe kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve dhe të qytetarëve, kombeve dhe kombësive të republikës si tërësi, atëherë edhe me Kushtetutën e Republikës së Serbisë.

emërtohen sikurse ato të republikave që njihen si Komitete Qendrore të PKJ-së. Këto organizata politike në të njëjtën kohë përfaqësohen në mënyrë të barabartë në nivelin federativ të organizimit partiak, por edhe më tutje kanë përfaqësues të tyre në nivelin republikan. Kosova dhe Vojvodina kanë pasur nga 15 anëtarë në KQ të LK të Serbisë, që do të thotë 30 anëtarë nga 120 anëtarë që kishte Komiteti Qendror.⁹³ Më tutje, në Kosovë krijohen organe ekzekutive, ligjvënëse dhe gjyqësore me çka praktikisht gjithçka barazohet me republikat, por edhe më tutje përfaqësuesit e Kosovës do të jenë të pranishëm në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor të Serbisë. Në të njëjtën kohë Kosova i ka përfaqësuesit e vet në të gjitha institucionet federative, deri edhe në Kryesinë e Jugosllavisë ku të gjitha krahinat dhe republikat kishin nga një anëtar.⁹⁴

Caktimi i interesave të përbashkëta, që duheshin rregulluar me Kushtetutën e Serbisë për të tërë territorin, megjithatë kufizoheshin me Kushtetutën federative. Bazuar në këtë hartuesit e Kushtetutës së RS të Serbisë kanë provuar të shënojnë një elasticitet në kuptim të përcaktimit të funksioneve unike të republikës, elasticitet që shërben si burim i paqartësive dhe i konflikteve të vazhdueshme deri në tendencat për eliminimin e tërësishëm të Kosovës nga sistemi, që ka rezultuar më pastaj edhe me shkatërrim të tërësishëm të Federatës Jugosllave, për çka do të flitet në kërret në vijim.

Disa sqarime dhe një interpretim i dispozitave kushtetuese për çështje të përbashkëta të republikës⁹⁵ që do të rregullohen me ligjin republikan i shërbejnë më shumë analizës. Në këtë kontekst, në vijim do të përzgjedhim disa nga çështjet që i ka shpjeguar njohësi dhe bashkëkohësi i hartimeve kushtetuese, Kurtesh Saliu, në punimin e tij⁹⁶: Organizimi dhe puna e organeve republikane; regjistrat e zgjedhjeve; ndryshimi i kufijve të Republikës; vula e republikës; flamuri i republikës; amnistia dhe falja për veprat penale të caktuara me ligjin republikan; festat shtetërore; dekoratat republikane; shpërblimet dhe mirënjohjet republikane; shtetësia; mbrojtja e kushtetutshmërisë; zgjidhja e konflikteve në mes ligjit republikan dhe atij krahinor; marrëdhëniet me botën e jashtme që i përkasin kompetencave unike; bazat e regjimit unik të pronës shoqërore; bazat e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike; bazat e bashkimit të qytetarëve dhe të tubimeve të qytetarëve; pozita e bashkësive fetare; huatë publike; shërbimi i

⁹³ Ekrem Avdiç&Azem, Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë-luftë antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.292.

⁹⁴ Shih nenin 321 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1974.

⁹⁵ Neni 300 i Kushtetutës së RS të Serbisë i përcakton çështjet që me ligjin republikan do të rregullohen në të tërë territorin.

⁹⁶ Kurtesh Saliu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 95-96.

sigurimit në interes për të tërë republikën; prodhimi dhe qarkullimi i armëve; përmbajtja e letërnjoftimit; institutet e përgjegjësishë për deliktet ekonomike; për kundërvajtjet; parimet themelore për organizimin e mbrojtjes popullore, bazat unike të planeve për mbrojtje popullore; parimet për marrëdhëniet reciproke lidhur me udhëheqjen e mbrojtjes civile dhe për udhëheqjen e mbrojtjes territoriale dhe të mbrojtjes civile; bazat e regjimit të ujërave me interes për tërë republikën dhe ndotjen e ujërave; mbrojtja nga ndotja e ajrit; mbledhja e të dhënave statistikore dhe përpunimi i tyre; financimi i detyrave dhe i punëve të cilat kryhen për të tërë territorin e republikës. Një listë kaq e gjatë e çështjeve, që duket se i janë lënë republikës, për t'i zgjidhur me ligj republikan, në shikim të parë duket se ka ngushtuar përgjithësisht kompetencat e Kosovës, por këtu nuk duhen bërë analiza, por dhe nuk duhen interpretuar jashtë kontekstit të përgjithshëm kushtetues- juridik ku përfshihet Kushtetuta e RSFJ-së dhe Kushtetuta e Kosovës. Kjo ngase, në radhë të parë shumica e këtyre çështjeve zgjidhen në mënyrë të pavarur me Kushtetutën e Kosovës dhe disa me Kushtetutën e Jugosllavisë dhe vetëm disa nga çështjet e përmendura zgjidhen me ligjin republikan. Këtu qëndron specifika e formulimit kundërthënës dhe vënies së Kosovës në një dualizëm pozitash:

si pjesë e barabartë e Federatës dhe në një mënyrë edhe pjesë e sistemit kushtetues të Serbisë.

E Serbisë, edhe me zgjidhjet e Kushtetutës së vitit 1974 shihet qartë se i janë bërë lëshime. Ajo refuzon avancimin e pozitës kushtetuese të Kosovës, e këtë Gazmend Zajmi e shihnte te

“qëndrimi posesiv i Serbisë ndaj Kosovës”,

që siç pohonte me të drejtë,

“gjithherë ishte një posesivitet i padrejtë dhe pa bazë reale etnike serbe”.⁹⁷

⁹⁷ Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish-Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.95.

Më lartë janë dhënë disa sqarime për formulimet juridiko- kushtetuese, por besoj, ende disa gjëra kërkojnë hulumtime shtesë. Dhe kur jemi këtu, është e paqartë se me zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974 a kemi të bëjmë me një zgjidhje kalimtare, që do të pasonte edhe me barazimin formal të krahinës me republikat apo me një zgjidhje kompromisi që mëtonte disi të kënaqte interesat serbe. Mbetet ende për t'u sqaruar nëpërmjet punimeve të tjera. Neni 300 i Kushtetutës së RS të Serbisë, në vetvete përmban terma abstraktë, të cilët edhe në rrethana normale kërkojnë zbërthim e jo më pastaj në raportet çfarë ish në mes të Kosovës dhe të Serbisë. Për shembull, këtu përdoren termat : parimet, parimet bazë, bazat e regjimit, bazat unike, etj., por gjatë zbatimit të mëtejme dhe gjatë zbërthimit të këtyre parimeve me teknikën juridike legislative vështirësitë janë më të mëdha, sepse siç është vënë re më lart pothuaj të gjitha fushat zgjidheshin edhe me Kushtetutën federative edhe me Kushtetutën e Kosovës. Ishte pastaj çështje më shumë politike dhe e raportit të forcave, që çështjet të vështirësoheshin dhe të prodhonin probleme, konflikte dhe pasoja, të cilat do t'i shohim më vonë. Kjo pozitë juridike, ky dualizëm kompetencash ka prodhuar vështirësi edhe në nxjerrjen e ligjeve për shkak të tendencës serbe për të dominuar dhe imponuar zgjidhjen duke kërkuar të drejtat sipas nenit 300 dhe për shkak të barazisë që kishte Kosova formalisht në këto fusha dhe natyrshëm ajo kërkonte që këto çështje, t'i zgjidhte me ligjet e veta. Në anën tjetër, neni 301 i Kushtetutës së RS të Serbisë sikundër edhe neni 285 i Kushtetutës së KSA të Kosovës janë bazë për shtimin e paqartësive dhe për paraqitjen e problemeve të reja në raportet në mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas këtyre dispozitave dhe në bazë të marrëveshjes, me ligj republikan mund të rregullohen çështje që pavarësisht janë të rregulluara nga krahina apo republika.⁹⁸ Kjo sipas hartuesve duhej t'i shërbente ekonomizimit dhe racionalizimit, sepse sipas qëllimit të proklamuar në vend të tri ligjeve, çështjet do të rregulloheshin me një ligj unik për të tria entitetet: për Serbinë, për Kosovën dhe për Vojvodinën. Kjo çështje megjithatë në një kuptim tjetër dallon nga neni 300 sepse këtu kemi të bëjmë siç është proklamuar, me çështjet e bashkëpunimit dhe jo me faktin e të qenurit të krahinave, pjesë edhe e sistemit kushtetues të Serbisë, krahas të qenurit të barabartë me të në Federatë si njësi konstituive e asaj Federate.

⁹⁸ Më gjerësisht lidhur me nenin 300 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, si dhe për natyrën dhe praktikën e ligjeve republikane në bazë të marrëveshjes shih Kurtesh Saliu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e Autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1984, fq.95-103.

1.3. Domosdoshmëria e avancimit të pozitës juridiko-kushtetuese të popullit të Kosovës

Që nga marrja e Kosovës nga Mbretëria Jugosllave dhe pastaj edhe nga aneksimi i bërë pas Luftës së Dytë Botërore tashmë nga Jugosllavia, nuk ka kaluar periudhë më të mirë sesa periudhën e viteve 1974 – 1981. Kjo periudhë fillon simbolikisht në vitin 1974 me aprovimin e Kushtetutës, tashmë të shtjelluar në fillim të kreut, dhe që realisht përfundon në vitin 1981. Jo rrallë është thënë se Tito i dha Kosovës autonominë në vitin 1974. Kështu deklaroi edhe Bill Clinton duke shtuar se kjo mundësonte vetëqeverisje dhe kontroll ndaj shkollave.⁹⁹ Dhe e dhëna edhe mund të merret lehtë. E për të marrë atë që “i është dhënë Kosovës” nismat kanë qenë menjëherë pasi “kjo i është dhënë Kosovës”. Kështu, formalo -juridikisht Kushtetuta mbetet në fuqi deri në vitin 1989, por zbatimi i saj nuk shkon në favor të Kosovës dhe të shqiptarëve pas vitit 1981. Është thënë edhe më herët se ndryshimet e statusit të Kosovës nuk ishin pranuar me zemërgjerësi në Serbi. Jo aq shumë në qarqet hegjemoniste, nacionaliste, unitariste, por te qarqet nacionaliste intelektuale serbe. Këto qarqe patën kundërshtuar largimin e Rankoviçit nga pushteti, gjithashtu. Më i zëshmi kundër ndryshimeve kushtetuese dhe kundër avancimit të pozitës së popullit shqiptar në Jugosllavi ishte shkrimtari, komunisti dhe nacionalisti serb Dobrica Qosiq. Ai në rrethanat e krijuara pas Plenumit të Brionëve u përjashtua nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Serbisë, por kjo nuk e bëri atë që të heshtë. Pas mbledhjes së Kryesisë së Komitetit Qendror të LKS-së, ku ishte vendosur që “Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë duhet të bëhet më shumë kategori kushtetuese dhe të shprehet në mënyrë të qartë si pjesë përbërëse e federalizmit”¹⁰⁰. Ai mbajti diskutimin e tij të famshëm, për çka përjashtohet nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Serbisë. Idetë e tij nacionaliste, dhe jo vetëm kundër shqiptarëve, por edhe kroatëve, boshnjakëve dhe hungarezëve do të marrin hov edhe më shumë, ndërkohë që fjalimi i tij në mbledhjen e Komitetit Qendror të Serbisë, tregon qartë kahjet dhe objektivat e unitaristëve dhe të nacionalistëve serbë siç ishte Dobrica Qosiq. Në mbledhjen e Komitetit Qendror të Serbisë, të mbajtur më 28 - 29.05.1968, ai ishte shprehur:

“është shqetësues disponimi antiserb që po paraqitet në format më të ndryshme në mjedise të caktuara, veçanërisht në Kroaci dhe në Slloveni (...) Nuk po shihet

⁹⁹ Bill Clinton, *My life*, Alfred A.Knopf Borzoi Book, New York, 2004, fq.849.

¹⁰⁰ Sonja Biserko, *Kovanje antijugoslovenske zavere*, knjiga 1, Zagorac, Beograd, 2006, fq.88.

*në përmasa të përgjegjshme disponimi shovinist dhe psikoza nacionaliste e kombësisë shqiptare (siptarske) (...) krejtësisht po hesht ekzistimi dhe funksionimi i autonomizmit burokratik të Vojvodinës, në të vërtetë i një partikularizmi retrogard (...) barazia e shqiptarëve e kuptuar në mënyrë etatiste dhe burokratike në Serbi dhe në Jugosllavi dhe zhvillimi i sovranitetit të tyre nuk mund të mos përfundojë me irredentizëm, në thellim të ndasive politike, mes popujve të Kosovës dhe të Metohisë kah një konflikt permanent (...) Nëse në Jugosllavi qëndrojnë dhe fitojnë orientimet tradicionale, gjegjësisht orientimet nacionaliste etatiste, nëse forcat demokratike socialiste nuk sjellin fitoren përfundimtare kundër forcave dhe stihive mikroborgjeze, mund që edhe te populli serb të ndizet qëllimi i vjetër historik dhe ideali nacional – bashkimi i popullit serb në një shtet të vetëm (...) Vetëm nën kushtet e internacionalizmit të përkushtuar në bashkësinë jugosllave, vetëm në kushte të vetadministrimit socialist dhe të demokracisë së plotë, çështja e integritetit nacional serb mund të vazhdojë në frymën e orientimeve të nisura me kryengritjen e vitit 1941”.*¹⁰¹

Diskutimi i Qosiqit, kur të analizohet në tërësinë e tij, por edhe sipas fjalorit të përdorur tregon qartë se idetë për krijimin e shtetit unitar serb apo thënë ndryshe për krijimin e Serbisë së Madhe nuk ishin shuar as përpara dhe as në fazat që do të vijnë. Ai jo vetëm që i shpalos këto tendenca në këtë mbledhje dhe në organizimet e vazhdueshme, por vazhdon të përdorë edhe një fjalor me të cilin nënçmon të tjerët. Qosiq dëshiron që të bëhet ajo që projektohet për serbët. Mjetet për të arritur këtë nuk janë të rëndësishme. Rren¹⁰² por edhe ofendon. Fjala “siptari” në fjalorin nacionalist serb kishte kuptim ofendues dhe nënçmues. Dhe pikërisht akademiku dhe intelektual i përdor këtë term, madje edhe në forume të larta politike, akademike, etj. Pas përjashtimit, vazhdon me aktivitetet e tij politike, por në forma tjera. Në vitin 1969 bëhet Kryetar i Kooperativës Letrare Serbe (Srpska Knjizevna Zadruga) me qëllim për ta shndërruar këtë mekanizëm si një lloj blloku opozitar në Serbi, i cili në fakt bëhet një sistem paralel pushteti, ku

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² “Rrena është interes shtetëror serb”. Dhe, jo vetëm kjo: “Ne rrejmë për ta mashtruar veten, për ta ngushëlluar tjetrin; rrejmë nga mëshira, rrejmë nga turpi, të trimërojmë, të fshehim mjerimin tonë, rrejmë për shkak të nderit, rrejmë për shkak të lirisë tonë. Rrena është formë e patriotizmit serb dhe dëshmi e inteligjencës sonë të lindur. Rrejmë në mënyrë krijuese, fantazuese, shpikëse”. Dobrica Qosic, “Ndarjet” (Deobe), Beograd, 1961, Cituar nga: Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë, Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.206.

gjejnë vend edhe disa nacionalistë të njohur serb si: Luba Tadiq, Mica Popoviç, Branislav Mihajloviç-Mihiz, Mihajlo Markoviç, etj. Për të kuptuar më lehtë rrethanat në Jugosllavi dhe shkaqet e rrënimit të Federatës, që mbijetoi disa dekada, duhet gjithsesi të kemi qasje në orientimet politike të këtyre forcave që nuk kanë filluar me Qosiqin. Qosiqi vetëm ka vazhduar me idetë e vjetra të Andriqit, Cvijiqit, Çubrilloviçit, etj., në rrethana të tjera dhe në kohë më moderne. Ky klub shkrimtarësh, intelektualë nacionalistë do vazhdojë me aktivitete jo vetëm kundër shqiptarëve dhe kundër statusit kushtetues të Kosovës, por edhe me, siç u potencia, krijimin e Serbisë së Madhe. Duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë ekonomike, pa perspektivën dhe stagnimin në zhvillim të Kosovës, që vazhdonte të mbetej rajoni më i pazhvilluar ekonomikisht, ka filluar një propagandë kundërshqiptare duke mos zgjedhur aspak mjetet. Dhe në këtë propagandë antishqiptare pos të tjerash do të orkestrohen dhe keqpërdoren në masë të madhe serbët dhe malazezët e Kosovës. Tentohet që, siç do ta shohim në gjithë lëvizjet në vazhdim, të sensibilizohet opinioni në Serbi dhe jo vetëm aty, për ndërhyrje dhe ndryshim të gjendjes së krijuar në Kosovë me pretekst se aty tash pakica serbe i është nënshtruar presionit për shpërngulje nga Kosova dhe se kjo pakicë është vënë në pozitë diskriminuese. Kjo në asnjë mënyrë nuk mund të argumentohet, natyrisht sepse faktet tregojnë krejtësisht të kundërtën. Ata që kishin pësuar dhe që ishin nën presion të vazhdueshëm, ishin pikërisht shqiptarët.

Branko Horvat, në vitin 1988, vlerëson se

etnifikimi i sistemit politik jugosllav në vitet shtatëdhjetë në të gjitha pjesët e Jugosllavisë ka forcuar proceset e migracionit të disa popujve drejt republikave amë, ndërsa shpërngulja e serbëve dhe e malazezëve nga Kosova në Serbi dhe në Mal të Zi, u përforcua më tej nga kushtet e vështira ekonomike dhe sociale në Kosovë.¹⁰³

Ndërkaq të diskriminuar mbeteshin shqiptarët. Pra, krejt e kundërta e asaj që nisi të propagandohej nga qarqet nacionaliste serbe. Në vitin 1971, ndërsa serbët dhe malazezët përbënin 21% të popullatës, ata përbënin 52% të të punësuarve në postet menaxheriale. Në fakt, pabarazia e përgjithshme në punësimin publik, asnjëherë nuk u përmirësua: më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptar merrte rrogë shtetërore.

¹⁰³ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq. 69.

Aty ku shqiptarët bënë përparimin më të madh ishte hyrja e tyre në radhët e partisë dhe të administratës lokale. Nga fundi i viteve 1970-të, përpjesëtimi i shqiptarëve në Lidhjen e Komunistëve të Kosovës u shtua deri në dy të tretat, kurse aty kah viti 1981, në polici dhe organet e tjera të sigurimit shqiptarët përbënë tri të katërtat.¹⁰⁴ Për më tepër duhet shtuar se shkalla më e lartë e papunësisë ishte në mënyrë të vazhdueshme në Kosovë, krahasuar me viset e tjera të Jugosllavisë. Shkalla e punësimit në përgjithësi, sipas përkatësisë etnike në Kosovë, tregon gjithashtu pozitën e pabarabartë për shqiptarët. Në një mijë banorë në Kosovë, të punësuar janë: 109 shqiptarë, 228 serbë dhe 258 malazezë.¹⁰⁵

Kundërshtimet e qarqeve të përmendura serbe ndaj avancimit të pozitës së Kosovës dhe të shqiptarëve në Federatë dhe aspiratat e shqiptarëve për të avancuar pozitën e tyre edhe më tutje vazhdojnë edhe në kontekst të vështirësive të mëdha ekonomike, me të cilat po ballafaqohej Jugosllavia. Nga fillimi i viteve 1980-të, mbi ekonominë jugosllave kishte filluar të lëshonte hije politika e marrjes hua pa kriter si rezultat i kredive të lira të perëndimit. Investimet e gabuara në industrinë e rëndë, ishin kthyer në barrë të dhimbshme, ndërsa borxhi i jashtëm, në vitin 1980, u rrit në 400%; nga 6 miliardë dollarë në vitin 1975, ai kërceu në 17 miliardë dollarë në vitin 1979 dhe në 23 miliardë në vitin 1980. Vetëm interesat e borxhit të jashtëm sillnin një inflacion me tri shifra. Çmimet e energjisë, ushqimit, veshjeve dhe artikujve të tjerë të domosdoshëm rriteshin çdo gjashtë muaj nga 60%. Nisi të shtohet me ritme të shpejta pakënaqësia për trashëgiminë politike dhe ekonomike të Titos.¹⁰⁶ Në këto rrethana të mospajtimeve të thella në mes të Serbisë dhe të Kosovës, u gjet një kompromis, sipas të cilit Kosova fiton status të barabartë në Federatë, por që për hir të Serbisë emri nuk i vihet republikë. Dhe siç ka ndodhur shpesh, në politikë kompromiset nuk kanë çuar kah zgjidhjet e qëndrueshme dhe, edhe me këtë rast, kompromisi i arritur nuk ka siguruar baza të qëndrueshme dhe afatgjate. Në anën tjetër në raportet ndërkombëtare Jugosllavia ka gëzuar reputacion pavarësisht vështirësive të brendshme dhe është vështirë të besohet nëse Kosova në atë kohë mund të kishte gëzuar ndonjë mbështetje ndërkombëtare për diçka më shumë se ç'ishte arritur me Kushtetutën e vitit 1974.

Disa nga kërkesat e shqiptarëve, që ishin shprehur gjatë demonstratave të vitit 1968, apo edhe të shprehura nga përfaqësues partiakë dhe shtetërorë të Kosovës, filluan të jetësohen. Hapet universiteti, lejohet përdorimi i flamurit kombëtar, në organe komunale të administratës rritet

¹⁰⁴ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë & shtëpia e librit Tiranë, 2001, fq.340.

¹⁰⁵ Branko Horvat, *Kosovsko Pitanje*, Drugo dopunjeno izdanje, Globus, Zagreb, 1989, fq.137.

¹⁰⁶ Jasminka Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, Albin, Tiranë, 1998, fq.73-74.

numri i shqiptarëve, rriten tendencat e një zhvillimi ekonomik dhe të një ndihme për Kosovën, por pavarësisht kësaj, Kosova vazhdon të jetë rajoni më i pazhvilluar në Jugosllavi. Kurse te një pjesë e madhe e popullatës mbretëron mendimi se Kosova dhe pasuritë e saj nëntokësore po eksplororeshin në favor të Beogradit. Së këndejmi, gjatë demonstratave të vitit 1968, ishin shprehur edhe kërkesa ekonomike.¹⁰⁷ Në Kosovë në vitin 1970 filloi punën universiteti në gjuhën shqipe. Në vitin 1981 universiteti kishte 26.000 studentë të rregullt, kurse gjatë vitit shkollor 1981-1982 në 1000 banorë në Kosovë kishim 26 studentë kundruall 14 sa kishte në Slloveni apo në Kroaci.¹⁰⁸ Personeli arsimor përbëhej prej 540 shqiptarëve dhe 330 serbëve. Ligjëratat mbaheshin në të dyja gjuhët. Zgjerimi i sistemit shkencor arriti kulmin me themelimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve në Prishtinë në vitin 1975.¹⁰⁹

Ky numër kaq i madh i studentëve është një potencial që do mbetet i shfrytëzuar në masë shumë të vogël, sepse mundësitë e punësimit janë shumë të vogla. Në anën tjetër, ky potencial do vazhdojë të rritet bazuar pos të tjerave edhe për faktin se Kosova kishte shkallën më të lartë të lindjeve. Dhe, duket se fare pak ishte menduar për nevojat e shfrytëzimit të këtij potenciali, i cili në një rajon ku edhe ashtu ka pakënaqësi politike, ekonomike, sociale, etj., mund të çojë te shprehja e pakënaqësisë në forma të ndryshme. Kosova nuk kishte potencial që të punësonte këta studentë kur të diplomoheshin, aq më tepër kur numri më i madh i tyre ishin caktuar që të studionin shkenca shoqërore, që nënkuptonte edhe punësim në zyrë. Ajo që mendoj se duhet nënvizuar në kontekst të këtij punimi, është që, falë arsimimit dhe pozicionimit të fortë të universitetit të Kosovës, doli e vërteta më argumentuese historike për shqiptarët, e vërtetë kjo që deri në këtë kohë ishte e dominuar nga elitat intelektuale serbe. Elitat serbe, që kishin dominuar me të vërtetën e tyre lidhur me Kosovën, nuk ishin të gatshme që tash të pranonin një të vërtetë krejt tjetër, sikundër që nuk ishin të gatshme të pranonin një barazi të lerë me një mbipërfaqësim të shqiptarëve në pozita politike, ekonomike dhe nuk ishin të gatshme të pranonin një situatë ku serbët nuk do të favorizoheshin më.

Aprovimi i Kushtetutës dhe zbatimi i saj në praktikë krijoi një hapësirë ku pjesët e Federatës, dikush më shumë e dikush më pak, dëshironin të ndiheshin më të pavarur. Republikat

¹⁰⁷ Parullat e shprehura gjatë demonstratave të vitit 1968 kanë qenë si: Duam republikë, duam kushtetutë, jemi shqiptarë-nuk jemi jugosllavë, Trepça punon-Beogradi ndërtohet, duam flamurin kombëtar, liri për të burgosurit politikë,etj. Kërkesa përafërsisht të njëjta do të kemi edhe gjatë demonstratave të vitit 1981, por në një kontekst krejt tjetër si nga rrethanat si për nga koha.

¹⁰⁸ Branko Horvat, *Kosovsko Pitanje*, Drugo dopunjeno izdanje, Globus, Zagreb, 1989, fq.137.

¹⁰⁹ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.186.

ishin dukshëm më të zhvilluara, ndërsa jugu i Jugosllavisë vazhdonte të mbetej dallueshëm më i pazhvilluar. Krijohesh përshtypja se me politikën ekonomike, përkundër ekzistimit të një Fondi Federativ për Zhvillimin e Viseve më të Pazhvilluara, nga të cilat edhe Kosova përkrahej, dëshirohej që të krijohesh një territor që do shërbente për prodhim të energjisë dhe për pajisje me lëndë të parë për pjesët e zhvilluara të Jugosllavisë. Në Kosovë, përqendrimi industrial po bëhej në disa zona për të cilat argumentohesh se ishin të pasura me resurse. Në Kosovë gjendeshin 65% të rezervave jugosllave të plumbit dhe të zinkut, mbi 50% të linjtit, pastaj të magnezit, kaolinit, arit, argjendit, bismutit dhe nikelit.¹¹⁰ Trepça mendohesh të ishte ndër bazat më të forta të ekonomisë. Ndikimi i Trepçës do të jetë i madh edhe në politikë. Për shembull emri i Trepçës përmendet në demonstratat e vitit 1968, në demonstratat e vitit 1981 kurse rol të jashtëzakonshëm do të luajnë minatorët e Trepçës në mbrojtje të subjektivitetit të Kosovës ndaj sulmeve që kishte ndërmarrë pushteti i Millosheviçit. Përcaktimi i politikave ekonomike jugosllave në kuptimin e ndarjes së zonave veriore si industri të zhvilluara dhe të atyre të pazhvilluara, që do të jenë për lëndë të parë dhe për përdorim të energjisë, kishte shtyrë shefin e Partisë Komuniste të Maqedonisë, Kërste Cërvenkovski, ta quante këtë situatë, ku jugu po zhvillohej nga veriu, si një neokolonializëm socialist.

Në një pavarësi të madhe të njërive federative, po vërehej një lëvizje e qytetarëve nga një njësi në tjetrën duke shkuar në drejtim të bashkimit me trungun nacional. Këto lëvizje ishin karakteristike pothuaj për të gjitha njësitë federative, ndërkohë që ky proces i lëvizjeve nuk ishte politizuar apo nuk ishte (keq) përdorur për interesa politike, me përjashtim të Serbisë. Lëvizje kishte edhe nga Kosova dhe nga ajo e dy etnive: shqiptare dhe serbe. Shqiptarët po iknin drejt përdorimit të Europës, por edhe në drejtim të Sllovenisë dhe Kroacisë, për shkak kryesisht ekonomike dhe të njëjtën gjë po bënin edhe serbët, por ata po lëviznin në drejtim të Serbisë. Dhe kjo lëvizje ishte vështirë të ndalej pa zhvillim të duhur ekonomik, por ky zhvillim nuk po ndodhte. Lëvizjet të tilla të popullatës të të dyja etnive nuk u bënë shkas për ndonjë debat të hapur. Në fakt në Serbi kjo lëvizje e serbëve dhe malazezëve u shfrytëzua fillimisht nga strukturat intelektuale, që kishin gjetur strehim në rrethin e Qosiqit, por edhe të Akademisë Serbe të Shkencave dhe jo vetëm aty. Edhe brenda strukturave partiake kjo çështje filloi të përdoret në fillim sipërfaqësisht, por me kalimin e kohës, kur nacionalistë e komunistë, intelektualë e politikanë, gazetarë e artistë, si edhe të tjerë, u rreshtuan të gjithë në një linjë dhe kjo u përdor

¹¹⁰ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.196.

deri në maksimumin e mundshëm. Në vorbullën e krijimit të një klime ku e vërteta serbe lidhur me ikjen e serbëve dhe të malazezëve do të bëhej e vërtetë përgjithësisht e pranuar, dominonte me qëndrime Akademia Serbe e Shkencave dhe mediet serbe, fillimisht ato të shkruara. Në shërbim të këtyre vihet edhe Kisha serbe. Kështu edhe një herë në histori tendencat për dominimin e të vërtetës serbe lidhur me shqiptarët, por edhe me Bosnjën dhe Kroacinë po shtroheshin dhe imponoheshin hapur. Kolegu i Dobrica Qosiqit, Milorad Ekmeçiç, nga Sarajeva, publikisht do të zhvillojë teorinë e vet që

*“serbët janë popull historik, kroatët johistorik, ndërkaq boshnjakët nuk janë popull”.*¹¹¹

Mediet serbe publikojnë të dhëna marramendëse dhe shumë larg së vërtetës. P.sh. Në fillim të viteve 80-të, për shembull, shtypi serb pretendonte se nga Kosova ishin shpërngulur më shumë se 200.000 serbë gjatë 20 viteve të fundit; më 1984 një prift ortodoks, arkimandriti Atanasie Jevtiq, shkroi se gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit nga Kosova kishin ikur 200.000 serbë...¹¹² Askush nuk mund të mohojë se ka pasur lëvizje të serbëve, por ka pasur edhe të shqiptarëve dhe kjo domosdoshmërisht ka çuar te rënia e numrit të popullatës, po shifrat e fabrikua nga mediet dhe nga politika zyrtare ishin larg numrit të vërtetë. Kjo është e lehtë të verifikohet nga të dhënat prej regjistrimeve zyrtare, prandaj nuk është e nevojshme për analiza edhe më të thella. Shifrat që shënuan numrin e serbëve dhe të malazezëve të ikur nga Kosova, ishin si vijon: 264.604 (1961); 259.819 (1971); 236.526 (1981)...¹¹³ Analiza nga shifrat zyrtare tregon se ka pasur lëvizje të serbëve dhe të malazezëve, por në kontekst të rrethanave dhe në kontekst kohe, kur të gjithë lëviznin për shkaqe ekonomike, pra nuk kishim të bënim me një shqetësim që prekte vetëm një etnitet. Qarqet e përmendura serbe jo vetëm frynin numrat, por edhe fabrikonin shkaqet e lëvizjes. E vërteta për shkaqet e lëvizjeve të serbëve dhe të malazezëve në Serbi paraqitej ndryshe dhe me një histori shoviniste. Thuhej se serbët dhe malazezët po detyroheshin të iknin nga Kosova nën presionin dhe dhunën e ushtruar nga shqiptarët kundër tyre. Kjo e pavërtetë u servirej edhe republikave të tjera, sikundër që i servirej edhe opinionit të jashtëm.

¹¹¹ Ekrem Avdiç & Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë-Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.281.

¹¹² Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë&shtëpia e librit Tiranë, 2001 fq.343.

¹¹³ Po aty.

Në fillim të viteve tetëdhjetë Jugosllavia do të fillonte të kthente kreditë e marra, në një kohë kur Tito vdiq dhe në një kohë kur Federata me elemente të konfederatës po fillonte të merrte kahje të cilave vështirë t'u përcaktohej itinerari. Vdekja e Titos interpretohet nga mendimtarë edhe si faktor destabilizues, sepse shqiptarët tek ai shihnin shpëtimtarin. Kështu, G.R.Jansen mendon se “mes efekteve destabilizuese ishte se shqiptarët po e ndienin që po humbin rojen e tyre të re”.¹¹⁴ Jugosllavia po futej në një krizë të thellë ekonomike, ku krahas shtimit të popullsisë urbane dhe popullsisë së re e të arsimuar, me frustrime nacionale gjithnjë në rritje, krijoi kushtet që karakterizuan shpërthimin e trazirave të shumta dhe të revolucioneve në mbarë botën.¹¹⁵

Kosova, e ndodhur në një situatë me ekonomi të dobët, me shkallën më të lartë të papunësisë dhe me një numër të madh të të rinjve, perspektiva e të cilëve ishte e zymtë; me një ikje të njerëzve drejt perëndimit dhe me pamundësi që të orientojë në mënyrë të drejtpërdrejtë politikat zhvillimore, në një situatë të një vetëdijeje më të ngritur nacionale dhe me një kujtesë për të këqijat dhe vështirësitë që kishin ndodhur gjatë qëndrimit të saj si pjesë e mbretërisë së dikurshme jugosllave dhe pjesë e Jugosllavisë socialiste; me një trysni të vazhdueshme nga Republika e Serbisë e përkrahur në masë të madhe nga Federata edhe nga republikat e tjera, varësisht nga rrethanat dhe nga koha; me një udhëheqësi komuniste të ndarë, por edhe me një elitë intelektuale që tash po bëhej e aftë të printe përkundër vështirësive të shumëllojshme; me aspirata të vazhdueshme për avancim të pozitës së vet si entitet, por edhe si popullatë; me një diasporë që po krijohej nëpër vende të Europës Perëndimore; me një klasë të krijuar punëtore; po akumulonte një energji të cilën ishte vështirë për ta kanalizuar.

Në anën tjetër, Serbia dhe elita e saj intelektuale e politike nuk ishin të gatshëm dhe nuk tregonin vullnet të pranonin faktin se Kosova po merrte drejtimin, të cilin e meritonte natyrshëm. Ata nuk po hiqnin dorë nga pretendimet territoriale të tyre ndaj Kosovës, por edhe nuk donin të kuptonin se rrethanat ishin krejt të tjera nga ato kur Kosova ishte marrë dhe ishte mbajtur në kuadër të mbretërisë jugosllave. Ishin krejt të tjera edhe nga ato kur Kosova ishte marrë dhe ishte futur në Federatën Jugosllave të pasluftës së Dytë Botërore. Ata nuk i kishin pranuar ndryshimet kushtetuese dhe Kushtetutën e vitit 1974 me vullnet të përgjithshëm. Ata nuk dëshironin të

¹¹⁴ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.6 (qasur me 29.12.2013).

¹¹⁵ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.70.

pajtoheshin me faktin se shqiptarët nuk ishin më ata të vitit 1918, 1946 apo të ngjashëm. Dhe ata nuk dëshironin të pranonin drejtësi dhe barazi kur koha e kolonializmit kishte përfunduar.

Rreth Kosovës brenda Federatës Jugosllave tashmë kishim dy opsione: opsioni serb që nuk pranonte avancim dhe barazi dhe opsioni shqiptar që vepronte ndaras. Një pjesë e elitës politike brenda Partisë Komuniste të Kosovës kishte shpresë se rrethanat mund të ndryshonin duke vepruar përmes institucioneve të pushtetit dhe përmes strukturave partiake, kurse pjesa tjetër në një mënyrë ishte shkëputur fare nga realiteti duke qenë e verbët nga ideologjia ose e larguar nga etniteti të cilit i takonte. Kurse në anën tjetër kishim elitën intelektuale e cila nuk besonte se Serbia mund të bindej që të ndryshonte qasjen ndaj Kosovës në mënyrën siç pretendonte elita politike e Kosovës, prandaj duhej shikuar edhe për rrugë të tjera alternative.

Në rrethanat e përshkruara, më 11.03.1981 në Prishtinë shpërthejnë demonstratat e studentëve¹¹⁶, fillimisht në mensën e studentëve, në shenjë pakënaqësie për gjendjen e rëndë dhe shumë shpejt demonstratat do të kaplojnë pothuaj gjithë territorin e Kosovës ku do të gjejnë përkrahje të përgjithshme popullore. Demonstrata kishte edhe në Tetovë (Maqedoni). Demonstratat filluan qetë dhe vetëm regjimet totalitare reagojnë me masat të cilat u ndërmorën kundër demonstruesve në Kosovë. Reagimi i Federatës ishte i ashpër dhe i frikshëm për Federatën, por edhe për Kosovën dhe reagimi ishte dukshëm në përputhje me kërkesat e qarqeve nacionaliste serbe. Mënyra e demonstrimit, parullat dhe kërkesat e shprehura, që kishin karakter ekonomik dhe politik, nuk kishin asgjë të përbashkët me nacionalizmin apo separatizmin shqiptar dhe demonstratat nuk po kërkonin vrasje për të tjerët. Nuk po shpreheshin tendenca hegjemoniste dhe shfrytëzim të të tjerëve. Nuk po kërkoheshin territore të huaja. Aty po kërkoheshin barazi dhe status i barabartë me të tjerët në Federatë. Aty po kërkoheshin barazi ekonomike dhe politike. Pushteti jugosllav nën presionin e shtuar të Republikës së Serbisë, në vend që t'i merrte në konsideratë kërkesat e qytetarëve dhe në vend që të bisedonte me qytetarët e Kosovës, zgjodhi rrugën e dhunës dhe të terrorit kundër atyre që i konsideronte qytetarë të vet. Ndërhyrja ndaj demonstruesve ishte e ashpër; u përdorën forca të mëdha duke zgjedhur mjetet e dhunës përfshirë

¹¹⁶ Mediet shtetërore në Kosovë dhe në Jugosllavi njoftojnë shumë shkurt lidhur me demonstratat. Fillimisht ato lajmërohen si incident dhe pastaj të dirigjuara nga pushteti fillojnë të trajtohen si demonstrata me karakter nacionalist, që kanë për qëllim destabilizimin e Jugosllavisë, etj. Edhe shtypi i huaj, fillimisht do të transmetojë lajme lidhur me demonstratat duke u bazuar në Agjencinë e lajmeve TANJUG, por megjithatë shumë gazeta e revista amerikane, angleze... botojnë informata rregullisht mbi ngjarjet e Kosovës. Për më shumë lidhur me shtypin e huaj për demonstratat shih artikullin e Samile Keçmezi-Basha, Demonstratat studentore të vitit 1981, në: <http://shenja.mk/index.php/kulture/histori/4448-demonstratat-studentore-te-vitit-1981.html> (qasur me 15.10.2013).

edhe tanket nëpër rrugët e Prishtinës. Sipas të dhënave zyrtare u vranë 9 demonstrues, kurse sipas të dhënave të pakonfirmuara numri i të vrarëve ishte shumë më i madh, pothuajse disa qindra të vrarëve. Kryesia e Jugosllavisë shpalli gjendjen e jashtëzakonshme¹¹⁷ dhe të njëjtën ditë merr vendimin për krijimin e njësitit të forcave policore federative. Me të qetësuar dhunshëm situatën, në rrethana të një shtetrrëthimi të ashpër fillojnë të zbatohen masa kundër popullatës shqiptare, gjithnjë nën pretekstin e ndjekjes së organizatorëve dhe iniciuesve të demonstratave, të cilat po shpallehin si separatiste, irredentiste dhe kundërrevolucionare. Filloi një fushatë e burgosjeve dhe e pastrimit të institucioneve nga “separatistët dhe nacionalistët shqiptarë” si dhe procesi i ashtuquajtur i diferencimit, përmes të cilit përjashtoheshin shqiptarë nga Partia Komuniste, që në vetvete ngërthente automatikisht masat e largimit nga puna apo të shkarkimit nga posti. Nga universiteti, të cilit i ishte dhënë titulli “çerdhe e nacionalistëve shqiptarë”, largohen profesorë të njohur, që ishin vënë në shënjestër të pushtetit tash totalisht armiqësor kundër shqiptarëve. U arrestuan më se 2000 shqiptarë gjatë kohës së demonstratave; u mbajtën kryesisht gjykime të mbyllura pa publik, ndërsa dënimet me burgim ishin të ndryshme prej 1 muaj deri 15 vjet. Nga fillimi i qershorit, u shpall zyrtarisht se ishin dënuar me burgim 479 persona; në vjeshtë u organizua një valë tjetër gjykimesh dhe dënimesh. Arrestimet e mëtejme, për shkak të demonstratave vazhduan edhe shumë muaj. Një vëzhgim i persekutimeve pasuese, i bërë nga revista e Beogradit “NIN”, më 1986, konkludonte se me burgime të rënda ishin dënuar 1.200 veta, kurse 3.000 të tjerë ishin dënuar deri në 3 muaj.¹¹⁸ Demonstratat shpërthyen papritmas dhe udhëheqësit partiakë (federativë dhe kosovarë) nën diktatin e Serbisë, e cila dukej se me padurim po priste një rast të tillë, shpejt u vlerësuan si armiqësore, nacionaliste, separatiste etj., kurse strukturat partiake dhe shtetërore të Kosovës u sollën si të ishin të nënshtruara dhe nuk treguan guxim që së paku ta kundërshtonin një vlerësimin të tillë. Ndonjë rast i vetëm sporadik reagimi nuk mund të ndikonte në ndryshim të vlerësimeve dhe të qëndrimeve shtetërore dhe partiake për demonstratat. Reagimet apo kundërshtimet individuale rezultuan me shkarkime apo me “dorëheqje”. Për qëllimin e këtij punimi nuk ka rëndësi nëse në këto demonstrata kishte përzierje edhe të forcave të sigurimit shtetëror serb, të futur si provokatorë në mesin e

¹¹⁷ Në mbledhjen e mbajtur me 02.04.1981 Kryesia e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë merr vendim që të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, ku përpos forcave policore angazhohet edhe armata Jugosllave me qëllim të “qetësimit të situatës” në Kosovë. Kryesia e Jugosllavisë duke vlerësuar demonstratat, në mes të tjerash shprehet se “po rrezikohet integriteti dhe sovraniteti i Jugosllavisë”. Nxjerrë nga: <http://www.nspm.rs/hronika/nadanasnji-dan-predsednistvo-sfrj-proglasilo-vanredno-stanje-na-kosovu-zbog-demonstracija-albanskih-studenata-pod-parolom-kosovo-republika.html?alphabet=1> (qasur me 23 dhjetor 2013).

¹¹⁸ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë&shtëpia e librit Tiranë, 2001, fq. 349-350.

demonstruesve, ashtu sikundër nuk ka rëndësi nëse këtu u angazhuan edhe përfaqësues të organizatave të fshehta shqiptare, që njiheshin si organizata marksiste - leniniste, etj. Këto janë studiuar dhe shumë çështje janë publikuar. Natyrisht ka nevojë për më shumë ndriçim lidhur me këto çështje. Ajo që dua të nënvizoj është se këto demonstrata përfundimisht shënojnë rënien e një idealizmi titist për një shtet socialist të ndërtuar në parullën e vëllazërimit dhe bashkimit të kombeve e të kombësive dhe për daljen në shesh të aspiratave për ndërtimin e shteteve nacionale, ku Serbia shquhet më së shumti me tendencat e saj hegjemoniste për krijimin e Serbisë së Madhe. Kështu u krijua terreni i përshtatshëm për Serbinë, e cila ia arriti të imponojë vullnetin e vet te strukturat e pushtetit federativ, i cili me ose paretëdije po ndihmonte edhe shkatërrimin e vetvetes. Për t'u realizuar aspiratat serbe Kosova ishte preteksti më i qëlluar dhe për këtë në Serbi ishte punuar pandërprerë. Menjëherë pas qetësimit të dhunshëm të demonstratave, organet serbe filluan të zbatojnë politikën e tyre të krijimit të Serbisë së Madhe. Fillimisht duhej marrë me zhveshjen e Kosovës nga shtetësia e saj. Dhe këtu u krijua terreni për ringjalljen e ideve dhe projekteve që kishin ekzistuar, të cilat do të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Por së pari, gjithçkaje i duhej dhënë ngjyra legale. Prandaj duhej ndryshuar Kushtetuta e vitit 1974. Në këtë kontekst, iniciativat e mëhershme për ndryshim të Kushtetutës ringjallen dhe vendosen në frymë dhe baza të tjera. Kështu ndër të tjera, gjatë datave 24-26 dhjetor 1981 mbahet mbledhja XVIII e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Serbisë lidhur me raportet në Serbi si dhe lidhur me pozitën e krahinave.

Si përfundim, prej këtij procesi i rrënimit të Federatës merr kahje dhe përmasa të tjera, të cilat do të paraqiten sipas nevojave të këtij punimi.

KREU II: Autonomia e Kosovës drejt rrënimin: masat represive të qarqeve serbo-jugosllave kundër të drejtave të shqiptarëve

2.1. Memorandumi i ASH të Serbisë dhe pozita e Kosovës

Rrënimi i pozitës së Kosovës brenda Federatës, që ishte përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974, ka filluar të kërkohet që në ditët e para pas aprovimit nga qarqet serbe, nacionaliste, unitariste, hegjemoniste dhe komuniste. Pas demonstratave të vitit 1981 dhe pas shtypjes së dhunshme të tyre, masat represive kundër shqiptarëve nuk kishin të ndalur. Rajko Daniloviç thotë

”Në periudhën 1981 mesi i vitit 1986 janë burgosur dhe dënuar për krim politik rreth 6500 shqiptarë, ndërkaq vetëm në vitin 1986, nga gjithsej 1.400 të burgosur, shumicën më të madhe e përbënin shqiptarët. Vetëm në periudhën midis prillit dhe korrikut 1986 janë dënuar 120 shqiptarë, në grupe dhe individualisht, për veprimtari politike (kështu edhe grupet marksiste - leninist të Kosovës, grupet për zhvillim shoqëror të Republikës shqiptare në Jugosllavi...”¹¹⁹

Në Kosovë imponohet një heshtje dhe qetësi, kurse strukturat partiake të Kosovës kryesisht u pajtuan me etiketimin e demonstratave si kundërrevolucionare dhe armiqësore. Me apo pa dëshirë. Por sido që të ketë qenë, në një mënyrë apo në një tjetër, ata jepnin pëlqimin për masat që po ndërmerreshin kundër popullit shqiptar në Kosovë, në veçanti kundër intelektualëve dhe të rinjve. Veçanti e periudhës së pasdemonstratave të vitit 1981 është se tash aktivitetet për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës bëhen në një konsensus të përgjithshëm në Serbi, ku do t’i gjejmë bashkë: intelektualë, nacionalistë, komunistë, majtistë, djathtistë, Kishën Serbe, Akademinë dhe të gjitha organet shtetërore e politike. Në Serbi krijohet një klimë, ku çdo lider serb, sipas mendimit të nacionalistëve serb, por edhe sipas Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve shpirtërore të tyre, duhej patjetër të testohet në çështjen e Kosovës, nëse dëshironte të

¹¹⁹ Rajko Daniloviç, *Përdorimi i armikut* (Upotreba neprijatelja), Beograd 2010, marrë nga: Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.208.

pranohej dhe të njëhej nga serbët.¹²⁰ Këto të fundit (institucionet politike e shtetërore) ç'është e vërteta për një kohë të shkurtër prapa perdes dhe në heshtje, duke u përpjekur që në një mënyrë të zhvishen nga transparenca e manifestimit të nacionalizmit. Fushata e egër dhe propaganda kundër shqiptarëve dhe Kosovës, në shërbim të së cilës ishin vënë të gjithë, merr përmasa marramendëse. Një grup i madh intelektualësh serbë të grupuar rreth Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve sigurojnë një përkrahje të përgjithshme në opinionin publik serb. Ata sigurojnë përkrahje të fuqishme prej Kishës serbe dhe bëjnë propagandë antishqiptare, pa zgjedhur mjete e kritere. Të gjitha këto nxitën në Serbi një rilindje ekstreme të nacionalizmit serb. Masat dhe dhuna shtetërore kundër shqiptarëve, edhe pse ishin tepër të ashpra, sikur nuk mjaftonin. Krijohet një klimë a thua se për çdo problem ekzistues në trungut social serb në Serbi, në Kosovë, në Kroaci, gjithandej, fajtorë në radhë të parë ishin shqiptarët dhe Kosova, por po përmendeshin edhe të tjerët. Propaganda e egër, e orkestruar me përmasa gebelsiane, sikur përgatiste terrenin e furtunave të ardhshme dhe për ta vërtetuar këtë tezë mjafton vetëm një vështrim i shkurtër i shtypit serb të atyre viteve.¹²¹

Është përmendur në kreun e mëhershëm se Kushtetuta e vitit 1974 nuk ishte pranuar me lehtësi në Serbi dhe është thënë se menjëherë pas aprovimit, krahas refuzimeve që ishin paraqitur në procesin e miratimit, kanë dalë qëndrime zyrtare me kërkesën për ndryshim të saj. Këto vërehen që nga viti 1975, pastaj me Librin e Kaltër dhe kështu me radhë. Por, demonstratat e vitit 1981, sikur mezi pritëshin në Serbi, për t'u përdorur si shkas i masave që do ndërmerren. Paraqiten ide nga më të ndryshmet. Përshkruhet se situata në Kosovë është e padurueshme për popullatën serbe. Paragjykimet, që kanë ekzistuar gjithnjë për shqiptarët, tashmë dalin edhe më haptas në Serbi, por edhe në vise të tjera. Shqiptarët jashtë Kosovës shikohen si të dyshimtë edhe kur ndodhen jashtë saj, por edhe kur shërbejnë në Armatë. Shtypi dhe mediet në përgjithësi janë të mbushura me tema për Kosovën. Për “vuajtjet e popullit serb”, për “dhunën e nacionalistëve dhe separatistëve shqiptarë”, për “djepin e civilizimit serb”, ndërkohë që Kosova thuhet asnjëherë më parë nuk kishte qenë më e qetë. Por kriza e Kosovës në pranverën e vitit 1981 po dëshmonte se kishte përcaktuar koha e “bashkim-vëllazërimit”, se kishte marrë fund

¹²⁰ Ekrem Avdiç & Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.270.

¹²¹ Gazetat dhe revistat si Politika, Veçerje Novosti, NIN, Duga, Radio Televizioni Serb ishin nga shumë të tjera më të zëshme për të krijuar një atmosferë antishqiptare duke fabrikuar të vërtetën serbe dhe duke krijuar klimë antishqiptare. Krahas kësaj me propagandë përgatitej terreni për të arsyetuar masat e dhunës shtetërore, dhunë e cila, veçse ishte e parapërgatitur.

internacionalizmi komunist dhe se vendin e tyre po e zinte me vërtik të paparë nacionalizmi tradicional.¹²² Në një atmosferë të tillë të propagandës, idetë për nxjerrje dhe ngjallje të programeve të dikurshme antishqiptare marrin hov. Dhe këso programesh në Jugosllavi ka pasur në numër të madh. Historiani, Hakif Bajrami, numëron rreth 26 programe të tilla, siç ishte ai i Vaso Çubrilloviçit.¹²³ Në këtë situatë ngarendjesh, se kush dhe si do të dilte më shumë shpëtimtar i popullit serb, Akademia e Shkencave doli me Memorandumin e famshëm, ideja e përpilimit të të cilit është pranuar në Kuvendin e ASSHA-së, me datë 23.05.1985. Për përpilimin e tij janë angazhuar akademikët serbë si: Pavle Iviç, Antonije Isakoviç, Dusan Kanazir, Mihajlo Markoviç, Milosh Macura, Dejan Medakoviç, Miroslav Pantiq, Nikola Pantiq, Lubisha Rakiq, Radovan Samarxhiq, Miomir Vukobradoviç, Vasilie Kerstiq, Kosta Mihailoviç, Ivan Maksimoviç, Stojan Çeliq dhe Nikola Qobeliq. Por deri te nxjerrja dhe publikimi i tij, besoj është me rëndësi të bëhet një përzgjedhje e disa veprimeve dhe ngjarjeve që lehtësuan terrenin për nxjerrjen publike të këtij programi. Këto ngjarje mund të përshkruhen dhe kategorizohen si vijon:

- *Më 24-26 dhjetor 1982 mbahet mbledhja XVIII e Komitetit Qendror të Serbisë për raportet në Serbi dhe për pozitën kushtetuese të krahinave;*
- *Më 26 shkurt 1982 mbahet Kongresi IX i Partisë Komuniste të Serbisë, i cili hap çështjen e shpërnguljes së dhunshme të serbëve dhe të malazezëve;*
- *Në prill 1982 21 priftërinj nënshkruan një apel me të cilin i drejtohen organeve më të larta shtetërore të Federatës dhe të Republikës, Kuvendit të Shenjtë të Kishës dhe Sinodit.*

¹²² Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vetizolimit, rasti i Shqipërisë 1961-1989*, GEER, Tiranë, 2004, fq. 592.

¹²³ Vaso Çubrilloviç, një ndër ideologët më të shquar serbomëdhenj, në vitin 1937 ka përpiluar elaboratin “Shpërngulja e shqiptarëve” dhe disa vite më vonë, po i njëjti paraqitet me elaboratin tjetër të vitit 1944 me emër “Të drejtat e pakicave në Jugosllavinë e re”. Me këto kërkohet shpërngulja e popullatës (pakicave siç i quante ky), sepse sipas tij serbët duhet t’i zotërojnë territoret e Kosovës. Dhe po sipas tij, “vetëm dhuna brutale kundër shqiptarëve ruan kontrollin serb mbi Kosovën...nëse Gjermania dëbon dhjetëra e mijëra hebrenj dhe Rusia zhvendos miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit në tjetrin, evakuimi i disa qindra e mijëra shqiptarëve nuk do të shkaktojë luftë botërore....Çubrilloviçi kërkonte spastrime etnike dhe si territore të spastrimeve etnike kishte definuar Rrafshin e Dukagjinit dhe Malet e Sharrit...sipas tij,në fshatra duhej të veprohej kundër të arsimuarve dhe pasanikëve; nëse njëherë zhduket elita, atëherë shtresa e popullsisë së paarsimuar dhe e varfër do të dëbohej lehtë...ky plan të kujton metodat e politikës shfarosëse nacionalsocialiste në Europën Lindore...por plani nuk mbeti vetëm në letër, sepse shumë elemente të tij u zbatuan me intensitet të ndryshëm pak para Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj mes 1945-ës dhe 1966-ës si dhe në mes 1989-ës dhe 1999-ës...nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, me elaboratin e dytë) Çubrilloviçi parashtrroi një version dhe më radikal...duhej të eliminoheshin me rend gjermanët, hungarezët, shqiptarët, italianët dhe rumunët...kushdo që merrej me kulturën shqiptare jashtë strukturave shtetërore serbe rrezikonte jetën e vet. Milan Shufflai, kroat, historian i Shqipërisë ishte vrarë nga një agjent serb dhe lidhur me këtë rast kishin reaguar Albert Einstein dhe Heinrich Mann”. Oliver J.Shmit, vepër e cituar, fq.161-163.

Teksti i apelit paraqet “ngritjen e zërit dhe të mbrojtjes shpirtërore dhe biologjike të qenies serbe dhe popullit serb në Kosovë e Metohi”;

- *Një grup episkopësh udhëtojnë për në SHBA (vizitojnë State Department-in dhe Congress-in) për të kërkuar intervenim për shkak të Kosovës;*
- *Në korrik të vitit 1983 nxirret revista JAVNOST udhëhequr nga një grup intelektualësh nacionalistë serbë, ku në mënyrë të pashmangshme gjendet Dobrica Qosiq;*
- *Në fund të vitit 1983 prifti, Atanasije Jevtic, fillon të shkruajë në Pravoslavlje një fejtון të titulluar “Od Kosova do Jadovna” në të cilin bën krahasime për vuajtjet e popullit serb nëpër pjesë të ndryshme të Jugosllavisë;*
- *Në fund të gushtit 1983 varroset Aleksandar Ranković, kjo do të shërbejë si pretekst për demonstrata të mëdha serbe në historinë e pasluftës;*
- *Me 15 janar 1986 në Knjizevne Novine botohet peticioni i 2015 serbëve dhe malazezëve nga Kosova;*
- *Me 24 shtator 1986 publikohet Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (SANU).¹²⁴*

Në Jugosllavi ende kishim sistem njëpartiak dhe ishte më lehtë që të veprohej, nëse për këtë çështje ishte diskutuar, vendosur apo gjykuar nga organet e partisë. Siç shihet, dy organet më të larta partiake të Serbisë diskutuan për pozitën kushtetuese të krahinave dhe për shpërnguljen e popullatës serbe dhe malazeze nga Kosova. Priftërinjtë e Kishës Ortodokse vihen në lëvizje sepse “ishte rrezikuar shpirti serb”, një pjesë e tyre duhej marrë me internacionalizimin e kësaj çështjeje, kurse sipas traditës, akademiku nationalist, Dobrica Qosiq, do të dilte në skenë sërish me idetë e tija. Tani edhe si këshilltar i drejtpërdrejt i grupeve serbe dhe malazeze nga Kosova, të cilët nën propagandën e ashpër antishqiptare, pa qenë të vetëdijshëm se po orkestroheshin, kishin filluar edhe vetë të besonin se ishin të shtypur e të përndjekur. Serbët nga Kosova po mësoheshin sesi të vepronin, kujt t’i drejtohen, në ç’ mënyrë dhe në këtë aspekt, mësimë më së miri po u jepte D.Qosiqi, siç edhe vetë e ka pranuar.¹²⁵ Njeriu që dikur ishte larguar nga funksionet shtetërore e

¹²⁴ Sonja Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske Zaverye*, knjiga 1, Zagorac, Beograd, 2006, fq. 104-111.

¹²⁵ “Është e vërtetë kjo që flitet, se mua njerëzit, serbët nga Kosova më drejtohen drejtpërdrejt dhe kërkojnë këshilla (...). Po dëgjoj se kemi tollovi në Kosovë, veçanërisht në Fushë Kosovë. Nga atje më thërrasin njerëzit dhe më pyesin se çka të bëjnë. (...) Më thonë se në Kosovë më nuk mund të jetohej dhe se serbët janë të gatshëm të vijnë masovikisht në Beograd. Llogarisin se në Beograd nuk do t’i përkrahin. Thonë se masa e serbëve dhe malazezëve, ata të cilët kanë mbetur në Kosovë, i janë kthyer shpërnguljes. Në gjithë këtë unë u them se ju kemi rezervuar dhomat në hotel. Le të flenë e pastaj do të takohemi në mëngjes. Këtë ua them me zë të ngritur dhe u lë porosinë që

partiake, kur po varrosej Rankoviçi po mblidhte mijëra serbë, që në një mënyrë edhe kjo po tregonte homogjenizimin serb nën flamur të nacionalizmit dhe hegjemonizmit. Dhe në një situatë të këtillë, në gazetën Veçernje Novosti, në shtator 1986 u publikua “Memorandumi i një grupi të anëtarëve të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve mbi çështjet shoqërore në vendin tonë”. Dokumenti që me të drejtë u interpretua si “mitologji politike”¹²⁶ fillon të përshkruajë krizën jugosllave dhe gjendjen e përgjithshme dhe pastaj menjëherë, numëron tri çështje të mundimshme: “prapambetja e gjatë ekonomike e Serbisë, marrëdhëniet e parregulluara shtetërore juridike me Federatën dhe me krahinat dhe gjenocidi në Kosovë” janë forcuar në skenën politike me forcë të përbashkët, që e bën situatën të ngarkuar nëse jo edhe eksplozive”.¹²⁷ Memorandumi, nuk u plasua si ndonjë dokument zyrtar, por si një “analizë” e intelektualëve.¹²⁸ Teksti më tutje ecën duke sqaruar shkaqet e krizës afatgjatë ekonomike të Serbisë dhe duke nxjerrë argumentet serbe se ndër të tjera, Serbia ka ngecje ekonomike nga shkak i “investimit të vogël për kokë banori dhe jo nga dobësitë në efikasitet të investimeve... ekonomia serbe për një kohë të gjatë i është nënshtruar shkëmbimit joadekuat. Shembull tipik për këtë është shkëmbimi i energjisë që, për shkak të çmimit të ulët, i dërgohet në sasi të mëdha republikave të tjera...kontributi i madh kohët e fundit në Fondin për zhvillimi e rajoneve jo mjaft të zhvilluara është shkaktar i rënies ekonomike...Sllovenia dhe Kroacia kanë filluar nga stadi më i lartë i zhvillimit dhe kanë arritur zhvillimin më të shpejtë...me përmirësimin relativ të pozitave të tyre është krijuar një hendek ndarjeje në mes tyre dhe pjesëve të tjera të Jugosllavisë”. Teksti më tutje tregon shkaqet e ndarjeve në mes të zonave të zhvilluara dhe të pazhvilluara dhe për këtë fajtohet është PKJ, e cila ka lejuar, që menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi, dy republika të futen me ekonomi më të fortë, krahasuar me republikat e tjera. Nënshtrimi ekonomik i Serbisë, sipas memorandumit nuk ka mundur të bëhet pa një nënshtrim politik, ku dy republikat veriore, Kroacia dhe Sllovenia, shihet se kanë dominuar që nga momenti i futjes së tyre në Jugosllavi. Për më tepër, sipas memorandumit janë dy udhëheqësit kryesorë të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë

pastaj le të vijnë tek unë. (...) Më thonë se janë të gatshëm për përleshjen përfundimtare me shqiptarët (siptarima). Nuk i lejoj në një mendim të tillë, sepse këtë edhe e duan. Kjo e keqe shqiptare dëshiron të na provokojë. Por ju do të shkoni nesër, ashtu siç kokat tuaja dinë te Dushan Ckrebiqu si Kryetar i Kryesisë së Republikës së Serbisë. Duhet t’u pranojë me çdo kusht. Shtrijuni në prag të derës. Duhet t’ju pranojë edhe Kryetarja e Qeverisë së Jugosllavisë, Milka Planinc”. (Liljana Bulatoviç, Ispovest 1995).

¹²⁶ Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq. 238.

¹²⁷ Shih Memorandumin e Akademisë Serbe të Arteve dhe Shkencës - Srpska Akademija Nauka i Umetnosti (SANU), fq.1.

¹²⁸ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë-Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.276.

Botërore: Tito dhe Kardel, ata që kanë orientuar zhvillimin e gjithëmbarshtëm në drejtim të atyre republikave duke lënë anash zhvillimin e pjesëve të tjera të Jugosllavisë, në veçanti Serbisë. Sllovenët dhe kroatët para luftës kanë krijuar partitë e tyre komuniste dhe kështu kanë marrë forcë vendimmarrëse në Partinë Komuniste të Jugosllavisë. Sesa janë të vendosura këto republika, gjithnjë sipas memorandumit, e tregon edhe fakti se atyre iu konvenon ruajtja e Kushtetutës së vitit 1974, sepse kjo Kushtetutë dobëson Serbinë. Fajësohet madje edhe KAÇKJ dhe vendi ku ishin mbajtur mbledhjet e themelimit të Jugosllavisë Socialiste, sepse kjo kishte ndodhur në Bosnjë dhe Hercegovinë, prandaj që atëherë Serbia është vendosur në pozita nënshtruese dhe pa ndikim. Fondi për mbështetje të rajoneve jo mjaft të zhvilluara, është ngarkesë e madhe për Serbinë, kurse këto republika kontribuojnë fare pak, nëse nuk kontribuojnë fare. Barazia e kombeve dhe e kombësive në Jugosllavi, si një ndër parimet e proklamuar, nuk respektohet për Serbinë, dhe këtu memorandumit ngre një parullë “Serbi e dobët - Federatë e fortë”, parullë që është thjeshtë e bazuar në teori konspirative dhe kjo do të jetë parullë tepër e përdorur në fazat e mëvonshme të zhvillimeve me përmasa tragjike, kur institucioni serb përdor të gjithë arsenalin politik, ushtarak, policor, etj., për të ndryshuar me dhunë Kushtetutën e vitit 1974. Sipas memorandumit Kushtetuta e Kosovës e ka ndarë në tri pjesë, ku kuvendet e krahinave janë të pavarura, kurse kuvendi serb nuk mund të vendosë vetë për territorin e tij të ngushtë pa pëlqimin e kuvendeve të krahinave. Për këtë arsye raportet në Serbi janë konfuzë, por sipas serbëve natyrisht.

Politika zyrtare serbe, sikundër elita intelektuale dhe politike, është në panik dhe në paranojë të madhe dhe kjo më së miri vërtetohet kur në memorandum flitet për Kosovën. Sipas tyre ndjekja e popullit serb nga Kosova është dëshmi spektakolare e humbjes së serbëve në Kosovë. Popullit serb në pranverën e vitit 1981 i shpallet luftë speciale, që në të vërtetë është luftë e përgjithshme e përgatitur në faza të ndryshme administrative, politike dhe kushtetuese. E vërteta e demonstratave të vitit 1981 është krejtësisht ndryshe.”Në mbështetje të përmbajtjes së këtij memorandumit, dhe të një politike nacionaliste serbomadhe, që zinte fill që nga fillimi i shekullit XIX”, siç shkruan akademiku Pajazit Nushi,

“filluan të krijohen kushte, rrethana dhe raporte politike, të cilat i vunë shqiptarët në pozicionin e të ndjekurve dhe të dëbuarve. Filluan burgosjet, internimet, keqtrajtimet e shqiptarëve, si të punëtorëve e fshatarëve, intelektualëve e

udhëheqësve shtetërorë e politikë, madje edhe partiakë, pra të vetë Lidhjes së Komunistëve në pushtet".¹²⁹

Më lart është folur për këtë dhe siç shihet në planet e tyre afatgjate, elitat intelektuale dhe politike serbe kërkonin pretekste, në të cilat do të bazoheshin për të fabrikuar të vërtetën serbe dhe për të krijuar bazën për masat antishqiptare. Lufta antifashiste e shqiptarëve mohohet krejtësisht, kurse situatën pas vitit 1981 e përshkruan si agresion ndaj serbëve. Thua se në Kosovë gjendja e jashtëzakonshme ishte vendosur kundër serbëve. Thua se serbët po burgoseshin, thua se serbët po rriheshin, thua se serbët po maltretoheshin, thua se serbët po diferencoheshin, thua se serbët po nxirreshin nga puna, thua se serbët po iknin nga persekutimet, thua se aktivistët e ikur nga ndjekjet po ekzekutoheshin nga UDB në Europë, thua se serbët po vriteshin gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, etj. Memorandumi ankohet në udhëheqësinë kosovare se kinse ajo nuk po bënte aq sa duhej për të ndryshuar raportet në Kosovë, ndërkohë që kjo udhëheqësi ishte krejtësisht e dorëzuar dhe po i bënte “amin” gjithë masave që po ndërmerreshin në Kosovë, në, siç thuhej, “luftën kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar”. Në një pjesë të memorandumit kur përshkruhej “gjendja e rëndë e popullatës serbe”, flitet edhe për pozitën e popullit serb në Kroaci ku serbët po i “nënshtroheshin asimilimit”. Në Kroaci, sipas memorandumit serbëve iu është ndaluar organizimi në shoqata, u imponohet gjuha kroate dhe serbët jo vetëm që janë ndarë fizikisht nga shteti amë (Serbia), por shtetit amë i hiqet mundësitat që të ndihmojë qytetarët e vet. Integriteti i popullit serb, sipas tyre, është rrezikuar në tërë territorin e Jugosllavisë. Përmes memorandumit, serbët ankohen se vetëm shkrimtarët më të shquar serbë vihen në listat e zeza-në listat e përndjekjes.

Më tutje elitës serbe i pengon edhe sistemi i arsimit. Sipas tyre në Jugosllavi, janë krijuar tetë sisteme të pavarura të arsimit (nëpër tetë njësitë federative) dhe më mirë do të ishte një marrëveshje e të gjithëve për një sistem unik, mundësisht sipas modelit serb. Prandaj, edhe propagandohej dhe për më tepër vihej në memorandum. E vetëdijshme se “elita intelektuale” kishte tejkaluar kufijtë e asaj që mund të quhej intelektuale, kërkon përmes memorandumit mbështetje për të përligjur aktet, veprimet dhe gjuhën gebelsiane. E nëse një parullë “Kosova Republikë” shkruhej në Kosovë apo madje vetëm nëse diku gjendeshin inicialet “KR”, autorit/rëve u diktoheshin masa shumë të ashpra.

¹²⁹ Esat Stavileci, Vepra I, *Kosova në ish-Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.47.

Memorandumi, në çfarëdo mënyrë që të lexohet nuk mund t'i jepet interpretim tjetër, përpos se ishte një program krejtësisht nacionalist, me qëllime dhe qëndrime që nuk duhej t'i takonin shekullit të njëzetë. Dokumenti me të drejtë u interpretua si “mitologji politike”: Aty qëllimisht përzgjidhen dhe interpretohen të vërtetat, gjysmë të vërtetat, të pavërtetat, faktet dhe pretendimet; akademikët (anëtarët e Akademisë) thjesht nuk dëshironin të bënin dallim në mes asaj se çfarë është e mundshme nga aspekti empirik, çka është e pamundshme ose çka mund të shikohet vetëm si supozim.¹³⁰ Ky dokument, nga i cili më lart kam seleksionuar fragmente të buta për t'i komentuar apo interpretuar, nuk është ide që i ka takuar vetëm kohës së pasviteve 1974, apo 1981, etj. Është program me ide që s'kanë pushuar së reshturi që nga shekulli 19. Është program me ide që kishin qenë në elaboratet e kaluara, tani me një fjalor më modern dhe me frazeologji gjithësi të ashpër nacionaliste. Dhe kur çështjet marrin një kahje, kur lindshmëria në Kosovë thuhej të ishte e lartë, nuk hezitohet edhe të quhej se në Kosovë po “bëhej gjenocid biologjik” ndaj serbëve. Deri këtu shkonin shpërthimet nacionaliste, fatkeqësisht të shprehura nga intelektualët siç është rasti i këtij termi, që u përdor nga Dimitrije Bogdanoviq dhe këto shpërthime, e përsëris shkaktuan pasojat që nuk ishin parë në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. Me rëndësi ishte që të krijohet një e vërtetë serbe dhe që vetëm asaj t'i besohet. Nuk kishte rëndësi cilat ishin faktet dhe të vërtetat. Ato krijoheshin dhe servoheshin. Memorandumi, pohonte se në periudhën 1690-1912, një gjysmë milionë serbë qenë dëbuar, nga të cilët 150000 e kishin lënë krahinën pas vitit 1876. Gjatë Luftës II Botërore krahinën e lanë 60.000 dhe nga 1966-a deri më 1986 më shumë se 200000.¹³¹ Se cila është matematika, që përdornin akademikët serbë, për të nxjerrë këto shifra është e vështirë të qëllohet, por se cili ishte qëllimi i lançimit të këtyre shifrave, është fare lehtë të kuptohet. Kjo edhe vërtetohet me masat që do të pasonin.

Memorandumi i Akademisë serbe edhe pse fillimisht u publikua përmes një gazete në mënyrë “gjysmë publike” ishte më shumë se publik. Ai ngërthente në vete angazhimin e të gjithë strukturave dhe pjesëve të elitës intelektuale; politike, fetare dhe shtetërore të Serbisë. Autoritetet partiake, ç'është e vërteta fillimisht heshtën, ndonjë aparatçik edhe e kundërshton me gjysmë zëri, ka edhe që e kundërshtojnë dhe që eliminohen nga skena,¹³² por ky dokument siç do shohim

¹³⁰ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.238.

¹³¹ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010, fq.307.

¹³² Stambolliqi (ishte mentor i Millosheviçit, por të cilin e hoqi nga pushteti Millosheviçi dhe në fund edhe e likuidoi fare, sqarim i B.Rr.) atë e dënoi publikisht (memorandumin, vërejtja e B. Rr.) dhe e vlerësoi të rrezikshëm për nga qasja ndaj krizës jugosllave dhe për zgjidhjet e ofruara. Duke cituar fjalimin e tij publik, që iu kushtua atij

do të jetë ndër udhëzuesit apo platforma kryesore e krijimit të politikave serbe në fazat e mëtejme të shkatërrimit të Jugosllavisë dhe me tendenca të krijimit të Serbisë së Madhe sipas parullës “të gjithë serbët në një shtet” apo “aty ku ka varre serbe, është tokë serbe”.¹³³ Pasojat e zbatimit praktik të memorandumit fillimisht i bartin shqiptarët e Kosovës, për të vazhduar më tutje në trojet e tjera të ish -Jugosllavisë, në veçanti në Kroaci dhe në Bosnjë dhe në Hercegovinë.

2.2. Strategjia e Millosheviçit për të asgjësuar pozitën kushtetuese të shqiptarëve të Kosovës

2.2.1 Kush ishte Millosheviçi?

Ka lindur në Pozharevac, me 20 gusht 1941, nga babai Svetozar Millosheviç, një prift ortodoks që kishte qëlluar veten duke u vetëvrarë dhe nga nëna Stanislava Millosheviç (Resanoviç) një mësuese, e cila gjithashtu bëri vetëvrasje. U diplomua në drejtësi dhe karrierën e ka filluar në biznesin bankar deri në vitin 1983 kur është futur në politikë. Ngritja e tij e madhe fillon në vitin 1987 duke shfrytëzuar krizën e Kosovës, e cila do të bëhet trampolinë e ngritjes së tij politike, por edhe vendi që e zbriti nga majat duke e dërguar në Gjykatën e Hagës për t’u gjykuar për krime kundër njerëzimit dhe ku në një qeli u gjet i vdekur, pa përfunduar gjykimi.

Nacionalizmi në Serbi kishte marrë përmasa, siç është parë, para ardhjes së Millosheviçit në krye të partisë serbe. Mentori i tij politik, Ivan Stamboliq, kishte nxitur lëvizje të tilla, si shef i Partisë Komuniste (1984 -1987) dhe President i mëvonshëm i Serbisë (1987-1988): ai punonte për heqjen e autonomisë së dy krahinave dhe mbronte raportimet gjithnjë e më antishqiptare në medium.¹³⁴ Atmosfera, klima dhe terreni për të zhvilluar politikë, sidomos antishqiptare/antikosovare u krijua pas demonstratave të 81-shit dhe Kosova vetëm po bëhej terren i pjellshëm për ngritje politike. Sa më radikal të paraqiteshe, sa më shumë masa drastike propozoje, sa më shumë retorikë antishqiptare të zbatoje, aq më shumë ngriheshe në pozitë. Në

Memorandumi, gazeta “Politika” me titull të madh e citoi: Memorandumi i ASSHA-së është in memoriam për Jugosllavinë”, tha Stamboliq dhe e vulosi fatin e vet si politikan, madje edhe si njeri. Marrë nga: Ekrem Avdic&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë - Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq. 276.

¹³³ Këto janë parulla politike që do të dëgjohen gjatë shumë viteve në forume dhe jashtë forumeve serbe; në demonstrata dhe mitingje serbe etj., kur po kërkoheshin të zbatohen pikërisht kërkesat dhe udhëzimet e memorandumit.

¹³⁴ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.239.

Serbi ishin bërë të gjithë një: Kosova duhet rrënuar. Nuk ka rëndësi çmimi dhe nuk kanë rëndësi mjetet e përdorura. Në Serbi kishte konsensus të plotë lidhur me Kosovën. Këtu do t'i gjeje bashkërisht: komunistë e çetnikë; nacionalistë e demokratë në emër ; shkrimtarë e artistë, poetë e priftërinj, akademikë e punëtorë. Të gjithë. Unitet gjithëkombëtar serb. Të gjithë një, por dallonin në qasje. Dallim në qasje kishte edhe Ivan Stamboliq. Çështjen e Kushtetutës ai dëshironte ta zgjidhte përmes rrugës legale. Ai mbështetej në pasuesin e tij Slobodan Millosheviç...¹³⁵, i cili, pas disa vitesh supozohet të ketë dhënë urdhër që ky të likuidohej në vitin 1999. Lidhshipi serb mobilizoi opinionin publik nën sloganin "s'ka forcë që ta ndalojë Serbinë nga unifikimi".¹³⁶ Është me rëndësi të bëhet një përzgjedhje e disa momenteve - ngjarjeve kyçe, të cilat nxjerrin në pah unitetin e të gjitha forcave serbe, në frymën e nacionalizmit dhe sidomos në frymën e luftës kundër shqiptarëve dhe kundër Kosovës, përfshirë Partinë Komuniste e cila për një kohë të shkurtër tentonte të fshihej prapa disa parullave të kinse bashkim - vëllazërimit. Por në esencë kjo shumë shpejt del jo e vërtetë, sepse elitat serbe kishin vendosur, të gjithë në një, të rreshtoheshin në platformën e krijimit të Serbisë së Madhe. Disa deklarata si kjo e Bogdan Trifunoviçit, ish - funksionar i lartë serb: "ne në Serbi, para pak kohe jemi takuar me një demonstrim të tillë të nacionalizmit serb. Ky është i ashtuquajtur i memorandumi".¹³⁷ Ky funksionar memorandumin e quan me emër të vërtetë, por pas një kohe shumë të shkurtër vihet edhe vetë në shërbim të zbatimit të tij. Pak ditë më pas Millosheviçi do të deklaronte: "...lidhur me atë se çka po ndodhë në akademi, ne kemi marrë qëndrime të qarta. Kjo nuk është kontestuese. Kurse komunistët në Akademi kanë marrë detyra sesi duhet luftuar për t'u ndryshuar kjo gjendje".¹³⁸ Pas fare pak ditësh, kur aktivitetet e serbëve dhe të malazezëve që kishin filluar të manifestonin forma të ndryshme "revolte ndaj gjendjes së rëndë", Slobodan Millosheviçi do të gjendet në Kosovë më 24.04.1987, si Kryetar i Komitetit Qendror të PKS-së. Në mitingun protestues të serbëve në Fushë Kosovë, ai i drejtohet masës së serbëve protestues me fjalinë e tij të famshme: "Askush nuk guxon t'ju rrah". Dhe ky do jetë momenti, ku fillon ngritja e madhe e Millosheviçit, që kohë më parë, në mbledhjen VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Serbisë, ishte zgjedhur Kryetar duke e mundur ish - mentorin e tij politik, Ivan Stamboliqin. Ky është momenti kur Millosheviçi nisi një valë nacionaliste serbe nëpërmjet

¹³⁵ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.239.

¹³⁶ G.Richard Jansen, <http://amar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.7, (qasur me 29.12.2013).

¹³⁷ E përditshmja me ndikim "Politika", 07.01.1987.

¹³⁸ Po aty.

së cilës forcoi pushtetin e tij, dhe kjo rezultoi me luftëra në Kroaci, në Bosnjë dhe në fund edhe në Kosovë dhe me pavarësinë e Kosovës.¹³⁹ Nga fjalimi i Fushë Kosovës ngjarjet zhvillohen me një ritëm më të shpejtë në kontekst të veprimeve kundër autonomisë së Kosovës, të cilat shoqërohen me masa të ashpra antishqiptare, duke mos lënë anash projektin serb të Serbisë së Madhe. Millosheviçi me retorikën e vet dhe me premtimet nacionaliste, te populli serb përgjithësisht, dhe në Kosovë në veçanti shndërrohet në një ikonë nacionale. Kurse te bashkësia ndërkombëtare ai herë - herë është paraqitur si lojtar apo faktor kyç, por në fund ai do të merrte emrin e vërtetë, atë duke filluar nga të trajtuarit si nationalist dhe serbomadh e deri te “Millosheviçi është gënjeshtar i lindur”.¹⁴⁰ Ai bëhet faktor i fuqizimit të unitetit serb në një platformë të vetme. Ndikimi i tij në të gjitha strukturat e Serbisë ishte i pakontestueshëm dhe me shpejtësi fillon ta shtrijë ndikimin e tij edhe në të gjithë Jugosllavinë, që po luhatej dhe që po vlonte nga sulmet e nacionalizmit serb dhe nacionalizmave e lëvizjeve mbrojtëse. Ai ia doli të gërshetonte mirë profilin e mbrojtësit të kombit serb me imazhin e reformatorit politik dhe ekonomik. Ngjarjet e Kosovës ishin një “kornizë” ideale për këtë.¹⁴¹

Gjatë verës së vitit 1987 debatet për Kosovën nxehen së tepërmi, kurse për herë të parë në Pejë mbajti mbledhje Sinodi i Kishës Ortodokse Serbe dhe kërkoi që kisha të kthejë në Kosovë “popullin e shpërngulur”. Nacionalizmi serb, i gërshetuar me populizmin social dhe i mbështetur nga mediet, nga shkrimtarët dhe nga kisha ortodokse, u kthye në një potencial të madh mobilizues.¹⁴² Në anën tjetër Millosheviçi i forcon radhët e veta brenda Partisë Komuniste serbe duke i vënë institucionet më të rëndësishme në shërbimin ekskluziv të tij, dhe duke larguar ata pak oponentë që kishin mbetur për të kundërshtuar politikën që tash po ndiqej po nga ai. Mediet edhe ashtu kishin pranuar kursin nationalist, kurse Radiotelevizioni serb vihet nën kontroll të plotë të Millosheviçit. Ndonjë eksese i çfarëdo lloji që mund të ndodhte dhe që kishte ngjyra ndëretnike në Kosovë, bëhej shkas për mitingje, protesta, demonstrata dhe kërkim masash kundër “veprave të nationalistëve dhe separatistëve shqiptarë”.¹⁴³ Shumë eksese mendohet të

¹³⁹ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.71.

¹⁴⁰ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare, Autobiografi*, Dudaj, Tiranë, 2004, fq.454.

¹⁴¹ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, Koha, Prishtinë, 2002, fq.45.

¹⁴² Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, 2002, fq.46-47.

¹⁴³ Është vënë nën thonjëza, sepse çfarëdo veprë, çfarëdo akti nga shqiptarët, merrte epitetin vepër e nacionalizmit ...etj., shqiptar. Nëse quheshe, për shembull, Kadri Rrapushi dhe nënshkruaje diku me inicialet KRR, kjo do të gjykohej si vepër e nacionalizmit shqiptar, sepse inicialet sipas tyre tregonin shkurtësinë për Kosova Republikë.

kenë qenë të orkestruara dhe ky supozim mbetet si i tillë, sepse rrethanat kurrë nuk janë sqaruar. Një ngjarje e rëndë transmetohet se me datën 02.09.1987 një i ri shqiptar, që po kryente shërbimin ushtarak në Paraqin (Serbi), kishte vrarë 4 ushtarë dhe kjo do të shërbejë si pretekst për fushatë antishqiptare të përmasave të papara. Një student i drejtësisë, Aziz Kelmendi, që la përkohësisht studimet për të kryer shërbimin ushtarak sipas asaj që jepte media e kohës, ka vrarë ushtarët, që nuk ishin vetëm serbë. Rasti siç transmetohej, ishte një vrasje makabre, por ata që i njohin rrethanat e asaj kohe brenda armatës jugosllave, kanë ngritur shumë pyetje, për të vënë në dyshim vërtetësinë e ngjarjes. Atëbotë të rinjve shqiptarë në shërbim ushtarak vështirë t'u jepeshin armë. Aq më tepër armë të mbushura me municion . Por, me këtë rast, nuk do jap argumente të tjera të shumta, që përdoren jo vetëm në Kosovë, por edhe në vende të tjera të -ish Jugosllavisë, të cilat shkojnë në favor të supozimeve se versioni zyrtar i rastit është pak i besueshëm. Sidoqoftë ky rast ndez edhe më shumë atmosferën politike, sidomos në raport me Kosovën dhe propaganda antishqiptare fryhet edhe më tepër. Në anën tjetër krahas masave politiko-partiako-shtetërore shtohen edhe më shumë veprimtaritë e organeve policore dhe të sigurimit shtetëror. Secili në Kosovë ishte në shënjestër për policinë dhe për sigurimin, e më së paku e priste ishte marrja në pyetje informative.¹⁴⁴

Milloseviçi fillon spastrimin e organeve partiake të Kosovës, edhe pse ato nuk shquheshin për veprime të forta kundërshtimi ndaj kësaj politike. Kjo arsyetohet me pasojat që do të vinin më pas. U larguan nga partia edhe themeluesit e Jugosllavisë, siç ishte lideri politik dhe krahu i Titos, Fadil Hoxha. Për Milloseviçin nuk ishte me rëndësi nëse e gjithë kjo që

¹⁴⁴ Rasti i Aziz Kelmendit, ishte një pretekst, kur autori i punimit ishte intervistuar nga oficerët e sigurimit shtetëror. Kjo nga shkakut se në atë kohë po ushtroja funksionin e prodekanit student në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Një ndër detyrat, në bazë të funksionit që ushtroja, ishte ndarja e vendeve për studentët në konvikte. Bazuar në këtë, një vit më parë kisha mundësuar strehimin e tij në konviktin e studentëve. Kjo do të jetë shkas që unë t'i nënshtrohem një torture psikike, vështirë të përshkruhet, sepse sipas tyre unë kisha dorë në krimin e bërë në Paraqin. Strehimi i tij në konvikt, sipas oficerëve të sigurimit ishte parakusht për shkollimin e tij dhe për përgatitjen që ai të vrasë njerëz në të ardhmen. Deri këtu shkonte imagjinata e sigurimit, sa ishin në gjendje të fabrikonin dhe të sajnin diçka që vështirë mendja e shëndoshë e dikujt mund ta konceptonte. Edhe sot të duket e dhimbshme se deri në çfarë çmendurie kishin shkuar oficerët e hipnotizuar nga nacionalizmi ekstrem, sa që në gjendje të dehur, intervistonin dhe kërcënonin një të ri, siç isha unë, pa zgjedhur fjalë dhe as fjalor ofendimesh e kërcënimesh, që unë as sot e as kurrë nuk mund t'i transmetoj tek të tjerët. Nga turpi dhe nga dëshira që ato të mbesin brenda mureve të vendit ku po intervistohesha. Sepse është vështirë që lexuesi të mos preket edhe sot nga emocionet. Por, cila ishte atmosfera e intervistës, ku i nënshtroheshe gjithfarë ofendimesh, kërcënimesh me likuidim, vrasje të anëtarëve të familjes, etj., në fund të fundit është pak e rëndësishme të përshkruhet. Ajo që duhet vënë në pah, është fakti se të gjithë ishim në shënjestër. Të gjithë duhet të frikësoheshim. Të gjithë ishim të stigmatizuar. Të gjithë duhet të prananim të vërtetën serbe, sepse s'kishte të vërtetë tjetër. Në të kundërtën gjithçka mund të ndodhte me ty. Dhe këtë ata donin të ta bënin me dije. Në çdo kohë.

aplikohej në Kosovë, ishte e pranueshme për shqiptarët. Ai kishte përcaktuar që të mobilizonte masat serbe, të cilat dukeshin sikur të hipnotizuara ndaj vozhdit që ishte krijuar apo që kishte ardhur “sikur të zbriste nga lart”, dhe ishin gjithnjë të gatshme të organizoheshin në mitingje që ishte bërë shprehi të quheshin “mitingje të së vërtetës”. Millosheviçit i pëlqente shumë udhëheqja e politikës në rrugë, nëpërmjet mitingjeve dhe manipulimit të masave.¹⁴⁵ Sesa ishin mitingjet të vërteta, tregojnë pasojat. Serbët e Kosovës bëhen pjesa më radikale e lëvizjes nacionaliste dhe në Fushë Kosovë u krijua një lloj qendre që shërbente si forcë motorike e gjithë kësaj lëvizjeje. Thuhej se ishin autoktonë në zhvillimin e ideve dhe të lëvizjeve, por në fakt qendra prej nga dirigjoheshin ishte Beogradi dhe vetë Millosheviçi, tash së tepërmi i forcuar politikisht. Atij i interesonte që populizmi i tij të forcohej krahas fuqizimit në të gjitha strukturat partiake dhe shtetërore. Çdo pengesë që parashihte se do t’i dilte në radhët e partisë dhe do të eliminonte sipas “kërkesave të popullit”, dhe “mitingjet e së vërtetës” menjëherë do të “vetorganizoheshin”. Kur atmosfera e ndezur nga poshtë kishte siguruar përkrahje që askush s’e kishte më parë, ai do tentojë që projektin e vet ta kanalizojë brenda institucioneve të sistemit. Projektioni ishte Jugosllavi nën diktatin serb, apo Serbi e Madhe. Pengesë për këtë ishte krijimi edhe i një rruge me ngjyra legale dhe kushtetuese. Duhet ndryshuar kushtetuta. Dhe në Serbi ishte propozim totalisht i pranuar se Kushtetuta duhet ndryshuar. Mitingjet serbe këtë pajtim e shprehnin çdo ditë. Tash duhet vepruar edhe në rrugë legale, përmes institucioneve. Dhe aty ku paraqiten rezistenca, vepron populli i mitingjeve. Kështu Kryesia e Serbisë, me datë 07.01.1988 merr iniciativën për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë e cila prej kohësh kishte bashkëpunim të ngushtë me Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, këtë e shohim edhe publikisht, kur gjatë ditëve 17-19 maj 1988 mbahet një takim shkencor i përbashkët në mes të autoriteteve serbe dhe Akademisë, lidhur me një projekt të përbashkët, të titulluar “Problemet aktuale kushtetuese dhe ndryshimet kushtetuese”. Duke filluar prej këtu, çdo gjë dhe çdo bashkëpunim mes institucioneve dhe Akademisë bëhet publikisht. Dhe veprimet brenda institucioneve marrin një ritëm të përshpejtuar. Me vendim të Kryesisë së Serbisë, me datën 28.03.1988 themelohet Komisioni për Reformë Ekonomike me në krye Millosheviçin, ndërkohë që në diskutimet për ndryshimet kushtetuese përfshihen edhe Shoqata e Shkrimtarëve Serbë, Shoqata e Sociologëve dhe Shoqata e Filozofëve Serbë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë në mbledhjen

¹⁴⁵ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq. 273.

vjetore, të mbajtur në maj të vitit 1988, aprovon “përpyjekjet dhe propozimet” e udhëheqësisë serbe “qëllimi i të cilave është gjetja e rrugës për dalje nga kriza”.¹⁴⁶ E para që duhej bërë tani ishte heqja e autonomisë së dy krahinave dhe duke bërë përpjekje që kjo të bëhej brenda institucioneve të sistemit. Me këtë mendohej se do kishte përkrahje nga pjesët tjera të Jugosllavisë, por edhe përkrahje ndërkombëtare. Apo së paku mendohej se nuk do të kishte kundërshtime. Por tubimet apo mitingjet serbe mbesin patjetër në dispozicion, për çdo situatë dhe për çdo kohë. Midis qershorit 1988 dhe pranverës së vitit 1989 u zhvilluan më se 100 mitingje, në të cilat morën pjesë gjithsej 5 milionë vetë.¹⁴⁷

Këto mitingje që nuk ishin veçse tubime të orkestruara, të mirorganizuara dhe të gjitha të financuara nga buxheti i shtetit, ishin shprehje e shpërthimit të lëvizjes nacionaliste, ku të gjithë ishin armiq; ku populli serb madhërohej duke u quajtur “popull qiellor” e të tjerët ofendoheshin me fjalorin më të ulët të mundshëm; ku kërkoheshin armë për luftë; ku shpaleshin programe për territore dhe shpërngulje me dhunë të të tjerëve; ku fajtorë për fatkeqësinë e popullit serb ishin ustashët kroatë, ballistët shqiptarë, autonomashët hungarezë ,Vatikani, e kush jo tjetër. Kundër popujve të tjerë edhe “shkenca” serbe ishte vënë në shërbim. Kolegu i Dobrica Qosiqit, Millorad Ekmeçiç nga Sarajeva, publikisht do të zhvillojë teorinë e vet që “serbët janë popull historik, kroatët johistorik, ndërkaq boshnjakët nuk janë popull”.¹⁴⁸ Në gjithë këtë gjurulldi tubimesh e shpërthimesh, Millosheviçit i thureshin ode, edhe pse kurrë nuk i kishte dënuar shpërthimet nacionaliste ekstreme, për më tepër ai këtyre iu jepte forcë, ashtu si benzina flakës, ndërkohë që ishte me plot gojë për të përmendur dhe sulmuar nacionalizmat e tjerë, që edhe pse po paraqiteshin në territoret e Jugosllavisë si refleksion vetëmbrojtjeje. Ai nuk reagon as kur të tjerët ofendohen tepër ulët, si bie fjala për lindshmërinë e lartë të shqiptarëve në Kosovë. Parullat fashiste dhe tejet të ulëta, kur nënat shqiptare të Kosovës po quheshin “makina që pjellin” nuk i bënin përshtypje, sepse edhe këto parulla mund të paralajmëronin masa të mundshme antishqiptare edhe për këtë meritë të këtyre nënave. Për më tepër në një intervistë, lidhur me këtë ai do deklarojë: ”Siç dihet, lindshmëria në Kosovë është ndër më të mëdhatë e botës. Më i lartë se edhe në vetë Shqipërinë. Kjo temë tabu vetëm tash së fundi ka filluar të bëhet objekt

¹⁴⁶ E përditshmja Politika, 27.05.1988.

¹⁴⁷ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999, Koha, Prishtinë, fq.47.

¹⁴⁸ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912 – 2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq. 281.

shqyrtimi. Lindshmëria po merr edhe aspekte të theksuara politiko-shoqërore. Popujt, që jetojnë me shqiptarët, bëhen pakicë dhe humbin territorin dhe hapësirën jetësore. Deri ku mund të na çojë kjo, nëse nuk ndërmerret diçka...”.¹⁴⁹ Me këtë mesazh adresuar popullit serb ai ngjall frikë, kurse te shqiptarët po ashtu paralajmëron mundësi për masa edhe në këtë aspekt.

Veprimet në dy kanale ato përmes rrugës dhe përmes institucioneve për nga qëllimi nuk dallojnë aspak. Dallohet vetëm forma e manifestimit dhe modifikimi i fjalorit të përdorur brenda institucioneve, jo në kuptim përmbajtësor, por në kuptim të mospërdorimit të ndonjë fjale që dëgjohej/shin në mitingje, të cilat asnjë shoqëri normale nuk do t’i lejonte që të përdreshin.

Kuvendi i Serbisë, aprovon projektpropozimin e amendamenteve të Kushtetutës serbe, me datë 25.07.1988. Kjo rrugë e ndryshimeve kushtetuese shtyhej nga Milosheviçi, pa marrë parasysh nëse të tjerët do të pranonin. Për një kohë të caktuar në strukturat politiko - partiake të Vojvodinës nuk po vërehej ndonjë disponim për t’u pajtuar me ndryshimet e iniciuara nga establishment politiko - shtetëror serb. Vërehet një rezistencë, ndërsa në Kosovë ekziston një gjendje ankthi dhe heshtjeje, që nuk është se s’mund t’i parashihej fundi. Strategjia e Millosheviçit ishte që çdo gjë të bëhet brenda institucioneve dhe aty ku ka rezistencë, me ndihmën e mitingjeve dhe mitinggjinjëve të imponohej ndërrimi apo shkarkimi i bartësve të funksioneve apo anëtarëve të tyre. Kështu, meqë rezistenca në Vojvodinë kundër ndryshimeve kushtetuese, sipas kërkesave të Serbisë ishte e dukshme, mekanizmi i mitingjeve u vu në lëvizje dhe me 5 tetor të vitit 1988 udhëheqësia e Vojvodinës u detyrua të dorëhiqej sipas asaj që njihet si “jogurt revolucioni”.¹⁵⁰ E njëjta strategji e organizimit dhe e përdorimit të masave përmes mitingjeve përdoret edhe për rrëzimin e udhëheqësisë së Malit të Zi, të cilët rezistuan një kohë, por nuk patën forcë të qëndrojnë më shumë se edhe disa muaj. Edhe atje nën presionin e rrugës udhëheqja e Podgoricës detyrohet të dorëhiqet në janar të vitit vijues. Me këtë Vojvodina dhe Mali i Zi, që të dyja njësi të barabarta federative, humbin udhëheqësinë legjitime dhe vihen nën udhëheqjen e qeverive kukulla të Millosheviçit. Duke vepruar në këtë mënyrë Millosheviçi po realizonte atë që më së shumti i interesonte: sigurimin e votave në institucionet federative. Në një situatë të tillë duhej vepruar edhe në Kosovë. Dhe atje u kuptua mirëfilli se Millosheviçi do të shkonte deri në fund. Millosheviçi vazhdonte me rrugën e tij drejt largimit të liderëve partiakë

¹⁴⁹ Revista NIN, 03.07.1988.

¹⁵⁰ U quajt kështu, ngase mitinggjinjët, qëllonin institucionet dhe zyrtarët vojvodinas me jogurt.

kosovarë, të cilët e kishin të qartë se duheshin kundërshtuar ndryshimet që sa po vinin e po imponoheshin. Kështu liderët partiakë, sidomos Azem Vllasi dhe Kaçusha Jashari, u shquan në këtë fazë për përpjekjet e tyre për ruajtjen e autonomisë së Kosovës, kurse në shenjë kundërshtimi për ndryshimet kushtetuese organizohen demonstrata dhe më vonë greva. Demonstratat e shqiptarëve fillojnë me marshin e minatorëve të Trepçës të cilët, nga Mitrovica, nisen për në Prishtinë, dhe vazhdojnë me marshe të tilla ecjesh në këmbë në të gjitha qendrat e Kosovës në drejtim të Prishtinës. Në nëntor të vitit 1988 minatorët e Trepçës marshojnë 55 kilometra nga Mitrovica për në Prishtinë në temperaturë të ulët afër ngrirjes duke kundërshtuar largimin e liderëve partiakë. Në Prishtinë atyre iu bashkohen punëtorë fabrikash dhe studentë. Ata mbajnë flamuj jugosllavë dhe shqiptarë si dhe fotografi të Titos për të mbrojtur Kushtetutën. Brohorasin sloganet “vëllazërim- bashkim” madje edhe “jetë të gjatë për popullin serb”(për të treguar se nuk janë antiserbë).¹⁵¹

Këto ishin demonstrata me një ikonografi jo të zakonshme. Duke qenë së për një kohë të gjatë shqiptarët nga mediet serbe ishin përshkruar si kundërrevolucionarë, dhunues, kundërshtarë, antiserbë, etj., dhe duke qenë se Kosova për një kohë ishte vënë në mbrojtje pikërisht nga këto shkaqe; në demonstrata do të shohim flamuj jugosllavë, fotografi të Titos, parulla për vëllazërim-bashkim dhe të ngjashme me to, ndërsa makineria serbe me ikonografi nacionaliste, me mitologji dhe madje edhe me bartje eshtrash të Car Lazarit gjithandej, dhe me propagandë fashiste e deri te kërkesat për armatime kërkonte rrënimin e statusit të Kosovës. Në anën tjetër me ikonografi internacionaliste, me flamuj të shtetit, i cili dukej qartë se po shkatërrohej, me fotografi të Titos që të gjithë po e fajësonin, me tendencë të mbrojtjes së vlerave të socializmit, po bënin përpjekje të ruanin atë që me vështirësi dhe me përpjekje të mëdha ishte arritur. Nonsens, që del i kuptueshëm nga vetë veçantitë e krijimit dhe të procesit të shkatërrimit të një Federate, në të cilën ishin futur “vullnetarisht” pas Luftës së Dytë Botërore. Sidoqoftë, përkundër demonstratave që shprehin një vullnet gjithëpopullor, edhe udhëheqësit partiakë shqiptarë iu nënshtruan presionit serb dhe Azem Vllasi e Kaçushi Jashari u larguan, me çka Millosheviçi arriti që në krye të Lidhjes Komuniste të Kosovës të vendoste një marionetë që mbante mbi supë përgjegjësi për shumëçka që kishte ndodhur kundër shqiptarëve në Kosovë, nga shkakut se kishte qenë shef i policisë. Atij iu bënë krah edhe figura shumë të komprometuara, Ali

¹⁵¹ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.13, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

Shukrija dhe Husamedin Azemi. Millosheviçi me ndërrimet në kreun partiak të Kosovës përgatiti fazën e fundit për të imponuar ndryshimet kushtetuese me çka statusi i Kosovës po shkonte drejt rrënimin total. Megjithatë minatorët e Trepçës më 20 shkurt 1989 kishin hyrë në grevë urie¹⁵², studentët e Universitetit të Prishtinës dhe punëtorët ndërmarrin edhe një përpjekje të dytë për të mbrojtur Kosovën, kur strukturat kukulla dhe marioneta të Kosovës po zbatonin politikën e Millosheviçit për pastrim të institucioneve përmes procesit të përsëritur të diferencimit dhe të ndjekjes, të, siç thuhej, organizatorëve dhe inspiratorëve të demonstratave të fundit. Kështu minatorët e Trepçës do të ngujohen në zgafellat e horizonteve të thella të Trepçës, kurse studentët dhe gjithë populli po i jepte përkrahje kësaj greve që dukej se nuk kishte ndodhur ndonjëherë në ndonjë vend. Ishte grevë urie dhe qëndrueshmëri stoike me kërkesë dorëheqjen e Rrahman Morinës, Ali Shukrisë dhe Husamedin Azemit, që në vetëvete, në fakt ishte refuzim i ndryshimeve kushtetuese që tash ishin afër pëlqimit nga marionetat që kërkohej të largoheshin.

Greva e minatorëve të Trepçës merr përmasa të papara ndonjëherë në botë, sepse ishte shndërruar në një grevë urie në të cilën shumë shpejt mund të vdisnin të gjithë. Kjo grevë do të gëzojë përkrahje totale në Kosovë, përmes një solidariteti krejtësisht sui generis. Greva e minatorëve, sipas Milan Kuçanit, “po mbronte themelet e Jugosllavisë së KAÇKJ-së”.¹⁵³ Dhe me të vërtetë sikur forcat jonacionaliste të mobilizoheshin në mbrojtje të Kosovës, nuk është se mund të shpëtohej Jugosllavia, por gjithsesi procesi i shkatërrimit të saj do të shkaktonte shumë më pak pasoja. Disa nga njësitë federative mbanin qëndrim neutral ndaj dhunës dhe trysnisë në Kosovë dhe ndaj Kosovës, sepse mendonin se Serbia do ta ndalonte dhunën në Kosovë dhe nuk do t’i shqetësonte edhe ato, por kjo rezultoi se ishte e gabuar; ngjarjet e mëvonshme vërtetuan të kundërtën - Serbia nuk do t’i linte edhe këto njësi federative të qeta.

Sidoqoftë, nën presionin e opinionit publik, jo vetëm kosovar, se në Kosovë po ndodhte tragjedia, tre funksionarët kukulla/marioneta kosovare pranuan të jepnin dorëheqje, dorëheqje që rezultoi se ishte falso dhe se këtu po ndodhte edhe një tradhti, siç ata dinin të bënin. Është e qartë se këta funksionarë ishin marrë vesh me Millosheviçin, që sapo të qetësohej situata dhe sapo të

¹⁵² Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912 – 2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.313.

¹⁵³ Milan Kuçani ish - lider komunistë dhe kryetar i Republikës së Sllovenisë edhe postkomuniste, shquhej si një ndër politikanët më të shkathët dhe më të ngritur të ish -Jugosllavisë. Me 27.02.1989 kur greva e minatorëve po shkonte drejt një tragjedia ku potencialisht të gjithë minatorët mund të vdisnin. Në këto rrethana, në Cankarjev Dom – Lublanë organizohet një tubim përkrahjeje për Kosovën dhe Milan Kuçani gjatë fjalimit të tij të përkrahjes do të deklarohet edhe për mbrojtjen e Jugosllavisë dhe që minatorët po jepnin energjinë e fundit.

bindeshin minatorët që të dilnin nga zgafella, ata do t'i tërhiqnin dorëheqjet. Kjo ngase dorëheqjet e tyre do të thoshin “jo” ndryshimeve kushtetuese sipas projektit serb dhe vetëm mbetja e tyre në pushtet, ishte garanci për Millosheviçin që ndryshimet të realizohen përmes një procedure me ngjyra legale. Dhe vetëm duke i pasur këta në institucione dhe në krye të partisë, ndryshimet do të bëheshin me “pëlqim” të Kosovës. Dhënia e dorëheqjeve dhe tërheqja e tyre, sapo minatorët dolën nga zgafella, shënojnë një rast mashtrimi që rrallë mund të ketë ndodhur gjatë historisë. Tërheqja e dorëheqjeve bëhej, sepse Beogradi u deklarua se ato nuk do të pranoheshin. Kjo ndryshe klasifikohet si akt tradhtie ndaj interesave kombëtare, ndërkohë që kjo tradhti vihet edhe më tutje në funksion të Millosheviçit dhe të politikës së tij. Në Beograd, më 01.03.1989 organizohet një miting i madh, ku Millosheviçi me stilin e tij, i drejtohet masës, sipas zakonit duke kombinuar shkathtësitë retorike, shpirtin nacionalist dhe emocionet e popullit serb që po kapte zenitin dhe për më tepër, kërkesave për burgosje të Azem Vllasit dhe të tjerëve, ai do t'u përgjigjet me premtimin se, edhe kjo do të ndodhte. Në një gjendje shumë të tensionuar politike, në një gjendje para shpërthimit dhe nën presionin e Serbisë, Kryesia e Jugosllavisë më 03.03.1989 shpall gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Gjendja e jashtëzakonshme në rrethanat ku ndodhej Kosova i ngjante okupimit klasik, ku çdo gjë vendoset me instrumentet e dhunës dhe ku qytetari shqiptar shndërrohet në një objekt, kundër të cilit mund të përdoren kërbaç e plumb, kurdoherë që t'i teket pushtetit ushtarako-policor të vendosur në Kosovë. Me këto masa edhe në Kosovë po bëhej gati terreni për “dhënie pëlqimi” dhe po përgatitej rreshtimi në atë që po trazohej në zbatim të asaj që po e quajmë Strategji e Millosheviçit. E strategjia e Millosheviçit në fakt është program nacional serb i dizajnuar nga Akademia Serbe e Shkencave si rezultat i një konsensusi gjithserb. Millosheviçi si nacionalist, bankier dhe politikan, me shkathtësi të shquara retorike, duke qenë në të njëjtën kohë guximtar dhe arrogant, kap momentin për t'i prirë lëvizjes nacionaliste dhe shoviniste serbe, që për shumë vite, do të jetë fatkeqësia e popujve të ish -Jugosllavisë dhe në një masë edhe fatkeqësi e vet popullit serb. Por për ardhjen dhe fuqizimin e tij, kontribut të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kanë dhënë të gjithë ngapak. E ai do të vazhdojë me programin dhe strategjinë e tij, në çka besonte se do të realizohej deri në momentet e vdekjes së tij. U ngrit me mitin e Kosovës¹⁵⁴ dhe vdiq pa marrë dënimin e merituar pikërisht nga shkakut i Kosovës.

¹⁵⁴ Në fjalimin e tij gjatë kremtimit të 600 -vjetorit të Betejës së Kosovës, Millosheviçi duke iu drejtuar masës së madhe të serbëve të mbledhur, si një lloj profeti po paralajmëronte luftën, të cilën të tjerët nuk e besonin apo bënin

2.3. Ndryshimet e dhunshme të Kushtetutës së Kosovës

Kosova nën atmosferën e pushtetit ushtarak apo të gjendjes së jashtëzakonshme kishte “dhënë pëlqimin” që t’i bashkohej Serbisë Federale, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Disa dekada më vonë, në vitin 1981, Kosova do të futet sërish nën thundrën e gjendjes së jashtëzakonshme dhe së fundi, edhe më datën 23.03.1989, sipas votimit për pranimin e ndryshimeve të Kushtetutës së vitit 1974, Kosova sërish me dhunë humbet atë që me shumë mund, djersë dhe gjak e kishte fituar dhe që në të vërtetë i takonte. Dhe që të tria herët, masat e jashtëzakonshme përdoren pikërisht atëherë kur kërkohet avancimi dhe përmirësimi i pozitës së tyre.

Këto të fundit, të shpallura nga Kryesia e Jugosllavisë, shkaktojnë pasoja të tmerrshme dhe afatgjatë për popullin e Kosovës në të njëjtën kohë që përgatitin terrenin e ndryshimeve kushtetuese të imponuara, por që duhet të paraqiteshin të aprovuara legalisht. Dhe synimi pasues ishte që edhe me votat e Kosovës të realizohet projekti i Serbisë së Madhe, po të ishte e mundur brenda procedurave dhe institucioneve shtetërore.

Në mitingun e Beogradit, menjëherë pas grevës së minatorëve, që organizohet për të përgatitur terren për futjen e sërishme të Kosovës në gjendje të jashtëzakonshme, masa të cilat u vendosën nga Kryesia e RSFJ-së si e vetmja e autorizuar sipas Kushtetutës. Këto masa kanë vendimet shoqëruese për përdorimin e ushtrisë dhe të forcave shtesë të policisë nga i tërë vendi në ngulfatjen e vullnetit politik të shqiptarëve të cilët mbronin të drejtat e tyre dhe pozitën kushtetuese të Kosovës.¹⁵⁵ Në miting Millosheviçi paralajmëroi burgosje, dhe burgosjet u realizuan. U burgosën ish - lideri komunist, Azem Vllasi, disa njerëz kyç të menaxhmentit të Kombinatit Trepça dhe shumë të tjerë. Gjithsej 200 përfaqësues të elitës shqiptare u dëbuan në Serbi dhe atje u mbajtën në izolim, shpesh duke u poshtëruar dhe torturuar.¹⁵⁶ Çdo pjesë e shoqërisë kosovare tregoi solidaritet me minatorët e Trepçës dhe në këtë vazhdë solidarizimi u

sikur nuk e besonin. Beteja që ishte zhvilluar 600 vite më parë, ku kishte rënë sulltani turk, Murati dhe princi serb L Lazar, është përdorur si një ndër “argumentet” serbe për të treguar të drejtën e tyre historike mbi Kosovën, ku sipas tyre, humbja serbe ishte fitore e madhe, ndërkohë që në këtë betejë të dhënat reale historike dhe faktet shpjegojnë një të vërtetë krejtësisht tjetër, por që nuk është pjesë e këtij studimi. E vërtetë është se, sidomos në kohën e Millosheviçit kjo betejë shndërrohet në një mit dhe ikonografia, letërsia, historia, e të tjera, të nxjerra nga ky mit, prodhojnë fatkeqësi dhe “legjitimojnë” masa kundër tjerëve, veçanërisht kundër shqiptarëve. Këtë mit Millosheviçi e përdori për kohë të gjatë, por ky mit nuk i dha lavdinë që duket se e dëshironte më shumë se Car Llazari.

¹⁵⁵ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912 -2012*, Koha, Prishtinë 2013, fq.321.

¹⁵⁶ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.243.

përpilua Peticioni i Intelektualëve Shqiptarë, të cilin pushteti i masave të jashtëzakonshme, nuk do ta merrte aspak në konsideratë. Millosheviçi vuri nën kontroll të tij strukturat partiake të Kosovës dhe rrjedhimisht tash siguroi edhe kryepeshkop në Kryesinë e Jugosllavisë. Përfaqësuesi kosovar në Kryesi të Jugosllavisë u ndërrua duke sjellë një marionetë me emrin Sejdo Barjamoviç dhe kështu raporti në Kryesi të Jugosllavisë do të jetë: Serbia, Kosova, Mali i Zi dhe Vojvodina. Ndërkohë duke qenë edhe vetë të rrezikuara edhe Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina do të rreshtohen në favor të Serbisë, brenda Kryesisë së Jugosllavisë dhe kjo për një kohë të caktuar.

Në rrethana të një qetësie të dhunshme, në rrethana të kufizimit të të gjitha lirive, me orë policore, në rrethanat e kërcënimeve për të gjithë dhe pa përjashtim, më 23.03.1989 u mbledh Kuvendi i Kosovës për të dhënë pëlqimin në aprovimin e ndryshimeve kushtetuese, në Kushtetutën serbe dhe në Kushtetutën e Kosovës, me çka praktikisht u hoq autonomia e Kosovës. Pikërisht kjo ngjarje në rrjedhën e saj shpalos paralelet me një nënshtrim tjetër të njëjtë sikur me rastin e miratimit të ligjit autorizues, me të cilin Adolf Hitleri mori pushtetin absolut në vitin 1933, edhe në sallën e Kuvendit të Kosovës më: 23 mars 1989, në sallë ishin të pranishëm një numër masiv dhe kërcënues policie dhe shërbimi sekret, saqë vetëm 10 delegatë shqiptarë morën guximin të votonin “kundër”. Të tjerët, ndërkaq, ishin përcaktuar të abstenonin, por në votimin e manipuluar u numëruan vetëm votat përkrahëse dhe kundërshtuese. Këtu me të drejtë mund të flitet për një puç kushtetues.¹⁵⁷ Përpara kësaj mbledhjeje të Kuvendit të Kosovës, shumë delegatë shqiptarë u thirrën në “takime konsultative” nëpër komunat prej nga vinin dhe ishin “përgatitur” sesi duhej të votonin. Ndaj tyre, në këto “takime konsultative” ishin përdorur metoda presioni dhe shantazhi dhe iu ishte thënë troç: “ju duhet të votoni për ndryshimet në Kushtetutë dhe kjo është në të mirën tuaj”.¹⁵⁸ Ky ndryshim, kjo dhënie e pëlqimit tregoi në një

¹⁵⁷ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.243.

¹⁵⁸ B.N. një ish -delegat i Kuvendit të Kosovës gjatë intervistimit shprehet se: “...dy ditë para mbledhjes së Kuvendit të Kosovës u thirrëm në nivel komunal në një takim si përgatitje për mbledhjen e Kuvendit të Kosovës. Së pari na bënë me dije qëndrimet e organeve më të larta partiake dhe shtetërore, të cilat kishin marrë vendim që nga ne të kërkojnë aprovimin e ndryshimeve të Kushtetutës. Gjatë gjithë takimit nëpër sallën ku po rrinim silleshin oficerë të sigurimit shtetëror, të cilën sikur na e bënë me dije se prania e tyre nuk ishte e kotë aty. Atmosfera u ashpërsua kur ne nisëm të shprehim dilemat tona dhe kur ne shprehëm dyshimet se ndryshimet ishin në kundërshtim me qëllimet që proklamohen se do të arrihen...me një fjalë atmosfera në fund ishte në stilin ata që refuzojnë marrin përgjegjësinë për fatin individual të tyre, sepse shumica e delegatëve tashmë e dinë përgjegjësinë për të votuar dhe ata do të votojnë për ndryshimet kushtetuese. Ata që do të votojnë kundër vihen në pozita të nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar...të viheshe në pozita të tilla, bëheshe gati të ballafaqohesh me masat që të gjithë ju i dini... vendosa të shkoj në mbledhjen e Kuvendit duke mos pasur guxim dhe as besim të flisja me të tjerët për vendimin

mënyrë edhe ligësinë e përfaqësuesve të Kosovës në parti dhe në institucione shtetërore, ndërkaq nxiti sërish një shpërthim të masave popullore, duke shprehur refuzimin e ndryshimeve kushtetuese dhe duke kundërshtuar masat serbo-jugosllave. Masat antishqiptare ashpërsohen akoma më shumë kur në Kosovë sërish situata shpërtheu me demonstrata dhe manifestime të ndryshme kundërshtimesh të pushtetit serbo-jugosllav. Policët shqiptarë, që shërbenin në policinë e Kosovës, duke mos dashur të ushtrorin dhunë kundër bashkëkombësve të tyre, hoqën uniformat dhe i bashkëngjiten masave popullore në manifestimet e tyre për të ruajtur qenësinë e Kosovës që tashmë u zhbë me dhunë dhe në mënyrë krejtësisht antikushtetuese. Vendimi i nxjerrë në Kuvendin e Kosovës ishte krejtësisht kundërkushtetues, ngase: “e para...masat e jashtëzakonshme ishin në fuqi prandaj nuk ekzistonin kushtet e ushtrimit të funksionit të delegatit/deputetit të Kuvendit; e dyta, shumë anëtarë janë kërcënuar me pasoja serioze nëse nuk votojnë pro ndryshimit të Kushtetutës; e treta, nuk ekzistonte kuorumi në Kuvend - dy të tretat ishin të nevojshme për të kaluar një ligj kushtetues; e katërta, votat kurrë nuk u numëruan dhe e pesta, delegatët e Beogradit dhe agjentët e sigurimit shtetëror kanë marrë pjesë në votim.”¹⁵⁹

Në rrethana të tilla, ku gjendej Kosova dhe Jugosllavia, vetëm një gjë ishte e sigurt: Kosova dhe rrënim i pozitës së saj kushtetuese po shënonin vdekjen e Jugosllavisë. Vetëm kur ndodhi fenomeni Kosovë në përmasat dhe mënyrën siç po realizohej strategjia e Millosheviçit, në republika e tjera filluan të mendojnë ndryshe. Jo të gjitha njësoj, sepse secila kishte problemet e saj dhe Millosheviçi po tregonte vendosmërinë e tij për të shkuar me idenë e Serbisë së Madhe. Ndryshimet e dhunshme në Kosovë prishën balancin në Federatë, sanksionuar me Kushtetutën e vitit 1974. Sllovenët, sërish solidar me Kosovën në një anë tregojnë qartë se nuk do të pranojnë një federatë ku pas ndryshimeve të dhunshme, të mbivotoheshin në organe federative në saje të pushteteve marioneta në Kosovë, në Mal të Zi, në Vojvodinë dhe me Millosheviçin në Serbi. Ndërkohë në Kosovë veprimet e pushtetit serbo - jugosllav për të qetësuar situatën shkaktojnë dhunë dhe terror edhe më të rëndë. Në demonstrata ka shumë të vrarë, të burgosur, të plagosur, të rrahur, të keqtrajtuar, etj. Numri i viktimave dallon varësisht nga burimet. Serbët arrijnë homogjenizim të paparë në frymë dhe në bazë nacionaliste e shoviniste. Kjo ishte aq e shprehur

tim...kisha vendosur të abstenoja nga votimi dhe ashtu edhe bëra...në rrethana të asaj kohe, kjo më bëhej se ishte një zgjidhje më adekuate”.

¹⁵⁹ Paulin Kola, *In Search of Greater Albania* 2003, fq.180-181, cituar: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, Accordance with International Law of the unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of self-government of Kosovo, 17 July 2009, fq.40.

sa që gjatë ditëve kur shqiptarët po vriteshin, burgoseshin, dhunoheshin, e çfarë jo tjetër, ata më 28.03.1989 shpallin amendamentet në Kushtetutën e Republikës së Serbisë. Kuvendi aprovon amendamentet kushtetuese të Kushtetutës së Serbisë, e cila po i merrte të gjitha ingjerenat e Kosovës.¹⁶⁰ Por me këtë ata përfundimisht po shkëpusnin çdo lloj mundësie për ndonjë lidhje në të ardhmen me shqiptarët dhe me Kosovën. Mund ta mbanin Kosovën me tytën e pushkës, por jo përgjithmonë edhe pse luftën dhe tytën e pushkës kishin nisur ta përmendin dhe ta përdorin kohë më parë. Pushteti serb qetëson situatën për një kohë në Kosovë me anë të arsenalit ushtarako-policor, por nuk zgjidhi asgjë, pos që prodhon armiqësi. Dhe vendosin të përdorin dhunën. Të gjithë veprojnë në një frymë dhe në një klimë, ndërkohë që kishin nevojë të gjenin arsye të dhunës e tyre, për opinion të jashtëm, në radhë të parë. Tentonin të arsyetonin dhunën dhe masat. Kështu një ndër nacionalistët e përbetuar serb, akademiku Dobrica Qosiq, në një intervistë do të thotë:

*“ Kosova është problem i pazgjidhshëm. Autonomia e Kosovës i jep legjitimitet të plotë krijimit të shtetit të dytë shqiptar që mund të bashkohet me Tiranën kurdo që të dojë. Lëvizja shqiptare është para së gjithash lëvizje nacionaliste. Ose do t’u japim territorin dhe me këtë do të humbim edhe gjysmën e Maqedonisë, ose do të përdorim dhunën sikurse Izraeli. Kjo është rrugë e mundimshme që sjell dëme të mëdha”.*¹⁶¹

Kjo nuk ka nevojë për komente dhe interpretime. Luftë dhe dhunë ose humbim edhe gjysmën e Maqedonisë dhe ajo në fjalorin nacionalist është bukë e gatuar. Maqedonia është Serbe. Qosiqi jep intervistë një ditë para mitingut të madh serb, që do të mbahet në Fushë Kosovë me rastin e kremtimit të 600- vjetorit të Betejës së Kosovës, një beteje që serbët e kanë përvetësuar duke e shndërruar në mit dhe legjendë, që gjithashtu do ta keqpërdorin sidomos në dëm të Kosovës dhe të shqiptarëve. Në ceremoninë e kremtes së 600- vjetorit të Betejës së Kosovës, ku vlerësohet të kenë ardhur në Kosovë nga gjysmë milioni e deri në një milion serbë, përfundimisht Millosheviçi i paralajmëron të gjithë se beteja për krijimin e Jugosllavisë sipas projeksioneve të Serbisë vetëm sa ka filluar. Ai do të vazhdojë me:

¹⁶⁰ Me datë 28 shtator 1990 Kuvendi i Republikës së Serbisë në Beograd nxjerr Kushtetutën e re me të cilën autonomitë e Kosovës dhe të Vojvodinës shndërrohen në formë të autonomisë territoriale dhe atributet e shtetit iu merren krejtësisht.

¹⁶¹ Il Tempo, 27 qershor 1989 dhënë nga gazeta Borba me:07.0.1989.

*“gjashtë shekuj më vonë, sot sërish jemi në luftë dhe para luftërave. Ato nuk janë të armatosura, edhe pse nuk përjashtohen. Por pavarësisht se çfarë janë, ato nuk mund të fitohen pa vendosmëri, pa trimëri dhe pa viktimizim”.*¹⁶²

Mesazhi shumë i qartë: do të luftojmë edhe me armë. Dhe armët po përdorëshin sikundër po shpërndareshin. Serbët në Kosovë po armatoseshin nga pushteti i Millosheviçit. Miti serb vazhdon të keqpërdoret, siç është vënë re më lart për zbatim të projekteve, që pos fatkeqësive për popujt e tjerë do të shkaktojë pasoja edhe për popullin serb. Në Kosovë, duke u bazuar në “pëlqimin e dhënë” për ndryshime kushtetuese, u krijua baza juridike për nxjerrjen e ligjeve që aplikohen në të gjithë territorin e Serbisë. Tash Republika e Serbisë, Kosovën e trajton territor të vetin dhe Kosova duhet të harmonizojë tërë legjislacionin në bazë të Kushtetutës serbe. Dhe kjo fillon shumë shpejt. Kuvendi i Kosovës dha mendimin për nxjerrjen e mbi 60 ligjeve republikane që vlejné për të gjithë territorin e Serbisë, të cilat u nxorën në frymën e amendamenteve të aprovuara vitin e kaluar.¹⁶³ “Dhënia e pëlqimit” për amendamentet e Kushtetutës, siç vërehet e zhvesh tërësisht Kosovën nga çdo element shtetësie me tendencën që ajo të lihej vetëm si emërtim gjeografik. Masat për të shtypur shqiptarët pas “ndryshimeve” ishin edhe më lehta që të ndërmerreshin dhe të zbatoheshin. Tash merren vendime duke u bazuar në një “bazë juridike”.

Duhet thënë se deri në dhjetor të vitit 1989 në këtë frymë u nxorën pothuajse 40 ligje, kurse në muajt e parë të këtij viti edhe nja njëzet sish. Ligjet që i nxori Kuvendi i RS Serbisë janë: Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin e qytetarit, Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Administratën Republikane, Ligji mbi Punët e Brendshme, Ligji mbi planifikimin e familjes, Ligji mbi kufizimin e qarkullimit të patundshmërive, Ligji mbi mbrojtjen e përgjithshme popullore, Ligji mbi mënyrën e punës dhe organizimin e KE-së të Kuvendit të RS-së të Serbisë, Ligji mbi referendumin, Ligji mbi njësitë zgjedhore për zgjedhjen e delegatëve në Kuvendin e RS-së të Serbisë, Ligji mbi gjykatat e rregullta, Ligji mbi rezervat e mallrave, Ligji mbi ujërat, Ligji mbi tokën ndërtimore, Ligjim mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Penal, Ligji mbi rregullimin dhe mbi planifikimin hapësinor, Ligji mbi Prokuroritë Publike, Ligji mbi mbrojtjen e qytetarëve nga sëmundjet ngjitëse, Ligji

¹⁶² Revista Vreme, fjalimi i ribotuar në numrin 964 të datës:25.06.2009.

¹⁶³ Blerim Reka, *Vitet e shpresës*, Zëri, Prishtinë,1991.

mbi kundërvajtjet, Ligji mbi sistemin e planifikimit shoqëror dhe mbi planin shoqëror, Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi amnistinë, Ligji mbi sistemin shoqëror të informimit, Ligji mbi bartjen, Kadastrën dhe mbi rregullimin e të drejtave në patundshmëri, Ligji mbi tokën bujqësore, Ligji mbi zgjedhjet e bartësve të funksioneve që i emëron Kuvendi i RS-së të Serbisë, Ligji mbi kooperativat bujqësore, Ligji mbi veprimtarinë bibliotekare, Ligji mbi punën personale, Ligji mbi tatimet dhe kontributet e qytetarëve, Ligji mbi elektroekonominë e Serbisë, Ligji mbi veprimtaritë shoqërore, Ligji mbi sistemin e ligjeve, Ligji mbi hekurudhat, Ligji mbi blegtorinë, Ligji mbi peshkatarinë, Ligji mbi planifikimin e familjes dhe mbi kujdesin shoqëror të fëmijëve, Ligji mbi arsimin dhe edukimin fillor, Ligjin mbi arsimin dhe edukimin e mesëm, Ligji mbi shkollimin e lartë, Ligji mbi universitetin, Ligji mbi veprimtarinë shkencore hulumtuese, Ligji mbi kulturën fizike, Ligji për të mirat kulturore, Ligji mbi informimin publik, Ligjin mbi Pleqësinë e Arsimit të RS-së të Serbisë, Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore, Ligji mbi marrëdhëniet banesore, Libri mbi librat amzë, Ligji mbi duhanin, Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi festat shtetërore të RS-së të Serbisë, Ligji mbi dhënien me qira të ndërtesave dhe të lokaleve afariste.¹⁶⁴ Siç shihet, me një shpejtësi të madhe në të dyja parlamentet: të Kosovës dhe të Serbisë zhvillohet një proces i nxjerrjes së ligjeve me të cilat në një rën anë zhvishet Kosova nga qenësia e saj kushtetuese dhe në anën tjetër Serbia ngutet të legalizojë atë që me dhunë e ka bërë. Mëvetësia e Kosovës tashmë jo vetëm zbehet, por krijohet një gjendje kur Kosovës vetëm emri i mbetet autonomi. Lista e paraqitur e një numri ligjesh jep sqarim të mjaftueshëm për procesin e ngutshëm legjislativ, kurse ligjet e nënvizuara janë ato që thellësisht prekin mëvetësinë duke e bërë atë si diçka që i takonte së kaluarës. E këto “ligje” po godasin çdo fushë të jetës në Kosovë. Edhe ekonominë, gjithashtu. Kështu, për shembull, në periudhën 5.07.1990 deri me 4.04.1991 masat e dhunshme qenë ndërmarrë në 187 organizata, prej të cilave 116 ishin ndërmarrje ekonomike, kurse të tjerat institucione të shërbimeve shoqërore. Në ato ndërmarrje dhe institucione, që ishin ndërruar nga vendet udhëheqëse, 176 shqiptarë dhe në 160 kolektive drejtorë të dhunshëm qenë emëruar kuadro serbe dhe malazise, kurse për anëtarë të atyre organeve qenë emëruar 340 serbë dhe malazezë dhe 98 shqiptarë, shumica prej të cilëve nuk e patën pranuar detyrën dhe qenë zëvendësuar.¹⁶⁵

¹⁶⁴ Blerim Reka, *Vitet e shpresës*, Zëri, Prishtinë, 1991, fq.73-74.

¹⁶⁵ Esat Stavileci, *Vepra I, Kosova në ish – Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë 2013, fq.101.

Kur vështrohen me kujdes ngjarjet, faktet, marrëdhëniet brenda dhe jashtë Federatës Jugosllave dhe raportet dhe pozita që kishte Kosova në Federatë është vështirë të nxirret një përfundim për të thënë se çështjet kanë mundur të shkojnë ndryshe, sikur në Kosovë të kishte vendosmëri më të madhe. Pas vitit 1981 dhe shtypjes së demonstratave përmes masave të jashtëzakonshme, e vërteta serbe ka qenë dominante, e vërtetë të cilën në masë shumë të madhe e kanë pranuar të gjitha pjesët e tjera të Federatës. Për më tepër të gjithë kanë ndihmuar për të shtypur demonstratat dhe zbatimin e masave të jashtëzakonshme në Kosovë : politikisht dhe ushtarakisht. Është dashur të kalojnë disa vite që të mendohet ndryshe dhe që e vërteta serbe të trajtohet pak më ndryshe. Por ka edhe një të vërtetë. Janë republikat e veriut që megjithatë kanë përkrahur Kosovën dhe shqiptarët dhe kanë kundërshtuar propagandën serbe në fillim të viteve nëntëdhjetë, sidomos. Atje strehohen edhe të ndjekur politikë nga Kosova, por edhe lejohen që në një mënyrë të zhvillojnë aktivitete politike, të nxjerrin revista, të zhvillojnë aktivitete kulturore, të publikojnë nëpër gazeta dhe revista sllovene si Delo apo Mladina në Slloveni dhe kundërshtimi i politikës serbe përmes liderëve shtetërorë e politikë sllovenë në fund të viteve nëntëdhjetë ka qenë vendimtar. Në anën tjetër masat e dhunës si: burgosjet, vrasjet, maltretimet, vrasjet në ushtri, ndalimet, orët policore dhe propaganda shumë e ashpër serbe, kanë krijuar në Kosovë një atmosferë frike vështirë të shpjegueshme. Pastaj udhëheqësia komuniste e Kosovës, me përjashtim të individëve të caktuar deri vonë, nuk është këndellur dhe në masë të madhe nën trysninë serbe ka pranuar përkrahimin dhe kualifikimin e ngjarjeve sipas diktatit. Pak nga liderët komunistë shqiptarë të Kosovës kanë sakrifikuar maksimalisht: disa nga frika, të tjerët nga ideologjia. Disa nga të dyja. Kurse Serbia dhe lidhshipi politik dhe shtetëror kishte platformë dhe strategji të qartë. Kishte mekanizma shtetërorë krejtësisht të vënë në shërbim të strategjisë dhe për më tepër kishte një konsensus total nacional. Propaganda serbe ishte armë shumë e fuqishme dhe Akademia e Shkencave ishte krejtësisht në duar dhe në shërbim të lëvizjes nacionaliste serbe. U shkruan shumë libra, artikuj, analiza, fjalime, antishqiptare e të tjera, të cilat godisnin cakun, falë fuqisë së madhe që kishte televizioni serb, por edhe shtëpitë e mëdha botuese. Në anën tjetër diplomacia e Jugosllavisë dominohej nga serbët dhe e vërteta serbe depërtonte shumë më lehtë se e vërteta shqiptare. Edhe të pavërtetat më bizare bëheshin temë për botime librash të veçanta. Për shembull rasti Martinoviç. Gjorgje Martinoviç ishte një bujk serb 56 vjeçar (dhe nëpunës civil i armatës jugosllave) nga një fshat në rrethinën e Gjilanit, i cili gjoja kishte pësuar një sulm jashtëzakonisht të pakëndshëm dhe poshtërues. Më 01.05.1985, atë e

sollën me urgjencë në spitalin e Prishtinës , ku i hoqën një shishe nga bytha. Shishja ishte e thyer dhe plagët ishin shumë të rënda. Ai pohonte se atë e kishin sulmuar dy shqiptarë të maskuar në një arë afër shtëpisë së tij, të cilët pasi e kishin lidhur, e kishin plagosur në atë mënyrë . Më pas ai shtoi se motivi i tyre kishte qenë që ai të shpërngulej në mënyrë që t'i merrnin tokën...¹⁶⁶ Ky rast, që nuk ka dilemë të jetë i rëndë, ka shërbyer si burim shkrimesh që arritën një numër marramendës. Madje shkruhet edhe një libër me titullin “Sluçaj Martinoviç” me 485 faqe. Lidhur me këtë rast ka pasur debate në të gjitha strukturat partiake e shtetërore të të gjitha niveleve, deri edhe në Kuvendin Federativ. Por që të gjitha këto debate kanë përfunduar çuditërisht kur ka mbaruar debati lidhur me ndryshimet kushtetuese. Gjithashtu për këtë rast, në janar të vitit 1986 216 intelektualët më të shquar, përfshirë Dobrica Qosiqin, që ishte përjashtuar nga Komiteti Qendror në vitin 1968 nga shkak se favorizonte politikën e Rankoviçit në Kosovë, paraqesin një petition në Parlamentin federativ. Ata deklarojnë se “rasti Martinoviç është shndërruar në predikament për të gjithë serbët në Kosovë”.¹⁶⁷ Lidhur me bujkun Martinoviç ka edhe një të vërtetë, që është shumë më afër së vërtetës, por që kjo kurrë nuk ka arritur të dalë e barabartë në diskutime dhe publikime. Ky njeri fatkeq, sipas së vërtetës tjetër, në një akt vetëkënaqësie seksuale është dëmtuar në anus kur shishja i është thyer brenda. Ai bazuar në rrethana të një shoqërie të prapambetur çfarë ishte fshati i tij, nuk guxonte të turpërohej duke pranuar aktin si fatkeqësi në vetëkënaqësi. Prandaj duhej fabrikuar gënjeshtër. Nëse sulmuesit ishin të maskuar, pse ata domosdoshmërisht duhet të ishin shqiptarë. Pastaj, nëse i kanë bërë trysni për t'i marrë tokat, atëherë ai do t'i njihet dhe sigurisht do të lajmëronte për ta me emër, sepse në atë kohë, mjaftonte vetëm të ishte serb dhe i tërë mekanizmi shtetëror vihej në shërbim tënd. Së fundi rrethanat në vend të ngjarjes kanë treguar po ashtu diçka tjetër. Dhe edhe po të ishte sulmuar nga dy shqiptarë, si mund të kualifikohet vepra si vepër e separatistëve dhe nacionalistëve shqiptarë me qëllim shpërnguljeje nga Jugosllavia, etj. Fillimisht versioni zyrtar në Kosovë ka qenë ky i dyti, pastaj është heshtur. Nga frika, sigurisht. Sepse për Kosovën ekzistonte vetëm e vërteta serbe. E vërteta serbe në rastin Martinoviç u kundërshtua nga vetë ekspertët serbë. E vërteta për vetëlëndimin e Martinoviçit shpejt u ndriçua, madje, ajo është më interesante, falë gjykatësit hetues, serbit Vukasin Trupiç nga Gjyqi i Qarkut i Gjilanit dhe gjyqtar ekspert, gjithashtu doktorit serb Markoviç nga Qendra e Klinikave dhe komandantit të garnizonit të APJ-së,

¹⁶⁶ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha Prishtinë&shtëpia e librit Tiranë 2001, fq.352.

¹⁶⁷ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.13, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006

nënkolonel Novak Ivanoviçit. Mirëpo asgjë nuk vlejti. Në Beograd u mor se rasti duhej paraqitur si krim i shqiptarëve mbi serbët e “rrezikuar”.¹⁶⁸

E vërteta është se kriza e përgjithshme ekonomike u shfrytëzua maksimalisht duke u vënë në shërbim të politikës nacionaliste serbe në krye me Akademinë, ndërkohë që momenti më i shndërritshëm për këtë qëllim ishte ardhja e Millosheviçit që dukej të ishte më i përkryeri për të zbatuar jetësimin e programit për Serbinë e Madhe. Sipas tij s’kishte rëndësi nëse kjo do të bëhej në mënyrë kushtetuese apo jokushtetuese. Shqiptarët nuk ishin ata që deshën të shkatërronin Jugosllavinë në ato rrethana. Po ata deshën të ruanin veten e tyre me atë që kishin mundësi. Me ata asnjëherë nuk ishte biseduar sinqerisht. Përkundrazi, pothuaj në dy shqiptarë njëri, në një mënyrë apo në një tjetër, kishte kaluar nëpër duar të policisë. Pra në një situatë dhe në rrethana të tilla tepër të rënda, Kushtetuta në vitin 1989 do të ndryshohej edhe sikur delegatët të votonin kundër ndryshimeve.

¹⁶⁸ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë-Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912 – 2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.271.

KREU III: Përpyjekjet e shqiptarëve për ripërcaktim të pozitës së tyre

kushtetuese

3.1. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës dhe efektet e saj politiko- juridike

Zbatimi i politikës serbe për të shkuar më tutje me dominimin në Federatë apo për të krijuar Serbinë e Madhe duke ndryshuar kufijtë e republikave, që Serbia i konsideronte kufij administrativë, nuk dukej se kishte të ndalur. Në Kryesinë e Jugosllavisë raporti i forcave, në rastin më të keq, për Serbinë ishte bllokada, pozita si në lojë shahu: remi. Kjo sepse në Kryesi të Jugosllavisë, Serbia hynte në start me 4 vota: Serbia me përfaqësues kukulla nga Kosova, Mali i Zi dhe Vojvodina. Serbia nuk kishte ndërmend të ndalej. Këtë të gjithë e dinë. Të gjithë në një mënyrë përgatiten për pozicionim të ri karshi sfidave që i prisnin. Strategjia dhe kërcënimet për të përdorur të ashtuquajturat “mitingje të së vërtetës” edhe në Slloveni dhe në Kroaci dështoi. Kjo sepse, pushteti slloven paralajmëroi me kohë se këtë nuk do ta lejonte dhe se shteti juridik do të vepronte me tërë qenien e vet. Edhe mitinggjinitë këtë e kuptuan dhe hoqën dorë nga kjo formë e organizimit në republikat veriore. Ndërkohë rrymat e demokracisë dhe pluripartizmit kishin filluar të ndihen sikundër BRSS e prirë nga Gorbaçovi po futej në rrugë të shthurjes, dhe kjo në Serbi nuk pritej me simpati. Madje edhe me frikë. Borisav Joviq, një ndër njerëzit më kryesorë në Partinë Komuniste dhe shtetërore, por dhe përkrahës e zbatues i politikës së Millosheviçit, në një intervistë, lidhur me BRSS-në shprehet: ”Me këtë lloj BRSS-je humbet baraspesha ndërkombëtare në raportin e forcave, në korniza të të cilave neve na ishte garantuar zhvillimi i pavarur. Tani baraspesha rrënohet dhe mbetemi krejtësisht në dëshirën e perëndimit, ndërsa dëshira e tyre është t’i flakin nga pushteti gjithë të padëgjueshmit, me çdo kusht”.¹⁶⁹ Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, e cila kishte udhëhequr luftën antifashiste dhe që kishte marrë autorësinë e krijimit të Jugosllavisë Federative po futej në fazën e fundit të ekzistencës. E para, për shkak të humbjes së unitetit partiak dhe e dyta, për shkak se edhe këtu po paraqiteshin sinjalet e para të pluripartizmit. Kështu, në Beograd 20-22 janar 1990 mbahet Kongresi XIV, që rezulton të jetë edhe i fundit, ku delegacionet sllovene dhe kroate, të pakënaqura me tendencat serbe për dominim dhe imponim të vendimeve përmes mbivotimit, lanë kongresin me çka edhe

¹⁶⁹ Borisav Joviq, *Poslednji dani SFRJ*, Prizma, Kragujevac, 1996, fq. 91.

kjo parti me famën dhe lavdinë e vet, sikundër me barrën e përgjegjësisë për shumë të bëra e të pabëra nga të cilat kanë vuajtur shumë njerëz, por edhe entitete të caktuara nacionale, ikën nga skena duke mbetur pjesë e historisë. Shqiptarët e Kosovës u larguan plotësisht nga kjo parti duke e mallkuar për gjithë atë që kishte bërë dhe për atë që s’kishte bërë për shqiptarët.

Dhe në Kosovë, Serbia po vazhdonte me masa kundër popullit shqiptar, që po shndërrohej si kategori e rendit të dytë. Filloi një proces, që shumë analistë dhe studiues do ta quajnë proces i serbizimit të Kosovës. Në të dyja programet, Programi për paqe, liri, barazi, demokraci dhe mirëqenie të marsit 1990 dhe Programi i zhvillimit për përfundimin e emigrimit dhe kthimin e serbëve dhe malazezëve, u përcaktuan qartë vijat e politikës serbizuese.¹⁷⁰ Ishin dy programe me frazeologji dhe demagogji për barazi e demokraci, por me përmbajtje tërësisht antishqiptare dhe segregacioniste. Ky program e përmbyllte vargun e mënyrave të avancimit të pozitës së serbëve: duke krijuar komuna të reja për ta, duke i orientuar dhe përqendruar investimet e reja në viset me shumicë serbe, duke ndërtuar shtëpi të reja për serbët që ktheheshin në Kosovë, duke i nxitur shqiptarët që të kërkonin punë në pjesë të tjera të Jugosllavisë, duke imponuar planifikimin e familjes dhe duke anuluar, retrospektivisht shitjen e pasurisë apo të pronave shqiptarëve nga serbët të cilët braktisnin Kosovën. Tashmë sipas ligjeve të reja serbe, të miratuara më 1989 shqiptarëve të Kosovës u ndalohej që të blinin ose të shisnin prona pa siguruar lejen e veçantë nga autoritetet.¹⁷¹ Shqiptarët duheshin lënë edhe pa mjete të komunikimit masiv sepse ata duhej t’i nënshtroheshin së vërtetës serbe, ndërkohë që gjithçka ishte e vërtetë vetëm kur thuhej nga pushteti i dhunshëm serb. Ndërsa më 26 qershor, u shpall një valë e re dekretesh, zyrtarisht të paraqitura si “masa të përkohshme”, në sajë të “Ligjit për veprimtarinë e organeve të Republikës në rrethana të jashtëzakonshme”. Këto masa të përkohshme, të cilat mbetën të përhershme, do të përfshijnë edhe pezullimin e gazetës në gjuhën shqipe “Rilindja”, mbylljen e Akademisë së Arteve e Shkencave të Kosovës dhe dëbimin nga puna të disa mijëra nëpunësve të shtetit.¹⁷² Me aprovimin e Kushtetutës së Republikës së Serbisë

¹⁷⁰ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.54.

¹⁷¹ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë & shtëpia e librit, Tiranë 2001, fq.360-361.

¹⁷² Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë & shtëpia e librit Tiranë, 2001, fq. 360-361.

të vitit 1990 autonomia e Kosovës zvogëlohet në masë të madhe. Pas kësaj, rastet e keqpërdorimit të pushtetit nuk ishin dukuri e rrallë.¹⁷³

Kalimi i kompetencave, që i takonin Kosovës në Serbi, si pasojë e ndryshimeve në Kushtetutën e vitit 1974, bënë që, masat e pushtetit serb tash kapin çdo sferë të jetës në Kosovë, duke filluar nga policia kur aty më nuk kishte policë shqiptarë e duke mbaruar me largime masive nga puna nga ndërmarrjet shtetërore/shoqërore të shqiptarëve. Në këtë kohë në Kosovë thuhet se kanë ardhur nga Serbia 20.000 deri 25.000 policë serbë, të cilët shquheshin me vrazhdësi në sjellje dhe me urrejtje të paparë ndaj shqiptarëve. Ekzistonte edhe një lloj policie speciale, që të shqiptarët ngjallte kujtimet gjithashtu të këqija të kohës së Rankoviqit. Nga njësitë policor federal, që vepronte në Kosovë, anëtarët sllovenë largohen duke e lëshuar këtë njësitë. Shkollat i nënshtrohen procesit të serbizimit, që nuk pranohet nga shqiptarët, me tendencë të imponimit të planeve dhe programeve serbe të mësimin. Më këmbëngulës ishin në imponimin e mësimin nga lëndët e historisë, gjuhës dhe letërsisë. Programet shqiptare duheshin eliminuar krejtësisht dhe nxënësit shqiptarë duhet të mësonin historinë dhe gjuhën serbe, në një vend që popullohej me 90% shqiptarë. Duke parë se refuzimi i shqiptarëve: i mësuesve, nxënësve, prindërve dhe me një fjalë i gjithë shoqërisë shqiptare ishte qind për qind, pushteti serb i instaluar në Kosovë vendosi të ndalojë frekuentimin e nxënësve shqiptarë në objekte shkollore me arsyetimin se ato ishin shkolla publike dhe se aty nuk bënë të ketë abuzime dhe refuzime të shtetit. Masat rezultojnë me mbyllje të administratës shkollore të Kosovës (...) dhe për institucione të tjera të edukimit (...). Më shumë se 18,000 mësues dhe staf shqiptar përjashtohen nga klasat e tyre dhe përjashtohen ngase refuzojnë kurikulat uniforme. Mijëra shqiptarë përjashtohen nga vendet e tyre të punës; sipas Asociacionit të Pavarur të Sindikatave të Kosovës nga puna përjashtohen 115.000 punëtorë nga gjithsej 170.000. Bëhen përpjekje që të kolonizohet Kosova gjithashtu. Privilegje të veçanta u bëhen serbëve që kthehen në Kosovë, përfshirë edhe hua dhe tokë falas. Nxirren ligje të veçanta, me të cilat ndalohet blerja e pasurisë së serbëve nga shqiptarët, kurse serbët nga Kroacia dërgohen në Kosovë. Para së gjithash ka abuzim të gjerë me të drejtat e njeriut- arrestime arbitrare, tortura, mbajtje në izolim pa gjykim. Shqiptarët akuzohen për “krime verbale” dhe merren nëpër stacione policore për “biseda informative”. Shkalla e abuzimit me të drejtat e shqiptarëve është dokumentuar nga Amnesty

¹⁷³ Nebojsa Raicevic, Humanitarna Intervencija u Medjunardodnom Javnom Pravu (doktorska dizertacija), Universiteti i Nish-t, 2008

International, Human Rights Watch dhe nga Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të njeriut. Thuhet se së paku një anëtar nga secila familje shqiptare është thirrur në polici apo ka kaluar disa kohë në burg, apo edhe priste për t'u gjykuar.¹⁷⁴ Në anën tjetër vazhdonte aksioni për ndërrimin e emrave të rrugëve, të institucioneve, të shkollave, etj, duke i hequr emrat shqiptarë dhe duke u vënë emra serbë, madje edhe serbë që njiheshin si famëkeq të mëdhenj në Kosovë. Në shumë ndërmarrje filloi aplikimi i të ashtuquajturave “masa të dhunshme”, nga ku largoheshin drejtorët dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë dhe viheshin serbë. Po në të njëjtën mënyrë u veprua edhe me institucionet shëndetësore. Një numër i madh individësh dhe familjesh të detyruar nga kriza e rëndë ekonomike dhe nga presioni e dhuna, edhe një herë vërshojnë drejt vendeve të perëndimit për të gjetur punë dhe strehim. Kosova bëhet vend i pasigurisë së përgjithshme dhe, edhe i eksperimenteve, për të parë se deri ku mund të shkojë durimi qytetar. Një valë të madhe pasigurie në popullsinë shqiptare ngjalli sëmundja në masë e nxënësve shqiptarë në mars të vitit 1990. Sipas të dhënave të medieve shqiptare në këtë muaj u vërejtën shenja helmimi të më tepër se 7000 fëmijë nga 13 komuna.¹⁷⁵ Situata dhe atmosfera e krijuar ishte shpërthyesë. Autoritetet serbe të instaluar dhunshëm, por edhe popullata lokale serbe jo vetëm që nuk shprehën keqardhje dhe jo vetëm që nuk ndërmorën asgjë për t'u zbuluar helmimet, por përkundrazi ato ironizonin dhe përqeshnin sikur shqiptarët po shprehnin shkathtësitë e aktrimit, ndërkohë të rinjtë e helmuar ballafaqoheshin me luftën për jetë ose vdekje. Profesorët dhe studentët u larguan nga objektet e universitetit dhe përgjithësisht shqiptarët u bënë kategori jashtëkushtetuese dhe jashtëligjore. Shqiptarët më nuk kanë hapësirë veprimi për asgjë dhe jeta e tyre vlen fare pak lekë. Në këto rrethana, të papërkrahur dhe me një të nesërme të pasigurt, atyre iu imponua organizimi i jetës në një sistem të ndërtuar karshi atij serb, që njihet me emrin “sistemi paralel i shqiptarëve në Kosovë”. Shqiptarët e Kosovës kështu u përballën me humbjen e statusit autonom në një kohë kur republikat e tjera filluan procesin e fitimit të pavarësisë. Kjo ishte shtysa që shqiptarët e Kosovës i orientoi në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve për të realizuar interesat dhe qëllimet e tyre të cilat me rastin e shpërbërjes së RSFJ-së u përcaktuan në kërkesën për Kosovë të pavarur.¹⁷⁶

¹⁷⁴ Shih Independent International Commission on Kosovo: *The Kosovo Report*, fq.13, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

¹⁷⁵ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 - 1999*, Koha, Prishtinë, fq.55-56.

¹⁷⁶ Dario Malnar, *Dario Malnar, SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.71.

Koha kur dhuna serbe po kapte përmasa të papara, ndodhi në një situatë kur komunizmi kishte filluar të binte dhe kur, siç u tha Lidhja Komuniste e Jugosllavisë u shtur. Në anën tjetër në Kosovë, sikundër gjithandej nëpër Jugosllavi, u formuan disa mekanizma që dalin me mendime të ndryshme me ato të pushtetit zyrtar. Një mekanizëm interesant, që ishte themeluar me ide gjithjugosllave, e organizoi edhe degën e vet në Kosovë. Ky mekanizëm njihej me akronimin UJDI e që do të thoshte: Shoqata e Nismës Demokratike për Jugosllavinë. Kjo shoqatë rreth së cilës ishin mbledhur intelektualë të rinj si: Veton Surroi, Shkëlzen Maliqi, Isuf Berisha, etj., filloi të organizojë aktivitete mjaft të guximshme në kontekst të rrethanave të një gjendjeje të jashtëzakonshme. Filluan aktivitetet kundër dhunës, si protesta, peticione dhe të ngjashme me to. Një peticion titulluar “Deklarata për Demokraci Kundër Dhunës” ishte i rëndësishëm dhe i madh pasi u mblodhën 400.000 nënshkrues anembanë Kosovës...¹⁷⁷ Këto ishin nismat e para të reagimit edhe në forma të tjera përpos demonstratave, nga të cilat shqiptarët po e pësonin vazhdimisht. Krahas kësaj, u themeluan Këshilli Për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe në fund të dhjetorit 1989 u themelua edhe partia e parë politike e shqiptarëve në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e cila shumë shpejt do të arrijë të sigurojë numër të madh anëtarësh, dhe shpesh thuhet se, në një moment të caktuar ka qenë partia më e madhe politike në Ballkan për nga numri i anëtarëve. Krahas LDK-së themelohen edhe disa parti të tjera politike dhe përfundimisht, në Kosovë krijohet një besueshmëri për një perspektivë, pos të tjerash edhe nga shkakut se liderët e këtyre partive politike konsideroheshin se ishin përfaqësues të vërtetë të kauzës shqiptare në Kosovë. Kjo edhe nga shkakut i sfondit të tyre intelektual dhe nga guximi qytetar për të marrë përgjegjësi si dhe nga aftësia për të artikuluar kërkesat reale të shqiptarëve të Kosovës. Aktiviteti i liderëve krijon klimë besimi ndërshqiptar dhe kërkesat e artikuluar dhe të argumentuara parashtrihen brenda dhe jashtë Kosovës. Jo pa vështirësi, gjithsesi. Gjatë këtij procesi afatgjatë të shkatërrimit politik dhe legjislativ, qëndrimi i anëtarëve shqiptarë të Kuvendit Krahinor ka qenë, në të shumtën e rasteve, një lloj nënshtrimi i turpshëm nën ndikimin e trysnisë. Mirëpo, në fund të qershorit (1990), një grup i madh i këtyre delegatëve tregoi një sens të papritur të iniciativës, kur bëri përpjekje të bllokojë Kushtetutën e re serbe dhe paraqiti propozimet e veta për Republikën e Kosovës.¹⁷⁸ Përbërja e fundit e Kuvendit të Kosovës ka kaluar nëpër filtra të shumtë dhe kjo përbërje mund të supozohet se ka qenë më e

¹⁷⁷ Shkëlzen Maliqi, *dialog me Baton Haxhiun - Shembja e Jugosllavisë - Kosova dhe rrëfime të tjera*, UET Press, Tiranë, 2011.

¹⁷⁸ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë & shtëpia e librit, Tiranë, 2001, fq. 361.

dobët sesa përbërja e kuvendit që votoi pro ndryshimit të Kushtetutës një vit më parë. E gjithë atmosfera e krijuar jashtë Kuvendit të Kosovës, homogjenizimi nacional serb për të rrezikuar edhe ekzistencën fizike të shqiptarëve dhe homogjenizimi i shqiptarëve për të kundërshtuar dhe për të rezistuar ndaj pushtetit serb, ndikuan që deputetët shqiptarë të Kuvendit të emancipohen dhe të veprojnë në emër dhe për llogari të atyre që supozohej se i përfaqësonin. Deputetët e Kuvendit të Kosovës tash po tregonin pjekuri dhe guxim. Dhe ata u rebeluan kundër politikës së Serbisë.¹⁷⁹ Ata tash shihet qartë se duan të pozicionojnë Kosovën në procesin e shtetit që po shthurej, sikurse edhe republikat e tjera. Por një pengesë e madhe për ata ishte Kryetari i Kuvendit, i cili po manipulonte me përdorimin e Rregullores së Punës, duke dashur të pengonte iniciativat e deputetëve shqiptarë. Deputetët shqiptarë tashmë duan të bllokojnë Kushtetutën e re serbe në njërën anë dhe duan të paraqesin propozimin e tyre për Republikën e Kosovës. Kryetari serb i Kuvendit të Kosovës, Gjorgje Bozhoviq, do të bëjë çmos që propozimi shqiptar të mos futej në rend të ditës dhe mbledhjen që planifikohej të mbahej me datë 02.07.1990 e shpalli të shtyrë për në datën 05.07.1990. Kjo ishte vetëm tendencë për të bllokuar dhe për të pamundësuar çdo iniciativë shqiptare. Tash masat çfarëdo që të ishin, ishin të mundura nga frika shqiptare, e cila më nuk ekzistonte. Më 01.07.1990 një grup, në shtëpinë e delegatit Skënder Skënderi, kishin shqyrtuar tekstin e deklaratës, që ishte hartuar nga akademik Gazmend Zajmi dhe përfundimisht, me 02.07.1990, 114 nga 128 anëtarë shqiptarë të kuvendit u mbledhën para ndërtesës së mbyllur të kuvendit dhe miratuan një rezolutë për shpalljen e Kosovës

*“si një entitet të barabartë e të pavarur në kuadrin e Federatës Jugosllave”.*¹⁸⁰

Kjo ndër të tjera,

*“është edhe kundërpërgjigje ndaj qeverisë serbe që i heq të drejtën për t’u mbledhur rregullisht Parlamentit të Kosovës”.*¹⁸¹

Kjo deklaratë shënon bazën e përcaktimit politik të popullit shqiptar të Kosovës, duke e vënë Kosovë në pozitë të barabartë ashtu siç po bënin edhe njësitë e tjera federative në këtë proces. Pra kjo deklaratë nuk po bënte asnjë përjashtim. Në anën tjetër, deklarata pavarësisht

¹⁷⁹ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, fq.334.

¹⁸⁰ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë&shtëpia e librit, Tiranë, 2001, fq.361.

¹⁸¹ G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.7 (parë më: 29.12.2013).

faktit se ka më shumë karakter politik, ka një rëndësi edhe juridike, sepse në një mënyrë anulon vendimin e datës 23.03.1989 me anë të të cilit ishte dhënë pëlqimi për ndryshimet kushtetuese të vitit 1974.

Vështruar nga aspekti kushtetues, Deklarata paraqet akt konstitutiv me të cilin bëhet avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës nga njësi autonome në njësi të pavarur dhe të barabartë me njësitë e tjera federale të ish - Jugosllavisë.¹⁸² Siç mund të shihet nga teksti i Deklaratës, ajo nuk shprehet për largim nga Jugosllavia, por konfirmohet vullneti i shqiptarëve të Kosovës që pozicioni i Kosovës të jetë i barabartë me republikat e tjera. Kjo është e arsyeshme, sepse në një raport të forcave të asaj kohe, e gjithë diplomacia botërore deklarohet për ruajtjen e Jugosllavisë. Është diçka tjetër nëse agjenci dhe shërbime të fshehta kishin paraparë shturjen e Federatës. Kështu, teksti i Deklaratës ishte i shkurtër dhe mjeshtërisht i hartuar. Kishte gjithsej 6 pika dhe një preambulë të shkurtër. Deklarata fillon me:

*“Duke u nisur nga vullneti i shprehur vendosshmërisht nga shumica e popullsisë së Kosovës, vullnet ky i sublimuar edhe në Deklaratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës...Kuvendi solemnisht shpall...për Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të Federatës (konfederatës) së Jugosllavisë dhe si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në Jugosllavi”.*¹⁸³

Ishte koha kur të gjitha republikat e tjera të Federatës po pozicionoheshin dhe ende nuk ishte e sigurt sesi do të ndërtohej e ardhmja e Jugosllavisë, ku opsionet më të dukshme ishin konfederata apo edhe ndonjë federatë e dobët. Nuk flitej për shturjen. Së paku jo zyrtarisht dhe publikisht nga diplomacia apo fuqitë e vendosjes. Është diçka tjetër nëse ishin bërë studime të agjencive të ndryshme, të cilat kishin paraparë shturjen e Federatës. Më tutje, në gjashtë pikat e saj, deklarata shpreh karakterin e vet konstitutiv. Në pikën 1 të saj shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë. Pika 2, shpall Kosovën njësi të barabartë në Jugosllavi dhe pret konfirmimin e këtij akti konstitutiv në Kushtetutën e Jugosllavisë. Pika 3 e deklaratës, shpall popullin shqiptar të Kosovës komb të barabartë me popujt e tjerë dhe jo kombësi, kurse pozitën e Kosovës e përcakton si bashkësi politiko- kushtetuese të përbashkët për qytetarët e saj. Më tej në

¹⁸² Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq. 59.

¹⁸³ Deklarata Kushtetuese e nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës me: 02.07.1990.

tekstin e deklaratës Kosova përcaktohet se raportet në të ardhmen do të bazohen në Kushtetutën federative duke shfuqizuar pëlqimin e dhënë për amendamentet kushtetuese të RS Serbisë të datës 23.03.1989 dhe në fund vërtetohet se emërtimi dhe komunikimi do të bëhet me emërtimin e vërtetë: Kosovë. Pika e fundit thotë se Deklarata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe pasojnë nënshkrimet e delegatëve.

Lëvizjet nga miratimi falso dhe i dhunshëm i ndryshimeve kushtetuese të datës 23.03.1989, të cilat i kishin bërë delegatët e përbërjes së kaluar të Kuvendit të Kosovës e deri tek aprovimi i Deklaratës së 2 korrikut ishin të shpejta dhe dramatike. Këto u kurorëzuan duke shprehur edhe një herë vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës, për të qenë i barabartë me popujt e tjerë, vullnet ky që nuk ishte respektuar asnjëherë në Jugosllavi. Deklarata u nxor në kohë të një represioni të ashpër dhe të vazhdueshëm, i cili u tregua kundërproduktiv ndaj atyre që po ushtronin dhunë dhe terror. Kësaj radhe, Jugosllavia kishte marrë një drejtim tjetër. Serbia praktikisht abrogon Kushtetutën federative duke aprovuar Kushtetutën serbe në shtator të vitit 1990¹⁸⁴ që ishte krejtësisht në kundërshtim me Kushtetutën federative. Këtu nis përsheptimi i shthurjes së Federatës, që në vete përfshiu ngjarje të rënda me pasoja të tmerrshme, me të cilat u ballafaqua edhe Kosova. Në rrethana të tilla, ideatorët dhe hartuesit, sikundër ata që aprovuan Deklaratën Kushtetuese ndërtuan themelet e krijesës së re dhe të vërtetë, e cila karakterizohet si fazë e parë, gjithsesi më e lehtë krahasuar me fazat e tjera, nëpër të cilat do të kalojë Kosova. Serbia me të aprovuar Deklarata do të ashpërsojë kursin e masave dhe të dhunës, si edhe atë të represionit, të cilët nuk do të kenë më efekt në kuptimin e ndryshimit të vullnetit të popullit të Kosovës. Në Kosovë tash gjejmë konsensus të përgjithshëm për të shkuar tutje në favor të lirisë dhe të barazisë së Kosovës dhe të shqiptarëve me të gjithë popujt e tjerë të (ish) Jugosllavisë.

3.2. Shpallja e Kushtetutës së viti 1990

Shpallja e Deklaratës Kushtetuese u bë me 2 korrik 1990, nga delegatët e Kuvendit të Kosovës para ndërtesës së Kuvendit. Delegatët nuk u lanë të hyjnë në sallë të Kuvendit dhe kjo tregon se deri ku shkonin masat e pushtetit të instaluar serb në Kosovë. Përfaqësuesve të popullit iu mbyllën dyert e Kuvendit. Deklarata shkaktoi reagim të ashpër të Serbisë dhe në Serbi, kurse mbledhja e mbajtur para dyerve të mbyllura të Kuvendit, po ndiqej nga përfaqësues të jashtëm,

¹⁸⁴ Ekrem Avdiç & Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.334.

si: Venera Gravs nga Liga Ndërkombëtare për të Drejta dhe Liri të Popujve, Zhan Zhak Kirkiasherien nga Lëvizja kundër Racizmit dhe për Miqësi ndërmjet Popujve, Eva Brendli, Charles Grevis nga Komisioni Ndërkombëtar i Profesionistëve të Shëndetësisë për të Drejtat e Njeriut, etj. Kosova në kohën e Deklaratës Kushtetuese ishte në gjendje shtetrrëthimi të plotë, por megjithatë ngjarjet në Kosovë kishin filluar të ndiqeshin nga medie, agjenci të ndryshme, si edhe nga zyra apo ambasada të huaja. Kjo shihet edhe nga monitorimi i mbledhjes prej aktivistëve të përmendur. Në një mënyrë e vërteta serbe për Kosovën filloi gradualisht të ballafaqohet edhe me një të vërtetë tjetër: të vërtetën shqiptare që, megjithatë me vështirësi po depërtonte. Ndërkohë kriza thellohet edhe më shumë.

Situata e paraaprovimit të Deklaratës Kushtetuese, vetëdijesimi i delegatëve të Kuvendit të Kosovës, uniteti i të gjitha forcave politike dhe jopolitike si dhe mobilizimi i qytetarëve përgjithësisht krijuan një atmosferë ku Kuvendi i Kosovës doemos duhej të mblidhej dhe të deklarohet për kërkesat gjithëpopullore. Në anën tjetër, pushteti serb, duke parë se kjo do të ndodhte dhe s'mund të ndalej, përkundër manipulimeve të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, me shpejtësi hartojë ligje të cilat do të ishin bazë për marrjen e masave të tjera. Kështu Kuvendi i RS Serbisë, me 26.06.1990 nxori Ligjin Për Veprimin e Autoriteteve Republikane në Rrethanat e Gjendjes së Jashtëzakonshme. Me këtë ligj Serbia i jep vetes pushtet, të cilin nuk e kishte me Kushtetutën e RSFJ-së.¹⁸⁵ Ky ligj aplikon masat e jashtëzakonshme në Kosovë, sipas të cilave Serbia mund të ndërmarrë masa në çdo fushë të jetës në Kosovë. Dhe në fakt menjëherë, pak ditë pas aprovimit, ajo edhe do të marrë masa që vërtetë prekin çdo fushë të jetës. Më 26.06.1990 Kuvendi i Serbisë aprovon tri vendime të një rangui legal të ndryshëm:

- *Normë të përgjithshme juridike: Ligji për veprimin e autoriteteve republikane në gjendje të jashtëzakonshme;*
- *Krijimin e gjendjes faktike për zbatim të ligjit: vendimi për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme;*
- *Sanksionim i një rasti të veçantë: vendimi i Kuvendit të Serbisë për futjen e masave të dhunshme në kompaninë shoqërore "Elektrokosova".¹⁸⁶*

¹⁸⁵ Republic of Slovenia, Ministry of Foreign Affairs, Written Comments of the Republic of Slovenia on other written statements, submitted to the International Court of Justice, 17 July 2009, fq. 19.

¹⁸⁶ Po aty, fq. 22-23.

Këto ligje dhe vendime hynë në fuqi dhe publikohen në Gazetën Zyrtare të RS të Serbisë që në ditën e nxjerrjes. Një ligj tjetër, i së njëjtës frymë dhe i së njëjtës datë, është Ligji për marrëdhëniet e punës në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme, që i dha Serbisë bazë formale për largim të jashtëligjshëm nga puna të 55.000 - 60.000 punëtorëve, kryesisht shqiptarë.¹⁸⁷ Serbia në një anë bënte përpjekje që çdo veprimi t'i jepte ngjyrë dhe terminologji, por dhe me bazë juridike, ndërsa edhe kur “krijonte një bazë të tillë lidhur me Kosovën” ligjet e aprovuara hynin menjëherë në fuqi. Parimi *vacation legis* nuk ekzistonte. Kurorëzimi përfundimtar i veprimeve “juridike” të Serbisë bëhet me datën 05.07.1990, kur Kuvendi i Serbisë nxjerr Ligjin për pushimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës. Ky ishte kulmi edhe i çmendurisë juridike, me të cilin Kosova i nënshtrohet një okupimi kushtetues, krahas okupimit faktik që kishte ndodhur në vazhdimësi me forca ushtarako-policore. Ky ligj, pos asaj që është thënë, kishte dy efekte të drejtpërdrejta negative:

- *Njerëzit e Kosovës humbasin nga të drejtat kushtetuese për të realizuar autoritetin në KSA të Kosovës dhe të drejtat e tyre sovrane në Federatë dhe*
- *Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës u pengua dhe në situata të caktuara edhe penguan ushtrimin e funksioneve të Federatës në Kosovë.*¹⁸⁸

Të gjitha këto masa morën edhe bekimin e Federatës, kur Kryesia e Jugosllavisë, në datën 11.07.1990 i aprovon masat serbe në Kosovë. Kjo është tregues se të tjerët në Federatë nga shpresa se Serbia kënaqet dhe ndalet me masat në Kosovë, aprovonin politikën serbe dhe në anën tjetër mundoheshin të përfitonin kohë për pozicionim tjetër në Federatë/konfederatë apo shkëputje nga Jugosllavia. Pa dyshim kalkulime të gabuara dhe aspak korrekte. Të gabuara, sepse një pjesë e tyre shpejt do të ballafaqohen me agresioni serb, kurse jokorrekte sepse legjitimonin një gjendje krejtësisht jokushtetuese dhe joligjore dhe në fund të fundit edhe krejtësisht johumane.

Në të njëjtën ditë kur Serbia merr vendim pa asnjë të drejtë përpos logjikës së forcës, për të shpërndarë Kuvendin e Kosovës, të njëjtën ditë Radiotelevizioni i Prishtinës dhe Rilindja e Zëri mbyllën për t'u vënë në masa të jashtëzakonshme. Përkundër një censure të paparë, që ushtrohej ndaj këtyre medieve, Serbia dëshironte që Kosovën ta fuste në një terr total informativ, gjë të

¹⁸⁷ Po aty, fq.27.

¹⁸⁸ Po aty, fq.30.

cilën edhe e bëri. Por jo për një kohë të gjatë, sepse pos të tjerash edhe bota përrreth po ndryshonte. Kuvendi u ndalua “me ligj” dhe me “kushtetutë”, por përfaqësuesit e popullit tash edhe pse nuk lejohen të veprojnë sipas autorizimeve të tyre, nuk ndalen së vepruari. Kuvendi ka formuar Komisionin për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe ky Komision ka punuar deri në 04.09.1990 kur kanë përfunduar draftimin e tekstit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në anën tjetër Serbia dëshironte me çdo kusht të kryente një proces që Oliver Schmitt e quan “serbizimi” i Kosovës. Fakti se Kosovën po e administrojnë një administrator serb, fakti se institucionet u spastruan etnikisht, fakti që shkollat u mbyllën për shqiptarët, se në Radiotelevizion u lanë vetëm 45 minuta program në gjuhën shqipe, se edhe Teatri Kombëtar u mbyll për t’u emëruar me emrin Tatri serb, si edhe fakti që u mbyll edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, se çdo gjë që quhej shqiptare mbyllej, nuk do të thotë se Serbia do t’ia dilte me politikën e saj të serbizimit. Kjo për arsyen e thjeshtë. Shqiptarët sado që detyroheshin të iknin nga Kosova, kush nga dhuna e kush nga vështirësitë ekonomike, e kush nga mungesa e perspektivës, por përsëri ata që mbeteshin në Kosovë në çdo variant përbënin shumicën. Mungesa e perspektivës dhe kërcënimi me shërbim në ushtrinë jugosllave i shtyri gjithsej 400.000 shqiptar të Kosovës, kryesisht të rinj, të iknin në botën e jashtme, sidomos në Evropën Qendrore dhe në atë Veriore; po ashtu shumë të rinj shqiptarë braktisën krahinën për të studiuar në botën e jashtme.¹⁸⁹ Por me që prapë mbeten shumicë, ata ose duhet vrarë ose duhet larguar nga vendi. Që të gjithë. Gjëra që nuk bëhen, në fund të shekullit XX. Pavarësisht tendencave apo tentativave. Ata për më tepër homogjenizohen dhe tregojnë solidaritet të jashtëzakonshëm. Përgjigjja ndaj politikës serbe të dhunës nuk ishte kryengritja e armatosur, e cila përballë pranisë së madhe të armatës serbe, policisë speciale dhe paramilitarëve nuk kishte gjasa për sukses, por vendimi që përmes rezistencës paqësore, të padhunshme të bëhet i qartë legjitimiteti i kërkesave të shqiptarëve të Kosovës.¹⁹⁰ Dhe vendimi për rezistencë paqësore rezulton të jetë pa dyshim i rëndësishëm dhe më i qëlluar. Në një gjendje kaq të rëndë dhe kaq të vështirë për të vepruar delegatët e Kuvendit të Kosovës po diskutonin për aprovimin e Kushtetutës së Kosovës, përkundër vështirësive dhe rreziqeve që dilnin nga shteti policor -ushtarak serb. Kështu, në një mënyrë shumë diskrete, ata mblidhen më 07.09.1990 në ndërtesën e Pallatit të Kulturës në Kaçanik dhe nën udhëheqjen e nënkryetarit të Kuvendit, Iliaz Ramajlit, për të materializuar

¹⁸⁹ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.249.

¹⁹⁰ Po aty, fq.248.

Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut. Në mbledhjen e Kuvendit, në prani të shumicës së delegatëve, u vendos për dy pika të rendit të ditës:

- *Aprovimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe*
- *Aprovimi i Rezolutës për njohjen e Republikës së Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare.*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në vetvete ka 140 nene dhe për nga përmbajtja është mjaft e shkurtër. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është një akt historik me të cilin populli shqiptar realizoi aspiratat e veta historike, aspirata që gjatë pesë dekadave të kaluara u ndëshkuan dhe u inkriminuan nga pushteti serb dhe ai jugosllav.¹⁹¹ Në këtë mbledhje krahas Kushtetutës u miratuan edhe disa ligje, si: Ligji për zgjedhjet, Ligji për bashkimin politik të qytetarëve dhe caktimin e raporteve me Jugosllavinë. Kjo Kushtetutë do të shërbejë si akti më i lartë juridiko - politik i Kosovës deri në çlirimin e saj përfundimtar dhe në bazë të kësaj u ndërtuan institucionet e ardhshme të Kosovës dhe bazuar në këtë Kushtetutë u zhvillua një jetë institucionale, pavarësisht se kjo jetë bëhej në rrethana të një okupimi klasik, por ku shqiptarët po respektonin jetën e tyre në atë që njihej sistem paralel kundruall pushtetit serb. Sipas kësaj Kushtetute Republika e Kosovës konstituohet në atë formë të rregullimit shtetëror të mbështetur në sovranitetin e popullit dhe të qytetarëve, në lirinë e organizimit dhe të veprimit politik të qytetarëve, pluralizmin e formave të pronës, ekonomisë së tregut dhe kushtetutshmërinë si dhe ligjshmërinë si bazë e sistemit kushtetues dhe politik.¹⁹² Dhe kjo Kushtetutë do të jetë akti final i emancipimit politik të shqiptarëve për të vazhduar drejt ndërtimit të institucioneve dhe drejt realizimit të aspiratave për liri dhe pavarësi.

3.3. Emancipimi politik i faktorit shqiptar në Kosovë: ngritja dhe ndërtimi i institucioneve të mëvetësishme

Të merrje përgjegjësi për të udhëhequr një popull nën okupim të egër ishte guxim tepër i madh në një rën anë, ndërkohë që duhej dije, përkushtim dhe durim i pakufishëm në anën tjetër. Kjo do të jetë akoma më e vështirë kur për çfarëdo suksesi të projektuar nevojitet ndërkombëtarizim dhe përkrahje ndërkombëtare. Dhe përkrahja ndërkombëtare në fillim të

¹⁹¹ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.60.

¹⁹² Po aty.

procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë ishte e vështirë, ndonëse jo fare e pamundur. Por sado të vështira rrethanat dhe sado i fortë të jetë kundërshtari, nëse emancipimi i trupit social ka arritur nivel të duhur, atëherë pengesat eliminohen më lehtë në një rrugë që edhe mund të jetë shumë e gjatë. Në fund të dhjetorit të vitit 1989 u paraqit partia e parë politike shqiptare në Kosovë: Lidhja Demokratike e Kosovës, kryetar i parë i së cilës do të jetë Presidenti i parë i shtetit të Kosovës, *Ibrahim Rugova*, për të cilin, Presidenti Clinton në librin e vet, shprehet: “Isha i bindur se me të mund të bënim një marrëveshje paqeje...”¹⁹³ Lidhja e Komunistëve të Kosovës u shpërbë si shkumë sapuni nën presionin e opinionit publik, por edhe nën vetëdijesimin e anëtarësisë se kjo parti tashmë edhe ashtu po perëndonte, e në anën tjetër të qëndruarit në këtë parti i tejkalonte perceptimet e të qenurit tradhtar. Menjëherë pas Lidhjes Demokratike të Kosovës, paraqiten edhe partitë e tjera, si: Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demokristiane, Partia Fshatare, Partia Nacionaldemokrate, Partia Republikane, etj. Të gjitha këto parti, që u themeluan në Kosovë, e pasurojnë koloritin pluripartiak, por Lidhja Demokratike e Kosovës¹⁹⁴ mbetet më e madhja dhe më e forta për të mbajtur një monopol në udhëheqje të politikës në Kosovë. Çështja se a kemi këtu të bëjmë me lëvizje kombëtare apo me parti thjesht politike mund të jetë objekt i studimit tjetër, ndonëse është shkruar mjaft për këtë. Në rastin konkret, konsideroj se të gjitha partitë politike shqiptare, bashkë me mekanizma të tjerë, përfshirë OJQ-të e para, organizatat e studentëve, intelektualët e shquar, sindikatat e pavarura, institucionet e kultit etj., përbënin lëvizjen nacionale që vepronte dhe mbijetonte brenda sistemit paralel dhe ku në Kosovë kishim jetë totalisht të ndarë: serbët pakicë dhe pushteti serbo- policoro -ushtarak në njërën anë, dhe populli shqiptar, në shumicë bashkë me përfaqësues pakicash në anën tjetër. Kështu, në rrethana të këtilla kemi dy taborë diametralisht të kundërt. Tabori shqiptar, që ishte i vendosur të ndërtojë jetën sipas sistemit të vet, që filloi t’i vërë bazat legale të funksionimit me synim barazinë me të tjerët dhe taborit serb, që kishte gjithë fuqinë ekonomike dhe ushtarake, për të imponuar pranimin e gjendjes së krijuar. Pika bashkuese në këto raporte as që mund të kishte. Por gjërat duheshin lëvizur në drejtime të caktuara.

Shqiptarët në kushtet e okupimit klasik, duhej të ndërtonin institucionet e veta, të cilat edhe duheshin bërë funksionale. Dhe kjo nuk ishte punë e lehtë. Për këtë duheshin krahas besimit

¹⁹³ Bill Clinton, *My life*, Alfred A. Knoph Borzoi Book, New York, 2004, fq.849.

¹⁹⁴ Në pranverë të vitit 1991 Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kishte 700.000 anëtarë dhe kishte zyra në Zurich, Stuttgart dhe në Bruksel në mes qytetesh të tjera. Marrë nga: G.Richard Jansen, <http://lamar.colostate.edu/grjan/kosovohistory.html>, fq.9 (parë më: 29.12.2013).

të qytetarëve edhe burimet financiare, të cilat mungonin plotësisht. Disa elemente të shoqërisë tradicionale shqiptare, që ishin ruajtur deri tash, tregohen të dobishme për këto rrethana, për shembull familjet e mëdha. Në anën tjetër homogjenizimi dhe solidariteti i brendshëm bëri që të organizohet një veprimtari e shuarjes së hasmërive brendashqiptare, e njohur me aksionin e pajtimit të gjaqeve. Përmes aktiviteteve të prira nga studentë dhe intelektualë, mes viteve 1990-1992 nëpër ceremoni publike u pajtuan 1000 gjaqe; kur policia shpërndau tubimet, pajtimi mbarëshoqëror (në kuptimin e besës tradicionale) vazhdoi nëpër shtëpi. Përballë presionit nga qeveria serbe, shoqëria shqiptare shtrëngoi radhët.¹⁹⁵

Lidhja Demokratike e Kosovës mori përgjegjësinë e udhëheqjes së lëvizjes nacionale shqiptare në Kosovë dhe në një mënyrë edhe të të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi. Kjo lëvizje kishte nevojë edhe për struktura, të cilat në fjalorin politik të kohës quhen si struktura paralele apo pushteti paralel i shqiptarëve në Kosovë. E ky pushtet kishte përkrahje të plotë qytetare jo vetëm shqiptare, sepse krahas shqiptarëve pati përkrahje, në një masë të caktuar, edhe nga myslimanët, turqit, romët, etj. Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen ku u aprovua Kushtetuta e Republikës së Kosovës aprovoi edhe Rezolutën për Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur dhe në bazë të kësaj mori vendim për organizimin e referendumit popullor lidhur me Rezolutën. Këto dokumente sado, që në kontekst të rrethanave dukeshin iluzione, ato nisën të japin efektet e tyre të përgjithshme. Në bazë të Rezolutës së përmendur, një vit më pas u organizua referendumi gjithëpopullor, me të cilin u tregua akti i vetëpërcaktimit demokratik, politik të popullit shqiptar lidhur me statusin kushtetues dhe politik të Kosovës pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave.¹⁹⁶ Referendumi u organizua përmes Kuvendit që shpalli Kushtetutën e që po punonte në ilegalitet. Një pjesë e delegatëve qëndronin në Kosovë dhe një pjesë tjetër ishin detyruar të iknin në Kroaci e Slloveni, por edhe më larg, duke ikur nga përndjekjet dhe burgosjet që u kanoseshin nga pushteti serb. Por, pavarësisht nga kjo, Kuvendi po gjente rrugë dhe mënyra për të vepruar. Dhe duhet potencuar se tash të gjithë delegatët e këtij Kuvendi, edhe pse të zgjedhur në kohën e dominimit të Lidhjes Komuniste dhe të kaluar nëpër filtrat e saj, po bashkëpunonin në koordinim të plotë me Lëvizjen Kombëtare - LDK dhe partitë e tjera politike. Këta delegatë, duke vepruar në këtë frymë, nisin të ndërmarrin edhe veprime të tjera dhe të nxjerrin vendime për jetësimin e synimeve, që po përcaktoheshin bazuar në lëvizjet e procesit të

¹⁹⁵ Oliver Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.249.

¹⁹⁶ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.61.

(shpër)bërjes së Jugosllavisë. Referendumi u mbajt në Kosovë më 26 - 30 shtator 1991 dhe në të me shumicë absolute (mbi 99% e zgjedhësve nga 87% e trupit elektoral që votoi në referendum) u deklarua për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur.¹⁹⁷ Vetëdijesimi qytetar, përkushtimi dhe guximi i liderëve të lëvizjes bënë që organizimi i referendumit sikundër edhe administrimi i rezultateve të bëhet me sukses të plotë. Sepse nuk ka qenë e lehtë që në ato rrethana të shtetit policoro - ushtarak serb të ndërmerreshin dhe të organizoheshin këso veprimesh. Në bazë të rezultateve të referendumit, Kuvendi i Kosovës me 19.10.1991 shpall Rezolutën për Republikën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo rezolutë i ngjasonte rezolutave që kishin nxjerrë edhe republikat e tjera të Jugosllavisë në pozicionimin e tyre për të ardhmen. Edhe Kosova po përcaktohej për një republikë të pavarur të hapur ndaj dy entiteteve: Shqipërisë dhe Serbisë, sepse për shqiptarët e Kosovës, kur Jugosllavisë do t'i shkëputeshin Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina e Maqedonia, opsioni i mbetjes në atë, që do quhej më vonë Republika Federative e Jugosllavisë, e që do ta përbënin vetëm Serbia dhe Mali i Zi, ishte krejtësisht i papranueshëm. Në ditën e aprovimit të Rezolutës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, Kuvendi i Kosovës ka plotësuar dhe ndryshuar Kushtetutën e nxjerrë një vit më parë, duke aprovuar amendamentet: I, II dhe VI, të cilat krijojnë zgjidhje të reja për situatë dhe rrethana të tjera. Nga këndvështrimi dhe konteksti i tashëm kohor dhe nga analizat sipërfaqësore, jo rrallë hasim mendime, se për kohën për të cilën po flasim, kishim të bënë me improvizime taktike e politike duke nxjerrë ligje e kushtetuta dhe duke organizuar zgjedhje parlamentare, të cilat nuk po zbatoheshin në jetën praktike dhe nuk po i shërbenin nevojave të qytetarëve të Kosovës. Këto mendime të shprehura në forma deklaratash politike dhe të nxjerra nëpër fletushka e revista, nuk japin një pasqyrë reale të gjendjes dhe nuk janë të bazuara në studime empirike; nuk duhet marrë seriozisht për nevoja shkencore dhe madje as për nevoja të politikës ditore. Është tjetër fakti se në momente të caktuara ka pasur pragmatizëm të tepruar dhe arsyetime për mosbërje të bazuara në racionalizëm politik. Liderët e lëvizjes politike të këtyre viteve të lëvizjes, ndoshta për herë të parë në histori po qëllonin të ishin totalisht në pajtim me synimet e përgjithshme popullore, dhe për më tepër, për herë të parë po tregonin dije dhe shkathtësi sikundër edhe guxim që t'i prinin një procesi personalisht me rreziqe të mëdha, kurse kombëtarisht me vlerë të përhershme. Në këtë kontekst, kur kthehemi tek amendamentet e Kushtetutës së 7 shtatorit ata po udhëzonin Kuvendin që të krijonte bazën për veprimet që do të pasonin. Në këtë drejtim Kuvendi

¹⁹⁷ Po aty.

i Kosovës, me 19 tetor të vitit 1991 miratoi amendamentin I dhe amendamentet II-VI, me të cilat bëri ndryshimin e dispozitave adekuate të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁹⁸ Ndryshimet kishin të bënin me funksionet dhe me zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës dhe atij po i jepnin funksionet që më parë i kishte Kryesia e Kosovës; po përgatitej baza juridike për krijimin e qeverisë së re, e cila bazuar në gjendjen e vështirë do të autorizohet që të nxirrte dekrete me fuqi ligjore, sepse ishte e qartë se në Kosovë kishim të bënim me gjendje të jashtëzakonshme dhe mundësitë për mbledhje të shpeshta të parlamentit ishin shumë të vogla. Qeveria autorizohet për aq kohë sa do të zgjaste gjendja e jashtëzakonshme që të ushtronte funksionet që realisht do të duhej t'i takonin parlamentit. Kryetari i Kosovës, tash me ndërrimet e aprovuara do të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. E sesi do të zbatohen këto dispozita të reja do t'i shohim shumë shpejt, kur në Kosovë do të organizohen zgjedhjet e para shumëpartiake. Por para se të flasim për këtë proces është me rëndësi të nënvizojmë edhe disa aspekte në të cilat duhej bazuar politika në Kosovë.

Sipas N.Malcolm politika themelore e ndjekur nga Rugova në LDK, që nga viti 1990 ka pasur tri aspekte:

*së pari, për ta penguar revoltën e dhunshme; së dyti, për ta “ndërkombëtarizuar” problemin e Kosovës, që do të thotë për t'i kërkuar format e ndryshme të ndërhyrjes politike ndërkombëtare (duke filluar me ndërmjetësimin diplomatik e deri te vënia e protektoratit të Kombeve të Bashkuara mbi Kosovën); dhe së treti, për të mohuar sistematikisht legjitimitetin e pushtetit serb, duke i bojkotuar zgjedhjet dhe regjistrimet dhe duke krijuar së paku konturet e një aparati shtetëror të “Republikës” së Kosovës.*¹⁹⁹

Kurse, filozofinë e asaj rezistence paqësore dhe kërkimin e zgjidhjes për daljen nga kjo situatë e zhvilloi lideri i LDK-së, Ibrahim Rugova. Shtresat e gjera të popullatës e pranuan atë lëvizje, si edhe Rugovën si lider.²⁰⁰ Revolta e mundshme në një gjendje të një pushtimi të ashpër ushtarako- policor nuk ishte e pamundur, por pasojat do të ishin katastrofike. Argumentet për këtë mund të gjenden nëpër shkrime e përshkrime ngjarjesh, por edhe në punime të ndryshme

¹⁹⁸ Po aty, fq.62.

¹⁹⁹ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha Prishtinë&shtëpia e librit Tiranë 2001, fq.363.

²⁰⁰ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë –Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq. 337.

dhe këtë e vërtetuan shumë shpejt revoltat kroate dhe boshnjake, të cilat krahasuar me Kosovën kanë pasur mundësi të organizoheshin ushtarakisht. Dhe, edhe pse të organizuara ushtarakisht e patën shumë të vështirë fitoren për liri, të cilën pa ndërhyrje ushtarake të jashtme edhe mund ta fitonin. Por çmimi i fitores së tyre pa ndërhyrje dhe ndihmë nga jashtë, ishte vështirë madje të supozohej. Bazuar në këtë, vitet për të cilat po flasim, janë vite që evitimi i revoltës ka qenë diçka që i ka takuar gjithashtu emancipimit politik të shqiptarëve. Por sigurisht, idetë bashkë me përgatitjet e opsioneve të tjera, krahas rezistencës paqësore, janë dashur të zhvillohen. Dhe kjo mund të jetë temë e një studimi tjetër apo së paku pjesë e një debati tjetër akademik.

Elementet e shtetësisë fillojnë të ndërtohen përmes veprimeve për të mbajtur jetën dhe kontrollin ndaj qytetarëve të Kosovës, që çdo ditë e më shumë ballafaqoheshin me terrorin e pushtetit serb, dhe me vështirësitë ekonomike. Republikës së shpallur të Kosovës i duheshin organet shtetërore që do të kishin legjitimitet demokratik. I duhej një qeveri që do të krijonte mekanizma për të siguruar jetën e qytetarëve. Kështu pavarësisht vështirësive dhe rreziqeve, pas miratimit të amendamenteve kushtetuese të Kushtetutës së shtatorit të 1990-ës, bazuar në bazën juridike u shpallën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Zgjedhjet u mbajtën me datën 24.05.1992 në të cilat për herë të parë populli po zgjidhte përfaqësuesit e vetë drejtpërdrejt. Duke i shtypur fletëvotimet në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe turqisht) popullsia shqiptare e Kosovës dëshironte të tregonte se e përfaqonte një shtet shumëgjuhësor.²⁰¹ Edhe ky akt i fletëvotimeve tregon pjekurinë qytetare karshi pushtetit serb i cili, kishte treguar urrejtje edhe ndaj gjuhës shqipe duke tentuar për vite e dekada të impononte gjuhën serbe dhe madje alfabetin cirilik te një vend me shumicë gjithmonë shqiptare. Me 99,7% të votave Ibrahim Rugova u zgjodh President; partia e tij LDK, në zgjedhjet parlamentare fitoi 76% të votave. 14 vendet e rezervuara për popullsinë sllave mbetën të zbrazëta për shkak të bojkotit të shumicës së serbëve dhe të malazezëve.²⁰² Edhe pse zgjedhjet, në një mënyrë sikur u shikuan me gjysmë syri të mbyllur nga pushteti serb, parlamenti nuk u konstitua asnjëherë formalisht, sepse thirrja e mbledhjeve plenare ishte i pamundur. Mund të bëhej me pasoja të paparapara. Sidoqoftë, deklarohet se po punohej nëpër komisione, kurse Qeveria e Kosovës në pamundësi që të vepronte në Kosovë, vendosi të punojë në ekzil duke e bartë selinë e vet në Bon të Gjermanisë. Atje arrihet me sukses të themelohet Fondi, në të cilin shqiptarët e punësuar në perëndim kontribuonin me 3% të të

²⁰¹ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha Prishtinë, 2012, fq.250.

²⁰² Po aty.

ardhurave të tyre në baza, me çka bashkë me sistemin e tatimit në bazë të të ardhurave, mbahej jeta sociale dhe organizimi politik e shoqëror në Kosovë. Me këto fonde që mblidheshin, më së shumti duhej financuar sistemi i arsimit në Kosovë. Më 1993 prej këtij fondi u financuan rreth 20.000 mësues, ligjërues dhe profesorë për arsimimin e 317.000 nxënësve dhe 12.000 studentëve.²⁰³ Derisa shkollat fillore dhe të mesme u mbyllën për nxënësit shqiptarë, ato u hapën sërish në pjesën më të madhe për të mundësuar zhvillimin e mësimin në gjuhën shqipe. Kjo u bë për dy arsye: e para, se pushteti serb/jugosllav dëshiroi t'i ikte komprometimit ndërkombëtar, në së paku këtë fushë dhe së dyti, ishte e pamundur të mbyllej çdo shtëpi që ishte shndërruar në shkollë për zhvillimin e mësimin në gjuhën shqipe. Por megjithatë, aty ku kishte serb ndarja nëpër lokale ishte tërësisht e tipit segregacionist. Mësimi ose zhvillohej nëpër turne të ndryshme: veç për shqiptarët e veç për serbët, ose bëhej në lokale të veçanta. Hyrja në lokale, nuk ngërthente financimin nga pushteti serb. Kjo bëhej nga sistemi i përmendur i tatimit nga qeveria në ekzil dhe nga të hyrat brenda Kosovës. Në mësimin universitar masat gjithashtu ishin drastike. Në fillim të vitit shkollor 1992-93 policia serbe nuk i lejoi studentët shqiptarë të hynin nëpër objektet universitare.²⁰⁴ Kjo bëri që universiteti shumë shpejt të riorganizohet dhe të gjithë profesorët shqiptarë, të përjashtuar nga universiteti publik, të vazhdonin punën me studentë nëpër shtëpi private. Universiteti i Prishtinës, për pushtetin serb ka qenë halë në sy, përherë dhe në veçanti nga demonstratat e vitit 1981 dhe këndej. Në zhargonin politik serb për universitetin thuhej se ishte “çerdhe e nacionalizmit shqiptar”. Sistemi i arsimit në Kosovë, që edhe sot e hasim të quhet sistemi paralel, ka arritur të mbajë mësimin dhe nuk ka kontribuar vetëm në edukimin e masave, por edhe ka mbajtur gjallë jetën e nxënësve dhe të rinjve, të cilët krahas dijes iu jepej edhe shpresa dhe besimi se do të kishin të ardhme. Edhe sistemi i shëndetësisë është një hallkë e rëndësishme që tregon vetorganizimin dhe emancipimin e shqiptarëve të Kosovës. Besimi në shëndetësinë e ofruar serbe kishte humbur, kurse mjekët privatë fillojnë të krijojnë klinikat e tyre modeste të cilat jepnin një ndihmë në këtë segment të rëndësishëm të jetës shoqërore. Në anën tjetër ishte organizata Nëna Terezë, ajo që shquhej me aktivitete dhe me

²⁰³ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq. 66.

²⁰⁴ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 - 1999*,Koha,Prishtinë, fq.67.

ndihma të shumëllojshme në këtë fushë. Deri në vitin 1998 kjo shoqatë krijoi një rrjet prej 91 klinikash në të gjithë krahinën.²⁰⁵

Lidershipi i Kosovës, të cilit i printe Ibrahim Rugova si kryetar i zgjedhur i Kosovës, bashkë me partinë e vet, LDK-në, tregohen mjaft të suksesshëm dhe qysh në vitet e para të rezistencës luajtën rolin e tyre udhëheqës. Krijohet një klimë tolerante brenda trupit social shqiptar, një klimë pluraliste, por edhe shumë homogjene në kuptimin nacional në përpjekjet për liri dhe pavarësi. Kjo parti kishte arritur të themelonte degët e veta edhe në perëndim dhe edhe në SHBA. Në vitet e para të organizimit të jetës politike dhe institucionale, arrihet një kohezion i fuqishëm i forcave politike që vepronin në Kosovë dhe i forcave politike që kishin vepruar si organizma të veçantë në diasporë, që edhe sot e kësaj dite konsiderohen se janë, si mekanizma me elemente marksiste - leniniste, etj. Ajo që dua të theksoj me forcë është fakti se në vitet e para kishte një pajtueshmëri në mes të qeverisë në ekzil, LDK-së dhe gjithë këtyre organizatave të perëndimit. Dhe në këtë kontekst do të nënvizoj gjithashtu se të gjitha manifestimet që bëheshin në diasporë, krahas ndihmës financiare përmes fondit të përmendur, por edhe përmes ndihmës së drejtpërdrejtë që iu bëheshin familjeve në Kosovë janë kontribut shumë i çmuar i mbajtjes së jetës në Kosovë, por janë gjithashtu kontribut i ndërkombëtarizimit të çështje së Kosovës, segment ky shumë i rëndësishëm për fazat e ardhshme të zhvillimeve në dhe për Kosovën. Edhe shqiptarët në diasporë, me dije e përkushtim, tregojnë pjekurinë dhe emancipimin politik; ata do të stimulohen nga të rinjtë e shkolluar në Kosovë.

Kursi i politikës nën okupim do të ndryshojë krahas zhvillimeve dramatike që po bëheshin në Kroaci dhe në veçanti në Bosnjë e Hercegovinë dhe ku domosdoshmërisht filloi të zhvillohet mendimi për diçka ndryshe edhe në Kosovë. Fillohet të mendohet se edhe Kosovën po e priste ajo që tash Bosnja po e pësonte. Kjo po fillonte të krijonte përçarjet brenda lëvizjes politike shqiptare, që gjithashtu tregon emancipimin politik të shqiptarëve, pavarësisht kërkesave dhe nismave për qasje të ndryshme në përpjekjet për liri dhe pavarësi të Kosovës. Në këtë vazhdë aktivitetesh dhe në një kohë kur tashmë qasjet radikale kishin filluar të vepronin në terren, në Kosovë mbahen edhe zgjedhjet e dyta të përgjithshme, me datën 22 mars 1998, me ç'rast sërish u zgjodh Kuvendi dhe Kryetari i Kosovës. Edhe ky Kuvend nuk arriti që të

²⁰⁵ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.68.

mbilidhej asnjëherë, qoftë edhe formalisht, ndërkohë që ngjarjet marrin kahje krejtësisht dramatike sepse edhe në Kosovë tash kishte filluar konflikti dhe lufta e armatosur, siç do ta shohim në kreun vijues. Lidhur me zgjedhjet dhe me organizimin e jetës politike, sidomos pas Konferencës së Dayton-it janë zhvilluar debate të shumta ku dallohen pozicionimet që pas vitit 1995 jeta politike në Kosovë ka qenë e paefektshme dhe se është dashur qasje tjetër dhe pozicionim më i butë, sipas të cilit radikalizimi i hershëm ka mundur të çojë te pasojat e paparapara. Njëra dhe tjetra qasje kanë argumentet e veta, por qasja më realiste duhet të qëndrojë diku në mes: ka mundur të ketë koordinim më të mirë mes dy qasjeve.

Sidoqoftë, në Kosovë vitet e fundit të shekullit XX, tregojnë unitet, homogjenizim, solidaritet dhe gatishmëri për sakrificë dhe të gjithë tregojnë emancipimin e plotë të shqiptarëve të Kosovës që u kurorëzuan me vënien e bazave legale: nxjerrjen e Deklaratës së 2 Korrikut, nxjerrjen e Kushtetutës dhe amendamentimin e saj, mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe organizimin e jetës në rrethana të një terrori dhe dhune të ashpër. Emancipimi politik u arrit nga brenda dhe nga jashtë përkundër turbulencave që arsyetohen kur paraqiten në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme dhe, apo në gjendje të luftës, ky është faktor vendimtar për ruajtjen e një populli dhe për realizimin e aspiratave të tij.

KREU IV: Institucionet e Kosovës dhe Faktori Ndërkombëtar

4.1. Daytoni dhe Kosova

Dy njësi federative Sllovenia dhe Kroacia, të dyja me specifika të veçanta, kishin shpallur pavarësinë dhe po bënë përpjekje që të ndërtonin shtetet e tyre. Bosnja dhe Herzegovina një republikë me një përbërje të përzier etnike, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë²⁰⁶ u gjend në një luftë të tmerrshme, ndër më të tmerrshmet në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. Tri grupe etnike të saj kishin orientime të ndryshme sa i përket ndërtimit të brendshëm të Bosnjës dhe Herzegovinës. Boshnjakët përpiqen të ndërtojnë shtetin unitar të qytetarëve të Bosnjës dhe të Herzegovinës, ndërsa kroatët kërkojnë krijimin e shtetit në parime konfederale kurse serbët kërkojnë krijimin e shtetit serb të Bosnjës në union me Jugosllavinë ose edhe me Bosnjën e Herzegovinën që ndërkohë po ristrukturohej.

Kosova në anën tjetër ishte vënë nën një pushtet të dhunshëm dhe segregacionist serbo-jugosllav ku popullata shumicë (shqiptarët), që aspironte pavarësinë, në një mënyrë ishte “paqësuar” në sajë të një lëvizjeje që udhëhiqej nga Ibrahim Rugova, lider kryesor i shqiptarëve të asaj kohe. Edhe pse ishte shpallur pavarësia, Kosova nuk ishte njohur nga askush, përveçse nga Shqipëria. Të përjashtuar dhunshëm tërësisht nga sistemi, shqiptarët në Kosovë ndërtojnë institucione paralele, në veçanti në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë dhe aplikojnë një strategji refuzimi të shtetit dhe të institucioneve serbo - jugosllave. Ndërkohë që Millosheviçin nuk e pengonte një politikë e rezistencës paqësore, në kohën e luftimeve në Bosnjë dhe në Kroaci.²⁰⁷ Lufta dhe tmerret e saj në Bosnjë dhe Herzegovinë në një mënyrë e kishin vënë nën hije çështjen e Kosovës. Faktorët kryesorë vendimmarrës më shumë merreshin me 6 njësi të ish-Federatës Jugosllave që emërtoheshin republika. Vojvodina pothuaj ishte pajtuar me politikën zyrtare serbe si dhe me mosqenien e saj pjesë e Federatës. Kosova lihej mënjanë edhe nga shkaku i emërtimeve kushtetuese, por më shumë nga shkaku se Kosova edhe ndoshta mund të priste sepse situata në Kosovë ishte e qetë. Në Kroaci kishte filluar një luftë e ashpër sepse në atë kohë qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare nuk ishin për ndryshime të kufijve të brendshëm të

²⁰⁶ Lufta në Bosnjë e Herzegovinë zyrtarisht ka filluar më 6 prill 1992, një ditë përpara njohjes, kurse Deklarata e Pavarësinë së Bosnjës e Herzegovinës është bërë më 28.02.1991.

²⁰⁷ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta antikolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.338.

njësive federative. Kjo ishte e papranueshme për Serbinë, e cila kishte një projeksion krejtësisht tjetër. Republika e Serbisë ishte shprehur hapur se serbët duan që të mbesin në Jugosllavi dhe kushdo që dëshiron të dalë nga Jugosllavia do të dalë pa serbët. Serbët në Kroaci kishin krijuar atë që njihet si “Srpska Krajina“ dhe në Bosnjë po krijonin Republikën Serbe. E gjithë kjo po bëhej me një luftë të tmerrshme, ku serbët po përdornin Armatën Jugosllave, si një ndër ushtritë më të forta të kohës që ishte e dominuar nga serbët. Agjenda e Bashkësisë Ndërkombëtare, pas shpërthimit të konfliktit të armatosur, ngarkohet krejtësisht me Bosnjën ku armata jugosllave “nisi një strategji të spastrimit etnik, shkatërrimit dhe shfarosjes së popullsisë kryesisht myslimane, që e tejkaloi brutalitetin e aksioneve në Kroaci. Situata ishte vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare objektive, duke filluar prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së e deri tek Asambleja e Përgjithshme si edhe nga trupat e të drejtave të njeriut, si e karakterizuar me shkelje neveritëse të të drejtave të njeriut që duhet të ndaleshin menjëherë, kurse pasojat duhej të sanoheshin. Megjithatë, nuk ishte e mundur të ndërmerreshin veprime jashtë miratimit të sanksioneve dhe zbakimit, me gjysmë zemre, të paqeruajtësve të OKB-së, që dështuan në përmbushjen e mandatit të tyre me agresivitet”.²⁰⁸ Ballkani edhe kësaj radhe po injorohej apo edhe mund të mos njihet sa duhet, prandaj edhe injorohet. Por ka edhe diçka tjetër. Është interesi i veçantë i shteteve të caktuara për përzierje sipas këndvështrimit apo interesit vetjak shtetëror. Dhe kjo u vu re sidomos gjatë viteve 1990 - 1995. Për Gjermaninë ishte joshja e zgjedhësve të tyre me prejardhje kroate, për Austrinë përfitimi nga pasuritë dhe afritë e shumta me Slloveninë fqinje, për Vatikanin mbështetja e bashkësisë së numërt katolike të Kroacisë.²⁰⁹ Politika dhe vendosmëria e bashkësisë ndërkombëtare nuk ishin as për së afërmi në koherencë me deklarativen e jo më me Bosnjën dhe me Kosovën.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë pothuaj katër vitet të tëra shohim përpjekje joefektive diplomatike të OKB-së, të Komunitetit Europian dhe të SHBA-së dhe vetëm pas disa ngjarjeve, për të cilat në asnjë mënyrë s’mund të heshtshin, por dhe as të përzireshin, administrata e Presidentit Clinton, vendosi të dërgojë Richard Holbrook-un në përpjekje të përgjithshme negociuese, për të përfunduar luftën. Krimet në Bosnjë, sidomos rasti i bombardimit të tregut të Sarajevës, të kryer më 05.02.1994 dhe të masakrës së Srebrenicës, ku u masakruan rreth 8.000 burra dhe djem boshnjakë në një zonë të OKB-së, nuk mund as të fshiheshin dhe as të mbeteshin

²⁰⁸ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.102.

²⁰⁹ Pierre Dufour, *Kosova – Paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq.115.

në heshtje. Për më tepër cinizmi dhe ironia serbe shkuan aq larg, sa që disa qindra paqeruajtës të OKB-së u zunë peng dhe do të përdreshin si trupa të gjallë mbrojtës ndaj sulmeve të mundshme të NATO-s. Kështu, pas përpjekjeve të gjata dhe joefektive të bashkësisë ndërkombëtare, të komunitetit europian dhe OKB-së, administrata e Presidentit Clinton vendosi të ndërmarrë iniciativën e udhëhequr nga z.Richard Holbrooke për një proces ndërmjetësimi në konfliktin mes tri palëve: ish-Republikës Federative të Jugosllavisë²¹⁰, Kroacisë dhe Bosnjës e Herzegovinës. R.Holbrooke, luftën e Bosnjës e quajti si “dështimi më i madh kolektiv i perëndimit qysh nga vitet 1930”.²¹¹

Para kësaj iniciative amerikane paaftësia e bashkësisë ndërkombëtare u tregua dhe u vërtetua në rastet e dështimit të katër propozimeve për paqe: plani Carrington – Cutileiro, i vitit 1992 që pretendonte të krijonte konfederatën e tipit zviceran me kantone, plani Vance – Owen, i vitit 1993, plani “invincible”, i vitit 1993 dhe plani i Grupit të Kontaktit, i vitit 1994, që pretendonte të bënte ndarjen e Bosnjës sipas linjave etnike.²¹² Këto plane ose dukeshin se ishin të papranueshme, sidomos për serbët dhe boshnjakët, ose dukeshin se nuk ishin nxjerrë me përkushtim të sigurtë. Në të vërtetë lufta e Bosnjës për shumë kohë u konsiderua si luftë ku nuk dihet se kush është viktimë dhe kush është agresor, apo si një luftë në bazë të së cilës qëndron konflikti i brendshëm, ku shtetet e huaja nuk kanë çka të kërkojnë. Madje- madje që të dyja palët ndërluftuese trajtoheshin në mënyrë të njëjtë, dhe mbaheshin njëllor fajtorë. Gjatë një lufte të tmerrshme, të ndjekur me një politikë ndërkombëtare të paaftë, në Bosnjë u vranë qindra mijëra njerëz, 2 milionë njerëz mbetën të pastrehë dhe gjatë këtyre viteve u shpik termi “pastrim etnik”, që aq shumë u zbatua në Bosnjë, për të vazhduar më vonë edhe në konfliktin dhe në luftën e Kosovës. Në fillim të luftës Armata Popullore e Jugosllavisë (JNA) luftoi drejtpërdrejt në anën e serbëve dhe pas datës 05.05.1992, kur u detyrua të bëjë tërheqjen e trupave të saj nga Bosnja për shkak të presionit të bashkësisë ndërkombëtare, JNA u zhvesh nga detyra e komandimit të rreth

²¹⁰ Republika Federative e Jugosllavisë, pas njohjes ndërkombëtare të Sllovenisë, të Kroacisë dhe Bosnjës e Herzegovinës, ishte vetëshpallur trashëgimtar i Jugosllavisë së kaluar dhe kjo përbëhej nga Serbia, Mali i Zi dhe nga Kosova që po mbahej dhunshëm dhe pa vullnetin e saj në këtë lloj kreature false. Vojvodina nuk përmendej aspak, sepse ajo tashmë ishte pajtuar me humbjen e subjektivitetit të vet. Në negociatat lidhur me zgjidhjen e konfliktit të Bosnjës në emër të serbëve të Bosnjës përgjegjësishin e morri Republika Federative e Jugosllavisë me në krye Millosheviçin.

²¹¹ Siç është cituar nga Thomas G.Weiss, “Collective Spinelessness: U.N. Actions in former Yugoslavia, in The World and Yugoslavia’s Wars”, edited by Richard H.Ullman (New York, A Council on Foreign Relations, 1996), 90.

²¹² Për më shumë detaje të këtyre planeve shih: David Owen’s Balkan Odyssey, New York, Harvest Book, 1995.

100.000 trupave të fortë dhe kështu në mënyrë efektive u krijua armata e serbëve të Bosnjës²¹³, armatë kjo që do mbahet mend përherë për krimet dhe gjenocidin e kryer në Bosnje dhe Herzegovinë.

Iniciativa amerikane, që do udhëhiqej nga Holbrooke do të ballafaqohej me vështirësi të shumta: duhej të ndërpritej lufta e përgjakshme, duhej siguruar lirimi dhe tërheqja e sigurt e pengjeve të OKB-së të kapur nga serbët dhe duhej siguruar një ridimensionim i vijave territoriale që ndanin territorin e Bosnjës. Tash kishte mbetur fare pak kohë që të bëhej diçka për të shpëtuar një popull nga shfarosja, por edhe për të shpëtuar fytyrën e demokracive perëndimore lidhur me paaftësinë e tyre. Në fund të muajit gusht 1995, NATO ndërmori sulme ajrore kundër caqeve të forcave serbe, duke ndjekë sulmet që serbët po bënin kundër qytetit të rrethuar të Sarajevës. Në shtator Holbrook arrin t'i bindë liderët serbë të Bosnjës që të nënshkruajnë një marrëveshje për heqjen e rrethimit të Sarajevës si dhe për përcaktimin e një kornize përfundimtare të bisedimeve të paqes që do të mbaheshin në Dayton (Ohajo) të SHBA-së. Para marrëveshjes së Dayton-it situata në terren kishte sjellë një gjendje të atillë ku akti është kryer. Serbët e Bosnjës kontrollonin 46% të territorit apo 23,687 km², myslimanët kontrollonin 28% ose 14.505 km² dhe kroatët 25% apo 12,937 km². Marrëveshja e Dayton-it u nënshkrua dhe përfundoi në Paris me nënshkrimin e saj me 14 dhjetor 1995, kurse politika kosovare, e prirë nga Ibrahim Rugova, nuk arriti të jetë pjesë e Konferencës. Kjo Konferencë ishte imponuar nga gjendja tepër e rëndë në terren dhe nga veprimi sipas asaj që shërbente si udhëzuese e që njihet me emrin *realpolitika*²¹⁴ e përdorur me tepri për të hequr qafe një gjendje të vështirë, por dhe nuk ishte aspak një mjet politik moral për zgjidhjen e konfliktit.²¹⁵ Kjo e kishte çuar mbarë bashkësinë ndërkombëtare të negocionte me atë që njihet si iniciatori kryesor i gjithë konflikteve në Ballkan, Slllobodan Millosheviçin. Pjesa më interesante e përpjekjeve të Millosheviçit për të krijuar Serbinë e Madhe, qoftë në formën e një federate të centralizuar apo të një shteti të pastër etnik serb, ishte ajo që lidhej me bashkësinë ndërkombëtare. Manovrat diplomatike të Millosheviçit

²¹³ Shih: Laura Silber&Allan Little, *Yugoslavia: Death of a Nation*, London, Penguin Books 1996, fq.225.

²¹⁴ "Realpolitik", fjalë që i kushtohet që në zanafillë politikës së jashtme të Bizmarkut. Për një shtet, kjo ka të bëjë me zhvillimin e një politike të jashtme, që bazohet në një parim lëvizës: pragmatizmin, në vend të një ideologjie dhe një politike të përcaktuar në mënyrë të qartë. Ajo nënkupton nënshkrimin e të gjitha marrëveshjeve të mundshme në të gjitha fushat, edhe me armiqtë, por me kusht që t'u shërbejnë interesave të menjëhershme kombëtare edhe nëse duhen denoncuar këto aleanca që të nesërmen, në çastin që nuk u shërbejnë interesave, aleancat e kundërta bëhen më të favorshme. Kjo është një formë cinizmi në politikën e brendshme. Cituar nga Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq.122.

²¹⁵ Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, 2010, fq.122.

bazoheshin në një logjikë të thjeshtë: plogështia dhe qëndrimi shfajësues i bashkësisë ndërkombëtare në vitet e para të luftës, i dhanë mundësi që ta kundërvinte një faktor ndërkombëtar ndaj një tjetri.²¹⁶ Se tash, kur situata në Bosnjë dhe Hercegovinë kishte shkuar aq larg të dukej se edhe Ballkani nuk po njihej mirë. Dhe, “tmerri nuk do të përfundojë përderisa Europa vazhdon ta injorojë Ballkanin”.²¹⁷ Europa edhe në këtë kohë duket se nuk e njeh mirë Ballkanin dhe kështu europianët gjatë gjithë kohës vepronin të ndarë e të përçarë dhe është e qartë, që sikur SHBA të mos shfrytëzonte rastin për të ndërhyrë, pasojat do të ishin shumë më të mëdha.

Në Kosovë, në rrethanat e një lufte tepër të ndyrë, sidomos në Bosnje dhe Hercegovinë, po mbretëronte një pacifizëm që nga kjo perspektivë kohore mund të emërtohet me emër tjetër dhe gjithashtu mund të karakterizohet me përmbajtje tjetër. Mund të ngremë pyetje nga më të ndryshmet nëse pacifizmi i udhëhequr nga Rugova ishte gjëja më e qëlluar që po jepte rezultate në kohën kur “bashkësia ndërkombëtare e trajton Millosheviçin jo vetëm si një burrë të respektueshëm shteti, por edhe si një garantues të paqes dhe të stabilitetit në rajon”.²¹⁸ Këto pyetje kishin filluar t’i bëheshin Rugovës drejtpërdrejt në Prishtinë, nga individë dhe grupe të caktuara, që mendonin se ka ardhur koha e të bërit ndryshe. Mosinkuadrimi i Kosovës në negociatat për Kosovën, në vendin ku ka filluar kriza dhe ku mendohej se edhe do të përfundonte, ngjalli frikë dhe ndjenjë defetizmi brenda trupit social shqiptar, tek i cili fillojnë të paraqiten dukshëm më shumë përçarjet. Ibrahim Rugova, me politikën e tij paqësore, u gjend në hall para rrezikut se bota do të imponojë ndonjë zgjidhje gjysmake apo zgjidhje të keqe për Kosovën.²¹⁹ Shqiptarët, një pjesë e madhe e tyre, ndihen të lënë mënjane dhe të tradhtuar dhe nga këndvështrimi i tyre u bë e qartë se politika e rezistencës pasive, të cilën dikush e quante gandiste, politika e padëgjueshmërisë qytetare kundër pushtetit serb, kishte përfunduar. Në anën tjetër te fuqitë e mëdha, në kryeqytetet perëndimore “mbretëronte interesimi për atë se çfarë po ndodhte në fushëbeteja dhe jo në demonstrata përherë paqësore të shqiptarëve të Kosovës”.²²⁰ Pragmatizmi dhe realpolitika e diplomacisë ndërkombëtare fuqizon bindjen e shqiptarëve se

²¹⁶ Enver Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: rasti i Jugosllavisë*, Buzuku, Prishtinë, 2010, fq.208.

²¹⁷ Desturnel de Konstan, cituar nga Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa 2010, fq.114.

²¹⁸ Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, 2010, fq.122.

²¹⁹ Ekrem Avdiç&Azem Vllasi, *Shtegu njëqindvjeçar i lirisë – Lufta anticolonialiste e shqiptarëve të Kosovës në vitet 1912-2012*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.341.

²²⁰ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.252.

duhet vazhduar ndryshe dhe të vazhduarit ndryshe Ibrahim Rugovën do ta luhasë nga pozicionet e tij të pritjes dhe të mosbërit diçka. Në pozitë të vështirë po viheshin edhe shqiptarët në diasporë, të cilët krahas ndjenjës së fajësisë për ikje nga vendi, po zhvillohej mendimi se duheshin përdorur metoda tjera për t'u aktivizuar. Kështu në Kosovë do të fillojë të bjerë homogjenizimi dhe pajtimi i përgjithshëm në një vijë politike. Shqetësimi i tyre ishte edhe më i madh, meqë ministri gjerman i punëve të jashtme, Klaus Kinkel, shteti i të cilit ishte në recesion, nën pretekstin e normalizimit të gjendjes, kërkonte nga Millosheviçi ta lehtësonte kthimin e 120.000 azilkërkuesve jugosllavë, shumica prej tyre shqiptarë. Kërkesa të ngjashme priteshin edhe nga Zvicra për 50.000 shqiptarë dhe nga shtetet skandinave për 100.000.²²¹ Nëse obligimet që kishte pranuar Millosheviçi në Dayton ishin të pranueshme, kjo e kthimit të refugjatëve shqiptarë nga perëndimi do ti prishte kalkulimet e tij matematikore në kuadër të politikave serbe për spastrim etnik të territoreve të Kosovës.

Nëse kishte edhe ndonjë shkak tjetër pse Kosova nuk u përfshi në Konferencën e Daytonit dhe në marrëveshjen e saj, themi se po. Por nga ajo që deri tash më së shumti dihet publikisht është fakti se Millosheviçi ishte treguar shumë i prerë lidhur më mospërfshirjen e Kosovës në Dayton. Ai vazhdonte, me këmbëngulësinë që e karakterizonte, që këtë ta impononte duke e trajtuar Kosovën si një politikë të brendshme të vendit të tij. Richard Holbrooke u përpoq që edhe në Dayton të hapte me të çështjen e Kosovës. Holbrooke me atë rast i aktualizoi kërkesat nga "Paralajmërimi i Krishtlindjeve". Millosheviçi përsëri reagoi fuqishëm duke pohuar se Kosova është çështje e brendshme.²²² Për shkak të rrezikut të përshkallëzimit të mëtejshëm të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, debati për Kosovën u mbyll duke mos harruar që Serbisë t'i përmendet obligimi për respektimin e të drejtave të njeriut. Edhe Wolfgang Ischinger, përfaqësues gjerman në Dayton, kur deklaroi se kishte udhëzimin e ministrit Kinkel që në Marrëveshjen e Daytonit të përfshihet edhe Kosova²²³, prandaj duhen bërë disa përpjekje që Kosova të jetë e pranishme, por megjithatë gjithçka shkon sipas Millosheviçit, që refuzon, dhe me çdo kusht ngulmonte që lufta në Bosnje të përfundonte.

Bashkësia ndërkombëtare u tregua jo e qartë, inerte, herë pa vullnet dhe herë e përçarë në fazat e para të përshkallëzimit të dhunës në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Por edhe

²²¹ Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, 2010, fq.145.

²²² Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.146.

²²³ Po aty.

entitetet dhe etnitetet në momente të caktuara nuk ditën ta kuptojnë këtë gjendje të bashkësisë ndërkombëtare të cilat në momente të caktuara u treguan të paaftha që të kuptonin mesazhin që u vinte nga jashtë, të transmetuar shprehimisht apo heshtazi. Edhe Kosova bën pjesë këtu. Por duhet shtuar se Kosova në këtë kohë, pra në këto vite nuk kishte potencialin slloven as përmbajtësisht dhe as formalisht, prandaj çështjet nuk është mirë të shikohen në mënyrë daltoniste. Megjithatë shoshitja e fakteve dhe e argumenteve duhet bërë dhe në këtë kontekst domosdoshmërisht duhet tentuar t'i jepet përgjigje pyetjes nëse Ibrahim Rugova me LDK-në do të mund të bënin atë që bëri Milan Kuçani me forcat territoriale sllovene kundër armatës jugosllave. Dhe këtë në kontekst të përgjithshëm brendajugosllav dhe jashtëjugosllav. Të kthehemi te gjendja post Dayton. Millosheviçi arriti të pagëzohet si njeri i paqes dhe arriti të heqë sanksionet që ishin aplikuar kundër tij. Millosheviçi donte të mbante kontrollin në Kosovë dhe kundërshtonte çdo lloj vendosje të trupave të huaja në Kosovë.²²⁴ Daytoni i la megjithatë të ashtuquajturin murin e jashtëm, si një përkujtues se ato mund të aktivizoheshin dhe si një shenjë monitorimi. Ndërkohë bashkësia ndërkombëtare monitoronte shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe reagoi nëpërmjet rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, me të cilat u dërgoheshin paralajmërime autoriteteve të RSF-së dhe i ftonin ato që t'i tërhiqnin ligjet diskriminuese, veçanërisht ato të miratuara pas vitit 1989.²²⁵ Ai i forcuar dhe i sigurt, pasi siguroi edhe njohje ndërkombëtare të RFJ-së, nuk do të ndalet me mënyrën e tij të të ushtruarit të politikës antishqiptare.

Ngjarjet në Prishtinë nuk janë shpresëdhënëse. Daytoni bëhet si një “turning point“ për ndërrime qasjesh dhe metodash të të bërit politikë për liri dhe pavarësi. Monopoli i LDK-së dhe i liderit të saj, Ibrahim Rugova, filloi të lëkundet. Kërkesat dhe opsionet për diçka ndryshe dalin në shesh. Dalin edhe individë e grupacione që kërkojnë dinamizëm dhe sakrificë më të madhe. Disa liderë kryesor shqiptar pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dayton-it zhgënjehen nga shkaku i mospërmendjes së Kosovës. Krahas, disa të tjerë flasin për mënyrë radikale të rezistencës. Këtë më së miri e pasqyrojnë fjalët e Veton Surroit se “përkujdesja ndërkombëtare mund të tërhiqet vetëm me luftë”.²²⁶

²²⁴ Bill Clinton, *My life*, Alfred A. Knoph Borzoi Book, New York, 2004, fq.849.

²²⁵ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.148.

²²⁶ Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.50, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

Konferencat për shtyp, thirrjet për qetësi dhe për ruajtje nga provokimet, thirrja për përkrahje ndërkombëtare, që deklarohet sikur është siguruar, thirrja për organet e pushtetit që konsiderohet paralel, thëniet se ne po bëjmë jetën institucionale, etj., nisin të marrin karakteristika të një rituali që ngjason me lutje për shi në një shkretirë. Adem Demaçi, një ish i burgosur politik heq dorë nga ajo që mund të quhet shoqëri civile dhe merr përgjegjësinë e të udhëhequrit të Partisë Parlamentare dhe tregohet energjik dhe mjaft dinamik me ide dhe me veprime. Duke i kuptuar orientimit e bashkësisë ndërkombëtare se më lehtë do të ishte që të bëhej diçka brenda Jugosllavisë, ai paraqitet me ide të cilat pretendonte se mund të gjenin përkrahje brenda dhe jashtë. Dukej sikur mund të pranonte idenë e konfederatës me tri njësi: Kosovë, Serbi dhe Mal i Zi dhe këtë projekt e pagëzoi me emrin Ballkania. Me dinamizmin e vet Demaçi nuk arrin të sigurojë përkrahje gjithaq të madhe te masa brenda Kosovës, përkundër faktit se një mbështetje e dukshme po i vinte nga Shqipëria, ndërkohë që Ismail Kadare po kritikonte Rugovën se kishte futur frikë të madhe te shqiptarët në Kosovë duke ngulatur kështu lëvizje dhe opsione të tjera për lëvizjen. Grupe të organizuara në diasporë, edhe ato të zhgënjyera me rezultatet e Daytonit, dhe një pjesë e tyre të ikur më herët nga Kosova, nisin seriozisht të mendojnë dhe të ndërmarrin hapat e parë më radikalë në kuptim të ndryshimit të strategjisë për liri dhe pavarësi. Tensionet po ngriheshin qysh nga marrja e autonomisë dhe shpërthyen pasi u siguroa pavarësia e Bosnjës.²²⁷ Sloganet liri, pavarësi, Kosova shtet sovran dhe i hapur për Shqipëri dhe Serbi, jo se nuk pëlqeheshin nga njerëzit, por çështja ndryshonte, sepse nuk besohej nëse këto mund të realizoheshin vetëm duke u përsëritur ditëve të premtë në konferencat e rregullta të shtypit, ku raportohej për gjendjen në Kosovë dhe prej ku bashkësisë ndërkombëtare i drejtohen kërkesa e protesta për gjendjen e padurueshme dhe për dhunën e vazhdueshme serbe kundër shqiptarëve. Sidoqoftë, edhe për një kohë opsionet për ndryshim të kursit dhe opsionet për të vazhduar me rezistencë pasive do të vazhdojnë. Asnjëra duke mos arritur të marrë primatin, por gjithsesi forca dhe ndikimi i LDK-së dhe e Ibrahim Rugovës filloi të bjerë dhe të luhet seriozisht dhe sidomos nga shkak i mospërfshirjes së Kosovës në Dayton. Në anën tjetër lidhur me bashkësinë ndërkombëtare rreth Kosovës, vlerësimet e shumë analistëve përmbledhen në vlerësimin e Kovaçeviçit (2007) se ndoshta, në rend të dytë, arsyeja më e rëndësishme për të vendosur për Kosovën ishte paqja iluzore në Kosovë, ndërsa politikanëve në të dyja anët e

²²⁷ Bill Clinton, *My life*, Alfred A.Knopf Borzoi Book, New York, 2004, fq.849.

oqeanit u dukej se ka çështje më të rëndësishme²²⁸, si dhe në vlerësimin se administrata e SHBA-së i ishte nënshtruar iluzionit se sanksionet ekonomike dhe format e tjera të presionit do të jenë të mjaftueshme për ta bindur Millosheviçin që t'i jepte fund represionit dhe të fillonte negociatat me udhëheqësit shqiptarë për të arritur një zgjidhje politike për të ardhmen e Kosovës.²²⁹ Siç u pa, bashkësia ndërkombëtare angazhohet më shumë dhe më energjikisht kur situata në terren ta determinojë dhe kjo u vërtetua sidomos me luftën e Bosnjës dhe të Herzegovinës ku ajo ishte e ngadaltë dhe e ngathët, kurse Daytoni duke lënë anash Kosovën përfundimisht solli një polarizim në lëvizjen e shqiptarëve të Kosovës duke nxjerrë në sipërfaqe grupe të caktuara, të cilat do të tregohen më revolucionare për të kërkuar të drejtat që u takonin shqiptarëve, por me mjete të tjera, sepse pacifizmi nisi dhe po përfundonte në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve me konferenca shtypi, ndërsa në anën tjetër, çdo ditë e më shumë ushtrohej dhunë, por fatkeqësisht kjo gjendje nuk ngjallte emocion edhe pse tmerret e luftës nxisnin reagim të shpejtë. Krahas LDK-së, në Kosovë në vitin 1996 paraqitet një organizatë e re e shqiptarëve me emrin Ushtria çlirimtare e Kosovës (UÇK) të cilën e krijojnë shqiptarët e Kosovës me banim jashtë vendit. Ajo gradualisht fillon të sigurojë përkrahje të shqiptarëve sikurse në përfundim ashtu edhe në Kosovë dhe e gjithë kjo në dëm të LDK-së. Kjo organizatë forcohet ushtarakisht sidomos pas shkërmoqjes së sistemit shtetëror në Shqipëri, kur veriu i Shqipërisë bëhet poligon stërvitjeje të UÇK-së sikundër që sasi e konsiderueshme e armëve arrin në duart e UÇK-së.²³⁰

Në vijim do të shohim sesi u zhvillua ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe cilat janë efektet e politikës së kundërt nga ajo pacifiste.

4.2. Ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës

Të veprosim për liri e pavarësi, pavarësisht mjeteve dhe metodave që përdoren, në kushtet e botës moderne, në kohën e ndërvarësisë jo vetëm që nuk është e pamundur, por është një aventurë, ku përpos humbjes asgjë tjetër nuk është e garantuar. Kjo luftë është akoma më e vështirë të bëhet në kontinentin Europian. Aty ku kanë nisur dy luftëra botërore dhe aty ku

²²⁸ Kovacevic Z., *Amerika i raspad Jugoslavije*, Filip Visnjic, Beograd, 2007, fq. 212. Cituar nga Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë 2013, fq.148.

²²⁹ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.213.

²³⁰ Independent International Commission on Kosovo: *The Kosovo Report*, fq.52, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

merrej se procesi i krijimit të shteteve nacionale kishte përfunduar, dhe se tash Europa kishte marrë një rrugë më të vendosur të integritimeve. Europa që ishte tronditur dhe ishte në fazë riorganizimi.

Të veprosh për të dalë nga një shtet - federatë, me famë e me namë, që njihej për dekada me specificitetin e vet; nga një shtet që kishte diplomaci të fortë dhe të përkrahur ndërkombëtarisht; nga një shtet që kishte miq dhe përkrahës të fortë ndërkombëtarë; nga një shtet që gëzonte një mbështetje apo mbrojtje nga BRSS - Rusia e mëvonshme -por që kishte edhe një mbështetje përtej Atlantikut, ishte gjithashtu një mision i vështirë për t'u realizuar. Dhe të veprosh në një situatë kur Kosova nuk ishte prioritet për bashkësinë ndërkombëtare deri para vitit 1998²³¹ ishte më shumë se punë e vështirë. Dhe krahas këtyre Jugosllavia, si kryetare e Lëvizjes së Kombeve të Paangazhuara, ishte një lojtare e dorës së parë dhe e respektuar në arenën botërore, çka që asnjë prej shteteve pasuese nuk ka shanse ta bëjë.²³²

Në një raport dhe në rrethana të tilla ndërkombëtare dhe të brendshme do veçoja dy çështje, që megjithatë hapnin deriçkën, nëse jo derën, për ndërkombëtarizim të domosdoshëm të çështjes së Kosovës. E para, nga brenda Jugosllavia kishte marrë rrugën e shpërbërjes prej nga shihej se të gjithë, me përjashtim të serbëve ngarendnin të iknin. Dhe kjo shkonte në favor të ndërkombëtarizimit të Kosovës sepse deshën a s'deshën nuk mund të mos ishte pjesë e procesit të shpërbërjes. E dyta, në botë po ndodhnin ndryshime të mëdha prej nga po binte perandoria e kuqe dhe bota e blloqeve po përfundonte bashkë me komunizmin. Krahas kësaj edhe Europa po riorganizohej dhe ndonëse e përçarë dhe e paaftë, së paku për vitet e para të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, përfundimisht arrin të dakordohet me SHBA-në për ndërhyrje politiko-diplomatiko-ushtarak.

Siç është thënë më lart, një ndër detyrat më të vështira, që kishte marrë përsipër Ibrahim Rugova dhe lëvizja e prirë nga ai, ishte problemi i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Dhe për këtë duheshin gjetur forma të ndryshme dhe të mundshme të ndërhyrjes politike ndërkombëtare. Atij i duhej me mjete modeste, me kuadro të pakta, me rreze të vazhdueshme, së pari të krijonte strategji të qartë ndërkombëtarizimi dhe së dyti, i duheshin mjete dhe rrugë për

²³¹ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.19, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

²³² John V.A.Fine, *Rasti i jashtëzakonshëm i Josip Broz Titos*, AHS, Tiranë, 2010, fq.73.

të zbatuar këtë strategji. Fillimisht as nga shteti amë nuk kishte mundësi të gëzonte ndonjë përkrahje të theksuar. Por “midis viteve 1990 dhe 1995 vetëm interesat egoiste shtetërore përçuan vendimet e tyre”.²³³ Ai do të arrijë suksesin më të madh në unifikimin e faktorit të brendshëm, por edhe për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Sepse, siç kemi nënvizuar pas Konferencës së Dayton-it, Rugova nuk do të arrijë të jetë i vetmi opsion brenda Kosovës. Paraqiten alternativa të tjera. Megjithatë, siç vëren Akademik Stavileci, pas zhbërjes së Federatës së Jugosllavisë dhe pas zgjedhjeve për organet e Republikës së Kosovës (1992), konflikti shqiptaro – serb mori përmasa të reja. Ai nuk ishte më konflikt në suaza të mëparshme të konfliktit shqiptaro – serb brenda Jugosllavisë, por i shpërthente ato suaza, duke marrë edhe karakter ndërkombëtar, sado ende të pamjaftueshëm dhe të patheksuar.²³⁴

Demonstratat e viteve 1989-1990 kishin ngjallur një interesim të opinionit publik jashtë Kosovës dhe jashtë Jugosllavisë. Gazetarë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut ndjekin ngjarjet e rënda në Kosovë dhe raportojnë me gjuhën e tyre. Pushteti i instaluar serb në Kosovë filloi të sillet me arrogancë edhe ndaj gazetarëve të huaj, duke menduar se e vërteta e Serbisë kishte zbritur nga qielli. Arroganca e pushtetit serb në një mënyrë është ndihmesë për Kosovën për të depërtuar aty ku kishte qenë shumë e vështirë. Ibrahim Rugova, me të marrë përgjegjësinë për të udhëhequr LDK-në filloi me elokuencë të jep intervista për shtypin e jashtëm dhe me urtësinë e tij, gjithnjë duke artikuluar argumentet për atë që po bëhej në Kosovë, fitoi simpatinë e gazetarëve që sigurisht do të thoshte edhe përkrahje për Kosovën. Kriza që filloi në Kosovë, vazhdoi edhe në pjesë të tjera të Jugosllavisë dhe ky problemi i ndërkombëtarizimit të Jugosllavisë nuk ishte diçka që Jugosllavia e donte. Përkundrazi ishte shpërbërja dhe shpërthimet që pasuan ato që vetvetiu ndërkombëtarizonin çështjen bashkë me pasojat që po shkaktoheshin. Dhe në këtë shpërthim, që gjithnjë e më shumë po bëhej i paevitueshëm, dikush do të kërkonte ndërhyrje. Së paku për ndërmjetësim. Dhe ai dikush që më së lehti do të ballafaqohej me pasojat ishte Komiteti European ose siç njihet sot Bashkimi European.

BE-ja mori rolin udhëheqës në menaxhimin e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe në zgjidhjen e krizës së Kosovës, ndërsa mekanizmi që zgjodhi ishte Konferenca e Paqes për Jugosllavinë në Hagë. Konferenca u mbajt në Hagë me 7 shtator, e kryesuar nga Lordi

²³³ Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, 2010, fq.115.

²³⁴ Esat Stavileci, *Vepra I, Kosova në ish – Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.50.

Carrington, me qëllim që të gjendet një zgjidhje paqësore për konfliktin në territorin e RSFJ-së. Në Konferencë u përcaktua projekti i zgjidhjes gjithëpërfshirëse të krizës jugosllave. Përpjekja për t'i zgjidhur çështjet e hapura, që kishin dalë nga shpërbërja e Jugosllavisë, dështoi sepse Serbia refuzoi planin e paqes.²³⁵ Por nuk do të jetë kjo e vetmja konferencë që do merret me problemet e shpërbërjes së Jugosllavisë, sepse konferenca dhe përpjekje diplomatike ndërkombëtare, siç do t'i shohim më vonë, do të ketë shumë. Çështja për Rugovën dhe për shqiptarët është si të depërtohet te qendrat e vendosjes, pa pasur ambasada, pa pasur shërbim të strukturuar diplomatik, pa pasur medie të forta dhe pa pasur forcë ushtarake që të mbroheshim vetë edhe pse jo, pa pasur ndonjë miqësi të fortë tradicionale me ndonjë fuqi, sidomos në Europë. Kur më 1992 dhe 1993 Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi dhe bashkëpunëtorët e tyre morën shkopin e tyre të pelegrinit për t'i vizituar me radhë kryeqytetet perëndimore, ata kishin dy qëllime: ta bëjnë të njohur gjendjen në Kosovë dhe të kërkojnë ndihmë.²³⁶ Çështja ishte si të bëhej kjo në mungesë potencialesh. A do të mjaftonin vetëm intervistat nëpër gazeta e televizione apo duhej më shumë. Pa marrë parasysh këtë, Ibrahim Rugova dhe të gjithë në Kosovë e kishin të qartë se Kosova ishte në një konflikt, i cili një ditë do të shpërthente. Ai me gjuhën e tij të butë ofronte opsionet e veta që shumë herë tingëllonin si utopike. Kërkonte ndërmjetësim ndërkombëtar duke informuar qendrat e vendosjes për rrezikun e masakrave që mund të ndodhnin në Kosovë, në rast se nuk ndërhyhej. Ai megjithatë do të arrijë të depërtojë pothuaj te çdo fuqi e vendosjes duke e lançuar të vërtetën e Kosovës dhe domosdoshmërinë e vënies së Kosovës në mbrojtje ndërkombëtare dhe krahas kësaj po arrinte të krijonte një lloj imazhi për vetveten, si një lloj Gandi për Ballkanin, i cili me urtësinë e tij dhe me karakteristikat e një intelektualit po arrinte që zëri i tij të dëgjohej.

Aktiviteti diplomatik ishte mjaft i dendur gjatë periudhës vendimtare të viteve 1992 dhe 1995. Ministria e Informimit trajtonte me sukses të gjitha ndodhitë që kishin të bënin me shkeljet dhe me dhunën kundër shqiptarëve. Kjo realizohej me anë të informatave që shpërndaheshin me sukses të dukshëm. Sipas buletinit të Ministrisë së Informimit “përfaqësuesit e Kosovës kanë zhvilluar një turne nëpër njëzet kryeqytete. Ibrahim Rugova ka qenë disa herë në Bon, në Bruksel, në Paris, në New York, Washington dhe në Gjenevë”.²³⁷ Të gjitha këto vizita dhe

²³⁵ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.391.

²³⁶ Pierre Dufour, *Kosova Paqja e Shpërfillur*, Rozafa, 2010, fq.75.

²³⁷ Po aty, fq. 77.

takime, aq sa i shërbenin të vërtetës së Kosovës, në një masë i shërbenin edhe diplomacisë vendimmarrëse, e cila ishte e interesuar që konflikti të mos plaste edhe në Kosovë. Kjo sepse të gjithë në fokus kishin Slloveninë, Kroacinë dhe më vonë Bosnjën dhe Hercegovinën. Por gjithsesi problemi i Kosovës po ndërkombëtarizohej. Qeveria në ekzil, e vendosur në Bon, zhvillonte aktivitetet me diasporën në Europë bashkë me degët dhe nëndegë të LDK-së që ishin themeluar gjithandej. Dhuna dhe krimet serbe ndaj popullatës së pafajshme ishin shkaqet, që shumë herë në qendrat kryesore të Europës organizoheshin demonstrata, të cilat organizoheshin mirë dhe dinin të transmetonin mesazhin te publiku paqedashës. Publik ky që filloi të ushtrojë presion te qeveritë e vendeve respektive. Në anën tjetër në SHBA, edhe Lobi Shqiptar i njohur me emrin Liga Qytetare Shqiptaro -Amerikane, ishte i fuqishëm dhe përvoja e ish- kongresistit, DioGuardi, bënte që aktivitetet e diasporës shqiptare edhe në SHBA të ishin më mirë të sinkronizuara. Edhe degët me nëndegët e LDK-së dukeshin të suksesshme. Por me kalimin e kohës degët e partive politike, që po formoheshin në mënyrë të dukshme, krijonin një zbehje aktivitetesh dhe rrjedhimisht përçarje të diasporës. Problemi i Kosovës, kërkesat shqiptare, paralajmërimi për përshkallëzim të dhunës, kërkesa për ndihmë ndikojnë shumë në ndërkombëtarizimin e çështjes dhe ndikimi në qendrat e vendimmarrjes vërehet dukshëm. Në anën tjetër, edhe pse nuk vëreheshin veprime konkrete, megjithatë kërkesat e Kosovës arrinin të deponoheshin te organe të rëndësishme ndërkombëtare dhe te qeveritë e forcave të vendosjes. Kështu, në shkurt të vitit 1993 ai ka paraqitur para Kombeve të Bashkuara planin vijues të paqes, që ishte edhe thelbi i kërkesave të tij pranë diplomatëve:

- *Vendosja e menjëhershme e një numri të mjaftueshëm paqeruajtësish të OKB-së ose të NATO-s;*
- *Vendosja e një protektorati në Kosovë;*
- *Rritja e numrit të vëzhguesve të OSCE-së në Kosovë;*
- *Zgjerimi i zonës së ndaluar ajrore në Kosovë;*
- *Ndërprerja e spastrimit të heshtur etnik në Kosovë nëpërmjet politikës frikësuese për serbët;*
- *Çarmatosja dhe shpërbërja e njësisve paramilitare serbe dhe vendosja e tërë armatimit të rëndë serb nën kontrollin ndërkombëtar;*
- *Rihapja e aeroportit të Prishtinës për fluturime dhe qëllime humanitare;*

- *Ndërprerja e kolonizimit të Kosovës nga Serbia;*
- *Lejimi i seancave të Kuvendit të zgjedhur në mënyrë të lirë;*
- *Veçimi i Kosovës nga sanksionet ndërkombëtare të zbatuara kundër Serbisë dhe Malit të Zi*²³⁸.

Janë të shumta vizitat e delegacioneve shtetërore e joshtetërore, të gazetarëve e aktivistëve ndërkombëtarë që vizitojnë dhe takojnë Rugovën në Prishtinë, ndërsa kur analizohet kërkesa e parashtruar, që del si një dokument shumë i qëlluar, dikush mund ta emërtojë profetik, por disa vite më vonë shumë nga këto kërkesa do të realizohen dhe do të gjejnë zbatim në Kosovë. “Rugova ka pasur përkrahje të madhe prej perëndimit, por sidomos nga amerikanët“, shprehet Shkelzen Maliqi, një ndër lojtarët kyç të asaj kohe dhe bashkëpjesëmarrës në takime e konferenca. Në çdo moment kritik për lëvizjen dhe për të personalisht, ai ftohej në Washington, dhe po kështu në Londër, Paris e Bon.²³⁹ Kjo tregon se ai kishte arritur të faktorizohej sikundër në një mënyrë edhe vetë Kosova, sepse të thirreshe në takime nga qendrat e vendosjes kishte një domethënie ndërkombëtarizimi. Njiheshe se ekzistojë. Pak kohë më parë, vështirë të paramendohej kjo. Duhej depërtuar me të vërtetën dhe me kërkesën tënde, krahas vështirësive të përmendura edhe për të thyer mendjen e ndonjë burrështetasi që ishte treguar shumë proserb, siç ishte rasti, për shembull me Presidentin francez Miteran.

Gjatë shumë takimeve, konferencave dhe nëpërmjet letrave zyrtare, Kosovës i kanë premtuar shumë dhe disa ishin të bukura, ndërsa në disa të tjera shprehej shqetësimi dhe keqardhja për gjendjen e krijuar dhe në të tjera shtyhej procesi i zgjidhjes. Disa bëheshin për të fituar në kohë. E kishte të tilla që kërkonin veprime konkrete. Disa kishin karakter shtetëror, e disa ndërshtetëror. Disa kishin nivel debatesh e disa reagim përmes ndonjë deklarate, ta zëmë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Esat Stavileci në këtë kontekst, nënvizon: “që në vitet 80-të dhe deri më sot, çështja e Kosovës, në arenën ndërkombëtare, në rend të parë u konceptua nëpërmjet dy dimensioneve të saj, atë të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe në atë të rrezikut të shpërthimit të luftës, duke depërtuar më vonë gjithnjë e më tepër vetëdija për dimensionin e tretë si themelor të kësaj

²³⁸ Po aty, fq.78.

²³⁹ Shkelzen Maliqi, *Dialog me Baton Haxhiun, Shembja e Jugosllavisë Kosova dhe rrëfime të tjera*, UET Press, Tiranë, 2011, fq.193.

çështjeje, që ka të bëjë me pozitën e Kosovës në raport me konfliktësinë shqiptaro-serbe dhe në raport me shthurjen e ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë, pjesë konstitutive e së cilës qe edhe Kosova”.²⁴⁰

E kur kthehemi te deklaratat, konferencat, etj., kishte edhe ndonjë që nuk kishte asnjë përmbajtje dhe themi që edhe pse kishte arritje si dhe një mori suksesesh në paraqitjen e problemeve të Kosovës, nuk rezultoi me përmbushjen e kërkesave të parashtruara. Ato refuzohen, ndonjëherë me cinizëm dhe pa argumente, por gjithsesi arshivohen dhe shërbejnë si dëshmi të zhvillimeve. Dhe sado të vogla të ishin efektet, ato shërbenin. I shërbenin së paku njohjes dhe pranimi të problemit që duhej të zgjidhej.

Letrat dhe takimet e ndryshme në mes përfaqësuesve kosovarë dhe qarqeve të vendosjes kishin përmbajtjet e caktuara që në momente të caktuara zbatoheshin duke qenë mjaft dobiprurëse.²⁴¹ Kosova zyrtarisht u paraqit me kërkesë për njohje me një letër drejtuar Lordit Carrington, kryesuesit të Konferencës për Jugosllavinë, një ditë para se të skadonte afati.²⁴² Ishte letër që duhej të vlerësohej nga Komisioni i Arbitrazhit të KE-së që po i bashkëngjitej Konferencës. Letra nuk u mor parasysh dhe në një mënyrë u injorua fare. Kërkesa e Kosovës ishte përgatitur mirë nga ana e përmbajtjes, por Badinteri ishte përcaktuar për disa kritere të

²⁴⁰ Esat Stavileci, *Vepra V, Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtina, 2013, fq.275.

²⁴¹ Kosova ka pasur mbështetje dhe premtime të bukura, si p.sh (...) në prill 1989 parlamenti europian kishte shprehur protestën ndaj masave represive (...) më 1993 ai miratoi një rezolutë, të konsideruar si konstruktive në Kosovë, duke i inkurajuar ushtarët të dezertojnë (...) rezoluta parashihte pranimin e tyre në shtetet e bashkësisë europiane (...) në shtator 1992 KSBE-ja kërkoi një veprim parandalues të menjëhershëm në Kosovë (...) KSBE-ja bënte presion ndaj autoriteteve të Beogradit për të nisur dialog serioz me përfaqësuesit e Kosovës me praninë e një pale të tretë (...) më 27.12.1992 Presidenti Bush, premtoi se SHBA-ja nuk do të lejojë që Kosova të shndërrohet në Bosnje të dytë...kërcënonte Serbinë me sulme ajrore (...) me 23.02.1993 në Gjenevë, me rastin e paraqitjes së “Planit të Paqes për Kosovën”, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut votoi një rezolutë që dënonte shkeljen e të drejtave të njeriut...veçanërisht në Kosovë...një tjetër rezolutë u votua me 20 gusht ku kërkohet vazhdimi i misionit të KSBE-së (...) në maj 1993 në Washington ministrat e punëve të jashtme: amerikanë, rusë, anglezë, francezë dhe spanjollë shprehin vendosmërinë e tyre, sipas së cilës Kosova duhet të gëzojë një autonomi të gjerë...ata nuk precizojnë se mund të merrnin parasysh pavarësinë në rast të vazhdimi të keqtrajtimit të shqiptarëve (...) 3 shkurt Ibrahim Rugova takoi Presidentin Clinton dhe z.Al Gore...ata nxisin shqiptarët të vazhdojnë me ndjekjen e politikës paqësore....(...) 2 nëntor 1994 bashkëkryesuesit e Konferencës Ndërkombëtare për ish -Jugosllavinë, Lordi David Owen dhe Thorwald Stoltenberg, pranuan në takim Ibrahim Rugovën...ata shprehën simpatinë e tyre për politikën paqësore...(...) 23 dhjetor 1994 Asambleja e përgjithshme e OKB-së...dënon ashpër masat dhe praktikën diskriminuese si dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës...(...) dënon represionin e shkallës së lartë të praktikuar nga policia dhe nga forcat e ushtrisë së RFJ-së...(...) kërkon vendosmërisht nga autoritetet e RFJ-së t’i lejojë misionet afatgjatë të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian të kthehet menjëherë në Kosovë....(Pierre Dufour, *Kosova paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq.78-79-80).

²⁴² Letra nga dr.Rugova Lordit Carrington, 22 dhjetor 1991, te Weller, *Crisis in Kosovo*, 81, cituar nga: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.100.

ngushta brenda një interpretimi restriktiv të Kushtetutës së vitit 1974, duke iu dhënë të drejtën e pavarësisimit vetëm njërive federale të Jugosllavisë që emërtoheshin si republika. Për njohjen dhe kërkesat për njohje, sikundër për të drejtën e Kosovës në shtetshmëri, do të flasim në kërret vijues, por këtu po potencojmë se vetë dërgimi i letrës dhe përmbajtja e saj janë pjesë e ndërkombëtarizimit. Shumë pak kohë pas kësaj, lidhur me Jugosllavinë, u organizua Konferenca e Londrës, në të cilën tash ishin ftuar të merrnin pjesë edhe anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, përfaqësuesit nga Organizata e Konferencës Islamike, KSBE-ja dhe gjashtë shtete fqinje së bashku me shtetet anëtare të KE-së, si dhe me Japoninë dhe Kanadanë.²⁴³ Në Kosovë shpresohej se, sidomos tash kur ishin mbajtur zgjedhjet e lira dhe kur Ibrahim Rugova ishte zyrtarisht kryetar i Kosovës, do të ftohej zyrtarisht të merrte pjesë në emër të Kosovës. Por edhe kësaj here, presioni serb bëri që Kosova të mos thirret. Por, me këtë rast krijohet një precedent sepse Ibrahim Rugova në njërën anë njoftohej se zyrtarisht ishte vendosur të mos ftohej në Konferencë, por megjithatë do të jenë të mirëseardhur që t'i shprehin pikëpamjet e tyre brenda kornizës së përgjithshme të Konferencës:

“Nëse planifikoni të vini në Londër në kohën e Konferencës (26-28 gusht), atëherë jam i lumtur t’ju informoj se do të jetë e mundur për ju dhe për delegacionin tuaj që të keni qasje në qendrën e konferencave „Queen Elisabeth II “...Meqë nuk do të jetë e mundur që, për shkaqe praktike dhe të tjera, t’ia mundësojmë delegacionit tuaj qasjen në vetë sallën e mbledhjeve, organizatorët do të sigurojnë një Salle d’ecoute ku do të transmetohet zhvillimi i Konferencës zyrtare në mënyrë të drejtpërdrejt.”²⁴⁴

Thirrja dukej mjaft e çuditshme, sikundër edhe vetë pjesëmarrja e delegacionit, por gjithsesi nuk mund të vlerësohet krejtësisht e padobishme. Aty në fund të fundit, sërish edhe pse jo në plan të parë, shqiptarët ishin të pranishëm. Kishin mundësi për kontakte. Kishin mundësi të promovonin idetë e shtetndërtimit para medieve që ishin në numër të madh dhe kishin mundësi që edhe të zhvillonin takime. Në fund edhe Lordi Carrington, përmes një deklaratë që quhej *Dokumenti i kryesuesit* thotë se Serbia dhe Mali i Zi ishin zotuar për kthimin e të drejtave të plota civile dhe kushtetuese të banorëve të Kosovës.²⁴⁵ Pas kësaj Konferenca do të vazhdonte duke

²⁴³ Marc Weller, Po aty,, fq.102.

²⁴⁴ Po aty, fq.103-104.

²⁴⁵ Po aty,fq.104.

organizuar mbledhje vijuese dhe pas disa përpjekjeve u themelua një “grup special” që do merrej me çështjen e Kosovës. Këtë grup e udhëheq ambasadori gjerman, Geert Ahrens, i cili tentonte t’i ikte çështjes së nxehtë të statusit dhe provonte që të inicioje zgjidhje të thjeshta dhe praktike, që pretendoheshin t’i shërbenin zgjidhjes së problemit që nuk mund t’i parashihej lehtë fundi. Së fundi bashkësia ndërkombëtare, siç është përmendur më sipër organizoi Konferencën e Dayton-it, konferencë kjo që bëri një kthesë të shqiptarëve të Kosovës, të cilët të pakënaqur sepse ishin lënë anash, fillojnë të mendojnë për opsione të tjera nga ato që deri më tani i kishte paraqitur Ibrahim Rugova.

Nuk besoj se duhen vënë në diskutim dhe në dyshim aktivitetet e viteve të para, në kuptim nëse ishin të dobishme dhe frytdhënëse. Pa ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, mund të shpërthente konflikti, por pasojat e konfliktit do të ishin katastrofike për popullin e Kosovës. Çdo hulumtim i opinionit ka treguar se në vitet e para të shpërthimit të konfliktit, urrejtja kundër shqiptarëve në Serbi ishte në shkallën më të lartë. Dhe nëse bazohemi vetëm në këtë, mund të paramendojmë se cili do ishte shfrenimi dhe shpërthimi i forcave serbe gjatë sulmeve në Kosovë. Sidomos nëse për Kosovën do të dihej në atë masë që dihej në atë kohë. Është e qartë se Ibrahim Rugova mbështetej shumë në faktorin ndërkombëtar dhe duke qenë kështu ai merr rolin e një misionari që ikën nga masat për të kaluar në një botë që nganjëherë nga kritikët quhej ireale. Komunikimin e vetëm, me ata të cilëve iu shërbente, e kishte ditëve të premtë përmes konferencave të shtypit, kur zakonisht përsëriste frazat për opsionin më të mirë shqiptar, me të cilat i drejtohej opinionit ndërkombëtar. Në anën tjetër opinionit të brendshëm ia përsëriste frazat për mbështetjen që Kosova po merrte nga bashkësia ndërkombëtare. Ndërkohë që terreni dhe jeta reale po merrte kahje tjetër. Po fillonin pakënaqësitë lidhur me mbështetjen ndërkombëtare, efektet e së cilës nuk po shiheshin aq shumë në terren. Për më tepër Kosova nuk mori pjesë në Dayton. E deri në vitin 1993, 400.000 shqiptarë lëshuan Kosovën nga shkaqet e përkeqësimit të kushteve socio-ekonomike. Shqiptarët e Kosovës u zhgënjyen shumë nga Marrëveshja e Dayton-it, e cila sipas tyre, dështoi të njihte pritjet e tyre të gjata dhe kërkesën e tyre të drejtë për pavarësi.²⁴⁶ Këtu fillon një ndarje opsionesh lidhur me atë se, duhet vazhduar me pacifizëm apo duhet përdorur edhe metoda të tjera të mundshme. Se mos Rugova e kishte tepruar me pacifizmin e ti, të cilin dikush e quajti “pacifizëm i imponuar”, se është çështje e

²⁴⁶ G.Richard Jansen, <http://amar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.9 (parë më: 29.12.2013).

diskutueshme dhe është e besueshme se ka pasur mundësi dhe, edhe nevojë që metodat dhe strategjitë të kombinoheshin, sepse siç do ta shohim më vonë, vetëm ngjarjet e ndryshuara në terren, sjellin ndërhyrje. Por pavarësisht nga kjo, Rugova ka arritur të ndërkombëtarizojë çështjen e Kosovës maksimalisht, duke ditur të prekë politikisht sensin e diplomatëve e deri tek emocionet e krijuara te Papa Gjon Pali, të cilin kishte arritur ta bënte pothuaj mik personal, e nga i cili, sigurisht kërkonte mbështetje për çështjen e popullit të vet.

4.3. Ridimensionimi i faktorit politik dhe ushtarak në Kosovë

Dayton-i anashkaloi çështjen e Kosovës. Aty Millosheviçi arriti të mos lërë që kjo çështje të diskutohet, sepse Kosova sipas tij, ishte çështje e brendshme e Jugosllavisë. Jugosllavia e Millosheviçit kërkonte njohjen dhe këtë e arriti. Bashkimi European njih plotësisht Jugosllavinë e mbetur në fillim të vitit 1996 me Kosovën brenda saj. Shqiptarët e Kosovës e pritën të dëshpëruar rezultatin e Konferencës së Dayton-it, por kësaj radhe një numër i madh i tyre jo vetëm që fillojnë të mendojnë për diçka ndryshe, por nisin të dalin nga monopoli i gjithëllojshëm që mbahej nga LDK dhe Ibrahim Rugova. Iluzionet se mund të fitohej pavarësia me strategji pacifiste fillojnë të zbehen dukshëm. Ata e panë se rezistenca e tyre paqësore nuk po përkrahej dhe se ata po i priste edhe një valë represioni serb. Po ashtu dështimi i trupave paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Bosnje (masakra e Srebrenicës) kishte treguar se me mijëra civilë të paarmatosur mund të vriteshin nga ushtarët dhe paramilitarët serbë para syve të ushtarëve europeanë (holandezë).²⁴⁷ Politika e udhëhequr në Prishtinë, e njohur si lëvizja paqësore, tregohet e ngurtë për të ndryshuar me strategjinë përkundër zhgënjimit në masë me mungesë rezultatesh. LDK dhe Ibrahim Rugova vazhdojnë me politikë të njëjtë dhe refuzojnë mendim ndryshe edhe brenda strukturave të veta. Kuvendi i zgjedhur i Kosovës nuk arrin të mblidhet asnjëherë dhe vetëm një herë kishte pasur tentativë për t'u thirrur. Ibrahim Rugova, lider i LDK-së dhe Kryetar i zgjedhur i Kosovës, vazhdon ta konsiderojë veten president, por kompetencat e presidentit në masën të madhe nuk i ekzekuton sipas Kushtetutës së vendit. Presidentit sipas Kushtetutës i takon të jetë edhe Komandant i forcave të armatosura, si çdo kryetari tjetër. Në një gjendje shtetrrethimi të plotë ai duhej të shpallte pushtimin dhe të thërriste mobilizimin për rezistencë të armatosur. Përvoja e Kroacisë dhe e Bosnjës dhe Herzegovinës kanë treguar se:

²⁴⁷ Oliver Schmitt, Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Koha, Prishtinë, 2012, fq.253.

-Millosheviçi krizat i zhvillonte gradualisht deri te konflikti i armatosur në shkallë të gjerë;

-Sanksionet ekonomike nuk ishin instrument që do të ndikonin te Millosheviçi që të hiqte dorë nga realizimi i qëllimeve;

-Format e tjera të presioni nuk ishin të mjaftueshme për ta bindur Millosheviçin për t'i dhënë fund represionit dhe për t'i filluar negociatat;

-Millosheviçi toleron disi vetëm kur i bëhet presion nga forcat ushtarake rivale dhe nga bashkësia ndërkombëtare;

-Millosheviçi lëshon pe vetëm kur e ka pushtetin e rrezikuar.²⁴⁸

Duke qenë njohës i rrethanave në Jugosllavi dhe duke i ndjekur rrethanat nga afër dhe me besimin se ishte i mirinformuar, është vështirë të shpjegohet pse ai dhe LDK vazhdojnë me strategjinë e njëjtë të rezistencës pasive. Nëse lëvizja, me rezistencë pacifiste kishte arritur që problemin e Kosovës ta bënte të njohur në qendrat e vendosjes, kjo nuk do të thoshte se ishin arritur të gjitha objektivat. Kishte akte juridike vendore në fund të fundit, që e obligonin. Presidenti i vendit pos të tjerash është edhe simbol i unitetit të popullit, ndërkohë që brenda popullit tash kishte mendime të tjera. Kishte grupacione të tjera. Kishte opsione të tjera. Dhe këto duhen respektuar dhe pse jo, të koordinoheshin aktivitetet. Arsytimi se me çfarëdo lloj strategjie tjetër do të humbim dhe do t'i nënshtrohemi masakrave, kërkon argumente të forta. E argumentet janë megjithatë të tjera. Terreni tregon diçka tjetër bashkë me përvojën kroate dhe boshnjake. Kurse pohimi se nuk ekziston opSION tjetër, se nuk ekzistonin grupe brenda dhe jashtë që po përgatiteshin dhe që po ndërmerrnin veprime të tjera, nuk ka si të arsyetohet. Aq më tepër se edhe ai edhe faktorët kyç brenda LDK-së këtë e kanë ditur. Sidoqoftë një kronologji veprimesh dhe faktesh është e nevojshme të paraqitet. Askush nuk mund të kontestojë rolin pozitiv dhe arritjet gjatë viteve që po funksiononte LDK, por në anën tjetër të mendohet se vetëm me atë strategji mund të shkohej deri në fitore përfundimtare, kjo nuk mund të argumentohet. Përkundrazi siç do ta shohim këmbëngulësia në qëndrime, në momente të caktuara, do të ketë zbehur dhe do të ketë penguar esencialisht vetë lëvizjen e përgjithshme. Këtu flas për tërësinë e strategjive dhe subjekteve dhe jo vetëm të njërit opSION. Megjithëse themelimi i një lëvizjeje masive gjysmë legale si LDK ishte një hap i madh përpara. Kosova mbeti nën ligjin e luftës dhe

²⁴⁸ Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.150.

ngacmimi i vazhdueshëm i popullsisë, arrestimet dhe vrasjet e aktivistëve e çuan në një ardhje të qëndrueshme të rekrutëve të LPK-së, shpesh në mërgim.²⁴⁹ Rugova, besohet të ketë qenë në dijeni se që në fillim të lëvizjes, për të cilën kishte marrë përgjegjësinë që t'i printe, kishte individë dhe grupe që po përgatiteshin për diçka ndryshe. Në disa raste ai ka qenë edhe vetë drejtpërdrejt i njoftuar. Kështu, në fund të pranverës së vitit 1990, me miratimin dhe dijeninë e qeverisë së Tiranës, fermeri i Prekazit, Adem Jashari, drejtoi një grup rekrutësh nëpër pyjet e dendura mbi Qafën e Koshares për në Shqipëri, për të filluar stërvitjen në Akademinë Ushtarake në Tiranë dhe në kampet ushtarake vendase në kodrat shqiptare.²⁵⁰ Dhe Adem Jashari, është figurë e pakontestuar e luftës, i cili me të drejtë njihet si Komandanti Legjendar. Për më tepër LDK e ditëve të sotme në një mënyrë e paraqet si njeri të afërt me Rugovën dhe me LDK-në. Aktivitetet e Adem Jasharit do të vazhdojnë dhe sipas Jakup Krasniqit, Adem Jashari ishte një nga anëtarët më të hershëm të LPRK-së në Drenicë, që më vonë do të quhet LPK.²⁵¹ Qëndrimi dhe veprimtaria e Adem Jasharit në Shqipëri lidhet ngushtë me opsionin tjetër në përpjekjet e lëvizjes për pavarësi. Ai, Adem Jashari në një moment të caktuar, për shkaqe të arsyeshme dhe mjaft të koklavitura “ ka vendosë të kthejë shumicën e shokëve në Kosovë, ndërsa ai me Jakup Nurën ndalen në Tiranë, me shpresë se do të takohej me Ibrahim Rugovën dhe Bujar Bukoshin. Edhe përkundër pritjes në aeroport, i pari nuk pranoi të takohet, gjersa me të dytin do të bisedojë vetëm 7 minuta dhe ky në praninë e Milazim Krasniqit dhe Skënder Zogajt do të premtojë për mbështetje, madje, në atë rast, Bujar Bukoshi u shpreh se do të ishte mirë të pickoheshin nga pak ata (policia)”.²⁵²

Në vitin 1991, në vende të tjera të botës komplekse të diasporës po ndërmerreshin iniciativa politike që do të kishin po atë ndikim të gjerë. Adem Jashari takoi Rugovën në Kroaci, në emër të LPK-së, ku diskutoi për mundësitë ushtarake që atij i dukeshin të hapura për shqiptarët, por takimi nuk dha rezultate konkrete.²⁵³ Përfaqësues nga diaspora, që i takonin grupeve të caktuara që siç njiheshin në atë kohë grupe marksiste - leniniste, por më së shumti të LPK-së vizitojnë Shqipërinë dhe takohen me presidentin e atëhershëm Ramiz Alinë, gjithnjë duke prekur

²⁴⁹ Jamess Petiffer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq.82.

²⁵⁰ Po aty, fq.84.

²⁵¹ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe – Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Buzuku, Prishtinë, 2006, fq.21.

²⁵² Ana Lalaj: *Kosova – Rruga e gjatë për vetëvendosje*, Tiranë, 2000, cituar nga Jakup Krasniqi, vepra e cituar, fq.22.

²⁵³ Nik Gjeloši, cituar nga: Jamess Petiffer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq.86.

mundësitë e organizimeve të hershme ushtarake. Në anën tjetër “Peja ishte një qendër e aktivitetit paraushtarak dhe aty u krijua një grup ilegal *Besa*, i cili, nga fundi i vitit 1990, kishte filluar importin e armëve të lehta në Kosovë nën drejtimin e Adrian Krasniqit-Rexhës dhe një vit më pas kishte krijuar organizatën *Arradha Çlirimtare e Pejës*”.²⁵⁴ Edhe në pjesët e tjera veprohej. Çeta e Llapit në Kosovën verilindore ishte gjithashtu e mirarmatosur dhe e aftë për të kryer sulme të suksesshme mbi policët serbë dhe kazermat e tyre.²⁵⁵ Në diasporë punohej gjithandej me një frymën të këtitllë, p.sh në Belgjikë Enver Hadri kishte themeluar *Çetën e Brukselit*, sikundër që herët fare, Fehmi Lladrovci “kishte qenë pjesë e një organizate të vogël marksiste-leniniste në politikën e fshehtë të Prishtinës, Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës (OMLK) dhe që në fillim të vitit 1985 u vendos në krye të krahut të saj ushtarak”.²⁵⁶ Shumë shqiptarë të Kosovës në Zvicër për vite kishin gjetur strehim politik dhe ekonomik dhe aty ishin mbledhur dhe krijuar mjaft grupe dhe ato, në kohën e lëvizjes paqësore, dalin me qëndrime radikale. LPK në Zvicër po punonte për organizatën Bashkimi i Shqiptarëve në Zvicër.²⁵⁷ Në një periudhë të caktuar kohore ka pasur tentativa dhe iniciativa për të themeluar trupin ushtarak që do të ishte pjesë përbërëse e lëvizjes së përgjithshme, por ose mbeteshin në tentativë ose mbeteshin në heshtje në pikën ku kishin nisur. Në këtë vazhdë, ”në Stučka Toplica në Kroaci në janar 1991 u mblodh një asamble mbarëshqiptare e intelektualëve të organizuar nga Lidhja Demokratike e Shqiptarëve të Kroacisë. Në mbledhje merrnin pjesë njerëz nga Kosova, Maqedonia, Presheva dhe Mali i Zi... Qëllimi i kësaj asambleje ishte të merreshin vendime strategjike për ta çuar përpara lëvizjen kombëtare pas shpalljes së Pavarësisë...asambleja hodhi themelet për Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK).²⁵⁸ FARK-u sipas ngjarjeve të mëvonshme, kur lufta mori përmasa do të karakterizohet si trupë e ndarë e qeverisë në ekzil, që përkundër qëllimit të përbashkët në luftën për liri e pavarësi, në një mënyrë është paraqitur si ushtri e dytë krahas UÇK-së dhe që të dyja nuk janë parë të kenë qenë të koordinuara për luftë të përbashkët.”²⁵⁹ Është

²⁵⁴ F.Mehmetaj, Adrian Krasniqi-Rexha-*Një jetë a vdekje për Atdhe*, Prishtinë, 2001, cituar nga Jamess Petiffer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq.84.

²⁵⁵ Jamess Petiffer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq .84.

²⁵⁶ Po aty, fq.87.

²⁵⁷ Po aty.

²⁵⁸ Po aty, fq.87-88.

²⁵⁹ Shumë rrëfime dhe intervista, në kohën e pasluftës nga liderë politikë dhe ushtarakë, tregojnë fatkeqësisht se edhe forcat ushtarake kishin qenë të përçara dhe në momente të caktuara kanë rrezikuar që të kenë edhe përplasje brendashqiptare. Pas luftës, në një moment të caktuara, është hapur një debat me përmasa fushate, përmes i cili

e njohur se qeveria në ekzil kishte një qeveri të mbrojtjes, të kontrolluar nga kryeministri i asaj kohe, Bujar Bukoshi, sipas të cilit pacifizmi i Rugovës e kishte penguar që Ministrinë e Mbrojtjes ta bënte funksionale. Faktikisht në një periudhë të caktuar kohore ai i shkëput marrëdhëniet me Ibrahim Rugovën - kryeministri nuk ka raporte me presidentin dhe kjo në një mënyrë tregon se ku dhe kah mund të çonin raportet e këtilla. Në anën tjetër organizatat e ndryshme ilegale po tentonin të forcoheshin dhe të organizoheshin. E tillë në Kosovë ishte LKÇK, e cila në mars të vitit 1993...i kishte përqendruar energjitë e saj fillestare në përgatitjen e popullit për mobilizimin masiv kundër serbëve dhe për kryengritje popullore.²⁶⁰ Kështu brenda e jashtë vendit, grupet ilegale, që njiheshin si marksiste-leniniste po organizoheshin për t'u lidhur dhe për të ndërtuar një strategji për rezistencë të armatosur. Mund të përmenden emra të njohur të skenës së sotme politike, si kryeministri aktual, Hashim Thaçi, dhe të tjerë që i ishin bashkëngjitur LPK-së, dhe organizatave të tjera. Shkaqet pse këto organizata quheshin marksiste-leniniste nuk do të shqyrtohen në këtë punim, por botime, si libri i James Pettifer-it, të cilin e kam cituar disa herë, japin shpjegimet e duhura. Hapat e ndërmarrë nga organizatat e përmendura, çojnë kah themelimi i UÇK-së. Në fillim të vitit 1993 në Drenicë u mbajt një takim i delegatëve, me rreth 100 pjesëmarrës, ku liderët e LPK-së dhe të grupit tepër marksist LKÇK, kryesisht një grup studentësh, u bashkuan me kontingjentin e LPRK-së dhe zgjodhën orientimin dhe simbolet ushtarake të UÇK-së²⁶¹. Për shkak të rrethanave që i diktonte terreni dhe për shkak të mundësive për lëvizje më të lehtë, UÇK fillimisht ishte më e efektshme në zonat e kufirit, pra në Llap (kufiri me Serbinë) dhe në Dukagjin (kufiri me Shqipërinë). Sipas James Pettifer, midis viteve 1992 dhe 1995, u kryen 135 sulme të armatosura kundër forcave të sigurisë jugosllave.²⁶² Të gjitha këto ngjarje rreth organizimit ushtarak po bëheshin ndërkohë që edhe në Prishtinë, brenda faktorit politik, kishin filluar të shfaqeshin pakënaqësitë lidhur me rezultatet që po i sillte politika pacifiste. Nga LDK do të dalin individë si Basri Musmurati, Jakup Krasniqi, Hydajet Hyseni, etj. Në anën tjetër Adem Demaçi me energjinë e tij vazhdonte të kërkojë dinamizëm, kurse një lëvizje e studentëve të Universitetit të Prishtinës vetëm sapo po mobilizonte idetë e

është tentuar të merret si primat për betejat e fituara. Megjithatë, përpos faktit se është vërtetuar të kishte përçarje edhe në forcat ushtarake, nuk mund të ulet dhe nuk mund të zbehet roli i UÇK-së në luftën çlirimtare për liri e pavarësi.

²⁶⁰ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq.91.

²⁶¹ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, fq.92.

²⁶² Po aty, fq.95.

kësaj që quhet dinamizëm i proceseve. Lëvizja e Bashkimit Demokratik, ku ishte angazhuar akademik Rexhep Qosja, gjithashtu i bashkëngjitet këtij koloriti. Gjithë kjo lëvizje fuqizohet akoma më shumë, kur një marrëveshje e ndërmjetësuar nga organizata *Sant 'Egidio* e Romës, në mes të Serbisë dhe Kosovës dështon. Kjo është edhe një argument shtesë së Millosheviçi nuk njih gjuhën e marrëveshjeve. Përkundrazi, represioni fillon të shtohet, por edhe vlimi brendashqiptar në të njëjtën mënyrë. Në këtë fazë, që sikur po veprime bëhemi sikur nuk po shohim dhe po ashtu sikur nuk po dimë, ndërkohë që gjërat ishin më shumë se të dukshme. Faktori ndërkombëtar kishte informacione për UÇK-në dhe për forcën ushtarake të saj. Edhe Serbia gjithashtu. Rugova dhe LDK, po e po. Ajo që është më e vështirë për t'u kuptuar ishte heshtja brenda LDK-së dhe Ibrahim Rugovës dhe ngurrimi i tyre për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta me UÇK-në e cila ngadalë filloi të paraqitet publikisht. Fillimisht “në shkurt dhe në prill 1996 u botuan komunikatat e para të UÇK-së, sidomos në pjesën e dytë të vitit 1997 pasuan sulmet kundër anëtarëve shqiptarë të Partisë Socialiste të Serbisë, shef i së cilës ishte Millosheviçi; kjo parti ishte pasardhëse e Lidhjes Komuniste të Serbisë; sulme kishte edhe kundër policëve serbë”.²⁶³ Për një kohë raportohej se ushtarë të uniformuar dhe të maskuar, të armatosur me kallashnikovë, patrullonin nëpër zona të ndryshme të Kosovës, sidomos në Dukagjin dhe në Drenicë. Patrullimi i tyre rezultonte edhe me ndonjë ndalim të autobusëve, ku legjitimoheshin pasagjerët, por nuk raportohej për ndonjë sjellje të pahijshme. Edhe forcat ushtarake serbe, duke pasur informacione për lëvizjen e grupeve të armatosura shqiptare, ndërmarrin aksione duke zënë dhe duke vrarë në pritë në disa raste. Forcat serbe kishin informacione për lëvizjet e grupeve të armatosura qoftë nga mjetet e sofistikuara të përgjimit, qoftë edhe përmes spiunëve të infiltruar. Më e besueshme është se informacionet i kishin nga të dyja krahët. Ngjarje e një rëndësie të veçantë për historinë e UÇK-së dhe historisë së re të Kosovës janë luftimet e hapëta ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe policisë serbe, që u zhvilluan më 25 nëntor 1997 në Vojnik dhe ajo më 26 nëntor 1997 në Rezallë të Re dhe Llaushë.²⁶⁴ Kjo cilësohet ndër betejat e para të drejtpërdrejta, ku forcat serbe kishin pësuar humbje dhe në tërheqje e sipër ato kishin vrarë një mësues në Llaushë. Dhe do të jetë varrimi i mësuesit të ndjerë, me datë 28 nëntor 1997, kur ushtarët e UÇK-së dalin publikisht të armatosur dhe pa maska, me ç'rast njëri nga ushtarët i drejtohet masës me një fjalim që pritet me

²⁶³ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.255.

²⁶⁴ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe – Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Buzuku, Prishtinë, 2006, fq.41.

entuziazëm dhe që jep shpresë se një mekanizëm ushtarak po vihet në mbrojtje të popullit të pambrojtur.

Ngjarjet tashmë ndjekin një dinamikë të përshpejtuar dhe me më shumë faktorë që imponohen, deshi apo nuk deshi si të thuash ndërmarrja politike e grumbulluar përreth Ibrahim Rugovës. Bëhet e qartë se vetëm më pacifizëm nuk mund të fitohet liria dhe pavarësia. Por nuk është e qartë dhe kjo, me sa është parë deri më sot, nuk është thënë ndonjë herë nga ai, pse Ibrahim Rugova nuk po vendoste kontakte dhe nuk po koordinohet me UÇK-në. Që të mos kish informacione kjo nuk besohet. Situata bëhet akoma më e vështirë për t'u kuptuar kur ai po jepte intervista duke përdorur shprehjet si “nuk kemi kurrfarë informacionesh për një organizatë të tillë. Sipas të gjitha gjasave është fjala për disa individë të frustruar, parimisht, është i pamundur konstituimi i një organizate të tillë, ngase ne jemi të kontrolluar rreptësisht në çdo rrafsh jetësor, në shtëpitë shqiptare nuk ka armë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës mund t'i shërbejë regjimit serb si pretext për një fushatë të re represive në Kosovë,...elementet me papërgjegjësi në një shoqëri, regjimi serb i përdorë për qëllimet e veta”.²⁶⁵ Por shërbimet e huaja e dinin mirë se ekzistonte një organizatë e tillë, dhe besohet kjo i është transmetuar Rugovës edhe përmes takimeve nga diplomatë të huaj. Në anën tjetër janë vetë agjencitë e fshehta, ato që jo vetëm kanë kontakte të drejtpërdrejta me UÇK, por edhe e përgatisin atë në mënyra të ndryshme. *Kommandos Specialkaftë* merreshin me trajtimin e ushtarëve (të UÇK-së). Dërgoheshin armë, municione, uniforma dhe pajisje spiunimi, që i takonin dikur STASI-t, ish-shërbimeve sekrete gjermanolindore, për UÇK-në (...). CIA kishte qenë aktive në trajnimin dhe pajisjen e separatistëve kosovarë²⁶⁶. Thuhet dhe merret se CIA ka marrë raporte lidhur me terrenin dhe me UÇK-në Kosovë, kur e përshkruanin “UÇK-në si një organizatë marksiste radikale, të infiltruar nga mafia, të përfshirë në kontrabandën e drogës, përfitimet e së cilës i shfrytëzonte për të blerë armë në tregun e zi”²⁶⁷, dhe kjo do të thotë se në një pjesë të botës perëndimore kishte paragjykitime për UÇK-në, të cilën nuk ngurronin, në momente të caktuara ta quanin edhe terroriste. UÇK po intensifikonte sulmet, Rugova heshtëte, të rinjtë nisnin të shtojnë simpatinë dhe UÇK filloi të rritet në numër, ndërsa Adem Demaçi shpreh dëshirë të takojë përfaqësuesit e

²⁶⁵ Shih më shumë, Jakup Krasniqi, *Vlerësimet për UÇK dhe shtypi botëror*, vepër e cituar, fq.42-45.

²⁶⁶ Bernard Adam (sous la direction de), *La guerre du Kosovo, éclairages et commentaires*, édition complete, GRIP, Bruxelles, 1999, fq.61., cituar nga: Pierre Dufour, *Kosova – Paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë 2010, fq. 156.

²⁶⁷ Eric Laurent, *Guerre du Kosovo, Le dossier secret*, Plon, 1999, fq.50, cituar nga: Pierre Dufour, *Kosova – Paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq. 156.

UÇK-së dhe më vonë do të bëhet edhe përfaqësues i UÇK-së. Edhe forcat serbe shtojnë dhunën dhe terrorin duke kundërgoditur kryesisht popullsinë civile. Fillimi i vitit 1998 shënon sulme të ashpra nga të dyja anët, ndërsa bashkësia ndërkombëtare detyrohet të veprojë. Dhe kjo për disa muaj kur shpërtheu hapur konflikti, dhe nuk ishte mobilizuar qaq shpejt për shumë vite rezistencë pasive. Ngjarjet marrin kahje që është vështirë të parashikohen dhe krijohet një paqartësi, pavarësisht angazhimit më të intensifikuar të bashkësisë ndërkombëtare. Robert Gelbard, në cilësinë e të dërguarit të posaçëm të SHBA-së, në muajin shkurt 1998 “shpreh shqetësimin e SHBA-së për përshkallëzimin e dhunës në Kosovë dhe theksoi nevojën për dialog serioz. Dënoi fuqishëm dhunën e papranueshme të grupeve terroriste në Kosovë, sidomos UÇK-në. Gelbard kishte deklaruar atëherë se UÇK-ja “...pa dyshim është grup terrorist...”²⁶⁸. Është analizuar nga shumë aspekte nëse ky cilësim ishte bërë në pajtim të plotë me qeverinë amerikane dhe nuk është e qartë nëse ky cilësim i kishte dhënë Millosheviçit sinjal për të goditur UÇK-në nën pretekstin se meqë kjo qenkërka organizatë terroriste do të sigurohej përkrahje amerikane. Por diplomacia, politika dhe veprimet ushtarake lidhur më shpërbërjen e Jugosllavisë nuk kanë qenë çdo herë të dakorduara mirë. Ajo që dihet është se edhe vetë Gelbard-i shumë shpejt do të takohet me përfaqësues të UÇK-së, që pak më parë i kishte cilësuar terroristë. Viti 1998 ka qenë me plot rënie dhe ngritje të UÇK-së dhe me plot paqartësi politike brenda dhe jashtë Kosovës e për Kosovën. Forcat serbe në muajin shkurt dhe mars kryejnë sulme të ashpra në Qirez dhe në Prekaz. Në Qirez u vranë kryesisht gra, burra, fëmijë e pleq kurse sulmi në Prekaz rezultoi gjithashtu me shumë të vrarë dhe aty në luftime ra edhe Komandanti Legjendar Adem Jashari. Kjo nxiti edhe më shumë revoltën në Kosovë ku shpërthyen demonstrata, sikundër që në qendrat kryesore të perëndimit organizohen protesta të mëdha, nga të cilat bashkësia ndërkombëtare do të jetë në trysni të madhe. Grupi i kontaktit, “në një deklaratë të tij më 9 mars 1998 i kërkon qeverisë serbe, përkatësisht asaj jugosllave, të tërhiqte brenda dhjetë ditësh njësitë e policisë speciale nga Kosova, të lejonte praninë e organizatave ndërkombëtare në krahinë dhe të fillonte menjëherë dialogun me përfaqësuesit politikë të shqiptarëve”.²⁶⁹ Për më tepër u vendosën edhe disa masa shtesë kundër Jugosllavisë, por brenda Grupit të Kontaktit kishim dy grupe me qëndrime jounike: rusët, francezët dhe italianët mbanin qëndrime më të buta,

²⁶⁸ Kosovo Report: *Conflict, International Response, Lessons Learned*, The Independent International Commission on Kosovo, Oxford University Press, Oxford, 2000, fq.146-147, cituar nga Dario Malnar, SHBA dhe Kosova, Koha, Prishtinë 2013, fq.161.

²⁶⁹ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.94.

ndërsa SHBA dhe Britania e Madhe mbanin qëndrime më të forta kundër Jugosllavisë. Për dallim nga Bosnie dhe Hercegovina, fuqitë e mëdha, veçanërisht SHBA, interesohen menjëherë rreth situatës në Kosovë. Në mars të vitit 1998 Këshilli i Sigurimit duke vepruar sipas Kreut VII të Kartës dhe pa pasur ndonjë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, aprovon Rezolutë përmes së cilës nga të dyja palët kërkon ndërprerje të zjarrit.²⁷⁰

Gjatë këtyre viteve u bënë përpjekje për të vënë një dialog të drejtpërdrejtë në mes përfaqësuesve politikë të shqiptarëve dhe qeverisë së Serbisë dhe një takim i tillë u organizua në Beograd, me 15 maj 1998, ku vërehet se kanë shtrënguar duart pos të tjerëve edhe Millosheviçi dhe Ibrahim Rugova. Takimi ishte mbajtur nën trysinë e bashkësisë ndërkombëtare dhe analistët në atë kohë, sidomos në Kosovë, nuk kanë pritur se do kishte më shumë shtrëngime duarsh dhe marrje pozash për fotografi. Dhe në fakt ashtu edhe ka ndodhur. Përkundër një situatë të paqartë dhe përkundër mospajtimit të spektrit politik, që kundërshtonte Rugovën dhe UÇK-në, në Kosovë organizohen zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, të cilat edhe pritej që t'i fitonte Rugova dhe LDK. Një studim i paanshëm politikisht do të sqaronte, se cili ishte qëllimi i mbajtjes së këtyre zgjedhjeve, kur organet e pushtetit nuk ishin konstituuar as me zgjedhjet e mëparme. Megjithatë, zgjedhjet u mbajtën, për t'u konsideruar farsë nga krahu që kishte kundërshtuar dhe që kishte bojkotuar zgjedhjet. Mbajtja e zgjedhjeve përkundër pjesëmarrjes së madhe të votuesve dhe përkundër rezultatit të lartë pro Rugovës dhe LDK-së nuk sollën një unifikim të faktorit politik dhe ushtarak. Ndërkohë që me përfaqësues të UÇK-së në muajin korrik takohet edhe ambasadori, Richard Holbrooke, në Junik të Kosovës.

Vera e vitit 1998 shënon një periudhë të një ofensive të ashpër të forcave serbe që përdorin gjithë arsenalin dhe gjatë kësaj ofensive UÇK do të detyrohet të lëshojë edhe zonat që i kishte mbajtur si zona të lira. Kurse nga sulmet më së shumti pësonin civilët, kundër të cilëve kishte filluar të përdorej taktika e tokës së djegur, që të mos kishin ku të ktheheshin më. Goditjet e ashpra kundër forcës së gjallë më së shumti civile shkaktojnë lumin e madh të refugjatëve, që s'kishin edhe ndonjë drejtim të caktuar lëvizjeje. Pos drejtimin të katastrofës humanitare. Me 10 qershor të vitit 1998 Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) njoftoi se mijëra vetë, kryesisht gra, fëmijë e pleq ishin dëbuar. Ata nuk mund të ktheheshin në brendësi të Kosovës, kështu që shumë syresh

²⁷⁰ UN Security Council Resolution 1160, 31 March 1998. Kjo rezolute aprovohet pa asnjë vote kunder, por me abstenim të Kines dhe Rusisë. Abstenimin e arsyejnë me atë se rezoluta është perzierje në punët e brendshme të RFJ; Wheeler N.J: Saving Strangers: Humanitarian Intervention in International Society, Oxford-New York, 2000, p. 259

u drejtuan në Shqipëri . Me 15 qershor ICRC-ja njoftoi se brenda Kosovës kishte mijëra refugjatë, drejt Shqipërisë ishin larguar 10.000 vetë dhe drejt Malit të Zi 3.000. Rreth 20.000 vetë ishin prekur drejtpërdrejt nga luftimet.²⁷¹ Ofensiva serbe dhe masat represive, në zonat ku nuk kishte luftë të hapur, po çonin kah katastrofa humanitare dhe kjo situatë bëri që bashkësia ndërkombëtare e niveleve dhe e formave të ndryshme, merr edhe një seri vendimesh, deklaratah të cilat kërkonin ndërprerjen e sulmeve dhe dhunës serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë. Një marrëveshje në mes të Richard Holbrooke dhe Millosheviçit u nënshkrua me 13 tetor pas bisedash disaditore dhe pas kërcënimeve të NATO-s me sulme kundër caqeve serbe. Marrëveshja kishte njëmbëdhjetë parime, të cilat nuk do të respektohen për kohë të gjatë, ndërkohë që u lejua të vendoset një mision vëzhgues i OSBE-së. Realizmi i obligimeve nga marrëveshja ndikon në qetësimin e situatës për një kohë të shkurtër dhe vendosja e misionit vëzhgues i kontribuon në një masë të konsiderueshme zbutjes së dhunës serbe kundër popullit shqiptar. Por dimri dhe fundviti sikur paralajmërojnë përgatitjen për luftën e re, e cila karakterizohet nga brutalitete dhe masakra, të cilat po të liheshin pa ndërhyrje mund të tejkalonin përmasat e luftës së Bosnjës.

Botës, në veçanti fuqive kryesore të vendosjes, iu deshën dhjetë vjet të merreshin dhe të përballoheshin me shpërbërjen e Federatës Jugosllave. Diplomacia perëndimore dështoi para së gjithash, për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm, sidomos mes shteteve të bashkësisë europiane. Edhe në vitet 1991-92 qeveritë e Francës dhe Britanisë së Madhe vepronin me qëllime proserbe dhe këtu rëndësi të veçantë kishin aleancat në dy luftërat botërore dhe një imazh tradicionalisht pozitiv i serbëve - derisa nga ana tjetër shikoheshin me kritikë popujt si kroatët, boshnjakët dhe shqiptarët, të cilët, sipas perceptimit britanik dhe francez gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishin qëndruar në anën e gjermanëve dhe interesat e të cilëve në vitet nëntëdhjetë përkraheshin nga diplomacia gjermane dhe austriake.²⁷²

Duke ndjekur rrethanat në proces të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe duke njohur raportin e forcave në radhë të parë në Europë, në Kosovë nevojitej një bashkëpunim dhe koordinim i faktorit politik me atë ushtarak, i cili ka munguar. Së paku hipotetikisht, koordinimi korrekt do të kishte shkurtuar luftën për liri dhe pavarësi duke zvogëluar rrjedhimisht edhe pasojat. Nuk ka

²⁷¹ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.105-106.

²⁷² Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha Prishtinë, 2012, fq.258.

asnjë dyshim se në vitet e para të procesit të shpërbërjes nevojitej diplomaci dhe rezistencë paqësore, por kur lufta merrte përmasa në Kroaci dhe në Bosnjë, bashkëpunimi politiko - ushtarak duhej të ishte i ngushtë dhe me përgjegjësi. Nëse serbët po sulmonin pa mëshirë Kroacinë, popullata e së cilës në fund të fundit ishte me origjinë sllave, çka mund të pritej se do të ndodhte me shqiptarët. Aq më tepër kur kishim në dorë elaborate e programe, realizimi i të cilave nuk mund të bëhej ndryshe, pos me përdorimin e dhunës ushtarako-policore. Ibrahim Rugova, pa dyshim figurë historike pozitive në tërësinë e tij, ka mundur të përshpejtojë procesin e lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, nëse do të kishte marrë përgjegjësinë për të vepruar në pajtim me kushtetutën e vendit. Ai kishte besuar shumë në strategjinë e tij pacifiste dhe kishte besuar shumë te perëndimi. Por premtimet e perëndimit për një kohë të gjatë kanë qenë më shumë retorike. Ajo që tregonte përvoja e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë ishte se vetëm lufta dhe pasojat e saj mobilizonin perëndimin për të ndërhyrë. Kjo sidomos kur në krye të shtetit serb kishim një njeri, një nacionalist të tërbuar dhe me urrejtje të paparë antishqiptare, i cili nuk njihte gjuhë tjetër, përpos gjuhës së forcës. Hipotetikusht mund të shtrohen shumë çështje, të cilat sikur të veprohej ndryshe, do të sillnin rezultate më të shpejta. Sidoqoftë vetëm bashkëpunimi konkret në mes të të gjitha forcave në Kosovë, sado i vonë që ishte, bëri që lëvizja nacionale shqiptare të merrte drejtimin e duhur dhe të sillte rezultatet, të cilat historikisht ishin pritur, por edhe që i takonin popullit të Kosovës. Dhe bashkimi i të gjithë faktorëve ndodhi në një fazë të ardhshme kur Ibrahim Rugova do të pajtohet që Hashim Thaçi të bëhej prijës kryesor i bisedimeve dhe kryeministër i qeverisë së përkohshme, dhe që të vazhdonte punën sipas marrëveshjes së Rambujesë.

4.4. Marrëveshja e Rambujesë dhe efektet politiko - juridike për Kosovën

Fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999 po shënonte një ndër fazat më dramatike të zhvillimeve në Kosovë, prej qysh se kishte filluar procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë. Konfliktet në mes të forcave serbe-jugosllave dhe forcave të UÇK-së fillojnë të marrin përmasa të gjera, nga të cilat më së shumti e pësonin civilët. Zhvillimet në terren tregojnë se marrëveshja Millosheviç- Holbrooke, nuk do të realizohet. Edhe diplomacia e dy negociatorëve, Christopher Hill dhe Petrich, nuk po vërehej se do të prodhonte rezultate. Marrëveshja shërbeu për një pushim afatshkurtër ku palët në konflikt të rigrupoheshin për aksionet e ardhshme. Misioni

vëzhgues raportonte se konfliktet po merrnin përmasa. Të dyja palët ndërluftuese duken të vendosura për arritjen e qëllimeve të tyre. Forcat ushtarake dhe policore serbe ishin dukshëm më të armatosura, kurse në rrafshin ushtarak nuk zgjidhnin mjete as caqe. Goditeshin fshatra të tëra, ku pasojat ishin katastrofike. Në datën e ndërrimit të viteve 1998-1999, UNHCR-ja vlerësonte numrin e të dëbuarve në gati 180.000, luftimet e janarit shtrënguan edhe rreth 30.000 vetë të braktisnin shtëpitë²⁷³ dhe ky numër kishte tendencë rritjeje sepse sulmet e forcave serbe e sidomos kundër fshatrave shqiptare kishin rritje në intensitet. Në një situatë luftimesh dhe konfliktesh në rritje, forcat kishin sulmuar fshatin Reçak, ku prapa vetes kishin lënë një numër të madh civilësh të vrarë nga afër. Sulmi ka ndodhur me 15 janar të vitit 1999, kurse shefi i Misionit Vëzhgues, ambasadori William Walker, ishte tmerruar me atë çka po shihe në vendin e ngjarjes. Menjëherë pas vizitës në fshat ai deklaroi:

*“Pasi mbërrita në Reçak, banorët e tij më çuan në vendin, ku me tmerr të madh pashë kufomat e 20 njerëzve, të cilat, me sa duket, kishin mbetur atje ku ishin ekzekutuar. Megjithëse unë pashë vetëm 20 kufoma, kryesisht pleq të vrarë nga afër me të shtëna në ballë, në zverk ose në kokë – vëzhgues të tjerë kanë gjetur kufoma të tjera. Edhe pse nuk jam jurist – ajo që pashë më bën ta përcaktoj pa ngurrim këtë rast si masakër, si krim kundër njerëzimit”.*²⁷⁴

Ishte kjo një masakër që krijoi një atmosferë tashmë krejtësisht të padurueshme: për vendorët dhe për ndërkombëtarë. Pamjet filmike të të masakruarve në Reçak dhe deklarata e ambasadorit Walker bënë që ambasadorët e trojkës së BE-së, të drejtuar nga Gjermania dhe të Grupit të Kontaktit, menjëherë pas ngjarjes i paraqesin notë proteste Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë, kurse Millosheviçi në vend që të shprehej së paku me keqardhje për krimin e bërë, nuk ngurron që ambasadorin Walker ta shpallte *persona non gratae*. Ndërsa terreni dhe tmerret po shtoheshin. Ndikimi i masakrës së Reçakut bën që numri i njerëzve që po braktisnin fshatrat, sipas të njëjtit burim të cituar më lart, po kapte 200.000, sipas vlerësimit të UNHCR-së me 22 janar. Këto ngjarje ku nuk kursehen burra, gra e pleq dhe ku digjet çdo gjë që gjendet para vetes shënon orën

²⁷³ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.161.

²⁷⁴ Po aty, fq.155.

pesë para dymbëdhjetë, përpara se masakra e Srebrenicës²⁷⁵ të dukej minore krahasuar me atë që dukej se do të kryhej këtu. Kjo masakër përfundimisht shënon momentin ku faktori ndërkombëtar mobilizohet dhe vetëdijësohet se një zgjidhje përfundimtare dhe afatgjatë duhet gjetur. Dhe aktivitetet e bashkësisë ndërkombëtare tregojnë përkushtimin për të shkuar tutje me veprime konkrete dhe me vendosmëri. Përdje në Paris, shprehet Ministri i Jashtëm i kohës, Paskal Milo në ditarin e tij, “ zhvillova dy takime të rëndësishme, të parin me H.Vedrin, Ministrin e Jashtëm francez, të parashikuar, dhe të dytin me Ministrin e ri të Jashtëm gjerman, Joshka Fisher, që u ndodh në kryeqytetin francez atë ditë për bisedime...Vedrine...pyeti nëse sipas mendimit tim kishte ende kohë për dialog e kompromis midis shqiptarëve të Kosovës e Beogradit, nëse duhej një aksion ushtarak në Kosovë, dhe se ku ndodhej qendra drejtuese e UÇK-së....ndërsa, Fisher kishte vazhduar me...Bosnja nuk përsëritet më, nuk do të lejojmë një diçka të tillë“.²⁷⁶ Dhe pikërisht, në këtë ditë, me 22 janar në Londër mbledhet Grupi i Kontaktit, ku diskutohet dhe pranohet një dokument me parimet e panegocueshme që do jetë bazë në konferencën që po përgatitej për t’u organizuar. Dokumenti përmban këto parime:

- *domosdoshmëria e dhënies fund të dhunës dhe respektimi i armëpushimit;*
- *zgjidhja paqësore përmes dialogut;*
- *marrëveshja e përkohshme, mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare pas një periudhe kalimtare trivjeçare;*
- *asnjë ndryshim i njëanshëm i statusit kalimtar;*
- *respektimi i tërësisë tokësore të RFJ-së dhe të fqinjëve të saj;*
- *mbrojtja e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive kombëtare (ruajtja e identitetit, gjuhës dhe arsimit të tyre, mbrojtje e posaçme për institucionet fetare);*
- *zgjedhje të lira dhe të ndershme në Kosovë (lokale dhe të përgjithshme) nën mbikëqyrjen e OSBE-së;*

²⁷⁵ Gjenocidi në Srebrenicë ka ndodhur në korrik të viti 1995 dhe nënkupton vrasje masive të planifikuar të një numri të madh të meshkujve dhe fëmijëve të boshnjakëve nga 12 deri 77 vjet. Gjenocidi ka ndodhur në regjionin e Srebrenicës dhe këtë e ka kryer ushtria e Republikës Serbe nën komandën e Ratko Madiqit dhe të formacionit ushtarak "Škorpioni", nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Kjo ngjarje shënon një nga masakrat më të mëdha pas Luftës së Dytë Botërore në Europë në të cilën janë vrarë 8 000 burra myslimanë. Masakra llogaritet të jetë një nga ngjarjet më makabre në historinë më të re të Europës. Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës ka marrë vendim që masakra e Srebrenicës të cilësohet si gjenocid.

²⁷⁶ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të jashtëm-Konflikti i Kosovës 1997-2001*, Toena,Tiranë, 2009, fq.133-136.

- *asnjë palë nuk do të përndjekë të tjerët për krime që kanë lidhje me konfliktin në Kosovë (përveçse për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare;*
- *amnisti dhe lirim i të burgosurve politikë;*
- *angazhimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi i plotë i palëve në zbatimin e zgjidhjes²⁷⁷.*

Pas vetëm pak ditësh, kur opinioni ndërkombëtar dhe vendor ishte sensibilizuar nga ngjarjet në Kosovë dhe po ushtrohej edhe një presion publik nga opinioni demokratik, me datë: 29 janar mbledhet Grupi i Kontaktit në nivel të ministrave të jashtëm, ku aprovohet një deklaratë prej tetë pikash, nga të cilat po veçojmë: “Grupi i Kontaktit ka vendosur që të mbledhë bashkë në një Konferencë në Rambuje, në afërsi të Parisit, përfaqësuesit e qeverive jugosllave e serbe me përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, më 6 shkurt nën bashkëkryesinë e ministrave të jashtëm të Francës, Huber Vedrine dhe të Britanisë së Madhe, Robin Kuk (Robin Cook) për të filluar negociatat me përfshirjen e drejtpërdrejtë të tij”.²⁷⁸ Me pikën pesë të deklaratës, “grupi i kontaktit obligon RFJ-në që të ndërmarrë disa veprime urgjente duke filluar me ndërprerjen e ofensivës dhe të sulmeve e deri tek identifikimi dhe pezullimi i oficerëve nën komandën e të cilëve ishte kryer masakra në Reçak, ndërsa me pikën gjashtë, shqiptarëve u kërkohet që të zbatojnë rezolutat, 1150,1999 dhe 1203 të Këshillit të Sigurimit. Më tutje, sipas pikës shtatë, Grupi i kontaktit obligon Robin Kuk-un të udhëtojë në Beograd dhe në Prishtinë për t’i transmetuar këto mesazhe dhe, pika e fundit, thotë se e ardhmja e Kosovës është në duart e liderëve të Beogradit dhe të Kosovës...”.²⁷⁹ Me këtë mbledhje të Grupit të Kontaktit do të përcaktohen kornizat e qarta kohore dhe legale, brenda të cilave do të kërkohet të gjendej zgjidhja kalimtare e problemit të Kosovës. Dhe nga vendimet e kësaj mbledhjeje do të organizohet Konferenca e Rambujesë, që sipas Marc Weller “është një shembull i çuditshëm i negociatave të imponuara”.²⁸⁰ Por përvoja e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë për të satën herë tregon se, pa imponim dhe pa kërcënim të forcës kundër Millosheviçit, asnjë problem nuk do të zgjidhej. Vendimi dhe vendosmëria për organizimin e konferencës, “në prag të fillimit të bisedimeve në opinionet politike ndërkombëtare

²⁷⁷ Shih Dokumentet e Konferencës së Rambujesë, Parimet e panegocueshme të Grupit të Kontaktit.

²⁷⁸ Shih Deklaratën e Grupit të Kontaktit të datës 29 janar, pika 3, paragrafi 4.

²⁷⁹ Për më tepër shih tekstin e Plotë të Deklaratës së Grupit të Kontaktit të datës 29 janar, 1999.

²⁸⁰ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.208.

ekzistonte frika se mbledhja mund të bojkotohej nga njëra apo nga tjetra palë^{.281} Dhe kjo frikë kishte të bënte me të dyja palët pjesëmarrëse në konferencë, prandaj palëve iu bëhet e ditur, se nëse nuk shkohet në bisedime, do të merrnin mbi vete të gjithë përgjegjësinë për pasojat që do të ndodhnin. Ekzistonte një frikë se: nga pala serbe do të kishte dredhi dhe manipulacione nga Millosheviçi dhe diplomacia tij dhe, nga ana shqiptare di të kishte mospajtime të thella në mes faktorit politik dhe ushtarak. Qeveria e Shqipërisë zyrtarisht me anë të një deklaratë mbështet vendimet e Grupit të Kontaktit, kurse përgjigjja e Prishtinës, krijonte bazë për frikë. LDK e Ibrahim Rugovës dhe LBD e Rexhep Qosjes deklarohen shpejt pro konferencës, ndërkohë që Adem Demaçi, si përfaqësues politik i UÇK-së, po shprehej kundër vendimeve të Grupit të Kontaktit. Dhe kjo ishte ajo, nga çka të gjithë duhej të ishim të frikësuar. Rreziku i dështimit të konferencës për fajin e shqiptarëve ishte baras me mbetjen vetëm, në një luftë, e cila vështirë se mund të fitohej dhe, edhe nëse do të fitohej ndonjëherë do të ishte si fitorja e Pirros. Dhe nuk është se s’kishte frikë se konferenca mund të dështonte për fajin e shqiptarëve. Vetë fakti se në një gjendje kaq të vështirë, delikate dhe vendimtare për fatin e një populli të pambrojtur, kishim tre grupacione plus, që do të shkonin në negociata me serbët, është i mjaftueshëm që frika të jetë e bazuar. Struktura e delegacionit shqiptar, që mori pjesë në bisedimet e Rambujesë, ishte: grupimi institucionalist legjitimist, grupimi i UÇK-së, grupimi i demokratëve liberalë të qendrës të R.Qosjes dhe grupimi i të pavarurëve.²⁸² Tre grupacione plus do të ulen në momentin vendimtar për fatin e popullit, në emër të të cilit thirreshin, por dhe rrezikojnë të jenë të përçarë për shkaqe legjitimiteti, krekosjeje, kapardisjeje, ideologjie, primati, etj. Ish- Sekretarja Amerikane e shtetit, e cila me angazhimin e saj këmbëngulës ka bërë që konferenca të mos dështojë për fajin e delegacionit shqiptar, deklaroi: “posa arrita në Rambuje, fillova takimin e parë ndër takimet e shumta me delegacionin shqiptar. Termi “i ndryshëm“ mund të ishte shpikur shumë mirë për këtë grup, i cili përbëhet që nga enigmatiku Rugova e deri te pragmatiku Surroi dhe problematiku Thaçi. Askush prej tyre nuk kishte marrë ndonjëherë pjesë në bisedime të koklavitura, sigurisht jo në shkallë botërore. Përveç kësaj, vazhdonin të kishin ende shumë mosmarrëveshje mes tyre...“^{.283} Palët në Rambouillet, Francë, me 6 shkurt takohen që të punojnë për detajet e një marrëveshjeje që do të kthejë autonominë, të mbrojë kosovarët nga shtypja

²⁸¹ Akademia e Shkencave – Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Kosova në vështrim enciklopedik*, Toena, Tiranë, 1999, fq.141.

²⁸² Poaty, fq.142.

²⁸³ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, fq.465.

përmes një operacioni të udhëhequr nga NATO, të çarmatosë UÇK-në dhe të mundësojë që serbët të patrullojnë kufirin. Madeleine Albright dhe partneri i saj britanik, Robin Cook, e ndjekin këtë politikë me agresivitet.²⁸⁴ Kontribut po jepnin të gjithë, si ata nga jashtë dhe ata nga brenda. Nuk mund të kontestohet sot dhe as atëherë kontributi i secilit individ dhe as ai i grupacioneve që po niseshin të ndarë dhe që ndoshta për herë të parë po bëheshin grumbull në avion për në Francë. Por, grupacionet nuk besoj se kishin të drejtë të thirreshin në të drejtat ekskluzive për primat dhe përfaqësim apo kryesim të delegacionit. Të thirreshe se i përfaqësoje institucionet e Kosovës, kur kuvendi kurrë nuk ishte mbledhë ishte jo e drejtë. Nuk ishte e drejtë po ashtu të mohojë gjithë luftën politike që megjithatë ishte bërë brenda dhe jashtë Kosovës, duke u thirrë në faktin se vetëm lufta po e bënte të veten. Sikur të kishim forcë për të përzënë forcat serbe, nuk do ishte e nevojshme shkuarja në konferencë. Megjithatë me përjashtim të deklaratave të Adem Demaçit, ekipet e grupacioneve të delegacionit kosovar formohen dhe „bashkimi i delegacionit të Kosovës, rreth një platforme politike, ishte suksesi më i madh i këtij delegacioni“.²⁸⁵ Dhe edhe bashkësia ndërkombëtare ishte shumë e interesuar që të gjitha grupacionet shqiptare të ishin të përfaqësuara në konferencë. Sidomos pjesëmarrja e UÇK-së, vlerësohej të ishte vendimtare. Vështirësitë që kishin në Kosovë, ndarjet e përçarjet që u përmendën më sipër, megjithatë zbehen, që të mos themi eliminohen fare gjatë konferencës. Pështja e përgjegjësive historike, vetëdija për dëmet që mund të shkaktoheshin, gjendja e rëndë, pritjet dhe shpresat që kishte populli dhe trysnia ndërkombëtare, janë disa nga shkaqet që grupacionet të bashkohen dhe të tejkalojnë ndarjet. Siç thotë Ramë Buja, njëri nga anëtarët, “ky takim i parë në Francë i delegacionit, dhe njohja për herë të parë e disa anëtarëve në mes vete, nuk linte përshtypjen se delegacioni do të ketë mundësi të konsolidohet shpejt dhe të jetë i suksesshëm. Por, për fat të mirë, ndodhi e kundërta e asaj që mendohej...²⁸⁶. Përcaktimi i delegacioneve nuk ishte punë e lehtë, por ato u krijuan dhe u ngarkuan me përgjegjësi, problemi tjetër ishte i llojit teknik. Ishte shumë vështirë që grupi i UÇK-së të udhëtonte për të dalë nga Kosova përmes aeroportit të Prishtinës, i cili ishte nën kontrollin e serbëve. Dhe përfaqësuesit e UÇK-së duhej të vinin nga vijat e luftës. Edhe pse ky element na duket teknik është detaj që tregon dy çështje. E para, se po organizohej një konferencë që ishte e pabarabartë për palët. Delegacioni kosovar e kishte të pamundur të mblidhej i tëri në Kosovë paraprakisht dhe vetë

²⁸⁴ Bill Clinton, *My life*, Alfred A. Knopf Borzoi Book, New York, 2004, fq.850.

²⁸⁵ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe – Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Buzuku, Prishtinë, 2006, fq.160.

²⁸⁶ Ramë Buja, *Konferenca e Rambujesë*, Vertigo, Prizren, 2006, fq.66.

mundësia e udhëtimit është argument shtesë për këtë pabarazi. E dyta, faktori ndërkombëtar ishte i vendosur që të shkohej me çdo kusht gjatë mbajtjes së konferencës dhe vështirësitë e udhëtimit tejkalohen falë një angazhimi të tillë. Kështu, delegacioni kosovar do të jetë i tëri në Francë, Rambuje, jo larg Parisit, me datë 5 shkurt 1999. Pra, delegacioni shqiptar prej gjashtëmbëdhjetë vetash përfshinte udhëheqësin e moderuar politik, Ibrahim Rugova, gazetarin e respektuar, Veton Surroi, akademikun, Rexhep Qosja dhe përfaqësuesit e partive të tjera politike, të pavarurit dhe UÇK-në.²⁸⁷

4.4.1. Fillimi i Konferencës

Delegacionet e palëve negociuese kishin ardhur me mandate të ndara dhe me përbërje heterogjene. Delegacioni kosovar megjithatë kishte mandat të plotë të vendoste, ndërsa mandati i delegacionit serbo-jugosllav ishte me mandat të kufizuar dhe me përfaqësim nënçmues për rangun e konferencës: për palën tjetër, për organizatorët dhe për ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Millosheviçi nuk e kryesonte këtë delegacion për dallim nga Konferenca e Dayton-it. Ai dëshironte që konferencës t'ia zbehte karakterin ndërkombëtar, duke u munduar të taktizojë dhe të krijojë hapësirë zhvarritjeje në procesin e marrjes së vendimeve, duke bërë që delegacioni serb të paraqiste kërkesa për konsultime me Beogradin. Kishte emëruar një delegacion, të cilit i printe zëvendëskryeministri i Serbisë, Ratko Marković, ndërsa në delegacion kishte sjellë edhe disa “përfaqësues kukulla“ të minoriteteve që jetonin në Kosovë dhe madje edhe disa të vetëquajtur shqiptarë. Me këtë ai donte të paraqiste delegacionin si gjithëpërfshirës dhe se kinse delegacioni serb mbronte interesat e të gjithëve në Kosovë. Taktikë e njohur, por që s'printe më ujë. Dhe llogari e gabuar gjithsesi.

Delegacioni shqiptar pavarësisht që ishte nisur në grupacioni tre plus²⁸⁸ që në ditën e parë tregon seriozitetin dhe secili grup kishte kryesuesin dhe në fund i tërë delegacioni do bëhej si një i tërë. Pavarësisht se edhe brenda delegacionit shqiptar pritej të kishte ndarje dhe mospajtime, kur të vinte çështja e aprovimit të dokumenteve, në çka në një mënyrë edhe llogariste pala serbe, megjithatë do të vepronte dhe do të merrte vendimet përfundimtare si një i vetëm. Karta e OKB-

²⁸⁷ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë 2004, fq.463.

²⁸⁸ Sqarim për tre plus: treshja janë tri grupacionet siç janë përshkruar, LDK, LBD dhe UÇK, kurse plus janë, Veton Surroi dhe Blerim Shala, publicistë, gazetarë, intelektualë, të shkathët në bisedime dhe me autoritet e ndikim brenda dhe jashtë.

së parasheh dy mekanizma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. I pari rregullohet me kreun VI, i cili paraqet zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, kurse kreu VII parasheh mjete të dhunës për zgjidhjen e kontesteve. Nga shkaku i kundërshtimeve të fuqive të mëdha, masat që janë paraparë me kreun VII të Kartës në praktikë nuk janë përjetuar në atë masë siç ka qenë fillimisht e menduar. Meqë nuk ka ekzistuar mundësia që kontestet ndërkombëtare të zgjidhen sipas mënyrës së paraparë, praktika ka krijuar forma të reja të cilat në një masë kanë plotësuar këtë zbrazëti.²⁸⁹ Shumë nga kjo shohim konkretisht edhe me rastin e Kosovës. Kemi konferenca, bisedime, ndërmjetësime, etj., por edhe intervenim ushtarak. Dhe intervenimi ushtarak do të ndodhë pas refuzimit të Serbisë/RFJ-së që të pranojë marrëveshjen e ofruar. Lidhur me intervenimin, duke pasur parasysh ngjarjet në Somali, Irak dhe në ish Jugosllavi, Helton konsideron se në situata të ngjashme duhet ndërmarrë një ndihmë humanitare e kufizuar pa pajtimin e shtetit dhe kjo duhet të jetë një ndër përgjigjet që bashkësia ndërkombëtare ka në dispozicion dhe që konsiderohen legalisht të lejueshme.²⁹⁰ Në Kosovë gjendja ishte buzë katastrofës. Ishte një gjendje, siç konsideron Bazylar, kur intervenimi humanitar mund të ndërmerret nëse qeveria e një shteti vret apo kërcënon se do të vrasë numër të madh të qytetarëve të vet, apo që është angazhuar në aktivitete siç janë pengimi i të ushqyerit dhe strehimit apo dëbimit dhe shpërnguljes së banorëve, që rezulton me humbje masive të jetërave të njerëzve.²⁹¹ Të gjitha këto po ndodhnin në Kosovë dhe intervenimi i NATO-s ishte legjitim dhe legal, pas dështimit të Konferencës së Rambouillet. Kurse gjendja e paraintervenimit e fuqizon atë që njihet si e drejtë e vetvendosjes zhdëmtuese.

E kur jemi te konferenca, ajo udhëhiqej nga dy bashkëkryetarët: Kuk dhe Vedrin dhe nga tre ndërmjetësuesve: Hill në emër të SHBA-së, Petric në emër të BE-së dhe Mayorski në emër të Rusisë.

Konferenca fillon, siç ishte paraparë me 6 shkurt 1999. Pjesëmarrësve të konferencës, por edhe opinionit botëror po u drejtohet Presidenti Jacques Chirac, i cili pastaj do të ndiqet me fjalimet edhe të bashkëkryetarëve, të cilët, do të dalin edhe para gazetarëve. Kjo në fakt do të jetë

²⁸⁹ Nebojsa Raicevic, Humanitarna Intervencija u Medjunardodnom Javnom Pravu (doktorska dizertacija), Universiteti i Nish-t, 2008

²⁹⁰ Helton A.C: The Legality of Providing Humanitarian Assistance Without the Consent of the Sovereign, *Interantional Journal of Refugee Law*, vol. 4, 1992, no. 3, p. 375

²⁹¹ Bazylar M.J: Reexamining the Doctrine of Humanitarian Intervention in Light of the Atrocities in Kampuchea and Ethiopia, *Stanford Journal of International Law*, vol. 23, Spring 1987, pp. 598-599

fundi i ditës së parë të konferencës dhe fillimi i procesit, fundi i të cilit do të hapë përfundimisht rrugën më të sigurt për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Organizatorët e konferencës kishin vënë kushte të ashpra pune, të cilat, siç përshkruhet nga kushdo që ka qenë brenda kështjellës, nuk janë respektuar nga delegacioni serbo-jugosllav. Ata, siç nënvizohet, nuk donin të kuptonin seriozitetin e konferencës as edhe efektet apo pasojat që do t'i sillte apo do t'i shkaktonte ajo.

Delegacionet kanë punuar veç e veç pa u takuar në sesione të përbashkëta. Atyre me datën 7 shkurt iu është dhënë dokumenti bazë, apo projekti i Kornizës së Marrëveshjes së Përkohshme për paqe e vetëqeverisje në Kosovë. Po këtë ditë delegacioni kosovar, në një takim të përbashkët, do të zgjedhë kryesinë e delegacionit kosovar, në të cilin ishin: Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja dhe Hashim Thaçi. Kryesisë iu la ta zgjidhte kryesuesin dhe ai do të jetë Hashim Thaçi - Kryeshef i Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Zëdhënës i grupit u caktua Veton Surroi. Grupi i mirëfilltë bisedues prej katër anëtarësh përbëhet nga Fehmi Agani, Hydajet Hyseni, Jakup Krasniqi dhe Blerim Shala. Vendimet mund të merreshin vetëm njëzëri.²⁹²

Marrja e dokumentit për shqyrtim dhe që kishte dy pjesë si kuadri politik dhe instrumentet e detyrimit e shtyn delegacioni kosovar të punojë bashkë me ndihmën e ekspertëve vendorë, me ekspertë nga Republika e Shqipërisë, dhe me ekspertë të jashtëm. Ishte një detyrë që kërkonte punë dhe përkushtim, por edhe kohë shtesë për shkaqe teknike, si bie fjala te përkthimi në shqipe. Dhe siç është zakoni në konferenca ndërkombëtare, ku zgjidhen fate popujsh e territoresh, gjithmonë ka skena e prapaskena. Ka informacione që mendohet se nuk rrjedhin, por që në fakt bëhen të ditura qysh herët. Ka opsione e kundëropsione. Ka tendenca lodhjeje të palës tjetër dhe fitim në kohë. Ka mospajtime edhe brenda vetë delegacioneve negociuese. Ka sigurisht edhe formula të cilat prezantohen aty për aty sikundër që ka trysni nga jashtë dhe nga brenda ndaj palëve negociuese. Ka edhe investime autoritetesh dhe djegie figurash politike. Ka edhe karakteristika të tjera të përbashkëta për konferenca ndërkombëtare më pak ose më shumë të

²⁹² Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.176.

rëndësishme, për t'u përmendur. Edhe kjo konferencë nuk ishte shumë përjashtuese nga kjo që u tha.

Palët pasi kishin marrë propozim për dokumentin, kishin marrë detyrë që deri me datë 12 shkurt të dorëzonin komentet e tyre. Delegacioni kosovar shfaqti rezerva dhe dyshime në pjesën e parë të dokumentit, në të cilin sanksionohej se statusi politik i Kosovës do të ndërtohej pa cenuar integritetin territorial të RFJ-së.²⁹³ Në reagimin e tyre të parë shqiptarët u ankuan për mungesën e klauzolës së referendumit për pavarësinë e krahinës. Veç kësaj roli i ardhshëm i UÇK-së nuk ishte përcaktuar qartë.²⁹⁴ Ishin këto paqartësitë e para, të cilat bëjnë që kryesuesi i delegacionit shqiptar, të këmbëngulë në qëndrime duke refuzuar çështjet, për të cilat nuk kishte autorizime që të merrte vendime. Brenda në kështjellë dukej se shkonte edhe ndonjë informacion, sipas të cilit nga terreni nuk po jepej pëlqimi për çmilitarizimin e UÇK-së, se nuk duhej hequr dorë nga referendumi pas periudhës së caktuar, etj. Në anën tjetër delegacioni serb dukej se më shumë po merrej me çështje procedurale sesa me çështje përmbajtjesore. Serbët kërkonin edhe dokumentin për sigurinë, ndërkohë që ndërmjetësuesit kishin vendosur që së pari të mbaronte ai për çështjen politike. Kur të përfundohej ky, atëherë do të flitej për sigurinë, për forcat e NATO-s që duhej të vendoseshin në Kosovë dhe që për Millosheviçin ishin krejt të papranueshme. Ai ose do të shkonte, sipas traditës deri në fund për të lëshuar pe, ose do të zgjidhte rrugën e tmerrit, me çka mund t'i bënte vetëm edhe për pak kohë dëm Kosovës. Ose kësaj here kishte humbur tërësisht aftësinë e marrjes së mesazheve, të cilat shumë qartë po i thoshin: nëse nuk pranon do të goditesh. Ndërkaq ai edhe gjatë konferencës po sulmonte me tërë arsenalin në Kosovë.

Brenda delegacionit shqiptar të Kosovës sado që kishte frymë pune, vërehet një frikë për disa elemente kyçe të dokumentit, sidomos për çështjen e referendumit pas një kohe të caktuar trevjeçare dhe pas shpërbërjes së UÇK-së. Vërtetë, në fazat përfundimtare të bisedave në Rambuje ishte një fjalë e vetme – referendumi – e cila e bllokoi tërë procesin. Kosovarët insistonin se fjala duhej futur në marrëveshje, në mënyrë që ata të kishin mundësi votimi në çështjen e pavarësisë pas tri vitesh. Prandaj kjo fazë ishte edhe “momenti i së vërtetës”²⁹⁵ dhe këtu ishin momentet në të cilat mund të bëheshe në të njëjtën kohë hero dhe tradhtar. Shqiptarët

²⁹³ Akademia e Shkencave – Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Kosova në vështrim enciklopedik*, Toena, Tiranë, 1999, fq.144.

²⁹⁴ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.178.

²⁹⁵ Berridge, (2005:47), cituar nga Bajram Gecaj, *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009, fq.50.

vazhdojnë të punojnë dhe të thyejnë shtizat te referendumi, kurse serbët veçse rikonfirmonin joseriozitetin e tyre. Se fjalët dhe terminologjia ndihmon, u vërtetua sidomos “kah fundi, delegacioni i Shteteve të Bashkuara iu dha shqiptarëve një letër në të cilën premtuhej referendumi pas tri vitesh.²⁹⁶ Një variant i propozuar, që hapte mundësinë e pranimit nga pala kosovare, ishte i një formulimi si më poshtë:

*“Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje do të thirret një konferencë ndërkombëtare për të përcaktuar një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën në bazë të vullnetit të shprehur të popullit, mendimit të autoriteteve të rëndësishme, përpjekjeve të secilës palë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe Aktit Final të Helsinkit, si dhe për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të zbatimit të marrëveshjes dhe për të shqyrtuar propozimet e secilës palë për masa shitesë”.*²⁹⁷

Ishte ky një formulim që në një mënyrë do të zbusë qëndrimin e Rexhep Qosjes dhe në veçanti të Hashim Thaçit, i cili megjithatë ishte këmbëngulës me JO-në e tij. Atij i ishte mundësuar të lëvizte shpejt jashtë kështjellës dhe ta takonte Adem Demaçin në Lubjanë të Sllovenisë, të cilit, do t'i jepte informacione për rrjedhat në konferencë dhe nga i cili, pretendohet të merrej pëlqimi i palës shqiptare. Ndërkohë në vizitën e dytë në Beograd, që Hill po bënte që nga fillimi i konferencës as që ishte pritur nga Millosheviçi. Konferenca po i ofrohej fundit pa u arritur qëllimi i pritur. Në grupin kosovar ushtrohet një presion, konsideroj më se i nevojshëm nga të gjithë. Nga Sekretarja e shtetit Albright, nga ndërmjetësuesit, nga qeveria shqiptare, nga intelektualë, kur rol tepër të fuqishëm do të ketë letra drejtuar delegacionit kosovar, nga shkrimtari Ismail Kadare. Letra e Kadaresë e lë Thaçin vetëm, sepse pas kësaj Qosja heq dorë nga kundërshtimi. Thaçi me JO-në e tij, tashti po rrezikonte të ardhmen e vendit të vet dhe këtë në një mënyrë po e lidhte me çështjen e mbijetesës së vet politike, apo mbijetesës së vet fizike. Thaçi, “i tregoi Jamiet-s²⁹⁸ se kishte frikë për jetën e tij”.²⁹⁹ Dhe këtë të drejtë nuk do t'ia jepte askush dhe kurrë. Pikëpamjet ndërkombëtare ishin të qarta, kurse pikëpamja amerikane në këtë periudhë kritike për fatin e marrëveshjes ishte: 1. Nëse të dyja delegacionet do

²⁹⁶ Hooper,(1999:161), cituar nga Bajram Gecaj, *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009,fq.51.

²⁹⁷ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.206.

²⁹⁸ Këtë ia kishte thënë në sy Jamie Rubin-it gjatë Konferencës së Rambouillet.

²⁹⁹ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë 2004, fq.470.

ta pranonin, një trupë ushtarake do të vendosej paqësisht në Kosovë, 2. Nëse marrëveshja do të nënshkruhej vetëm nga pala shqiptare, NATO do të ndëshkonte regjimin e Beogradit për mospranimin e paqes, 3. Por nëse as delegacioni shqiptar nuk do ta nënshkruante marrëveshjen, atëherë do të mbetej të rishqyrtohej edhe një herë mundësia e ndërhyrjes ose jo të aviacionit të Aleancës Euro-atlantike në ish -Jugosllavi.³⁰⁰ Serbia duke qenë e informuar se brenda delegacionit shqiptar ka përçarje, ndërtonte strategjinë e vet duke dërguar letra me kinse propozime e kundërpropozime, për të fituar në pozicionim dhe në kohë. Veton Surroi, sigurisht edhe nga përvoja e tij diplomatike del me një propozim i cili qetëson delegacioni shqiptar dhe që do të jetë i pranueshëm edhe për organizatorët e konferencës. Kërkohej dy javë kohë që të zhvillohen konsultime dhe që populli në Kosovë të informohet me rrjedhat dhe me dokumentet e propozuara. Kjo ishte një miratim në parim i marrëveshjes dhe “shtyrja për tri javë e nënshkrimit të saj, ishte një vendim i mençur diplomatik i Grupit të Kontaktit, por para së gjithash i amerikanëve. Kjo i dha frymëmarrje e kohë delegacionit shqiptar, e kryesisht Thaçit e drejtuesve të tjerë të UÇK-së, që të ktheheshin në Kosovë, të bisedonin me komandantët e njerëzit e terrenit dhe pastaj të merrnin një vendim të pjekur mirë”.³⁰¹ Koha e dhënë për konsultime politikisht ishte e qëlluar, për të ruajtur unitet brenda delegacionin dhe për të dhënë siguri se marrëveshja do të përkrahej nga të gjitha grupacionet. Në anën tjetër ishte një zgjatje ankthi, frike dhe pasigurie për qytetarët e Kosovës, të cilët po pësonin edhe më shumë nga intensifikimi i dhunës nga forcat e gjithëllojshme dhe ishte edhe një afat shtesë për Millosheviçin që të përforcojë pozitat duke krijuar një gjendje çfarë i konvenon në terren dhe të sjellë edhe më shumë trupa në Kosovë. Marrëveshja u sqarua aq sa kishte nevojë të sqarohej, nga të gjithë te vartësit dhe përkrahësit e tyre. Përndryshe, populli për këtë ishte deklaruar që moti. Sidoqoftë kishte edhe diplomaci. Kishte përpjekje për të bindur edhe Serbinë. Kishte edhe frikë në mos delegacioni shqiptar po ndryshonte mendje. Ishte investuar shumë dhe të gjitha veprimet bëheshin që të mos kishte dështim. Ndërmjetësuesit ishin tërë kohën në terren duke zhvilluar bisedime me serbe e me shqiptarë. Në Kosovë e në Serbi. Holbrooke dhe Ivanov vizitojnë Serbinë me përpjekje që t’i ndryshojnë mendje Millosheviçit, por pa sukses. Me 14 mars Grupi i Kontaktit shqyrton përpjekjet diplomatike për periudhën pas Rambujesë dhe deri në Paris për të ndërtuar strategji për vazhdimin e konferencës.

³⁰⁰ Akademia e Shkencave – Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Kosova në vështrim enciklopedik*, Toena, Tiranë, 1999, fq.145.

³⁰¹ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të jashtëm-Konflikti i Kosovës 1997-2001*, Toena, Tiranë, 2009, fq.163-164.

Konferenca vazhdon në Paris dhe jo në Rambuje, me 15 mars 1999, ndërkohë që tashmë ishte e qartë se shqiptarët kishin dhënë pëlqimin për këtë. Pritej nënshkrimi formal dhe ekzistonte shpresa se edhe pala serbe do të pajtohej me marrëveshjen. Serbët për dallim nga Rambuje tash kishin ardhur me delegacionin ku presidenti serb Millutinoviç dirigjonte. Serbët po kërkonin bisedime shtesë, takime të drejtpërdrejta me shqiptarët, propozojnë formulime të reja në marrëveshje ku kërkonin heqjen e çfarëdo elementi që zvogëlonte sovranitetin serb e gjepura tjera, të cilat tashmë ishin të papranueshme as për t'u vënë në diskutim. Kryesuesi i delegacionit kosovar i drejton letër Kryesuesit të Këshillit të BE-së, Joshka Fisher dhe të Dërguarit të Posaçëm të BE-së, Petritsch, se delegacioni kosovar dhe ai personalisht ishin të gatshëm që të nënshkruanin marrëveshjen “në praninë Tuaj në kohën dhe vendin që Ju do ta gjykoni të arsyeshëm...në suksesin tonë të përbashkët ndihmesa Juaj dhe e vendit Tuaj ka një peshë vendimtare...Populli i Kosovës është aleat i Europës dhe i tillë do të jetë edhe më tej...ndihmesa Juaj dhe e Bashkimit Europian ishin të pazëvendësueshme dhe çmohen si të tilla”.³⁰² Me 16 mars Grupi i Kontaktit në mbledhjen e vet ka analizuar ecurinë, kurse trojka ndërmjetësuese shpreh mendimin se bisedimet duhet të përfundojnë me 18 mars, gjë që edhe do të ndodhë. Në një ceremoni pa pompozitet dhe pa fjalime zyrtare, delegacioni shqiptar nënshkruan marrëveshjen, e cila nënshkruhet edhe nga ndërmjetësuesit Hill dhe Petritsch, kurse Mayorski edhe pse ishte i pranishëm nuk e nënshkruan dokumentin. Delegacioni kosovar, në deklaratën për marrëveshje të përkohshme. do të shprehet se Kosova e pranon marrëveshjen dhe ky pranim nënkupton se pranohet teksti i paraqitur i datës 23 shkurt si një tërësi. Më tutje në deklaratë theksohet se teksti i marrëveshjes konsiderohet si përfundimtar dhe nuk mund t'i nënshtrohet asnjë ndërhyrjeje ose diskutimi për ndryshime. Deklarata në fakt duke pranuar tekstin e marrëveshjes i bën thirrje forcave të vendosjes që sa më parë të veprojnë sipas obligimeve të marrëveshjes, përfshirë vendosjen e trupave të NATO-s dhe krahas kësaj edhe të elementëve civilë për zbatim të marrëveshjes. Potencohet përkushtimi që të lejohet deklarimi i popullit, pas periudhës kalimtare prej tre vjetësh dhe në fund tregohet vendosmëria e shndërrimit, siç quhej të UÇK-së. Deklarata është nënshkruar nga Hashim Thaçi, si Kryetar i Kryesisë së Delegacionit të Kosovës.

³⁰² Citate nga letra e Hashim Thaçit, marrë nga Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.238.

Konferenca përfundon me kaq dhe delegacionet marrin drejtimet e veta të kthimit. Delegacioni i Kosovës e kishte shumë më të vështirë kthimin, sepse nuk mund të bëhej shumë për sigurinë e tyre. Për pjesën e UÇK-së as që mund të flitej. Konferenca shënon të arritjen më të madhe për popullin shqiptar të Kosovës që nga shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar. Efektet e saj politike janë të shumta dhe mund të grupohen në të brendshme dhe të jashtme.

Të brendshme: të gjitha grupacionet me orientime të ndryshme ideologjike bashkohen në një dhe për më tepër pranojnë të udhëhiqen nga krahu ushtarak. Kjo është e rëndësishë së veçantë, sepse Kosova nuk ka pasur mundësi deri në këto kohë të kishte ushtri e cila do vihej në mbrojtje të popullit të vet. Uniteti politik i delegacionit forcon pozicionin e Kosovës, pozicion ky që Kosovën e nxjerrë si palë më e fortë në një ndeshje negociatore të pabarabartë. Konferenca sjell edhe të një unitet gjithëshqiptar, ku po arrihet një unitet politik i dy entiteteve shqiptare. Krahas kësaj ndikimi i intelektualëve ishte politikisht dhe profesionalisht i efektshëm. Ekspertiza e potencialit intelektual shqiptar përdoret sikundër që ndikimi i tyre ishte i një vlere të paçmim. Letra e shkrimtarit Ismail Kadare konsideroj të ketë qenë kyç për unitetin politik dhe diplomatik shqiptar. Uniteti i tillë ka sjellë marrëveshjen për krijimin e qeverisë së përkohshme gjithëpërfshirëse që do qeveriste vendin deri në përfundimin e zgjedhjeve të lira.

Të jashtme: Kosova paraqitet si subjekt i barabartë në një proces negociator të organizuar dhe të ndërmjetësuar nga faktorët më të fuqishëm ndërkombëtarë. Tendencave të Serbisë për të trajtuar Kosovën si problem të brendshëm, përfundimisht i janë prerë rrugët dhe argumentet e saj, në këtë kontekst kanë qenë veçse të zbehura. Fakti se në dispozitat e marrëveshjes Kosova si entitet figuronte si pjesë e RFJ-së, nuk do të ishte pengesë që pas periudhës kalimtare trevjeçare të deklarohet për vetëvendosje. E drejta e vetëvendosjes ishte shkelur me dhunë nga Serbia, sepse kjo e drejtë i takonte me Kushtetutën e vitit 1974. Kosova ndërkombëtarisht kishte pozicion të fortë duke qenë e vendosur fuqishëm në krahun e diplomacisë amerikane dhe e përkrahur nga Bashkimi Europian. Në një mënyrë duke u bërë faktor edhe karshi Rusisë.

KREU V: Çlirimi i Kosovës

5.1. Kosova e lirë nën protektoratin e OKB-së

Më 9 mars, pasi delegacioni shqiptar nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë, bashkëkryetarët e Konferencës Kuk dhe Vedrin i drejtohen Millosheviçit me një letër, nga i cili kërkojnë të pranojë marrëveshjen. Esenca e letrës është edhe një përpjekje për të shmangur atë për çka NATO ishte e gatshme të ndërmerre. Bashkëkryetarët me këtë përpjekje vihen në dispozicion për të dhënë përgjigje, por bëjnë me dije se marrëveshja duhet të respektohet tërësisht. Ata gjithashtu bëjnë me dije se Grupi i Kontaktit mbetet unik dhe se nuk shihet nevojshme ndonjë vizitë shtesë në Beograd, ndërsa Grupi i Kontaktit do të mbledhet edhe një herë javën e ardhshme. Misioni vëzhgues i OSBE-së po këtë ditë nis evakuimin, ashtu si edhe ambasadat e huaja të cillat fillojnë të largojnë stafin e tyre nga Beogradi. Trojka negociuese bën një përpjekje për të bindur Millosheviçin, por përpjekja përfundon pa sukses. Edhe Richard Holbrooke, me përvojë të veçantë negociimi, edhe pse gjatë vizitës me Millosheviçin ia bën të qartë atij fundin në rast se do të fillojnë goditjet ushtarake, prapëseprapë me të nuk pati shpresë për marrëveshje paqësore, përkundrazi ai po e sulmonte Kosovën me të gjitha forcat militare, paramilitare, policore, por edhe me civilë të mobilizuar serbë. Millosheviçi dukej se kishte 4 qëllime bazë: të shkatërronte UÇK-në; të ndryshonte përgjithmonë ekuilibrin etnik në Kosovë; të trembte shqiptarët që kishin mbetur në Kosovë; dhe të krijonte një krizë humanitare destabilizuese, që do të shqetësonte komunitetin ndërkombëtar dhe do ta përçante rajonin.³⁰³ Kurse fushata e bombardimeve do të ketë tre objektiva: t'i tregohet Millosheviçit se ne e kishim seriozisht të parandalonim edhe një raund spastrimesh etnike, të frenojmë ofensivën e përgjakshme kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë dhe seriozisht të dëmtonim kapacitetet ushtarake serbe.³⁰⁴

³⁰³ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, fq. 477.

³⁰⁴ Bill Clinton, *My life*, Alfred A. Knopf Borzoi Books, New York, 2004, fq.851.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana shprehet se përdorimi i forcës është i domosdoshëm dhe se kjo ka mbetë si i vetmi instrument që mund të parandalojë pësimet dhe dhunën kundër popullatës civile në Kosovë.³⁰⁵

NATO mban premtimin. Me 24 mars 1999, NATO filloi sulmet ajrore kundër Serbisë, të cilat vazhduan deri me 10 qershor 1999; gjithsej u realizuan 10.500 sulme ajrore kundër caqeve në Kosovë dhe në Serbi.³⁰⁶ Forcat serbe ndërmorën një fushatë spastrimi etnik ku shqiptarët ballafaqohen me terror të pashembullt, ku vriteshin pa asnjë shkak, ku plaçkiteshin dhe detyroheshin të iknin duke i ndarë burra dhe gratë, ku bëhen ekzekutime në masë, ku dhunohen gratë, ku ishte vënë në zbatim plani serb i zbuluar me emrin patkoi, qëllimi i të cilit ishte ndryshimi i balancit etnik në Kosovë, duke shpresuar se të shpërngulurit e dhunshëm nuk do të ktheheshin më në trojet e veta. “Fushata e përgjakshme dhjetëvjeçare e Millosheviçit për të imponuar vullnetin e tij në ish -Jugosllavi ishte në momentet e fundit. Djegia e fshatrave dhe vrasja e të pafajshmëve ishte histori. E dija se ishte vetëm çështje kohe kur Millosheviçi të bëhej vet histori”.³⁰⁷ Është shkruar e raportuar hollësisht për krimet dhe genocidin e ushtruar në Kosovë, për çka Millosheviçi ishte dërguar në Hagë për t’u gjykuar.

Gjatë sulmeve 78 ditëshe ajrore në prapavijë diplomacia amerikano-europiane bën përpjekje për zgjidhjen e konflikteve duke bindur palën serbe të pranonte kushtet. Gjermania që po udhëhiqte me BE-në del me një plan, të cilin Parlamenti Serb me datë 3 qershor e pranon. Bazuar në këtë, në Kumanovë me 10 qershor nënshkruhet një marrëveshje tekniko-ushtarake në mes Ushtrisë Jugosllave dhe forcave të NATO-s. Në të njëjtën ditë Këshilli i Sigurimit të OKB-së me 14 vota pro dhe me asnjë kundër e me abstenimin e Kinës miraton Rezolutën 1244³⁰⁸ me çka

³⁰⁵ Press Statment, 23 March 1999 (NATO Press Release 1999 040); cituar sipas: Brenfors M.-Petersen M.M: op. cit., p. 497

³⁰⁶ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq. 262.

³⁰⁷ Bill Clinton, *My life*, Alfred A.Knopf Borzoi Books, New York, 2004, fq.860.

³⁰⁸ Rezoluta 1244 në një mënyrë është formalizim i marrëveshjes në mes të NATO-s dhe RFJ-së Elementet kyçe të kësaj rezolute ishin të drejtat e të gjithë refugjatëve për t’u kthyer (...) më e rëndësishme ishte korniza për një zgjidhje politike bazuar në parimet në vijim:-ndërprerja e menjëhershme e dhunës dhe e represionit në Kosovë,-tërheqja e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare,-vendosja e prezencës ndërkombëtare civile dhe sigurisë të vendosur nga Kombet e Bashkuara, të aftë për të garantuar arritjen e objektivave të përbashkëta,-ndërtimi i një administrate të përkohshme në Kosovë të vendosur nga Këshilli i Sigurimit, e cila do të sigurojë kushte për paqe dhe jetë normale për të gjithë banorët e Kosovës,-kthim të sigurt dhe të lirë të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur si dhe qasje të papenguar nga organizatat humanitare,-një proces politik drejt krijimit të një kornize të përkohshme politike, që do të sigurojë vetëqeverisje përmbajtësore për Kosovën, duke marrë parasysh marrëveshjen e Rambouillet...marrë nga: G.Richard Jansen,<http://amar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.13-14 (parë më: 29.12.2013); Rezoluta 1244 eliminon çdo dyshim lidhur me legalitetin e intervenimit të NATO-s. Edhe pse ajo nuk e bekon shprehimisht intervenimin, është jashtë çdo dyshimi se OKB si obligim parësor ka ruajtjen e paqes dhe

hapet rruga e administrimit ndërkombëtar civilo -ushtarak të Kosovës. Dhe përpilimi i tekstit të Rezolutës ka qenë gjithashtu vështirësi e llojit të vet. Gjuha e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit u përpunua nga ministrat e jashtëm të G-8-tës në Gjermani, më 7 dhe 8 qershor, pas dymbëdhjetë orë bisedimesh. Gjatë gjithë ditës së parë, Ivanovi u përpoq të fshinte referencat ndaj bashkëpunimit me Gjykatën për Krimet e Luftës dhe sugjeroi që të lejoheshin disa forca serbe të sigurimit të qëndronin në Kosovë...³⁰⁹ Me arritjen e marrëveshjes në Kumanovë, trupat e NATO-s, që numëronin 16.100, hynë në Kosovë gjatë ditës së fundit të tërheqjes së forcave jugosllave-serbe më 18 qershor 1999. Numri shtesë prej 11.000 ushtarësh u mundësua nga bazat e IRJM-së.³¹⁰ Trupat ushtarake, që vendosen në Kosovë, nuk do t'i nënshtrohen autoritetit të kontrollit të Sekretariatit të OKB-së. Ato udhëhiqen nga NATO. Kurse UNMIK-u (United Nations Interim Mission In Kosovo) para vetes kishte këto objektiva: demilitarizimin i Kosovës, kthimin e refugjatëve, rindërtimin e Kosovës, ndërtimin e një administrate civile dhe demokratizimin e shoqërisë kosovare. I gjithë teksti i Rezolutës bëhet bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së dhe kjo rezolutë, kishte këto qëllime: përfundimin e luftës dhe krijimin e paqes, krijimin e një administrate tranzitore në një shoqëri pas konfliktit dhe krijimin e një qeverisjeje përmbytësore deri në zgjidhjen e statusit final. Administrata e përkohshme e OKB-së themelohet mjaft shpejt dhe i gjithë pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor i takon UNMIK-ut, ndërsa kosovarëve u mbetet vetëm e drejta e konsultimit. Pushteti i UNMIK-ut ndërtohet në të ashtuquajturat 4 shtylla, të cilave u përcaktohen detyrat dhe bartësit e kryerjes. Kështu UNMIK-u ka:

- *Shtylla e parë: Policia dhe Drejtësia – e udhëhequr nga KB-ja;*
- *Shtylla e dytë: Administrata civile – e udhëhequr nga KB-ja;*
- *Shtylla e tretë: Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve – e udhëhequr nga OSBE-ja dhe*
- *Shtylla e katërt: Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik – i udhëhequr nga Bashkimi Europian.*

sigurisë dhe kështu mund “ të njeh një situatë legale që është krijuar me krim”, sepse në të kundërtën, sikur të ishte jolegale, intervenimi i NATO-s do të mund të karakterizohej si krim agresioni. (Pellet A: State Sovereignty and the Protection of Fundamental Human Rights: An International Law Perspective, Pugwash Occasional Papers, vol. 1, no. 1, <<http://www.pugwash.org/publication/op/opv1n1.html>> , p. 5)

³⁰⁹ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, fq.489.

³¹⁰ NATO, Brifingu i mëngjesit, Jamie Shea, 9 qershor, 1999, Burimi: <http://www.nato.int/Kosovo/press/b990618m.html> , cituar nga: KIPRED, *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë - Mësimet e mësuara dhe ato që mbetën për t'u mësuar*, Prishtinë, Gjenevë, 2005, fq.16.

Siç u tha i gjithë pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor mbetet në duart e UNMIK-ut dhe Rregulloret e UNMIK-ut kishin fuqinë dhe formën e ligjit, ndërkohë që Rezoluta 1244 mund të quhet si një lloj Kushtetute e UNMIK-ut për Kosovën. Një karakteristikë specifike e këtij misioni, ishte: “koncentrimi i pushtetit te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i cili si kreu legal i shtetit të Kosovës ishte ngarkuar që të sigurote koherencë të të gjithë misionit dhe virtualisht gëzonte një pushtet të pakufishëm.³¹¹ Për më tepër nëse analizohet zbatimi i pushtetit që i ishte dhënë, do të shohim se ky autoritet po merrte mbi vete edhe fuqi për zgjidhje të konflikteve politike, të cilat ushtroheshin më shumë apo më pak, varësisht se kush ishte në krye të misionit. Kishim kryeadministrator më dinamik dhe më të fuqishëm dhe kishim të tjerë, më të ftohët dhe të ngathët. Por kishte edhe të tillë që, ishin bërë krejt të padurueshëm për popullatën vendase (në vokabularin shqip në Kosovë përfaqësuesi special quhej shkurtimisht kryeadministrator). Pushteti i UNMIK-ut mund të ndahet në disa faza kohore, ndërsa edhe marrëdhëniet e administratës së UNMIK-ut me vendorët duke kaluar nëpër vite zbehen dhe dobësohen deri në atë masë dhe deri në një moment kur sipas vendorëve UNMIK-u po paraqitej si pengesë e zhvillimeve më dinamike dhe më pozitive, të cilat po kërkoheshin.

5.1.1 Baza legale dhe strukturat

Fillimisht po i jepej ngjyrë juridike pushtetit të UNMIK-ut dhe Kryeadministratorit, me Rregulloren 1999/1 të datës 25 korrik 1999. Kryeadministratori, Bernard Kouchner, si njeri që e njihnte Kosovën dhe deri diku mentalitetin e vendasve po ndërtonte një qeverisje që ishte e paprovuar ndonjë herë diku tjetër. Në fakt diçka e tillë si ky pushtet nuk ishte provuar diku tjetër apo përvojat e tilla nuk ishin studiuar në mënyrë që mësimet e nxjerra të aplikoheshin në Kosovë.³¹² Por falë rrethanave të krijuara si pasojë e luftës, ai arrin të zbatojë detyrat dhe pushtetin e vet dhe të përmbushë obligimet duke gëzuar përkrahje të fortë vendase. Një ditë pasi

³¹¹ Mertus (2003,8) cituar nga Nikolas Lemay-Hebert, *State building from the outside in: UNMIK and its Paradox*, <http://www.princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf>. (parë më: 30.11.2013).

³¹² King's College Case Study, Eide Report, Inventory UN Capacity in Peacebuilding (2006), and Developing a Security Sector Reform Concept for the United Nations, Expert Workshop Conference Report, 7 July 2006, cituar nga: Eric Scheye, UNMIK and the Significance of Effective Programme Management: *The case of Kosovo*, fq.29, marrë nga: <http://www.gsdr.org/go/display&type=Document&id=4791> (parë më: 28 janar, 2013).

erdhi në Kosovë ai mbledh Këshillin e Përkohshëm Tranzitor³¹³, një krijim në të cilin merrnin pjesë liderët politikë kryesorë të Kosovës përfshirë edhe bishopin Artmeije. Ky krijim dukej se ishte një platformë ku mund të bëhej një lloj politike, por nuk ishte ndonjë organ lokal i pushtetit. UNMIK-u me këtë lloj platforme donte të kishte me vete një diçka vendore, e cila kishte një lloj karakteri konsultativ. Në fund të dhjetorit të vitit 1999 nënshkruhet “Marrëveshje për Kosovë - UNMIK për krijimin e strukturave të përkohshme administrative”, të njohur me shkurtesën Joint Interim Administrative Structures (JIAS). Marrëveshjen e nënshkruajnë: Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja dhe Hashim Thaçi. Marrëveshja pastaj shndërrohet në Rregullore të UNMIK-ut. Meqenëse tash me rregullore parashihet përfshirje në strukturat administrative të Kosovës, liderët kosovarë do të obligohen të heqin dorë nga të gjithë titujt që kishin (president, kryeministër, etj) dhe t’i shpërbënin strukturat e tyre deri në fund të janarit të vitit 2000.³¹⁴ Do të shpërbëheshin të dy qeveritë, parlamenti i zgjedhur dhe i pambledhur i vitit 1998, fondet e qeverisë në ekzil. Bukoshi si kryeministër i qeverisë në ekzil nuk ka transferuar fonde tek UNMIK-u.³¹⁵ Formimi i JIAS-it nuk shpërbën shtyllën e dytë të UNMIK-ut, ndërsa bashkudhëheqësit e departamenteve nga radhët e vendorëve nuk mund të vendosnin diçka pa siguruar miratimin e bashkudhëheqësve të jashtëm.³¹⁶ Departamentet qendrore dhe administrimet lokale ishin pjesë e marrëveshjes JIAS, për t’i dhënë një ngjyrë vendore, por zyrat regjionale të UNMIK-ut mbeten të paprekura nga JIAS-i.³¹⁷

Me marrëveshjen JIAS (Joint Interim Administrative Structures) parashihet krijimi i institucioneve të përbashkëta, me çka PSSP-ja do të bëjë një menaxhim administrativ të përkohshëm me përfaqësues kosovarë dhe në të njëjtën kohë do të mbajë të gjithë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv për vete. Marrëveshja specifikon strukturat, ku Këshilli Tranzitor i Kosovës - KTC, Këshilli i Përkohshëm Administrativ - IAC, departamentet administrative që janë gjithsej 14³¹⁸ si dhe bordet administrative dhe këshillat komunale në nivel lokal, paraqesin

³¹³ Lidhur me Këshillin Tranzitor shih më shumë në nenin 2, të Rregullores së UNMIK-ut Mbi strukturën e përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës, nr.2000/01.

³¹⁴ Marcus Brand, *The development of Kosovo Institutions and the transition of authority from UNMIK to local self-government*, CASIN, Geneva, 2013, fq.13.

³¹⁵ Marcus Brand, *The development of Kosovo Institutions and the transition of authority from UNMIK to local self-government*, CASIN, Geneva 2013, fq.15.

³¹⁶ Shih seksionin 7 të Rregullores së UNMIK-ut Mbi strukturën e përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës, nr.2000/01.

³¹⁷ Shih Rregulloren e UNMIK-ut, nr.1999/14, seksioni 1.

³¹⁸ Shih aneksin e Rregullores së UNMIK-ut Mbi Strukturën e përbashkët të përkohshme administrative të Kosovës, nr.2000/01, ku janë të listuara të gjitha departamentet.

strukturat e krijuara.³¹⁹ Rregullorja për JIAS-in nuk i jep Kosovës subjektivitet juridik dhe për më tepër edhe raportet mes pushtetit të dhënë kosovar dhe strukturave të UNMIK-ut më shumë janë të bazuara politikisht sesa juridikisht.

Këshilli i përkohshëm administrativ - IAC³²⁰ përbëhej nga Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja dhe nga udhëheqësit e tri shtyllave të UNMIK-ut. Udhëheqësi i shtyllës së parë (UNHCR kryesisht) dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile kanë rolin e vëzhguesit dhe në mbledhje të Këshillit të përkohshëm administrativ merrte pjesë edhe Shefi i policisë së UNMIK-ut. Mbledhjet zakonisht mbahen dy herë në javë.³²¹

Kështu zgjedhjet e para lokale shënojnë një sukses të lakmueshëm në rrugën për zhvillimin e demokracisë dhe të ndërtimit të institucioneve apo strukturave vendore të qeverisjes. Rezultatet e zgjedhjeve të para lokale të vitit 2000 determinojnë ndryshimin e përbërjes së IAC bazuar në numrin e përgjithshëm të votave që subjektet politike kishin marrë. Rexhep Qosja largohet nga këshilli duke u zëvendësuar nga Ramush Haradinaj që si subjekt politik merr 7% të votave, kurse Qosja vetëm 1%.³²²

Këshilli Tranzitor i Kosovës, sipas marrëveshjes tash do të ketë 36 anëtarë, të gjithë mendohet se përfaqësojnë diçka në Kosovë. Anëtarët emërohen nga PSSP-ja me propozim të OSBE-së dhe aty pos përfaqësuesve të subjekteve do të ketë përfaqësues të shoqërisë civile (11 përfaqësues), përfaqësues të tri religjioneve më të mëdha si dhe përfaqësues të minoriteteve. Këshilli mblidhet një herë në javë sipas parimit *ad hoc*. Mbledhjet nuk kanë qenë të hapura deri vonë për publikun. Këshilli tranzitor nuk ka pasur asnjë rol legjislativ.

Ndarja e vendeve nëpër departamente për funksione të bashkudhëheqësve janë bërë sipas formulës: Rugova – Thaçi – Qosja - 2 serb - një boshnjak dhe një i pavarur. Vendimet duheshin marrë bashkërisht nga të dy bashkëkryesuesit, kurse vendimet e bashkëkryesuesve ndërkombëtarë kanë qenë vendimtare. Ndarja e mandateve për vendorët ka qenë e paqartë nëse

³¹⁹ Shih më gjerësisht Rregulloren e UNMIK-ut Mbi strukturën e përbashkët të përkohshme administrative të Kosovës, nr.2000/01.

³²⁰ Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut Mbi Strukturën e përbashkët të përkohshme administrative të Kosovës, nr.2000/01.

³²¹ Seksioni 4, paragrafi 4.4 i Rregullores së UNMIK-ut Mbi strukturën e përbashkët të përkohshme administrative të Kosovës, nr.2000/01.

³²² Marcus Brand, *The development of Kosovo Institutions and the transition of authority from UNMIK to local self-government*, CASIN, Geneva, 2013, fq.19.

bëhej sipas kriterëve politike apo sipas kriterëve të ekspertizës. Çështja e përgjegjësive të njëjës dhe tjetrës palë gjithashtu ka qenë mjaft e vështirë, sepse nuk ka qenë se kujt i përgjigjeshin këta ministra. Funkzioni i mbledhjes së tatimit dhe i financimit të shërbimeve publike kryhet nga Autoriteti Qendror Fiskal – CFA. Në vitet e para mbledhja e taksave ka pasur shkallë të ulët dhe pjesa më e madhe e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës është krijuar me donacione të vendeve të treta.

PSSP në vitin 2000 krijon një mekanizëm në të cilin mbledhen të gjithë bashkëkryesuesit e departamenteve, në një trup si pothuajse këshill i ministrave. Por shumë shpejt hiqet dorë nga ky mekanizëm sepse duhej hequr dorë nga ajo që quhej në vazhdimësi mungesë legjitimiteti – pra cili ishte procesi i zgjedhjes së tyre? Dhe kjo në fakt është çështje që ka të bëjë gjithë kohën me pushtetin civil ndërkombëtar që nga dita e parë e deri në fund të mandatit të vet.

Sa i përket pushtetit lokal, së pari emërohen administratorët regjionalë për pesë regjione³²³ (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Gjilan) dhe administratorët regjionalë mbikëqyrin punën e administratorëve komunalë në komunat që i përkasin atij regjioni. Kurse administratorët regjionalë i raportojnë zëvendësit të PSSP-së të OKB-së.³²⁴

Kosovarët dhe forcat politike, duke parë se UNMIK nuk kishte përcaktuar afate të qarta kohore se kur do të konsiderohej që organet vendore të pushtetit janë krijuar dhe përforcuar dhe se kur duhej transferuar pushteti te vendorët, ata nisnin të ushtrojnë një presion publik për përcaktim e rregullore dhe kornizave kohore. Kështu gjendet një konsensus dhe në maj të vitit 2001 UNMIK nxjerr Kornizën Kushtetuese të Kosovës për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës,³²⁵ në formë të Rregulloreve të UNMIK-ut, nr.1999/9. Përgjithësisht nëse analizohet ky dokument, do të shihet se ai i ka bazat themelore të sistemit politik dhe juridik, në bazë të të cilit, Kosova do të qeveriset për disa vite. Kur jemi te legjislacioni duhet potencuar se në Kosovë, sipas rregulloreve të UNMIK-ut kishim një kompleks ligjesh që aplikoheshin në Kosovë: të parat ishin ligjet e UNMIK-ut në formë të rregulloreve, pastaj ligjet e Kosovës dhe së fundi ligjet e RFJ-së të aprovuara para datës 23 mars të vitit 1989. I gjithë ky set ligjesh njihej me termin “ligj i aplikueshëm”. Në mes të qershorit të vitit 1999 dhe shtatorit të

³²³ Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/14, seksioni 1.

³²⁴ Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/14, seksioni 1, paragrafi 2.

³²⁵ Shih Raportin e Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S.Policy: Background to independence, updated June 2008, fq.8.

vitit 2002 UNMIK miratoi 144 rregullore dhe 86 urdhëresa administrative, që përfshijnë të gjitha fushat ligjore, si ligjin penal, ligjin civil-komercial dhe ligjin publik-administrativ.³²⁶ Pushteti në Kosovë po ndërtohej në tri nivele: pushteti lokal, pushteti qendror (pas zgjedhjeve të para të organizuara sipas Kornizës Kushtetuese) dhe pushteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, të cilit i ishin lënë edhe disa kompetenca shtesë që njiheshin si “të drejtat e rezervuara”. Bazuar në këtë pushteti i institucioneve të përkohshme të Kosovës nuk mund të përfshinte përgjegjësitë nga pushteti i rezervuar për PSSP-në. Pushteti i rezervuar për PSSP-në përfshin: autoritetin e plotë për të siguruar të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe të sigurojë që ato të jenë të mbrojtura në tërësi, shpërndarjen e parlamentit, me kërkesën e 2/3 të votave të anëtarëve të parlamentit dhe kjo kërkesë i komunikohet përmes presidentit të Kosovës; politikën monetare; autoriteti final për të përcaktuar parametrat e politikave financiare dhe për buxhetin e konsoliduar të Kosovës; ushtron kontrollin ndaj doganave të UNMIK-ut; autoritetin kryesor për emërimin dhe largimin apo edhe disiplinimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve; ushtrimin e pushtetit lidhur me angazhimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë; mbikëqyr përmbushjen e përkushtimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në emër të UNMIK-ut; marrëdhëniet me jashtë; kontroll ndaj pikave kufitare lidhur me tranzitin e mallrave dhe kafshëve; administron pronën publike dhe shoqërore në bashkëpunim me institucionet e përkohshme të qeverisjes së Kosovës; kontrollin administrativ të hekurudhave, menaxhimin e frekuencave të aviacionit civil; emëron anëtarët e Këshillit Ekonomik Financiar, të Bordit Qeverisës të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës; etj.³²⁷ Karakteri unik i rolit të PSSP-së ishte gjithashtu i dukshëm për faktin se ai mund “t’ia bënte” ndryshimet Kornizës Kushtetuese ose me shumicën prej dy të tretave të Kuvendit apo sipas diskrecionit të vet.³²⁸ Kjo mënyrë formulimi tregon se pavarësisht faktit se kishim të bënim me një akt që ka karakteristika të kushtetutës, nuk ishte e tillë, sepse e para, nuk aprovohet përmes një procesi legjitim dhe rrjedhimisht as nuk ndryshohet dhe e dyta, PSSP duket edhe si mbret që d.m.th. e ndryshon kushtetutën sipas diskrecionit. Kjo dispozitë shkaktonte dyshime në lidhje me karakterin e instrumentit si “kushtetutë” dhe në vend të kësaj ia konfirmonte karakterin sui generis.³²⁹ Kur jemi te pushteti i rezervuar për PSSP-në aty ai ka kompetenca të sigurojë të drejtat e

³²⁶ KIPRED, *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë-ribotim*, Prishtinë, Gjenevë, 2005, fq.9.

³²⁷ Shih Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2001/9, pikat 8.1 dhe 8.2.

³²⁸ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq. 264.

³²⁹ Po aty.

komuniteteve, përcakton si autoritet përfundimtar parametrat financiarç dhe politikë, kompetencë për të miratuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës, ushtron kontrollin doganor, emëron gjykatësit dhe prokurorët, ka të drejtën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, shpërbën parlamentin dhe shpall zgjedhjet, të drejtë në politikën monetare, etj. Këto janë disa nga kompetencat e rezervuara vetëm për PSSP-në dhe shprehin një karakteristikë të një pushteti që është vështirë t'i gjendet emri i plotë. Por karakteristikë themelore e tij është jolegjitimiteti i brendshëm. Themi kështu sepse ky pushtet dhe këto kompetenca nuk rrjedhin nga një proces i rregullt zgjedhor ku do të dihejshin qartë zgjedhësit, dhe ku do kishim llogaridhënie të zgjedhësit, kurse në anën tjetër edhe vetë korniza kushtetuese nuk ishte nxjerrë në bazë të këtyre premisave themelore demokratike. Dhe mungesa e legjitimitetit do të jetë, nëse jo shkaku i vetëm, atëherë ky do të jetë shkaku kryesor që çon te rënia e autoritetit të UNMIK-ut dhe të PSSP-së. Korniza Kushtetuese e Kosovës, organeve të përkohshme të vetëqeverisjes i njeh këto kompetenca: politikat ekonomike dhe fiskale, çështjet fiskale dhe çështjet buxhetore, veprimet dhe aktivitetet administrative doganore, tregun e brendshëm dhe të jashtëm, industrinë dhe investimet, edukimin, shkencën dhe teknologjinë, rininë dhe sportin, shëndetësinë, mjedisin, transportin dhe post e telekomunikimin, informacionet teknologjike, shërbimet publike administrative, bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin rural, statistikat, planifikimin hapësinor, turizmin, qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta dhe çështjet jorezidente.³³⁰ Ndërkaq si organe të pushtetit të përkohshëm bëheshin: Parlamenti, Presidenti, Qeveria, Gjykatat dhe organet e tjera të parapara me Kornizë Kushtetuese. Korniza Kushtetuese sikundër edhe vetë Rezoluta 1244 ka karakter të përkohshëm dhe do të vlejë deri në nxjerrjen e një akti apo rezolute të re nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, ose deri në gjetjen e zgjidhjes finale statusore për Kosovën.³³¹ Dhe zgjatjen pa kufi të mandatit të UNMIK-ut e shohim si pengesë të zhvillimeve në Kosovë. Zgjedhjet e para për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të nivelit qendror janë mbajtur në nëntor të vitit 2001 për Parlamentin me 120 vende. Pas zgjedhjeve Parlamenti formon një set komisionesh; zgjidhet Presidenti i Kosovës dhe themelohen edhe disa agjenci shtetërore.

³³⁰ Shih kreun pesë të Kornizës Kushtetuese.

³³¹ Arsīm Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.76.

Në tetor të vitit 2002 mbahen zgjedhjet e dyta komunale të cilat vlerësohen si të organizuara shumë mirë ashtu sikurse edhe zgjedhjet e para. Tash me këto zgjedhje mandati i komunarëve zgjat 4 vjet.

Çështjet e policisë fillimisht kanë qenë në duar të KFOR-it, pastaj kalojnë te policia e UNMIK-ut dhe kjo është paraparë me Rezolutën 1244. Shkolla e shërbimit policor të Kosovës përmendet zakonisht si një çështje suksesi në trajnimin dhe në krijimin e shërbimit policor të Kosovës. Çështjet e rendit dhe të ligjit janë rregulluar me kreun gjashtë të Kornizës Kushtetuese dhe nga ky kapitull janë ushtruar funksione nga Policia e Kosovës nën mbikëqyrje të policisë së UNMIK-ut nën autoritetin e PSSP-së. Çështja e pranisë ushtarake në Kosovë ka mbetur në duar të KFOR-it, çështje kjo që pothuajse asnjëherë nuk është kontestuar, me përjashtim të një pjese të trupave ruse, të cilët pas një kohe të shkurtër janë larguar nga ajo zonë. Dhe pastaj përfundimisht edhe nga Kosova. Sfidë e veçantë për Kosovën ka qenë demilitarizimi i UÇK-së dhe shndërrimi apo krijimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës, çështje kjo që përkundër sfidave është përfunduar pa turbulenca të mëdha. Sipas Kornizës Kushtetuese janë krijuar edhe disa trupa të pavarura si: Komisioni Qendror Zgjedhor, Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial, Auditori Gjeneral, Komisioni i Pavarur i Medieve, etj. Për punën dhe performancën e këtyre institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, do të krijohen standarde në bazë të të cilave do të vlerësohet performanca e institucioneve dhe e bartësve, si një ndër parakushtet e transferit të pushtetit më të shpejtë nga ndërkombëtarët te vendorët drejt nisjes së procesit të përcaktimit të statusit final të Kosovës, siç do ta shohim në pjesën në vijim. Por të shohim si vlerësohet UNMIK-u dhe rëndësia, efektet dhe raportet me vendorët.

5.1.2. A ishte UNMIK-u i suksesshëm?

Në vitet e para, të cilat i takonin fazës që njihet si “fazë emergjente” i gjithë pushteti ndërkombëtar gëzonte përkrahje. Më vonë, kur institucionet vendore fillojnë të forcohen dhe kur kërkesat për zhvillim shtohen, atëherë përkrahja e vendorëve zbehet dukshëm. Është vështirë për çdo administratë ndërkombëtare që të shmangë reagimin e qenësishëm në administrim të drejtpërdrejtë³³². Njerëzit janë të lodhur për vite të tëra pritjeje dhe pavarësisht mirënjohjes për

³³² Nikolas Lemay-Hebert, *State building from the outside in: UNMIK and its Paradox*, fq.5, <http://www.princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf> (parë më:25.06.2013)

kontributin e dhënë në dëbimin e forcave serbe, ata kanë nevojë për të jetuar më mirë dhe kështu kërkesat rriten. Eric Chevallier, që ishte këshilltar kryesor i Bernard Kouchner-it, thotë: “ ne duhet të kemi parasysh para së gjithash se njerëzit që kishin humbur dinjitetin dhe që kishin vuajtur nga një konflikt, duan që ta rikthejnë këtë dinjitet”.³³³ Ata, së pari, duke mos parë zhvillim ekonomik, por edhe ngecje në zhvillim politik, sidomos në aspekt të ngadalësimit të procesit të përcaktimit të statusit final, e quanin se dinjiteti i tyre po nëpërkëmbej në një mënyrë tjetër.

Kur institucionet vendore të pushtetit u krijuan si rezultat i zgjedhjeve, logjikisht kërkonin më shumë autorizime dhe kërkonin një barazi në trajtim. Dhe institucionet vendore, jo se janë gjithmonë të mira në ushtrimin e pushtetit të tyre, por ato megjithatë në një mënyrë i nënshtrohen një kontrolli vendor dhe një kontrolli të ashpër ndërkombëtar. E kur është fjala tek UNMIK-u dhe te përfaqësuesit e tij në Kosovë, nuk mund të flitet për përgjegjësi. Kur zyrtarët e UNMIK-ut kryejnë vepra krimi, zëri i institucioneve vendore nuk mund të dëgjohet, sepse ata sado që i takonin një mekanizmi ndërkombëtar, në të njëjtën kohë ishin edhe shtetas të shteteve të caktuara. Ashtu, si “në protektoratin e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë - Herzegovinë, edhe në Kosovë shumë shpejt u hap një hendek kulturor në mes pjesëtarëve të autoriteteve ndërkombëtare dhe shoqërisë rajonale. Shumë shqiptarë të Kosovës e hodhën poshtë UNMIK-un si sundim kolonial”.³³⁴ Raporti në mes të vendorëve dhe administratës së UNMIK-ut varej jo rrallë edhe nga qasja që kryeadministratorët e caktuar kishin ndaj Kosovës dhe ndaj kompetencave të tyre. Kishte të atillë që nuk kishin prirje për të bashkëpunuar me vendorët, që praktikonin një lloje sjelljeje kolonialiste dhe paternaliste, të cilat nuk pritshin nga administratorët ndërkombëtarë. Lista e kryeadministratorëve e dhënë në vijim, nuk kërkon mund të madh për të nxjerrë se cili ishte më bashkëpunues dhe energjik dhe cili ishte me i ngathët dhe më pak bashkëpunues. Bernard Kouchner, nga Franca, ishte Përfaqësuesi i Parë i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i cili mbikëqyrë UNMIK-un deri në janar të vitit 2001. Ai zëvendësohet nga Hans Haekkerup, ministër danez i Mbrojtjes, mandati i shkurtër i të cilit në Kosovë përfundoi në dhjetor të vitit 2001. Michael Steiner, një diplomat gjerman me përvojë në ish- Jugosllavi, bëhet PSSP i tretë në vitin 2002 dhe përfundon mandatin në korrik të vitit 2003.

³³³ Chevallier 2002,4. Cituar nga Nikolas Lemay-Hebert, *State building from the outside in: UNMIK and its Paradox*, fq.5, <http://www.princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf>, (parë më:25.06.2013)

³³⁴ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.265.

Diplomati finlandez, Harri Holkeri, bëhet PSSP i katërt në gusht të vitit 2003. Largohet në maj të vitit 2004 duke përmendur arsytet shëndetësore edhe pse disa vëzhgues spekulojnë se dorëheqja e tij ishte bërë nga shkak i disa spekulimeve lidhur me kredibilitetin e tij sikundër që i gjithë UNMIK-u si tërësi u dëmtua nga trazirat e marsit 2004. Diplomati danez, Soren Jessen Petersen, i cili ka qenë përfaqësues special i BE-së në Maqedoni bëhet PSSP i ardhshëm në mes të gushtit. Me të arritur ai skicoi pesë prioritete të misionit: përmirësimin e sigurisë, prioritetin e standardeve dhe zbatimin e tyre, transferim më të madh të pushtetit tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, mbrojtjen e pakicave dhe përmirësimin e ekonomisë. Në qershor të vitit 2006 ai deklaroi largimin e mëhershëm nga UNMIK-u. Ishte Joachim Rücker nga Gjermania që zëvendëson Jessen-Petersenin si PSSP në shtator të vitit 2006 dhe në korrik të vitit 2008 diplomati italian, Lamberto Zannier, vihet në krye të UNMIK-ut.³³⁵

Për efektivitetin e qeverisjes së UNMIK-ut në Kosovë ka mendime të ndryshme. Disa mendojnë se ka qenë fare i padobishëm dhe se e ka penguar zhvillimin e Kosovës. Të tjerët mendojnë se po mos të ishte kjo strukturë e ardhmja do të ishte e zyrtë. Ka të tjerë që mendojnë se vitet e para në Kosovë ishte dashur të kishte administrim krejtësisht ndërkombëtar dhe vetëm pas një periudhë të caktuar, duhej menduar që të krijohej hapësira për organizim të pushtetit vendor. Nuk mendoj se është e qëlluar të fokusohemi në një opion të vetëm, sepse argumentet për dhe kundër janë gjithmonë të pranishme, ndërsa mendimi se në asnjë mënyrë nuk duhej të kishte administrim ndërkombëtar, nuk qëndron dhe as nuk duhet të diskutohet. Duhet parë gjërat ashtu siç kanë qenë. As që mund të paramendohet se çdo të kishte ndodhur në ditët e para të pasluftës në Kosovë sikur të mos vendosej një administrim i huaj. Konflikti nga ndëretnik do të kishte përfunduar edhe me ndërshqiptar. Nuk duhet harruar sesi pothuaj një milion refugjatë kanë dalë nga Kosova dhe në ç'gjendje janë kthyer dhe çka kanë gjetur prapa. Të mos flasim se cilat do të ishin pushtetet që do qeverisnin në Kosovë? Ne edhe pse u patëm marrë vesh në Rambuje për të krijuar një qeveri të përkohshme, atë nuk e respektoam. Kthimi i kosovarëve pas lufte solli edhe ardhjen e dy qeverive: njëra e njohur si qeveri e ekzilit dhe tjetra si qeveri e përkohshme. Dhe të mos harrojmë se në momente të caktuara kishim edhe dy formacione ushtarake, të cilat nuk është se kanë pasur mirëkuptim për njëri -tjetrin.

³³⁵ Shih raportin e Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S. Policy: Background to independence, updated June 2008, fq. 11-12.

Nuk duhet të pranohet mendimi se Kosova duhej vënë në protektorat të plotë ndërkombëtar për një periudhë të caktuar kohore, për t'iu dhënë pastaj kosovarëve mundësi graduale. Në këtë mënyrë vetëm se do të krijohej përshtypja për një kolonizim të ri të Kosovës, me petka të tjera, dhe kështu besimi i shqiptarëve në struktura të UNMIK-ut nuk do të ekzistonte që nga dita e parë. Kosovarëve u duhej dhënë pronësi në sistem, sepse ata ishin përjashtuar nga sistemi për shumë vite dhe po të mos ishin pjesë e sistemit, gjërat vetëm do të agravinin.

Nuk ka asnjë dyshim se mund të numërohen si dobësitë, ashtu edhe dobitë. Ka shumë fusha në të cilat UNMIK-u ka investuar shumë, por arritjet kanë qenë të vogla. Investime të shumta janë bërë në dialogun ndëretnik, nga i cili nuk janë arritur rezultate me të cilat mund të lavdërohet dikush. Por në dialogun ndëretnik qasje të gabuar mund të themi kenë pasur edhe shumë agjenci shtetërore e joshtetërore dhe rrjedhimisht edhe rezultate të vogla. Zhvillimi ekonomik është fusha ku gjithashtu UNMIK-u nuk ka pasur sukses. Është investuar në diçka që nuk është dashur fare. “Për më tepër, gjithsej 400 milionë euro u harxhuan në riparimin e një termocentrali, udhëheqja e të cilit i ishte lënë në dorë një mashtruesi gjerman”.³³⁶ Investimi i gabueshëm dhe menaxhimi nga personi mashtrues, nuk e amnistion mospaguesin kosovar të shpenzimit të energjisë elektrike. Është folur shumë se UNMIK-u nuk ka arritur të bëjë shumë në fushën e antikorrupsionit dhe kundër krimit të organizuar, sikundër që është thënë shumë prania e UNMIK-ut ka shënuar ngritjen e shkallës së prostitucionit që kontrollohej nga shqiptarët. Nuk është arritur shumë në mbrojtjen e dëshmitarëve sidomos për rastet e krimeve të luftës. Të gjitha këto qëndrojnë, por qëndrojnë edhe faktet se në një masë edhe vendorët kanë dhënë kontribut të caktuar. Të kesh një strukturë shumë heterogjene në terren, ku shërbyesit e asaj strukture kishin edhe obligime të dyfishta duhet menduar se aty ka pasur edhe sabotues dhe spiunë, e çka jo tjetër. Anëtarë të strukturave të UNMIK-ut, disa më shumë e disa më pak e kanë dashur Kosovën. Ata kanë raportuar te shefat e tyre me bazë në New York, por ata në të njëjtën kohë kanë raportuar edhe te shtetet e tyre nacionale. Të mos bëhemi shumë konspirativë, por hipotetikusht mund të shtrohet pyetja: a ka pasur mundësi sabotimi të qëllimshëm? I ngre këto çështje jo për të minimizuar dobësitë, por vetëm për t'i vënë në pah, që të shërbejnë për ndonjë analizë më të thellë që ka si objekt këtë çështje. Kur flitet për dobitë, sigurisht mund të numërohen shumë dhe konkretisht: zbutja e përkohshme e papunësisë; zbutja e nivelit të krimit,

³³⁶ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq.266.

kontributi në ndërtimin e institucioneve vendore, kontributi në fazën e emergjencës në kuptim humanitar dhe ndërtim e rindërtim, zhvillimi i demokracisë, etj. Por gjithsesi edhe këtu duhet të mos bazohemi vetëm në raportet zyrtare, sepse praktika ka treguar, kudo në botë, ku ka misione, se raportet zyrtare janë pak më të fryra sesa gjendja aktuale.

Nga misioni i UNMIK-ut është pritur më shumë, por në momente të caktuara ai ka qenë i dobishëm si edhe më pak i dobishëm, por në momente të caktuara edhe ka penguar proceset. Në këtë kontekst UNMIK-u nuk arriti të zgjidhte saktë dhe përfundimisht asnjë nga problemet e Kosovës, siç janë kriza ekonomike, mungesa e energjisë, papunësia, tensionet etnike, sundimi i ligjit. UNMIK-u dështoi për shkak të strukturave sociokulturore të Kosovës, direktivave të paqarta juridike dhe politike nga New Yorku dhe dobësive të veta organizative”.³³⁷

5.2. Evolucionin e shtetësisë së Kosovës: Plani i Ahtisaarit

Një ndër detyrat e UNMIK-ut në Kosovë ishte krijimi sa më përshtatshëm i Institucioneve të Përkohshme të Qeverisjes së Kosovës, që do çonin kah krijimi i një autonomie thelbësore, si parakusht për vazhdimin e procesit të përcaktimit të statusit final të Kosovës. Edhe me Marrëveshjen e Rambujesë ka qenë paracaktuar një afat kalimtar 3 vjeçar, pas të cilit do të përcaktohej statusi final i Kosovës. Krijimi i institucioneve të Kosovës u bë me sukses dhe deri në vitet e para të pushtetit të tij UNMIK-u gëzonte përkrahje nga popullata kosovare, kjo përkrahje nisi të zbehet sidomos kur u krijuan institucionet vendore të pushtetit. Por kjo nuk është shkak kryesor. Shkak më shumë duhet kërkuar dhe aty gjendet; tek amullia politike dhe në veçanti te mosarritja e sukseseve në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Në një masë të madhe edhe nga heterogjeniteti i strukturave të UNMIK-ut, sjellja paternaliste, por edhe te dëshira e disa funksionarëve apo atyre që qëndronin pas tyre për një zgjatje sa më të madhe të mandatit. Kjo nuk ishte në koherencë me dëshirat dhe me aspiratat e popullit të Kosovës dhe në veçanti me lidhshimin politik që tash ishte edhe brenda institucioneve të Kosovës. Por këtu ka edhe diçka, ku sipas Marc Weller-it “në mesin e aktorëve ndërkombëtar ekzistonte një ndjenjë se statusi duhej lënë anash për sa më shumë që do të ishte e mundur. Koha do të mund t’i shëronte vrragat e historisë dhe kujtimet e konfliktit të vitit 1999”.³³⁸ Kjo mund të ketë qenë perceptcion i

³³⁷ Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012 fq.267.

³³⁸ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.309.

qëlluar, por gjithsesi jo i favorshëm për popullatën e Kosovës. Sepse çfarëdo kohe të kalojë kosovarët nuk do të mund të harronin krimet dhe tmerret që kishin ndodhur jo vetëm në vitin 1999, por me dekada të tëra. Gjendja në Kosovë arriti në një situatë të status quo-s, gjendje e cila duhej ndryshuar, përpara se të merrte kahje negative. Duke e parë këtë anemi politike dhe ekonomike të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së me datë 24 prill 2002, në fjalimin e vet para Këshillit të Sigurimit, tregon se nga përfaqësuesi i tij në Kosovë, gjermani Steiner, ka kërkuar që të zhvillojë standardet (benchmarks), në bazë të të cilave do të matej zhvillimi në Kosovë.³³⁹ Kështu, bashkë me institucionet e përkohshme qeverisëse të krijuara, shefi i UNMIK-ut, Michael Steiner, krijoi sloganin “Standardet para statusit“ në vitin 2003-2004, të stërholluar në politika operacionale me standarde për qeverisje të mirë dhe akomodim ndëretnik.³⁴⁰

5.2.1. Standardet para statusit

Zhvillimi dhe arritjet në Kosovë duhet t’i nënshtroheshin një procesi vlerësues dhe në këtë proces duheshin përcaktuar fushat sikundër edhe matësit. Kështu, parimisht sferat në formë të standardeve janë dakorduar në marrëveshjen e partive politike të Kosovës, pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe UNMIK-ut dhe këto tashmë përmblihen duke u shndërruar në një dokument që do të quhet “standardet para statusit“. Në dhjetor të vitit 2003 UNMIK-u dhe organet e përkohshme të Kosovës krijuan pesë grupe bashkëpunuese për implementim të standardeve. Komuniteti serb i Kosovë nuk pajtohet që të marrë pjesë në këto grupe bashkëpunuese. Pavarësisht nga kjo, me 31 mars 2004, shefi i UNMIK-ut, Holkeri, shpaloj Planin e Zbatimit të Standardeve për Kosovën, që ishte një udhërrëfyes i detajuar për realizimin e standardeve.³⁴¹ Ndërsa dokumenti, që është nënshkruar me 10 dhjetor të vitit 2003 dhe që në vetvete përmban tetë standarde në fushat përkatëse është sa më poshtë vijon:

- Funksionimi i institucioneve demokratike.
- Sundimi i ligjit.
- Liria e lëvizjes.

³³⁹ Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për misionin e OKB-së në Kosovë, të datës 22 prill 2002.

³⁴⁰ Shih Raportin *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë/Beograd/New York/Brussels, 2007, fq.7.

³⁴¹ Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S.Policy: Background to independence, updated June 2008, fq.14.

- Kthimi i qëndrueshëm dhe respektimi i të drejtave të komuniteteve.
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.
- Të drejtat pronësore.
- Dialogu me Beogradin dhe
- Transformimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.³⁴²

Për të udhëhequr këtë proces, nga marsi i vitit 2004, burokracia e UNMIK-ut kishte marrë procesin në dorë. E kishte hartuar planin prej 117 faqesh për zbatimin e standardeve në Kosovë dhe që përfshinte aq shumë tema sa mund të listoheshin vetëm në disa tabela mjaft komplekse.³⁴³ Procesi i vlerësimit të standardeve ndryshon nga ritmi, nga shkak i ngjarjeve të marsit, ku ndodhi një shpërthim dhune në formë protestash e demonstratash, me ç'rast kishte edhe dhunë ndëretnike. Këto shpërthime që zgjatën tri ditë, në fakt janë edhe një tregues se procesi i mospërcaktimit të statusit nuk mund të priste shumë gjatë, sepse situata në terren mund të ndryshonte çdo gjë brenda natës. Kështu diplomati norvegjez, Kai Eide, me cilësinë e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ka bërë një vlerësim duke nxjerrë edhe shkaqet e shpërthimit në lidhje me pakënaqësitë e popullatës shumicë me UNMIK-un, por edhe me pozitën e pakicave në Kosovë. Pos të tjerash është konstatuar se procesi i kalimit së kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët duhej përshpejtuar. Dhe në fakt, në muajin korrik të vitit 2004 Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara, Kai Eide, ka rekomanduar kalim të pushtetit tek institucionet e përkohshme vetëqeverisës dhe ka rekomanduar të fillohet me diskutime për statusin.³⁴⁴

Raporti i dytë i Kai Eides titulluar: Shqyrtimi gjithëpërfshirës i situatës në Kosovë, do të jetë çelësi dhe udhëzuesi për nisjen e negociatave për statusin final të Kosovës, dhe ky raport mban datën 7 tetor 2005.

“Duke ndjekur një gjendje të amullisë politike dhe të një frustrimi të gjerë, Kosova ka hyrë në një periudhë të re të zhvillimit dinamik,” thuhet që në fillim të raportit. Një proces politik është në rrugë e sipër dhe ai po fiton momentum-in. Ai është i bazuar në një strategji gjithëpërfshirëse

³⁴² Shih Dokumentin zyrtar “Standardet për Kosovën”, të datës 10 dhjetor 2003.

³⁴³ www.unmikonline.org, cituar nga Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.311.

³⁴⁴ Shih Raportin *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë, Beograd, New York, Brussels, 2007, fq.7.

politike, që përshin edhe prospektet e procesit për statusin e ardhshëm.³⁴⁵ Raporti e lidh procesin e implementimit të standardeve duke e bërë pjesë të dinamikës së përgjithshme. Më tutje raporti bën krahasimin me vakuumin institucional që kishte ekzistuar në vitin 1999 me atë të ditëve të vlerësimit, kur në Kosovë ishin ndërtuar institucionet e përkohshme të qeverisjes lokale dhe qendrore. Flitet për procesin e nxjerrjes së ligjeve dhe për shërbimet publike që funksionojnë në Kosovë, sikundër procesi i transferit të kompetencave që po ndodhte në vazhdimësi. Shqiptarët nisin të bëhen pronarë të institucioneve, kurse serbët vendosin të mbesin jashtë duke krijuar struktura paralele. Serbët nga frika se do të shndërrohen në dekor për demokraci nuk bëhen pjesë e sistemit, kurse koha ka ardhur që Beogradi të ndryshojë politikën ndaj atyre duke ndikuar që të heqin dorë nga kjo praktikë negative. Zhvillimi ekonomik është i dobët, ndërsa papunësia ka shkallë të lartë. Vlerësohet se Kosova ka resurse, të cilat Kosovën nga një vend të uritur për energji do ta shndërrojnë në një vend eksportues të energjisë. Situata lidhur me raportet ndëretnike duket e qëndrueshme, por megjithatë raportet konsiderohen të brishta. Të tilla janë konstatuar edhe në raportin e parë të Kai Eide-s kur ishin nxjerrë konstatime lidhur me raportet ndëretnike dhe kur ishte propozuar një “road map” si formë propozimi për zgjidhje.³⁴⁶ Kërkohe më shumë nga ndërkombëtarët dhe nga vendorët që ta ndryshojnë këtë pamje. Lidhur me të drejtat pronësore juridike është vlerësuar se kjo mbetet sfidë e madhe përmes së cilës do të sigurohet një shoqëri multietnike e vërtetë. Flitet gjithashtu për procesin e të kthyerve, duke numëruar disa të meta dhe duke sugjeruar që, p.sh., kampet ku jetojnë romët të shikohen me kujdes më të madh. Sugjerohet dhe kërkohet një decentralizim më i theksuar me qëllim që t’u jepen sa më shumë mundësi serbëve për krijimin e lidhjeve horizontale të komunave të tyre.

Kërkohe që procesi i përcaktimit të statusit të zhvillohet krahas zbatimit në jetë të standardeve sepse ekziston një frikë se po u përqendruam vetëm te statusi, standardet do të mbesin aty ku janë. Është vlerësuar se në Beograd ashtu edhe në Prishtinë, por edhe në bashkësinë ndërkombëtare pritjet për bisedimet për status janë të mëdha dhe këtu duhet theksuar se Eide ka vlerësuar se statusi duhet zgjidhur gjatë kohës së pranisë të ndërkombëtare në Kosovë. Bisedimet për status vlerësohet se duhet të fillojnë me kujdes dhe duhet të sigurohet prania e të dyja palëve dhe ato duhet të jenë bashkë që nga fillimi i negociatave deri në përfundimin e tyre. Nuk duhen caktuar afate artificiale dhe negociatat në asnjë mënyrë nuk duhet të ndërpriten nga asnjëra palë.

³⁴⁵ Raporti i Kai Eide-s i datës 7 tetor 2005.

³⁴⁶ Shih Raportin e Kai Eide-s dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të datës 06 gusht 2004.

Ato duhet të fillojnë dhe duhet të mbarojnë pa pasur ndërprerje. Procesin e përcaktimit të statusit të Kosovës më shumë duhet ta marrin europianët, sepse përpos të tjerash Kosova është në Europë dhe ky është vendi ku ka organizata të forta regjionale, sigurisht duke menduar për Bashkimin Europian.³⁴⁷ Këto do të jenë më në gjendje të ndërmjetësojnë, por dhe mund të ofrojnë perspektiva të integritimeve. Ka ekzistuar dhe duhet shprehur se bashkësia ndërkombëtare do të ndihmojë dhe BE-ja duhet të jetë e gatshme të futet në Kosovë, sikundër duhet vënë në pah se NATO do të qëndrojë edhe më tutje me praninë e vet në vend. Duhet t'i jepet Kosovës një prospekt i qartë integrimi në të ardhmen, por edhe Beogradit gjithashtu. Pa marrë parasysh se çfarë do të jetë statusi, bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë kujdes që ky status të mos jetë status i dështuar. Në raport, më tutje, konstatohet se është vështirë të caktohet saktë se cila do ishte dita dhe koha më e mirë për të filluar negociatat për statusin, por shtyrja nuk është opsion, sikundër se nuk është zgjidhje nëse përdorim shprehjen “shohim e bëjmë”. Është një pritje në Beograd dhe në Prishtinë se një proces për statusin do të fillojë. Në Prishtinë fillimisht është vërejtur një rivalitet në mes të liderëve shqiptarë në kuptimin se kush do të jetë më i merituari për t'i prirë negociatat, sesa përgatitja e mirëfilltë lidhur me përmbajtjen e tyre. “Së fundi, një ekip negociator, i përbërë nga pesë liderët shqiptarë më të njohur të Kosovës, do të caktohet nën udhëheqjen e presidentit të Kosovës”³⁴⁸ Ekipi negociator i Kosovës nuk ka përfshirë përfaqësues të serbëve të Kosovës, të cilët ishin përfshirë nga ana e Serbisë.³⁴⁹ Dhe në Beograd më shumë kishte tendenca të një lideri për t'u marrë me tjetrin sesa për t'u koordinuar për hapat që duhen ndërmarrë.

Siç shihet, dhe siç u paraqit në formë të shkurtër, Kai Eide ka arritur që në nivel të duhur dhe për një kohë të shkurtër të nxjerrë gjithë elementet e duhura nga terreni dhe ai ka arritur të prekë thelbin e problemit që kërkon zgjidhje. Qasja e tij ka qenë mjaft gjithëpërfshirëse dhe gjetjet sikundër edhe sugjerimet janë dhënë në mënyrë objektive. Është e vështirë për një raportues objektiv që të përpilojë raporte dhe të nxjerrë përfundime për palë me qëndrime diametralisht të kundërta. Akoma më vështirë është të veprohet kur kornizat e veprimit janë edhe kohore edhe

³⁴⁷ Më gjerësisht shih raportin e Kai Eide-s dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me datë 05 tetor 2005/S/2005/635. Raporti është paraqitur në Këshillin e Sigurimit me datë 07 tetor 2005 nga Sekretari i Përgjithshëm.

³⁴⁸ Raporti i Kai Eide-s, Shqyrtimi gjithëpërfshirës i gjendjes në Kosovë, pika 65, marrë nga: Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq. 91

³⁴⁹ Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S. Policy: Background to independence, updated June 2008, fq. 11.

përmbajtësore. Për më tepër edhe në këtë rast raportuesi ka ditur të nxjerrë thelbin sado që edhe te njëri entitet është ballafaquar më përçarjet e brendshme të liderëve patriotë, që duan primat në proces. Raporti mund të vlerësohet objektiv dhe i nxjerrë në momentin më të duhur, sepse çdo shtyrje e procesit mund të çonte drejt rrugëve të paparashikuara. Raporti i dorëzuar te Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka 86 pika të cilat kapin të gjitha fushat më të rëndësishme të gjendjes në Kosovë që nga ekonomia, raportet ndëretnike, ndërtimin e institucioneve, sundimin e ligjit, pronën, kthimin dhe të kthyerit, etj.³⁵⁰

5.2.2. Parimet e Grupit të Kontaktit

Raporti i Kai Eide-s hapi derën për negociatat dhe bazuar në këtë u aktivizua edhe Grupi i Kontaktit, i cili mirëpriti iniciativën e Sekretari të Përgjithshëm për emërimin e emisarit special që do të udhëheqë procesin. Për më tepër grupi i kontaktit paraqet dhjetë parime, ku u bazua dalja e rezultatit të bisedimeve për status. Këto parime kanë rëndësinë e vet, sepse vetë përbërja e grupit të kontaktit është garanci e llojit të vet për statusin. Këto parime kanë të bëjnë me atë se zgjidhja e statusit duhet të bëhet në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe të së drejtës ndërkombëtare dhe i kontribuojnë sigurisë regjionale; zgjidhja duhet të jetë konform vlerave europiane, që duhet të sigurojë shoqëri multietnike, zgjidhja duhet të sigurojë pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, duhen paraparë mjete të veçanta për sigurinë e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë, duhet të përforcojë stabilitet dhe siguri në rajon - nuk do ketë ndryshime në territorin e sotëm të Kosovës, nuk do ketë as ndarje dhe as bashkim, integriteti i shteteve fqinje duhet të respektohet plotësisht, duhen krijuar mekanizma të qartë lidhur me sundimin e ligjit në Kosovë, duhet siguruar zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe politik në Kosovë dhe Kosovës edhe për një kohë i duhet prania civile dhe ushtarake.³⁵¹ Aktivizimi i Grupit të Kontaktit, në këtë fazë ishte një ide e qëlluar sepse me të mendohej dhe pritej se edhe Rusia do të angazhohej në zgjidhjen dhe çka është më shumë e rëndësishme edhe në përkrahjen kur zgjidhja të ishte arritur. Kjo pastaj do të lehtësonte procesin e tërësishëm, sepse po të sigurohej përkrahja dhe pëlqimi i Ruisë atëherë procesi mendohej se do të ishte më i lehtë për t'u administruar dhe në anën tjetër

³⁵⁰ Shih më gjerësisht raportin e Kai Eide-s që mban shifrën S/2005/635 të datës 5 tetor 2005.

³⁵¹ Shih më gjerësisht Dokumentin e Grupit të Kontaktit për Parimet e zgjidhjes së statusit të Kosovës, datë 7 tetor 2005/UNOSEK.

do të sigurohej vota e Ruisë në Këshillin e Sigurimit. Kishte zëra që ngulmonin që gjithçka të vihej në kanale të Këshillit të Sigurimit. Me këtë po sigurohej një unitet brenda bashkësisë ndërkombëtare, me çka qëndrimet ishin të përbashkëta dhe që të gjithë ishin të mendimit se koha për përcaktimin e statusit ishte maturuar krejtësisht. Siç shihet, me këtë Grupi i Kontaktit sërish merr rol kryesor në negociimin e procesit të statusit edhe pse kjo punë duhej t'i takonte OKB-së. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, në fakt me datë 14 nëntor 2005 e emëron të dërguarin special të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisaari. Zyra e tij do të jetë në Vjenë, Austri.³⁵² Zëvendësi i Martti Ahtisaarit emërohet diplomati austriak Albert Rohan. Prej këndej fillon procesi i negociatave për përcaktimin e statusi final të Kosovës, një proces sa i mundimshëm aq i rëndësishëm, në të cilin përse i përket pozicionimit të palëve, sërish do ta quaja të pabarabartë. Për këtë do të flasim më poshtë.

5.3. Shpallja e pavarësisë

Emërimi i Martti Ahtisaarit ka qenë një gjetje e qëlluar për të udhëhequr procesin negociator. Ish- Presidenti finlandez ka pasur dijeni të shumta lidhur me zhvillimet në Ballkan dhe në veçanti për ish -Jugosllavinë dhe për më tepër ai ka qenë i angazhuar edhe më herët në zgjidhjen e çështjeve të lidhura me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Duke qenë kështu dhe duke pasur një karrierë të pasur politiko -diplomatike, qysh në fillim mund të supozohej se përfundimi do të rezultonte me propozim për zgjidhjen. Ai që në fillim kur ka pranuar detyrën, e ka pasur të qartë se do të udhëhiqte një proces të koklavitur dhe të vështirë për t'u realizuar. E ka ditur se do ketë të bëjë me dy palë, që do dalin me qëndrime të ngurta, prej të cilave nuk heqin dorë. E ka ditur gjithashtu se edhe vetë ata që e kanë emëruar në fund të mandatit do ta kënë të vështirë të vendosin sipas propozimit të tij. Ndërkaq ai ka qenë i vetëdijshëm se në arenën ndërkombëtare, që nga vendosja e administrimit civil ndërkombëtar në Kosovë, kanë qarkulluar shumë opsione të mundshme, që një ditë do të viheshin në tavolinë për shqyrtim të mundshëm dhe për aprovim. Së fundi, ai ka pasur njohuri të thella edhe për procesin e bisedimeve që ishin zhvilluar në Rambuje. Dhe gjithsesi ai e ka ditur se “mund të nxirret një konkluzion, por për statusin final të Kosovës, cilat negociata, duhet të merren në konsideratë sepse një vendim i tillë, mund të krijojë në regjion një konsekuencë të gjerë gjeopolitike, që vetvetiu dhe pastaj

³⁵² Vizito web faqen e UNOSEK (United Nations Office of the Special Envoy for Kosovo) te Special Envoy.

drejtpërdrejt ndikon edhe në dinamikat globale të forcave. Kompleksiteti dhe ngatërresat e kësaj dosjeje bashkë më çështjet e tjera në politikat aktuale ndërkombëtare nuk duhet nënvlerësuar.³⁵³

Që nga vendosja e administrimit civil ndërkombëtar në Kosovë në arenën ndërkombëtare janë paraqitur lloj -lloj projektesh e propozimesh për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ndër to po paraqesim ato të propozuara nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovës³⁵⁴ të cilat janë diskutuar nëpër forume të ndryshme zyrtare e gjysmëzyrtare. Sipas Komisionit, janë të mundura këto opsione:

- *protektorati për Kosovës;*
- *ndarja e Kosovës sipas gjendjes së krijuar në terren me vijën ndarëse lumi Ibër;*
- *pavarësi e plotë e Kosovës;*
- *autonomi brenda RFJ demokratike;*
- *pavarësi e kushtëzuar.*³⁵⁵

Për të gjitha opsionet e përmendura, Komisioni ka dhënë argumente pro dhe kundër, kurse brenda bashkësisë ndërkombëtare krahas këtyre, janë gjetur edhe opsione të tjera të ngjashme apo të kundërta me këto. Kishte edhe opsion që Kosova mund t'i bashkohej Shqipërisë.

5.3.1. Kronologjia e takimeve

Me të marrë detyrën Martti Ahtisaari, do të ndërmarrë një udhëtim për të vizituar palët të cilat do t'i ndërmjetësojë. Kështu në muajin nëntor do të vizitojë Beogradin, Prishtinën dhe pastaj edhe Tiranën, Podgoricën dhe Shkupin. Që nga këtu e tutje ai, zëvendësi i tij dhe anëtarët

³⁵³ David Crikemans, *Final Status of Negotiations, Model United Nations-Flanders*, Third edition, University of Antwerp, Belgium, 2007, fq.7.

³⁵⁴ The Independent International Commission on Kosovo (IICK) u themelua në gusht të vitit 1999 menjëherë pas luftës së Kosovës me iniciativë të kryeministrit suedez, Goran Persson, dhe me aprovimin e qeverisë suedeze. Komisioni kishte 11 anëtarë, 7 nga të cilët ishin nga shtete anëtare të NATO-s. Qëllimi i këtij komisioni ishte vlerësimi nëse normat ekzistuese janë të mjaftueshme që të parandalonin konfliktet etnike në të ardhmen, të ngjashme me konfliktin e Kosovës.

³⁵⁵ Shih Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.

e UNOSEK-ut³⁵⁶ do të vizitojnë terrenin shumë herë. Për më tepër, emisari i posaçëm ka kryesuar takimet e drejtpërdrejta të lidërshipt kosovar dhe serb në Vjenë me 24 korrik 2006. Presidenti, Boris Tadiç, dhe Kryeministri, Vojislav Koshtunica, kanë udhëhequr delegacionin e Serbisë, ndërsa Fatmir Sejdiu Ekipin e Unitetit të Kosovës. Takimi i dha mundësi secilës palë që të paraqesë në nivelin më të lartë pikëpamjet e saj për të ardhmen e Kosovës tek të tjerët dhe te komuniteti ndërkombëtar që përfaqësohet nga UNOSEK-u dhe nga vëzhguesit e Grupit të Kontaktit, BE dhe NATO.³⁵⁷

Sipas raportit të UNOSEK-ut takimet e drejtpërdrejta në mes Beogradit dhe Prishtinës janë mbajtur, si vijon:

- *Takimi i lidërshipt kosovar dhe serb në Vjenë: 24 korrik 2006;*
- *Tetë takime lidhur me decentralizimin: 20-21 shkurt, 17 mars, 3 prill, 5 maj, 19 korrik, 7 gusht, 7 shtator dhe 15 shtator;*
- *Tri takime lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë: 23 maj, 18 korrik dhe 8 shtator;*
- *Dy takime lidhur me të drejtat e minoriteteve: 8 gusht dhe 8 shtator dhe*
- *Një takim lidhur me çështjet ekonomike: 31 maj.*

Kjo listë takimesh, siç është paraqitur nga UNOSEK tregon vetëm takimet e drejtpërdrejta në mes të palëve, por procesi në vetvete ka qenë i ngarkuar edhe me aktivitete të tjera, si: takimet e ekspertëve gjatë vizitave në Kosovë e në Serbi, takimet e Emisarit të Posaçëm me grupin e kontaktit, me ministrat e jashtëm të BE-së, me NATO-n sikundër raportimet në Këshillin e Sigurimit. Me 25 janar 2007 Emisari i Posaçëm e njofton Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së lidhur me zhvillimet dhe ka ndarë me të propozimin e tij. Një ditë më pas në Vjenë takohet me Grupin e Kontaktit ku si pjesë e konsultimeve iu tregon përmbajtjen e propozimit të tij. Më pas Emisari i Posaçëm do të udhëtojë për në Beograd dhe për në Prishtinë dhe me 2 shkurt draftpropozimin iua jep Presidentit Tadiç në Beograd kurse në Prishtinë Presidentit Sejdiu.

Emisari i Posaçëm pastaj thërret të dyja palët në Vjenë në një seri takimesh lidhur me draftpropozimin. Gjatë raundit të parë të bisedimeve, të mbajtur në mes të 21 shkurtit dhe 2 marsit, delegacionet shqyrtuan në tërësi dokumentin. UNOSEK-u pastaj ka bërë revizion në

³⁵⁶ Zyra e OKB-së e emisarit të posaçëm për procesin e statusit të Kosovës, me seli në Vjenë.

³⁵⁷ Shih web faqen e UNOSEK-www.unosek.org.

draftin fillestar dhe ka thirrur palët që të marrin pjesë në Vjenë në nivel të lartë. Delegacioni i Beogradit udhëhiqej nga Presidenti Tadiç dhe nga Kryeministri Koshtumica, kurse delegacioni i Ekipit të Unitetit nga Prishtina udhëhiqej nga Presidenti Sejdiu. Përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, BE dhe NATO gjithashtu marrin pjesë në mbledhje.³⁵⁸

Pas këtij takimi të nivelit të lartë, President Ahtisaari arriti në konkluzionin se në mes palëve nuk vërehet asnjë mundësi për të gjetur një zgjidhje të favorshme për të dyja palët dhe kështu bëri të ditur qëndrimin e vet, se gjatë muajit mars do të finalizojë draftpropozimin për t'ia dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, meqë të gjitha mundësitë tashmë ishin shtjerrur. Në mars ai e dorëzon draftin final të Propozimit gjithëpërfshirës të statusit të ardhshëm të Kosovës. Në raportin e tij dërguar Sekretarit të Përgjithshëm ai shkruan: *“Gjatë gjithë procesit dhe në shumë raste, të dyja palët kanë riafirmuar pozitat e tyre kategorike diametralisht të kundërta: Beogradi kërkon autonomi për Kosovën në Serbi, kurse Prishtina nuk pranon asgjë më pak se autonomi. Madje edhe në çështjet praktike siç janë decentralizimi, të drejtat e komuniteteve, çështjet e trashëgimisë kulturore dhe fetare, dallimet konceptuale – gati gjithmonë lidheshin me statusin – vazhdojnë, dhe vetëm një progres modest mund të arrihet”*.³⁵⁹ Emisari i posaçëm pasi sqaron rrjedhën e ngjarjeve, në raport nxjerr edhe përfundimet se:

- Riintegrimi me Serbinë nuk është opsion i zbatueshëm;
- Vazhdimi i administrimit ndërkombëtar nuk është i qëndrueshëm dhe
- Pavarësia me mbikëqyrje ndërkombëtare është opsioni i vetëm i zbatueshëm³⁶⁰.

Duke përfunduar, Emisari Special sqaron në pikën 15 se “Kosova është një rast i veçantë dhe kërkon zgjidhje të veçantë”. Dhe në fund, në pikën 16 të raportit, i cili ka 12 anekse, Ahtisaari do të shtojë: “rekomandimi im për pavarësi të mbikëqyrtur nga bashkësia ndërkombëtare, merr në konsideratë historinë aktuale, realitetet e Kosovës së sotme dhe nevojat për stabilitet ekonomik dhe politik në Kosovë. Propozimi im i zgjidhjes do të bazohet mbi pozitat e palëve në procesin negocues dhe gjatë ofertave të kompromisit në shumë çështje ku synohet të arrihet një zgjidhje e fortë- qëndrueshme“.³⁶¹

³⁵⁸ Shih raportin e takimeve te www.unosek.org.

³⁵⁹ Raporti i Marti Ahtisaarit dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, S/2007/168, datë 26 mars 2007, pika 2.

³⁶⁰ Shih dokumentin e cituar – Raporti i Ahtisaarit.

³⁶¹ Shih Raporti i cituar, pika 16.

Me datë 3 prill ai raporton dhe shpjegon propozimin e tij para Këshillit të Sigurimit, i cili, siç është pritur, nuk do të aprovojë rezolutën e sponsoruar nga 17 shtete, të cilat e kanë konsideruar propozimin e Ahtisaarit të balancuar dhe që mundësonte paqe dhe stabilitet në rajon.

Me 19 prill anëtarë të Këshillit të Sigurimit vendosin të ndërmarrin një mision për mbledhje faktesh (fact finding mission) dhe këtë delegacion do ta udhëheqë përfaqësuesi belg. Misioni do të ndalojë së pari në Bruksel ku zhvillon takime me Sekretarin e NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, me përfaqësuesin special të BE-së për Kosovën, Stefan Lehne, dhe me Komisionerin për zgjerim të UE-së, Olle Rehn. Gjatë takimit në Bruksel, Sekretari i NATO-s ka njoftuar delegacionin se propozimi i Ahtisaarit është i pranueshëm për NATO-n dhe se NATO është e gatshme që të kryejë obligimet e veta, duke nënvizuar se do të vazhdohet me trajnimin e mëtejshëm të forcave të sigurisë së Kosovës, se do të vazhdohet me shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, se do të vazhdohet me mbrojtjen e monumenteve kulturore serbe, etj. Stefani Lehne ka vënë në pah se status quo-ja dhe shtyrja nuk i shërbejnë asnjë interesi. Ai ka vazhduar të shpreh interesin e BE-së për paqe dhe siguri në regjion dhe është shprehur për një ndër çështjet më të rëndësishme se nuk parashihet në asnjë mënyrë protektorat dhe ka nënvizuar faktin se BE i ka dhënë përkrahje të plotë propozimit të Ahtisaarit. Ndërkaq Olle Rehn ka nënvizuar perspektivat europiane, por ka shtuar se vetëm shtetet mund të futen në marrëdhënie kontraktuese me BE-në.³⁶² Misioni më tej ka vizituar Beogradin ku nga Kryeministri Koshtunica dhe nga negociatorët serbë ka marrë qëndrimin e Serbisë për autonomi për Kosovën. Ndërsa në Prishtinë nga takimi me grupin e unitetit, të kryesuar nga Presidenti Fatmir Sejdiu është marrë qëndrim i prerë se zgjidhja e vetme dhe e pranueshme është pavarësia e Kosovës dhe se nuk mund të ketë zgjidhje që të zëvendësojë pavarësinë. Misioni i mbledhjes së fakteve nxjerr përfundimet e veta, ndërsa brenda në Këshillin e Sigurimit bëhet edhe një përpjekje për një draft-rezolutë të këqyruar, nga Gjermania, nga Belgjika, Britania e Madhe, nga SHBA-ja dhe nga Italia. Gjithnjë ishin bërë përpjekje që zgjidhja finale të bëhej brenda Këshillit të Sigurimit, sepse aty do të ishte edhe Rusia.

³⁶² Lexo më shumë për takimin në Bruksel, tek: David Crikemans, *Final Status of Negotiations, Model United Nations-Flanders*, Third edition, University of Antwerp, Belgium, 2007, fq.11-12 dhe raportin e Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S.Policy: Background to independence, updated June 2008, fq. 20-21.

Gjendja e pritjes nuk do të zgjaste përgjithmonë. Në kontekstin e një pritjeje, së cilës nuk mund t'i parashihej fundi, Presidenti Bush në qershor të vitit 2007 viziton Shqipërinë dhe atje nënvizon se koha për pavarësinë e Kosovës kishte ardhur duke shtuar se SHBA-ja do të njihte pavarësinë e Kosovës në mënyrë unilaterale. Në takimin e G-8-ës Presidenti i Francës, Sarkozy, kërkon shtyrje gjashtëmujore. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në korrik tërheq vërejtjen që të mos shtyhet çështja e statusit të Kosovës duke shpresuar se Këshilli i Sigurimit do të pajtohet me një draftrezolutë për t'iu dhënë serbëve dhe shqiptarëve edhe 120 ditë brenda të cilave ata do të arrinin marrëveshje. Në rrethanat e krijuara dhe bazuar në historinë jo të largët, si dhe bazuar në aspiratat e shqiptarëve, atyre vetëm një forcë e madhe mund t'iu impononte diçka më pak se propozimi i Ahtisaarit. Në anën tjetër politika serbe kishte mbetur në qëndrime të ngjashme si të Millosheviçit dhe si të tilla nuk mund të ishin opsion që merret në konsideratë. Megjithatë edhe një përpjekje diplomatike do të ndërmerret për angazhime shtesë në një periudhë 120 ditëshe. Edhe një draftrezolutë do të qarkullohet në Këshill të Sigurimit gjatë korrikut, esenca e së cilës ishte: nëse brenda 120 ditëve nuk arrihet marrëveshje, atëherë pavarësia e mbikëqyrtur për Kosovën do të ishte aprovuar në mënyrë automatike. Edhe në këto përpjekje Rusia do të kundërshtojë, ndërsa Fatmir Sejdiu, President i Kosovës ishte shprehur se Kosova do ta shpallte pavarësinë në mënyrë unilaterale në ditën e pavarësisë së shtetit shqiptar. Këtë e kishin thënë edhe zyrtarë të tjerë si ndihmëssekretari amerikan i shtetit, Daniel Fried, i cili është shprehur: “Kjo ose do të bëhet në mënyrë të kontrolluar, të mbikëqyrtur dhe do të jepet e mirëqenë për serbët, ose do të bëhet në mënyrë të pakontrolluar, nga çka serbët e Kosovës do të vuajnë më së shumti, dhe kjo do të jetë e tmerrshme”.³⁶³

Situata e ndërlikuar dhe në një masë e acaruar do të qetësohet në një mënyrë, dhe për pak kohë kur SHBA dhe Rusia të emërojnë përfaqësuesit e tyre për angazhim shtesë lidhur me statusin e Kosovës. Bëhet përpjekje që përmes deklaratës Sekretari i Përgjithshëm të njoftojë për përpjekjet shtesë 120 ditëshe, pas të cilave pritej një raport i Grupit të Kontaktit. Por edhe këto përpjekje shtesë nuk arrin pëlqimin e Ruisë. Përfundimisht përpjekjet që brenda OKB-së të arrihej marrëveshja dështuan. Kështu Propozimi Gjithëpërfshirës – Plani i Ahtisaarit nuk u paraqit fare për votim në Këshillin e Sigurimit. Dhe Kosova pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2007 filloi me angazhimet konkrete për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

³⁶³ RFE/RL Newline, 30 April 2007, marrë nga: Raportin *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë, Beograd, New York, Brussels, 2007.

5.3.2. Faktorët, formati dhe mënyra e zhvillimit të bisedimeve

Përpyqjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mes Serbisë dhe Kosovës, kanë vazhduar për një kohë të gjatë dhe gjatë kësaj kohe janë përdorur pothuajse të gjitha mjetet diplomatike që njihen në të drejtën ndërkombëtare si: bisedimet, shërbimet e mira, ndërmjetësimi, hetimet apo anketimi, mjetet që ofrojnë institucionet ndërkombëtare dhe pajtimi. Së fundi edhe një mjet gjyqësor ka nxjerrë një opinion me të cilin është thënë se shpallja e pavarësisë së Kosovës, nuk ka bërë shkelje të normave të së drejtës ndërkombëtare. Se cili është objekt i mosmarrëveshjes në mes Kosovës dhe Serbisë, kemi folur në kërret e mëparshëm. Kurse për nevoja të këtij punimi po nxjerrim një përcaktim të mosmarrëveshjes, për të parë se a u përdorën të gjitha mjetet e mundshme për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje (dispute). “Mosmarrëveshja politike nënkupton, mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me interesat jetike, pavarësinë ose nderin e ndonjëres palë, për ç’arsye shtetet s’janë të gatshme t’ua lënë organeve gjyqësore për zgjidhje, por përkundrazi zgjidhjen e tyre më me dëshirë e bëjnë me mjete diplomatike, ngase lënë hapësirë të gjerë për bisedime, procedura është më e thjeshtë, obligojnë më së paku juridikisht, etj., gjë që nuk ndodh në procedurat gjyqësore. Në këtë mënyrë zgjidhen çështjet kufitare, shkolonizimi, etj.”³⁶⁴

Mosmarrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë, që në një kohë ka shpërthyer në luftë të armatosur, nuk i takon vetëm kohërave të reja. Se cili ka qenë objekt i mosmarrëveshjes varet nga qasja që kemi ndaj zgjidhjes së tij. Ndër mjetet që janë përdorur, në mosmarrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë po veçojmë bisedimet, ndërmjetësimin dhe një mjet i veçantë që e kanë përdorur institucionet ndërkombëtare - konferencat, ndër më e rëndësishmja: Konferenca e Rambouillet. Dhe në rastin e Kosovës, që pothuaj çdo element paraqet një rast sui generis të gjitha mjetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, kryekëput kanë qenë të iniciuara nga bashkësia ndërkombëtare. Shumë shkurt po përmendim ndërmjetësimin, për të parë nëse si i tillë është përdorur për rastin e Kosovës. Ndërmjetësimi konsiston në aksionin e një shteti të tretë, të një grupi të shteteve ose të ndonjë personi autoritativ me qëllim që të gjendet zgjidhja e një konflikti midis dy shteteve.³⁶⁵

³⁶⁴ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan ISM-Shkup, 2007, fq.467-477.

³⁶⁵ Po aty, fq.483.

Për të ekzistuar një proces i mirëfilltë negociimi duhet që palët të pajtohen për të hyrë në këtë proces dhe në rastin e Kosovës, të dyja palët kanë dhënë pëlqimin për të hyrë në proces, por të dyja kanë pasur qëllime të ndryshme. Kosova është futur në këtë proces për të nxjerrë dhe për të legalizuar atë që ajo e ka konsideruar se është legjitime: të drejtën e vet për ndërtimin e shtetit të pavarur. Serbia në anën tjetër është futur në proces për të legjitimuar stagnimin dhe përmes stagnimit për të nxjerrë shkëputjen e një pjese të territorit. Kjo sa i takon procesit të pasluftës, kurse me rastin e paraluftës ka hyrë në proces për të legjitimuar dhe legalizuar një gjendje të krijuar në terren, në saje të epërsisë ushtarake.

Sidoqoftë, nisja e procesit të negociatave të ndërmjetësuara nga Martti Ahtisaari, është bërë në një mjedis të vështirë negociimi. Pozicioni i Beogradit përputhej me përkrahjen e fuqishme që i bën sistemi klasik ndërkombëtar i ruajtjes së integritetit territorial dhe i unitetit territorial të shteteve.³⁶⁶ Ky ishte pozicioni i Serbisë, në të cilin ajo dëshironte të mbështetej tërësisht, pa marrë parasysh se kishim të bënim me një qasje krejtësisht tjetër dhe në kohë krejtësisht të ndryshme kur normat klasike të së drejtës ndërkombëtare nuk mund t'i shërbenin qëndrimeve të Serbisë. Çështje tjetër lidhur me negociatat ishte çështja e pëlqimit të palëve. Bisedimet po bëheshin nën patronatin e OKB-së dhe varësisht se nga cili kre i Kartës së OKB-së po veprohej, pëlqimi mund të ndryshonte rrjedhën. Sipas kapitullit VII ishte bërë ndërhyrja ushtarake. Struktura e negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës ishte komplekse. Korniza për negociatat ishte përcaktuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, bazuar në rekomandimet e ambasadorit Eide dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Kjo kornizë i kishte rrënjët, në një kuptim të përgjithshëm, te Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).³⁶⁷

Të bazohesh në mënyrë strikte në normat që kishte paraparë Rezoluta 1244 ishte e vështirë në rrethanat e reja. E para, ajo garantonte unitetin territorial të RFJ-së, ndërkohë që tash nuk kishte më RFJ. Mali i Zi ishte larguar nga RFJ dhe mbetej vetëm Serbia. Pastaj sipas rezolutës detyrat e pushtetit ndërkombëtar ishin për të krijuar një pushtet vendor dhe një autonomi substanciale, si nisje për përcaktimin e ardhshëm të statusit final. Krahas kësaj Grupi i

³⁶⁶ Marc Weller, "Why the legal rules on self-determination, do not resolve self-determination disputes, te Marc Weller dhe Barbara Metzger, eds, *Setting self-determination conflicts* (Dordrecht:Martinus Nijhoff,2008): 17-47. Biafra dhe Katanga janë shembujt kryesorë të shkëputjes së tentuar por të dështuar nga epoka klasike moderne. Bangladeshi është përjashtimi që e dëshmon rregullin, po të marrim parasysh rrethanat specifike të atij rasti. Cituar nga Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.317.

³⁶⁷ Po aty, fq.319.

Kontaktit i kishte thënë shprehur parimet në bazë të të cilave Emisari Special Ahtisaari duhet të tentonte për të orientuar procesin e negociatave.

Megjithatë pëlqimi për bisedime u dha nga të dyja palët dhe siç kemi e parë më lart, janë organizuar një seri takimesh. Mënyra teknike e organizimit të takimeve ndryshonte nga Rambujeja. Takimet e drejtpërdrejta në mes të delegacioneve organizoheshin në Vjenë dhe ku palët uleshin përballë njëra-tjetrës, me ekipin e UNOSEK-ut, shpesh të përforcuar me përfaqësuesit e BE-së dhe trupa të tjera, në krye të tavolinës.³⁶⁸ Para fillimit të raundeve zakonisht Emisari Special apo zëvendësi do të kenë organizuar takim veç e veç me delegacionet, para se ato të uleshin ballë për allë. Bisedimet në formë të tillë kanë qenë të vështira, sepse palët kanë ardhur në takim me propozime të parapaketuara dhe janë sjellë sipas asaj merr e lër. Kjo nuk ka krijuar hapësirë të madhe për diskutime dhe për afrim të opsioneve. Sipas asaj që është bërë e ditur nga ndërmjetësit, por edhe nga anëtarët e delegacioneve, pala serbe edhe kësaj here, në negociata bëhej sikur nuk ka ardhur për të gjetur zgjidhjen, por më shumë të shtynte zgjidhjen dhe për të fituar në kohë. Ata herë pas here nxirrnin propozime, gjithnjë me qëllimin për të fituar në kohë, propozime që ishin larg së mundshmes.

Kishte negociata të drejtpërdrejta, kishte edhe diplomaci fluturuese, kur ekspertët ndërmerrnin misionet nëpër qendrat e palëve negociuese dhe së fundi, “sidomos në fazën përfundimtare të bisedimeve, u zbatua formati i bisedimeve të afërta. Këtu delegacionet do të punonin në dhoma të ndara, kurse ndërmjetësit lëviznin prej njëres dhomë në tjetrën”.³⁶⁹ Kur UNOSEK të krijonte përshtypjen se ka marrë pozicionet më të qarta nga palët, atëherë formulonte propozimet. Dhe i gjithë ky proces, që po zhvillohej në Vjenë, në Prishtinë e në Beograd, por edhe në New York dhe Bruksel nuk arrin t’i bindë palët që të dalin me një pajtueshmëri në fund të negociatave. Kjo bëri që Martti Ahtisaari të dalë me Planin e Vet Gjithëpërfshirës, siç sqaruar më lart. Dhe kjo bëri që pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2007, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Hashim Thaçi, të niste përgatitjet për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës sepse nuk kishte më asnjë arsye për pritje, nuk kishte asnjë arsye për shtyrje dhe nuk kishte opsione të tjera përpos pavarësisë. E, Gazmend Zajmi, qysh herët kishte nxjerrë konkluzionin qendror “se solucioni i Kosovës së pavarur, nuk është kurrfarë solucioni ekstrem,

³⁶⁸ Po aty, fq.325.

³⁶⁹ Po aty, fq.327.

por është solucion i drejtpeshuar i kohës, me interes të thellë kombëtar, jo vetëm për kombin shqiptar, por edhe për kombin serb në Ballkan“.³⁷⁰ Kryeministri Thaçi do të luajë rolin kryesor për të koordinuar aktivitetet me BE-në dhe me SHBA-në në drejtim të shpalljes së koordinuar të Pavarësisë së Kosovës.

Për t’u shpallur pavarësia duhej siguruar përkrahja e partnerëve kryesorë strategjikë të Kosovës, ndërsa në anën tjetër një grup ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë po përgatisnin tekstin e Kushtetutës së Kosovës. Të njëjtin përgatitin edhe Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Teksti i Deklaratës së Pavarësisë është shkruajtur me dorë dhe në papirus, kopja origjinale e së cilës u soll në Parlament ditën e shpalljes.

Mbledhja e Parlamentit të Kosovës, ku është bërë shpallja e Deklaratës së Pavarësisë, është mbajtur me datën 17 shkurt 2008 në të cilën kanë marrë pjesë 109 deputetë³⁷¹ dhe mbledhjen e ka hapur Kryeparlamentari, Jakup Krasniqi, pas të cilit ka folur Presidenti, Fatmir Sejdiu, dhe Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës, ka lexuar Deklaratën e Pavarësisë. Ai, duke iu drejtuar të pranishmëve dhe opinionit të jashtëm dhe të brendshëm që në fillim shpreh falënderime për SHBA-në, për BE-në dhe për NATO-n. Dhe pastaj, Hashim Thaçi do të shprehet: “Ne udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate Shpallim Kosovën Shtet të Pavarur dhe Demokratik. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe propozimin e tij gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ne e shpallim Kosovën Republikë Demokratike, laike dhe shumë etnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe të mbrojtjes së barabartë sipas ligjit...”³⁷² Pas leximit të Deklaratës, tekstin e saj e nënshkruajnë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në të njëjtën ditë Parlamenti i Kosovës ka aprovuar edhe simbolet e shtetit të ri: të flamurit dhe të stemës së Kosovës. Menjëherë Kosova fillon të njihet nga shtetet e para si SHBA, Franca, Anglia, Gjermania, Turqia, Shqipëria dhe kështu me radhë. Dita e shpalljes së Pavarësisë është ndjekur me interesim të madh në gjithë botën dhe të gjitha agjencitë kryesore kanë raportuar drejtpërdrejt

³⁷⁰ Gazmend Zajmi, cituar nga Esat Stavileci, Vepra V, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtinë, 2013, fq.104-105.

³⁷¹ Shih Deklarata e Pavarësisë nga mbledhja e Kuvendit të Kosovës e datës 17 shkurt 2008, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Dek_Pav_sh.pdf.

³⁷² Po aty.

nga Parlamenti i Kosovës duke raportuar edhe për mjediset dhe atmosferën festive gjithëkombëtare.

5.4. Kushtetuta e re e Kosovës

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës – Plani i Ahtisaarit³⁷³ dhe ndikimi në Kushtetutën e Kosovës

Është nënvizuar më lart se Delegacioni i Kosovës dhe institucionet e Kosovës u deklaruan pro Planit Ahtisaari. Me këtë ata dëshirojnë të tregojnë gatishmëri për marrëveshje me Serbinë në një të anë, dhe të tregojnë të bashkësia ndërkombëtare gatishmërinë për të marrë obligime ndërkombëtare, në anën tjetër. Pavarësisht faktit se Serbia nuk e pranoi këtë pako, Kosova vazhdoi me procesin e vet të shtetndërtimit duke u bazuar dhe duke e respektuar këtë pako. Për më tepër siç është thënë më lart Kuvendi i Kosovës ishte deklaruar pro këtij plani.³⁷⁴ Pakoja Ahtisaari, siç njihet shkurt në Kosovë u pranua në tërësinë e saj, kurse kjo pako ka hapur shumë debate diplomatike dhe akademike, për ta klasifikuar këtë në kategorinë që i takon. Me këtë rast nuk do të bëjmë krahasime, për të qenë pjesë e këtij debati, por duhet thënë se “pakoja parashihte çdo gjë që Kosova do të kishte nevojë për ta transformuar veten në shtet dhe për të tjerët që ta njohin si shtet, nëse ashtu duan”.³⁷⁵ Do të japim më poshtë shkurtimisht përmbajtjen dhe elementet e saj, sepse Kosova ka nisur të ndërtojë shtetin e vet dhe të forcojë shtetshmërinë, pikërisht duke ndërtuar dhe funksionalizuar institucionet bazuar në këtë dokument, që njihet si Pakoja e Ahtisaarit. Pakoja Ahtisaari është një dokument që në vete ka 12 anekse, kurse në pjesën hyrëse në 14 nene flitet për parimet në të cilat do të ndërtohet pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës. Kosova do të jetë shoqëri shumetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.³⁷⁶ Sipas nenit 1, pika 1.3 të pakos, Kosova do të ketë kushtetutën e vet³⁷⁷, e cila do të

³⁷³ Është bërë publikisht i njohur si dokument me datën 2 shkurt kur Martti Ahtisaari Propozimin gjithëpërfshirës për Statusin Final të Kosovës ua dërgoi Beogradit dhe Prishtinës.. Teksti i Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës paraqitet si dokument aneks/shtesë i Këshillit të Sigurimit si S/2007/168/Add.1.March 26, 2007.

³⁷⁴ Deklarata e Kuvendit të Kosovës për pranimin e Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Pakja Ahtisaari) - Kuvendi i Kosovës e ka nxjerrë këtë Deklaratë me 5 prill 2007.

³⁷⁵ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.347.

³⁷⁶ Shih Pakon Ahtisaari, neni 1, Dispozitat e përgjithshme.

³⁷⁷ Kushtetuta e Kosovës është nxjerrë me 9 prill 2008 dhe hyn në fuqi më 15 qershor 2008 (neni 162 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

përshkruajë dhe do të garantojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, që janë të domosdoshëm për t'u siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike...³⁷⁸ Gjithnjë sipas këtij neni, Kosova do të ketë të drejtë të lidhë marrëveshje ndërkombëtare dhe të kërkojë anëtarësim në organizata ndërkombëtare, do të ketë simbolet e veta të veçanta kombëtare, përfshirë flamurin, stemën, etj. Më tutje vihet në pah se Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti.³⁷⁹ Përpiluesi i kësaj norme në radhë të parë do të ketë pasur parasysh propagandën që është bërë në vazhdimësi lidhur me tendencat shqiptare për krijimin e Shqipërisë së Madhe, apo me tendencat për të marrë territore nga Maqedonia apo edhe nga Serbia Jugore. Kjo mënyrë e formulimit të normës, besohet të jetë bërë edhe nga shkak se pakjoja është pritur (dhe dëshiruar) të aprovohej nga Këshilli i Sigurimit dhe është shpresuar se me formulime të këtilla në pjesë të caktuara të tekstit, do të hiqeshin argumentet se po krijohet Shqipëria e Madhe, e cila ishte një peshë kryqi në shpinë të Kosovës gjatë gjithë kohës së negociatave. Dhe kjo, jo vetëm me krijimin e pakos së Ahtisaarit, por kështu është vepruar edhe në Rambuje dhe, edhe më herët gjatë të gjitha përpjekjeve për negociata. Neni 2 i dispozitave të përgjithshme ka të bëjë me të drejtat e njeriut ku përmendet obligimi për të rregulluar këtë çështje sipas Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut, në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe protokolleve të saj. Neni 3 i kushtohet të drejtave të komuniteteve, që specifikohen me aneksin 2 dhe 1 të këtij dokumenti. Neni 4 i kushtohet refugjatëve dhe personave të zhvendosur, kurse neni 5 i kushtohet personave të zhdukur, me çka Serbia dhe Kosova do të obligoheshin për të marrë masat e domosdoshme për të dhënë informacione lidhur me identitetin, vendndodhjen e personave të zhdukur, etj. Decentralizimi si çështje shumë e diskutuar dhe mund të themi si shumë e diskutuar gjatë negociatave të Vjenës, është paraparë me nenin 6 dhe ka marrë karakteristika të një lloj decentralizimi etnik dhe jodecentralizimi që do të nënkuptonte kalimin e resurseve nga lartë poshtë. Decentralizimi është mjet kryesor i sugjeruar për të garantuar multietnicitetet. Pakjoja e Ahtisaarit bëri që shumica e serbëve të mbetur në Kosovë të kthehen te komunat me shumicë serbe; në një kulm me ta. Ai e formalizon decentralizimin si nikoqir të pushteteve qeverisëse të komunave të Kosovës. Aktualisht janë 30

³⁷⁸ Shih më gjerësisht Pakon Ahtisari, neni 1, pika 1.3.

³⁷⁹ Shih pikën 1.8 të Pakos së Ahtisaarit.

komuna dhe tre pilotkomuna të tjera. Ahtisaari i shton pesë të reja me shumicë serbe (dhe një e zgjeron) duke e bërë numrin në total 38.³⁸⁰ Çështja e trashëgimisë kulturore dhe fetare është një fushë që e ka kapur neni 7 dhe kjo është bërë thujse krejtësisht vetëm për serbët dhe për Kishën Ortodokse serbe, ndërsa neni 8 ka të bëjë me çështjet ekonomike dhe pronësore. Çështja e sigurisë përmenden me nenin 9 ku Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe prania ushtarake ndërkombëtare do të mbikëqyrin dhe do të zhvillojnë edhe më shumë institucionet kosovare të sigurisë. Me nenin 10 parashihet që të krijohet Komisioni Kushtetues, i cili do të ketë 21 anëtarë. Neni 11 flet për Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, kurse neni 12 përfshin përkrahjen ndërkombëtare për sundimin e ligjit. Prania ushtarake ndërkombëtare rregullohet me nenin 13, kurse neni 14 përshkruan dispozitat kalimtare, ku parashihet një afat 120 ditor, brenda të cilit do të vlejnjë të gjitha aktet e UNMIK-ut, kurse Kosova do të ketë të aprovuar kushtetutën e vet brenda këtij afati, etj. Më poshtë do të numërojmë të gjitha anekset, kurse shkurtimisht do të paraqesim ato që mendohet se kanë qenë më të vështirat për t'u pranuar nga Kosova.

5.4.1. Anekset në Propozimin gjithëpërfshirës të zgjidhjes së statusit final të Kosovës

Aneksi 1: Dispozitat kushtetuese

Këto dispozita kanë të bëjnë me kushtetutën që do të ketë Kosova dhe me përmbajtjen e saj. Kushtetuta e Kosovës duhet të jetë në përputhje me Pakon Ahtisaari dhe në rast kolizionit në mes të të dyjave, atëherë dispozitat e pakos do të vihen në përdorim.³⁸¹ Sipas këtij aneksi edhe parimet e përmendura duhet të janë të inkorporuara në kushtetutën e Kosovës. Kosovës duhet t'i jepet karakteri shumetnik dhe Kosova nuk do të ketë fe zyrtare.³⁸² Kushtetuta e Kosovës duhet të parashoh që të gjitha instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duhet të jenë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Këtu numërohen konventat kryesore të kësaj

³⁸⁰ Shih Raportin Kosovo: *No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë, Beograd, New York, Brussels, 2007, fq.13.

³⁸¹ Kreu XIII të dispozitat përfundimtare të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 143, pika 2, shprehet se Dispozitat e propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

³⁸² Shih për më shumë nenin 1 të Aneksit 1 i Dispozitave Kushtetuese.

fushe.³⁸³ Sipas marrëveshjes Kuvendi i Kosovës do të ketë 120 vende që do të zgjidhen me vota të fshehta. 20 vende për dy mandatet e para do të jenë të rezervuara për 10 vende që do t'u ndahen partive, koalicioneve, etj., që deklarohen serbë, kurse 10 vendet e tjera do t'u ndahen komuniteteve të tjera që janë të pranishme në Kosovë.³⁸⁴ Një formulim i tillë është bërë në bazë të asaj që Kosova, siç është thënë, parashihet të jetë multietnike. Neni 4 parasheh se Kosova do të ketë kryetarin e vet që paraqet unitetin e popullit dhe ky do të zgjidhet nga Parlamenti i Kosovës. Neni 5 parasheh organizimin e qeverisë së Kosovës, ku në mënyrë të qartë parashihet përfaqësimi i komunitetit serb në nivel qeverie. Neni 6 përshkruan organizimin e gjykatës kushtetuese dhe të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Për më tepër përshkruhen edhe kriteret e zgjedhjes së gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese dhe për përbërjen e gjykatës. Është me rëndësi se tre gjyqtarë të gjykatës kushtetuese do të jenë ndërkombëtar dhe këta të tre zgjidhen nga Kryetari i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut pas këshillimit me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar. Gjithnjë sipas këtij neni parashihet edhe formimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, institucione që nuk kishin ekzistuar më parë. Neni 7 parasheh dispozitat për themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të përbërë prej nëntë anëtarëve, ndërsa kryetari i komisionit do të emërohet nga Kryetari i Kosovës nga radhët e Gjykatës Supreme të Kosovës. Neni 8 flet për decentralizimin e komunave, duke përcaktuar kompetencat e komunave dhe parasheh se ato kanë të drejta bashkëpunimi ndërkomunal tejkufitar lidhur me kompetencat vetanake dhe të zgjeruara. Neni 9 flet për çështje ekonomike, ku parashihet sesi Kosova do të ketë valutën dhe parasheh se Kosova do të ketë autoritet të pavarur qendror bankar. Sa i përket amandamentimit të kushtetutës (neni 10) parashihet se ato mund të aprovohen me dy të tretat e deputetëve përfshirë edhe dy të tretat e deputetëve me vende të rezervuara. Neni 11 përbëhet nga dispozitat kalimtare ku kërkohet nga autoritetet kosovare që të përligjësojnë vendimet e autoriteteve ndërkombëtare që kanë mandat për të mbikëqyrur zbatimin e marrëveshjes.

Aneksi 2: Të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre

Aneksi 2 me katër nene rregullon çështje të cilave u është kushtuar shumë vëmendje edhe gjatë negociatave në mënyrë që të sanksionohen me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Flitet dhe u

³⁸³ Po aty.

³⁸⁴ Shih nenin 3 të Aneksit 1 i Dispozitave Kushtetuese.

kushtohet rëndësi të gjitha komuniteteve, ndërsa tregohet përkujdesje e veçantë për komunitetin serb. Rregullohen çështjet e përdorimit të gjuhëve, emërtimeve, simboleve dhe përdorimit të tyre, etj.

Në mënyrë ultimative Pakoja e Ahtisaarit paraqet maksimumin e koncesioneve që mund të nxirren nga popullata shumicë 90% shqiptare në favor të që përbëjnë afërsisht 7% të popullatës.³⁸⁵

Aneksi 3: Decentralizimi

Çështjet e decentralizimit dhe trashëgimia kulturore sikundër të drejtat e komuniteteve kanë marrë më së shumti kohë dhe përkushtim nga marrëveshja. Çështjes së decentralizimit i janë kushtuar 14 nene në këtë aneks dhe çështje që më së shumti kanë krijuar paqartësi dhe që kanë ngritur dilema është çështja e bashkëpunimit të komunave që krijohen në baza etnike serbe me Republikën e Serbisë (neni 10) dhe financimi i aktiviteteve komunale nga Republika e Serbisë. Është bërë debat lidhur me këtë çështje dhe debati vazhdon edhe sot e kësaj dite lidhur me këto çështje ku jo rrallë komunitete të tjera ,që jetojnë në Kosovë, janë ankuar për pozitën e favorizuar të serbëve karshi pozitive të tyre. Pastaj debati pro e kundër ka vazhduar dhe ka vazhduar sepse aktivitetet e Republikës së Serbisë, qoftë edhe në mënyrë të tillë duke përkrahur financiarisht komunat serbe, kanë shkelur rëndë mëvetësnë apo sovranitetin e Kosovës. Kujdes i veçantë me marrëveshje i kushtohet edhe qytetit të Mitrovicës, qytet që ndahet në dy pjesë: komuna e Mitrovicës dhe komuna e Mitrovicës së veriut, për të cilat do të krijohet një bord i përbashkët. Sidoqoftë, kur jemi këtu le të shohim çka thuhet në raportin e ICG-së. “Ahtisaari konfirmon veçantinë e komunave me shumicë serbe duke iu dhuruar atyre “kompetenca të përforcuara”. Mitrovica e Veriut është dizajnuar të jetë dhënës i arsimit të lartë; Mitrovica e Veriut, Graçanica dhe Shterpce do të japin shërbime shëndetësore. Grantet e bllok të tyre do të garantojnë këto lehtësime. Të gjitha komunat me shumicë serbe do të ushtrojnë monopol ndaj politikave kulturore brenda kufijve të tyre dhe do të kenë kontroll të madh në zgjedhjen e shefave të policisë së këtyre komunave. Propozimi më tutje u jep të drejtë këtyre komunave të

³⁸⁵ Vlerësohet se në Kosovë jetojnë 130.000 serbë në përbërje të popullatës me rreth 2 milionë. Regjistrimi i fundit i popullatës ku bashkëpunuan të gjitha komunitetet ishte ai i vitit 1981. Nëse në Kosovë do të ktheshin të gjithë serbët që kanë ikur nga vitit 1999, proporcioni i serbëve do të rritej në rreth 10 dhe 12%. Marrë nga: Raportin *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë, Beograd, New York Brussels, 2007.

bashkëpunojnë me Institucionet e Qeverisë së Serbisë përmes marrëveshjeve të partneritetit. Serbia gjithashtu mund të dërgojë fonde te komunat serbe dhe kjo do të bëhet përmes Bankave Kosovare të licencuara...³⁸⁶

Aneksi 3, ka shtojcën e cila paraqet zonat kadastrale në të cilat do të formohen komunat serbe: Graçanica, Ranilluga, Kllokoti, Novobërda dhe Mitrovica e Veriut.

Aneksi 4 rregullon çështjen e gjyqësorit të Kosovës, jep rregullat e krijimi të gjyqësorit dhe elemente të rëndësishme janë pos të tjerash krijimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Aneksi 5: Ky aneks, që flet për trashëgiminë kulturore, më shumë është hartuar duke iu referuar Kishës Ortodokse Serbe. Shkaqet e një referimi të tillë besohet se janë vënë për balancë, me thirrjet e serbëve “për të drejtat e tyre historike”. Aa do të kënaqeshin kur me norma kushtetuese po sanksionohet një “e drejtë historike e tyre”. Besohet më shumë se një formulim i tillë ka karakter politik, sepse janë historianët ata që kanë shkruar mjaft për atë se çka është “djepi dhe shpirti” i një kulture. Me këtë rast nuk do ndalemi të sqarojmë kultin, mitin dhe legjendën që, në momente të caktuara të historisë së Ballkanit, ka prodhuar vetëm fatkeqësi. E kanë treguar historianët dhe besoj do ta tregojnë edhe më shumë në të ardhmen. Sidoqoftë, vetë aneksi është mjaft i mjegullt dhe i paqartë dhe prandaj krijon një pabarazi në mes komuniteteve tjera, sepse serbët vihen në pozitë më të barabartë sesa komunitetet e tjera. Pothuaj i tërë aneksi flet për Kishën Serbe e cila në të njëjtën mënyrë paraqitet mbi objektet tjera fetare, edhe pse Kosova ndërtohet si shtet pa fe zyrtare. Aneksi i klasifikon edhe zonat e mbrojtura, të cilat kanë përmasa e karakteristika gjeografike. Përreth këtyre zonave ndalohen veprimtari të caktuara, varësisht nga hapësira dhe kështu disa objekte kufizohen me një zonë 50 metra të mbrojtur, disa me njëqind³⁸⁷ dhe kështu me radhë. Lidhur me këtë çështje, do të formohet Këshilli për Implementim dhe Monitorim, i cili do të kryesohet nga personi që do të caktohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Aneksi 6 rregullon çështjet e borxheve, sipas të cilit Kosova do të marrë përsipër borxhin e vet të borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë, që ndërmjet të tjerash përfshin borxhin ndaj

³⁸⁶ Shih : Raportin *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari Plan*, ICG – International Crisis Group, Europe Report nr.182, Prishtinë, Beograd, New York, Brussels, 2007.

³⁸⁷ Shih më gjerësisht neni 4 i Aneksit 5 Trashëgimia Kulturore dhe Fetare.

Bankës Botërore dhe të kreditorëve të Londrës dhe të Parisit. Në rast mosmarrëveshje lidhur me borxhet në mes të Kosovës dhe Serbisë, atëherë këto çështje do të rregullohen nga një arbitër që do të caktohet nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar.

Aneksi 7 rregullon çështjet e pronës dhe të arkivit, sipas të cilit të drejtat e pronësisë në ndërmarrjet publike dhe obligimet e ndërlidhura, duke përfshirë, por jo duke kufizuar detyrimet para korporatizmit, do t'i transferohen Kosovës....pavarësisht nga këto të drejta pronësore, organet kompetente të Kosovës marrin masa të duhura për implementimin e parimeve të Bashkimit Europian për qeverisjen dhe liberalizimin e korporatave.³⁸⁸ Sipas nenit 2 ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre do të administrohen nga institucioni pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Aneksi 8: Sektori i sigurisë në Kosovë, është ndër sektorët e rëndësishëm të shtetësisë dhe pakoja sjell disa risi krahasuar me atë që kishim më parë. Parashihet themelimi i një komisioni parlamentar të sigurisë, pastaj parashihet krijimi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili i raporton kryeministrin të Kosovës dhe zhvillon strategjinë e sigurisë në përputhje me pakon. Sa i përket çështjes së policisë, pakoja i kushton rëndësi të veçantë çështjes së angazhimit të komuniteteve dhe, në komunat me shumicë serbe, përcakton rregulla të veçanta për zgjedhjen e komandantëve të policisë. Neni 4 i këtij aneksi parasheh themelimin e Agjencisë Kosovare të inteligjencës, që do t'i monitorojë kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës në përputhje me aneksin 9. Me nenin 5 parashihet themelimi i një forceje profesionale shumetnike – Forca e Sigurisë së Kosovës. Fillimisht kjo forcë parashihet se do të merret me krizat, me asgjësimin e mjeteve eksplozive dhe me mbrojtjen civile. Neni 6 rregullon çështjen e shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (trashëgimtarët e UÇK-së së dikurshme).

Aneksi 9: Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Duke qenë se Kosova ka për të përmbushur këtë marrëveshje, atëherë një përfaqësues civil ndërkombëtar³⁸⁹ do të mbikëqyrë dhe do të mbështetë përpjekjet e autoriteteve të Kosovës në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesi civil ndërkombëtar do të jetë autoriteti final që do të interpretojë dispozitat e pakos, do të sigurojë zbatim efektiv të kësaj pakoje, do të ndërmarrë masa korrigjuese për të përmirësuar, nëse ka

³⁸⁸ Shih neni 1 Aneksi VI Ndërmarrjet Publike i Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

³⁸⁹ Neni 146 dhe neni 147 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga Kreu XIV, te dispozitat kalimtare përshkruan autoritetin dhe autorizimet e përfaqësuesit ndërkombëtar civil.

nevojë çdo veprim që ndërmerret nga autoritetet kur vlerëson se aktet e autoriteteve kosovare rrezikojnë seriozisht sundimin e ligjit, përfaqësuesi do të ketë autoritetin të sanksionojë apo të largojnë nga detyra çdo zyrtar publik ose ka të drejtë të ndërmarrë masa të tjera, për të siguruar respektimin e pakos. Përfaqësuesi ka autoritet gjithashtu për të emëruar auditorin e përgjithshëm, i cili do të jetë ndërkombëtar, si dhe një anëtar në bordin e trustit të kursimeve pensionale të Kosovës, në zgjedhjen e bartësve të funksioneve, po ashtu përfaqësuesi ndërkombëtar do të japë pëlqimin për zgjedhje.³⁹⁰ Me nenin 3 të këtij aneksi rregullohet koordinimi me aktorët ndërkombëtarë, neni 4 rregullon strukturën e stafit në zyrën e përfaqësuesit civil ndërkombëtar, kurse neni 5 rregullon çështjet e zvogëlimit dhe mbarimit të mandatit të përfaqësuesit, i cili do të përfundojë kur Grupi Ndërkombëtar Drejtues³⁹¹ të konstatojë se janë përmbushur kushtet e kësaj marrëveshjeje.

Shtojca 10 ka të bëjë me Misionin European për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Aneksi 11 ka të bëjë me praninë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, e cila do ta sigurojë nga rreziqet e jashtme, përderisa institucionet nuk kanë marrë atë përgjegjësi, do të ofrojë mjedis të sigurt në gjithë territorin e Kosovës, mbikëqyrjen dhe mbështetjen e themelimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës, do të ofrojë ndihmë dhe këshilla në procesin e integritimit në strukturat euroatlantike.

Aneksi 12 i pakos jep një listë ligjesh të cilat duhet të nxirren nga parlamenti i Kosovës në periudhën e tranzicionit dhe pas kësaj periudhe.

5.4.2. Kushtetuta e Kosovës dhe raporti me Propozimin Gjithëpërfshirës

Çështjen se kush do të ishte grupi që do të hartonte kushtetutën e Kosovës, e ka përcaktuar Ahtisaari duke propozuar një grup prej 21 anëtarësh dhe ky grup do të kishte detyrë që të hartonte një kushtetutë të mirë dhe këtë brenda 120 ditëve. Kjo nuk ishte e lehtë dhe nuk mund të duronte komoditetin e garës politike se kush do të ishte përfaqësues dhe i kujt në këtë komision. Rolin më të madh në proces të hartimit të kushtetutës do ta ketë zyra amerikane dhe USAID-i. Teksti i kushtetutës është bërë publik dy ditë pas shpalljes së pavarësisë. Pastaj teksti i kushtetutës është certifikuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar me 2 prill dhe kushtetuta u

³⁹⁰ Shih më gjerësisht nenin 1 dhe 2 të Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, Pakoja Ahtisaari.

³⁹¹ Grupi Drejtues Ndërkombëtar do të përbëhet nga: Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe, SHBA, BE, Komisioni European dhe NATO-shih më shumë neni 4.1. në aneksin 9.

miratua nga Parlamenti i Kosovës me 9 prill 2008 për të hyrë në fuqi me 15 qershor 2008. Kushtetuta e Kosovës është përpiluar në mënyrë të tillë që të mos iu shmanget obligimeve të pakos së Ahtisaarit dhe nuk karakterizohet si një akt juridiko – politik voluminoz. Gjithsej ka 14 krerë me 162 nene. Kur të analizohet çështja e karakterit të kësaj kushtetute, duhet menduar nëse këtu fillon ndërtimi i shtetit të Kosovës, apo ka ekzistuar edhe më herët. Kosova kishte nxjerrë kushtetutën e vet edhe gjatë procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave, por Kosova ka pasur kushtetutë edhe gjatë kohës kur ishte subjekt i federalizmit, siç është folur më herët. Se a është vetëm kjo kushtetutë me karakter shtetndërtues, apo të tilla i kishim edhe ato të mëparmet, duhet diskutuar më gjerë. Jam i mendimit se kjo kushtetutë duhet vënë në kontekst të të gjithë procesit të pavarësimit të Kosovës, ndryshe nuk do të kemi mundësi të përdorim argumentet historike në raport me nevojat e sotme, sidomos për njohje më të shumta. Argumente të cilat edhe janë përdorur tepër shumë, ndërkohë që ka pasur argumente tepër të favorshëm. Profesor, Arsim Bajrami, thotë: “si rregull karakter konstitutiv dhe themelues kanë aktet e para me të cilat një shtet themelohet, ose pavarësohet për herë të parë...model tipik për këtë është Kushtetuta e Republikës së Kosovës që themeloi shtetin tonë të pavarur”.³⁹² Kjo kushtetutë, me specifikat e saj i shërben forcimit të shtetit të Kosovës dhe pozicionimit më të fuqishëm ndërkombëtar. Në rrethanat e jashtme dhe të brendshme të nxjerrjes së saj, ajo gjen zgjidhjen optimale duke e përshkruar Kosovën si shtet të qytetarëve dhe duke ofruar mbrojtje të veçantë për komunitetet në pakicë. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, problemi i sovranitetit trajtohet nga një këndvështrim bashkëkohor, në përputhje me prirjet integruese, që janë karakteristikë e vendeve të sotme evropiane, dhe që u përgjigjen dhe aspiratave të popullit të Kosovës, sikurse dhe popujve të tjerë të kontinentit tonë.³⁹³ Pavarësia e Kosovës, që është kurorëzuar me 17 shkurt 2008, nuk është akt i thjeshtë unilateral, por është aktivitet i bashkërenditur dhe i koordinuar me mekanizma ndërkombëtarë dhe rezultat i bisedimeve të formave të ndryshme me Serbinë, si dy ish- njësi të Federatës Jugosllave, edhe pse bisedimet nuk kanë rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjeve nga ana e Serbisë. Ajo nuk ka pranuar Rambujenë dhe nuk ka pranuar Ahtisaarin, ndërkohë që Kosova që të dyja i ka pranuar. Rrjedhimisht Kosova ka pranuar edhe që të jetë e mbikëqyrur ndërkombëtarisht, dhe kështu “Kushtetuta e Republikës së Kosovës promovon një

³⁹² Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.148.

³⁹³ Luan Omari, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues*, Dudaj, Tiranë, 2009, fq.11.

koncept të sovranitetit të kufizuar, përkatësisht të një shteti me pavarësi të mbikëqyrur“.³⁹⁴ Dhe mbikëqyrja buron nga pakoja e Ahtisaarit, që është burim i Ahtisaarit dhe që “burimi i këtij obligimi është vetë kufizimi i sovranitetit që kishte ofruar Kosova në Deklaratën e Pavarësisë“.³⁹⁵ Obligimet i Kosovës për t’iu nënshtruar supremacisë së Pakos së Ahtisaarit janë të pranishme në të gjithë kushtetutën, por po veçojmë dy krerë ku mendohet se Kosova ka avancuar në kuptimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve. Të drejtave të njeriut i kushtohet rëndësi e veçantë. Krahas gjenden dhe gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë, duke pasur përparësi në rast konflikti me ligjin vendor, edhe këto akte ndërkombëtare: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me të gjitha protokollet e veta; Konventa Kornizë e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.³⁹⁶

Me Kushtetutën e Kosovës, pakicat kombëtare nuk emërtohen sikurse zakonisht njihen në vende ku gëzojnë mbrojtje të veçantë. Kushtetuta e Kosovës në këtë kuptim përdor termin komunitetet dhe pjesëtarët e tyre. E si komunitete që njihen në Kosovë janë: komuniteti serb, komuniteti boshnjak, komuniteti turk, komuniteti goran, komuniteti rom, komuniteti ashkali, komuniteti egjiptian. Me neni 57 (Parimet e Përgjithshme) të Kushtetutës komunitete konsiderohen banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës, që gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në kreun II të kësaj Kushtetute. Në pikën 2 të këtij neni thuhet se çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjidhë lirisht nëse do të trajtohet ose nuk do të trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim. Neni 59 i numëron në 14 pika të drejtat e komuniteteve duke filluar nga të drejtat për të shprehur identitetin e vet, gjuhën, fenë, traditat, arsimimin në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës sipas përzgjedhjes së

³⁹⁴ Arsim Bajrami, *Sistemi Kushtetues i Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.149.

³⁹⁵ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.407.

³⁹⁶ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës – Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare.

tyre, të themelojnë dhe të menaxhojnë institucione private të arsimit, të përdorin gjuhën e tyre në jetë publike dhe private, të përdorin dhe të shfaqin simbolet, të regjistrojnë emrat në formën e tyre origjinale, të krijojnë medie të tyre, të krijojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës, etj. Një mekanizëm i veçantë në kuptimin e mbrojtjes dhe të avancimit të pozitës së komuniteteve themelohet sipas Kushtetutës me emërtimin Këshilli Konsultativ për Komunitete. Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe aty përfaqësohen të gjitha komunitetet. Ky këshill sipas Kushtetutës ofron një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë së Kosovës; mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.³⁹⁷

Krahas kësaj që u tha më lart për komunitetet, atyre u garantohet edhe pjesëmarrje me vende të rezervuara në Parlament të Kosovës në dy mandatet e para të tij. Kështu nga 120 vende që ka Parlamenti i Kosovës, 10 janë të ndara për nismat, partitë, koalicionet, kandidatët e pavarur që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb nëse numri i vendeve të fituara është më i vogël se 10, kurse 10 vendet e tjera ndahen në: komuniteti rom (1), komuniteti ashkali (1), komuniteti egjiptian (1), dhe një vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali ose egjiptian që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme, komuniteti boshnjak (3), komuniteti turk (2) dhe komuniteti goran (1), nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.³⁹⁸ Përfaqësimi i komuniteteve nuk përfundon me kaq, sepse ka rregulla të veçanta të përfaqësimit të tyre në struktura qeveritare në të gjitha hallkat e pushtetit në Kosovë.

Raporti në mes të Pakos së Ahtisaarit nxirret varësisht nga këndvështrimi që do të kemi ndaj këtyre dy akteve juridike. Fakti se pakoja e Ahtisaarit emërtohet si propozim, për Kosovën del se në tërësinë e vet është obligim sepse, siç është theksuar në rast kolizioni në mes këtyre dy akteve, supremacionin do ta ketë pakoja. Në anën tjetër, pjesët e pakos janë inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës, ku janë zbërthyer dhe zgjeruar, por në asnjë moment jo jashtë frymës dhe qëllimeve

³⁹⁷ Shih nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

³⁹⁸ Shih nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

të pakos. Pakoja si dokument edhe sikur ta marrim krejtësisht të imponuar, ka rëndësinë e vet historike dhe praktike nga e cili mund të veçojmë:

- *Hapjen e rrugës për statusin përfundimtar;*
- *Bërjen e Kosovës me kushtetutë si aktin më të lartë juridik;*
- *Hapjen e rrugës për shfuqizimin e Rezolutës 1244 dhe qartësimin e gjendjes e cila ishte krijuar nën administrimin shumëvjeçar ndërkombëtar;*
- *Bërjen e Kosovës me simbole shtetërore;*
- *Krijimin e mundësive për krijimin e një force të re të sigurisë, e cila realisht është ushtria e ardhshme e Kosovës; dhe*
- *Sendërtimin e parimeve të grupit të kontaktit.*³⁹⁹

Pakaja e Ahtisaarit krijon edhe vështirësi e paqartësi, që në radhë të parë janë të natyrës praktike. Ajo krijon decentralizim etnik, me çka rrezikon të bëjë ndarje etnike të thella, që dalin si qëllim i kundërt me atë që është e detyruar, krijimi i zonave të mbrojtura në një Kosovë me shumë komunitete dhe në një territor kaq të vogël, krijon bazë për pabarazi dhe asimetri në të drejta; pakicat në një mënyrë favorizohen duke marrë forma të pozitës së privilegjuar; Kosova nuk ka sovranitet të plotës, sepse pushteti i saj mbetet i kufizuar nga pushteti ndërkombëtar në Kosovë.

Mund të ndalemi duke numëruar vështirësi praktike nga më të ndryshmet, por pavarësisht nga të gjitha këto, Kosova ka bërë mirë që ka aprovuar pakon Ahtisaari, që për momentin kur është hartuar ka qenë e vetmja rrugë për ta çuar Kosovën drejt përfundimit të procesit të pavarësisë. Në fund të fundit, edhe një shtet me potencial të madh ekonomik, politik, ushtarak e çfarë jo, në kohët moderne nuk mundet të bëjë dhe të arrijë qëllimet e veta pa u dakorduar dhe pa interaktivitet me bashkësinë ndërkombëtare. Fundja ne e kemi shpallur pavarësinë. Pse kërkojmë njohjen e shtetit tonë nga të tjerët? Le t'i japim përgjigjet më poshtë.

³⁹⁹ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011, fq.97.

KREU VI: Sfidat e reja të Kosovës së Pavarur

6.1. Njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës

Bashkësia Ndërkombëtare nuk është një entitet i pandryshueshëm, por është subjekt i dobësimit dhe i rrjedhës së jetës politike.⁴⁰⁰ Qysh se ekzistojnë mekanizmat e quajtur shtete, historia njih raste kur shtete të reja krijohen, ndërkohë që të tjera zhduken. Disa pushtohen për një kohë të shkurtër ose edhe të gjatë, të tjerat kolonizohen dhe pastaj ndodhë shkolonizimi. E drejta ndërkombëtare merret me çështjen, kur shteti faktikisht paraqitet. Nuk ka rëndësi se në ç'mënyrë është krijuar shteti: a është krijuar në pajtim me rendin ekzistues juridik të brendshëm apo ndërkombëtar.⁴⁰¹ Kur shteti të paraqitet faktikisht, vetëm atëherë konsiderohet se kemi një pikënisje për një gjendje juridike. E sesi mund të definohet shteti, ka shumë teori dhe mendime, nga të cilat po zgjedhim vetëm dy: shteti është institucion i krijuar nga grupi për realizimin e disa qëllimeve, nga të cilat më e rëndësishmja është ruajtja e së drejtës dhe rendit brenda kufijve dhe ruajtja e pavarësisë së popullit në marrëdhënie me popujt e tjerë⁴⁰², apo shteti është një lloj personi juridik i njohur nga e drejta ndërkombëtare.⁴⁰³ Por cilat janë disa nga kushtet themelore, që ky institucion, apo ky person juridik duhet t'i plotësojë, në mënyrë që të konsiderohet se faktikisht ekziston dhe pse është e rëndësishme njohja e shtetit të ri, të krijuar faktikisht, nga shtete të tjera apo nga Bashkësia Ndërkombëtare? Kur mund të konsiderohet se Kosova u krijua faktikisht shtet dhe pse njohjet janë kaq të rëndësishme për Kosovën.? A kishte Kosova të drejtë në krijimin e shtetit të vet dhe cilat janë argumentet në të cilat bazohen shtetet kur ngurrojnë të njohin Kosovën si shtet të pavarur? A ishte shpallja e Pavarësisë akt unilateral apo akt i koordinuar ndërkombëtarisht? U krijua Kosova shtet në bazë të një procesi shkolonizimi apo u krijua nga ndonjë mekanizëm ndërkombëtar? Apo asaj iu dhurua pavarësia? Këto janë çështje që kanë zënë vend në debatet politike, diplomatike dhe akademike brenda dhe jashtë Kosovës.

⁴⁰⁰ Shih në përgjithësi, për shembull, Të Drejtën Ndërkombëtare, Oppenheim botimi i nëntë, London 1992 (...) Lauterpacht, *Recognition in International Law*, Cambridge 1947(...), T.C. Hen, *The International Law of Recognition*, 1951 (...) cituar nga: Malcolm N. Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq. 367.

⁴⁰¹ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan ISM-Shkup, 2007, fq. 71-72.

⁴⁰² Svarlien, cituar nga: Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan ISM-Shkup, 2007, fq. 69.

⁴⁰³ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, 2003, fq. 69.

Procesi i krijimit të shtetit të Kosovës është i gjatë dhe ai përfundon me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, e cila u bë me 17 shkurt të vitit 2008. Kurse procesi i shtetndërtimit vazhdon bashkë me procesin e njohjes ndërkombëtare. Njohja ndërkombëtare e shtetit të Kosovës, që nga shpallja e Deklaratës së Pavarësisë, është kërkesë, por edhe objektive e strukturave të Republikës së Kosovës, ndërsa njohjet janë realizuar, por jo pa vështirësi. Vala e parë e njohjeve, menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë, është realizuar shpejt. Përmbajtësisht, kjo është vala më e rëndësishme e njohjeve, sepse në këtë fazë Kosova është njohur nga shtetet më të rëndësishme perëndimore, si SHBA, Britania e Madhe, Franca, Kanadaja, Gjermania, Italia, etj. Por procesi, pas valës së parë është realizuar më ngadalë, ku shtete të ndryshme të globit kanë njohur shtetin e Kosovës, ndërkohë që të tjerat kanë kundërshtuar qoftë me heshtje, qoftë me reagime, për të parandaluar njohjet e reja. Këto mund të kategorizohen si vështirësi nga jashtë, kurse vështirësi ka edhe nga brenda dhe kjo shkak të veprimit anemik të institucioneve të Kosovës, garës politike brenda strukturave të shtetit për të marrë primatin e njohjes, por edhe nga shkak se iu mungonte shkathtësia e duhur për ushtrimin e funksionit të diplomatit. Le të shohim nëse njohja për Kosovën ka më shumë rëndësi politike apo ka më shumë rëndësi për efektet që prodhon akti i njohjes.

Që nga kërkesa e hapur për njohjen e Republikës së Kosovës shtetet janë ndarë në grupe: shtetet që kanë reaguar menjëherë dhe e kanë njohur zyrtarisht atë, pastaj grupi i shteteve që janë hamendur, por që gradualisht kanë ndërruar mendjen dhe e kanë njohur dhe i treti, grupi që deklarohet kundër njohjes së Kosovës. Pra është e qartë se “Problemi i njohjes së shteteve dhe qeverive nuk ka siguruar satisfaksion as në teori dhe as në praktikë. Vështirë të ketë ndonjë çështje më kontraverse sesa kjo apo që praktikisht i çon shtetet te një situatë paradoksale”.⁴⁰⁴ Janë bërë një numër i madh përpjekjesh që të adaptohet teoria konstitutive. Lauterpacht mban qëndrimin, p.sh., që nëse një herë janë plotësuar kushtet e përshkruara nga e drejta ndërkombëtare për shtetshmëri, atëherë është detyrë e shteteve të tjera që të japin njohjen. Kjo ngase në mungesë të autoritetit qendror në të drejtën ndërkombëtare, që të masë dhe shpallë personalitetin juridik, atëherë janë shtetet ato që këtë e bëjnë në emër të së drejtës ndërkombëtare

⁴⁰⁴ Hans Kelsen, “*Recognition in International Law: Theoretical Observations*”, (1941) 35 AJIL 605, at 605, cituar nga: Cedric Ryngeart & Sven Sobrie, Recognition of States: International Law or Realpolitik? The Practice of Recognition in the Wake of Kosovo, South Ossetia and Abkhazia, *Leiden Journal of International Law*, 24 (2011), pp.467-490, Foundation of the Leiden Journal of International Law, doi:10.1017/S0922156511000100, fq.24 - marrë nga Cambridge Journals/shkarkuar me: 10 maj 2011.

dhe të bashkësisë ndërkombëtare.⁴⁰⁵ John Dugard e zgjeron teorinë e Lauterpach-ut, por ka gjetur detyrimin për njohje me pranim në OKB.⁴⁰⁶ Sipas teorisë konstitutive, shteti ekskluzivisht bëhet person ndërkombëtar dhe subjekt i të drejtës ndërkombëtare përmes njohjes.⁴⁰⁷ Por përballë teorisë konstitutive për njohjen e shteteve qëndron teoria deklarative e njohjes së shteteve. Praktika lidhur me njohjen e shteteve të reja gjatë shekullit 20 sugjeron se njohja luan më shumë sesa një rol evidentimi.⁴⁰⁸ Teoria deklarative ka një qasje të kundërt dhe është pak më shumë në pajtim me realitetet praktike. Kjo mban qëndrimin se njohja është kryesisht pranim nga shtetet të një situatë e cila veçse ekziston. Shteti i ri fiton kapacitetin në të drejtën ndërkombëtare jo me virtyte pëlqimi nga të tjerët, por nga virtytet e një situatë faktike.⁴⁰⁹ Kurse njohja ka rëndësi për të dyja palët: për shtetin që kërkon njohjen në njërin anë dhe për bashkësinë ndërkombëtare dhe për shtetet e tjera që do të njohin shtetin e ri, në anën tjetër. Ka diçka që është praktikë thelbësore e shteteve prapa pikëpamjeve deklarative. Shtetet e panjohura janë zakonisht dhe shumë shpesh objekt i kërkesave ndërkombëtare, i akuzave të agresionit dhe i shkeljeve të tjera të Kartës së OKB-së nga ana e shteteve që refuzojnë të bëjnë njohjen.⁴¹⁰ Nëse analizohet pozita e Kosovës dhe nëse kërkohen shkaqet pse, ta zëmë, Serbia reziston të njohë Kosovën, atëherë ky konstatim qëndron plotësisht. Një aspekt tjetër është se Kosova shumë shpesh bëhet objekt i kërkesave ndërkombëtare, duke qenë në të njëjtën kohë shtet i mbikëqyrur ndërkombëtarisht dhe duke e ndarë sovranitetin e vet në fusha të rëndësishme me ndërkombëtarët.

Derisa sipas teorisë *konstitutive*, shteti do të bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare me aktin e njohjes, pasi të jetë konsideruar se shteti i ri i ka plotësuar kushtet e parashtruara, *teoria deklarative* e konsideron se shteti para njohjes fiton subjektivitetin ndërkombëtar, nëse i ka plotësuar kushtet që ia ka parashtruar e drejta ndërkombëtare, kushte për të cilat do të flasim më poshtë.

⁴⁰⁵ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.372-373.

⁴⁰⁶ Hersch Lauterpacht, Recognition in International Law 1947-cituar nga William Thomas Worster, LAW, POLITICS, AND THE CONCEPTION OF THE STATE IN STATE RECOGNITION THEORY, <http://128.197.26.34/law/central/jd/organizations/journals/international/volume27n1/documents/Worster.pdf>, fq.7, qasur me dt.20 janar 2014.

⁴⁰⁷ Oppenheim, *International Law* (8-th edition, Vol I, 1955) para 71 in D. J Harris Cases and Materials on International Law (5-th edition, Sweet&Maxwell, 1998)145.

⁴⁰⁸ Thomas Grant *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution* Plaeger Publishers 1999, 22.

⁴⁰⁹ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.369.

⁴¹⁰ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, 2003, fq.87.

Teoria deklarative është më e drejtë dhe më shumë i përgjigjet kërkesave të kohës dhe realitetit ndërkombëtar. Me njohje, një shtet deklaron se sipas mendimit të tij shteti i ri i plotëson kushtet e shtetësisë që i parashtron e drejta ndërkombëtare.⁴¹¹ Sipas M.Shaw “praktika aktuale çon kah një pozicion i mesëm në mes të këtyre dy perceptimeve”.⁴¹² E drejta ndërkombëtare nuk parasheh rregulla, të cilat obligojnë një shtet që të bëjë njohjen e shtetit të ri. Kjo mbetet thjesht akt diskrecioni i shtetit individual që të vendosë nëse do të njohë apo do të refuzojë të njohë shtetin e ri. Këtu kemi të bëjmë më shumë me një akt të thjeshtë politik, për të cilin shteti vendos të akordojë njohjen ose mosnjohjen dhe kjo nuk ka të bëjë me veprim arbitrar të një shteti të caktuar. Departamenti i shtetit të SHBA-së në vitin 1976, shprehej se e drejta ndërkombëtare nuk kërkon nga shtetet që të njohin entitetin tjetër si shtet. Është një çështje e vlerësimit se a e meriton një entitet të njihet si shtet. Në marrjen e vendimit lidhur me këtë, SHBA tradicionalisht shikon nëse ekzistojnë: 1) kontrolli efektiv mbi territorin e përcaktuar qartë dhe mbi popullsinë, 2) administrata e organizuar qeveritare, 3) aftësia me vepruar efektivisht në drejtimin e marrëdhënieve të jashtme dhe 4) dëshira për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare.⁴¹³ Njohja ndërkombëtare e shtetit të ri është kryesisht akt i oportunitetit politik. Ç’është e vërteta, ekzistojnë normat e së drejtës ndërkombëtare të cilat “postulojnë fakte të caktuara për njohjen e shtetit të ri”. Ato janë: a) efikasiteti i pushtetit të ri; b) pavarësia dhe c) qendërsimi i rendit juridik.⁴¹⁴

Njohja e shteteve bëhet në forma të ndryshme. Ndër më të përmendurat janë njohja *de iure* dhe njohja *de facto*. Ndarja e këtyre formave nuk ka ndonjë karakter të caktuar, kjo sepse e drejta ndërkombëtare nuk ka norma të qarta për këtë çështje. Njohja *de facto* është një njohje jo e plotë dhe e përkohshme. Shteti që bën njohjen *de facto*, tregon në këtë mënyrë dëshirën për të hyrë në disa marrëdhënie të kufizuara me shtetin e ri, marrëdhënie jo të plota dhe të paqëndrueshme, duke menduar se shteti i ri nuk është ende i konsoliduar mirë. Në qoftë se shteti i ri nuk është në gjendje t’i rezistojë provës dhe zhduket ashtu sikurse lindi, shteti që ka bërë njohjen *de facto* e tërheq atë.⁴¹⁵ Njohja *de facto* përfshin një vlerësim hezitues të situatës, një qëndrim të asaj çka shohim, që të trashëgohet me njohjen *de iure*, kur dyshimet janë tejkaluar

⁴¹¹ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan, ISM-Shkup, 2007, fq.79.

⁴¹² Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.369.

⁴¹³ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan, ISM-Shkup, 2007, fq.79-80.

⁴¹⁴ Hans Kelsen, “*Opsta teorija prava i drzave*”, Beograd, 1950, cituar nga Esat Stavileci, Vepra XVII, Prishtinë, 2013, fq.264.

⁴¹⁵ Arben Puto, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Botimi i dymbëdhjetë, Dudaj, Tiranë (pa vit botimi), fq.177.

esencialisht për t'u zgjeruar me pranim formal.⁴¹⁶ Njohja de iure konsiderohet si njohje e plotë. Shteti që akordon këtë lloj të njohjes, këtë e shpreh përmes një akti formal dhe parimisht kjo njohje është e parevokueshme. Megjithatë në kuptimin politik që të dyja format e njohjes mund të revokohen: në kuptimin juridik kjo nuk mundet të bëhet përderisa ndryshimi i rrethanave imponon këtë.⁴¹⁷ Në të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare vërehen tendenca të heqjes së dallimeve në mes këtyre dy formave të njohjes, sepse përdorimi i njohjes de facto ka mundësuar paraqitjen e pazarllëqeve në njohjen apo mosnjohjen e shteteve të reja.

Shteti i ri, më tutje njihet nga shteti që akordon njohje, me anë të një akti të njëanshëm. Mund të jetë me telegram, me deklaratë të shefit të shtetit, me notë diplomatike, që i dërgohet shtetit me të cilin njoftohet se pranohet, ose me një traktat ndërkombëtar.⁴¹⁸ Në këtë rast kemi të bëjmë me njohjen që bëhet shprehimisht, dhe që në fakt shtetet më së shumti e preferojnë. Por njohja e shtetit bëhet edhe pa u shprehur në formë të një akti unilateral. Një shtet lidh marrëveshje me shtetin e ri, pranon konsuj të shtetit të ri, pranon dhe dërgon përfaqësues diplomatik⁴¹⁹ dhe kur këto veprime ndërmerren realisht, ndërkohë që nuk është bërë njohja përmes ndonjë akti formal, kemi të bëjmë me njohjen *e heshtur apo heshtazi*.

Në të drejtën ndërkombëtare ekziston edhe një ndarje e vështirë dhe e paqartë në mes të pranimi të njohjes së shtetit të ri, në veçanti të atij që ka dalë apo që po del si rezultat i shkëputjes dhe ndërhyrjes në çështjet e brendshme të një shteti tjetër përmes njohjes së parakohshme apo njohjes me kusht, siç është, për shembull, pikëpamja e qeverisë federale të Nigerisë lidhur me njohjen e “Biafrës” nga pesë shtete.⁴²⁰ Në këto raste e drejta ndërkombëtare kërkon studim të hollësishëm të gjendjes faktike, përpara se të akordohet njohja, duke shmangur kështu rrezikun që të ballafaqohet me nocionin përzierje në punët e brendshme të një shteti i cili eventualisht po dekompozohet. Rasti i shpërbërjes së Federatës Jugosllave ka nxjerrë debate politike, diplomatike dhe akademike. Nga këto debate vërehen mendime se në këtë proces të shpërbërjes ka pasur njohje të nxituara apo të parakohshme dhe zakonisht përmendet njohja e Kroacisë nga komuniteti evropian, sikundër edhe i Bosnjës dhe Herzegovinës. Që të dyja shtetet fitojnë njohjen ndërkombëtare në vitin 1992, pavarësisht faktit se nuk i kishin plotësuar të gjitha

⁴¹⁶ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.382.

⁴¹⁷ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, 2003, fq.91.

⁴¹⁸ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan, ISM-Shkup, 2007, fq.82.

⁴¹⁹ Zejnullah Gruda, *E drejta ndërkombëtare publike*, Furkan, ISM-Shkup, 2007, fq.83.

⁴²⁰ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.383.

kushtet e paracaktuara me Udhëzimet e Komunitetit European të datës 16 dhjetor 1991. Njëra nuk kishte plotësuar kushtet për të drejtat e njeriut dhe për pakicat, kurse tjetra nuk po ushtronte kontroll efektiv në të gjithë territorin e vet.

Një lloj tjetër njohjeje e shteteve të reja është njohja me kushte. Në raste të tilla, shtetit të ri i janë parashtruar disa parakushte të cilat duhet t'i plotësojë para se t'i bëhet njohja. Raste të tilla kemi në zhvillimet bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare lidhur me njohjen. E drejta ndërkombëtare fiton norma të reja për njohjen me ç'rast normat tradicionale pasurohen. Këto norma të reja paraqiten me udhëzuesin e komunitetit european lidhur me krijimin e shteteve të reja gjatë shpërbërjes së dy federatave: BRSS dhe Jugosllavisë.

Kemi parë tashmë nocionin dhe llojet e format e njohjes së shteteve, sikundër edhe teorinë kryesore. Kemi parë gjithashtu, procesin e ndryshimit të statusit juridik të Kosovës, sikundër edhe pozicionimin e Kosovës në procesin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave deri te shpallja përfundimtare e Pavarësisë së Kosovës. Në fakt që në fillim të procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave Kosova, gjegjësisht Parlamenti i Kosovës, ishte drejtuar me kërkesë për njohje ndërkombëtare. Kjo ka rezultuar e pasuksesshme dhe vetëm Republika e Shqipërisë ishte deklaruar se do ta njohte Kosovën. Asnjë shtet tjetër nuk i është përgjigjur pozitivisht Kosovës dhe të njëjtën gjë e kishte bërë Komisioni i Badinterit.⁴²¹ Dhe Kosova sërish me datë 17 shkurt 2008 shpall pavarësinë, shpallje kjo që rezultoi me njohje ndërkombëtare nga shumë shtete, por procesi i njohjesve të reja vazhdon të jetë i vështirë. Në disa vende kundërshtohet zëshëm, kurse disa të tjera ndryshojnë, por jo lehtësisht qëndrimin pro njohjes së Kosovës. Edhe debati akademik jo rrallë është i përfshirë në temën nëse me shpalljen e pavarësisë së Kosovës kishim shkelje të normave të së drejtës ndërkombëtare. Politikisht gjithnjë është (keq) përdorur procesi i

⁴²¹ Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës për Jugosllavinë është njohur përgjithësisht si një komision që është krijuar nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Ekonomik European, që të jepte opinione juridike për Konferencën. Quhej Badinter, sepse kryesohej nga Robert Badinter dhe ky komision përbëhej prej pesë anëtarësh: Robert Badinter - Kryetar i Këshillit Kushtetues të Francës, Roman Herzog-Kryetar i Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, Aldo Corasaniti-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, Francisco Tomas a Valiente – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës dhe Irene Petry – Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës. Gjatë periudhës 1991-1993 Komisioni ka nxjerrë 15 opinione juridike lidhur me ish -Jugosllavinë. Interpretimet lidhur me të drejtën e ish -njësive federative për krijimin e shteteve të pavarura dhe interpretimi se federata kishte përfunduar mendoj se duhet elaboruar edhe më shumë sidomos te çështja e së drejtës së vetëvendosjes si dhe të parimit uti possidetis në kontekst të së drejtës së Kosovës si njësi federative. Kjo çështje do të jetë objekt i studimeve të tjera të thelluara vetëm për Konferencën për Jugosllavinë dhe pozitën e Kosovës. Kurse për sqarime më të gjera lidhur me Komisionin e Badinterit, shih: http://www.pf.uni-lj.si/media/skrk_mnenja.badinterjeve.arbitrazne.komisije.1_10.pdf parë më: 15 dhjetor 2013).

argumentimit të njohjes duke paralajmëruar rreziqet e krijimi të një precedenti, që do të mund të përdoret edhe në shumë situata të tjera, ku etnitete aspirojnë pavarësinë. Rusia madje e ka thënë haptazi dhe në rastin kur ka bërë njohjen e Osetisë dhe Abkazisë e ka përmendur Kosovën si rast precedent.⁴²²

Në procesin e shpalljes së pavarësisë dhe të njohjes së Kosovës, lidhur me shtetet e reja për vetëvendosje si dhe për shkëputje, ne do të gjejmë qasje klasike, moderne dhe postmoderne brenda bashkësisë ndërkombëtare.⁴²³ Përkrahësit kategorikë të qasjes klasike ndaj vetëvendosjes kundërshtojnë të drejtën e Kosovës për vetëvendosje duke arsyetuar se ky proces ka përfunduar me shkolonizimin dhe kështu, Kosova nuk ka qenë koloni. Përbërja e së drejtës për vetëvendosje tradicionalisht ka qenë e kufizuar me situatat e kolonizimit. Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë e drejta e vetëvendosjes zgjerohet te një kontekst i pastër jokolonial.⁴²⁴ Kjo meqë e drejta ndërkombëtare nuk ka mundur të mbetet kaq statike dhe e pandryshuar. Kjo, sidomos, jo, pas shpërbërjes së dy federatave të përmendura (BRSS dhe RSFJ). Në anën tjetër kundërshtohet e drejta e vetëvendosjes për të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje duke u bazuar në konstrukcionet juridike të Kushtetutës Jugosllave sipas të cilave, vetëm kombet (narodi) dhe jo edhe kombësitë, kanë të drejtë në vetëvendosje, ndërkohë që, sipas tyre e drejta ndërkombëtare vetëm kombeve iu njeh të drejtën e vetëvendosjes.⁴²⁵ Sipas këtij interpretimi shqiptarët e Kosovës do të kishin të drejtën e vetëvendosjes së brendshme, por jo edhe në vetëvendosjen e jashtme. Por e drejta ndërkombëtare nuk ka rregulla, të cilat e ndalojnë shpalljen e pavarësisë, e

⁴²² Në një intervistë dhënë BBC-së, Presidenti Rus Medvedev është shprehur: “Moska ndihej e obliguar të njohë Ossetinë Jugore dhe Abkhazinë, ashtu siç kanë bërë shtetet e tjera duke njohur Kosovën”. Shih më gjerësisht intervistën në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/7582181.stm>.

⁴²³ Bashkim Rrahmani&Majlinda Belegu: *International Conference Booklet*, 10 years of Slovak Aid, A vision of development cooperation for a changing world, Bratislava 2013, Pontis/Ministry of Foreign Affairs/UNDP fq.159-160.

⁴²⁴ J.Castellino, *International Law and Self-Determination* (2000)II8 cituar nga: Cedric Ryngaert&Sven Sobrie, *Recognition of States: International Law or Realpolitik?* The Practice of Recognition in the Wake of Kosovo, South Ossetia and Abkhazia, *Leiden Journal of International Law*, 24 (2011), pp.467-490, Foundation of the Leiden Journal of International Law, doi:10.1017/S0922156511000100,fq.19 - marrë nga Cambridge Journals/shkarkuar me: 10 maj 2011.

⁴²⁵ Shumë argumente kundër pavarësisë së Kosovës vënë në pah se ajo nuk gëzonte të drejtën për vetëvendosje ashtu sikurse këtë e gëzonin republikat. Megjithatë, duhet pasur parasysh se as republikat nuk e kishin shprehimisht të njohur këtë, pasi kjo e drejtë nuk mbështetej në territor. Argumenti mbështetej në dallimin ndërmjet kombeve “konstitutive” dhe atyre “jokonstitutive” – kombeve dhe kombësive. Se një parim i tillë ishte joadekuat dhe fluid, rrjedhimisht kudërproduktiv, shihet nga pretendimet e Serbisë për të pasur brenda kufijve të vet pjesë të Kroacisë dhe pjesë të tjera të ish- Jugosllavisë. Rrjedhimisht, kjo nuk ishte marrë për bazë për kombet “konstitutive” kur këto ishin në pakicë në ndonjë republikë tjetër. Shih më shumë: KIPRED, *Analizë politike*, nr.6, *Kosova shtet i paprecedencë*, Prishtinë, 2007, fq.7.

cila mund të bëhet në forma dhe në mënyra të ndryshme. Shteti është krijesë faktike dhe vetëm kur t'i ketë plotësuar kushtet e caktuara, atëherë mund të merremi me subjektivitetin e tij ndërkombëtar, ndërkohë që për t'u shpallur ka mundur edhe me shkëputje, edhe me marrëveshje, edhe në proces të shpërbërjes së ndonjë krijese siç ishte rasti i Jugosllavisë, etj. Kosova, në kuptim të kritereve faktike, i ka plotësuar kriteret e njohura me Konventën e Montevideos në momentin e shpalljes së pavarësisë. Shteti si person në të drejtën ndërkombëtare duket të ketë: a) një popullsi të përhershme; b) territorin e përcaktuar; c) qeverinë dhe d) kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.⁴²⁶ Që të katër këto kritere faktike kanë qenë të plotësuara në kohën e shpalljes së pavarësisë, krahas edhe një serie kushtesh dhe kriteresh, të cilat kanë vënë në pah specificitetin e mënyrës së krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës, gjithnjë në koherencë të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Kriteret që i parasheh Konventa e Montevideos në momentin e shpalljes së pavarësisë, nuk mund të kontestohen dhe në fakt këto kanë qenë të pranishme edhe gjatë kohës së të qenurit të Kosovës njësi konstitutive e Federatës Jugosllave. Pavarësisht faktit se një pjesë të kompetencave nga këto kritere nuk kanë mundur të zbatoheshin në tërësinë e tyre. Dhe kjo është e kuptueshme për sistemet federative, ku një pjesë e kompetencave i takojnë organeve federative. Por megjithatë edhe në kriterin katër, Kosova sipas Kushtetutës së vitit 1974 ka pasur kompetenca në fushën e marrëdhënieve me jashtë, duke pasur funksional Sekretariatit për Marrëdhënie me Jashtë (ndryshe lirisht mund të emërtohej Ministria e Jashtme). Është një diçka tjetër koha e pasrrenimit të Jugosllavisë dhe sidomos koha kur Kosova në procesin e shpërbërjes ishte pozicionuar për të ardhmen e vet, duke krijuar organet e veta të pushtetit, karshi pushtetit të instaluar serb. Kjo në esencë, paraqet kohën kur Kosova fillon të marrë njohje de facto dhe njohje në heshtje. Organet e pushtetit, që quhej paralel, sado që mund të duket si simbolikisht, ata zhvillonin aktivitete dhe, nga faktorët e ndryshëm ndërkombëtarë takoheshin me këto organe, kontaktoheshin dhe herë -herë ishin edhe subjekt për marrëveshje të ndryshme ndërshtetërore. Këto institucione, qofshin të brishta, qofshin jo të qëndrueshme apo, qofshin të pakonsoliduara prodhonin efekte brenda dhe jashtë. Në momente të caktuara më shumë, e në disa tjera më pak. Atyre tani mund t'u bëhen vërejtje dhe është dashur t'u bëhen vërejtje edhe atëherë. Por gjithsesi kishin pushtet nga brenda dhe ishin subjekt kontakti nga jashtë. Në Konferencën e Rambujesë Kosova shkante me subjektivitetin e vet dhe

⁴²⁶ Shih: Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933, available at: <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html> Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933, available at: <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html>.

negocionte me të tjerët për të ardhmen e vet. Subjektiviteti kishte një burim të vetin qoftë gjatë të qenurit në Jugosllavi, qoftë edhe para Jugosllavisë socialiste. Pra kemi të bëjmë edhe me një të drejtë historike, e cila te pala tjetër (Serbia) kishte karakteristika të mitit. Sado që edhe thirrja me argumente historike është në favor të Kosovës, megjithatë në rrugën e mbrojtjes së të drejtës për shtetshmëri, nuk duhet të merrej si argumenti kryesor. Në momente të caktuara ballafaqimi me Serbinë në të drejtat historike domosdoshmërisht çon te sintagmat “Shqipëri e Madhe” apo “Serbi e Madhe”, argumente të cilat nuk tregohen si të vetmet apo si më të fortat për të siguruar përkrahje. Kosovës i duhen sa më shumë njohje dhe thirrja vetëm sipas argumenteve historike nuk jep efektet e pritura dhe të duhura. Argumentet historike duhen përdorur dhe bashkërenduar në mesin e argumenteve shumë të forta që Kosova i ka sipas normave të reja të së drejtës ndërkombëtare. Normat e reja të së drejtës ndërkombëtare e lehtësojnë procesin e argumentimit të shtetshmërisë duke bërë thirrje për kritere të reja dhe në veçanti për normat që kanë të bëjnë me daljen e shteteve të reja nga sistemet që shpërbëhen. Dhe këto norma janë të ndryshme përfshirë edhe kategoritë dhe normat e moralit. Në fund të fundit intervenimi i NATO-s në Kosovë tregon “një konsensus në rritje lidhur me ekzistimin e një hendeku të paparanueshëm në mes të asaj se çka është e drejta ndërkombëtare dhe asja se çka morali kërkon”.⁴²⁷

Praktika dhe e drejta ndërkombëtare në tërësi ka treguar që ajo (e drejta e vetëvendosjes, vërejtje e B. Rr) është një e drejtë e pakufizuar dhe jo një parim politik.⁴²⁸ Dhe në kohën e shpërbërjes së BRSS, Komuniteti European me datën 16 dhjetor 1991 ka nxjerrë një Deklaratë të emërtuar “Udhëzuesi për njohjen e shteteve të reja në Europën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik“ me çka është aprovuar procesi i njohjes së shteteve të reja. Është bërë e ditur në veçanti se njohja kërkon:

- *respektimin e dispozitave të Kartës së OKB-së si dhe përkushtimin e përshkruar me Aktin Final të Helsinkit si dhe në Kartën e Parisit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut;*
- *garantimin e të drejtave të grupeve etnike, grupeve nacionale dhe pakicave në pajtim me përkushtimet përshkruar me kornizën e OSBE-së;*

⁴²⁷Buchann A: Reforming the International Law of Humanitarian Intervention, in Holzgrefe J.L.-Keohane R.O: Humanitarian Intervention: Ethical, Legal and Political Dilemmas, Cambridge, 2003, p. 130

⁴²⁸ Jordan Daci, *Të drejtat e njeriut*, Botimi III, Julvin 2, Tiranë 2011, fq.330.

- *respektimin e paprekshmërisë së të gjithë kufijve, të cilët mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përbashkët;*
- *pranimin e të gjitha përkushtimeve relevante lidhur me çarmatimin dhe jo proliferimin nuklear si dhe sigurinë dhe stabilitetin regjional;*
- *zotimin për të zgjidhur me marrëveshje, përfshirë aty ku mundet burimet e arbitrazhit, si edhe të gjitha problemet lidhur me sukseset e shteteve si dhe të mosmarrëveshjeve regjionale⁴²⁹.*

Në të njëjtën ditë komuniteti europian ka nxjerrë Deklaratën për Jugosllavinë me çka komuniteti dhe shtetet anëtare pajtohen të njohin republikat jugosllave, por kur t'i përmbushin disa kushte të caktuara. Këto ishin kur këto republika dëshironin njohje për të qenë të pavarur: se pranojnë zotimet e parapara me Udhëzuesin; se dispozitat e parapara me draftkonventën e Konferencës për Jugosllavinë, në mënyrë të veçantë të drejtat e njeriut dhe të drejtat nacionale dhe të drejtat e grupeve etnike do të pranohen; si dhe përkrahja e dhënë përpjekjeve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe vetë Konferencës për Jugosllavinë. Komuniteti dhe anëtarët e vet kanë kërkuar gjithashtu që republikat e veçanta jugosllave, që kërkojnë njohje, do të zotohen para njohjes se do të japin garanci kushtetuese dhe politike me çka sigurojnë që nuk do të ketë kërkesa territoriale ndaj shtetit fqinj.⁴³⁰

Këto kritere të komunitetit europian (Bashkimit Europian të sotëm) u nxorën pikërisht në kohën e shpërbërjes së Federatës Jugosllave dhe shtetet e reja, të drejtën në shtetshmërinë e tyre do ta realizojnë duke i plotësuar kushtet e përmendura. Kur flasim për vitin 1991, kohën kur janë nxjerrë këto kritere, Kosova ndodhet në një situatë pushtimi total nga Serbia. Ishte përjashtuar me dhunë nga sistemi jugosllav i Kushtetutës së vitit 1974. Disa republika ishin nisur drejt pavarësisht të plotë dhe kishin filluar të vendosnin pushtetin e tyre duke larguar pushtetin federativ. Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës Ndërkombëtare për Jugosllavinë kishte filluar të nxjerrë opinionet e veta lidhur me Jugosllavinë dhe ai po nënvizonte se: “ekzistimi ose zhdukja e një shteti është çështje fakti kurse efektet e njohjes nga shtetet e tjera janë pastër deklarative”.⁴³¹ Ajo që duhet nënvizuar në këtë kontekst kohor dhe në kontekst të rrethanave, është “Komisioni ka vendosur se procesi legal i shpërbërjes së Jugosllavisë është kompletuar dhe kështu RSFJ nuk

⁴²⁹ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.374-375.

⁴³⁰ Malcolm N.Shaw, *International Law*, fifth edition, Cambridge University Press, Cambridge, 2003, fq.375.

⁴³¹ Shih më shumë nga Opinioni, nr. 1, të Komisionit të Arbitrazhit, të datës 29 nëntor 1991.

ekziston më”.⁴³² Komisioni duke konstatuar një gjendje të tillë si të përfunduar, është dashur gjithashtu të konstatojë se të gjitha njësitë e tjera të federatës paraqitnin një gjendje faktike. Të gjitha ishin deklaruar për rrugën e tyre (përfundim bente Vojvodina) në të ardhmen. Në këtë kontekst edhe Kosova, gjithashtu. Kosova nëse bazohemi në kriteret e Montevideos i plotësonte ato, por realisht nuk mund t’i fuste në jetë në tërësinë e tyre. Shkaqet ishin kryesisht të bazuara në rrethana të shtetrrrethimit total që kishte vënë Serbia: një njësi federative kishte pushtuar njësinë tjetër federative, në mënyrë antikushtetuese. Kur Komisioni nxori përfundimin se Jugosllavia nuk ekzistonte atëherë rrjedhimisht të gjithë përbërësit e saj duheshin trajtuar në mënyrë të barabartë. Por këtu Kosova u trajtua ndryshe edhe pse ajo kishte shpallur pavarësinë e vet dhe kishte drejtuar kërkesën për pranim ndërkombëtar. Kosova kishte popullsi, kishte territor, kishte qeveri dhe ishte futur në marrëdhënie ndërkombëtare në një masë të caktuar. E vërteta është se territori i Kosovës mbahej dhunshëm me forca ushtariko- policore në një formë pushtimi të pashpallur, ndërkohë që disa institucione kosovare mbaheshin në Kosovë duke ushtruar më shumë një pushtet moral sesa një pushtet politik ndaj popullatës shumicë. Qeveria në Ekzil vepronte. Sipas një interpretimi të butë të normave ndërkombëtare ajo në një mënyrë heshtazi dhe de facto njihej nga një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Edhe me institucionet e tjera në Kosovë, zhvilloheshin kontakte të ndryshme nga ana e një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare. Dhe në fund, kur në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës edhe ajo në heshtje ishte njohur nga bashkësia ndërkombëtare dhe jo vetëm kaq. Ajo në fakt gjatë Konferencës së Rambujesë do të merrte rolin kryesor në negociatën lidhur me të ardhmen e Kosovës. Sidoqoftë, analiza nëse është dashur dhe nëse ka mundur të bëhet më shumë duhet të vazhdojë për çështje studimesh dhe argumente ka për të dyja. Por është një fakt, që nuk mund të vërë në pikëpyetje të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe për deklarimin e pavarësisë. Kurse të gjithë këtë që e thamë në kuptim të njohjes heshtazi dhe de facto të institucioneve të Kosovës dhe UÇK-së mund ta vendosim në favor të fuqizimit të kërkesave për njohjen e Kosovës dhe në favor të argumentimit të plotë se Kosova kishte të drejtë të pakontestuar për shpalljen e pavarësisë dhe për ndërtimin e shtetit të pavarur. Gjithsesi vetë procesi, qoftë i futjes në Federatën Jugosllave, qoftë edhe i daljes nga federata duke u pavarësuar shënon një proces të veçantë apo sui generis.

⁴³² Shih më shumë nga Opinioni nr. 8, të Komisionit të Arbitrazhit, të datës 4 korrik 1992.

Kosova, siç është parë më lart, shpalli pavarësinë e vet me datën 17 shkurt 2008 dhe shteti i Kosovës filloi të njihet nga shtetet e fuqishme të demokracive perëndimore, por edhe nga vende të tjera të botës që në ditën e shpalljes. Të shohim se çka e bën Kosovën të jetë rast sui generis.

Deklarata nga Sekretarja e shtetit të SHBA, SHBA njih Kosovën si shtet të Pavarur“ dhënë me 18 shkurt 2008:“ Një kombinim jo i zakonshëm faktorësh gjendet në situatën e Kosovës – përfshirë kontekstin e shpërbërjes së Jugosllavisë, historinë e spastrimit etnik dhe krimeve kundër civilëve në Kosovë, si dhe periudhën e zgjatur të administrimit të Kombeve të Bashkuara – nuk janë gjetur diku tjetër, prandaj kjo e bën Kosovën rast të veçantë. Kosova nuk mund të shihet si precedent për ndonjë situatë në botën e sotme.”⁴³³ Deklarata numëron faktorët duke i quajtur “kombinim i pazakonshëm” dhe këtu ndër argumentet e tjera është përdorur edhe historia e spastrimeve etnike që e fuqizon të drejtën e Kosovës për shtetshmëri. Projektioni i shpalljes së pavarësisë, për të kurorëzuar aspiratat e popullit të Kosovës nuk është akt krejtësisht unilateral. Esenca e kërkesës që Kosova të jetë një rast i veçantë del nga përgjigjja e bashkësisë ndërkombëtare dhe nga transformimi efektiv i Kosovës në territor të ndërkombëtarizuar.⁴³⁴ Për më tepër i gjithë procesi i përgatitjes për shpalljen e pavarësisë dhe, edhe vetë dita dhe skenari i shpalljes së pavarësisë është bërë në koordinim të plotë me bashkësinë ndërkombëtare, apo thënë ndryshe me faktorët kyç vendimmarrës. Në rastin e Kosovës duhet marrë në konsideratë se Kosova është rast sui generis bazuar në rrethanat specifike që çuan te Deklarata e Pavarësisë. Këto rrethana janë statusi autonom i Kosovës në ish -RSFJ dhe më vonë shkelje të mëdha dhe sistematike të të drejtave të njeriut, katastrofa humanitare, refuzim i Konferencës së Rambouillet. Sipas Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kreu VII i Kartës së OKB-së, edhe pse nëntë vjet prani ndërkombëtare prej administrimit ndërkombëtar, kishte mungesë marrëveshjes nga aktorëve kyç për të siguruar një nivel të qëndrueshëm autonomie për krahinën e Kosovës, si edhe mungesë përgjegjësie nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për paqe dhe për stabilitet në regjion.⁴³⁵ Kur kundërshtohet pavarësia e Kosovës, zakonisht përdoret “shpallja unilaterale e Pavarësisë së Kosovës“ e cila në fakt, nuk ka qenë krejtësisht unilaterale. E vërteta është, se shpallja e Deklaratës së Pavarësisë nuk ka qenë akt i pastër unilateral. Aktit të shpalljes së

⁴³³ www.state.gov.

⁴³⁴ Carsten Stahn, *Constitution without a State? Kosovo under UN Constitutional Framework for Self-Government* 2001 14 *Leiden Journal of International Law* 531, 540.

⁴³⁵ Written contribution of the Republic of Kosovo, submitted to the International Court of Justice, April 17, 2009, pp. 60-61.

pavarësisë i kanë paraprirë një seri aktesh dhe veprimesh të koordinuara ndërkombëtarisht për të bërë që “Kosova është një rast i veçantë që rrjedh nga procesi jokonsensual i shpërbërjes së Jugosllavisë dhe nuk është precedent për ndonjë situatë tjetër”.⁴³⁶ Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë, ka përfunduar me krijimin e 7 shteteve të reja, nga tetë njësi federative sa kishte Federata Jugosllave. Kurse konflikti i armatosur dhe lufta në Kosovë ka përfunduar dhe kjo është vërtetuar me vendosjen e Kosovës nën një administrim ndërkombëtar, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe “Rezoluta 1244, ka lënë hapur të gjitha opsionet duke filluar prej pavarësisë e deri te restaurimi i pushtetit serb”.⁴³⁷ Thirrja në Rezolutë, vetvetiu kundërshton argumentet, që aty - këtu dëgjohen, se ajo nuk ka mohuar faktin se Kosova mbetet të jetë pjesë e Republikës Federative të Jugosllavisë. Një formulim i tillë është nxjerrë në rrethana të caktuara kohore, ku është arritur një konsensus ndërkombëtar edhe vetë brenda Këshillit të Sigurimit. Por rezoluta megjithatë është e përkohshme në njërën anë dhe në anën tjetër është akt që pa dyshim e ka thelluar ndërkombëtarizimin e Kosovës, çështje të cilën Serbia është përpjekur vazhdimisht ta pengonte. Në anën tjetër nga krijesa, nga Republika Federative e Jugosllavisë (RFJ), ishte larguar Mali i Zi dhe faktikisht nuk mund të flitet më për RFJ. Pas asaj që shqiptarët kanë pësuar në duart e autoriteteve të RFJ-së, ata janë tërësisht të pavullneshëm për të pranuar çfarëdo shprehje të sovranitetit mbi krahinë, qoftë edhe të natyrës simbolike (Kosovo Report 2000:0).⁴³⁸ Shpallja e koordinuar e pavarësisë së Kosovës është rezultat i plotësimit të kushteve brenda Kosovës. Këto kushte janë monitoruar dhe janë vlerësuar nga faktori ndërkombëtar dhe aq më tepër janë përcaktuar po nga ai vetë. Kushtet i kanë paraprirë hapjes së bisedimeve për statusin final, të cilat, kemi parë se kanë hasur në refuzim apo destruksion nga pala serbe. Standardet para statusit, raporti i Kei Eides për vlerësimin e standardeve, negociatat e ndërmjetësuara nga UNOSEK dhe nxjerrja e Propozimit gjithëpërfshirës për statusin final të Kosovës (Pakoja e Ahtisaarit) janë ndër kushtet kryesore të cilat Kosova i ka plotësuar duke treguar maturimin e saj për ndërtimin e shtetshmërisë finale, që u njoh ndërkombëtarisht. Kosova deklarimin dhe përkushtimin për të vepruar konform obligimeve dhe standardeve ndërkombëtare e ka vërtetuar edhe me vetë Deklaratën e Pavarësisë. Sipas deklaratës, Kosova mirëpret angazhimin dhe praninë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, duke shprehur gatishmërinë për mirëpritje të pranisë civile

⁴³⁶ Shih preambulën e Deklaratës së Pavarësisë, Aneksi 1.

⁴³⁷ Zejnullah Gruda, *Some key principles for a Lasting Solution of the Status of Kosova: Utī possidetis, the ethnic principle, and self determination*, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Issue 1 Symposium: Final Status for Kosovo: Untying the Gordian Knot, 2005.

⁴³⁸ KIPRED, Analizë Politike, nr.6, *Kosova: shtet i paprecedencë*, Prishtinë 2007, fq.8.

ndërkombëtare për të mbikëqyrur zbatimin e planit Ahtisaari dhe misionin e sundimit të ligjit të prirë nga Bashkimi Europian (pika 5 e Deklaratës). Me pavarësinë vjen edhe detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare duke iu përmbajtur parimeve të Kartës së OKB-së dhe Aktit final të Helsinkit dhe akteve tjera (pika 8). Deklarata vazhdon me përkushtimet për marrëdhënie të veçanta me Republikën e Serbisë. Ndërkohë që në pjesën preambul përshkruhen zhvillimet që kanë çuar deri në këtë fazë.⁴³⁹

Pavarësia e Kosovës në fakt ishte akt që nuk mund të shmangej. Kushtet dhe obligimet e parashtruara Kosova i kishte plotësuar sikundër ishte zotuar se në vazhdimësi do të vepronte në harmoni të plotë me të gjitha aktet ndërkombëtare duke filluar me Kartën e OKB-së. Pavarësia dhe shpallja e saj, “ishte shumë interesante se asnjëri shtet në Këshill pos Ruisë dhe Serbisë, nuk thoshte se shpallja e pavarësisë ishte një akt jolegal ndërkombëtar që do të duhej të kundërshtohet nga bashkësia e organizuar ndërkombëtare, për shembull, nëpërmjet politikës kolektive të mospranimit apo madje edhe sanksioneve”.⁴⁴⁰ Askush dhe asnjë mekanizëm ndërkombëtar nuk është shprehur dhe nuk ka punuar që anëtarët e vet të mos e njohin pavarësinë e Kosovës. “Këshilli nënvizon se shtetet anëtare do të vendosin në pajtueshmëri me praktikatat nacionale dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, në marrëdhëniet e tyre me Kosovën”⁴⁴¹. Kushtet që Komuniteti Europian (Bashkimi Europian i sotëm) i ka vendosur në vitin 1991 lidhur me shtetet që krijoheshin në procesin e shpërbërjes së BRSS-së dhe RSFJ-së konsiderohet se janë respektuar nga Kosova dhe nga institucionet e saj dhe kjo është argument shtesë se kërkesa për njohje është krejtësisht legjitime dhe e drejtë. Pajtueshmërinë e shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë me të drejtën ndërkombëtare e ka vërtetuar Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë⁴⁴², kur ka vendosur që “shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën

⁴³⁹ Shih më gjerësisht tekstin e plotë të Deklaratës së Pavarësisë, të shpallur më 17 shkurt 2008.

⁴⁴⁰ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2011, fq.437.

⁴⁴¹ Komunikatë për shtyp (Press Release) e Këshillit të Bashkimit Europian e datës 18 shkurt 2008, nga mbledhja 2851.

⁴⁴² Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) është organi kryesor i drejtësisë i Kombeve të Bashkuara. Është themeluar në qershor të vitit 1945 me Kartën e OKB-së dhe ka filluar punën në prill të vitit 1946. Selia e Gjykatës është në Pallatin e Paqes në Hagë (Holandë). Nga gjashtë organet kryesore të OKB-ë, është i vetmi organ që nuk është i vendosur në New York (SHBA). Roli i gjykatës është të zgjidhë mosmarrëveshjet legale në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të paraqitura në Gjykatë dhe të japë opinione këshillëdhënëse në çështje juridike të referuara e të autorizuara nga OKB dhe nga agjencitë e specializuara. Kjo gjykatë përbëhet nga 15 gjykatës që zgjidhen me mandate 9- vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Këshilli i Sigurimit. Ndihehet nga Regjistri si organ administrativ. Gjuhë zyrtare të gjykatës janë: anglishtja dhe frëngjishtja.

ndërkombëtare”.⁴⁴³ Duke vërtetuar se nuk ishin shkelur normat e së drejtës ndërkombëtare, gjykata çështjen e njohjeve të shtetit të Kosovës e trajton si çështje politike⁴⁴⁴ për çka shtetet do të vendosin individualisht. Kjo është rrjedhojë e natyrshme, sepse njohja është akt publik i një shteti - është akt opsional dhe politik dhe nuk ka ndonjë obligim juridik lidhur me këtë.⁴⁴⁵ Çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë e kishte ngritur Serbia më 15 gusht 2008, duke paraqitur zyrtarisht kërkesë tek OKB-ja, kurse Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e miratonin propozimin e Serbisë në formë Rezolute⁴⁴⁶ me datë 30 shtator 2008. Sekretariati i OKB-së me 9 tetor 2008 njofton Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për dosjen që po përgatitej, kurse procedimet janë karakterizuar me një mori aktesh të shkruara: kërkesa për , veprime të shkruara, paraqitje verbale, dhënie opinionesh, etj., të gjitha veprime karakteristike për këtë mekanizëm të drejtësisë ndërkombëtare. I gjithë procesi në këtë gjykatë lidhur me rastin e Kosovës zgjatë deri më 22 korrik 2010, kur gjykata vërtetoi se shpallja e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare. Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është edhe një bazë e fortë për të kërkuar njohje të shtetit të Kosovës dhe trajtim të barabartë të këtij shteti brenda bashkësisë ndërkombëtare.

Në favor të së drejtës për shtetëshmëri dhe në favor të asaj se Kosova kishte të drejtë për shpalljen e pavarësisë shkon edhe ajo që sot njihet si “vetëvendosje zhdëmtuese“. Kjo doktrinë vjen nga dy variante: mungesa e përfaqësimit nga njëra anë, dhe represioni, nga ana tjetër.⁴⁴⁷ Në rastin e Kosovës nën Federatën Jugosllave në shumicën e kohës, populli i Kosovës nuk ishte përfaqësuar dhe qytetarët e saj ishin trajtuar si qytetarë të rendit të dytë. Për më tepër ata përjashtoheshin nga të drejtat e tyre. Kur kësaj i shtohet edhe dhuna dhe represioni sistematik i vazhdueshëm, atëherë vetëvendosja është e drejtë e pashmangshme, që duhej t’i takonte. Doktrina e vetëvendosjes zhdëmtuese bazohet në parimin e përgjithshëm të drejtësisë *ubi ius ibi remedium*. Kjo do të thotë se aty ku ka vetëvendosje ka edhe një çarë dhe mjet për këtë të drejtë. Argumenti për mjet/çare është qartë i ilustruar me fjalët e Ryngaert dhe Griffionen: “Çka nëse një shtet në mënyrë persistente i mohon të drejtat fundamentale nga vetëvendosja e brendshme? Çka nëse njerëzit nuk kanë mundësi të zgjedhin lirshëm, por i nënshtrohen dhe durojnë shkelje të

⁴⁴³ <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf> 22 korrik 2010.

⁴⁴⁴ Po aty.

⁴⁴⁵ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, 2003, fq.89.

⁴⁴⁶ Shih Rezolutën A/RES/63/3 e datës 30 shtator 2008.

⁴⁴⁷ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë 2011, fq.441.

mëdha të të drejtave bazike dhe të gjitha mjetet e mundshme për zgjidhje paqësore të konfliktit janë shtjerrur? A duhet këtyre njerëzve t'u ndalohej një mjet/çare /ie vetëndihmës në formë të vetëvendosjes së jashtme?⁴⁴⁸ Përgjigjja logjike është automatike: nuk mundemi dhe nuk ka norma ndërkombëtare që legalizojnë dhe legjitimojnë dhunën dhe shtypjen e të tjerëve se kanë gjuhë, kulturë, origjinë, traditë, etj., tjetër nga këta që ushtrojnë dhunën. Dhe këta që i janë nënshtruar dhunës sistematike dhe që janë përjashtuar nga të drejta nuk mund të privohen nga e drejta e përdorimit të vetëvendosjes zhdëmtuese. Dhe pavarësisht se Kosova me kushtetutën e saj është ndërtuar si shtet qytetar, megjithatë gjatë gjithë ekzistencës së saj, është karakterizuar me shumicë shqiptare, prandaj kjo jep edhe një argument shtesë për të argumentuar arsyeshmërinë e pavarësisë. Vello Pettai argumenton se në rastin e Lituaniës, populli ka ekzistuar dhe mund të argumentonte me sukses pavarësinë politike nga BRSS, për shkak se ishte me shumë homogjen nga raca, krahasuar me shtetet e tjera Baltike.⁴⁴⁹ E drejta moderne ndërkombëtare, tash është parë se nuk është një grumbull normash krejtësisht statike. Edhe kjo i është nënshtruar procesit të ndryshimeve që janë të ndikuara nga gjendja faktike brenda bashkësisë ndërkombëtare. Vetë paraqitja e shteteve të reja dhe parimi i vetëvendosjes dhe i shkëputjes nuk ka qenë e mundur që të rregullohej me normat tradicionale të jus cogens-it. E drejta ndërkombëtare, sikurse ka shtuar numrin e subjekteve ndërkombëtare, gjithashtu ka pasuruar qëndrimet dhe kriteret lidhur me mundësinë e krijimit të shteteve të reja dhe me njohjen ndërkombëtare të tyre. Kështu tash asaj i paraqiten kritere shtesë si: të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i nivelit të demokracisë, fizibiliteti i shtetit, obligimi i vështrimit ndryshe nga jus cogens, etj.

6.2. Roli i diplomacisë amerikane

Kur shkruhet për rolin e diplomacisë amerikane dhe për rolin e saj, nuk mund të mos përmendim rolin e shtetit amerikan në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimeve për fatin popullit shqiptar. Është kjo periudha e fundit e Luftës së Parë Botërore, kur politika dhe diplomacia amerikane fillojnë të angazhohen në Europë për të vazhduar më tej me një rol kyç në

⁴⁴⁸ Ryngaert and Griffioen, "The relevance of the right to self-determination in the Kosovo matter: in partial response to Agora papers," para.6, cituar nga Ieva Vezbergaitė, Remedial Secession as an Exercise of the Right to Self-Determination of Peoples, Central European University, CEUeTD Collection, Budapest, 2011, fq.44.

⁴⁴⁹ Shih Vello Petai, *Contemporary International Influences on Post-Soviet Nationalism: The Cases of Estonia and Latvia*, Presented Ass'n for the Advancement of Slavic Studies, 25 Nat'l Convention (Nov.19-21, 1993 www.ut.ee/ABVKeskus/publ/1999/Post_Soviet_Nationalism.html.-Worsten, fq.16).

momente vendimtare të vetë historisë së re të Europës. Kurse për sa i përket Shqipërisë dhe shqiptarëve, “interesi amerikan për Shqipërinë dhe për shqiptarët buron nga parimet civilizuese të vlerave që SHBA-ja përfaqëson.⁴⁵⁰ Angazhimi amerikan i parë nga Presidenti i asaj kohe, Wilson, po i kontribuonte vendosjes së një drejtësie në botë. Dhe ky angazhim shënon një angazhim të thellë në Europë, i cili nuk do përfundojë asnjëherë. Presidenti amerikan, Woodrow Wilson, kishte paraqitur me 18 shtator 1918 në New York pesë pika bazë, mbi të cilat duhej ndërmarrë paqja dhe rendi i ri botëror. Në pikën e parë të këtij programi thuhej se “duhet të vendosim një drejtësi, e cila nuk duhet të ketë asnjë favorizim dhe diferencim, por të njohë të drejtën e barabartë të kombeve”.⁴⁵¹ Në këtë kontekst, në një kohë kur fuqitë e mëdha nuk po tregoheshin aspak miqësore me shqiptarët dhe kur trojet e tyre po copëtoheshin haptas apo fshehtas dhe kur fqinjët nuk po ngopeshin duke marrë territore shqiptare, do të jetë qëndrimi i SHBA-së që do vihet krahas shqiptarëve. Në janar të vitit 1919 Wilson deklaroi se qeveria amerikane kundërshton në mënyrë të vendosur copëtimin e trefishtë të Shqipërisë (midis Italisë, Greqisë dhe Serbisë) duke denoncuar Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, traktat i cili u paraqit si zgjidhje në Versajë.⁴⁵² Dhe disa dekada më vonë do të jetë pikërisht SHBA-ja që do të vihet në krahasim të Kosovës, për të shpëtuar popullin shqiptar të Kosovës nga katastrofa dhe për t’u vënë në krahasim të Kosovës në angazhimet për liri dhe pavarësi. Kurse raportet Shqipëri -SHBA kishin një shkëputje thuhet 45- vjeçare. Shkaqet e shkëputjes nuk do shqyrtohen në këtë punim. Por ato natyrisht janë pak a shumë të qarta. Shteti shqiptar mbeti pjesë e botës komuniste duke u shndërruar në një shtet komunist të mbyllur hermetikisht, kurse Kosova mbeti pjesë e Jugosllavisë, e cila edhe pse komuniste kishte qasje krejtësisht të ndryshme në raport me botën perëndimore. Kështu Jugosllavia socialiste kishte ndërtuar raporte të mira në të gjitha fushat me SHBA-në, kështu që raporti i Kosovës me SHBA-në në kontekst për sa i përket përmirësimit apo avancimit kombëtar nuk ka shënuar ndonjë karakteristikë të veçantë. Së paku jo për disa dekada.

Por raportet shqiptaro -amerikane pavarësisht se Kosova kishte mbetur jashtë tringut shtetëror shqiptar, gjithsesi duhen shikuar nga një këndvështrim i përbashkët kombëtar. SHBA-ja mbajti një pozitë mbrojtëse për shqiptarët dhe faktikisht nuk u pajtua me copëtimin e trojeve

⁴⁵⁰ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq. 371.

⁴⁵¹ Versailles zum Weltkrieg, përmbledhje dokumentesh, Munchen, 1965, fq.31 cituar: nga Enver Bytyçi *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq. 371.

⁴⁵² Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq. 371.

shqiptare. Sekretari amerikan i Fondit të Ndhimave për Ballkanin, William U.Haward, shkroi në vitin 1918 në gazetën “Christian Work“ një ese politike për Shqipërinë, me të cilin ai solidarizohej me të drejtën për vetëvendosje dhe denoncoi vendimet e europianëve për copëtimin dhe denigrimin e shqiptarëve.⁴⁵³ Artikulli shprehet qartë kundër vendimeve që fuqitë qendrore kishin marrë për të ardhmen e Shqipërisë. Haward në vazhdim rekomandon: “Kufijtë shqiptarë të caktohen, duke pasur për bazë deri ku shtrihet raca shqiptare, pa përfillur arbitraritetin e paraluftës si dhe marrëveshjet e arritura nga Fuqitë Qendrore ose nga Aleatët e Antantës për të ardhmen e Shqipërisë. Përcaktimi i trevave të saj dhe drejtimi i çështjeve të saj të quheshin të pavlefshme...Shqipëria të trajtohet në përputhje me deklaratën e parimeve të Presidentit Wilson, e cila nënvizon hyrjen e Amerikës në luftë “dhe për Shqipërinë, ai rekomandon që ajo të merret në mbrojtje të veçantë nga SHBA-ja“.⁴⁵⁴ Pas vënies së vetos nga Presidenti Wilson në Konferencën e Paqes në Paris SHBA-ja shumë shpejt merr vendim që të vendosë marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Kështu, marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe SHBA-së e kanë pikënisjen me 28 korrik të vitit 1922, kur ende shteti shqiptar sapo kishte rikonfirmuar pavarësinë.⁴⁵⁵

Por për një periudhë të caktuar kohore nuk kishte ndonjë raport të fortë në mes të SHBA-së dhe shqiptarëve. Gjatë sundimit diktatorial në Shqipëri dhe gjatë epokës jugosllave në Kosovë, SHBA-ja nuk luan ndonjë rol të veçantë, përveç faktit se ishte një tokë e ëndrrave apo vend destinimi për disidentë dhe për ata që kërkonin jetë më të mirë.⁴⁵⁶

Megjithatë, SHBA-ja ishte e para nga vendet demokratike, të cilat në fillim të viteve 1980 e kthyen vëmendjen në drejtim të Kosovës. Në vitin 1981 Senatori, Helms, deklaroi se ishte në interesin e SHBA-së, që të artikulonte në politikën e saj bashkimin e shqiptarëve në një shtet të vetëm antikomunist.⁴⁵⁷ Por RSFJ-ja për një kohë të gjatë, megjithatë ka gëzuar një përkrahje dhe mbështetje nga shtetet e perëndimit dhe në radhë të parë falë pozitës gjeo - politike. Por gjithsesi

⁴⁵³ Po aty, fq.372.

⁴⁵⁴ Artikulli është ribotuar në revistën Koha, nr.5, të datës 27 qershor 1998 si dhe në librin e autorit “Shqiptarët, serbët dhe grekët“ Koha, Tiranë, 2005, fq.370 cituar nga: Enver Bytyçi, Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.372-37.

⁴⁵⁵ http://sq.wikipedia.org/wiki/Marr%C3%ABdh%C3%ABniet_Shqip%C3%ABri_-_SHBA (qasur me 12 shkurt 2014).

⁴⁵⁶ Naim Dedushaj, *Paradiplomatic' relations between the United States and Kosova: A friendship between an elephant and a mouse*, University of Malta, 2006, fq.76.

⁴⁵⁷ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.374.

edhe falë politikës së jashtme jugosllave, sidomos gjatë udhëheqjes së Titos. Për më tepër Jugosllavia gëzonte statusin e kombit më të favorizuar në tregtinë me SHBA-në. Megjithatë, në vitet nëntëdhjetë edhe më tutje në Kongres qarkullonin projektrezoluta lidhur me çështjen e kthimit të autonomisë së Kosovës dhe me shkeljen e të drejtave të njeriut të shqiptarëve. Menjëherë pas vizitës së Eagleburgerit në Beograd, me 26 prill 1990, ndodhi qarkullimi i parë i projektrezolutës në Senat. Ajo ishte projektrezoluta e Senatit 124.⁴⁵⁸ Kjo ishte koha kur lëvizjet për shpërbërjen e Jugosllavisë kishin filluar, ndërsa SHBA-ja ende vazhdonte të deklarohej për ruajtjen e unitetit të federatës. Por kjo është edhe koha kur CIA, në vjeshtën e vitit 1990, kishte dalë me dy analiza që tregonin se Jugosllavia do të shpërbëhej. Analiza e dytë e CIA-s, pohon se “Jugosllavia do të pushojë së funksionuari brenda një viti dhe me siguri do të shpërbëhet brenda dy vjetëve”.⁴⁵⁹ Opinioni nr.8 i Komisionit të Arbitrazhit kur konstaton se procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë ka përfunduar në korrik 1992 vërteton saktë precizionin e parashikimit të shpërbërjes së Jugosllavisë nga CIA. Në analizën e dytë, CIA parashikoi se:

- *Serbia do t'i bllokojë përpjekjet e Sllovenisë dhe të Kroacisë për të formuar një konfederatë jugosllave;*
- *Do të ndodhë kryengritja afatgjatë e armatosur e shqiptarëve në Kosovë e mbështetur nga pakica shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi dhe e fokusuar në ndarjen nga Serbia duke kërkuar mbështetje materiale nga Shqipëria, por jo bashkim formal me të;*
- *Serbia do të nxisë kryengritje të pakicës serbe në Kroaci dhe në Bosnjë.*⁴⁶⁰

Pas vizitës së Eagleburger-it në Jugosllavisë, një grup senatorësh do të vizitojnë Beogradin dhe Prishtinën për t'u njoftuar më afër me situatën e krijuar, sidomos pas rrënimit me dhunë të autonomisë së Kosovës. Senatorët, Robert Dole dhe D'Amato, gjatë vizitës në Kosovë hasën në një mikpritje ta madhe nga masat shqiptare, kundër të cilave edhe në sy të senatorëve do të ushtrohet një dhunë e ashpër nga policia serbe. Kështu senatorët patën rastin të shihnin drejtpërdrejt se deri ku kishte filluar të shkonte dhuna e pushtetit serb kundër shqiptarëve në Kosovë. Ndërkohë që kishin filluar të dëgjoreshin zëra se demokracia dhe vetëvendosja ishin më të rëndësishme për SHBA-në sesa ruajtja e unitetit të Jugosllavisë. Gjithsesi edhe brenda

⁴⁵⁸ S.CON.RES.124, April 26, 1990, marrë nga Dario Malnar, fq.110.

⁴⁵⁹ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë ,2013, fq.115.

⁴⁶⁰ Po aty.

faktorëve me ndikim në politikën e jashtme të SHBA-së kishte kontradikta që lidheshin mes këtyre dy opsioneve: ruajtjen e unitetit të Jugosllavisë apo përkrahjen e vetëvendosjes për ata që donin të dilnin nga Jugosllavia. Kosova po vizitohej nga senatorë e kongresmenë dhe gjithashtu nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe gazetarë, të cilët merrnin informacion nga dorë e parë për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe me raportet e tyre krijonin opinion për domosdoshmërinë e aktiviteteve kundër pushtetit serb lidhur me politikën e tyre në Kosovë. Krahas kësaj, administrata e shtetit duke qenë e informuar se shpërbërja e Jugosllavisë kishte marrë rrugë që s'mund të ndalej informon shtetet europiane lidhur me pasojat e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë. Dhe pasojat do t'i bartte Europa më shumë se SHBA-ja, prandaj kjo do të duhej të ishte “subjekt i konsultimeve në NATO dhe në samitin e ardhshëm të KSBE-së në Paris, të planifikuar për në nëntor të vitit 1990”.⁴⁶¹ Por në Europë në këtë kohë nuk kishte ndonjë unitet, prandaj pikëpamjet amerikane “plotësisht i mbështetën Austria dhe Hungaria, ndërsa Gjermania dhe Britania e Madhe u përgjigjen se pajtohen pjesërisht, por Franca pohonte se SHBA-ja po i dramatizonte gjërat dhe refuzoi konsultimet në NATO dhe diskutimet në samitin e KSBE-së”.⁴⁶²

Edhe në Kosovë, strukturat e krijuara që njiheshin si paralele fillojnë me aktivitete politike dhe diplomatike (aty-këtu dëgjohej si paradiplomatike) për të ndërkombëtarizuar problemin e Kosovës dhe për të siguruar përkrahje ndërkombëtare. Diaspora shqiptare do të shërbejë si mjet shumë i rëndësishëm dhe i fuqishëm në këtë aspekt. Në Europën Perëndimore dhe në SHBA bëhet një mobilizim i grupeve, të cilat për një moment lënë anash dallimet ideologjike për t'u vënë në funksion të sigurimit të përkrahjes zyrtare të shteteve ku vepronin për Kosovën. Në SHBA edhe më herët ka pasur aktivitete të diasporës, në formë demonstratash dhe aktivitete që shprehnin kundërshtimin e politikës jugosllave. Por në këtë periudhë kohore, Liga Qytetare Shqiptaro -Amerikane⁴⁶³ ka sponsorizuar një delegacion të dhjetë liderëve shqiptarë për

⁴⁶¹ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.113.

⁴⁶² Po aty.

⁴⁶³ Liga Qytetare Shqiptaro -Amerikane është themeluar në janar të vitit 1998 me qëllim lobimi në Kongres dhe në administratën e Presidentit Bush, në emër të shqiptarëve, në veçanti të atyre nga Kosova. Kjo organizatë është themeluar nga ish- kongresisti Joseph DioGuardi, i cili ishte i pari që në Kongres ngriti çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Ballkan përmes një rezolute në Kongres që e kishte sponsorizuar si anëtar i ri i Dhomës së Përfaqësuesve në vitin 1986. Ai ishte gjithashtu përgjegjës për dëshmitë për Kosovën (hearing) në vitin 1987. Ai ka ndërmarrë më shumë se 40 udhëtime në Ballkan që nga largimi prej Kongresit në vitin 1989 në cilësinë e themeluesit, vullnetarit dhe Presidentit të Ligës Qytetare Shqiptaro- Amerikane. Shih më shumë për organizatën në: <http://www.aacl.us/aboutus.htm>.

të dëshmuar kundër okupimit nga Millosheviçi në një dëgjim historik në Kongres për të drejtat e njeriut dhe pastaj është organizuar një mbrëmje historike në New York ku morën pjesë 2,700 shqiptaro -amerikanë për “nder të Lirisë dhe Demokracisë për Kosovën”.⁴⁶⁴ Një organizatë shumë e rëndësishme, që është paraqitur pak më vonë në SHBA është Këshilli Nacional Shqiptaro - Amerikan (The National American Albanian Council) “që është një shoqatë jofitimprurëse komunitare, e cila i dedikohet përfaqësimit të shqetësimeve të shqiptaro-amerikanëve dhe përforcimit të të kuptuarit të çështje shqiptare në SHBA”.⁴⁶⁵ Kurse shoqata dhe organizime shqiptare ka pasur gjatë gjithë kohës së ekzistimit të shqiptarëve në Amerikë, sikundër që ka pasur edhe individë që krahas aktiviteteve institucionale, kanë pasur ndikim të madh brenda komunitetit shqiptar në Amerikë dhe kanë krijuar opinion edhe te shteti dhe opinionin amerikan. Sado që nuk janë objekt i këtij studimi po përmendim Fan Nolin, Faik Konicën, shoqatën Vatra duke lënë me vetëdije edhe shumë individë dhe organizata e organizime që kanë luajtur rol të rëndësishëm për shqiptarët përgjithësisht. Lidhur me çështjen e sensibilizimit të çështjes së Kosovës po përmendim edhe krijimin e Degës së LDK-së në Amerikë, e cila është krijuar në dhjetor të 1990-ës. Të dy mekanizmat joqeveritarë, Liga Qytetare Shqiptaro -Amerikane dhe Këshilli Kombëtar Shqiptaro -Amerikan, bashkë me degën e LDK-së kanë luajtur rol të rëndësishëm në sensibilizimin e çështjes së Kosovës; në vënien e kontakteve për liderët kosovarë me kongresmenë e senatorë; në vënie kontaktesh me media dhe me organizata të fuqishme lobimi dhe për avokimin brenda SHBA-së; në organizime të dëgjimeve dhe dëshmime në trupat kryesorë të qeverisjes amerikane, por edhe në aktivitete të tjera të fushës së kulturës, arsimit, etj. Në momente të caktuara këta mekanizma kanë vuajtur nga sëmundja e luftës për primat, që ka rezultuar me përçarje, por megjithatë aktivitetet e tyre kanë qenë me peshë dhe me sukses. Është me rëndësi të theksohet se anëtarët dhe aktivistët e këtyre mekanizmave krahas qenies së tyre me origjinë shqiptare, kanë vepruar edhe si qytetarë dhe deri krijesa amerikane, që gjithsesi i ka shtuar peshën veprimeve të tyre. Dhe mekanizmat joqeveritarë në SHBA, janë forma shumë të rëndësishme të bashkimeve dhe bashkimeve politike⁴⁶⁶ dhe nuk janë vetëm shoqatat e numërta shqiptare, krahas këtyre që u përmenden, që

⁴⁶⁴ Shih më shumë: <http://www.aacl.us/aaclhistory.htm>.

⁴⁶⁵ Shih më shumë: <http://www.alb-net.com/about.htm>.

⁴⁶⁶ Amerika është vendi ku nga bashkimi është nxjerrë më shumë dobi në botë dhe ku është zbatuar ky mjet i fuqishëm veprimi në një larmi të madhe çështjesh (...). Kur një mendim përfaqësohet nga një shoqatë, ai është i detyruar të marrë një trajtë më të qartë dhe më të saktë. Ajo shoqatë i numëron ithtarët e saj dhe i nxjerr para botës për të mbrojtur çështjen e saj (...) në ushtrimin e së drejtës së bashkimit në çështjet politike, është edhe një shkallë e

janë marrë me çështjen e Kosovës dhe me krijimin e opinionit apo të ndikimit në politikëbërjen amerikane në favor të avancimit të çështjes së Kosovës. Është një numër shumë i madh i shoqatave, sfondi i të cilave nuk ka qenë amerikan, e që me të vërtetë kanë ndikuar në politikën amerikane, por edhe në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, përgjithësisht.

Të kthehemi sërish tek orientimet amerikane lidhur me Jugosllavinë dhe me reagimin europian në këtë raport. Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë po bëhej kur BRSS-ja tashmë nuk ishte fuqi dhe kur lufta e ftohtë i takonte historisë. Dhe në këtë situatë, fuqitë europerëndimore veprojnë “kur zhdukja e kërcënimit sovjetik iu krijoi kushte për t’i forcuar pozitat e veta në planin politik ndërkombëtar e të sigurisë dhe të dobësishtit proporcional të rolit të Amerikës në Europë”.⁴⁶⁷ Por gjatë kohës së krizës jugosllave, së paku në fillimet e shpërbërjes, vetë SHBA-ja duket se dëshironte që çështja të mbetej në duar të europianëve, ku sipas Jacques Poos, që ishte kryesues i BE-së: “agoi epoka europiane dhe kjo më vonë, në muajt dhe në vitet që do të vijnë, do të përsëritet shpesh”.⁴⁶⁸ Entuziazmi europian do të zbehet shumë shpejt nga zhvillimi dramatik i ngjarjeve në terren dhe nga paaftësia europiane për të gjetur zgjidhjen. Komuniteti Europian do të marrë udhëheqjen e procesit për zgjidhjen e konflikteve në Jugosllavi. Si rrugë për zgjidhjen e konflikteve, që kishin filluar, BE-ja gjen organizimin e Konferencës së Paqes në Hagë nën udhëheqjen e Lordit Carrington. Por lidhur me Kosovën, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk vërehej gjë. Për serbët e Kroacisë parashihej një status special, i cili tërthorazi mund t’i atribuohet edhe Kosovës në të ardhmen. Por, në kohën kur siç kishte nënvizuar James Baker, në mbledhje të Këshillit të Sigurimit se, “ishte i dukshëm qëllimi i udhëheqjes serbe për të krijuar një Jugosllavi të vogël ose Serbi të Madhe”⁴⁶⁹, ishte e qartë se me konferenca të tilla nuk do të mund të zgjidheshin problemet në Jugosllavi. Këtu, ishte koha kur SHBA-ja duhej të udhëhiqte dhe jo ta ndiqte BE-në e cila tregoi se është plotësisht e paaftë për menaxhimin e krizës.⁴⁷⁰ Kurse politika e Millosheviçit ndër të tjera llogariste se me gjendjen e krijuar në terren, do të përfitonte nga entuziazmi europian për BE-së dhe nga ngathtësia e tyre për të vepruar, por edhe nga hezitimi amerikan. Politika e Millosheviçit mund edhe ta ketë llogaritur se megjithatë BE-ja,

fundit: ithtarët e një mendimi të njëjtë mund të mblidhen në tubime zgjedhore. Në të vërtetë ky është sistemi i përfaqësimit, i zbatuar në një parti..., shih më shumë nga: Aleksis de Tokvilë, *Mbi demokracinë në Amerikë*, Dukagjini, Pejë, 1998, fq.180-186.

⁴⁶⁷ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.118.

⁴⁶⁸ Halberstam, D., *Rat u vreme mira: Bush, Clinton i generali*, B&G, Beograd, 2003, fq. 55, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë 2013, fq.119.

⁴⁶⁹ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.121.

⁴⁷⁰ New York Times, August 14, 1991, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.121.

në fund të fundit, do të angazhohej duke pranuar gjendjen e krijuar në terren edhe si kundërpërgjigje e mundshme ndaj angazhimit të drejtpërdrejtë amerikan që tashmë ishte i domosdoshëm. Kur lufta në ish - Jugosllavi vazhdonte dhe po intensifikohej, u bë e qartë se BE-ja dhe anëtarët e saj ishin të papërgatitur veç e veç të dislokoni fuqinë e fortë, e cila mund t'i jepte fund konfliktit. Si pasojë e kësaj administrata e Clinton-it u detyrua të ndërhyjë me forcë duke përdorur si mjet NATO-n...⁴⁷¹ Këtu duhen gjetur arsyet e angazhimit dhe të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë amerikan në krizën jugosllave dhe jo në disa interpretime që hasen aty -këtu se arsyet e ndërhyrjes amerikan janë: “ si përgjigje ndaj themelimit të Bashkimit Europian si lojtar global; SHBA-ja kishte interes të demonstronte se edhe më pas do të mbetej aktori i vetëm që mund të vendosë dhe që vepron në të gjitha pjesët e botës dhe kështu, edhe në periferi të Europës“.⁴⁷²

Kur konflikti në Jugosllavi shpërtheu, fillimisht pak ditë në Slloveni e më vonë në Kroaci dhe në Bosnjë, në Kosovë gjendja në dukje ishte e qetë, por e tensionuar si para shpërthimit. Presidenti, George H.W.Bush, me qëllim të parandalimit pak para përfundimit të mandatit, me 24 dhjetor 1992 i dërgon Presidentit serb, Slobodan Millosheviç, të ashtuquajturin Paralajmërimin e Krishtlindjeve.⁴⁷³ Arsyet që e kanë shtyrë Presidentin Bush që pikërisht në fund të mandatit të bëjë, siç thuhet shpesh, një tërheqje të vijës së kuqe, do të këtë qenë parandalimi i shpërthimit të konfliktit dhe i luftës në Kosovë. Tri javë pas ardhjes në pushtet të Presidentit Clinton më 1993, sekretari i shtetit, Christopher, e theksoi sërish “Paralajmërimin e Krishtlindjeve.⁴⁷⁴ Kissinger e konsideron se ajo deklaratë, të cilën nuk e ndoqi përkufizimi i sjelljes së papranueshme, si dhe as propozimi i zgjidhjeve, madje as edhe e idesë sesi do të duhej të dukej ajo, shënoi fillimin e përfshirjes së SHBA-së në problemin e Kosovës.⁴⁷⁵ Paralajmërimi i Krishtlindjeve koïncidon me atë se, zyrtarisht në SHBA Kosova është përfaqësuar diku nga viti 1992, atëherë kur Presidenti i zgjedhur, Ibrahim Rugova, foli para Kongresit Amerikan për gjendjen e rëndë të situatës të të drejtave të shqiptarëve në Kosovë dhe kërkoi domosdoshmërinë

⁴⁷¹ Michael Cox&Doug Stokes, *Politika e Jashtme e Shteteve të Bashkuara*, IDK-Oxford University Press,2008, fq.287.

⁴⁷² Gazeta Politika, Nikola Jovanoviç, 20.02.2013.

⁴⁷³ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.131.

⁴⁷⁴ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare Autobiografi*,Dudaj 2004, fq.443.

⁴⁷⁵ Kissinger, H.,*Treba li Amerika vanjsku politiku: Prema diplomaciji za 21 stoljece*, Golden Marketing, Zagreb, 2003, fq.226, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.131.

e përmirësimit të menjëhershëm të saj.⁴⁷⁶ Nga Paralajmërimi i Krishtlindjeve politika amerikane futet në një evolucion që në vazhdimësi do pësojë ndryshime, nga qëndrimi për ruajtjen e unitetit të Jugosllavisë e deri te përkrahja e plotë e pavarësisë. Për çdo rast, siç thotë Frank Wisner, Paralajmërimi i Krishtlindjeve shënoi fillimin e një procesi të gjatë të përfshirjes në çështjen e Kosovës, që zgjati deri në ndërhyrjen e SHBA-së dhe të NATO-s.⁴⁷⁷ Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë merr kahje pa kthim dhe shpërthimi i luftës në Bosnjë bëhet prioritet për angazhimin e diplomacisë amerikane, sidomos pas dështimeve dhe ipotencës së BE-së dhe të OKB-së. Dhe angazhimi i SHBA-së në dukje do të zbehet për një periudhë të caktuar kohore. Por Kosova megjithatë mbetet si çështje që kërkonte zgjidhje dhe që lënia anash e çështjes së Kosovës duhej kuptuar vetëm si një çështje, së cilës duhej t'i vinte radha e zgjidhjes. Problemet në një kohë trajtoheshin si çështje e të drejtave të njeriut dhe angazhimet në bazë të deklaratave zyrtare shkonin kah ajo që Kosovës t'i kthehej autonomia që i ishte marrë me dhunë nga Serbia. Pavarësia e Kosovës për vitet e para të shpërbërjes së Kosovës, nuk ishte diçka që do të përkrahej nga SHBA-ja dhe nga shtetet perëndimore të angazhuara në këtë proces. Së paku kjo nuk ishte bërë publike. Në anën tjetër, siç është thënë më lart mospjesëmarrja e Kosovës në Konferencën e Dayton-it do të ndryshojë gjendjen në terren, ku rezistenca paqësore do të ballafaqohet me opsione të tjera. Fundi i vitit 1997 dhe fillimi i vitit 1998 ndryshon krejtësisht situatën në terren. UÇK-ja paraqitet si faktor që po ndryshonte gjendjen dhe që gradualisht po fitonte mbështetje sidomos te masa e të rinjve që ishin pa perspektivë. Britania e Madhe si aleatja më e fortë e SHBA-së kishte iniciuar aktivizimin e Grupit të Kontaktit, si mekanizëm që mund ta ndihmonte procesin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Kjo po bëhej me shpresë se në proces do të sigurohej pjesëmarrja e Rusisë. Dhe që nga muaji mars i vitit 1997 u iniciua aktivizimi i Grupit të Kontaktit, i cili do të merret më shumë me Kosovën.⁴⁷⁸ Por aktivizimi i grupit të kontaktit,

⁴⁷⁶ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.375.

⁴⁷⁷ Kissinger, H., *Treba li Amerika vanjsku politiku: Prema diplomaciji za 21 stoljece*, Golden Marketing, Zagreb, 2003, fq.226, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.132-133.

⁴⁷⁸ Daalder dhe O'Hanlon (2000) pohojnë se aktivizimi i shpejtë i Grupit të Kontaktit ishte bërë në bazë të "katër leksioneve" që anëtarët e Grupit Perëndimor (SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia) i nxorën në rastin e Bosnjë-Herzegovinës: 1. U pajtuan se duhet të veprojnë shpejt për të shmangur përsëritjen e tmerrshme boshnjake; 2. Ndërhyrja e suksesshme (qoftë politike, qoftë ushtarake) kërkon përpjekje unike, por udhëheqje amerikane (jo europiane) 3. Vetëm presioni i përbashkët kundrejt Millosheviçit mund të jetë i suksesshëm në mënyrë që të bindet për t'i dhënë fund dhunës dhe të fillojë dialogun me shqiptarët e Kosovës ;4. Të përjashtohet mundësia e një pavarësie formale për Kosovën. Daalder, I.H.O'Hanlon, M.E.Wining Ugly: *NATO's War to Save Kosovo*, Brookings Institute Press, Washington D.C.2000, f.24-25, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.154.

megjithatë vinte në pah edhe përçarjet, sidomos në mes të vendeve të perëndimit dhe të Rusisë. Por ishte përvoja e hidhur e dështimit të perëndimit lidhur me Bosnjën prandaj reagimet pritëshin të ishin më të shpejta. Albright në takimin e Grupit të Kontaktit paralajmëroi se “ne nuk duhet të harrojmë mësimet e nxjerra nga Bosnja dhe Herzegovina kur bashkësia ndërkombëtare veproi shumë vonë.⁴⁷⁹ Albright deklaroi publikisht “nuk kemi ndërmend të rrimë duarkryq e të presin autoritetet serbe të bëjnë në Kosovë atë që nuk e bënë dot në Bosnjë⁴⁸⁰, ndërkohë që konflikti i armatosur kishte plasur në Kosovë. Sidoqoftë angazhimi përmes Grupit të Kontaktit, por edhe zhvillimet në terren determinojnë edhe angazhimin e OKB-së. Me 31 mars 1998 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën nr.1160, në të cilën dënohej përdorimi i tepruar i forcës nga pushtetarët jugosllavë kundër shqiptarëve, qytetarëve të thjeshtë të Kosovës dhe në fakt vendosi embargon, si dhe sanksionet kundër Beogradit.⁴⁸¹ Rëndësia e rezolutës qëndronte në faktin se po angazhohej edhe OKB-ja, ndryshe rezultati i OKB-së lidhur me ndalimin e Millosheviçit mund të supozohej i dështuar. Këtë e kishte vërtetuar praktika e deritashme. Dhe shqetësimet për atë që konflikti i Kosovës po rrezikonte paqen dhe sigurinë, se po rrezikohej paqja ndërkombëtare, etj., ishin paraqitur sidomos nga përfaqësuesi amerikan, Bill Richardson, në Këshillin e Sigurimit, dhe diskutimin e tij e kishin ndjekur edhe të tjerë, si: përfaqësuesi nga Sllovenia, përfaqësuesi nga Bosnjë e Herzegovina, etj.⁴⁸² Dallimet gjatë diskutimeve ishin jo vetëm në kuptimin e marrjes së masave, por edhe në kuptimin e koncepteve lidhur me esencën e problemit, nëse kishim të bënim vetëm me një konflikt të brendshëm apo se konflikti po rrezikonte paqen ndërkombëtare. Sidoqoftë rezoluta ishte bazuar në kreun VII të Kartës së OKB-së dhe ajo ftonte për marrje të caktuara masash për të dyja palët në konflikt. Grupi i Kontaktit do të mbajë sërish mbledhje, por mbledhjet po dukeshin të paefektshme dhe nuk po jepnin rezultatet e nevojshme. Kështu Presidenti, Clinton, vlerësoi në maj të vitit 1998 se përpjekjet e Grupit të Kontaktit po dështonin të gjenin një zgjidhje, prandaj duhej bërë më shumë.⁴⁸³ SHBA-ja fillon me përpjekje të reja diplomatike për të siguruar negociata në mes RFJ-së/Serbisë dhe Kosovës, duke emëruar ambasadorin amerikan në Maqedoni, Christopher Hill, si të dërguar të posaçëm.

⁴⁷⁹ Albright, M., Frontline interview, f.1., cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.156.

⁴⁸⁰ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, fq.444.

⁴⁸¹ AR.A.ULLURJAR &S.G.KULESHOV, *Faktori Kosovë*, Elve,Tiranë, 2009, fq.76.

⁴⁸² S/RES/1160 (1998), 31 March 1998 dhe S/PV.3868, 31 March 1998, p. 13 (USA), 7 (Slovenia), 27 Bosnia and Herzegovina, etj.

⁴⁸³ Clinton, B., *My life*, Alfred A.Knope, New York, 2004, fq.787, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.159.

Paraprakisht, qëndrimi amerikan ndaj UÇK-së në fillimin e lëvizjes së saj ishte kritik. Robert Gelbhard, ndërmjetës kryesor i SHBA-së për zgjidhjen e krizës në Ballkan, deklaroi në shkurt 1998 se UÇK-ja ishte një organizatë e vogël terroriste. Por pak muaj më vonë, i dërguari special i Presidentit Amerikan në Ballkan, Richard Holbrooke, takoi një grup përfaqësuesish të UÇK-së, e cila në këtë kohë (qershor 1998) kontrollonte thuhetse 40% të territorit të Kosovës.⁴⁸⁴ Dhe tash për të dërguarin e posaçëm ishte edhe një angazhim shtesë. Ai duhej të gjente rrugë që edhe me këtë faktor të rëndësishëm të komunikojë. I emëruari i posaçëm, Christopher Hill, do të fillojë me angazhimet e tij për të nxjerrë plane gjithëpërfshirëse dhe plani i parë i tij, do të nxirret me 01 tetor të vitit 1998.⁴⁸⁵ Kjo ishte koha kur situata në terren ishte në buzë katastrofës dhe në një situatë kur palët (Serbia dhe Kosova) kishin qëndrime diametralisht të kundërta, duhej ndërmarrë diçka që së paku katastrofa humanitare të evitohet. Plani i parë i Hill-it ishte një dokument që përcaktonte disa kompetenca për Kosovën, por kur është fjala për RFJ-në parashihte autorizimet e mbështetura në integritetin territorial: tregu i përbashkët, politika monetare, politika e mbrojtjes, politika e jashtme dhe policia federale.⁴⁸⁶ Plani i parë u refuzua nga të dyja palët edhe pse kjo ishte paraparë që të ishte si një lloj marrëveshje e përkohshme. Me 20 nëntor 1998 RFJ-ja dhe Serbia nxjerrin formalisht një kundërpropozim, që thuhet se gëzonte përkrahjen e grupeve joshqiptare në Kosovë (turqve, goranëve, myslimanëve, romëve, etj).⁴⁸⁷ Kjo ishte një gjimnastikë serbe, me të cilën si zakonisht tentohej të mos gjendej zgjidhje, për kalkulime politiko-diplomatike. Hill-i me 02 dhjetor del me propozimin e tretë, duke treguar se përpjekje të tilla nuk do të reshtnin së shpresuari për gjetjen e zgjidhjes së problemit. Mirëpo, projekti i tretë i propozimit të Hill-it ishte befasi e pakëndshme për shqiptarët e Kosovës.⁴⁸⁸ Sepse ishte më shumë në favor të Serbisë. Ky propozim po bëhej ngase, “duhet të kihet parasysh, sipas Hillit, se logjika e SHBA-së në atë kohë u fokusua në përmirësimin e kushteve të jetesës për shqiptarët:

⁴⁸⁴ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.376.

⁴⁸⁵ Marc Weller, *The Rambouillet Conference on Kosovo*, <http://www.chathamhouse.org/sites/default/files/public/International%20Affairs/Blanket%20File%20Import/inta069.pdf> (qasur me datë 20 dhjetor 2013).

⁴⁸⁶ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.179.

⁴⁸⁷ Marc Weller, *The Rambouillet Conference on Kosovo*, <http://www.chathamhouse.org/sites/default/files/public/International%20Affairs/Blanket%20File%20Import/inta069.pdf> (qasur me datë 20 dhjetor, 2013).

⁴⁸⁸ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.189.

arsim, shëndetësi, etj., dhe në zhvillimin e institucioneve.⁴⁸⁹ Dhe vërtet situata e fundvitit 1998 ishte më e rëndë se asnjëherë më parë. Por gjërat kishin shkuar aq larg sa që ishte vështirë që palët të bindeshin për zgjidhje gjysmake, sado që propozoheshin zgjidhje të përkohshme. E zgjidhje të përkohshme kishte kërkuar Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, kur më 10 dhjetor 1998 kishte takuar Ibrahim Rugovën.⁴⁹⁰ Në anën tjetër bashkësia ndërkombëtare nuk ishte unike me qëndrimet për Kosovën dhe nuk ishin të gjithë krah SHBA-së dhe qëndrimeve të saj. Por edhe në Kosovë duheshin unifikuat qëndrimet, sepse tashmë kishte grupacione, të cilat nuk e mundësonin Ibrahim Rugovën që të merrej dhe të ishte si përfaqësues i vetëm i të gjithë shqiptarëve të Kosovës. Për më tepër në terren ekzistonin njësitë e armatosura, të cilat kishin strategji tjetër për rezistencë dhe që kërkonin të ishin pjesë e bisedimeve si edhe pjesë e krijimit të platformave për zgjidhjen e problemit të Kosovës. E Hill, sikundër edhe diplomatë të tjetër europianë tash po zhvillonin bisedime me këto njësite, që në njëfarë mënyre do të thotë se UÇK-ja po siguronte njohje. Bazuar në përvojën e politikës serbe gjatë gjithë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë ishte e qartë se problemi nuk mund të zgjidhej me diplomaci fluturuese, por problemi mund të zgjidhej vetëm me konferencë ndërkombëtare dhe me garanci ushtarake për jetësimin e saj. Diplomacia fluturuese ishte aktivitet që ishte përkrahur edhe nën kërcënimin e forcës. E forca si iniciativë fillon me kërcënimin e nxjerrë nga NATO në qershor të vitit 1998 si rezultat i bashkëpunimit në mes të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, komandantit Suprem aleat për Europën, gjeneralit Wesley Clark dhe Ambasadorit të SHBA-së në NATO, Aleksander Vershbow, drejtuar Presidentit, Slobodan Millosheviç, që t'i jepet kredibilitet diplomacisë shuttle të Ambasadorit të SHBA-së në Maqedoni, Christopher Hill, në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe përpjekjeve të Grupit të Kontaktit për t'iu përgjigjur kryengritjes në rritje nga UÇK-ja përmes vrasjeve të policëve serbë në shënjestër në Kosovë dhe te fqinji, në Maqedoni si dhe përleshjes në fshatra për të provokuar hakmarrjen nga forcat jugosllave të sigurisë.⁴⁹¹ Fuqitë perëndimore e kishin të qartë se Kosova ishte vatër krize që do të shpërthente dhe e kishin të qartë se ndaj konfliktit në Kosovë duhej vepruar me vendosmëri dhe

⁴⁸⁹ Shala, B., *The Diplomatic War for Kosova: A Dialogue with Ambassador Christopher Hill*, Zëri, Prishtinë, 2003, fq.60, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.190.

⁴⁹⁰ President Rugova meet with U.S. Secretary of State Albright in Paris, Kosova Daily Report # 1633, 98-12-05, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.191.

⁴⁹¹ Susan L. Woodward, *Does Kosovo's Status Matter? On the International Management of Statehood* SÜDOSTEUROPA, 55 (2007) 1, S. 1–25, fq.6.

me shpejtësi.⁴⁹² Por e qartë ishte se vetëm SHBA-ja mund të shkonte guximshëm dhe pa ekuivoqe, tamam si me angazhimin në Bosnjë që solli Dayton-in. Por viti ku kriza filloi të ashpërsohet dhe kur konflikti po merrte përmasa, ishte ndjekur edhe me një problem në SHBA, që njihet si “Afera Lewinski” e që Presidentit Clinton po i shkaktonte vështirësi të nduardurshme. Megjithatë dhe pavarësisht kësaj, reagimet ndaj konfliktit dhe dhunës serbe, sidomos pas sulmeve serbe gjatë verës së vitit 1998 nuk munguan. Komisioni i Kongresit Amerikan për Sigurinë dhe Bashkëpunimin me Europën, i cili udhëhiqej nga zv. Presidenti i Kongresit, republikani, Christopher H. Smith, reagoi ashpër. Në fjalën e tij ai e cilësoi gjendjen e krijuar në Kosovë si shumë serioze dhe që po sillte një katastrofë të rëndë.⁴⁹³ Dhe katastrofa tashmë kishte ardhur. Serbia edhe një herë po tregohej kokëfortë në rrugën e saj. Ajo sikur nuk dëshironte t’i merrte seriozisht kërcënimet për sulme ushtarake nga NATO kurse Paralajmërimin e Krishtlindjeve të Presidentit Bush dukej sikur e trajtonte si shprehje të ndonjë fantazie politike. Millosheviçi, i cili në Dayton u bë faktor i zgjidhjes së problemit, tash nisi të bëhej vetë problemi. Këtë e kishin të qartë tash të gjithë. Ai arriti që me stilin e tij, që të zbrapste sulmet e NATO-s duke nënshkruar marrëveshjen e Tetorit⁴⁹⁴, me çka pos të tjerash u mundësua vendosja e misionit të vëzhguesve të OSBE-së në Kosovë. E kjo megjithatë ishte zbrapsje e përkohshme, sepse kërcënimin i përdorimit të forcës mbetej aty ku ishte nxjerrë. Ishte e qartë, se fuqitë perëndimore duhej të vepronin për të parandaluar konfliktin në Kosovë: siç është artikulluar nga SHBA-ja (veçanërisht nga Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright dhe i dërguari i saj Ambasadori Holbrooke) dhe Kryeministri Britanik Tony Blair, ku u diktuan dy parime: kurrë përsëri (përsëritje të Bosnjës-shpjegim/interpretim i BRR) dhe asnjë diplomaci nuk është efektive pa kërcënimin e forcës.⁴⁹⁵ E, vjeshta e vitit 1998 dhe dimri e pranvera e vitit 1999 shënuan kulmin e angazhimit amerikan në këtë çështje dhe për pasojë Kosova doli në krye të

⁴⁹² Susan L. Woodward, *Does Kosovo's Status Matter? On the International Management of Statehood SÛDOSTEUROPA*, 55 (2007) 1, S. 1–25, fq.7.

⁴⁹³ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.376-377.

⁴⁹⁴ Marrëveshja Millosheviç- Holbrooke, siç njihet si Marrëveshje e Tetorit, e shpëtoi Serbinë nga kërcënimin i NATO-s për të përdorur forcën kundër qaveve serbe. Marrëveshja përpos të tjerash mundësoi vendosjen e një misioni vëzhgues civil ndërkombëtar, për efektet e të cilit, sikundër edhe për vetë marrëveshjen e përmendur debatet janë të vazhdueshme lidhur me atë nëse këto të dyja arritën efektshmërinë e pritur.

⁴⁹⁵ Susan L. Woodward, *Does Kosovo's Status Matter? On the International Management of Statehood SÛDOSTEUROPA*, 55 (2007) 1, S. 1–25, fq.7.

axhendës ndërkombëtare.⁴⁹⁶ Ambasadori Hill vazhdon aktivitetet e tij të diplomacisë fluturuese për të ofruar një zgjidhje. Në një deklaratë ai ishte shprehur: “në Kosovë kërkojmë zgjidhje, në Kosovë nuk kërkojmë drejtësi”.⁴⁹⁷ Kjo deklaratë e Hill-it në kontekstin kohor duhet kuptuar si deklaratë e kushtëzuar nga situata e rëndë në Kosovë. Në rrethana të tilla duhej bërë ajo që ishte më së shumti e nevojshme. E kjo ishte parandalimi i katastrofës humanitare në Kosovë, ku krahas vrasjeve, rrahjeve, arrestimeve, etj., numri i refugjatëve po shtohej në një kohë të një dimri të ashpër. Prandaj nuk mund të flitej për një zgjidhje të drejtë, por mund të flitej thjesht për një zgjidhje që më vonë shpresohet të evoluonte në zgjidhje të drejtë, që do të ishte në një mënyrë vazhdimësi e evoluimit të politikës amerikane karshi zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Kështu në kërkesën për zgjidhjen, Hill del me propozimin e katërt të datës 27 janar 1999. E inkurajuar nga deklarata e përbashkët me Ivanovin, ditë më parë në Moskë, Albright kërkoi me këmbëngulje nga Beogradi dhe Prishtina të pranonin marrëveshjen. Përgjigje pozitive nuk pati dhe Grupi i Kontaktit vendosi t’i bashkonte palët kundërshtarë për negociata në Rambouillet.⁴⁹⁸ Dhe kështu ndodhi “Konferenca e paqes në Rambouillet nën nikoqirllëkun e përbashkët britaniko-francez, por të konvokuar të diskutohet dhe të aprovohet propozimi amerikan i paqes në tri javët e para të shkurtit 1999 dhe gjatë një vazhdimi të shkurtër me 18 mars.⁴⁹⁹ Për Konferencën e Rambujesë është folur në kreun e katërt dhe këtu duhet nënvizuar edhe një herë se nënshkrimi i marrëveshjes ka qenë një ndër hapat më të qëlluar të shqiptarëve të Kosovës në përpjekjet e tyre për liri dhe pavarësi. Kurse angazhimi i diplomacisë amerikane, i prirë nga Albright, shënon kthesën vendimtare amerikane në rrugë drejt përkrahjes së pavarësimit të plotë të Kosovës.

Tashmë angazhimi amerikan kishte kahje krejtësisht tjetër dhe përgatitjet për hapa të tjerë po zhvilloheshin konform asaj që ishte pohuar shumë herë, se nuk do të lejohej përsëritja e Bosnjës. E në fakt, përgatitjet për diçka të tillë ishin bërë në Serbi. Raporti i CIA-s i 16 marsit paralajmëronte se RFJ-Serbia po përgatiste një sulm të ri në Kosovë.⁵⁰⁰ E vërteta është se gjatë

⁴⁹⁶ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.377.

⁴⁹⁷ Esat Stavileci, *Kosova nën administrimin ndërkombëtar*, Forumi për Iniciativë Demokratike, Gjakovë, 2000, fq.89.

⁴⁹⁸ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.201.

⁴⁹⁹ Paul Heinbecker, Kosovo, in: David M.MALONE (ed.), *The UN Security Council: From the Cold War to the 21st Century*, Boulder/London: Lynne Rienner and the International Peace Academy, 2004, pp. 537-550, cituar nga: Susan L. Woodward, *Does Kosovo's Status Matter? On the International Management of Statehood SËDOSTEUROPA*, 55 (2007) 1, S. 1–25, fq.6.

⁵⁰⁰ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.214.

Konferencës së Rambouillet sulmet serbe kundër shqiptarëve ishin shumëfishuar dhe nevoja për ndërhyrje të shpejtë ushtarake ishte e domosdoshme. Ndërkohë që po përfundonte afati kohor për ndjekjen e rrugës diplomatike, Senati votoi 58 me 41 për të autorizuar Presidentin të mbështeste bombardimet e NATO-s.⁵⁰¹ Kjo i ishte bërë e ditur Serbisë nga SHBA-ja dhe nga NATO-ja, gjithashtu. Mosnënshkrimi i Marrëveshjes së Rambouillet do të shënojë edhe një përpjekje të fundit diplomatike amerikane, përmes të deleguarit, Holbrooke, për të bindur Millosheviçin për mosrefuzim. Dy ditë para fillimit të sulmeve të NATO-s, gjatë kohës që Holbrooke ishte në Beograd, Presidenti Clinton deklaronte:

- *SHBA-ja ka për qëllim të ndalojë vrasjet dhe të arrijë paqe të qëndrueshme, si dhe rikonstruktimin e vetëqeverisjes së Kosovës;*
- *Holbrooke ka për detyrë që në mënyrë të qartë t'i paraqesë Millosheviçit zgjidhjen me të cilën do të përballet – në qoftë se zgjedh agresionin, e jo paqen, planet ushtarake të NATO-s do të zbatohen patjetër;*
- *Se i kishte dërguar një letër Presidentit rus, Jelcin, në të cilën e njoftonte për seriozitetin e situatës;*
- *Ekzistonte rreziku që konflikti të përhapej madje edhe në Greqi e në Turqi*⁵⁰²

Presidenti Clinton do të vazhdojë të japë deklarata për të dhënë mesazhet e fundit se më nuk kishte kohë dhe se NATO do të sulmonte. Urdhri e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për sulme kundër RFJ/Serbisë Clinton do ta përkrahte dhe me rastin e urdhrin për sulme, ai nga zyra ovale do të jepte një deklaratë duke shpjeguar arsyen dhe domosdoshmërinë e sulmeve të NATO-s. Deklarata e 24 marsit jep sqarime për bazueshmërinë e sulmeve të NATO-s qoftë për shkaqe humanitare, qoftë për shkaqe gjeopolitike. Clinton u përpoq që të bindë opinionin amerikan se përgjegjës për aksionin ushtarak të NATO-s ishte Millosheviçi. Madje ai shprehet se

*Millosheviçi vendosi të bëjë agresion në Kosovë, e për këtë shkak atij i duhej dhënë përgjigja e duhur.*⁵⁰³

Kurse Sekretarja e shtetit shprehet se

⁵⁰¹ Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, fq.473.

⁵⁰² Remarks by the President on the Situation in Kosovo, The White House – Office of the Press Secretary, March 22, 1999, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.216.

⁵⁰³ <http://www.glasnost.de/kosovo/990324clinton.html>. cituar nga: Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq. 382.

“SHBA konsideron se rezolutat ekzsituase të Këshillit të Sigurimit për Kosovën krijojnë bazë të mjaftueshme juridike për akcione të NATO-s.”

Ajo në konference për shtyp thotë

“duke vepruar sipas kreut VII të Kartës, Këshilli i Sigurimit ka aprovuar tri rezoluta – 1160, 1199 dhe 1203 – me të cilat RFJ-së i janë imponuar detyrime e të cilat RFJ në mënyrë flagrante i ka injoruar. Kështu akcioni i NATO-s është ndërmarrë brenda këtyre kornizave dhe ne besojmë se akcioni i NATO-s është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të ndërprerë dhunën.”⁵⁰⁴

E përfaqësuesi i SHBA në Këshillin e Sigurimit do të shprehet

“ne besojmë se një akcion i tillë është i domosdoshëm me qëllim që t’i përgjigjemi ndjekjes brutale të shqiptarëve të Kosovës nga ana e Beogradit, dhunimin e të drejtës ndërkombëtare, përdorimin e pamasë dhe joselektiv të forcës, refuzimin e bisedimeve me çka do të zgjidhej kjo çështje paqësisht dhe grumbullimin aktual të forcave ushtarake – me çka paralajmërohet katastrofa humanitare (humanitarian catastrophe-anglisht) të përmasave të paparapara. Ne filluam akcionin e sotëm me qëllim të parandalimit të katastrofës humanitare dhe për të pamundësuar agresionin e mëtejshëm dhe represionin në Kosovë”. Ai më tutje ka shtuar “në këtë kontekst, ne besojmë se akcioni i NATO-s është i drejtë dhe i nevojshëm për të ndërprerë dhunën dhe për të parandaluar katastrofën (humanitarian disaster-anglisht)”.⁵⁰⁵

Sulmet e NATO-s ndaj caqeve ushtarake serbe do të zgjasin 78 ditë dhe SHBA-ja krahas angazhimit të drejtpërdrejtë në sulme do të angazhohet edhe me përpjekje diplomatike për

⁵⁰⁴ Sekretarja e shtetit M.Olbrajt (M. Albright), Konference shtypi për Kosovën, Washington, 25. mars 1999; Cituar sipas: Portela C: Humanitarian Intervention, NATO and International Law, Research Report 00.4, December 2000, p. 5

⁵⁰⁵ UN Security Council, 3988thmeeting, 24 March 1999, Doc. S/PV. 3988, pp. 4-5

zgjdhjen e çështjes pas përfundimit të luftës. Presidenti, Sekretarja e Shtetit, Al Gore dhe Strobe Talbot janë figurat më të angazhuara në këtë çështje. Vlerësohej se ishte shumë me rëndësi të sigurohej një angazhim rus për gjetjen e zgjidhjes paqësore. Kështu angazhimi sjell sukses dhe Jelcini cakton Çernomirdinin si emisar të vetin dhe në mes të Al Gore-s dhe Çernomirdin-it vihet kanali i komunikimit të cilit më vonë do t'i bashkëngjitet edhe Ahtisaari, që do të ketë ngjyra të OKB-së. Është thënë më lart se operacionet ushtarake kundër caqeve serbe përfundojnë me Marrëveshjen teknike-ushtarake të Kumanovës dhe me nxjerrjen e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244, të datës 10 qershor 1999. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit vendosi bazën juridike për vënin e administrimit civil ndërkombëtar në Kosovë, UNMIK, bashkë me komponentin ushtarak KFOR. SHBA-ja edhe pas këtij momenti do të vazhdojë me politikën e vet gjithnjë më të qartë dhe më të vendosur krahasuar me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë lidhur me përcaktimin e statusit final të Kosovës. SHBA-ja do të jetë pjesë aktive e këtyre mekanizmave të administrimit ndërkombëtar, qoftë brenda UNMIK-ut, qoftë brenda KFOR-it me trupat e vetë ushtarakë.

Administrimi ndërkombëtar nuk ishte diçka që mund të zgjaste në mënyrë të pakufizuar. Kështu faktorët e vendosjes e kishin të qartë se duheshin bërë përgatitje për zgjidhje të çështjes. Marrëveshja e Rambouillet edhe pse nuk ishte nënshkruar nga pala serbe kishte një kornizë të caktuar kohore, pas së cilës duhej marrë parasysh deklarimi i popullit të Kosovës. SHBA-ja kishte përkrahur iniciativat që njiheshin si “standartet para statusit” dhe kështu sikur po vinte koha që “vija e kuqe” e Bushit të vjetër të niste të shënonte kurorëzimin nga Bushi i ri, i cili fillimisht “gjatë fushatës elektorale në vitin 2000 nuk ka treguar përqendrim më të madh në çështjet e politikës së jashtme. Mirëpo, Kosova doli një nga temat rreth së cilës u ballafaqua si kandidati presidencial, demokrati Al Gore, ashtu edhe republikani George W. Bush”.⁵⁰⁶ Në shkurt të vitit 2001, ish -Sekretari i Shtetit shprehet se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për paqe në Ballkan dhe se forcat e NATO-s duhet të mbesin në Bosnjë dhe në Kosovë me vite.⁵⁰⁷ Gjatë fillimit të mandatit të tij Bush-i do të veprojë sipas doktrinës së vet : bashkë kemi hyrë dhe bashkë do dalim. Por situata në Kosovë kërkonte veprime më të shpejta, sepse po vërehej që, administrata civile ndërkombëtare nuk po shkonte në proporcion të drejtë me

⁵⁰⁶ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.270.

⁵⁰⁷ Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S. Policy: Background to independence, updated June 2008, fq.26.

kërkesat dhe me shpresat e popullatës shumicë në Kosovë. Në anën tjetër në vitin 2003 vërehen iniciativa në Kongres dhe në Senat për të njohur të drejtën për pavarësi të Kosovës. Dhe iniciativat amerikane, sikundër të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga amerikanët, gëzonin përkrahje të plotë nga popullata shumicë në Kosovë dhe kjo garantonte siguri dhe qëndrueshmëri për zgjidhjet që mund të propozoheshin nga amerikanët. Në maj të vitit 2005 administrata e dytë e Bushit shpalli fazën e re të politikës amerikane në Ballkan. Duke theksuar nevojën “për të përfunduar punën” nënkretari për çështje politike, Nicholas Burns, dëshmon në Kongres se moszgjidhja e statusit nuk ishte më e qëndrueshme dhe e dëshirueshme. Ai vazhdon, duke thënë se SHBA-ja mbështet shqyrtimin e standardeve në vitin 2005, gjë që me gjasë çon kah bisedimet për status në fund të vitit. Zgjidhja pritet të arrihet në fund të vitit 2006 dhe lidhur me këtë SHBA-ja do të mbetet partner aktiv në Kosovë.⁵⁰⁸ Ishte e qartë se situata në vendnumëro s’do të mbetej përgjithmonë. Ajo kërkonte lëvizje dhe ndryshime, sepse mund të shpërthente. Për dallim nga Bosnja “që ishte bërë e lirë dhe e pavarur pas ndërhyrjes së NATO-s, Kosova ishte vetëm e lirë”⁵⁰⁹, shkruanin Holbrooke dhe Kouchner. SHBA-ja do fillojë të jetë më aktive edhe për çështjen e përcaktimit të statusit final të Kosovës. Në këtë aktivitet dëshironin sërish të kishin në funksion Grupin e Kontaktit dhe preferonin edhe Kombet e Bashkuara. Por pavarësisht angazhimit të këtyre mekanizmave, gjendja në Kosovë nuk lejonte komoditetin e pritjes pa kufi të bisedimeve për statusin final. Grupi i Kontaktit kishte caktuar parimet e negociatave, Martti Ahtisaari kishte filluar procesin e negocimit, ndërkohë Administrata kishte emëruar ambasadorin, Frank Wisner, si Përfaqësues Special i Sekretarit të Shtetit për bisedime rreth statusit⁵¹⁰, por Serbia sipas zakonisht vazhdonte me lojën e shtyrjes dhe të sabotimit të negociatave. Llogariste edhe ndonjë ndryshim të situatës në favor të saj, por dhe përkrahjen ruse. Përkrahja ruse nuk mund të plotësonte tërësisht dëshirat dhe kërkesat serbe. Por, ishte e qartë se kur çështja e favorshme për Kosovën të vinte në Këshillin e Sigurimit, nuk do të gëzonte përkrahjen ruse. Kjo megjithatë nuk do të ndalonte procesin. Këtë e kishte bërë të qartë Sekretarja e Shtetit, Condoleeza Rice, pas një takimi në Moskë me Presidentin Putin, kur ishte shprehur: “ishte jashtëzakonisht e rëndësishme të pranohej se Kosova kurrë më nuk do të jetë pjesë e Serbisë,

⁵⁰⁸ Po aty, fq.28.

⁵⁰⁹ *The Good and Bad, and the Ugly*, By Richard Holbrooke and Bernadr Kouchner, Wall Street Journal, October 9, 2003, cituar nga: *Dario Malnar, SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.283.

⁵¹⁰ Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S. Policy: Background to independence, updated June 2008, fq.28.

sepse ajo është e pamundur”.⁵¹¹ Pak ditë më parë, më 28 prill 2007, në Konferencën e Brukselit, ndihmëssekretari i shtetit, Daniel Fried, kishte thënë: “Kosova do të jetë e pavarur me apo pa rezolutë të Kombeve të Bashkuara dhe Rusia duhet të kthehet në marrëveshje për të mbrojtur minoritetin serb“. Ish ndihmësi i sekretarit të shtetit, në një mision diplomatik jozyrtar, që në të njëjtën Konferencë është shprehur se nëse Rusia vë veto në planin e Ahtisaarit në Këshillin e Sigurimit, “atëherë do të kemi shpallje të njëanshme të pavarësisë nga Kosova. SHBA-ja do ta njoh këtë pavarësi, dhe shpresoj të njëjtën ditë...disa anëtarë të BE-së do ta bëjnë këtë, disa jo”.⁵¹² Në kohën e negociatave, që po zgjasnin dhe fundi i të cilave në një mënyrë mund të parashihej, ndodhi kulmi i paralajmërimeve amerikane lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës. Presidenti Bush, më 10 qershor 2007, gjatë vizitës që i bëri Shqipërisë, në kryeqytetin Tirana, duke iu referuar negociatave, u shpreh: “herët më mirë se vonë ju keni për të thënë mjaft është mjaft. Më tutje ai vë në pah pozicionin e SHBA-së, ku “pavarësia është qëllimi. Kosova është e pavarur. Çështja është vetëm nëse do të kemi një dialog të pafund për një çështje për të cilën ne tashmë kemi vendosur”. Pozicioni i SHBA-së u përsërit një muaj më vonë nga Sekretarja e Shtetit, Condoleezza Rice, që deklaroi:

*“në një mënyrë apo në një tjetër, Kosova do të fitojë pavarësinë, pavarësisht kundërshtimit rus në OKB. Europianët japin shenja të lëvizjes në këtë drejtim.”*⁵¹³

Qasja amerikane ndaj Kosovës, lirisë së saj dhe pavarësisë mund të analizohet nga këndvështrime të ndryshme dhe mund të bëhen studime edhe më të thella, të cilat do të mund të vënë në pah lëvizjet brenda administratës dhe ndryshimet e qëndrimeve sipas rrethanave globale dhe situatës në terren. Pavarësisht evoluimit në favor të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, që ndonjëherë ka mundur të duket i ngadalshëm, pa angazhimin e diplomacisë amerikane vështirë se do të arrihej pavarësia e Kosovës. Vetëm angazhimi i drejtpërdrejtë amerikan dhe që në momente ka qenë unilateral ka mundur të sjellë pavarësinë e Kosovës dhe ky lloj angazhimi, më herët kishte vendosur paqen në Bosnjë dhe Herzegovinë. Pas “vijës së kuqe”, që kishte tërhequr Bushi senior, Bushi Junior e vërtetoi këtë duke e njohur formalisht Kosovën, sepse njohjen faktike të së cilës e kishte bërë pak më herët.

⁵¹¹ Rajs: *Kosovo vise nece biti deo Srbije*, B92, 15 maj 2007, cituar nga: Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, fq.318.

⁵¹² Verbeke: *Ska afat për vendim*: “B92, 29 prill 2007. Cituar nga ICG: *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari plan*, Europe Report No182-14 maj, 2007, fq.9.

⁵¹³ http://www.stratfor.com/weekly/georgia_and_kosovo_single_intertwined_crisis (qasur me 23 dhjetor 2013)

6.3. Roli i Republikës së Shqipërisë dhe zhvillimet në Kosovë

Roli i Republikës së Shqipërisë, në zhvillimet në Kosovë mund të karakterizohet si politik, diplomatik, arsimor, ushtarak, kulturor, ekonomik, etj. Të gjitha mund të shtjellohen dhe të analizohen nga këndvështrime të ndryshme, por që të gjitha derivojnë nga një që është shumë e rëndësishme: vetë ekzistimi i Shqipërisë i rumbullakëson të gjitha. Roli i Republikës së Shqipërisë në kontekst të procesit të pavarësisimit të Kosovës mund të ndahet në periudha të caktuara kohore, nëpër të cilat janë zhvilluar ngjarjet. Disa nga këto kanë qenë më të frytshme e disa nuk janë vërejtur fare. Dhe në disa, në nuanca të caktuara, ka pasur edhe dëme të tërthorta.

Fundi i Luftës së Dytë Botërore nuk do të shënojë thellimin e miqësisë së ngushtë jugosllavo – shqiptare, të ndërtuar sidomos gjatë luftës dhe frymës internacionaliste të proklamuar nga partitë komuniste të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë. Dallimet ideologjike brenda së njëjtës ideologji do të jenë një ndër shkaqet e prishjes së raporteve në mes të shtetit shqiptar dhe shtetit jugosllav. Kjo do të rezultojë me mbylljen hermetike të kufijve shtetërorë. Dhe kjo mbyllje do të jetë vazhdim i fatkeqësisë së popullit shqiptar të Kosovës, por edhe gjithë popullit shqiptar. Mbyllja e kufirit do të shënojë një ndërprerje të marrëdhënieve shqiptaro – shqiptare, ndërprerje kjo që nuk do të përjashtojë as lidhjet thjesht familjare që ekzistonin në mes njerëzve. Kështu Shqipëria dhe Kosova për një kohë shumë të gjatë janë sjellë si dy botë krejtësisht të ndara njëra me tjetrën.⁵¹⁴

Dhe këto dy botë të ndara, megjithatë do të ushqejnë njëra -tjetrën në mënyra jo të zakonshme, por gjithsesi të rëndësishme. Ka mundur të jetë ndryshe pa dyshim, por në rrethanat e krijuara, jo. Jo, sepse kontaktet tashmë bëhen krejtësisht ndryshe. Propaganda e medieve shqiptare (kryesisht TV dhe radio) megjithatë ushqen botën shqiptare në Kosovë nëse jo me asgjë tjetër, së paku me shpresë. Shqiptarët në Kosovë, të ushqyer nga një propagandë e paparë komuniste dhe duke u mbështetur në forcën e shtetit shqiptar që jepte shpresë vazhdonin të idealizonin arritjet e shtetit shqiptar dhe vazhdojnë të ushqehen me shpresën se në rrethana të rrezikut, shqiptarët do të reagonin si të tërë. Dhe kjo frazë që ushqehet në mendjen e shqiptarëve të Kosovës do të dëgjohet e shprehur pas disa dekadash, si “Nëse Serbia do të veprojë

⁵¹⁴ Esat Stavileci, *Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Kollokiumi shkencor 15 qershor 2011, botuar në vitin 2012, Prishtinë, fq.18.

ushtarakisht në Kosovë për asgjësimin e shqiptarëve atje, atëherë shqiptarët do të veprojnë si komb”.⁵¹⁵ Por, për të ardhur deri te ky moment u deshën shumë vite. E gjatë këtyre viteve kontaktet shqiptaro – shqiptare ishin shndërruar në kontakte të rralla familjare, ku ai/ajo, që rastësisht fitonte nga rasti që të vizitonte Shqipërinë, konsiderohej si njeri që e ndiqte fati i madh. E shqiptarët nga Shqipëria, kur rastiste të vizitonin Kosovën, shikoheshin si qenie të jashtëzakonshme. Dhe edhe të parët dhe edhe të dytët ndiqeshin me heshtjen. Kosovarët kur të ktheheshin do të heshtin apo do të tregojnë vetëm për gjërat e mira, kurse qytetarët shqiptarë gjatë qëndrimit në Kosovë kryesisht ishin të heshtur. Kjo sikur bënte që diçka të mos bëhej e njohur. Nuk ishte e njohur dhe nuk merrej me mend se „socializmi te shqiptarët kishte përmasat e një katastrofe kombëtare, të një fatkeqësie natyrore. Ai përveç që shkatërroi vlera dhe krijoi dramën më të dhembshme individuale dhe kolektive, për pesëdhjetë vjet shkëputi kontinuitetin e natyrshëm të zhvillimit të një populli pikërisht në një shekull kur dinamika e zhvillimit arrin tempin më të lartë”.⁵¹⁶ Por pavarësisht mbylljes dhe ndarjes, shkëputja totale e dy pjesëve të një trangu nuk mund të bëhej plotësisht. Lidhjet, sado të vogla dhe pavarësisht formës së manifestimit mbaheshin. Nuk është qëllimi i këtij studimi për t’u futur në arkivat shqiptare dhe serbe, për të nxjerrë prapaskenat dhe marrëveshjet e mundshme në mes të dy shteteve dhe për qëllimet e tyre për të ardhmen në Ballkan. Nuk është gjithashtu qëllimi që të nxjerrim të pavërtetat, të vërtetat apo gjysmë të vërtetat, që janë zhvilluar në prapaskenë, e për të cilat kanë mundur të dëgjohen seri të shumta teorish konspirative. Nuk ka asnjë dyshim se roli i Shqipërisë për zhvillimet në Kosovë duhet studiuar dhe kjo tash mund të bëhet shumë më lehtë, sepse qasjet në arkiva janë më të lehta. Të përmendim edhe një fakt te media shqiptare, e cila siç u tha te populli shqiptar në Kosovë ushqente shpresë, por ajo gjatë regjimit të Enver Hoxhës, brenda popullit shqiptar në Shqipëri kishte efekt krejt tjetër. “Për shkak të kufizimeve të medias dhe propagandës që zhvillonte regjimi i Hoxhës, shqiptarët në Shqipëri dinin më shumë së çfarë ndodhte në Mozambik sesa në Kosovë...Ndonëse Enver Hoxha u përpoq ta ndiqte çështjen kombëtare në mes të rezistencës gjatë kohës së luftës, në periudhën pas luftës ai në mënyrë të vazhdueshme e ka tradhtuar çështjen e bashkimit kombëtar në interes të stabilitetit të regjimit të vet në Tiranë”.⁵¹⁷ Edhe në politikën e jashtme, shteti shqiptar i kohës së regjimit të Enver Hoxhës

⁵¹⁵ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.400.

⁵¹⁶ Mehmet Kraja, *Mirupafshim në një luftë tjetër*, Rozafa, Prishtinë, 2003, fq. 26.

⁵¹⁷ Miranda Vickers&James Pettifer,*Shqipëria-Nga anarkia te një identitet ballkanik*,Toena,Tiranë, 1998, fq.143.

nuk kishte bërë atë që ka mundur të bëjë. Pavarësisht faktit se shteti shqiptar ka ndjekur një politikë krejtësisht të mbyllur, megjithatë në kontekst të ndërkombëtarizimit, ka mundur të bënte më shumë. Qeveria shqiptare asnjëherë nuk e ngriti çështjen e Kosovës para forumeve të tilla ndërkombëtare si OKB dhe Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut, as nuk ndërhyri drejtpërdrejt në politikën e brendshme të Kosovës.⁵¹⁸ Por pas demonstratave të vitit 1981 kursi i politikës shqiptare megjithatë merr ngjyra dhe kahje të tjera. Përballë krizës së Kosovës të pranverës së vitit 1981, politika e jashtme e Shqipërisë reagoi në mënyrë shumë aktive, duke ndryshuar, zhvilluar dhe duke shpalosur publikisht ide e qëndrime që nuk i kishte bërë asnjëherë më parë. Politika e jashtme e Shqipërisë për herë të parë hodhi dritë mbi të vërtetën historike të Kosovës, mbi gjendjen politike të saj në kuadër të Jugosllavisë, mbi statusin dhe të drejtat që do të duhej të gëzonte Kosova.⁵¹⁹

Kontaktet politike për kohë të gjatë ishin thuaja joekzistente në mes strukturave politike shqiptare dhe kosovare. Kurse raportet në mes të dy shteteve (Jugosllavisë dhe Shqipërisë) në vitet shtatëdhjeta shënojnë një përmirësim dhe afrim. Si rrjedhojë , me 5 shkurt 1971 , qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Jugosllavisë ngrehin nivelin e përfaqësimit diplomatik në nivel ambasadorësh dhe të shkëmbejnë ambasadorët e tyre.⁵²⁰ Kontakte të drejtpërdrejta pothuaj nuk kishte fare deri në procesin e shpërbërjes së federatës jugosllave. Ndërsa kontakte individuale mbaheshin dhe një rëndësi të veçantë për Kosovën kishte literatura, sidomos ajo e fushës së letërsisë që ka luajtur rol shumë të rëndësishëm për Kosovën dhe për edukimin në Kosovë. Në kohën e themelimit të Universitetit të Prishtinës ndihma e ardhur nga Tirana ishte e rëndësishme së veçantë. Me 1970, ky Universitet i ri nënshkroi një marrëveshje me Universitetin e Tiranës; më se 200 profesorë nga Tirana do të vijnë në Prishtinë gjatë pesë vjetëve të ardhshëm për të mbajtur ligjërata në gjuhën shqipe duke përdorur edhe tekste të botuara në Shqipëri.⁵²¹ Në kuadër të këtij procesi, brenda një viti në Kosovë erdhën nga Shqipëria 7 grupe pedagogësh me gjithsej 38 veta për leksione e konferenca pasuniversitare si edhe 8 kuadro të larta për cikle të shkurtra ligjëratash dhe për ligjërata të veçanta. USHT për katedrat e UP dërgoi edhe nga 5 ekzemplarë të

⁵¹⁸ Po aty.

⁵¹⁹ Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vetizolimit – Rasti i Shqipërisë 1961 – 1989*, GEER, Tiranë, 2004, fq.592-593.

⁵²⁰ ASHAK, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1979-1988, Numri i lëndës 36, kutia 3, f.1. Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë dhe pozita e KSA të Kosovës e detyrat e saj. (sipas Sabit Syla, *Disertacioni doktorale-Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti: Histori-Filologji, Departamenti i Historisë, Tiranë 2011, fq.149)

⁵²¹ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë & shtëpia e librit Tiranë, 2001, fq.26.

të gjitha botimeve të veta të fundvitit, si dhe nga botimet e mëparshme u dërguan rreth 200 tituj me rreth 800 ekzemplarë...⁵²² Kontributi i këtyre profesorëve për zhvillimin e universitetit të parë në Kosovë dhe bashkëpunimi ndëruniversitar është i rëndësisë së veçantë. Kështu, marrëdhëniet e bashkëpunimit ndëruniversitar i ndihmuan shumë shqiptarët e Kosovës si dhe ata të viseve të tjera (...); u mbajtën një sërë konferencash me studiues nga të dy anët e kufirit kushtuar ngjarjeve të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, si: Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, mbajtur në Tiranë nga data 12-18 janar 1968, Simpoziumi kushtuar 500 -vjetorit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në Prishtinë, 9-12 maj 1968; Sesioni shkencor mbajtur në Tiranë me 25 maj 1971, me rastin e 125 -vjetorit të lindjes së shkrimtarit Naim Frashëri; Konferenca Kombëtare e Folkloristikës Shqiptare, mbajtur në Tiranë më 26-27 maj 1972; Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, mbajtur në Tiranë më 15-20 shtator 1972; Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, mbajtur në Tiranë më 20-25 nëntor 1972, etj.⁵²³ Edhe pse qëndrimi i profesorëve shqiptarë sikundër edhe aktivitetet si këto të përmendura më lart nuk do të jenë të gjata, për nga koha, rëndësia dhe kontributi i tyre nuk mund të zbehet. Demonstratat e vitit 1981 në një mënyrë shënojnë largimin e përgjithshëm të profesorëve shqiptarë sikundër shënohet edhe ndërprerja e bashkëpunimit kulturor, që ishte në rritje edhe pse e vogël dhe kryesisht përmes vizitave të trupave të teatrit apo të grupeve dhe ansambleve shqiptare në Kosovë. Por demonstratat e këtij viti, me përjashtim të një heshtjeje vetëm gjatë ditëve të para, shënojnë reagimin mediatik të shtetit komunist shqiptar kundër dhunës dhe terrorit jugosllav në Kosovë. Flitet edhe për reagime diplomatike, të cilat në ato vite ndikuan disi për një mbyllje , por përkohësisht sepse së paku nga efektet e kohës, nuk u duk se patën ndikim të madh. Kjo se ai shtet fatkeqësisht nuk po mbronte as qytetarët e vet. Socializmi te shqiptarët ishte imponuar dhe nuk është pranuar. Me refuzimin masiv të socializmit (i cili nuk përputhej me mentalitetin e trashëguar shqiptar) shpjegohet edhe ashpërsia e diktaturës në Shqipëri, por edhe gjenocidi i vazhdueshëm që u ushtrua gjatë kësaj periudhe mbi shqiptarët në Jugosllavi. Në të dyja rastet, viktima të dhunës e të shfarosjes permanente ishin shqiptarët e pabindur dhe jolojalë ndaj ideologjisë komuniste.⁵²⁴ Në një gjendje të tillë propaganda mbetej mjeti më i fortë i kundërshtimit të dhunës dhe i terrorit të shtetit serb. Ato që sot hasen aty -këtu në debate të ndryshme, që ushtria shqiptare ishte në mobilizim të plotë, se po përgatiteshin apo se ishin

⁵²² Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 – 1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2012, fq.192.

⁵²³ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 – 1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2012, fq.196.

⁵²⁴ Mehmet Kraja, *Mirupafshim në një luftë tjetër*, Rozafa, Prishtinë, 2003, fq.27.

përgatitur plane ushtarake për të sulmuar Jugosllavinë më shumë mund t'i ngjajnë spekulimeve fantastike, sesa një realiteti të kohës. Për më tepër edhe po të kishin qenë të vërteta, rezultati do të mbetej hipotetik. Sidoqoftë, dhuna dhe terrori shtetëror serbo-jugosllav nxisin një largim të dhunshëm sidomos të rinjve nga Kosova në vendet e perëndimit dhe aty -këtu kishte edhe individë të caktuar që arrinin të kalonin kufirin shqiptar për të gjetur strehimin dhe shpëtimin. Nëpër disa vende të perëndimit do të organizohen grupe të njohura si marksiste-leniniste, disa nga të cilat do të vendosin kontakte me shërbimet diplomatike shqiptare dhe madje disa edhe do të vizitojnë Shqipërinë. Por reagimi i Tiranës mbetet retorik dhe periodik. Politika e përgjithshme e Tiranës ishte që të bënte një deklaratë periodike për konfliktin në vazhdim, për shembull mbi “barazinë e të drejtave” të kosovarëve, dhe herë pas here të botonte vëllime me dokumente për këtë çështje. Gjatë viteve 1980 për arsye ekonomike dhe të sigurimit, Tirana u rropat të vendoste marrëdhënie të mira më shumë me Beogradin sesa me Prishtinën, dhe ndonëse disa grupe të lidhura ideologjikisht me Tiranën ishin përfshirë në veprimtari armiqësore në Kosovë, ato shërbenin vetëm si një faktor që i krijonte shqetësime udhëheqjes shqiptare.⁵²⁵ Se çfarë ka qenë ndikimi i këtyre grupeve dhe i këtyre individëve në shtetin shqiptar dhe anasjelltas është gjithashtu çështje që meriton shtjellim në ndonjë punim tjetër. Por është e qartë se politika shqiptare që nga viti 1948 deri te rënia e Murit të Berlinit ka bërë më pak sesa realisht mund të bënte. Pasi Tito u shkëput nga Stalini në vitin 1948, Jugosllavia i shkëputi marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, e cila mbeti lojale ndaj Moskës. Ndërkohë mijëra shqiptarë arrestohen jo si “fashistë”, siç ishin trajtuar më parë, por si “stalinistë”.⁵²⁶ Rënia e murit të Berlinit dhe procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë shënon kohën e diziluzionizimit në një anë, por në anën tjetër edhe rivënien e kontakteve, duke filluar nga ato individuale e private, për të vazhduar me ato institucionale. Institucionet e reja të shtetit shqiptar pas zgjedhjeve të para, sado të pakonsoliduara dhe sado të brishta, së pari ndryshojnë qasjen shqiptare ndaj çështjes së Kosovës, por edhe qasjen ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi. Qysh nga kjo kohë roli i Shqipërisë në skenën ndërkombëtare vjen duke u shtuar në rrafshin politik dhe diplomatik, por tërthorazi edhe ushtarakisht. Dhe nga kjo nuk mund të shkëputet konteksti kosovar. Kurse marrëdhëniet në mes institucioneve të Kosovës dhe atyre shqiptare kohë pas kohe përjetojnë edhe turbulenca dhe kundërshtime opsionesh. Profilizimet partiake në të dyja anët, në momente

⁵²⁵ Miranda Vickers & James Petiffer, *Shqipëria nga anarkia te një identitet ballkanik*, Toena, 1998, fq.145.

⁵²⁶ G. Richard Jansen, <http://amar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>, fq.5 (parë më: 29.12.2013).

të caktuara, krijojnë situata kur palët bëjnë tifozëri njëra për tjetrën duke ndikuar tërthorazi te njëri entitet shtetëror. Në momente të caktuara ndërhyrja e politikës së shtetit shqiptar krijonte përçarje politike në Kosovë. Opsionet, që propozonte politika shqiptare, në këto momente nuk ishin të akorduara me kërkesat e shprehura politike të shqiptarëve të Kosovës. Kështu për një kohë, opsioni kryesor kishte të bënte me “kthimin e autonomisë së vitit 1974 në Kosovë”, si kusht i fillimit të bisedimeve midis Prishtinës dhe Beogradit, në prani të një pale të tretë. Në të vërtetë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e njohu shtetin e Kosovës në vitin 1991 dhe mbi bazën e kësaj njohjeje në Tiranë u hap zyra e përfaqësimit diplomatike të Kosovës.⁵²⁷ Sidoqoftë, është e ditur se në Shqipëri kishin filluar stërvitjet e para ushtarake të grupeve të UÇK-së. Dhe këto stërvitje do të zgjerohen sa më shumë që shtohet terrori serb ndaj popullit të Kosovës. Kurse, kolapsi i sistemit shtetëror shqiptar dhe i institucioneve ndryshon në mënyrë dramatike situatën. Depot dhe magazinat e armatës dhe Ministrisë së Brendshme shpërthyen dhe kështu UÇK-ja siguroi armë në dispozicion. Nga shkaku i kolapsit të sistemit të sigurisë dhe rënies së fuqisë së ligjit në Shqipëri, bëhet e mundur që të organizohen trajnime në veri afër kufirit me Kosovën. Kjo ka treguar se ishte kushti më i rëndësishëm për mobilizim dhe trajnim permanent, për organizim të rrugëve të furnizimit dhe për përpjekjet e para të koordinimit të grupeve regjionale dhe lokale të luftës.⁵²⁸ Konflikti i armatosur shkaktonte pasoja të mëdha, që do të kenë implikime të drejtpërdrejta në shtetin shqiptar, që ishte në një fazë konsolidimi pas shkërmoqjes së vitit 1997. Nga beteja e zhvilluar në Rrafshin e Dukagjinit, popullata vendore shndërrohet në refugjatë dhe si të tillë do të kërkojnë strehim në shtetin shqiptar. Kurse fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999 do ta shndërrojë shtetin shqiptar si rast unikal të mirëpritjes së refugjatëve dhe miradministrimit të situatës. Shqipëria si shtet do të mbushet me një numër të madh të ikurish nga lufta. Shqipëria do të bëhet vendi ku njerëzit ushqeheshin me shpresë. Shqipëria ishte bërë qendër e diplomacisë dhe e gazetarisë së botës. Por edhe vendi i vetëm ku ushtarët e UÇK-së mund të gjenin shërim dhe armatim. I gjithë shteti shqiptar, të gjitha institucionet shqiptare ishin vënë në shërbim të shpëtimit dhe të strehimit të sigurt të qindra mijëra refugjatëve kosovarë. Por në anën tjetër i gjithë mekanizmi shtetëror, mediet, etj., ishin mobilizuar për t’i shërbyer humanizmit dhe drejtësisë. Edhe diplomacia shqiptare ishte vënë e tëra në dispozicion të lëvizjes politike dhe ushtarake kosovare sikundër edhe në dispozicion të diplomacisë botërore. Në një

⁵²⁷ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.400.

⁵²⁸ Shih më shumë: Independent International Commission on Kosovo report.

situatë të këtillë, në Rambouillet, organizohet Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën. Ishte Konferencë që do të determinojë fatin e të ardhmes së Kosovës. E aty kërkohej unitetit në radhë të parë i gjithë spektrit shqiptar. Qeveria shqiptare kishte mobilizuar të gjitha kapacitetet politike e diplomatike, por edhe ekspertët e fushës për t'i vënë në dispozicion të grupit negociator në Konferencë. Në këtë kontekst, qeveria e Majkos kërkoi nga grupi negociator i shqiptarëve të Kosovës koherencë dhe pajtim me kërkesat e marrëveshjes së paraqitur në të. Edhe diplomacia shqiptare vebet në shërbim të mirëfilltë të luftës së drejtë të shqiptarëve në Kosovë, sikundër që është në koordinim të plotë me bashkësinë ndërkombëtare. Përfaqësuesi shqiptar në Këshill të Sigurimit, është shprehur "...bashkësia ndërkombëtare ka intervenuar me qëllim të ndërprerjes së katastrofës humanitare...Republika e Shqipërisë plotësisht përkrah akcionin ushtarak të Organizatës veriperëndimore dhe konsideron se akcioni i shërben paqes dhe sigurisë në regjion".⁵²⁹

Shkrimtari i shquar shqiptar, Ismail Kadare, ishte interlokutori më autoritativ që ndikoi në gjetjen e një konsensusi midis fraksioneve politike të Kosovës.⁵³⁰ Mobilizimi gjithëpërfshirës bëri që serbët të humbin luftën, gjatë së cilës pavarësisht formës së manifestimit, shqiptarët vepruan si një. Para se të përfundojmë me këtë pjesë që meriton studim dhe vështrim të veçantë, duhet nënvizuar se pa ekzistimin e shtetit shqiptar dhe pastaj pa mobilizimin e tij, do të ishte e vështirë të parashihej përfundimi i luftës së Kosovës. Cilado që të jetë analiza dhe pavarësisht këndvështrimit, rezultati do të dalë se roli i shtetit shqiptar është kyç për shpëtimin e shqiptarëve të Kosovës dhe për lirinë dhe pavarësinë e saj. Si përmbyllje të kësaj pjesë do të shërbejë letra e Ismail Kadesë, drejtuar grupit negociator në Rambouillet, që i vë vulën angazhimit të shtetit shqiptar dhe të gjithë përbërësve të tij, pa angazhimin e të cilëve çështja e Kosovës hipotetikusht mund të studiohej vetëm si një zonë dikur e banuar me shumicë shqiptare, që sot do të përbënte një pakicë.

Delegacionit shqiptar në Konferencën për Kosovën

Në pamundësi t'ju them gojarisht disa mendime të miat për atë çka po pret gjithë kombi shqiptar prej jush, më lejoni t'ju drejtohem më këtë letër të shkurtër. Një shqetësim i orëve të fundit u bë

⁵²⁹ UN Security Council, 3988th meeting, 24 March 1999, Doc. S/PV. 3988, p.18

⁵³⁰ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës juglindore, Tiranë, 2012, fq.403.

nxitje për këtë letër, e sidomos deklarata e Madeleine Albright se: a) nëse të dy palët nuk bien dakord, nuk do të ketë ndërhyrje ushtarake në Jugosllavi dhe b) nëse shkas për dështim bëhen shqiptarët, ndihma ndaj tyre do të pritët.

Besoj se jam në gjendje të dalloj deklaratat që bëhen për arsye presioni nga ato që shprehin një të vërtetë më të thellë. Nga njoftimet që kam dhe nga një intuitë alarmuese, kam bindjen se deklarata e ministres amerikane duhet marrë me seriozitetin më të madh.

Në të dyja rastet, pra edhe sikur të dyja palët, serbe e shqiptare, të mos bien dakord, e sidomos në rastin e dytë, sikur faji t'u mbetet shqiptarëve, serbët dalin të fituar. Dhe në të dyja rastet, shqiptarët dalin të humbur.

Me sa duket, strategjia serbe është bazuar pikërisht në këtë kurth: t'i bëjë shqiptarët bashkëfajtorë, madje edhe fajtorë, dhe vetë të dalë e larë. Serbët s'kanë ç'kërkojnë më shumë nga kjo Konferencë. Për ata do të jetë fitore e madhe. Mendoj se kjo është mjaft për të kuptuar se kurrsesi delegacioni shqiptar nuk duhet të bjerë në grackë.

Pyetja dramatike që shtrohet është: Ndonëse aspirata jonë është e madhe, po megjithatë a mund të kënaqemi me aq sa kemi fituar? A mund të arrihej më shumë nga një fazë e parë kalimtare prej tre vitesh?

Mendoj se tani për tani mund të mbetemi me kaq se vështirë se mund të arrihej më shumë në një fazë kalimtare. Ky është një shans i madh përpara popullit shqiptar të Kosovës dhe përpara gjithë kombit shqiptar. Historia shumë herë e ka treguar se jo çdo luftë, sado heroike të jetë, e sjell një shans të tillë. Dhe shanset nuk përsëriten kaq lehtë. Kam bindjen se këtij shansi kurrsesi nuk i duhet rënë me shkelm.

Bindja ime bazohet në faktin se interesimi botëror për Kosovën ka arritur pikën maksimale. Kurrë më në të ardhmen nuk mund që ky interesim, ky preokupim, ky seriozitet, të përsëdytet. Qysh tani, ky interesim ka filluar të quhet i tepruar dhe ka zgjuar xhelozinë e disa vendeve dhe popujve. Rrjedhimisht, pas harxhimit të kësaj vëmendjeje, masakra edhe më të mëdha në Kosovë do të zgjojnë vëmendje shumë më të vogël. Bota do ta quajë ndërjegjen të lartë dhe kjo do të jetë fatale për Kosovën.

Jam i sigurt së serbët presin me padurim „jo-në” shqiptare. Dhuratë më të madhe nuk mund të ketë për ta.

Në këto kushte mendoj që të merret ajo që mund të merret dhe të mos kërkohet tani për tani e pamundura. Një Konferencë tjetër për Kosovën pas tre vitesh e lë portën e lirisë të hapur. Unë e kuptoj ndjenjën tuaj të përgjegjësisë, e kuptoj drojën se mos bëni ndonjë lëshim që s’duhet bërë. Në këtë rast, më lejoni t’jua kujtoj, se unë si shkrimtar, nuk do të guxoja kurrë t’jua jepja këtë këshillë, sikur unë të kisha vetë drojën më të vogël se po bëja një faj që do të rëndonte ndërgjegjen dhe në biografinë time. Duke jua drejtuar këtë letër, jam i gatshëm t’i mbroj mendimet e mija publikisht, përpara kujtdo e bashkë me të, të mbroja gjer në fund vendimin tuaj.

Ju përfaqësoni sot popullin shqiptar të Kosovës në momentin më delikat. Nga urtësia, trimëria, ndershmëria juaj, bashkë me fatin e Kosovës varen fate të tëra jetësh njerëzore, varen jetë grash, fëmijësh e burrash. Në këtë rast do doja të përsërisja se të bësh lëshim atëherë kur duhet bërë, është po aq trimëri e heroizëm, sa edhe kur je në luftë. Ju lutem mos dëgjoni rrahagjoksët e papërgjegjshëm, të cilët e kanë lehtë të bërtasin: o pavarësi menjëherë, o të bëhemi shkrumb. Askush s’ka të drejtë të propozojë shkrumbin dhe vdekjen për popullin e vet. Ju jeni aty për lirinë, pra për jetën e Kosovës dhe jo për vdekjen e saj.

Përshëndetjet e mia më të përzemërta, bashkë me shpresën se do të më kuptoni drejt.

*Ismail Kadare*⁵³¹

6.4. Zbehja e UNMIK-ut dhe vendosja e EULEX-it

Popullariteti dhe autoriteti i UNMIK-u, siç është parë ka shënuar rënie të vazhdueshme, derisa në një moment të caktuar, jo vetëm perceptimet, por edhe bindjet kanë qenë se po bëhej pengesë për zhvillimin e Kosovës, sidomos në zhvillimin ekonomik dhe në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Qysh nga lançimi i projektit “standardet para statusit” ishte bërë e qartë se nevojitej një diçka tjetër që do të zëvendësonte UNMIK-un, pavarësisht të mirave dhe dobive që kishte sjellë ky mision. E tash ishte edhe burim i pengesave që gradualisht pengonin ecurinë dhe ritmin e kërkuar për zhvillime në Kosovë. Misioni i UNMIK-ut kishte qenë i qartë, por bisedimet

⁵³¹ Wolfgang Petritsch&Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, fq.207-209.

për statusin e Kosovës po tregonin se Kosovës do t'i duhej një mbikëqyrje ndërkombëtare e tjetërllotjë. Dhe mbikëqyrja e tjetërllotjë nuk do të përjashtojë ekzistimin e Rezolutës 1244, e cila është në fuqi edhe në kohën kur po shkruhet ky punim. Për më tepër Plani Gjithëpërfshirës për statusin final të Kosovës (pakoja e Ahtisaarit) parashihte, krahas të tjerave edhe vendosjen e një Misioni European për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.⁵³² Në këtë kontekst ky mision do të udhëhiqej nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit European i cili do t'i ushtrojë kompetencat sipas nenit 2.3 të shtojcës IX të Pakos së Ahtisaarit. Kurse shkaqet pse ishte zbehur autoriteti i UNMIK-ut janë dhënë në kreun pesë. Por në këtë kohë, kur po bëhej e qartë se Plani i Ahtisaarit nuk do të kalonte përmes rrugëve të OKB-së, nga shkak i, në radhë të parë, kundërshtimit rus, prandaj duhej gjetur një zgjidhje e shpejtë. Dhe, “dilema u zgjidh nga Ministrat e Jashtëm të Këshillit të Europës të cilët nguten me një veprim të përbashkët duke krijuar EULEX-in, përpara se Kosova të shpallte pavarësinë dhe kjo ishte koha kur asnjë shtet i BE-së nuk do të kundërshtonte krijimin e EULEX-it.⁵³³ Dhe pas më pak se dy javësh nga vendosja e EULEX-it, Kosova e shpalli pavarësinë e saj, me 17 shkurt 2008.⁵³⁴ Ndërkohë, që “Investigimet e skolarëve për rolin e BE-së si menaxher konfliktesh globale, tregojnë se, tani për tani, kjo është fushë relativisht pak e zhvilluar për kërkesa akademike. Megjithatë është bërë një punë e rëndësishme në të dyja drejtimet: në procesin e politikave të brendshme të BE-së për zhvillimin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) dhe Politikave të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (ESDP) dhe aplikimin e këtyre politikave në vende dhe regjione specifike dhe gjithashtu një rritje e një trupi të literaturës për Politikën Europiane të Fqinjësisë (ENP)”.⁵³⁵ E planifikimi për vendosjen e misionit të BE-së në Kosovë kishte filluar më: “10 prill 2006 me krijimin e Ekipit Planifikues të BE-së (EUPT), që synonte sigurimin e tranzicionit të qetë të përgjegjësive nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi misionin e ardhshëm të Bashkimit European (BE) në Kosovë”.⁵³⁶ Planifikimi filloi sepse ekzistonte

⁵³² Shih shtojcën X të Pakos së Ahtisaarit.

⁵³³ V. Dzhic/H. Kramer (note 1), 7, cituar nga: Robert Muharremi, *The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law*, 2010 Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht/ZaöRV 70, 2010, fq.10.

⁵³⁴ KIPRED - Analizë Politike, Nr.1/13, Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç'ka më tutje*, Prishtinë, 2013, fq.6.

⁵³⁵ Stefan Wolff-*Learning the Lessons of Ethnic Conflict Management? Conditional Recognition and International Administration in the Western Balkans since the 1990*-Nationalities Papers, Vol. 36, No. 3, July 2008, ISSN 0090-5992 print; ISSN 1465-3923 online/08/030553-19#2008 Association for the Study of Nationalities, fq.9.

⁵³⁶ KIPRED-Analizë Politike, Nr.1/13, Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç'ka më tutje*, Prishtinë, 2013, fq.6.

shpresa, se bisedimet për statusin e Kosovës do të sillnin një rezultat. Gjë që nuk ndodhi. Ky mision që kishte EULEX-i nuk është larguar nga kornizat e Rezolutës 1244, por ka edhe baza ligjore⁵³⁷ të tjera që burojnë nga Bashkimi Europian dhe Kosova gjithashtu. Këtu duhet shtuar se mandati i EULEX-it është paraparë gjithashtu me Deklaratën e Pavarësisë, me Planin Ahtisaari, me Kushtetutën e Kosovës dhe me ftesën e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Kosovës.⁵³⁸ Dhe funksionalitetin e plotë, EULEX-i e ka arritur në prill të vitit 2009.⁵³⁹ Sot ky mision, përkrahët nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, sikundër janë edhe pesë shtete të tjera që konsiderohen si shtete kontribuese: Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe SHBA-ja.⁵⁴⁰ Gjatë kohës së përfundimit të këtij studimi, ende diskutohet për formën që do të ketë ky mision në të ardhmen, ndërkohë që mandati aktual i misionit është paraparë të zgjasë deri më 14 qershor 2014. Ky mandat është përcaktuar të përfundojë me këtë datë, sepse “një marrëveshje, e cila nxjerr objektiva të përbashkëta të sundimit të ligjit është nënshkruar në mes të Ministrit të Drejtësisë së Kosovës, Përfaqësuesit Special të BE-së dhe shefit të misionit, të cilët përkushtohen të forcojnë sundimin më të gjerë të ligjit në Kosovë. Ai është një dokument i rëndësishëm i cili vë kritere të detajizuara, të cilat Kosova, e asistuar nga EULEX-i përmes mandatit të tij për Monitorim – Mentorim – Këshillim (MMK), duhet t’i përmbushë.⁵⁴¹ Sipas shënimeve zyrtare të postuara në faqen elektronike të EULEX-it, ky mision ka në përbërje të vetën një personel prej 2250 anëtarësh vendorë dhe ndërkombëtarë dhe një buxhet vjetor prej 111 milionë euro. Procesi i vendosjes së këtij procesi në Kosovë nuk ka qenë i lehtë, sepse qysh në nismat e tij është menduar që ky mision të jetë neutral ndaj statusit të Kosovës. Që të ishte neutral ndaj statusit të Kosovës nuk ka qenë punë e lehtë në kohën e planifikimit, kurse puna është vështirësuar pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Misioni i EULEX-it, siç figuron nga faqja zyrtare, vetvetiu vërteton sesa e vështirë është të punohet në një situatë kur je neutral përballë statusit të një shteti, duke punuar po brenda këtij shteti, i cili tashmë ka fituar njohje nga

⁵³⁷ COUNCIL DECISION 2012/291/CFSP of 5 June 2012 amending and extending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; New EULEX Organizational Chart; COUNCIL DECISION 2010/322/CFSP of 8 June 2010 amending and extending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; COUNCIL JOINT ACTION 2009/445/CFSP of 9 June 2009 amending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO.

⁵³⁸ Written contribution of the Republic of Kosovo, submitted to the International Court of Justice, April 17, 2009

⁵³⁹ <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php> (qasur me 20 dhjetor 2013).

⁵⁴⁰ <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php> (qasur me 20 dhjetor 2013).

⁵⁴¹ KIPRED - Analizë Politike, Nr.1/13, Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç’ka më tutje*, Prishtinë 2013, fq.23.

23 shtete anëtare të Bashkimit Europian. E, “ misioni i EULEX-it - e përkrah Kosovën në rrugën e saj drejt integriteteve më të mëdha Europiane në fushën e sundimit të ligjit. Aftësitë dhe ekspertiza e EULEX-it janë duke u përdorur në mbështetje të synimeve kryesore të BE-së në procesin e liberalizimit të vizave, studimin e fizibilitetit dhe dialogun Prishtinë - Beograd. EULEX-i, po ashtu, e përkrah dialogun e strukturuar mbi sundimin e ligjit, të udhëhequr nga Brukseli. EULEX-i është duke e vazhduar përkushtimin e tij në luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimit të ngushtë me kolegët vendas për ta arritur qëndrueshmërinë dhe praktikat më të mira të BE-së në Kosovë. EULEX-i i jep prioritet vendosjes së sundimit të ligjit në veri”.⁵⁴² Një vështrim në misionin e EULEX-it mund të ngrejë një seri pyetjesh, përgjigjet e të cilave nuk arrijnë të sqarojnë atë sesi jetësohet mirëfilli neutraliteti i misionit ndaj statusit, por kur ky mision vepron në kuadër të kompetencave të veta ekzekutive, do të shërbehet edhe me ligje vendore. E shumë nga këto ligje janë nxjerrë nga Parlamenti i Republikës së Kosovës – nga Parlamenti i një shteti të pavarur. Dhe siç e përmendëm, EULEX-i ka edhe kompetenca ekzekutive, ndërkohë që, i gjithë misioni ndahet në dy divizione: divizionin ekzekutiv dhe divizionin e fuqizimit. I pari, heton, ndjek dhe gjykon rastet e ndjeshme duke përdorur pushtetin e vet ekzekutiv. I dyti, monitoron mentoron dhe këshillon partnerët vendorë të policisë, të drejtësisë dhe në fushën e doganave,⁵⁴³ kështu thuhet në misionin zyrtar të EULEX-it.

Mandati i EULEX-it është edhe i gjerë - në krahasim me funksionet shtetërore, meqë përfshin aktivitete me të cilat zakonisht merren një sërë ministrish dhe departamentesh, por edhe ambicioz - meqë merr përsipër shumë përgjegjësi për të "siguruar", "mbështetur", "kontribuar" dhe "ndihmuar".⁵⁴⁴ Shtrirja e mandatit të EULEX-it në tërë territorin e Kosovës, ka shkuar me vështirësi duke pasur parasysh situatën në veri të vendit. Akoma më vështirë ka qenë zbatimi i misionit sipas kompetencave të dhëna. Dhe pritjet në Kosovë, përgjithësisht lidhur me EULEX-in, kanë qenë shumë të mëdha sepse sundimi i ligjit është vlerësuar se duhet të jetë thelbësor, dhe këtë rol duhet ta luante ky mision, por më fuqishëm dhe më me përkushtim.

EULEX-i gëzon imunitet ndaj proceseve ligjore dhe administrative vendore. Kjo është në përputhje me atë që vlen për misionet e tjera ndërkombëtare dhe diplomatike nëpër botë.

⁵⁴² <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php> (parë më: 21 dhjetor 2013).

⁵⁴³ Po aty.

⁵⁴⁴ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, 4 shkurt, 2008, Neni 3, marrë nga: KIPRED - Analizë Politike Nr.1/13 Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç'ka më tutje*, Prishtinë, 2013, fq.11.

Megjithatë, përderisa legjislacioni vendor nuk mund të zbatohet kundër EULEX-it ose pjesëtarëve të tij, EULEX-i dhe pjesëtarët e tij duhet ta respektojnë legjislacionin vendor. Prandaj, nëse një pjesëtar i EULEX-it bën shkelje të ligjeve të Kosovës, imuniteti i tij/saj mund të hiqet dhe ky person mund të përgjigjet penalisht në shtetin amë.⁵⁴⁵ Misioni përbëhet kryesisht nga gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë dhe zyrtarë të doganave⁵⁴⁶ të cilët do të ballafaqohen me pritjet e popullatës në njërën anë, dhe me vështirësitë që rrjedhin nga situata e ndërlikuar dhe rrethanat e përgjithshme politike e shoqërore në Kosovë, në anën tjetër. Siç është përmendur, EULEX-i në vitin 2012 është rikonfiguruar dhe mandati i tij është zgjatur deri në vitin 2014, ndërkohë që ky mision është zvogëluar për rreth 25% dhe aktualisht operon në dy seksione: në Divizionin Ekzekutiv, që punon sipas mandatit të misionit ekzekutiv dhe divizionin e fuqizimit që koncentrohet në monitorim, mentorim dhe në këshillim të autoriteteve të Kosovës. Ndërsa në gusht është nënshkruar një marrëveshje e përbashkët për asistencë legale në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe EULEX-it, që nënkupton rolin ndërmjetësues të EULEX-it në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën dhe se EULEX-i do të lehtësojë procesin e kërkesave për asistencë legale nga këto shtete.⁵⁴⁷

Pritjet e opinionit publik nga angazhimi i EULEX-it në Kosovë kanë qenë të mëdha, në aspekt të fuqizimit të shtrirjes së sundimit të ligjit në Kosovë dhe sidomos në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe krimi i organizuar si edhe korrupsioni janë prioritet i EULEX-it. Një krahasim i vogël në mes të pritjeve dhe rezultateve mund ta ilustronjë një e dhënë si vijon: EULEX-i ka një sukses të vogël në ndjekjet e rasteve të mëdha të krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Sipas EULEX-it janë nxjerrë 202 vendime për raste serioze të krimit deri në mes të tetorit 2011, 14 lidhur me krimin e organizuar dhe 30 lidhur me korrupsionin e lartë.⁵⁴⁸ “Por, aftësia e misionit për t’u marrë me prioritetet e tij po sfidohet nga prioritetet e Brukselit në rajon. Prioritetet që i ka vendosur BE-ja për rajonin në asnjë rrethanë nuk duhet të paragjykojnë, pasi ato janë legjitime, por duhet të pranohet se prioritetet e BE-së në rajon, në kohë të caktuara,

⁵⁴⁵ Shih më shumë për të gjitha llojet e llogaridhënies të EULEX-it në Doracakun e EULEX-it për Sundimin e Ligjit, www.eulex-kosovo.eu.

⁵⁴⁶ http://www.eas.europa.eu/csdp/missions-and-operations/eulex-kosovo/pdf/factsheet_eulex_kosovo_en.pdf (parë më 2014).

⁵⁴⁷ Shih raportin e Progresit të Komisionit Europian të vitit 2011, fq.11.

⁵⁴⁸ Forum 2015 Short analyses of public policies: “What went wrong”? *Rock and Rule : Dancing with EULEX*, Group for legal and political studies, KFOS – operational project, Prishtinë, 2013, fq.12.

sfidojnë aftësinë e EULEX-it për të realizuar mandatin e tij.”⁵⁴⁹ Në mes të këtyre pritjeve nga vendorët, prioriteteve të BE-së në rajon dhe qëndrimit për të qenë neutrale ndaj statusit, krahas heterogjenitetit të misionit, misioni nuk është aq i lehtë të realizohet sidomos nëse merret për bazë edhe karakteri ekzekutiv i funksionit të EULEX-it. Mossuksesi i EULEX-it në ndjekjen apo në kapjen e të ashtuquajturve peshqit e mëdhenj, pos të tjerash është i kondiciounuar nga vështirësitë e gjetjes së dëshmitarëve, por edhe në sigurimin e jetës së tyre. Janë gjetur dëshmitarë të vdekur gjatë kohës së gjykimit, kurse tregimet në publik lidhur me këto raste kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kapacitetin e EULEX-it për të thirrur dëshmitarë dhe rrjedhimisht edhe për të ndjekur rastet e profilit të lartë të krimit të organizuar dhe të korrupsionit.⁵⁵⁰ Por edhe mbështetja politike nga institucionet kosovare nuk është treguar në nivelin e dukshëm. Për më tepër, në momente të caktuara, në ndjekje të krimeve të rënda jo vetëm që ka munguar vullneti i shprehur politik dhe përkrahja e duhur për EULEX-in, por sjellja dhe deklaratat e zyrtarëve kosovarë kanë krijuar përçarje dhe hapësirë për zhvillim të teorive të konspiracionit. Këtu duhet theksuar se në njëfarë mënyre edhe vetë sjellja e EULEX-it ka kontribuar në krijimin e përçarjes dhe zhvillimit të teorive të tilla.⁵⁵¹ Në anën tjetër EULEX-i, që nga ardhja në Kosovë nuk ka arritur që të shtrijë aktivitetin e vet të plotë në veri të Kosovës. Kjo ,në radhë të parë, për shkak të kompromisit që është dashur të bëhet me Serbinë kur është thënë se EULEX-i do të ketë qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Por natyrisht kjo nuk është arsye e vetme. Popullata lokale serbe në veri të Kosovës, ka qenë thuajse tërë kohën e ftohtë në raport me EULEX-in dhe në momente të caktuara krejtësisht e ashpër kundër EULEX-it. Kështu ky mision nuk arrin të kryejë misionin vet, dhe për këtë madje edhe është kritikuar nga vetë Sekretari i Përgjithshëm i NATOS, Anders Fogh Rasmussen.⁵⁵² Misioni nuk po gjente mënyrë dhe rrugë për zgjidhjen e

⁵⁴⁹ KIPRED - Analizë Politike Nr.1/13 Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç’ka më tutje*, Prishtinë 2013, fq.28.

⁵⁵⁰ Forum 2015 Short analyses of public policies: *“What went wrong”?* *Rock and Rule : Dancing with EULEX*, Group for legal and political studies, KFOS – operational project, Prishtinë, 2013, fq.13.

⁵⁵¹ Ilustrimi më i mirë i sjelljeve të këtilla të të dyja taborëve janë rastet Limaj dhe afera “Pronto”. Kur u akuzua ish- ministri Fatmir Limaj, fillimisht reagimet e zyrtarëve ishin të llojit se: po masakrohej drejtësia nga EULEX-i, se po nullosoj lufta çlirimtare e Kosovës dhe reagime të këtij lloji. Por me këtë rast kishte edhe mendime (sipas teorive të këtilla) se Limaj po akuzohej, sepse angazhimi i tij politik do të mund të shkaktonte dridhje në subjektin politik PDK, ku ai figuronte si njeri shumë i votuar. Por kur deklaratat në mbrojtje të Limajt ishin më të zëshme, atëherë EULEX-i gjithnjë sipas këtyre teorive publikoi incizimet nga afera “Pronto” ku dëgjoheshin funksionarë të lartë shtetërorë duke folur për çështje që i tejkalojnë temat personale dhe politike, etj. Për më tepër shih: <http://www.kohavision.net/video/rubikon/5100/>, komentuar nga: KIPRED - Analizë Politike nr.1/13 janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Ç’ka më tutje*, Prishtinë 2013.

⁵⁵² Shih: B92. (24 April 2012). “NATO chief criticizes EU mission in B92”. (24 April 2012). “NATO chief criticizes EU mission in Kosovo. ” Retrieved from <http://www.b92.net/eng/news/politicsarticle>.

problemit të barrikadave, me të cilat po bllokoheshin rrugët në veri për të penguar “vendosjen e policisë së Kosovës në pikat kufitare gjatë verës 2011.”⁵⁵³ Vështirë ishte të mendohej se mund të deblokoheshin rrugët dhe të hiqeshin barrikadat pa angazhimin e plotë të KFOR-it.

Pavarësisht vështirësive që ka EULEX-i në realizimin e vet, nuk mund të pritet një zbehje e autoritetet në shkallë të lartë në publikun kosovar, siç kishte ndodhur me UNMIK-u. Arsyet për këtë janë të ndryshme. Por kryesorja është se aspiratat për integritet janë prioritet për popullin shqiptar për Kosovën, e në këtë kontekst EULEX-i paraqet dhe përfaqëson BE-në, e cila në momente të caktuara paraqitet, kjo me qëllim, edhe si pengesë e zbatimit të misionit të EULEX-it. Kjo ngase për BE-në, në momente të caktuara prioritetet dallojnë dhe janë krejtësisht të tjera me ato që ka EULEX-i në Kosovë. BE-ja, ka vënë si prioritet dialogun Beograd – Prishtinë, apo dialogun rajonal në frymën e integriteteve të Ballkanit Perëndimor, etj., dhe këto dalin më shumë si çështje të karakterit politik, sesa çështje që mbështesin sundimin e ligjit në Kosovë.

EULEX-i në anën tjetër duke qenë në pozitë neutrale ndaj statusit, për të siguruar përkrahjen në veri të vendit në një anë dhe duke mos u marrë me misionin e vet sipas pritjeve dhe sipas zotimit mund të zbehë vetvetiu ndikimin dhe autoritetin e vet, që rrjedhimisht do të iniciojë debatin mbi domosdoshmërinë e ekzistencës së vet.

Numri i stafit të EULEX-it, duke qenë i vogël, nuk është garanci e suksesit të plotë, kurse mosinvestimi dhe moskalimi në momente të duhura i kompetencave nga EULEX-i tek institucionet kosovare është gjithashtu pengesë në realizim të funksioneve sipas kompetencave që ka.

Sidoqoftë, organizimi dhe forma e manifestimit të aktiviteteve të EULEX-it do të ndryshojnë pas qershorit të vitit 2014. Por pavarësisht dilemave, ngadalësisë në veprime, prioriteteve të ndryshme, qëndrimit ndaj statusit, etj., EULEX-i nuk pritet që të zbehë autoritetin dhe së paku jo në nivel dhe në shpejtësi që kishte përjetuar UNMIK-u. Kjo jo, sepse siç u tha Kosova aspiron integritetin dhe integriteti do të kushtëzohet në masë të madhe nga

php?yyyy=2012&mm=04&dd=24&nav_id=79921,marrë nga: Forum 2015 Short analyses of public policies: “*What went wrong*”? *Rock and Rule : Dancing with EULEX*, Group for legal and political studies, KFOS – operational project, Prishtinë, 2013, fq.14.

⁵⁵³ Shih Raportin e Progresit të Komisionit Europian të vitit 2012.

sundimi i ligjit në Kosovë, për të cilin, publiku kosovar është shumë i interesuar jo vetëm nga shkakut i integriteteve.

6.5. Shteti i Kosovës dhe integrimi European

Aspiratat e Kosovës dhe të popullit të saj për integritete europiane janë të kahmotshme. Zotimi për të përmbushur kritere dhe detyrime që parashtrohen për shtetet që aspirojnë aderimin në BE⁵⁵⁴ është shprehur në vazhdimësi nga institucionet e Kosovës. Pavarësisht faktit se raportet europiano-shqiptare gjatë historisë nuk kanë qenë siç janë këto të sotmet. Kanë ekzistuar paragjykime ndaj shqiptarëve përgjithësisht dhe për sa i përket këtij konteksti, Kosova nuk mund të përjashtohet. Veprime dhe ngjarje të caktuara europiane kanë shkaktuar pasoja për popullin shqiptar, të cilat janë bartur deri në ditët e sotme. Kongresi i Berlinit⁵⁵⁵, Konferenca e Londrës⁵⁵⁶,

⁵⁵⁴ Bashkimi European është një partneritet unik ekonomik dhe politik në mes të 28 shteteve, të cilat bashkërisht kapin pjesën më të madhe të kontinentit. BE-ja është krijuar në fund të Luftës së Dytë Botërore. Hapat e parë ishin forcimi i bashkëpunimit ekonomik: ideja ishte se shtetet që tregtojnë njëra me tjetrën bëhen interdependente dhe në këtë mënyrë shumë më lehtë evitojnë konfliktet. Rezultati ishte Komuniteti Ekonomik European (EEC) krijuar më 1958 dhe në mënyrë fillestare duke rritur bashkëpunimin ekonomik në mes të gjashtë shteteve: Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Qysh atëherë është krijuar treg i madh dhe vazhdon të zhvillohet në drejtim të potencialit të vet të plotë (për më tepër shih web faqen zyrtare të Bashkimit European: http://europa.eu/about-eu/index_en.htm).

⁵⁵⁵ Kongresi i Berlinit u hap më 13 qershor 1878, me rend dite rishikimin e Traktatit të Shën-Stefanit. Në të morën pjesë 6 Fuqitë e Mëdha të Europës: Gjermania, Anglia, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia. Sipas procedurës së vendosur paraprakisht, vendimet do të merreshin njëzëri. Punimet e Kongresit të Berlinit i drejtoi kancelari gjerman, Otto Bismark. Vendimet e Kongresit të Berlinit cenonin rëndë interesat e popullit shqiptar dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë. Ashtu si Traktati i Shën-Stefanit, edhe ai nuk e pa Shqipërinë si një njësi politike të veçantë, por e trajtoi si një plaçkë tregu të destinuar për të përmbushur synimet e Fuqive të Mëdha dhe për të kënaqur lakmitë e shteteve ballkanike. Traktati i Berlinit nuk i njohu Shqipërisë asnjë të drejtë kombëtare, madje nuk e zinte fare në gojë emrin e saj. Ai nuk e respektoi as tërësinë e saj territoriale. Malit të Zi, përveç trojeve me popullsi të përzier shqiptare e sllave, iu dhanë përsëri disa vise thjesht shqiptare (krahinat e Plavës, të Gucisë e të Rugovës), sikundër edhe Serbisë (krahinat e Vranjës, të Trenit e të Pirotit). Bullgarisë nuk iu njohën viset e Shqipërisë Lindore, por, nga ana tjetër, iu dhanë Greqisë (e cila nuk përfitonte asgjë nga Traktati i Shën-Stefanit), viset e Çamërisë. Veç kësaj, me Traktatin e Berlinit lindi edhe një rrezik tjetër për trojet shqiptare. Ky rrezik vinte nga Austro-Hungaria, e cila, përveç pushtimit të Bosnjës dhe të Herzegovinës, fitonte gjithashtu të drejtën të vendoste garnizone ushtarake dhe të ndërtonte rrugë strategjike në sanxhakun e Novi Pazarit “deri përtej Mitrovicës”. Me këto koncesione Vjena hidhte hapin e parë për të pushtuar një ditë krejt Kosovën dhe për të dalë pastaj në Selanik (shih më shumë në: http://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi_i_Berlinit).

⁵⁵⁶ Ideja e një konference ambasadorësh për të diskutuar problemet që dolën nga lufta ballkanike, u mbështet nga Ministri i Jashtëm britanik, sër Eduard Grej, (...) pushtimi i tokave shqiptare prej ushtrive fqinje si dhe dobësia e madhe e ushtrisë turke gjatë konfliktit ballkanik solli mpleksjen e interesave ndëroeuropiane në çështjen e gadishullit (...) kjo solli, gjithashtu, fillimin e bisedimeve të fshehta midis palëve të interesuara dhe sidomos midis Rusisë dhe Austro-Hungarisë, për të ardhmen e shqiptarëve dhe të territoreve të tyre, si pjesë e Ballkanit (...). Pikërisht për të diskutuar për Ballkanin dhe të ardhmen e tij, më 17 dhjetor 1912, u mbledh në Londër Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, nën kryesinë e Ministrit të Jashtëm anglez, Eduard Grej, (...). Në Konferencën e Ambasadorëve nuk u lejuan të merrnin pjesë delegacionet zyrtare të shteteve ballkanike duke përfshirë edhe Shqipërinë, por shtetet ballkanike fituese në konfliktin ballkanik ruajtën të drejtën t’i paraqitnin Konferencës së Ambasadorëve kërkesat e tyre territoriale, të drejtë që Shqipëria nuk e kishte... Si rezultat i punimeve të konferencës... (Kosova dhe pjesë të

Karl May-a⁵⁵⁷, ngathtësia për të vepruar më shpejt për parandalim të shpërthimit të luftës në Kosovë, etj., mund të jenë disa nga këto veprime. Por, pavarësisht kësaj, në Kosovë dhe te shqiptarët në përgjithësi, proeuropianizmi nuk është zbehur në asnjë fazë të zhvillimit, sado që dyshimet kanë qenë të pranishme. Dhe proeuropianizmi është manifestuar në forma të ndryshme, ndërsa për nevojën e këtij studimi, do të ndalemi te përpjekjet për të siguruar përkrahjen e kërkesave legjitime për liri dhe pavarësi të Kosovës dhe më vonë përpjekjet e Kosovës në rrugën për integritet europian. Përkrahja e integriteteve europiane në Kosovë, por në tërësi nga shqiptarët është dukshëm më e shprehur krahasuar me shumë vende të Europës juglindore. Këtë mund ta vërtetojmë edhe me rezultatet e një ankete të zhvilluar në Kosovë, sipas së cilës “Popullariteti i BE-së në Kosovë mbetet mjaft i lartë: në një referendum nëse duhet t’i bashkohet BE-së, 72 % e qytetarëve thanë “Po” – përqindje që nuk ka ndryshuar aspak nga dy vitet e kaluara. Shumica besojnë se integrimi do të ishte një përparësi për Kosovën; pothuaj 90 % e të anketuarve e konsiderojnë si të rëndësishëm fuqizimin e lidhjeve me BE-në; dhe më shumë se 70 % e tyre e shohin integrimin në BE si një zgjidhje të mundshme për problemet ekzistuese në ekonomi, bujqësi, transport, sigurim të së ardhmes për të rinjtë, mirëqenie sociale.”⁵⁵⁸ Ndërkohë që edhe vetë BE-ja ka kaluar nëpër disa faza për çka është dashur të ndërmerren disa hapa që ndahen si vijon:

- 1951: Komuniteti i Thëngjillit dhe Çelikut është themeluar nga gjashtë anëtarët themelues;

tjera të banuara me shqiptarë mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar (përfundim nga BRR-autori), për Konferencën e Ambasadorëve shih me shumë tek: Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912 – 2000*, Kristalina-KH, Tiranë, 2007, fq.25-55.

⁵⁵⁷ Karl Friedrich May (1842-1912) ka qenë shkrimtar popullor gjerman, i njohur më së shumti për novela siç ishin ato të stilit të vjetër perëndimor amerikan (Winnetou dhe Old Shatterhand) si dhe për libra të ngjashëm për lindjen dhe lindjen e mesme me Kara Ben dhe Handschi Halef Omar). Njihet edhe si njeri i muzikës dhe i artit si dhe që ka luajtur në shumë instrumente muzikore. (shih më shumë: http://en.wikipedia.org/wiki/Karl_May). Edhe pse nuk është e njohur të ketë qenë ndonjëherë në tokat shqiptare, në një nga veprat e tij, e njohur si: “Eine reise durch das land der skipetaren” shqiptarët dhe shoqërinë shqiptare i përshkruan me një gjuhë mjaft përcjuese. Shih më shumë nga: Jahrbuch der Karl-May-Gesellschaft.24 (1994), S.247-284, <http://karl-may-gesellschaft.de/kmg/seklit/jbkmg/247.htm> cituar nga: Bashkim I. Zahiti, *E Drejta Europiane*, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.197.

⁵⁵⁸ Anketa, e cila është organizuar nga projekti i financuar nga BE-ja, “Perspektiva e BE-së në Kosovë” (EUPK) është realizuar në maj dhe qershor të vitit 2012 nga “UBO Consulting”, përmbante 1,500 intervista ballë për ballë me përfaqësues nga i gjithë vendi, si shqiptarë, serbë dhe komunitete të tjera minoritare të Kosovës, të cilat kanë qenë të ndara sipas gjinisë, arsimimit, të ardhurave, dhe prejardhjes urbane dhe rurale. Një anketë e ngjashme është realizuar për Zyrën e BE-së në gusht të vitit 2010, e cila shërbeu si mundësi e mirë për krahasim të disa trendeve dhe aspiratave në opinionin publik. Më shumë për anketën shih : Anketa e plotë është në dispozicion në website e EUPK (www.eupk.org), MIE-së (www.mei-ks.net) dhe Zyrës së BE-së / PSBE-së (www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo).

- 1957: Gjashtë shtetet e njëjta nënshkruajnë Traktatin e Romës duke krijuar Komunitetin Ekonomik Europian (EEC) dhe Komunitetin Europian të Energjisë dhe të Atomit (Euroatom);
- 1973: Komuniteti zgjerohet dhe bëhet me nëntë shtete anëtare dhe prezantohen më shumë politika të përbashkëta;
- 1979: mbahen zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për Parlamentin Europian;
- 1981: zgjerimi i parë mediteran;
- 1992: Tregu unik europian bëhet realitet;
- 1993: Traktati i Maastricht-it krijon Bashkimin Europian (BE-në);
- 2002: Euro futet në qarkullim;
- 2007: BE-ja ka 27 shtete anëtare;
- 2009: hyn në fuqi Traktati i Lisbonës, i cili ndryshon mënyrën e punës së BE-së.⁵⁵⁹

Këta hapa në një mënyrë paraqesin etapat e zhvillimit të BE-së, por kur flasim për kontekstin e aspiratave të Kosovës për të aderuar në BE themi se këtë e gjejmë në hapat e vonshëm. Kurse procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë shënon periudhën kur Kosova do të vërë kontakte me Brukselin, për çështjet e veta kushtetuese. Këto kontakte fillestare nuk kanë qenë kontakte me qëllim aderimi, sepse procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë po bëhej në kohën e fuqizimit të tregut europian dhe në procesin e nxjerrjes së Traktatit të Maastricht-it që po krijonte BE-në. Në fakt këtu në BE po “bëhej me dije se Bashkimi Europian do të merrte në dorë çështjet e politikës së jashtme e të sigurisë europiane”.⁵⁶⁰ Bazuar në këtë, kontaktet fillestare kishin të bënin me: sensibilizimin e çështjes së Kosovës, me kërkesa për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë me përbërësit e tjerë të Jugosllavisë, sigurimin e mbështetjeve në fusha të ndryshme të jetës dhe kërkesa të tjera të kësaj natyre. Kurse vetë europianët kishin vendosur më 1991 se “të drejtën e shkëputjes nga ish -Federata Jugosllavisë e kishin vetëm republikat, por jo edhe krahinat (Kosova dhe Vojvodina). Vendet europiane nën diktatin e Francës e njohin Serbinë pas Dayton-it (1996) me emrin e vjetër Jugosllavia dhe i dhanë Serbisë dhe Malit të Zi të drejtën që ta trashëgonin emrin e federatës së dikurshme të shkatërruar.”⁵⁶¹ Më herët Komuniteti Europian

⁵⁵⁹ Pascal Fontaine, European Commission, Directorate-General for Communication Publications, ISBN 978-92-79-17486-5, European Union, 2010.

⁵⁶⁰ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës Juglindore, Tiranë, 2012, fq.386.

⁵⁶¹ Po aty, fq.389.

kishte nxjerrë udhëzimet për njohjen e shteteve të reja pas shpërbërjes së BRSS dhe RSFJ, çështje kjo që meriton një analizë të veçantë akademike lidhur me atë se a ka mundur Kosova të bëjë më shumë sipas udhëzuesit dhe a po arrijnë ta përdorin këtë udhëzues në favor të njohjeve të reja. Përpjekjet e BE-së për të ndërhyrë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, në periudhën para luftës, sado që nuk ofronin zgjidhje në pajtim me kërkesat e shprehura nga shqiptarët e Kosovës, sabotoheshin dhe refuzoheshin në vazhdimësi nga Serbia. Serbia në vazhdimësi këmbëngulte që ta trajtonte Kosovën si problem të brendshëm të saj edhe pse me asnjë element të saj, Kosova nuk mund të ishte problem i brendshëm i Serbisë. Ajo kishte refuzuar vazhdimisht iniciativat ndërkombëtare dhe një gjë të tillë po e bënte edhe në kohën kur konflikti po merrte përmasa të mëdha. Kështu, në verën e vitit 1998 BE-ja, për të dëshmuar një aktivitet më të shtuar në adresë të zgjidhjes së konfliktit në Kosovë caktoi ish -kryeministrin e Spanjës, Felipe Gonzales, si të dërguar të saj në ndërmjetësimin e paqes midis serbëve dhe shqiptarëve. Ai ishte njëkohësisht edhe i dërguar i OSBE-së në dialogun e shumëkërkuar. Por Millosheviçi e kishte refuzuar vizitën e Gonzales në Beograd, pasi, siç thoshte ai, nuk mund të pranonte ndërhyrjen në punët e brendshme të Jugosllavisë (Serbisë) të BE-së e sidomos OSBE-së, anëtare e së cilës nuk ishte Serbia.⁵⁶² Por të kthehemi tek evoluimi i kërkesave përfshirë edhe bashkëpunimin Kosovë - BE, duke u fokusuar në ato të pasluftës (1999) dhe pas shpalljes së pavarësisë (2008).

Me 10 qershor 1999 me iniciativë të BE-së në Cologne u aprovua Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore.⁵⁶³ Ishte kjo një ndër ndërmarrjet e mëdha të Bashkimit Europian⁵⁶⁴ ku më shumë se 40 vende partnere dhe organizata përkushtohen në fuqizimin e vendeve të Europës Juglindore në përpjekje për të ushqyer paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të prosperitetit ekonomik që të arrihej stabiliteti në tërë regjionin. Të gjitha vendeve të regjionit i premtuhej integrimi euro - atlantik. Pakti u riafirmua në Samitin e Sarajevës me 30 korrik 1999.⁵⁶⁵ Edhe pse thuhej se me këtë po punohet për një skenar për përfshirje e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor⁵⁶⁶, megjithatë për Kosovën, nuk po krijoheshin mundësi të

⁵⁶² Joint Action on the nomination of an EU Special Representative for the FRY, 8 June 1998, dok.in.a.a.O., faqe 229-230, cituar nga: Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës Juglindore, Tiranë, 2012, fq. 391-392.

⁵⁶³ <http://www.stabilitypact.org/about/default.asp> (qasur me 02 janar 2014).

⁵⁶⁴ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i studimeve të Europës Juglindore, Tiranë, 2012, fq.399.

⁵⁶⁵ <http://www.stabilitypact.org/about/default.asp> (parë më: 02 janar 2014).

⁵⁶⁶ Ku flitet për Ballkanin Perëndimor me vokabularin e BE-së mendohet për vendet e dala nga ish -Jugosllavia dhe për Shqipërinë, e, ku përjashtohet Sllovenia.

barabarta me vendet e tjera të Ballkanit. Për më tepër, tani nga shkak i mosnjohjes së shtetshmërisë së Kosovës nga Serbia dhe nga Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova ballafaqohet me vështirësi, të cilat e pengojnë pjesëmarrjen e saj në këshillin e bashkëpunimit regional (trashëgimtari i Paktit të Stabilizimit).⁵⁶⁷ Kosova në këtë kohë administrohej ndërkombëtarisht dhe për shkak se nuk kishte status të përcaktuar ishte lënë mënjanë, në një kohë kur vendet e tjera të Ballkanit po bëheshin gati për të nënshkruar marrëveshjet e stabilizim- asociimit. Disa edhe kishin nënshkruar. Në aspekt të rindërtimit të Kosovës, Bashkimi Europian kishte nënvizuar nevojën e vendosmërisë për të marrë një rol udhëheqës.⁵⁶⁸ Në Kosovë BE-ja do të fillojë të luajë rol të fuqishëm në rindërtim dhe zhvillim. BE-ja në kuadër të administratës së UNMIK-ut ka qenë pjesë e shtyllës IV dhe në vitin 2000 është themeluar Agjencia Europiane për Rindërtim (European Agency for Reconstruction). Kjo agjenci do të menaxhojë deri në vitin 2008 programin e Bashkimit Europian për Zhvillim, i cili buronte nga të ashtuquajturit CARDS - Programe, dhe të cilat ishin në këto fusha:

- rindërtimin;
- stabilizimin e regjionit;
- ndihmë për refugjatët e kthyer dhe për personat e zhvendosur;
- përkrahje për demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, shoqëria civile, mediet e pavarura dhe lufta kundër krimit të organizuar;
- zhvillimi i një ekonomie të qëndrueshme të orientuar kah tregu;
- zvogëlimin e varfërisë, barazinë gjinore, arsimimin dhe trajnimin dhe rehabilitimin e mjedisit;
- bashkëpunimi regjional, transnacional dhe ndërkombëtar në mes të vendeve recipiente dhe BE-së dhe me vendet e tjera të regjionit.⁵⁶⁹

Më vonë Kosova do të përfitojë në këtë kuptim edhe nga fondet për paraanëtarësim, që ndryshe njihen si IPA funds (Pre - Accession Instrument). Në këtë vazhdë, në korrik të vitit 2008

⁵⁶⁷ Forum 2015 - KFOS operational project, *Kosovo - EU Relations: The history of Unfulfilled Aspirations? Lost opportunities in Kosovo's European integration Process*, Prishtinë, 2013, fq.7.

⁵⁶⁸ http://www.europarl.europa.eu/summits/kol2_de.htm, marrë nga Bashkim I.Zahiti, E Drejta Europiane, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.199.

⁵⁶⁹ http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/eestern_balkans/r18002_en.htm (qasur me datë: 20 janar 2014).

në Bruksel u organizua një Konferencë e Donatorëve për Kosovën, në të cilën morën pjesë 37 shtete dhe 16 organizata ndërkombëtare, nga çka për Kosovën u zotuan 1.2 miliard euro.⁵⁷⁰

Fondet e BE-së për rindërtim dhe zhvillim, por edhe për fushat e tjera të jetës në Kosovë, janë kontribut shumë i çmuar, por angazhimi politik i BE-së për të avancuar dhe për të zgjidhur statusin final të Kosovës nuk ka qenë në nivel të nevojave dhe nuk mund të krahasohet me angazhimin e SHBA-së. Për një kohë të gjatë janë vërejtur hezitime rreth thellësisë së angazhimeve politike drejt Kosovës apo për Kosovën. Këto hezitime vazhduan edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vazhdojnë në forma të ndryshme edhe pas shpalljes së pavarësisë. Edhe pse ishte e qartë që Kosova nuk do të kthehej më në ndonjë katurë serbo - Malazeze, nga BE-ja në momente të caktuara, bëhej pikërisht kjo. Madje edhe kur shihej qartazi se bashkëjetesa e Serbisë me Malin e Zi nuk do të kishte gjasa, BE-ja dërgon Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë në Beograd për të ushtruar ndikimin e vet...me arsyetimin e vetëm: derisa Jugosllavia të mbijetojë, qoftë edhe nën një etiketë të re, pretendimet e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi nuk do të kenë ndonjë shans për sukses.⁵⁷¹ Por bashkësia Serbi dhe Mal i Zi, nuk zgjati shumë, sepse Mali i Zi do të ikte nga kjo bashkësi, që kishte mbetur si tendencë e fundit për t'u përdorur si argument se po ekzistonte RFJ-ja. Pavarësisht nga të gjitha, Kosova edhe pse pa status të përcaktuar, nuk mund të lihej mënjane politikisht. Në kontekst të procesit të paktit të stabilitetit për Kosovën u krijua një mekanizëm i veçantë që njihet si Mekanizmi Përcjellës i Stabilizimit Asocimit (MPSA). Ky mekanizëm i krijuar nga BE-ja ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2003, për të shërbyer si mekanizëm kryesor në dialogun në mes të Kosovës dhe Komisionit Europian, në kuadër të procesit të Stabilizimit Asocimit. Ky mekanizëm ka funksionuar në dy nivele:

- Në formë të dialogut politik duke u mbajtur mbledhje plenare të bashkëkryesura nga autoritetet më të larta qeveritare të Kosovës dhe Komisionit Europian. Këtu diskutohen arritjet në përmbushjen e Partneritetit Europian dhe arrihet pajtimi për periudhën vijuese. Që nga krijimi i MPSA-së e deri në qershor të vitit 2009 janë mbajtur 16 mbledhje të tilla.

⁵⁷⁰ Shih më shumë në: <http://ec.europa.eu/enlargement/archives/seerecon/kdc/index.html>.

⁵⁷¹ Verica Spasovska: Kunststaat im Interesse der EU, me 04.02.2004 në Deutsche Welle: <http://www.dw.de/kunststaat-im-interesse-der-eu/a-771277>, cituar nga: Bashkim I.Zahiti, *E Drejta Europiane*, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.200.

- Në formë të dialogut teknik ku zhvillohen mbledhje sektoriale për 6 sektorë: qeverisja e mirë, ekonomia, tregu i brendshëm, inovacioni dhe kohezioni social, infrastruktura dhe bujqësia e peshkataria.

Qëllimi i mbledhjeve politike dhe teknike është që komisioni European të përcjellë dhe monitorojë reformat e Kosovës në procesin e përafrimit me BE-në, në veçanti lidhur me prioritetet e parapara në Partneritetin European.⁵⁷² Duke qenë së Kosova nuk mund të lihej jashtë procesit të stabilizimit, brenda BE-së ishin zhvilluar dhe nxjerrë ide sesi duhej punuar me Kosovën. Një mekanizëm i tillë ishte MSPA-ja, ndërkohë që kishte edhe ide tjera. Një dokument i brendshëm me opinion të ekspertëve të drejtësisë të Këshillit të BE-së lidhur me mundësinë e marrëveshjeve kornizë për përfshirjen e Kosovës në programe të BE-së. Ata citojnë marrëveshjen në mes të Tajvanit dhe Hong Kongut si shembull për iluminimin e marrëveshjeve në mes të entiteteve që nuk janë shtete.⁵⁷³

Sidoqoftë Kosova ishte e vetëdijshme se duhej të plotësonte kritere të caktuara duke filluar me ato që ishin krijuar si kritere shtesë për vendet që ishin liruar nga bota komuniste. Kështu, për vendet që aspironin aderimin në BE, nga bota e Europës Qendrore dhe Lindore, Këshilli European kishte vënë disa kritere të njohura si kriteret e Kopenhagenit. Në bazë të këtyre, vendet candidate do të gjykoreshin për pranimin në BE dhe që përcaktonin:

- *Qëndrueshmëri të institucioneve duke garantuar demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat njerëzore si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve;*
- *Ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale si edhe të aftë për t'iu përgjigjur presionit konkurrues dhe forcave të tregut të BE-së;*
- *Aftësi për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë edhe ndjekjen dhe zbatimin e qëllimeve politike, ekonomike dhe monetare të bashkimit.*⁵⁷⁴

Por krahas këtyre kritereve duhet theksuar se lidhur me Ballkanin Perëndimor, procesi i stabilizim asocimit është ndërtuar në katër parime⁵⁷⁵, të paraqitura në vijim:

⁵⁷² Shih më shumë te Ministria e Integritimit European, në: www.mei-ks.net.

⁵⁷³ Forum 2015 - KFOS operational project, *Kosovo - EU Relations: The history of Unfulfilled Aspirations? Lost opportunities in Kosovo's European integration Process*, Prishtinë, 2013, fq.5.

⁵⁷⁴ Desmond Dinan, *Historia e Integritimit European*, AIIS për botimin shqip, Tiranë (pa vit të botimit), fq.188.

- *Në ofertën për stimulime në sferën ekonomike dhe politike, inkluzivisht perspektivën e integritit në struktura e BE-së;*
- *Në obligimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor që të reformohen;*
- *Në intensifikimin e bashkëpunimit rajonal dhe*
- *Bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.*

Krahas zotimeve të shprehura për perspektivën dhe alternativën e vetme për Kosovën në rrugë për integritime europiane, Qeveria e Kosovës në vitin 2005 në mënyrë të njëanshme ka nxjerrë Planin e Veprimit për Implementimin e Partneritetit European (PVPE), që paraqet një dokument kombëtar të politikave për integritime europiane. Plani i Veprimit i Partneritetit European (PVPE) është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues i Qeverisë së Kosovës që ka për qëllim përcaktimin e veprimeve të nevojshme për zbatimin e axhendës europiane dhe progresin në procesin e Integritit të Kosovës në BE, në pajtim me prioritetet e identifikuara nga Partneriteti European. Prioritetet e Partneritetit European janë ndarë në prioritete afatshkurtra (1-2 vite) dhe prioritete afatmesme (3-4 vite). PVPE-ja përfshin kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet europiane. Përmbajtja dhe struktura e planit paraqitet në formë prezantimi të reformave që janë ndërmarrë në aspektin e kornizës ligjore dhe institucionale në planin afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe në veprimet e planifikuara për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit të vitit të mëparshëm.⁵⁷⁶

Sado e vështirë dhe e paqartë të jetë situata lidhur me procesin e integritimeve europiane, bazuar në pozitën e vet sui generis, ku 5 nga 28 shtete të BE-së nuk e njohin shtetin e Kosovës, sidomos në periudhën e pasluftës janë ndërmarrë hapa dhe veprime konkrete, të cilat avancojnë pozitën e Kosovës në proces të integritimeve. Pas kryerjes së Studimit të Fizibilitetit për Kosovën (gjatë tërë vitit 2009), në nëntor të vitit 2009 KE-ja ka publikuar Komunikatën Kosova – Përmbushja e Perspektivës Europiane”, në bazë të së cilës Procesi i Stabilizim-Asociimit për Kosovën është avancuar nga Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim-Asociimit (MPSA) në Dialogun

⁵⁷⁵ Bashkim Zahiti, Die verfassungsrechtliche Entwicklung des Kosova unter Berücksichtigung der EU-Beitrittsperspektive, fq. 118, cituar nga: Bashkim I.Zahiti, *E Drejta Europiane*, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.202.

⁵⁷⁶ Shih më shumë te Ministria e Integritit European, në: www.mei-ks.net.

e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA). Korniza e DPSA-së ka filluar të zbatohet në fillim të vitit 2010.⁵⁷⁷

Më poshtë po japim këto aktet/veprimet e përzgjedhura nga Ministria e Integritimeve, e që lehtësojnë procesin e të kuptuarit të evoluimit të pozitës së Kosovës brenda procesit të integritimeve. Këto janë:

- Shtator 2000: aprovohen masa tregtare autonome në mes të Kosovës dhe BE-së;
- Nëntor 2002: themelohet Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim -Asociimit;
- Dhjetor 2002: takimi i parë ndërparlamentar joformal në mes të Parlamentit Europian dhe Kuvendit të Kosovës;
- Mars 2004: takimi i dytë ndërparlamentar joformal në mes të Parlamentit Europian dhe Kuvendit të Kosovës;
- Qershor 2004: Këshilli Europian adopton për herë të parë Partneritetin Europian për Kosovën;
- Gusht 2004: themelohet Zyra për Integrim Europian, Brenda Zyrës së Kryeministrit;
- Shtator 2004: hapet Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian në Kosovë;
- Janar 2005: adoptohet për të parën herë Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Europian;
- Shkurt 2005: organizohen për herë të parë punëtori sektoriale të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim -Asociimit në fushën e Energjisë dhe Ekonomisë;
- Prill 2005: Komisioni Europian adopton Komunikatë për Këshillin Europian dhe Parlamentin Europian mbi “Një të ardhme Europiane për Kosovën”;
- Qershor 2005: takimi i tretë ndërparlamentar joformal në mes të Parlamentit Europian dhe Kuvendit të Kosovës;
- Nëntor 2005: Komisioni Europian publikon për herë të parë Raportin e Progresit për Kosovën si dhe Letrën e Strategjisë së Zgjerimit;
- Janar 2006: Këshilli Europian adopton Partneritetin Europian për herë të dytë për Kosovën;

⁵⁷⁷ Po ay.

- Qershor 2006: takimi i katërt ndërparlamentar joformal në mes të Parlamentit European dhe Kuvendit të Kosovës;
- Gusht 2006: adoptohet Plani i Dytë i Veprimit për Implementimin e Partneritetit European;
- Nëntor 2006: Komisioni European publikon për herë të dytë Raportin e Progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit të BE-së dhe sfidat kryesore;
- Nëntor 2007: Komisioni European publikon raportin e tretë të progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit për vitin 2008;
- Dhjetor 2007: Këshilli European konfirmon gatishmërinë e BE-së për të asistuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës nëpërmjet një perspektive të qartë Europiane në një linjë me perspektivën europiane për rajonin;
- Janar 2008: Kuvendi i Kosovës themelon Komitetin për Integrim European;
- Shkurt 2008: Kuvendi i Kosovës miraton rezolutën që shpall Kosovën shtet të pavarur;
- Shkurt 2008: Këshilli i BE-së merr parasysh rezolutën e pavarësisë të Kosovës dhe vëren që vendet anëtare të BE-së do të vendosin vetë, në pajtueshmëri me praktikat vendore dhe të drejtën ndërkombëtare mbi marrëdhëniet e tyre me Kosovën. Gjithashtu nënvizon bindjen e BE-së që Kosova përbën një rast sui generis;
- Shkurt 2008: Këshilli i BE-së adopton Misionin e BE-së për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX). Gjithashtu, themelon zyrën e Përfaqësuesit Special të BE-së/Zyrën Ndërkombëtare Civile;
- Shkurt 2008: Këshilli European miraton për herë të tretë Partneritetin European për Kosovën;
- Shkurt 2008: Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore pasohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal;
- Prill 2008: Kosova miraton Planin për Integrim European 2008-2010;
- Maj 2008: takimi i parë ndërparlamentar në mes të Parlamentit European dhe Kuvendit të Kosovës;
- Qershor 2008: Këshilli European rikujton “gatishmërinë e BE-së për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës nëpërmjet një perspektive të qartë europiane, në një linjë me perspektivën europiane të rajonit”;

- Korrik 2008: miratohet për herë të tretë Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Europian;
- Korrik 2008: qeveria themelon struktura të reja për Integrim Europian;
- Tetor 2008: qendra e Koordinimit të donatorëve si dhe Agjencia për Integrim Europian bashkohen për të formuar Agjencinë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Europian;
- Tetor 2008: Komisioneri Europian për Zgjerim, Olli Rehn, viziton zyrtarisht Republikën e Kosovës;
- Nëntor 2008: Komisioni Europian publikon për herë të katërt Raportin e progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit 2009;
- Shkurt 2009: Kuvendi i Republikës së Kosovës adopton Rezolutën mbi prioritetet dhe Strategjinë e Kosovës për Integrim në BE;
- Mars 2009: mbledhet në Prishtinë për herë të parë Forumi i Nivelit të Lartë në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të donatorëve, ku diskutohet mbi projektet në ecuri e sipër dhe alokimin e zotimeve të Konferencës së Donatorëve të vitit 2008 për Kosovën;
- Prill 2009: takimi i dytë ndërparlamentar në mes të Parlamentit Europian dhe Kuvendit të Kosovës;
- Korrik 2009: përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Javier Solana, viziton zyrtarisht Republikën e Kosovës;
- Korrik 2009: miratohet për herë të katërt Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Europian;
- Tetor 2009: Komisioni Europian publikon për herë të pestë Raportin e Progresit;
- Tetor 2009: Komisioni Europian propozon fillimin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën si dhe negociatat mbi Marrëveshjen Tregtare në mes të Kosovës dhe BE-së;
- Tetor 2009: vendoset dialogu i Procesit të Stabilizim -Asociimit;
- Nëntor 2009: Qeveria e Kosovës miraton 10 prioritetet strategjike për integrim europian;
- Shkurt 2010: Përfaqësuesja e lartë e BE-së për çështje të Jashtme, Catherine Ashton, viziton zyrtarisht Kosovën;
- Prill 2010: themelohet Ministria e Integrimin Europian;

- Prill 2010: Komisioni Europian dërgon pyetësorin për të filluar përgatitjet për Marrëveshje Tregtare në mes të BE-së dhe Kosovës;
- Prill 2010: mbahet në Prishtinë takimi i dytë i Forumit të Lartë në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të donatorëve, me fokus në progresin e arritur gjatë periudhës raportuese (2009-2010) në lëvizimin e fondeve të zotuar në Konferencën e Donatorëve për Kosovën dhe në themelimin e strukturave institucionale të Kosovës për koordinim me donatorë;
- Maj 2010: Qeveria e Kosovës i dorëzon përgjigjet Komisionit Europian për Pyetësorin e Komisionit Europian;
- Maj 2010: miratohet për herë të pestë Plani i Veprimit për Partneritet Europian;
- Korrik 2010: Parlamenti Europian miraton rezolutën që thërret të gjitha vendet anëtare të BE-së të njohin pavarësinë e Kosovës;
- Korrik 2010: delegacioni i Komisionit Europian kryen mision identifikues për marrëveshje tregtare;
- Korrik 2010: Kosova rishikon dhe priorizon më tej Planin e vet të Veprimit për Partneritet Europian;
- Korrik 2010: mbahet takimi plenar për DPSA-në;
- Gusht 2010: vizita e Ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Guido Westerwelle, në Prishtinë për t'u takuar me zyrtarët më të lartë shtetërorë të Kosovës si dhe me përfaqësues ndërkombëtarë në Kosovë;
- Shtator 2010: Ministria e Integritetit Europian dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian në Kosovë lançojnë ciklin e programit të pjesës nacionale të Instrumentit të paraanëtarësimit (IPA) 2010;
- Tetor 2010: lançohet në përdorim Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Jashtme. Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Jashtme, gjegjësisht projekteve, programeve si dhe modaliteteve të tjera të asistencës së ofruar nga donatorët;
- Shkurt 2011: zëvendës drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim i Komisionit Europian, Stefano Sannino, viziton Kosovën ku takohet me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, me liderë politikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë të përfshirë në procesin e Kosovës drejt integritetit në BE;

- Shkurt 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë i nënkomitetit për drejtësi, liri dhe siguri në kuadër të dialogut të Procesit të Stabilizim -Asociimit;
- Mars 2011: Kryeministri Thaçi dhe Shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Europian në Kosovë, Renzo Daviddi, nënshkruajnë Programin Vjetor 2010 të Instrumentit për Asistencë të Paraanëtarësimit (IPA), paketa financiare e të cilit kap vlerën prej 63.9 milionë eurogjithsej.
- Mars 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë për Bujqësi, Zhvillim Rural, Peshkatori, Pylltari dhe Sigurinë e Ushqimit në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit;
- Mars 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim -Asociimit;
- Mars 2011: Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Rregulloren nr.01/2011 për Departamentet për Integrim Europian dhe Koordinim në kuadër të ministrive;
- Prill 2011: mbahet në Bruksel takimi i dytë i Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Shëndetit dhe të Konsumatorit në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit;
- Maj 2011: Ministria, Çitaku, i dorëzon Khaldon Sinno, u.d.Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Europian në Kosovë Kontributin e parë të autoriteteve të Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit;
- Maj 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë i Nënkomitetit për Inovacion, kapital njerëzor, politika sociale dhe shoqëri informative në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit;
- Maj 2011: mbahet në Bruksel takimi i dytë i Nënkomitetit për Tregti, Industri, Dogana dhe tatime në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit;
- Qershor 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë i Nënkomitetit për Ekonomik, Financa dhe Statistika në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit;
- Qershor 2011: Qeveria e Kosovës miraton Rregulloren nr.04/2011 për Koordinimin e Donatorëve, e cila përcakton strukturat institucionale vendore në këtë fushë dhe përgjegjësitë e tyre;

- Korrik 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë plenar i Dialogut të procesit të Stabilizim Asociimit në mes të autoriteteve të Kosovës dhe Komisionit Europian, ku diskutohen arritjet që nga publikimi i Raportit të Progresit 2010 për Kosovën dhe caktohen prioritetet e Axhendës Europiane për periudhën në vijim;
- Korrik 2011: mbahet në Prishtinë takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët për Monitorim të asistencës së BE-së për Kosovën;
- Korrik 2011: nënshkruhet në Shkup projekti i përbashkët Kosovë -Maqedoni për bashkëpunim ndërkufitar (BNK) në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencë të Paraanëtarësimit (IPA);
- Gusht 2011: Ministria e Integritit Europian dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Europian në Kosovë lançojnë ciklin e programimit të pjesës nacionale të Instrumentit të Asistencës të paraanëtarësimit (IPA) 2012;
- Shtator 2011: ministrja, Çitaku, i dorëzon Khaldon Sinno-s, ud. Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të komisionit Europian në Kosovë, Kontributin e dytë, sipas radhës, të autoriteteve të Kosovës për Raportin e Progresit 2011, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit;
- Shtator 2011: ministrja Çitaku viziton Londrën për të diskutuar perspektivën europiane dhe procesin nëpër të cilin Kosova do të kalojë drejt integritit Europian;
- Shtator 2011: ministrja Çitaku dhe ministrja shqiptare e Integritit Europian, Majlinda Bregu, nënshkruajnë në Prizren projektin e Përbashkët Kosovë-Shqipëri për Bashkëpunim Ndërkufitar në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencë të Paraanëtarësimit (IPA).⁵⁷⁸

Veprimet e ndërmarra apo aktivitetet e zhvilluara e kanë bazën e tyre në krahasim me atë që është thënë më lart, edhe në qershor 2005 Këshilli i Europës ka përsëritur se: "...progresi i secilit vend drejt integritit evropian, duke marrë në konsideratë evoluimin e *acquis-it*, varet nga përpjekjet për të përmbushur kriteret e Kopenhagen-it dhe kushtëzimet e bëra nga procesi i stabilizim asociimit. Për më tepër, në këtë proces, bashkëpunimi regional dhe marrëdhëniet e

⁵⁷⁸ Shih më tepër faqen zyrtare të Ministrisë së Integritit Europiane.

mira fqinjësore do të mbesin element esencial të politikave të BE-së”.⁵⁷⁹ Kjo vlente edhe për shtetet e Ballkanit Perëndimor, nga i cili Kosova nuk mund të përjashtohet sado që pozicioni i saj në këtë proces ishte më i vështirë krahasuar me shtetet e tjera të Ballkanit. Kjo, pos të tjerash edhe nga shkaku se ishte vend nën administrim ndërkombëtar. Por bashkëpunimi në frymën e rrugës së bashkëpunimit me qëllim integrimin kishte filluar dhe në fakt ishte i pashmangshëm. BE-ja edhe gjatë kohës së qeverisjes së plotë nga UNMIK-u do të merret me perspektivën europiane të Kosovës. Komisioni Europian do të lançojë raportin e progresit për Kosovën në vazhdimësi. Në prill të vitit 2005, Komisioni publikon një komunikim duke përsëritur përkushtimin/determinimin për të ndihmuar Kosovën, duke u kërkuar liderëve të demonstrojnë një përkushtim të qartë për parime demokratike, për të drejtat e njeriut, për mbrojtjen e minoriteteve, sundim të ligjit, reformë për ekonomi të tregut dhe për vlerat në të cilat është bazuar BE-ja. Ky komunikim i jep mbështetje axhendës për fuqizim të zhvillimit socio-ekonomik dhe integrim më të ngushtë në regjion.⁵⁸⁰ Me raporte të progresit në parim matet (assess) jetësimi i procesit të stabilizimit asociimit. Duke u bërë kjo dhe nëse analizohet struktura e raporteve, aty do të gjejmë raportin e BE-së me Kosovën, aty do të gjejmë analizën e gjendjes politike përfshirë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e minoriteteve, vlerësimin e gjendjes ekonomike, konkurrencës, legjislacionin, kapacitetet qeverisëse, vlerësimin se deri në ç’masë Kosova ka adresuar prioritetet e Partneritetit Europian, etj. Dhe që nga marsi i vitit 2002, Komisioni ka raportuar në Këshill dhe në Parlament për progresin e arritur për vendet e Ballkanit dhe për raportet Kosovë – BE.

Paraqitja në mënyrë kronologjike e disa veprimeve të ndërmarra lidhur me raportin Kosovë - BE nuk mund të shpjegojë në tërësi kompleksitetin e rrethanave, kur të kemi parasysh sidomos faktin se Kosova nuk mund të vendosë raporte kontraktuale me BE-në nga shkaku se vetëm shtetet anëtare të BE-së e kanë njohur Kosovën si shtet dhe disa ende vazhdojnë të mos e njohin. Është thënë vazhdimisht se “BE-ja do ta ndihmojë integrimin e Kosovës nëse institucionet e saj do të kenë një axhendë të qartë për integrim të vendit – porosisin zyrtarë të BE-së. Institucionet e Kosovës duhet të jenë të përkushtuara për të përmbushur kushtet e kërkuara nga BE-ja për

⁵⁷⁹ Shih më shumë: Raporti i Progresit i Komisionit Europian i vitit 2005, i disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf, fq.6.

⁵⁸⁰ Po aty.

integrim të vendit”.⁵⁸¹ Përmbushja e kushteve të kërkuara nga ana e BE-së nganjëherë del si çështje që vështirë të kuptohet dhe të matet. Kjo sidomos te çështjet e pozicionit të Kosovës karshi institucioneve të BE-së, të cilat mbajnë një qëndrim neutral ndaj Kosovës duke u vënë në një mënyrë në mes të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën shumë herë dalin si parakusht për ecjen përpara. Por ky raport nuk varet gjithmonë dhe vetëm nga Kosova. E mosnjohja e Kosovës nga 5 shtetet e BE-së, nga të cilat është kërkuar njohje, është edhe një tjetër vështirësi shtesë në grumbullin e vështirësive ekzistuese. Në mungesë të njohjes nga këto 5 shtete, nuk mund të kemi raporte kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës. Dhe aspiratat për integrim në BE, siç është thënë, në Kosovë janë të shprehura qysh moti sikundër që, siç është vërejtur, institucionet e Kosovës kanë bërë përpjekje të plotësojnë standardet e kërkuara dhe të përmbushin obligimet për integrim në një mekanizëm që nuk është i lehtë as për t’u kuptuar dhe as për t’u plotësuar. Anëtarësimi i një vendi në Bashkimin Europian nuk shihet si një akt, por si një proces. Ky proces nisët nga të qenët shtet sovran dhe transformimi në shtet anëtar, duke kaluar statusin e shtetit pretendues, pastaj të shtetit aspirant, të kandidatit potencial, më tutje në shtet aplikant, në shtet kandidat, mandej në shtet negociator deri te shtet anëtar.⁵⁸² Sesa është Kosovë larg apo se ku mund të vendoset Kosova në këtë zinxhir brenda procesit të anëtarësimit është çështje që mund të debatohet nga shumë këndvështrime. Ajo është sa larg aq edhe afër. Kurse interesi vlerësohet të jetë i përbashkët për të dyja palët: BE-në dhe për Kosovën. Në mes të përkushtimit të Kosovës për integritet dhe kushteve të vëna nga BE-ja, Parlamenti Europian ka bërë thirrje për shtetet, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që këtë ta bëjnë sa më parë që të jetë e mundur, në mënyrë që perspektiva europiane e Kosovës të kontestohet. E kjo është e mundur edhe nga pikëpamjet juridike, sepse BE-ja mund të lidhë Marrëveshje Stabilizim Asociimi me Kosovën, duke u bazuar në nenet 217 dhe 218 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të BE-së dhe Kosovës mund të lidhet në atë mënyrë që ajo të respektojë qëndrimet e shteteve anëtare lidhur me statusin e Kosovës. Në shumë raste, Këshilli ka vërtetuar perspektivën europiane të Ballkanit. Së fundi,

⁵⁸¹ Esat Stavileci, *Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Kolokiumi shkencor 15 qershor 2011, botuar në vitin 2012, Prishtinë, fq.17.

⁵⁸² Shih Blerim Reka, *Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të UE-së*, Bruksel, Shkup, 2010, cituar nga: Esat Stavileci, *Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Kolokiumi shkencor 15 qershor 2011, botuar në vitin 2012, Prishtinë, fq.18.

Këshilli e konfirmoi këtë perspektivë të Kosovës në dhjetor të vitit 2011. Ambicjet europiane të Kosovës gëzojnë përkrahje të fuqishme prej publikut të Kosovës.⁵⁸³

⁵⁸³ Raport Progresi i Komisionit European i vitit 2012.

EPILOG:

Periudhën 1974 – 2011 është përzgjedhur për studim për si vijon. *E para*, hyrja përshkruan shkurtimisht pozitën dhe situatat nëpër të cilat ka kaluar Kosova. *E dyta*, viti 1974 shënon një vit ku Kosova forcon pozitën kushtetuese brenda federatës si edhe jashtë saj. *E treta*, wshtw synuar të studiohet procesi i fuqizimit, por edhe të rrënimit të pozitës së Kosovës deri tek pushtimi i dhunshëm kushtetues. *E katërta*, studimi sikurse ka një fillim me një datë apo periudhë të caktuar ai duhet të ketë edhe një përfundim. Studimi përfundon enkas me ndonjë përvjetor apo me ndonjë ngjarje që mund të jetë simbolike ose përmbajtësore, dhe që mund të jetë pikë kthese apo një fillim i ri. Studimi përfundon me vitin 2011 dhe kjo këtë është bërë sepse këtë vit kanë filluar studimet e doktoraturës, datë kjo që megjithatë përfundon para fillimit të vitit 2012 kur fillojnë manifestimet më të rëndësishme të gjithë Kombit Shqiptar: 100 VJET SHTET. Studimi përfundon brenda këtij përkufizimi kohor nga siç u cek më lartë, për t'u zgjeruar dhe thelluar me studime tjera. Studimi përfundon në fillimin e shkollës doktorale (2011) në prag të festimit të Festës së Madhe.

Para përfundimeve, paraqiten disa momente dhe ngjarje, të cilat nuk janë përfshirë me studim ngase janë zhvilluar pasi studimi ka përfunduar.

Kosova ka hyrë në një proces intensiv bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe këto bisedime po vazhdojnë të mbahen nën patronatin e Baroneshës Ashdown. Ndërkohë që procesi i kërkesave për njohje të reja vazhdon të zhvillohet sikundër që numri i rritjeve është shtuar, por jo në nivel të dëshirave dhe të nevojave për njohje dhe jo në proporcion me frekuencën që kishin njohjet deri në vitin 2010. Deri me 15 janar 2014 Republika e Kosovës është njohur me rreth 55.4% nga shtetet anëtare të OKB-së. Kosova është njohur nga 23 shtete anëtare të Bashkimit Europian nga gjithsej 28 dhe e shprehur në përqindje kjo është 82%. E kanë njohur Kosovën edhe 24 nga 28 shtete anëtarë të NATO-s apo 86% dhe 35 nga 57 (61%) e shteteve të Organizatës për Bashkëpunim Islam. Zhvillimet në Kosovë kanë qenë mjaft dinamike për sa i përket përpjekjeve për shtimin e numrit të njohjeve, por edhe për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. E normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është një ndër parakushtet më kryesore për rrugën e integriteteve Europiane të Kosovës. Kryeministri i Kosovës që e mori mandatin e dytë në vitin 2010, ka marrë pjesë në një seri takimesh që janë zhvilluar në Bruksel me kryeministrin serb Ivica Daçiç. Ndër prioritetet kryesore për Kosovën është

përshpejtimi i procesit të integritit të Kosovës në BE dhe në këtë kontekst do të përzgjidhen aktivitetet kyçe që janë zhvilluar lidhur me procesin e integritimeve. Lidhur me këtë është iniciuar një dialog i ndihmuar nga BE-ja, që në një mënyrë përcakton rrugën e integritimeve europiane për Kosovën dhe për Serbinë. Prandaj do të bëhet përzgjedhje e disa zhvillimeve që kanë ndikim në këtë proces të integritit.

Me 10 shtator Grupi Ndërkombëtar Mbikëqyrës (ISG) duke konsideruar se Kosova parimisht ka zbatuar standardet e parapara me Propozimin Gjithëpërfshirës dhe duke konsideruar se Kosova ka aprovuar kornizë të domosdoshme legale dhe kushtetuese, ka shpallur përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur dhe ka shpallur edhe mbarimin e mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Kështu zyra e përfaqësuesit civil ndërkombëtar do të mbyllet në fund të vitit 2012. Pas këtij momenti BE-ja do të marrë një rol më të spikatur dhe më të madh.

Në vitin 2011 është zhvilluar regjistrimi i popullsisë në të gjithë Kosovën, por regjistrimi nuk ka përfshirë të dhëna për veriun e Kosovës. Në kohën e organizimit të zgjedhjeve të fundit në Kosovë, dalja e votuesve në zgjedhje ka qenë shumë e vogël. Në maj të vitit 2012 komunat Zubin Potok dhe Zveçan kanë organizuar zgjedhje lokale në mënyrë unilaterale në të njëjtën kohë kur janë organizuar zgjedhjet serbe në Serbi. Këto zgjedhje nuk janë njohur nga Prishtina, Beogradi dhe nga bashkësia ndërkombëtare.

Duke u bazuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së të shtatorit 2010, BE-ja ka ndihmuar për një dialog në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Dialogu është lançuar në vitin 2011 për të promovuar bashkëpunimin, për të arritur progres në rrugën për në BE dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve. Tashmë palët janë pajtuar për qarkullimin e lirë të personave, për vulat doganore, njohjen e diplomave universitare, shënimeve kadastrale, regjistrave civilë, IBM (Menaxhimi i përbashkët i kufirit) dhe në zhvillimin regional. Që të dyja: Kosova dhe Serbia duhet të vazhdojnë me implementimin me mirëbesim të asaj që është arritur dhe që të angazhohen konstruktivisht në rang të plotë të çështjeve me ndihmën e BE-së.

Kosova ka krijuar Këshillin Nacional për integritim në BE që kryesohet nga Presidenti/ja. Objektiv i këtij Këshilli Nacional është mobilizimi i institucioneve të Kosovës për të dhënë në axhendën e reformës së BE-së. Ministria e Integritimeve Europiane udhëheq një Task Force për integritime europiane. Ministria ka treguar zotësi të mirë për të mobilizuar ministrinë e tjera dhe institucionet duke koordinuar kontributin gjithëpërfshirës në Kosovë, në përgatitjet për studimin e fizibilitetit.

Në dhjetor, Kosova bëhet anëtare e Bankës Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD) dhe vend i operacioneve të EBRD-së. Në maj Kosova është organizatorja e një konference të donatorëve për energji të qëndrueshme. Në qershor Këshilli i Bankës Europiane për Zhvillim (CEB) pajtohet që Kosova t'i bashkëngjitet. Me 7 qershor Banka Europiane për Investime (EIB) nënshkruan marrëveshjen kornizë me Kosovën. Marrëveshja i mundëson Bankës që të procedojë me financimin e projekteve në Kosovë dhe që të japë ndihmë teknike. Përfshirja e EIB-së do të ndihmojë gjithashtu bashkëfinancimin e projekteve me donatorë të tjerë dhe do të përkrah instrumente të ndryshme siç është Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Kosova dhe Serbia kanë marrë pjesë aktive dhe konstruktive në dialogun e përkrahur nga BE-ja që është ngritur në një proces të nivelit të lartë të përkrahur nga Përfaqësuesi i Lartë duke ndjekur zgjedhjet e vitit 2012 në Serbi. Që nga tetori i vitit 2010 janë mbajtur 17 takime ku kanë marrë pjesë kryeministrat e dy vendeve. Një takim gjithashtu është mbajtur në mes të dy presidentëve: Tadiç dhe Jahjaga në shkurt, në kontekst të iniciativave të ndryshme të qershorit dhe të korrikut. Që nga janari i vitit 2013 takimet e dy kryeministrave rezultojnë me Marrëveshjen e parë për parimet e qeverisjes dhe normalizimit të marrëdhënieve të datës 19 prill, të komplementuar në maj me planin gjithëpërfshirës të implementimit. Kjo pikë referimi e arritur paraqet një ndryshim radikal në marrëdhëniet në mes të dy palëve. Kjo marrëveshje përfshin këto elemente kyçe: krijimin e asociacionit/komunitetit të komunave serbe; parimet e forcës së përbashkët policore të Kosovës dhe integrimin e të gjitha forcave policore të veriut të Kosovës në polici të Kosovës; parimet e integritit dhe të funksionimit të të gjithë autoritetit të drejtësisë brenda kornizës legale të Kosovës; dhe zgjedhjet komunale, që duhet të mbahen në veri të Kosovës, në vitin 2013 – të përkrahura nga OSBE-ja. Këto zgjedhje është paraparë të mbahen me 3 nëntor 2013, atëherë kur do të mbaheshin zgjedhjet për gjithë territorin e Kosovës. Të dyja palët janë pajtuar të mos bllokojnë apo të inkurajojnë të tjerët që të bllokojnë procesin e rrugës europiane për të gjithë. Ministrat janë fokusuar në veri të Kosovës dhe në krijimin e strukturave që i takojnë nevojave të sigurisë dhe të drejtësisë të popullatës vendore në një mënyrë që sigurohet funksionalizimi i një krijese institucionale dhe administrative në Kosovë në pajtim me Konkluzionet e Këshillit të dhjetori 2012.

Gjetjet dhe përfundimet

Në këtë studim janë nxjerrë disa përfundime. Midis tyre vlen të përmendet në radhë të parë se Kosova ka pasur një pozitë dualiste brenda federatës jugosllave, pozitë kjo që në momente të caktuara ka qenë më e dobët e në momente tjera shumë më e fuqishme. Emërtimi si krahinë autonome dhe emërtimi “kombësi” për shqiptarët e Kosovës janë dy argumente që kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës i kanë përdorur për të mohuar të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe shkëputje. Ata kanë përdorur edhe argumente tjera për të kundërshtuar pavarësinë e Kosovës.

Kushtetuta e ish RSFJ nuk ka qenë pengesë dhe nuk ka mundur të ndalojë pavarësinë e Kosovës; e drejta për vetëvendosje nuk i takon vetëm procesit të shkolonizimit; e drejta ndërkombëtare ka ndryshuar dhe është pasuruar me norma të reja të së drejtës sidomos pas shpërbërjes së dy federatave të bllokut komunist: BRSS dhe RSFJ; Komuniteti Evropian (BE e sotme) me fillimin e shpërbërjes së këtyre dy federatave ka nxjerrë kriteret e reja për njohjen e shteteve, në bazë të të cilave Kosova ka pasur të drejtë të plotë për të shpallur pavarësinë; Kosova gjithashtu të drejtën për vetëvendosje e ka fituar edhe në bazë të të drejtës së vetëvendosjes zhëmtuese; Kosova nuk ka qenë vetëm problem dhe projekt kosovar, por edhe problem dhe projekt ndërkombëtar, për të cilën janë mbajtur një sërë konferencash, nga të cilat më e rëndësishmja konferenca e Rambouillet.

Kosova është krijuar si rast *sui generis*; Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar se nuk është shkelur e drejta ndërkombëtare dhe Kosova për vite të tëra ka qenë nën administrim ndërkombëtar duke mos pasur kurrfarë lidhjesh me shtetin e dikurshëm që është shpërbërë dhe i cili në fund të fundit nuk ekziston më: nuk ka Republikë Federative të Jugosllavisë dhe as Federatë në mes të Serbisë dhe Malit të Zi; Marrëveshja e Rambouillet Kosovës i ka njohur të drejtën e vetëpërcaktimit pas një periudhe të caktuar kohore.

Më gjërësisht praktika e deritashme ka treguar se, në përgjithësi sistemet federative, qëndrueshmërinë dhe mbijetesën nuk e kanë të sigurt, sidomos kur njësitë federative përbëhen nga etnitete të ndryshme. Sado i lartë që të jetë niveli i zhvillimit të demokracisë, përsëri tendencat për dominim të një njësie ndaj njësisë tjetër mund të jenë të pranishme. Janë të pranishme edhe tendencat e dominimit të një etniteti ndaj etnitetit apo etniteteve të tjera. Dhe

këto tendenca çojnë kah shpërbërja e sistemit. Procesi i shpërbërjes nuk përfundon me marrëveshje në të gjitha rastet. Ku dhe kur nuk ka marrëveshje për shpërbërje, procesi i shpërbërjes mund të jetë i kushtueshëm. Kjo ngase tendencat e supremacisë dhe të dominimit të njërit entitet kundërshtohen nga aspiratat për liri dhe vetëvendosje të etnitetit tjetër. Si rezultat shfaqen mosmarrëveshjet si varianti më i butë, që mund të ndiqen me shpërthim dhune dhe konflikti, që çojnë edhe deri te lufta e armatosur. Rol të rëndësishëm në procesin e shpërbërjes luan edhe mënyra e krijimit të sistemit federativ duke pasur për bazë qëllimet e njërive federative që janë futur në atë federatë. Nëse dikush megjithatë futet në federatë në mënyrë të panatyrshme: me imponim dhe me dhunë, atëherë ekzistenca e federatës së tillë është edhe më shumë në pikëpyetje. Kjo ka qenë karakteristikë tipike në rastin e Jugosllavisë. Jugosllavia e pas Luftës së Dytë Botërore u krijua me parullën e vëllazërimit dhe bashkimit të popujve që u mbajt artificialisht për disa dekada. U mbajt sepse po mbahej Jugosllavia nga brenda dhe nga jashtë. Nga brenda sepse lideri i kohës, Tito, arriti të ndërtojë një model dhe një sistem të një socializmi të dallueshëm nga socio-komunizmi i pjesës tjetër të botës. Nga jashtë, për shkak të pozitës gjeostrategjike, ku bota e ndarë në dy blloqe po e trajtonte si një terren apo zonë që do t'i shërbente të dy blloqeve. Për më tepër Jugosllavia ndihmohej në formë kredish duke gëzuar një lloj simpatie dhe duke marrë një rol prijës në botën e tretë që po quhej bota e shteteve të painkuadrura. Por kjo Jugosllavi qoftë nga brenda, qoftë nga jashtë u pa se nuk ishte ndërtuar në themele të qëndrueshme. Nga brenda jo, sepse vullneti për t'u bashkuar në federatë nuk kishte qenë i vërteti. Federata ishte krijuar nga themeluesit jo në baza të shëndosha dhe të barabarta. Ata ishin futur me plane rezervë që në momentin më të volitshëm do të dilnin të ishin planet e vërteta.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, sigurimi i njohjeve për Kosovën ka qenë sfidë kryesore. Dhe kjo sfidë vazhdon të mbetet çështje e vështirë për t'u përballuar edhe disa vite pas shpalljes së pavarësisë. Vazhdon të jetë sfidë nga shkaqe të doktrinës së të drejtës ndërkombëtare lidhur me të drejtën e popujve për vetëvendosje. Siç u përmend edhe më sipër, sipas qasjes tradicionale të së drejtës ndërkombëtare, e drejta e vetëvendosjes mbetet e rezervuar vetëm për procesin e shkolonizimit. E drejta e vetëvendosjes, sipas kësaj qasjeje i takon vetëm shteteve që çlirohen nga sundimi kolonial dhe rrjedhimisht sipas kësaj, Kosova duke mos qenë koloni e dikujt, nuk kishte të drejtë, për të drejtën e vetëvendosjes dhe aq më pak për të drejtën e shkëputjes. Pengesë tjetër, apo bazë për kundërshtim të pavarësisë së Kosovës është frika se

rasti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës do të krijojë një precedent, i cili mund të përdoret në vende dhe rajone të tjera të botës e që do të rezultonte me destabilizim dhe me prishjen e balancit ndërkombëtar ekzistues.

Thuhet se Kosova ka bërë shpallje të njëanshme të pavarësisë dhe me këtë argumentohet se Parlamenti i Kosovës nuk ka pasur të drejtë të shpallte njëanshëm pavarësinë. Kjo argumentohet edhe me faktin se Kosova ka qenë vetëm krahinë brenda Federatës Jugosllave dhe krahinave nuk i është njohur e drejta e vetëvendosjes, sepse kjo e drejtë i ka takuar vetëm popujve dhe republikave dhe jo edhe krahinave autonome, ndërkohë që, është thënë se Kosova ka qenë element përbërës i Federatës Jugosllave.

Në fund të fundit shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk mund të merret, për të qenë vetëm një projektion kosovar. RFJ/Serbia u bombardua sepse refuzoi një marrëveshje të Konferencës Ndërkombëtare të Rambouillet-it, e cila parashihte periudhën kohore, kur qytetarët e Kosovës do të deklaroheshin për të ardhmen e tyre. Akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës u bë pas shumë vitesh administrimi ndërkombëtar, dhe ku edhe krijesa e fundit me emrin RFJ nuk po ekzistonte më, sepse Mali i Zi përfundimisht ishte larguar nga kjo krijesë, për ta lënë Serbinë që vazhdonte të kontestonte Pavarësinë e Kosovës, duke u thirrur në mite e legjenda, të cilat, se nuk mund t'i konkurrojnë aspak argumenteve historike shqiptare. Dhe krejt në fund si mund të bindet një popull të jetojë në një krijesë, e cila i ka lënë në kujtesë vetëm vuajtje, shtypje, presion e terror? Shtetshmëria e disa prej tyre u kontestua, kurse e disa të tjerave jo. Argumentet kushtetuese-juridike gjenden në sistemin kushtetues të ish- federatës, kurse fakti se Kosova dhe populli shumicë i saj u trajtuan jo si të barabartë me popujt e tjerë i shërben ndërtimit të argumentit të asaj që njihet si vetëvendosje zhdëmtuese dhe që akoma më shumë e përforcon të drejtën e Kosovës për pavarësi dhe për shtetshmëri. Krijimi i shtetit të Kosovës, për nga brenda duhet shikuar si proces që ka qenë specifik ashtu si edhe vetë krijimi i Federatës Jugosllave. Nga brenda Kosova kishte ndërtuar elemente qenësore të shtetësisë së saj dhe në procesin e shpërbërjes së federatës Kosova bëri përpjekje dhe u pozicionua për veten e saj, sikurse edhe të tjerët. Pra fakti që pavarësia e shpallur, në fazën e hershme të shpërbërjes së federatës, nuk u pranua, shkon vetëm në favor të asaj që po përmendim, të vetëvendosjes zhdëmtuese. Ky fakt nuk mund të mohohet për nga rëndësia historike dhe pavarësia e shpallur në vitin 2008 nuk e mohon lidhjen politike, por as atë juridike të këtij akti dhe të këtij procesi të shtetndërtimit.

Komuniteti European (BE e sotme) në fazën e hershme të shpërbërjes së BRSS-së dhe RSFJ-së ka nxjerrë udhëzuesin për njohjen e shteteve të reja që po dilnin nga këto sisteme të koklavitura federative. Kosova e sotme që të gjitha këto kushte i ka të plotësuara. Për më tepër një vështrim në Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit vërteton se Kosova ka marrë obligimin që t'i plotësojë të gjitha këto kritere si edhe kritere të tjera plotësuese. Kriteret e Komunitetit European, për njohjen e shteteve të reja, i pasurojnë normat e së drejtës ndërkombëtare. Këto kritere të nxjerra nga institucione evropiane, përdoren dhe zbatohen së pari nga SHBA-ja, me rastin e njohjes së Kosovës. Ngjajshëm, duke bërë vlerësimin nëse këto kritere Kosova i ka plotësuar dhe respektuar, shtetet e fuqishme kanë bërë njohjen e Kosovës. Në anën tjetër nuk ka norma ndërkombëtare me të cilat është ndaluar shpallja e pavarësisë dhe këtë në fund të fundit e ka vërtetuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, duke konstatuar se shpallja e Deklaratës së Pavarësisë nuk ka bërë dhunim të së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha karakteristikat e dhëna kanë shërbyer që Kosova të njihet nga mbi 100 shtete dhe kanë shërbyer që Kosova të anëtarësohet në disa mekanizma të rëndësishëm ndërkombëtarë. Krijimi i shtetit është një akt dhe është fakt, i cili do të mbulohet juridikisht përmes procesit të njohjes.

Diplomacia, politika, bota akademike dhe mediet shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri përgjithësisht nuk kanë përdorur argumentet e përmendur, në ato pjesë të botës, ku ende ka hezitime për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe shtetshmëri. Njohuritë akademike dhe përvoja diplomatike duhen sintetizuar më tepër dhe infrastruktura e shtetit shqiptar duhet përdorur pa frikën se po veprohet për krijimin e një shteti të përbashkët shqiptar.

Paqartësitë institucionale dhe paqartësitë në kompetenca paraqesin pengesë në procesin e aktiviteteve lobuese për sigurimin e njohjeve. Në disa raste kemi qenë dëshmitarë të krijimit të paqartësive lidhur me njohjen nga disa shtete prej shkakut të angazhimit në një rast konkret të shumë personave dhe shumë përfaqësuesve institucionalë.

Fakti se njohjet janë të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës nuk mund të amnistojë ndokënd nga përgjegjësia për pengesat që paraqiten nga tendenca për supremaci në proces.

Koordinimi institucional duhet të fuqizohet dhe duhet pasur një axhendë të qartë lobimi me ndarje detyrash për të gjithë bartësit e përgjegjësive të aktiviteteve politiko - diplomatike.

Krijimi i një mekanizmi të veçantë si Task Force lobimi në vendet që nuk kanë njohur Kosovën mund t'i shërbejë përshpejtimit të procesit të njohjeve. Ky mekanizëm në përbërje të vet mund të ndahet në disa departamente. Departamenti për sigurimin e njohjeve nga shtete e lindjes.

Departamenti për sigurimin e njohjeve nga shtete e Amerikës Latine dhe kështu me rradhë. Në këto departamente mund të angazhohen diplomatë karriere nga bota shqiptare (në veçanti nga Republika e Shqipërisë), intelektualë dhe njohës të sistemeve politike të shteteve që nuk kanë njohur shtetin e Kosovës. Task Forcë e tillë mund të jetë i koordinuar nga Ministria e Jashtme e Kosovës dhe nga Presidenca e vendit.

Krahas kësaj duhet angazhim i botës akademike që të përmbledhë normat e së drejtës ndërkombëtare, ku bazohet e drejta e Kosovës në vetëvendosje dhe kjo duhet vënë në shërbim të diplomacisë shqiptare, sikundër që intelektualët duhet të depërtojnë më shumë përmes aktiviteteve të tyre sidomos në vendet të cilat ende nuk kanë njohur shtetin e Kosovës. Aty duhet të gjithë të argumentojmë se Kosova pavarësinë e vet e ka shpallur duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare, në bazë të një procesi që shpërbënte një federatë, në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtën e popujve për vetëvendosje, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare nga të cilat kishte marrë obligime, në bazë të kriterëve të BE-së për njohjen e shteteve të reja, në bazë të të drejtës moderne ndërkombëtare që është pasuruar me norma të reja, dhe në bazë të normave të së drejtës së vetëvendosjes zhdëmtuese. Të gjitha këto argumente duhen përdorur bashkërisht dhe kjo përbën atë që rastin e Kosovës e paraqet si rast *sui generis*.

BURIMET DHE LITERATURA KRYESORE

Burime parësore

- § Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RSFJ, Gazeta Zyrtare nr.55/68, Beograd, 1968.
- § Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RSFJ, Gazeta Zyrtare, nr.9/74, Beograd, 1974.
- § ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës, viti 1945, kutia 23/A, dokumenti nr.2352.f.1-2. Rezolucion i Asamblesë krahinore të Kosovës e Metohisë.
- § ASHAK, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1979-1988, Numri i lendës 36, kutia 3, f.1. Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë dhe pozita e KSA të Kosovës e detyrat e saj.
- § Congressional Research Service - CRS for Congress, Order Code RL31053, Kosovo and U.S. Policy: Background to independence, updated June 2008.
- § COUNCIL DECISION 2012/291/CFSP of 5 June 2012 amending and extending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; New EULEX Organizational Chart; COUNCIL DECISION 2010/322/CFSP of 8 June 2010 amending and extending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO; COUNCIL JOINT ACTION 2009/445/CFSP of 9 June 2009 amending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO.
- § Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e vitit 2008.
- § Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut, shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr.10-22/90.
- § Dokumenti Standardet para statusit.
- § Forum 2015 Short analyses of public policies: *"What went wrong"?* *Rock and Rule : Dancing with EULEX*, Group for legal and political studies, KFOS – operational project, Prishtinë, 2013.

- § Guideliness on the Recognition of New States in Eastern Europe and in the Soviet Union, December 16,1991.
- § http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf.
- § <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html> Montevideo Convention on the Rights and duties of States, 1933, available at:
<http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-40.html>.
- § ICG: *Kosovo: No good alternatives to the Ahtisaari plan*, Europe Report No182-14 maj 2007.
- § Independent International Commission on Kosovo: The Kosovo Report, fq.11, nxjerrë nga <http://www.reliefweb.int/library/documents/thekosovoreport.htm>, publikuar me 21.06.2006.
- § Izbor materiala za javnu debate o ustavnim amandmanima,Tanjug, Beograd 1971.
- § KIPRED, *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë - Mësimet e mësuara dhe ato që mbetën për tu mësuar*, Prishtinë/Gjenevë 2005.
- § KIPRED, *Analizë politike nr.6, Kosova shtet i paprecedencë*, Prishtinë 2007.
- § KIPRED-Analizë Politike Nr.1/13 Janar 2013, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje*, Prishtinë 2013.
- § Komunikatë për shtyp (Press Release) e Këshillit të Bashkimit Europian e datës 18 shkurt 2008, nga mbledhja e 2851.
- § Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e vitit 2001.
- § Kushtetuta e KSAK e vitit 1974, Gazeta Zyrtare e KSAK, nr.4/74.
- § Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008.
- § Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar në Kaçanik me 7 shtator 1990.
- § Kushtetuta e RFPJ 1946, Gazeta Zyrtare, nr.10/46, Beograd ,1963.
- § Kushtetuta e RSFJ 1974,Gazeta Zyrtare,nr.9/74,Beograd,1974.
- § Kushtetuta e SFRJ e vitit 1963, Gazeta Zyrtare nr.14/63, Beograd, 1963.
- § Ligji Kushtetues i Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare, nr.3/53, Beograd, 1963.
- § Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë-Marrëveshja e Rambouillet e vitit 1999.

- § Marrëveshja tekniko ushtarake e Kumanovës lidhur në mes të KFOR-it dhe Qeverisë së RFJ, 9 qershor 1999.
- § Memorandumi i SANU - Memorandumi i Akademisë Serbe të Arteve dhe Shkencave – 1986.
- § Ocjene i prikazi, Fontes Izvori za Hrvatsku Povijest, No.3 (Zagreb) 3.
- § Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i datës 22 korrik 2010.
- § Opinioni nr. 1 të Komisionit të Arbitrazhit, të datës 29 nëntor 1991.
- § Opinioni nr. 8 të Komisionit të Arbitrazhit, të datës 4 korrik 1992.
- § Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për të ardhmen e Kosovës, S/2005/709, 10 Nëntor 2005.
- § Plani i implementimit të standardeve, 31 mars 2004.
- § Press Statment, 23 March 1999 (NATO Press Release 1999 040);
- § Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës e vitit 2007.
- § Propozimi gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.
- § Raporti Gjithëpërfshirës i Kai Eide për Vlerësimin e Standardeve, 7 tetor 2005, UN Doc.S/2005/635.
- § Raporti i Kai Aides 13 maj, 2005 (S/2005/335).
- § Raporti i Martti Ahtisaarit dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, S/2007/168, datë: 26 mars 2007.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2005.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2006.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2007.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2008.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2009.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2010.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2011.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2012.
- § Raporti i Progresit të Komisionit Europian të vitit 2013.
- § Republic of Slovenia, Ministry of Foreign Affairs, Written Comments of the Republic of Slovenia on other written statements, submitted to the International Court of Justice, 17 July 2009.

- § Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, Accordance with International Law of the unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of self-government of Kosovo, 17 July 2009.
- § Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e datës 10 qershor 1999.
- § Rezoluta A/RES/63/3 e datës 30 shtator 2008.
- § Rezoluta e Konferencës së Bujanit - nxjerrë nga libri Këshilli Popullori Krahinës Autonom të Kosovës dhe Dukagjinit.
- § Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Republikën e Kosovës Shtet Sovran dhe i Pavarur, miratuar me 18 tetor 1991.
- § Rregullorja e UNMIK-ut, nr.2001/9.
- § S/RES/1160 (1998), 31 March 1998 dhe S/PV.3868, 31 March 1998, p. 13 (USA), 7 (Slovenia), 27 Bosnia and Herzegovina.
- § The EC Declaration Concerning the Conditions for Recognition of New States. Extraordinary EPC meeting, Brussels, December 16, 1991.
- § UN Security Council Resolution 1160, 31 March 1998.
- § UN Security Council, 3988th meeting, 24 March 1999, Doc. S/PV. 3988, p.18
- § UN Security Council, 3988th meeting, 24 March 1999, Doc. S/PV. 3988, pp. 4
- § Why Conditional Independence? The follow up of the Kosovo report, The Independent International Commission on Kosovo, 2001.
- § Written contribution of the Republic of Kosovo, submitted to the International Court of Justice, April 17, 2009.

Burime dytësore

- Agani Fehmi, *Pavarësia gjasa dhe shpresë*, Dukagjini, Pejë, 1999.
- Ahrens Geert-Hinrich, *Diplomaci mbi tehun e thikës*, Toena, Tiranë, 2010.
- Ahtisaari Marti, *Detyra në Beograd*, Trend, Prishtinë 2008.
- Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Kosova shtet i Pavarur dhe Sovran*, Prishtinë, 2006.

- Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Kosova vështrim monografik*, Prishtinë 2011.
- Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës*, Kollokuium Shkencor, Prishtinë, 2011.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Botimi i dytë i ripunuar, Toena, Tiranë, 2002.
- Akademia e Shkencave, *Kosova një vështrim enciklopedik*, Toena, Tiranë, 1999.
- Albright Madeleine, *Zonja Sekretare Autobiografi*, Dudaj, Tiranë 2004.
- Allcock John B., *Explaining Jugoslavia*, London, 2000.
- Bajrami Arsim, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Artini, Prishtinë, 2011.
- Bajrami Hakif, *Kosova njëzet shekuj të identitetit të saj*, Prishtinë, 2001.
- Bashkurti Lisen, *Diplomacia e vetizolimit - Rasti i Shqipërisë 1961-1989*, Geer, Tiranë, 2004.
- Biserko Sonja, *Kovanje antijugoslavenske zavere, Libri 1, Svedocanstvo*, Beograd 2006.
- Brownlie Ian, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, 2003.
- Bugajski Janos, *Ngritja e Kosovës*, Koha, Prishtinë, 2006.
- Buja Ramë, *Konferenca e Rambujesë*, Vertigo, Prizren, 2006.
- Bulatovic Liljana, *Ispovest* 1995.
- Bytyçi Enver, *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Instituti i Studimeve Juglindore, Tiranë 2012.
- Christopher Pierson, *Shteti modern*, AIIS Tiranë 2009.
- Clark Wesley, *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the Future Combat*, Public Affairs, New York 2001.
- Clinton Bill, *My life*, Alfred A.Knope, New York, 2004.
- Cox Michael&Stokes Doug, *Politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara*, Oxford University Press 2008, Botimet IDK.
- Daci Jordan, *Të Drejtat e Njeriut*, Botimi i tretë, Julvin, Tiranë 2011.
- David Owen's *Balkan Odyssey*, New York Harvest Book, 1995.

- Dinan Desmond, *Historia e Integritimit Evropian*, AIIS për botimin shqip, Tiranë (pa vit të botimit).
- Dufour Pierre, *Kosova – Paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë 2010.
- Duka Valentina, *Histori e Shqipërisë 1912 – 2000*, Kristalina-KH, Tiranë, 2007.
- Fevziu Blendi, *100 vjet Një ekskursion në politikën e shtetit Shqiptar nga 1912 – 2012*, Klan&UET Press, Tiranë 2012.
- Filo Llambro, *Platforma ideore dhe institucionet politike Amerikane*, Ideart, (Pa vit botimi).
- Fine John V.A., *Rasti i jashtëzakonshëm i Josip Broz Titos*, AIIS, Tiranë, 2010.
- Fontaine Pascal, European Commission, Directorate-General for Communication Publications, ISBN 978-92-79-17486-5, European Union, 2010.
- Gashi Bejtush, Pjetër Hidri, *Konflikti ndërkombëtar dhe ndëretnik*, Twins 2008.
- Gashi Ibrahim, *Kosova Rruga te pavarësia*, Prishtinë 2012.
- Gashi Shkelzen, *Marrëveshja për Paqe*, Copyright, Prishtinë, 2004.
- Gecaj Bajram, Konferenca e Rambujesë, AIKD Prishtinë 2009.
- Glenni Misha, *The Fall of Yougosllavia*, London, 1996.
- Gruda Zejnullah, *E Drejta Ndërkombëtare Publike* (Botim i plotësuar dhe i përmirësuar), 2007 Furkam ISM – Shkup.
- Gruda Zejnullah, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*, Botimi i Pestë, Prishtinë 2010.
- Hasani Enver, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: rasti i Jugosllavisë*, Buzuku 2010.
- Holsti Kalevi J., *Shteti, lufta dhe gjendja e luftës*, AIIS, Tiranë 2008.
- Horvat Branko, *Kosovsko Pitanje*, Drugo dopunjeno izdanje, Globus Zagreb, 1989.
- Ismaili Hilmi&Sejdiu Fatmir, *Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës*, UP, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2000.
- Ismaili Osman, *Fillet e së Drejtës*, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004.
- Jackson Robert&Sorenses Georg, *Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Dudaj, Tiranë, 2013.
- Jans Reuter, *Shqiptarët në Jugosllavi*, Botimpex, Tiranë 2003.

- Jashari Ruzhdi, *Diplomacia e forcës dhe forca e diplomacisë, Lufta e UÇK-së dhe intervenimi ndërkombëtar*, Shkrola, Prishtinë 2011.
- Jovic Borisav, *Poslednji dani SFRJ: Izvodi iz dnevnika*, Politika, Beograd, 1995.
- Joviq Borisav, *Poslednji dani SFRJ*, Prizma, Kragujevac, 1996.
- Judah Tim, *Kosovo, war and Revenge*, New Haven and London: Yale University Press, 2000.
- Keka Gjon, *Gabimet Politike në Kosovë dhe Shqipëri*, Botart 2010.
- Krasniqi Jakup, *Kosova në kontekst historik*, Buzuku 2010.
- Krasniqi Jakup, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Buzuku, Prishtinë, 2006.
- Krisafi Ksenofon, *Diplomaci pas lufte*, Dita 2000, Tiranë, 2009.
- Kullashi Muhamedin, *Politika, Lufta dhe Diplomacia – Anarkia ndërkombëtare dhe e drejta*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës 2012.
- Kushner Bernard, *Luftëtarët e paqes*, Mësonjëtorja, 2004.
- Lefter Nasi, *Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë 1981-1986*, Toena 2011 Tiranë.
- Lenard Cohen J., *Millosevic Misteri i pushtetit*, AIIS Tiranë 2010.
- Malcolm Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha 2001.
- Maliqi Shkëlzen, *Dialog me Baton Haxhiun Shembja e Jugosllavisë, Kosova dhe rrëfime tjera*, UET/Press Tiranë 2011.
- Meier Victor, *Fundi Jugosllavisë, goditja në Kosovë*, Lubjanë, 2007.
- Meier Viktor, *Yugoslavia. A History of its Demise*, London, Routledge, 1999.
- Mesiç Stipe, *Si u shkatërrua Jugosllavia*, Prishtinë 2011.
- Milo Paskal, *Ditari i një ministri të jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001* Toena Tiranë 2009.
- Milo Paskal, *Nga Rambuje në pavarësi*, Toena Tiranë 2009.
- Mingst Karen A., *Bazat e marrëdhënieve ndërkombëtare*, AIIS 2008.
- Muharremi Bujar, Ballkan: *Quo vadis Serbisllavia, Mbi një shtet që u zhduk nga harta e botës*, Pakti, Tiranë 2008.
- Murati Shaban, *Enigmat diplomatike të Pavarësisë së Kosovës (Fletë nga ditari i një ambasadori)*, Kristalina KH, Tiranë, 2007.

- Murati Shaban, *Profile të diplomacisë europiane në Ballkan*, UET Press, 2009.
- Nebojsa Raicevic, *Humanitarna Intervencija u Medjunardodnom Javnom Pravu* (doktorska dizertacija), Universiteti i Nish-t, 2008
- Nye Joseph S., Jr & David A. Welch, *Konflikti dhe bashkëpunimi në marrëdhëniet ndërkombëtare*, Dudaj, Tiranë, 2014.
- Omari Luan, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues*, Dudaj, Tiranë, 2009.
- Petritsch Wolfgang & Pichler Robert, *Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, Koha, Prishtinë, 2002.
- Pettifer James & Vickers Miranda, *Çështja Shqiptare – Riformësimi i Ballkanit*, albPaper, Tiranë 2007.
- Pettifer James, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948 – 2001*, Onufri 2013.
- Puto Arben, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Universiteti Marin Barleti Press, Botimi i dymbëdhjetë (pa vit botimi).
- Qosja Regjep, *Çështja shqiptare, historia e politika*, Prishtinë 1994.
- Qosja Regjep, *Paqja e Përgjakshme*, Toena, Tiranë, 1999.
- Qosja Regjep, *Shqipëria dhe Kosova*, Si janë dhe si do duhej të jenë, Toena, 2013.
- Reka Blerim, *Vitet e shpresës*, Zëri, Prishtinë 1991.
- Saliu Kurtesh, *Lindja, Zhvillimi, Pozita dhe Aspektet e Autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
- Schmitt Oliver Jens, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike*, Koha Prishtinë 2012.
- Schwartz Stephen: *Kosova – prejardhja e një lufte*, Prishtinë, 2006.
- Silber Laura & Little Allan, *Yugoslavia: Death of a Nation*, London, Penguin Books 1996.
- Smith Anthony D., *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale*, Dudaj, Tiranë, 2008.
- Smith Steve, Hadfield Amelia, Dunne Tim, *Politika e Jashtme*, UET Press, Tiranë, 2012.
- Stavileci Esat, *Çështja shqiptare në udhëkryqin e zgjidhjeve paqësore*, Prishtinë 1995.
- Stavileci Esat, *Kosova nën Administrimin Ndërkombëtar*, Forumi për Iniciativë Demokratike, Gjakovë 2000.

- Stavileci Esat, *Shteti – shqyrtime të përgjithshme teorike me vështrim rasti i Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2008.
- Stavileci Esat, Vepra I, *Kosova në ish-Jugosllavi*, Dardania, Prishtinë 2013.
- Stavileci Esat, Vepra V, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, Dardania, Prishtinë 2013.
- Suomalainen Nina&Karvinen Jyrki, *Trashëgimia e Ahtisaarit, Finlanda dhe Ballkani 1992-2008*, Prishtinë 2010.
- Syla Sabit, *Dokumente diplomatike të Qeverisë Shqiptare për demonstratat e vitit 1981*, KGT Prishtinë 2012.
- Syla Sabit, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939 – 1981*, Instituti i Historisë, Prishtinë 2012.
- Shala Blerim, *Libri i fitores, Vëllimi i parë&Vëllimi i dytë*, Koha Prishtinë 2012.
- Shala Blerim, *Shteti i shkelur*, Koha, Prishtinë,2012.
- Shala Blerim, *Vitet e Kosovës 1998-1999*, Gama Prishtinë 2001.
- Tokvile Aleksis dë, *Mbi demokracinë në Amerikë*, Dukagjini, Pejë , 1998.
- Udovicki Jasminka&Ridgeway James, *Makthi Etnik i Jugosllavisë*, Albin, Tiranë1998.
- ULLURJAR Ar.A.&S.G.KULESHOV, *Faktori Kosovë*, Elve,Tiranë, 2009.
- Verli Marenglen, *Shqipëria dhe Kosova – Historia e një aspirate*,Vëllimi i dytë, Botimpex, Tiranë,2007.
- Vickers Miranda&Petiffer James, *Shqipëria nga anarkia te një identitet ballkanik*, Toena,1998.
- Vickers Miranda, *Between Serb and Albanian, A history of Kosovo*, London,1998.
- Vukaj Shaqir, *Rusia dhe Kosova*, Enriko Koco,Tiranë 2007.
- Weller Marc, *Shtetësia e Kontestuar – Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Koha Prishtinë 2011.
- William A.Schabas, *Gjenocidi në të Drejtën Ndërkombëtare*, Cambridge University Press, 2000, Katalogimi në publikim - (CIP).
- Zahiti Bashkim I., *E Drejta Europiane*, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.197.
- Zimmerman Voren, *Poreklo jedne katastrofe: Jugoslavia i njeni rusitelji*, Dan Graf, Beograd, 1996.

Punime-Revista-Zhurnale-Journals

- § Bazylar M.J: *Reexamining the Doctrine of Humanitarian Intervention in Light of the Atrocities in Kampuchea and Ethiopia*, Stanford Journal of International Law, vol. 23, Spring 1987
- § Brenfors M.-Petersen M.M: *The Legality of Unilateral Humanitarian Intervention - A Defence*, Nordic Journal of International Law, vol. 69, 2000, no. 4, pp. 449-499
- § Buchann A: *Reforming the International Law of Humanitarian Intervention*, in Holzgrefe J.L.-Keohane R.O: *Humanitarian Intervention: Ethical, Legal and Political Dilemmas*, Cambridge, 2003
- § Cedric Ryngaert&Sven Sobrie, *Recognition of States: International Law or Realpolitik? The Practice of Recognition in the Wake of Kosovo, South Ossetia and Abkhazia*, Leiden Journal of International Law, 24(2011), pp.467-490, Foundation of the Leiden Journal of International Law, doi:10.1017/S0922156511000100, fq.24 - marrë nga Cambridge Journals Worsten.
- § David Criekemans, *Final Status of Negotiations, Model United Nations-Flanders*, Third edition, University of Antwerp, Belgium, 2007.
- § Dedushaj Naim, *Paradiplomatic' relations between the United States and Kosova: A friendship between an elephant and a mouse*, University of Malta, 2006.
- § Forum 2015 - KFOS operational project, *Kosovo - EU Relations: The history of Unfulfilled Aspirations? Lost opportunities in Kosovo's European integration Process*, Prishtinë, 2013.
- § Grant Thomas, *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution* Plaeger Publishers 1999 http://www.pf.uni-lj.si/media/skrk_mnenja.badinterjeve.arbitrazne.komisije.1_.10.pdf.
- § Gruda Zejnullah, *Some key principles for a Lasting Solution of the Status of Kosova: Uti possidetis, the ethnic principle, and self determination*, Chicago-Kent Law Review, Volume 80, Issue 1 Symposium: Final Status for Kosovo: Untying the Gordian Knot, 2005.
- § Helton A.C: *The Legality of Providing Humanitarian Assistance Without the Consent of the Sovereign*, Interantional Journal of Refugee Law, vol. 4, 1992, no. 3,

- § Hersch Lauterpacht, *Recognition in International Law 1947*-citar nga William Thomas Worster, LAW, POLITICS, AND THE CONCEPTION OF THE STATE IN STATE RECOGNITION THEORY,
<http://128.197.26.34/law/central/jd/organizations/journals/international/volume27n1/documents/Worster.pdf>. princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf.
- § <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>.
- § J.Castellino, *International Law and Self-Determination* (2000)II8 cituar nga: Cedric Ryngaert&Sven Sobrie, Recognition of States: International Law or Realpolitik? The Preactice of Recognition in the Wake of Kosovo, South Ossetia and Abkhazia, Leiden Journal of International Law,24 (2011), pp.467-490, Foundation of the Leiden Journal of International Law, doi:10.1017/S0922156511000100.
- § Jansen G.Richard,<http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html>.
- § Marcus Brand,*The development of Kosovo Institutions and the transition of authority from UNMIK to local self-government*, CASIN, Geneva 2013.
- § Martti Koskenniemi, *National Self-determination Today*, Problems of Legal Theory and Practice, International and Comparative Law, Quarterly Vol.43 April 1994, Part 2.
- § Muharremi Robert, *The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law*, 2010 Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht/ZaöRV 70 (2010).
- § Nikolas Lemay-Hebert, *State building from the outside in: UNMIK and its Paradox*,
<http://www.princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf>.
- § Oppenheim, *International Law* 8th edition,Vol I,1955 para 71 in D.J Harris Cases and Materials on International Law (5th edition,Sweet&Maxwell,1998).
- § Pellet A: *State Sovereignty and the Protection of Fundamental Human Rights: An International Law Pespective*, Pugwash Occasional Papers, vol. 1, no. 1,
<http://www.pugwash.org/publication/op/opv1n1.html>
- § Portela C: *Humanitarian Intervention*, NATO and International Law, Research Report 00.4, December 2000
- § Ryngaert and Griffionen, “*The relevamce of the right to self-determination in the Kosovo matter: in partial response to Agora papers*,”para.6, cituar nga Ieva Vezbergaite, Remedial Secession as an Exercise of the Right to Self-Determination of Peoples, Central European University, CEUeTD Collection, Budapest,2011.

- § Rrahmani Bashkim & Belegu Majlinda: International Conference Booklet, *10 years of Slovak Aid, A vision of development cooperation for a changing world*, Bratislava 2013, Pontis/Ministry of Foreign Affairs/UNDP.
- § Rrahmani Bashkim, International Scientific Forum, ISF 2013, Tiranë, Conference Proceedings, vol.2.
- § Stahn Carsten, *Constitution without a State? Kosovo under UN Constitutional Framework for Self-Government*, 2001 14 Leiden Journal of International Law 531,540.
- § Thomas G. Weiss, "Collective Spinelessness: U.N. Actions in former Yugoslavia, in *The World and Yugoslavia's Wars*, edited by Richard H. Ullman (New York. A Council on Foreign Relations, 1996).
- § Wheeler N.J: *Saving Strangers: Humanitarian Intervention in International Society*, Oxford-New York, 2000.
- § Wolff Stefan - *Learning the Lessons of Ethnic Conflict Management? Conditional Recognition and International Administration in the Western Balkans since the 1990-* Nationalities Papers, Vol. 36, No. 3, July 2008, ISSN 0090-5992 print; ISSN 1465-3923 online/08/030553-19#2008 Association for the Study of Nationalities.
- § Woodward Susan L., *Does Kosovo's Status Matter? On the International Management of Statehood*, SÜDOSTEUROPA, 55 (2007) 1, S. 1–25.

Gazeta:

- § Borba
- § E përditshmja Politika
- § Revista Vreme
- § Revista: NIN

Web faqe:

- § http://europa.eu/about-eu/index_en.htm
- § http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/r18002_en.htm
- § <http://karlmaygesellschaft.de/kmg/seklit/jbkmg/247.htm>
- § <http://news.bbc.co.uk/2/hi/7582181.stm>

- § http://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi_i_Berlinit
- § <http://www.aacl.us/aaclhistory.htm>
- § <http://www.aacl.us/aboutus.htm>
- § <http://www.alb-net.com/about.htm>
- § http://www.b92.net/eng/news/politicsarticle.php?yyyy=2012&mm=04&dd=24&nav_id=79921
- § <http://www.chathamhouse.org/sites/default/files/public/International%20Affairs/Blanket%20File%20Import/inta069.pdf>
- § <http://www.dw.de/kunststaat-im-interesse-der-eu/a-771277>
- § http://www.eeas.europa.eu/csdp/missions-and-operations/eulex_kosovo/pdf/factsheet_eulex_kosovo_en.pdf
- § <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php>
- § <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/whatisEulex.php>
- § http://www.europarl.europa.eu/summits/kol2_de.htm,marrë
- § <http://www.glasnost.de/kosovo/990324clinton.html>
- § <http://www.kohavision.net/video/rubikon/5100>
- § <http://www.stabilitypact.org/about/default.asp>
- § http://www.stratfor.com/weekly/georgia_and_kosovo_single_intertwined_crisis
- § www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo
- § www.eupk.org
- § www.mei-ks.net
- § www.princeton.edu/jpia/past-issues-1/2009/4.pdf
- § www.state.gov
- § www.unosek.org
- § www.ut.ee/ABVKeskus/publ/1999/Post_Soviet_Nationalism.html.-Worsten
- § http://sq.wikipedia.org/wiki/Marr%C3%ABdh%C3%ABniet_Shqip%C3%ABri_-_SHBA